



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**

**R A P O R T**

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit  
1 Janar – 31 Dhjetor  
Viti 2009**

## **Fjala e Avokatit të Popullit**

**E nderuar Zj. Kryetare e Kuvendit  
Të nderuar Zj. dhe Z. Deputetë**

Kur unë u zgjodha për herë të parë Avokat i Popullit në 16 shkurt të vitit 2000, mora në dorë nga Kuvendi i Shqipërisë jo vetëm një vendim në letër, por edhe mbështetjen politike konsensuale, maksimale për atë kohë, për ta ngritur këtë institucion mbi bazën e parimeve të njohura të punës për një ombudsman të mirë. Këto parime janë paaësia politike, konfidencialiteti, profesionalizmi dhe pavarësia nga 3 pushtetet, parime të cilat janë zbatuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë tonë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë edhe qeverisjen e mirë.

Eshtë e vërtetë se ne në Shqipëri kemi një institucion Ombudsmani, detyrat dhe të drejtat e të cilit për fat të mirë janë përcaktuar qartë në Kushtetutën tonë si dhe kemi një ligj organik për Avokatin e Popullit, i cili është cilësuar si një ligj nga më të mirët në Evropë për llojin e tij. Eshtë gjithashtu e vërtetë se ne patëm fatin e mirë që të kemi mbështetje të fortë morale dhe financiare nga miqtë tanë ndërkombëtarë. Por dua të shtoj se të gjithë këta faktorë “objektivë” nuk do të jepnin rezultatin e kërkuar pa faktorin e brendshëm, pa Avokatin e Popullit dhe stafin e tij. Kështu që ne, me përkushtim të thellë për misionin tonë, nuk u lodhëm nga pengesat dhe vështirësitë e para, të cilat në të vërtetë kanë qenë të panumërta, duke filluar nga mungesa e njohjes si nga publiku, ashtu edhe nga zyrtarët shqiptarë për të drejtat dhe detyrat e Avokatit të Popullit, mungesa e stafit dhe e mjeteve të punës dhe deri tek mungesa e zyrave të mjaftueshme. Ne shpallëm vizionin tonë, të cilin vlerësoj se e kemi bërë realitet, se kontrata e Avokatit të Popullit është para së gjithash jo me partitë politike dhe pavarësisht rotacionit të tyre në pushtet, por kontrata jonë është me qytetarët shqiptarë, me ata që ju mohohen apo ju shkelen liritë dhe të drejtat e tyre themelore, si e drejta e jetës dhe pronës private, e drejta e informimit, e drejta e mirëadministrimit të punëve të shtetit etj. Duke punuar vetë me transparencë të thellë dhe në bashkëpunim të ngushtë me Mediat, ne kemi synuar që me hetimet dhe rekomandimet tona jo vetëm të ndihmojmë qytetarët shqiptarë apo të huaj që na kanë kërkuar ndihmë, por të ndikojmë që administrata jonë publike, përfshirë edhe pushtetin gjyqësor dhe prokurorinë, të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të bëhen të përgjegjshme për nevojën e qeverisjes së mirë, dhe kundër abuzimeve me pushtetin, kundër çdo akti

apo veprimi të padrejtë apo të paligjshëm ndaj qytetarëve që mund të ketë si nxitje apo të jetë rrjedhojë e paaftësisë, korrupsionit apo nepotizmit.

Gjatë këtyre 10 viteve janë rreth 33 mijë ankesa të trajtuara nga Avokati i Popullit dhe 20-22 përqind e atyre që kanë qenë brenda juridiksionit tonë janë zgjidhur në favor të qytetarëve. Ndërhyrjet tona institucionale janë evidentuar në dy drejtime, së pari, në zgjidhjen e ankesës konkrete dhe së dyti, në rregullimin e kuadrit ligjor, në përputhje me standartet e kërkuara nga Kushtetuta dhe dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. Si rrjedhojë janë bërë 168 rekomandime për përmirësimin e ligjeve dhe akteve nënligjore normative, nga të cilat 142 ose 84 përqind janë pranuar nga organet që i kanë nxjerrë ato. Nga 142, për 99 rekomandime ose 70% janë bërë edhe ndryshimet e propozuara.

### **Të nderuar të pranishëm!**

Puna e Avokatit të Popullit në Shqipëri ka qenë e larmishme, pasi të larmishme janë edhe problematikat që kanë ngritur njerëzit pranë nesh, përmes ankesave të tyre. Megjithatë, ne e ndjejmë se duhet të punojmë për të përmirësuar performancën tonë. Ndjekja me këmbëngulje e problemeve të ngritura, deri në realizimin e plotë të tyre, do të ngelet një sfidë e përhershme për Avokatin e Popullit. Gjithashtu një marrëdhënie më e harmonizuar me Parlamentin, do të ishte më efikase për realizimin e asaj që ne, duke kopjuar miqtë tanë danezë, kemi theksuar se jemi, si “krah i zgjatur i Parlamentit për kontrollin e ekzekutivit”.

Thelbin e filozofisë së funksionimit të Avokatit të Popullit në Shqipëri unë e kam thënë shpesh dhe ai ka qenë: “Avokati i Popullit nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë asnjëherë Opozitë kundër Qeverisë, pavarësisht se cilat forca politike do të kenë pushtetin, por do të jetë gjithmonë një Oponencë për Mirëqeverisje”. Por gjithashtu me kënaqësi duhet të deklaroj se për këtë filozofi jemi mirëkuptuar nga të gjithë palët që bëjnë politikën në Shqipëri dhe gjej rastin që për këtë mirëkuptim t’i falenderoj publikisht në emër të institucionit.

Ne, veç parimeve të shpallura si paanësia, pavarësia, profesionalizmi dhe konfidencialiteti kemi patur parasysht 3 aksioma; 1) “një ombudsman i panjohur nga publiku dhe zyrtarët nuk mund të jetë ombudsman i vërtetë”; Për këtë veç një fushate Mediatike të mirëorganizuar, ne nuk kemi pritur që qytetarët gjithmonë të na vijnë në zyrë, por tashmë prej vitesh kemi organizuar edhe aktivitetet që i kemi quajtur “ditë të hapura”. Pra kur të paktën dy herë në vit, kemi shkuar në tërë territorin e Republikës, për t’i marrë ankesat apo kërkesat atje ku janë problemet e qytetarëve.

2) Ne kemi bërë tonën edhe aksiomën tjetër, sipas së cilës “nuk është ombudsman ai, që nuk e bën administratën të mbledhë buzët”, që thënë ndryshe, zyrtarët t’i ngacmojmë në qetësinë e tyre dhe t’i bëjmë më

të ndjeshëm dhe të ndërgjegjshëm për faktin se ata ekzistojnë dhe janë përfitues pikërisht nga taksat e qytetarëve ankues.

3) Avokati i Popullit nuk ndryshon vetë vendimet e administratës publike, por bën vetëm rekomandime për ndryshimin e tyre. Por shpesh qytetarët nuk e kuptojnë këtë dhe ngelen të pakënaqur. Në letrat e tyre ata shpesh kërkojnë që Avokati i Popullit të japë apo të ndryshojë vendimet në favor të tyre ose edhe të marrë pjesë në gjykatë krahas tyre. Por Ombudsmani nuk është modeluar për të ndryshuar vendimin e një zyre apo të një administratori. Ne, si të gjithë ombudsmanët e tjerë nëpër botë, thjesht rekomandojmë për një vendim ndryshe, duke u bazuar mbi profesionalizimin, në drejtësinë dhe në integritetin e pikëpamjeve tona, për ta bindur administratorin të ndryshojë vetë qëndrimin apo vendimin e tij.

### **Të nderuar të pranishëm!**

Avokati i Popullit festoi 10-vjetorin e krijimit të tij me një status të trefishtë. Së pari, ne funksionojmë si zyrë Ombudsmani, në kuptimin kushtetues dhe juridiko-administrativ, pra të investigatorit dhe të rekomanduesit për administratën publike shqiptare. Këtij atributi i përgjigjet një realitet, siç thamë prej rreth 33 mijë ankesash të shqyrtuara, pas të cilave qëndrojnë disa qindra mijëra të tjerë qytetarë, të cilët kanë përfituar nga zgjidhjet në favor të tyre.

Së dyti, ne funksionojmë si Institucion Kombëtar për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut, madje të riakredituar me statusin “A”. Këtij atributi në përputhje me Parimet e Parisit, i përgjigjet një realitet gjithashtu i kënaqshëm, sepse përmes përgatitjes dhe dërgimit direkt të informacioneve tona apo të raporteve vjetore apo të veçanta tek strukturat ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut, mendojmë se kemi ndikuar sadopak edhe në përgjegjshmërinë dhe performancën e zyrtarëve shqiptarë në raport me të drejtat e njeriut. Por me punën tonë gjithashtu kemi ndikuar për mirë në ndryshimin pozitiv të Raporteve ndërkombëtare për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe si rrjedhojë, ne kemi ndikuar pozitivisht në procesin e pranimit në NATO dhe në atë të plotësimit të kushteve për në Bashkimin Evropian.

Së treti, Avokati i Popullit, që nga viti 2008, funksionon edhe si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në kuadër të Konventës Evropiane Kundër Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe të Protokollit Opsional. Tashmë në Shqipëri kemi një realitet të kënaqshëm, jo thjesht për faktin e realizimit të rreth 150 inspektimeve nëpër burgje, dhoma paraburgimi, në spitalet psikiatrike, porte e aeroporte, në repartet ushtarake, në shtëpi pleqsh dhe fëmijësh. Përtej këtij fakti, kontrollet tona kanë pasur ndikimin e vet në përmirësimin e gjendjes në këto institucione.

Duke vlerësuar veprimtarinë 10-vjeçare të Avokatit të Popullit, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin Nr.6355 datë 07.12.2009 i dha Institucionit të Avokatit të Popullit, Urdhërin “Nënë Tereza” me këtë motivacion: **“Për gatishmërinë, humanizmin dhe kurajon e treguar në përmbushjen e misionit Kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve në Republikën e Shqipërisë”**.

**Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,**

Ju faleminderit për mundësinë që më dhatë që për 10 vite radhazi të punoj si Avokat i Popullit, që t’i shërbej Atdheut tim, që t’i tregojmë të gjithëve, shqiptarëve dhe të huajve se ne, shqiptarët dimë të ndërtojmë dhe të udhëheqim me sukses institucione thellësisht demokratike që nga fillimi.

Më lejoni të citoj, jo për të parën herë, një vlerësim të punës së Ombudsmanit, të bërë nga homologu im Danez, z. Hans Gammeltoft Hansen: “Puna e Ombudsmanit është art i mbajtjes së ekuilibrave. Nga njëra anë, Ombudsmani duhet të jetë rojtar i të drejtave të njeriut dhe i mirëqeverisjes, dhe natyrisht ai nuk duhet të trembet për të marrë dhe trajtuar çështje që mund të jenë, le të themi, kundërthënëse dhe problematike. Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme që Ombudsmani të sigurojë pranueshmërinë e organeve të administratës, të cilën ai kontrollon. Prandaj unë e quaj art të mbajtjes së ekuilibrave. Dhe kjo ka më tepër rëndësi për Ombudsmanin e parë, i cili duhet të shtrojë rrugën në drejtimin e duhur”.

Sa më sipër përmban ky përcaktim i rolit dhe funksionit të Ombudsmanit, personalisht jam munduar ta dëshmoj dhe justifikoj me angazhimin tim 10-vjeçar në krye të kësaj zyre.

Teksa jam duke pritur të fillojë procesi i zgjedhjes për këtë detyrë, më lejoni t’ju shpreh edhe një herë në mënyrë të pakushtëzuar mirënjohjen time për ndihmën dhe mbështetjen që më keni dhënë për kryerjen e misionit si Avokat i Popullit tim.

**Me respekt,  
AVOKATI I POPULLIT  
Ermir DOBJANI**

Tiranë, më 15 shkurt 2010

## PERMBAJTJA

Fjala e Avokatit të Popullit	1
Përmbajtja	5
Hyrje. Avokati i Popullit dhe parimet mbi te cilat ai funksionon.	8
Prezantim i shkurtër i Raportit	15

### KREU I PARE

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit.	17
2. Buxheti i institucionit për vitin 2009.	21
3. Bashkepunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009.	21
4. Sfidat dhe objektivat e institucionit për vitin 2009 e në Vazhdim.	28

### KREU I DYTE

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2009.	31
2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri.	34
3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë.	51
4. Raporti i Veçantë Nr.4 i Institucionit të Avokatit të Popullit, dërguar Kuvendit.	56
5. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese.	73
6. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun dhe median.	101
a. Sektori i Pritjes së Popullit.	103
b. Ditët e hapura – përvojë për t’u vazhduar.	108
7. Konferenca Nderkombëtare “Te drejtat e njeriut, mirëqeverisja dhe performanca e një Ombudsmani”.	109
8. Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009.	113

## KREU I TRETE

### **Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare**

1.	Këshilli i Ministrave (Qeveria).	117
2.	Ministria e Drejtësisë	120
	a. Sistemi i burgjeve dhe paraburgimeve.	121
	b. Zyrat e Përmbartimit.	138
	c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.	148
	ç. Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve.	156
3.	Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore.	158
4.	Ankesat për Prokurorinë.	173
5.	Ministria e Brendshme.	196
6.	Ministria e Mbrojtjes.	259
7.	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.	269
8.	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.	275
9.	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës.	288
10.	Ministria e Financave.	297
11.	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.	313
12.	Ministria e Shëndetësisë.	319
13.	Ministria e Punëve të Jashtme.	328
14.	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.	333
15.	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.	335
16.	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.	337
17.	Ankesat për Administratën e Shërbimit Informativ Shtetëror	339
18.	Veprimtaria në mbrojtje të të Drejtave të Fëmijëve.	340
19.	Veprimtaria e Njesisë për Parandalimin e Torturës dhe çdo Trajtimi Çnjerëzor dhe Degradues.	349
20.	Veprimtaria në favor të ish të të përndjekurve politikë.	360
21.	Zyra eksperimentale vendore në Shkodër.	366

## **KREU I KATERT**

1. E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative. 371
- Pasqyra Nr.1. Evidenca e rekomandimeve për plotësime apo ndryshime të ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 2000-2009. 373
- Pasqyra Nr.2. Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime në aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave për periudhën 2000-2009.
- Pasqyra Nr.3. Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime për aktet nënligjore të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore për periudhën 2000-2009.
2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit (“ex officio”) 423

## **ANEKSE**

1. Letra falenderimi nga qytetarët dhe vlerësime të Institucioneve. 424
2. Tabela dhe grafikët. 429



## HYRJE

### Avokati i Popullit dhe Parimet mbi të cilat ai Funkcionon

Avokati i Popullit përfaqëson një mekanizëm shtetëror, ekstrajgyqësor dhe ndërmjetësues, veprimtaria e të cilit konsiston në hetimin e pavarur të ankesave apo kërkesave të qytetarëve ndaj sjelljes, vendimeve, veprimeve apo mosveprimeve të parregullta e të paligjshme të administratës publike. Parimet dhe tiparet thelbësore të funksionimit të këtij Institucioni janë pavarësia, paanshmëria, fleksibiliteti, besueshmëria dhe transparenca ndaj publikut.

Avokati i Popullit u parashikua për herë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vitit 1998.

Në 5 nene të Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, përcaktohen detyrat, statusi dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Ky parashikim i jep Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, cilësinë e një institucioni të pavarur, të parashikuar shprehimisht në Kushtetutë.

Në nenin 60/1 të Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, përcaktohet objekti i veprimtarisë së Avokatit të Popullit, ku thuhet shprehimisht që:

“Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të Administratës Publike”. Në shkurt të vitit 1999, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Kurse me Ligjin 8600 datë 10.04.2000, u bë një plotësim në nenin 35 të këtij ligji me qëllim që të forconte pavarësinë e tij nga Qeveria. Pas thujse pesë vitesh veprimtari, me propozim të një grupi deputetësh, me ligjin nr.9398, datë 12 maj 2005 Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Avokatin e Popullit”, duke forcuar më shumë kompetencat e tij. Ajo që është për t’u evidentuar në lidhje me objektin e veprimtarisë së këtij institucioni, është se në ligjin organik të tij specifikohet rrethi i subjekteve, të cilët janë nën juridiksionin e këtij ligji, ku veç Administratës Publike, përfshihen administrata e pushtetit gjyqësor dhe “të tretët që veprojnë për llogari të saj”.

Në veprimtarinë e tij Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e **pavarësisë, paansësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizimit** në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, jo vetëm për shtetasit shqiptarë në marrëdhëniet e tyre me administratën publike shqiptare, por edhe për të huajt, rezidentë të rregullt ose jo në Shqipëri, refugjatët, si dhe personat

pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Mjeti ligjor që shërben për vënien në lëvizje këtë institucion është paraqitja e ankesave, kërkesave apo njoftimeve, pa përjashtuar këtu diskrecionin e dhënë me ligj për të filluar shqyrtimin e çështjeve të caktuara me inisiativën e tij. E drejta për t'u ankuar tek Avokati i Popullit, i takon çdo individ, grupi individësh ose organizate joqeveritare.

Pavarësia e institucionit është një tipar, i cili ka gjetur garancinë e tij së pari, në parashikimet kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e këtij institucioni, dhe së dyti, në mënyrën se si është realizuar gjatë këtyre viteve performanca administrative e institucionit.

Duke ju referuar veçanërisht kuadrin ligjor, pasi performanca është objekt vezhgimi e vlerësi nga pale te treta, pavarësia është garantuar sepse është parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Duke qenë se Avokati i Popullit në vendin tonë, konsiderohet si pjesë e administratës publike, parashikimi i tij shprehimisht në Kushtetutë, tregon një qëndrueshmëri më të madhe, pasi të paktën teknikisht për çdo ndryshim që kërkohet në mënyrën e funksionimit, si në juridiksion apo kompetenca, është e nevojshme procedura e votimit në Kuvendin e Shqipërisë me shumicë të cilësuar dhe jo me shumicë të thjeshtë.

Element shumë i rëndësishëm i kësaj pavarësie është, raporti që vendoset midis Avokatit të Popullit dhe Kuvendit të Shqipërisë. Avokati i Popullit është i detyruar që të paraqesë përpara Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij apo të raportoje para tij kur kjo gjë i kërkohet nga Kuvendi, si dhe t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme, siç percaktohet në nenin 26 dhe 27 të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

Në bazë të nenit 60, pika 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka buxhet të veçantë, të cilin e administron vetë. Ai e propozon buxhetin sipas ligjit.

Mjetet financiare të Avokatit të Popullit përballohen nga buxheti i shtetit, ku Avokati i Popullit ka një zë të veçantë. Projekt buxheti siç thote ligji, propozohet nga Avokati i Popullit në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe të Privatizimit, dhe në Ministrinë e Financave. Por në fakt projekt buxhetin e ben Ministria e Financave dhe në si Institucion i Avokatit të Popullit nuk thirremi në komisionin e sipercituar, por vetem në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Pastaj paraqitet për miratim në Kuvend, në përputhje me ligjin "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit".

Avokati i Popullit mund të përfitojë nga donacione të ndryshme financiare ose materiale, që duhet të jenë pa kushte komprometuese për pavarësinë dhe paanësinë e veprimtarisë së tij. Në këtë kuadër ka funksionuar edhe bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me Programin

DANIDA të qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës, më përfaqësinë e Këshillit të Evropës në Tiranë, me Aba Ceeli-n, me Agjensinë Ndërkombëtare të Frankofonisë etj.

Përcaktimi i strukturës dhe organikës së zyrës, është kompetencë e Avokatit të Popullit. Padyshim që edhe ky është një element ligjor i cili, garanton pavarësinë e Avokatit të Popullit. Ne paragrafet 1 dhe 2 te nenit 35 te Ligjit “Per Avokatin e Popullit”, percaktohet se:

“Personeli i zyrës se Avokatit te Popullit ben pjese ne sherbimin civil te Republikes se Shqiperise.

Struktura dhe organika e zyrës se Avokatit te Popullit caktohet nga Avokati i Popullit”.

Tregues i garantimit ligjor të paanësisë dhe profesionalizmit është edhe kompetenca diskreciale që ligji “Për Avokatin e Popullit”, i jep atij për të filluar shqyrtimin e çështjeve të caktuara me inisiativën e tij, ose e njohur ndryshe si “ex-officio”. Ushtrimi i këtij diskrecioni, në disa raste lidhet me dhënien e pëlqimit të palës së interesuar apo dëmtuar, për raste të veçanta të bëra publike. Kur i dëmtuari është i mitur, apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara, pëlqimi që duhet të marrë Avokati i Popullit për fillimin e shqyrtimit të një çështje me inisiativë nuk është i nevojshëm, kur kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i këtyre personave nuk vepron.

Konkretisht ne nenin 13 te Ligjit “Per Avokatin e Popullit”, percaktohet se:

“Avokati i Popullit fillon proceduren e shqyrtimit te çeshtjes kur veren ose dyshon se ka ndodhur nje shkelje e te drejtes, ne baze te ankeses apo te kerkeses se personit te interesuar ose te demtuar, si dhe me nismen e vet, per raste te veçanta te bera publike, por me pelqimin e te interesuarit ose te demtuarit.

Ne rastet kur Avokati i Popullit fillon proceduren e shqyrtimit te çeshtjes me nismen e vet dhe kur kujdestari ose perfaqesuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kerkohet pelqimi i te demtuarit kur eshte i mitur apo i paaftë menderisht apo me aftesi te kufizuara ose per mbrojtjen e te drejtave te nje numri te madh te individeve.

Ne mbrojtje te interesave te nje komuniteti te gjere, te cilet mund te preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka te drejte te filloje nje procedim administrativ dhe te marre pjese ne te, ne perputhje me kerkesat e Kodit te Procedurave Administrative”.

Tregues i garantimit ligjor të kriterëve të paanësisë dhe profesionalizmit është e drejta e Avokatit të Popullit për t’ju rekomanduar organeve që kanë të drejtën ligjvënëse, të bëjnë propozime për ndryshimin e përmirësimin e ligjeve; t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore, kur ai vëren se është vetë përmbajtja e ligjit apo e akteve të tjera normative e jo

zbatimi i tyre shkakua që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut. Këtu përfshihet edhe pranimi i kërkesave për vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe procedurat gjyqësore.

Konkretisht keto kompetenca parashikohen në nenin 24 dhe paragrafin e fundit të nenit 25, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet që:

“Kur Avokati i Popullit verën se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkakua që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënese të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;

t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nëligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasoje pezullimin e fuqisë së akteve nëligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

te verë në levizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla”,

“Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit”.

Pjesëmarrja dhe ndihma në përgatitjen e raporteve dhe dokumenteve të tjera, të hartuara nga shteti shqiptar, për të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe bashkëpunimi me organizatat joqeveritare për marrjen periodikisht të mendimeve të tyre lidhur me gjendjen e të drejtave, si dhe për organizimin e një veprimtarie kombëtare lidhur me këtë gjendje të të drejtave dhe lirive të njeriut përbën një tjetër, parashikim ligjor që mundëson një veprim gjithëpërfshirës dhe efikas për realizimin e objektit të veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Kjo gje parashikohet konkretisht në nenet 29 dhe 30, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet që:

“Avokati i Popullit mund të ndihmojë dhe të japë mendime e rekomandime në përgatitjen e raporteve dhe të dokumenteve të tjera, të hartuara nga shteti shqiptar, për të drejtat e lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me organizatat joqeveritare, duke marrë, periodikisht mendimet e tyre për gjetjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Avokati i Popullit, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, organizon, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë”.

Ky kuadër ligjor garanton funksionimin e pavarur të Avokatit të Popullit, si një institucion kombëtar në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Tipar themelor i Institucionit të Avokatit të Popullit është pavarësia nga Qeveria dhe nga çdo ndikim politik.

Ashtu si ligjet e mjaft shteteve të tjera që e kanë këtë institucion, edhe ligji shqiptar nuk i ka dhënë Avokatit të Popullit fuqi vendimmarrëse në raport me organet e administratës, por vetëm të drejtën e rekomandimeve përkatëse. Kjo nuk do të thotë se Avokati i Popullit nuk ka mjete për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njerëzve. E drejta e tij për t'i ndjekur çështjet shkallë-shkallë sipas hierarkisë së administratës deri në dërgimin e çështjes në Kuvend, si dhe transparencën, në punën e tij, bashkëpunimi i ngushtë me OJF-të dhe Median garantojnë suksesin në detyrën që i është caktuar atij.

Ne çdo kohe dhe me te gjitha mjetet e komunikimit Avokati i Popullit është sot një nga institucionet me të aksesueshëm në vend, si për asistencën e tij ligjore, ashtu dhe për dhenien e keshillimeve të dobishme në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Fleksibiliteti shprehet në rrugët dhe format që Avokati i Popullit ndjek për t'ju afruar shërbimin dhe rivendosur të drejtën e pretenduar ose të shkelur të qytetarit. Ky parim vlen edhe për komunikimin zyrtar të Avokatit të Popullit me përfaqësuesit e administratës publike. Madje edhe zgjidhja që synon të arrijë Avokati i Popullit në favor të qytetarit, nuk kushtëzohet patjetër nga afatet ligjore të apelimit të shkëljes. Sikundër edhe qëllimi i Avokatit të Popullit nuk është penalizimi i zyrtarit, por ndërgjegjësimi i tij për t'u shërbyer qytetarëve sipas ligjit.

Paanshmëria dhe objektiviteti janë parime të rëndësishme, ku bazohet i gjithë veprimi i Avokatit të Popullit për të hetuar ankesa të veçanta, parime ku bazohet edhe funksioni i tij ndërmjetësues, gjithmonë si mekanizëm i kontrollit dhe balancës së pushteteve. Ky parim siguron më pas edhe besueshmërinë e Avokatit të Popullit, si palë që shikon të dyja anët e medaljes, për të siguruar jo vetëm zgjidhje të drejta, por mbi të gjitha ligjore.

Transparenca është një parim, pa të cilin Avokati i Popullit nuk do të kishte mundur të kryente misionin e tij. Aleanca e natyrshme me median e bën më të nevojshëm zbatimin e këtij parimi, pasi, përmes transparencës, Avokati i Popullit arrin të informojë, ndërgjegjësojë apo deri edhe të demaskojë sjelljen abuzive të zyrtarit publik në dëm të të drejtave të qytetarëve. Transparenca është mjeti më i mirë, përmes të cilit Avokati i Popullit siguron integritetin e tij personal dhe institucional, sikundër edhe përgjegjshmërinë e tij para publikut.

Funksioni dhe misioni i Avokatit të Popullit është të shqyrtojë çështjet që lindin si pasoje e keqadministrimit në administratën publike. Instrumenti i përditshëm, përmes të cilit Avokati i Popullit synon të arrijë

rezultatit e tij është rekomandimi. Pas shqyrtimit dhe hetimit të çështjeve të ndryshme, Avokati i Popullit realizon ndërmjetësimin dhe, nëpërmjet rekomandimeve të tij synon t'i zgjidhë problemet mbi baza ligjore. Zgjidhjet e arritura nga ai synojnë të sjellin përmirësime në standardet dhe cilësinë e shërbimeve të administratës publike ndaj qytetarëve.

Por ç'është keqadministrimi? Me "keqadministrim" kuptojmë sjelljen, pra veprimet apo mosveprimet e zyrtarit në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjet në fuqi dhe me normat e gjithëpranuara morale në shtetin tonë. Duke goditur këtë dukuri, Avokati i Popullit promovon mirëqeverisjen dhe ndershmërinë në administratën publike.

Qëndrimi që administrata mban ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj shkeljeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t'i riparuar ato.

Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit është instrumenti më i rëndësishëm i Avokatit të Popullit, përmes të cilit ai informon Parlamentin çdo vit, në mënyrë që ky i fundit të realizojë funksionin e tij si kontrollues i Qeverisë. Edhe këtë vit, teksa përpiqemi të paraqesim para Kuvendit një pasqyrë analitike ndaj ankesave të popullit në vend, synimi ynë është ndikimi për realizimin e standardeve të larta në mirëqeverisje. Fokusi i punës së Avokatit të Popullit ka qenë dhe është praktika e përditshme e marrëdhënieve individ-shtet dhe niveli i mirëqeverisjes si e drejtë e njeriut.

Në rastet e paraqitura në këtë Raport, jemi munduar të pasqyrojmë punën tonë, sikundër edhe të vëmë gishtin mbi dukuritë abuzive që shfaqin përfaqësuesit e administratës publike, në nivel qendror dhe vendor. Përtej kësaj, Avokati i Popullit synon të qartësojë rrugët që duhen ndjekur për të krijuar kulturën e shërbimit cilësor dhe të ndershëm ndaj qytetarëve.

Avokati i Popullit ka punuar me administrata qendrore dhe vendore të ndryshme për nga orientimi politik. Parime të tilla si pavarësia dhe paanshmëria, në një farë mënyre duket sikur paraqesin konflikt interesi, por në fakt e para është në funksion të së dytës, pra garantimi i pavarësisë lipset në funksion të garantimit të paanshmërisë. Pavarësia, faktikisht gjithmonë rrezikon të jetë një patate e nxehtë, që krijon tek mbajtësi i saj dilemat midis prodhimit të demokracisë si institucion apo modelit autokratik si funksionim. Prodhimi i demokracisë, nga ana tjetër, kushtëzohet me parimin e transparencës, së pari për vetë institucionin, dhe më pas edhe për administratën e kontrolluar prej tij. Më së fundi, transparenca në funksionim kushtëzon edhe profesionalizmin, si kusht të domosdoshëm për të krijuar integritetin dhe besueshmërinë publike të vetë institucionit. Në termat e kësaj ndërvarësie të shumëfishtë, Avokati i Popullit është përpjekur të dëshmojë se, duke ofruar oponencë për mirëqeverisje, ai nuk punon të bëjë Opozitën ndaj Qeverisë. Kjo ka qenë,

është dhe do të jetë filozofia e funksionimit të tij, e zhveshur nga çdo anësi politike. Nëse do të ishim orientuar drejt konfliktualitetit ose, në të kundërt, drejt kompromisit politik me pushtetmbajtësit e radhës, parimet themelore, mbi të cilat ne mbështetemi, do të komprometoheshin rëndë dhe institucioni do të dështonte, si në sytë e opinionit publik shqiptar, ashtu edhe të organizmave ndërkombëtare që na monitorojnë nga afër.

## PREZANTIM I SHKURTER I RAPORTIT

Raporti Vjetor është publikimi më i rëndësishëm i Institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet të cilit bëhet e mundur njohja e anëtarëve të Kuvendit me punën e Avokatit të Popullit gjatë vitit për të cilin ai bën raportimin dhe në të njëjtën kohë, ndihmohet administrata publike dhe agjensitë e ndryshme që ofrojnë shërbime për publikun, të përmirësojnë administrimin e tyre. Raporti Vjetor e bën punën e Avokatit të Popullit të aksesueshme edhe nga publiku që është i interesuar të ndjekë aktivitetin e tij, duke përfshirë këtu publikun e gjërë, median, nëpunësit civil etj. Në këtë raportim nuk kemi bërë thjesht një listim të aktiviteteve të Institucionit, por kemi prezantuar dhe shumë analiza të veprimtarisë së tij. Raporti Vjetor përmban refleksionet tona për çështjet më të rëndësishme të prezantuara gjatë vitit si dhe identifikon problemet të cilat kanë nevojë për përmirësime në të ardhmen.

Një vënd të veçantë në këtë raport, ashtu si vitin e kaluar, i kemi kushtuar veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit në kuadër të Mekanizimit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe çdo Dënimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues. Kjo strukture, siç është bërë e ditur, është ngritur në zbatim të “Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe çdo Dënimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues”, (OPCAT) ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me anë të Ligjit Nr.9094 dt.03.07.2007 dhe ka filluar veprimtarinë në Janar 2008.

Raporti i dhjetë vjetor i Avokatit të Popullit, që paraqet veprimtarinë e tij gjatë vitit 2009, është i ndarë në katër krerë dhe dy anekse dhe fillon me fjalën e veçantë të Avokatit të Popullit, në të cilën ai paraqet shkurtimisht arritjet kryesore të punës së tij gjatë vitit 2009, si dhe nënvizon filozofinë e punës së tij, në raport me administratën publike shqiptare.

Kreu i parë është prezantimi i cili ndër të tjera shpjegon shkurtimisht arritjet e Institucionit dhe në veçanti objektivat e tij për të ardhmen. Gjithashtu i kushton vëmendje bashkëpunimit të Institucionit tonë me zyrat homologe dhe detajon pjesëmarrjen aktive të Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare.

Kreu i dytë, ka të bëjë me aktivitete të informimit dhe komunikimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky kre është ndarë në 8 seksione ku një vënd të veçantë zënë opinionet për situatën e të drejtave të njeriut si dhe për mirëqeverisjen në Shqipëri. Një seksion i veçantë i është kushtuar organizimit të “ditëve të hapura” dhe bashkëpunimit me mediat, nëpërmjet të cilave kemi siguruar aksesin e nevojshëm në publik.



Po ashtu, shkurtimisht kemi bërë një përshkrim të Raportit të Veçantë për Romët, që Avokati i Popullit, në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 27 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar, dhe në nenin 63/2 të Kushtetutës, i ka drejtuar Kryesisë së Kuvendit dhe ministrive përkatëse të cilat janë përgjegjëse të fushave që kanë qënë objekt i raportimit.

Kreu i tretë, i cili zë dhe pjesën më të madhe në raport, ka të bëjë me ankesat, kërkesat dhe njoftimet e trajtuara nga Avokati i Popullit, të ndara sipas ministrive përkatëse dhe organeve të tjera të administratës publike, hetimet e kryera për disa raste si dhe rezultatet. Këtu kemi prezantuar dhe mjetet për zgjidhjen e rasteve tipike dhe të përsëritura, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme. Ky kre gjithashtu përmban rekomandime dhe propozime për eliminimin e shkeljeve dhe padrejtësive, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit. Në një seksion të veçantë kemi prezantuar punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve për vitin 2009 si dhe veprimtarinë e Njesisë për Parandalimin e Torturës dhe çdo Dënimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues.

Ky kre i raportit përmban gjithashtu dhe shumë analiza të detajuara për raste të veçanta, të cilat sipas këndvështrimit tonë, janë konsideruar të rëndësishme dhe që do të vazhdojnë të jenë në vëmendjen tonë në të ardhmen.

Kreu i katërt paraqet veprimtarinë shumë të rëndësishme të Avokatit të Popullit, të realizuar nëpërmjet rekomandimeve për nxjerrjen, ndryshimin apo plotësimin e ligjeve apo akteve nënligjore, në rastet kur është përmbajtja e këtyre dhe jo zbatimi ose moszbatimi i tyre shkak që krijon premisa apo kushte për shkelje të të drejtave të njeriut apo keq qeverisje. Për shkak të kësaj rëndësie, në tre tabelat përkatëse kjo veprimtari paraqitet për 10 vitet e ekzistencës së Avokatit të Popullit në Shqipëri. Gjithashtu në këtë kre prezantohen edhe çështjet e filluara me iniciativë nga Avokati i Popullit.

Në aneksin 1 kemi paraqitur disa nga letrat e falenderimit të qytetarëve drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit dhe vlerësime të institucioneve.

Aneksi 2 prezanton në mënyrë grafike statistikën kryesore të punës së Institucionit.

## KREU I

### 1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit

Ligji nr.8600, datë 10.04.2000 “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës dhe organikës (numrit të personelit) të tij. Kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë Nr.500, dt. 18.07.2003 “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”, i ndryshuar.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, siç i ka përcaktuar neni 31 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar me ligjin nr.9398 dt.12.05.2005.

**Seksioni i parë** merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre dhe drejtohet nga zj. Florina Nuni.

**Seksioni i dytë** merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura, prokurorinë e pushtetin gjyqësor dhe deri në dt.09.10.2009 është drejtuar nga Z. Skënder Haluci. Komisioneri S. Haluci u hoq nga kjo detyrë sepse nuk plotëson një kusht mjaft të rëndësishëm, të kërkuar nga ligji për të punuar në këtë detyrë. Për këtë janë njoftuar Presidenti i Republikës, Kryetarja e Kuvendit dhe Kryeministri. Eshte gjetur si zgjidhje e përkohshme që të kalojë në një seksion tjetër. Pas kësaj date e në vazhdim ky seksion drejtohet nga Z. Riza Poda.

**Seksioni i tretë** ose seksioni i përgjithshëm, deri në dt.09.10.2009 është drejtuar nga z.Riza Poda. Mbas kësaj date e në vazhdim drejtohet nga Z. Skënder Haluci. Ky seksion trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Po kështu, ashtu siç është raportuar edhe vitin e kaluar, që nga janari 2008 funksionon edhe Njësia për Parandalimin e Torturës dhe drejtohet nga z. Ervin Karamuço, nën varësinë direkte të Avokatit të Popullit, në përbërje të të cilit janë katër ndihmëskomisionere.

Hallkë e rëndësishme e strukturës së institucionit është edhe Kabineti, në përbërje të të cilit janë Drejtori i Kabinetit dhe këshilltarët, të cilët janë në vartësi direkte nga Avokati i Popullit.

Sektorët mbështetës që ndihmojnë në realizimin e detyrave kryesore të Institucionit janë Drejtoria e Informacionit, Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë si dhe Drejtoria e Personelit dhe Administratës, të cilat janë në varësi direkte të Sekretarit të Përgjithshëm. Pjesë të rëndësishme të këtyre drejtorive, janë Sektori i Informacionit e Pritjes së Popullit dhe Sektori i Financës. Kjo strukturë, e cila është përcaktuar nga Avokati i Popullit, ka rezultuar e efektshme, në përputhje me prioritetet e vendosura për vitin 2009.

Kuvendi në ligjin “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2009”, ka miratuar 50 punonjës dhe po kaq kanë qenë të punësuar. Nga këta, janë 18 juristë që quhen ndihmëskomisionerë, të cilët merren direkt me zgjidhjen e ankesave. Juristë janë edhe Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Kabinetit, 2 këshilltarë, 3 komisionerët, drejtuesi i Njësisë dhe vetë Avokati i Popullit.


Një element i rëndësishëm lidhur me strategjinë e Avokatit të Popullit është dhe rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të institucionit. Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme e ndihmëskomisionerëve brenda dhe jashtë vendit dhe e punonjësve të tjerë të Administratës, ka ndihmuar në ngritjen e tyre profesionale, gjë kjo që vërtetohet edhe me pajisjen e tyre me çertifikatat e marra nga Instituti i Trajnimit të Departamentit të Administratës Publike.

Titullin Master e kanë fituar 8 anëtarë të stafit, katër prej të cilëve janë në proces doktore, ndërsa 3 të tjerë janë në vazhdim të studimeve për të fituar titullin Master i Nivelit të II-të. Për vitin akademik 2010 kanë aplikuar në Universitetin Shtetëror 3 anëtarë të stafit për titullin Master dhe janë në pritje të miratimit. Kurse 5 juristë të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetet e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës.

Pjesa më e madhe e specialistëve të Zyrës së Avokatit të Popullit zotërojnë dhe përdorin mirë një ose më shumë gjuhë të huaja, kryesisht anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht, gjermanisht, etj.

**Pasqyra Nr.1**

**STRUKTURA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT**



**Pasqyra nr.2**

**ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT**

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>NËPUNËS</b>
<b>I.</b>	<b>AVOKATI I POPULLIT</b>	<b>(1)</b>
<b>II.</b>	<b>KABINETI</b> Shefi i Kabinetit + Zëdhënës i Avokatit të Popullit Këshilltarë të Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	<b>(5)</b> 1 3 1
<b>III.</b>	<b>SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	<b>(7)</b> 1 5 1
<b>IV.</b>	<b>SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	<b>(7)</b> 1 5 1
<b>V.</b>	<b>SEKSIONI I PËRGJITHSHËM</b> Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Nënseksioni për Fëmijët (Ndihmëskomisioner) Sekretare + rregjistruese	<b>(7)</b> 1 4 1 1
<b>VI.</b>	<b>MEKANIZMI PER PARANDALIMIN E TORTURES</b> Drejtes (Ndihmëskomisioner) Ndihmëskomisionerë (Juristë)	<b>(5)</b> 1 4
<b>VII.</b>	<b>SEKRETARI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>(1)</b>
<b>VIII.</b>	<b>DREJTORIA E INFORMACIONIT, MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN DHE ME JASHTË</b> Drejtor Shef Sektori Specialist Arkivist+Sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm	<b>(5)</b> 1 2 1 1
<b>IX.</b>	<b>DREJTORIA E PERSONELIT, ADMINISTRATËS DHE FINANCES</b> Drejtor Shef Sektori Specialist Shofer Punëtore Teknik Mirëmbajtës	<b>(12)</b> 1 2 1 5 2 1

Organika e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2009 ishte 50 punonjës.

## 2. Buxheti i Institucionit për vitin 2009

Për të funksionuar me efikasitet një institucion për të drejtat e njeriut siç është Avokati i Popullit, kërkohet jo vetëm mbështetje politike, institucionale, potenciale njerzore, por dhe mbështetje financiare.

Në këtë vështrim një konceptim i drejtë ka ekzistuar nga Kuvendi dhe Qeveria Shqiptare. Për vitin 2009 Institucionit të Avokatit të Popullit mbështetur në Ligjin nr.100025 dt.27.11.2008 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2009”, i është dhënë një buxhet në shumën 93.000.000 leke, i cili për periudhën objekt raportimi është konsumuar në masën 95% e konkretisht:

<b>Nr. Llog.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Plan lekë</b>	<b>Realizim lekë</b>	<b>Realiz. %</b>
600	Pagat	59.640.000	55.838.567	93.6%
601	Sigurim shoqëror	7.270.000	7.194.900	99%
602	Shp operative	20.890.000	20.871.279	100 %
605	Kuote anetaresie	200.000	157.677	78.8 %
231	Investime(Rikonstruksion)	2.570.000	2.559.736	99.6%
231	Pajisje zyre	2.430.000	2.424.694	99.7%
	<b>Totali</b>	<b>93.000.000</b>	<b>89.046.853</b>	<b>95%</b>

Përsa i përket shpenzimeve të buxhetit, ato janë përdorur për paga punonjësish, blerje kancelerie, riparime automjesh, blerje karburanti, parkim automjesh, shpenzime për energji elektrike, shpenzime telefoni, shpenzime poste, shërbim telegrafik, abonime gazetalesh, sigurime automjesh, shërbim interneti etj.

Ambientet e rinovuara tashmë paraqesin një institucion bashkëkohor, mjaft të përshtatshëm për punë dhe mikpritës për çdo qytetar që paraqitet pranë nesh për të kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Në lidhje me kuotat e anëtaresisë në bëjmë pagesën në Institutin Europian të Ombudsmanëve, Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofonë, dhe Shoqatën e Ombudsmanëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USOA).

## 3. Bashkëpunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009

Marrëdhëniet e Institucionit të Avokatit të Popullit me Jashtë janë bazuar kryesisht në tre drejtime. Së pari, në shkëmbimin on-line të informacioneve mbi zhvillimet në forumet ndërkombëtare të familjes së Ombudsmanit dhe të Institucioneve Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (marrëdhënie shumëpalëshe). Së dyti, në shkëmbimin e vizitave njohëse dhe trajnimeve me zyrtar homologe (marrëdhënie

dypalëshe). Së treti, në pjesëmarrjen në konferenca, seminare, tavolina të rrumbullakta etj. ku diskutohet për të drejtat e njeriut dhe veprimtarinë e Ombudsmanëve apo institucioneve kombëtare të kësaj natyre.

Veprimtaritë e Avokatit të Popullit në këto drejtime kanë konsistuar në prezantimin e arritjeve të institucionit tonë, sikurse dhe të përpjekjeve që bën shteti shqiptar për të përmbushur standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut një nga të cilat është edhe ngritja dhe konsolidimi i institucionit të Avokatit të Popullit apo si quhet kryesisht në gjuhën ndërkombëtare Ombudsmanit Parlamentar.

Një drejtim tjetër i marrëdhënieve me faktorin ndërkombëtar është edhe bashkëpunimi me organizmat vepruese në Shqipëri, interesimi i të cilave për shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut është parësor. Kështu mund të përmendim bashkëpunimin e vazhdueshëm me Departamentin Amerikan të Shtetit, përmes Ambasadës Amerikane në Tiranë, për përditësimin e Raportit Vjetor të këtij Departamenti për të Drejtat e Njeriut. Falë besueshmërisë së shfaqur në veprimtarinë e Avokatit të Popullit, Ambada Amerikane në Tiranë vazhdon ta konsiderojë Avokatin e Popullit si partner për hartimin e Raportit dhe një ndër filtrat informativ, të vlefshëm për referim në rastet e shumë trajnimeve që kjo ambasadë ofron për nëpunësit dhe autoritetet publike shqiptare, duke afishuar me këtë rast si standart sjelljen dhe figurën e tyre përsa i përket rekordit të shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut. I tillë është edhe bashkëpunimi me Zyrën e OSBE-së në Tiranë për probleme të ndryshme që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut dhe standartet e shtetit ligjor.

Institucioni i Ombudsmanit, forcohet më shumë dhe zhvillohet më tej edhe përmes bashkëpunimit me zyrat homologe si dhe pjesëmarrjes aktive në forumet ndërkombëtare, cilësuar joformalisht si Familja Ndërkombëtare e Ombudsmanit.

Avokati i Popullit është anëtar me të drejta të plota i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI), i Ombudsmanit European (EOI), Shoqatës së Ombudsmanit dhe Mediatorit Frankofon (AOMF), Shoqatës Ndërkombëtare të Ombudsmanit (IOA) dhe se fundmi i Shoqates se Ombudsmaneve te Rajonit te Mesdheut (AOM). Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia, Avokati i Popullit i realizon përmes pjesëmarrjes në aktivitete si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Vlen për t'u përmendur vendimi përfundimtar i Byrosë së Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, bazuar mbi propozimin e Sekretariatit të këtij Komiteti, në Nëntor 2008 që ky Sekretariat pasi shqyrtoi me imtësi materialet e dërguara nga ana e Zyrës së Avokatit të Popullit, por edhe pasi bëri verifikimet e rastit sipas procedurave të tyre, e gjeti Avokatin e Popullit si Institucion të bazuar

plotësisht mbi parimet e Parisit. Mbi këtë bazë u bë e mundur që Institucionit të Avokatit të Popullit të Shqipërisë t'i rrijepej statusi A, tashmë pa rezerva, çka do të thotë një pjesëmarrje dhe imazh më autoritar në strukturat ndërkombëtare.

### **I. Aktivitete të organizuara nga Këshilli i Europës:**

1. Në kuadrin e Projektit “Peer -to- Peer”, bashkë financuar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi European dhe bashkë-organizuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës dhe Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Padovës, me qëllimin e ngritjes së një rrjeti aktiv të strukturave të pavarura jogjyqësore për të drejtat e njeriut, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Seminarin me temë “Mbrojtja e të drejtave të Romëve nga strukturat kombëtare për të drejtat e njeriut” që u zhvillua në Budapest, Hungari më 24-25 shkurt 2009.

2. Po ashtu, në kuadrin e Projektit “Peer -to- Peer”, bashkë financuar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi European, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Seminarin me temë “Roli i Strukturave Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në rastin e mos ekzekutimit të vendimeve të gjykatave vendore” që u zhvillua në Padova, Itali, më 24-26 mars 2009.

3. Edhe më 9-11 qershor 2009, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Seminarin realizuar në kuadrin e Projektit “Peer-to-Peer, përsëri në Padova të Italisë, me temë “Roli i Strukturave të të Drejtave të Njeriut lidhur me marrjen e masave kundër terrorizmit”.

4. Në kuadrin e projektit Eunomia, të Këshillit të Europës, për promovimin e Institucioneve të Ombudsmanit, një përfaqësues i Institucionit të Avokatit të Popullit mori pjesë në seminarin me temë: “Ombudsmani dhe mbrojtja e mjedisit”, organizuar në Athinë, Greqi, nga Ombudsmani Grek, më 22-23 qershor 2009.

5. Më 15-16 shtator 2009 u zhvillua në Budapest, Hungari, seminari me temë “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të të moshuarve nga Strukturat Kombëtare të të Drejtave të Njeriut” përsëri në kuadrin e Projektit “Peer -to- Peer” ku pati pjesëmarrje të një përfaqësuesi të Avokatit të Popullit.

6. Në vijim të Projektit “Peer -to- Peer”, më 20-22 tetor 2009, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Seminarin me temë “Mbrojtja nga Strukturat Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të minoreneve të veçuar/të pashoqëruar”, zhvilluar përsëri në Padova të Italisë.

7. Më 17 nëntor 2009, në kuadrin të Projektit “Peer -to- Peer dhe me organizim të Zyrës së Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës, Drejtori i Kabinetit të Avokatit të Popullit mori pjesë në



Konferencën e Tretë Vjetore të Personave të Kontaktit që u zhvillua në ambjentet e Qendrës Rinore Europiane në Budapest, Hungari.

## **II. Konferenca ndërkombëtare brenda vendit:**

1. Me 9-10 mars 2009, Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Institucionin e Ombudsmanit Grek dhe me mbështetje të Projektit Eunomia të Keshillit të Europës, bashkë-organizuan në Tiranë, Konferencën ndërkombëtare me temë: “Aksesi për Informacion: çfare mund të bëjë Ombudsmani”?

Krahas bashkëorganizatoreve, z. Ermir Dobjani dhe z. Yorgos Kaminis, perkatesisht Ombudsmanë të Shqipërisë dhe Greqisë, në këto aktivitet morën pjesë Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Bamir Topi, Ombudsmani i Bashkimit Evropian, Proffesor Nikiforos Diamandouros, Nenkryetari i Parlamentit, z. Neritan Ceka, Ministri i Drejtësisë, z. Enkelejd Alibeaj si dhe Ombudsmanë dhe përfaqësues të zyrave të tyre nga 13 vende të Evropës.

Problematika e Konferencës ishte e drejta për informim, si e drejtë themelore e njeriut dhe roli i institucionit të Ombudsmanit në procesin e transparencës që është jetik për një shoqëri demokratike, të hapur për të pranuar dhe njekohësisht për t’u ndeshur me sfidat e integritimit.

2. Me 10 dhjetor 2009, me rastin e 10 Vjetorit të krijimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe të 61 Vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit organizoi në Tiranë, ceremoninë festive të 10 Vjetorit të krijimit të tij, ku ky institucion u dekorua me Urdherin “Nënë Tereza” si dhe Konferencën ndërkombëtare me temë: “Te Drejtat e Njeriut, Mire-Qeverisja dhe Performanca e një Ombudsmani”. Në këto aktivitet morën pjesë, Presidenti i Republikës, Z. Bamir Topi, Nenkryetari i Kuvendit, Z. Ardian Turku, Ministri i Shtetit, Z. Genc Pollo si dhe rreth 20 ombudsmanë nga Europa. Me rastin e 10 vjetorit të krijimit, duke vlerësuar profesionalizmin, kurajon, pavarësinë dhe paanësinë e Avokatit të Popullit, iu akordua Institucionit Urdheri “Nënë Tereza”.

## **III. Konferenca të tjera ndërkombëtare jashtë vendit:**

1. Në kuadër të implementimit të OPCAT, një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në konferencën mbi “Implementimi i OPCAT, Eksperiencat nga Europa Juglindore”, e bashkë organizuar nga OSBE, ODHIR dhe Ombudsmani i Malit të Zi, që u zhvillua në Podgoricë, me 22-23 prill 2009.

2. Me 19-20 maj 2009, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë: “Fëmijet dhe divorcet e diskutueshme – Aksesi i fëmijëve ndaj drejtësisë, kombëtare, ndërkombëtare dhe europiane”, organizuar nga Ombudsmani i Fëmijëve të Kroacisë që u zhvillua në Dubrovnik, Kroaci.

3. Me ftese te Krye/Ombudsmanit Parlamentar te Suedise, Avokati i Popullit mori pjese ne Konferencen e IX-te nderkombetare te Institutit Nderkombetar te Ombudsmanit si dhe ne festimin e 200 Vjetorit te Ombudsmanit Parlamentar te Suedise qe u zhvilluan ne Stokolm, Suedi me 9-12 qershor 2009.

4. Avokati i Popullit me dy anetare te stafit te tij, moren pjese ne konferencen shkencore me teme: “Pjesemarrja aktive e instrumentave te rinj te mbrojtjes se te drejtave te njeriut. Avokati i Popullit dhe Mbrojtjesit e Popullit ne vendet e Mesdheut dhe Ballkanit” qe u zhvillua ne Bari , Itali me 18 qershor 2009, organizuar nga Universiteti i Barit.

5. Me ftese te Ombudsmanit te Marche, Itali & Koordinator kombetar i Ombudsmaneve rajonal te Italise, nje perfaqesues i Avokatit te Popullit mori pjese ne konferencen e organizuar ne Ankona me 23 shtator 2009, mbi çeshtjen e krahasimit te rregullave dhe praktikave kombetare te Ombudsmaneve ne zonen e Adriatikut.

6. Znj. Florina Nuni, Komisionere prane Avokatit te Popullit, mori pjese ne Asamblene e Pergjithshme te Institutit te Ombudsmanit European qe u zhvillua ne Firence, Itali me 5 tetor 2009.

7. Nje perfaqesues i Avokatit te Popullit mori pjese ne konferencen nderkombetare me teme: “Shteti para gjykates – roli i te drejtes administrative ne zhvillimin dhe forcimin e shtetit te se drejtes”, qe u zhvillua ne Dubrovnik, Kroaci me 17-20 nentor 2009. Qellimi i konferences ishte shkembimi i pervojave dhe ideve mes pjesemarrsesve nga Europa Juglindore dhe Lindore me ato te shteteve te BE-se.

8. Z. Riza Poda, Komisioner prane Avokatit te Popullit, mori pjese ne inagurimin e zyrove qendrore te Shoqates se Ombudsmaneve te vendeve Mesdhetare ne Tangier, Marok si dhe ne simpoziumin nderkombetar qe u organizua me ate rast, me 4 nentor 2009.

9. Avokati i Popullit, mori pjese ne Konferencen nderkombetare me teme: “Transparenca ne sherbimet publike: Cili eshte roli i Ombudsmanit?”, organizuar nga Shoqata e Ombudsmaneve te Rajonit te Mesdheut, qe u zhvillua ne Athine, Greqi, me 14-15 dhjetor 2009.

Ombudsmanet dhe Mediatorët e Rajonit te Mesdheut formojne tashme qe prej vitit 2008 nje familje institucionale qe punojne se bashku per mbrojtjen e te drejtave te njeriut. Institucioni i Avokatit te Popullit eshte bere tashme Anetar edhe i kesaj Shoqate.

#### **IV. Vizita të Autoriteteve Homologe të Avokatit të Popullit në Shqipëri**

1. Me 23-26 mars 2009, me ftesë të Avokatit të Popullit dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Shqiptar erdhi në Shqipëri për një vizitë zyrtare nje delegacion nga Mbreteria e Tajlandes i kryesuar nga

Krye Ombudsmani, Z.Gen.Teeradej Meeipen (Ret) dhe Kontrollorja e Pergjithshme Znj. Khunying Jaruvan Maintaka.

Gjatë vizitës së këtij delegacioni pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ata u njohën nga afër me punën dhe arritjet e këtij Institucioni gjatë 9 vjetëve të aktivitetit të tij në Shqipëri.

2. Me ftesë të Avokatit të Popullit erdhi për një vizitë zyrtare në Tiranë, më 22-25 prill 2009 Komisioneri Parlamentar për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Hungarisë, Z. Mate Szabo.

Gjatë kësaj vizite u shkëmbyen eksperiencat përkatëse dhe u vlerësua vazhdimësia e bashkëpunimit në të ardhmen i të dy institucioneve homologe.

Bashkëpunimi me zyrat homologe si dhe pjesëmarrja në aktivitetet shumëpaleshe mbetet një konstante e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për t'iu motivuar dhe përditësuar gjithmone e me shume me praktikën me të mira që ofrojnë vendet respektive

3. Ombudsmani Parlamentar i Republikës së Bullgarisë, Z. Ginyo Ganev vizitoi Tiranën më 28-30 maj 2009, me ftesë të Avokatit të Popullit. Krahas takimeve me homologun e tij dhe stafin e Avokatit të Popullit, delegacioni i Ombudsmanit të Bullgarisë u takua edhe me personalitete të larta të vendit ku këta të fundit i shprehën Ombudsmanit Parlamentar të Bullgarisë, konsideratat e tyre për punën e Avokatit të Popullit në Shqipëri.

“Privilegji i një Ombudsmani është pikërisht fakti se ai nuk ka pushtet administrativ”, vlerësoi gjatë takimeve, z. Ganev. “Arma më e madhe e një Ombudsmani është presioni i shoqërisë mbi administratën, duke patur për objekt të punës së tij mirëqeverisjen. Duke treguar rastet e keqadministrimit, me kurajo dhe kompetencë, ai ushtron kontrollin qytetar të shoqërisë mbi administratën publike, dhe synon me këtë të rrisë besimin e qytetarëve tek shteti i tyre”, tha zoti Ganev.

4. Me 2-3 korrik 2009, Avokati i Republikës së Kosovës, z. Sami Kurteshi, i sapozgjedhur nga Parlamenti i Kosovës për herë të parë në këtë detyrë, vizitoi Tiranën me ftesë të homologut të tij në Shqipëri.

Gjatë takimit me mikpritësin e tij Dobjani, ky i fundit e njohu z. Kurteshi me veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, duke theksuar rëndësinë e marrëdhënieve të këtij institucioni me Parlamentin si dhe raportin konstruktiv të tij me administratën publike shqiptare në teresi. Gjithashtu Z. Dobjani propozoi për thellimin e bashkëpunimit midis dy zyrave, përpilimin dhe nënshkrimin e një memorandum bashkëpunimi. Ky memorandum do të konsistonte në shkëmbimin e vizitave dypaleshe studimore, si në nivel të lartë, ashtu edhe në nivel ekspertësh, në trajnime për shkëmbimin e përvojave reciproke, në ndjekjen e ankesave konkrete përkatëse si të shtetasve kosovare në Shqipëri, ashtu edhe të shtetasve shqiptarë në Kosovë.

Nga ana e tij, z. Sami Kurteshi e falenderoi homologun e tij z. Ermir Dobjani per bashkepunimin e deritanishem me zyren e tij, si dhe shprehu gadishmerine e tij per nenshkrimin e protokollit te bashkepunimit midis dy institucioneve, ne nje takim tjetër ne Prishtine.

Avokati i Popullit te Kosoves u prit ne takime te veçanta edhe nga Presidenti i Republikes, z. Bamir Topi, nga Kryetari i Gjykates Kushtetuese, z. Vladimir Kristo si dhe nga Kryetarja e Gjykates se Larte, zj. Shpresa Beçaj.

## **V. Vizitat e Avokatit të Popullit në Zyrat e Ombudsmanëve të vendeve të tjera.**

1. Me ftese te Mediatorit te Frances, Avokati i Popullit beri nje vizite zyrtare prane homologut te tij ne Paris, më 17 mars 2009 per te biseduar rreth projekteve te bashkepunimit ne te ardhmen.

2. Me 26-27 qershor 2009, me ftese te Shefit te Zyres se Komisionerit Parlamentar per te Drejtat e Njeriut te Republikes se Hungarise, Z. Attila Peterfalvi, Avokati i Popullit beri nje vizite zyrtare ne Zyren homologe ne Budapest ku u bisedua sidomos per pervojat e mbrojtjes se minoritetit rom.

3. Me 17-18 shtator 2009, me ftese te homologut te tij te Republikes se Kosoves, Z. Sami Kurteshi, Avokati i Popullit shkoi per nje vizite zyrtare ne Prishtine. Krahas takimeve me homologun e tij dhe stafin e Avokatit të Popullit te Kosoves, delegacioni i Avokatit te Popullit u takua edhe me personalitete me të larta të Republikes se Kosoves, si Presidentin Fatmir Sejdiu etj. Teme e bisedave ishte nxitja e bashkëpunimit rajonal në një fushë të ndjeshme sikurse është ajo e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ne kete kuader u nenshkrua edhe protokollit i Bashkepunimit, per te cilin u diskutua ne takimin e zhvilluar ne Tirane, me 3 korrik 2009.

4. Me 12-15 tetor 2009, Avokati i Popullit i beri nje vizite zyrtare homologut te tij Rumun, Z. Ioan Muraru ne Bukuresht. Gjatë kësaj vizite u shkëmbyen eksperiencat mes dy zyrave homologe dhe Avokati i Popullit u njoh nga afër me aktivitetin dhe sukseset e këtij Institucioni. Të gjitha takimet zyrtare me Ombudsmanin, stafin e tij dhe autoritetet e vendit u gjetën shumë të rëndësishme dhe frutdhënëse.

5. Ne vijim te vizites ne Bukuresht, me 15-18 tetor 2009, Avokati i Popullit, Z. Ermir Dobjani vazhdoi viziten zyrtare ne Sofie, prane homologut te tij bullgar, Z. Ginyo Ganev. Ky ishte edhe kthimi i vizites se homologut bullgar ne Tirane. Z. Dobjani pati kenaqesine ta ftonte Z. Ganev si nje nga folesit e nderuar edhe ne 10 Vjetorin e krijimit te Avokatit te Popullit ne Shqiperi, me 10 dhjetor 2009.

## **V. Vizita studimore të realizuara jashtë Shqipërisë**

1. Me mbështetje dhe organizim të Zyres së IOM në Tiranë, bazuar në projektin “Mbeshtetje për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin”, bashkë financuar nga Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë dhe Qeveria Italiane, dy përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në viziten studimore që u realizua në Athinë, Greqi, me 8-10 shkurt 2009 dhe në Itali në mars 2009.

### **4. Sfidat dhe objektivat e Institucionit për vitin 2010 e në vazhdim**

Në raport me misionin e tij si Institucion i parashikuar të ndikojë në mirëqeverisje, Avokati i Popullit gjithmonë pretendon një përgjegjshmëri në rritje të të gjitha organeve shtetërore për respektimin e të drejtave të njeriut. Përtej dispozitave ligjore, të cilat natyrisht të orientojnë drejt dhënies së drejtësisë, ai shikon frymën e ligjit. Avokati i Popullit ka reaguar fort, qoftë edhe për raste të veçanta, sa herë që ka marrë informacione për shkelje flagrante të të drejtave të njeriut, nga cilido përfaqësues i administratës publike shqiptare.

Qysh në fillim të veprimtarisë së institucionit Avokati i Popullit ka paralajmëruar për çështjet që kalojnë në filtrat e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe Shqipëria penalizohet si shtet.

Duke patur statusin “A” të akreditimit si Institucion Kombëtar për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Avokati i Popullit do të vazhdojë të jetë anëtar me të drejta të plota i Komitetit Koordinues Ndërkombëtar, duke kontribuar në koordinimin e nismave dhe politikave në forumet ndërkombëtare të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në kuadrin e OKB-së.

Nga ana tjetër, pas ratifikimit nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, me ligjin nr.9094, datë 03.07.2003, të Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, ku në nenin 17 të tij përcaktohej ndër të tjera një nga kërkesat kryesore të detyrueshme për zbatim nga ana e shtetit tone dhe me konkretisht “mbajtja, emërimi ose krijimi i një ose disa mekanizma të pavarur, kombëtar parandalues për parandalimin e torturës në nivel kombëtar” Avokati i Popullit do të vazhdojë si i tillë të ndikojë si në përmirësimin e gjendjes nëpër dhomat e paraburgimit, burgje, spitale psikiatrike, shtëpi fëmijësh dhe pleqsh, ashtu dhe në krijimin e një perceptimi në rritje të një Shqipërie pa torturë.

Sfidat dhe objektivat e Avokatit të Popullit janë gjithmonë përplotësuese me vetë sfidat dhe objektivat e qeverisjes së vendit, në nivel qendror dhe lokal.

Avokati i Popullit do të vazhdojë t’u kushtojë vëmendje të veçantë objektivave të mëposhtëm:

1. Konsolidimi i partneritetit me institucionet e administratës publike, me synim ndjekjen në vazhdimësi dhe zgjidhjen sa më të shpejtë të kërkesave dhe ankesave të përditshme të qytetarëve.

2. Rritja e efikasitetit të zyrës për të mundësuar zgjidhjen e ankesave, përmes teknikave të mediacionit, me synim parandalimin e rritjes së ngarkesës së punës së gjykatave, aksesit ndaj të cilave gjithsesi mbetet gjithmonë i garantuar.

3. Rritja e bashkëpunimit me organet e zbatimit të ligjit, sikurse janë Policia e Shtetit, organi i Prokurorisë, drejtoritë e burgjeve etj, në funksion të realizimit të drejtësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

4. Rritja e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me organizmat e shoqërisë civile, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë në këtë proces edhe lobimin për probleme të veçanta, të bëra kauza të përbashkëta me grupe të caktuara të interesit, fjala vjen, për të drejtat e grave, fëmijëve, romëve etj.

5. Rritja e vëmendjes për ndjekjen e rasteve me vetiniciativë, fokusuar në mbrojtjen e të drejtave që prekin grupe të mëdha njerëzish apo grupet më në nevojë e më të prekshëm, pa përjashtuar rastet individuale të bëra publike nga media.

6. Vazhdimësia gjithmonë e më efikase e veprimtarisë së Njesisë për Parandalimin e Torturës përmes rritjes së frekuencës së kontrolleve të befasishme që kjo Njësi kryen në kuadrin e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

7. Angazhimi më i madh i Njesisë për Parandalimin e Torturës në përgatitjen e raporteve të posaçme për Kuvendin si dhe integrimi i tyre në Raportet e institucioneve ndërkombëtare të fushës.

8. Vazhdimi i praktikës së Ditëve të Hapura, në mënyrë periodike dhe në zona të ndryshme të vendit, jo si qëllim në vetvete dhe thjesht për të grumbulluar ankesa, por për të rritur praninë fizike të Avokatit të Popullit pranë qytetarëve, qoftë edhe për të kompensuar mungesën objektive të zyrave rajonale.

9. Rritja e bashkëpunimit me Median, për të shtuar presionin pozitiv mbi administratën, ka qenë dhe mbetet një kusht i domosdoshëm dhe jetik për Avokatin e Popullit, me synim edukimin me praktikën e mira administrative dhe denoncimin e praktikave korruptive.

10. Rritja e transparencës së institucionit, përmes publikimit më të mirë dhe më shumë të problemeve kryesore të evidentuara nga shkeljet e Administratës Publike në fushën e të drejtave të njeriut, duke pasuruar në mënyrë të vazhdueshme faqen tonë në Internet.

11. Finalizimi i përpjekjeve për zgjidhjen përfundimtare që duhet të japë Kuvendi për opsionet, nëse duhet konsoliduar nënseksioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve apo duhet pranuar propozimi për krijimin e Ombudsmanit të Fëmijëve.

12. Angazhimi për nxitjen e nismave ligjore të deputetëve për të realizuar kompetencat e Avokatit të Popullit në raport me gjyqësorin, ose duke bërë ndryshimet në legjislacionin perkatës, ose dukë i hequr ato nga ndryshimet e bëra në Ligjin “Për Avokatin e Popullit” më 12 Maj 2005, me ligjin nr.9398.

13. Rritja e pjesëmarrjes aktive të Avokatit të Popullit në tryezat ndërkombëtare, qoftë të atyre shumëpalëshe, në kuadrin e Këshillit të Evropës apo të Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, qoftë të atyre dypalëshe, në kuadrin e bashkëpunimit me zyrat homologe.

14. Angazhimi më aktiv, si për t’iu përgjigjur kërkesave të institucioneve shqiptare, për të kontribuar për hartimin e raporteve që Shteti shqiptar paraqet pranë organizmave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç është rasti i plotësimit të Pyetësorit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë.

15. Kërkesa në rritje nga gjithë institucionet përkatëse qeveritare, dhe organizmat e shoqërisë civile e informacioneve përgjithësuere, në mënyrë që më pas, Avokati i Popullit të ketë mundësinë të raportojë në mënyrë më të plotë dhe koherente për standardet që Shteti e Qeveria shqiptare synon të arrijë apo ka arritur në fushën e mirëqeverisjes dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

16. Ruajtja e qëndrueshmërisë teknike, pavarësisht se kjo është e kushtëzuar deri diku edhe nga qëndrueshmëria financiare. Rrjeti ynë i sistemit kompjuterik kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme, prandaj do të vazhdojë të ketë përparësi.

17. Ruajtja e qëndrueshmërisë financiare, përmes sigurimit të financimeve edhe nga partnerë ndërkombëtarë, duke patur parasysh faktin se qeveria shqiptare është e detyruar të ndjekë një politikë të rreptë në shpenzimet operative dhe nga kjo nuk pretendojmë të privilegjohemi vetëm ne.

18. Ruajtja e qëndrueshmërisë administrative përmes një angazhimi dhe motivimi më të madh të të gjithë punonjësve të Avokatit të Popullit për të kryer secili detyrat e veta funksionale.

Garanci për përballimin e këtyre sfidave dhe të tjerave që lidhen me to është përvoja e krijuar tashmë prej 10 vjetësh si dhe ruajtja e kapaciteteve njerëzore e profesionale të Zyrës.

## K R E U II

### **1. Statistika përmbledhëse e vitit 2009**

*(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)*

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet veprimtarisë së tij, kontribuon në përmirësimin e praktikave të mirëqeverisjes, duke siguruar një mbikqyrje të sjelljes administrative të organeve të administratës publike për mënyrën se sa dhe si këta të fundit u shërbejnë qytetarëve. Në këtë ndërveprim të përditshëm, objektivi i Avokatit të Popullit është respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit, dhe eventualisht rivendosja e së drejtës së tij të shkelur nga nëpunësi i administratës publike. Nëpërmjet ndërhyrjeve me mjetet që i lejon ligji, Avokati i Popullit ndihmon për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësinë e vendimeve që ajo merr dhe për përgjegjësinë ndaj publikut duke e bërë atë të kuptojë se roli i vërtetë i saj është t'i shërbejë qytetarëve që të realizojnë të drejtat e tyre. Për këtë, ajo duhet të veprojë me transparencë, të administrojë pronën publike me profesionalizëm dhe përgjegjësi si dhe të japë llogari përpara taksapaguesve.

Ajo çka ne synojmë në kryerje të detyrës sonë, është krijimi i shanseve të barabarta për të gjithë individët, që ata të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën.

Gjatë veprimtarisë së përditshme të punës sonë jemi ndeshur me forma të ndryshme të rezistencës nga ana e organeve të administratës apo të autoriteteve publike. Kjo sepse, administrata shqiptare, ashtu si administrata e shumë vendeve të tjera, nuk i ka shpëtuar tendencës për të qënë e mbyllur, për të urdhëruar më tepër se sa për të dëgjuar dhe sqaruar qytetarët. Prandaj, nëpërmjet aktivitetit tonë, përpiqemi t'a bëjmë publikun të kuptojë se të drejtat e tij përbëjnë detyrim për administratën publike.

Ashtu sikundër do të shihet në pjesët përkatëse të raportit, edhe këtë vit i kemi adresuar një numër të konsiderueshëm organeve të administratës. Për një pjesë të tyre, nuk kemi marrë akoma përgjigje nga organet të cilave i jemi drejtuar dhe kjo për ne, tregon në vazhdim një mosangazhim sa duhet të këtyre organeve për të trajtuar me përgjegjësi rekomandimet e një organi kushtetues siç është Avokati i Popullit dhe si rrjedhim, kemi përsëritje të problemeve dhe shfaqje të keqadministrimit.

Edhe gjatë vitit 2009, nëpërmjet organizimit të ditëve të hapura, kemi realizuar njohjen e problemeve të individëve të ndryshëm jo vetëm



në Tiranë dhe qytetet rreth saj, por dhe në Komunat dhe rrethet më të largëta të vëndit. Kemi ndërmarrë më shumë iniciativa për të ndërgjegjësuar administratën lidhur me detyrimet që ajo ka në ushtrim të funksioneve të saj.

Gjatë periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2009 janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit **3734** ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga **3734** ankesa, **365** kanë qenë të mbartura nga viti 2008, **2546** janë raste të regjistruara në vitin 2009 dhe **823** janë raste të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë në Zyrën e Pritjes së Popullit.

Ankesa, kërkesa dhe njoftime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë kanë qenë **3165**. Nga këto, **460** ankesa ose rreth **15 %** e tyre kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2010. Gjatë vitit 2009 janë përfunduar së shqyrtuari gjithsej **2705** ankesa, nga të cilat ka rezultuar se **1146** ankesa, ose **42 %** e tyre, kanë qënë jashtë juridiksionit dhe kompetencës. Por për këto ankesa është bërë punë efektive, sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. **514** ose **19 %** e ankesave kanë rezultuar të padrejta, kurse **915** ose **34 %** e tyre janë zgjidhur në favor. Për **31** ankesa, ose **1.14 %** e ankesave të përfunduara, rekomandimet me shkrim drejtuar organeve përkatëse të administratës për shkelje të konstatuara prej tyre, nga zyra jonë, janë refuzuar. Për **99** raste, ose **3.66 %** të tyre, të paraqitura për shqyrtim pranë nesh, ankuesit kanë hequr dorë gjatë procesit të shqyrtimit. Për ankesat e gjetura të bazuara, për **196** prej tyre janë bërë rekomandime apo propozime përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër (**719 raste**) zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve me shkrim apo ndërmjetësimin tonë verbal me organet e Administratës Publike, të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitet e kaluara, rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

Më poshtë po paraqesim numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të trajtuara në vitin 2009, të ndara për Këshillin e Ministrave

dhe sipas Ministrive përkatëse, organeve apo enteve të tjera të administratës publike.

<b>1. Këshilli i Ministrave</b>	<b>24</b> , nga të cilat
Për vetë Qeverinë	19
<hr/>	
<b>2. Ministria e Drejtësisë</b>	<b>583</b> nga të cilat:
për vetë ministrinë	35
a. Për burgjet dhe paraburgimet	244
b. Zyrat e Përmbarimit	85
c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	126
d. Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	93
<hr/>	
<b>3. Për organet e pushtetit gjyqësor</b>	<b>258</b>
<b>4. Prokuroria</b>	<b>169</b>
<b>5. Ministria e Brendshme</b>	<b>610</b> nga të cilat:
Për Organet e policisë	173
<b>Organet e pushtetit vendor</b>	<b>437</b>
a. Komunat	89
b. Bashkite	298
c. Prefekturat	16
d. Qarqet	8
dh. Gjëndja Civile	26
<hr/>	
<b>6. Ministria e Mbrojtjes</b>	<b>78</b>
<b>7. Ministria e Financave</b>	<b>166</b>
Për vetë ministrinë	12
a. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe deget në varesi të saj	7
b. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët në varesi të saj	6
c. Instituti i Sigurimeve Shoqërore	138
d. Bankat	3
<hr/>	
<b>8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit</b>	<b>125</b> , nga të cilat:
Për vetë ministrinë	34
a. Inspektoriatet ndërtimore	69
b. Ujësjellës kanalizime	6
c. Albtelekom dhe telefonia mobile	7
ç. Enti Kombëtar i Banesave	9

<b>9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës</b>	<b>74</b> , nga të cilat:
Për vetë ministrinë	19
<b>KESH</b>	<b>55</b>
<b>10. Ministria e Shëndetësisë</b>	<b>34</b>
<b>11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës</b>	<b>77</b>
<b>12. Ministria e Punëve të Jashtme</b>	<b>14</b>
<b>13. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta</b>	<b>58</b> , nga të cilat:
Për vetë ministrinë	49
a. Shërbimi Social Shtetëror	9
<b>14. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit</b>	<b>3</b>
<b>15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave</b>	<b>5</b>
<b>16. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</b>	<b>7</b>
<b>Të tjera</b>	<b>259</b>
<b>TOTALI</b>	<b>2546 ankesa</b>

Siç do të shihet dhe nga pjesët e veçanta të këtij raporti, përveç trajtimit të ankesave të ardhura nga qytetarë të ndryshëm, shoqëri apo shoqata, Avokati i Popullit ka punuar aktivisht duke kryer hetime për probleme të ndryshme me iniciativë “ex officio”, duke takuar përfaqësues të ndryshëm të administratës qendrore dhe vendore dhe duke i bërë të ditur qytetarve të drejtat e tyre. Po kështu gjatë vitit 2009, ka vazhduar zgjidhja në favor të ankuesve të një numri të konsiderueshëm të ankesave, (**915 ankesa**), nëpërmjet ndërhyrjes së Avokatit të Popullit tek organet e administratës publike të të dyja niveleve.

## 2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri (viti 2009)

Afirmimi, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut është një nga guret e themelit të ekzistencës dhe zhvillimit në një shoqëri dhe shtet demokratik, që individin e sheh si një forcë të dobishme dhe të domosdoshme për të plotësuar mozaikun e ekzistencës dhe të dinjitetit të qenies njerëzore në teresinë e saj. Sikurse parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, garantimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

perben bazen funksionale te shtetit shqiptar, nderkohe qe zgjerimi i garancive per te drejtat dhe lirite themelore, mund te konsiderohet fare mire si domosdoshmeri dhe sfide ndaj zhvillimeve aktuale.

Ne kete kendveshtrim mbrojtja dhe respektimi i te drejtave te njeriut, eshte e lidhur pazgjidheshmerisht me menyren se si qeverisesit, qeverisin te qeverisurit, permes procesit te vendimmarrjes dhe procesit permes te cilit zbatohen vendimet. Nese ky proces njihet si “Qeverisje”, thelbi i respektimit te te drejtave te njeriut ka te beje me “Mireqeverisjen”, e cila nga ana tjetere tregon se si institucionet publike drejtojne punet publike dhe menaxhojne burimet publike, me qellim qe te garantojne realizimin dhe respektimin e te drejtave te njeriut.

Nenshkrimi i Marreveshjes se Stabilizim Asociimit ndermjet vendit tone dhe vendeve te Bashkimit European, ne 12 qershor 2006, pranimi i Shqiperise ne NATO ne prill 2009 dhe pershpejtimi i procesit per statusin e vendit kandidat per t’u anetarësuar ne BE, aktualisht i materializuar me dorezimin dhe pervijimin e punes per plotesimin e pyetesorit te Komisionit European, na ngarkon edhe me me shume pergjegjesi per te rritur cilësisht standartet e mireqeverisjes dhe te te drejtave te njeriut. Aftësia e Shtetit Shqiptar per te ushtruar ne menyre te efektshme pergjegjesite e veta ne mbrojtje te te drejtave te njeriut, varet kryesisht nga fuqia e institucioneve te vendit.

Nje institucion i tille, qe garanton demokracine, sundimin e ligjit dhe te drejtat e njeriut, pra mireqeverisjen, dhe si i vetmi institucion kombetar me status kushtetues per mbrojtjen e lirive dhe te drejtave te njeriut ne Shqipëri, eshte parashikuar te jetë Avokati i Popullit (Ombudsmani). Per me tepër qe Avokatit te Popullit i eshte njohur edhe statusi i Institucionit Kombetar per Mbrojtjen dhe Promovimin e te Drejtave te Njeriut, si dhe detyra e Mekanizmit Kombetar per Parandalimin e Torturës.

Nese demokracite ne tranzicion lipset te konsolidojne procesin demokratik, arritjen e mireqeverisjes dhe respektin per te drejtat e njeriut, kjo do te thote se roli i Avokatit te Popullit ka qene, eshte dhe do te jetë gjithmonë e më i rëndësishëm. Standartet kryesore te mireqeverisjes, kane qene pikerisht treguesit qe na kane udhehequr ne punen tone jo vetem si mbikqyres se mbrojtjes dhe respektimit te te drejtave te njeriut ne punen e organeve dhe institucioneve qe na qeverisin, por edhe si institucione qe duhet te prodhojme dhe promovojme mireqeverisjen dhe sjelljen e mire administrative.

Niveli i mireqeverisjes, si nje e drejte e njeriut, ende nuk i ka arritur standartet e caktuara si detyre shtepie per organet dhe institucionet ne Shqipëri.

Besueshmeria eshte nje kerkese kyçe e mire qeverisjes. Por ajo nuk mund te krijohet pa transparence dhe pa respektimin e shtetit te se drejtes.

Për opinionet që do të paraqesim më poshtë, nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet e marra nga organizatat jofitimprurëse për fusha të veçanta të së drejtës, nga sondazhet dhe informacionet e publikuara në mediat shqiptare si dhe në raportet e organizmave dhe institucioneve ndërkombëtare që analizojnë gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, siç janë Raportet e Komisionit Evropian, Këshillit të Evropës, Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Amnesty International, komitetet e të drejtave të njeriut pranë organizmave të Kombeve të Bashkuara, natyrisht pa përfshirë edhe raportet zyrtare të Qeverisë shqiptare, etj. Padyshim që viti 2009 ka patur zhvillime pozitive edhe në fushën e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri. Por Avokati i Popullit është institucion që duhet të kërkojë gjithmonë standarde gjithnjë e më të larta. Prandaj edhe Raportet apo informacionet tona përshkohen më tepër nga kritika konstruktive.

Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit 2009, e ka ngritur zërin në çdo rast që ka konstatuar shkelje të të drejtave të personit nga policia, për respektimin e të drejtave të të burgosurve, për të drejtën dhe lirinë e shprehjes, për të drejtën e informimit, të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, për cilesinë e jetes dhe ndotjen e ambientit, për zvarritjet në procedurat gjyqësore, për përfitimin nga sistemi i sigurimeve shoqërore, për përfitimin nga sistemi i shërbimit shëndetësor e veçanërisht për të drejtat e pacientit, për ushtrimin e lire dhe efektiv të së drejtës për arsimim etj. Reagimet tona të forta ndjehen në të gjitha rekomandimet tona që kanë pasuar inspektimet dhe kontrollet periodike nëpër burgje, në dhomat e paraburgimit, në spitalet psikiatrike apo ambiente të tjera të mbyllura. Në të gjitha këto raste, ne kemi qenë tepër kërkues ndaj punonjësve të policisë së shtetit, për të mos përdorur dhe për të eliminuar dhunën, torturën dhe çdo formë tjetër keqtrajtimi të lidhur me to. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe fakti se, qysh nga Qershori i vitit 2008, në plotësim të detyrimeve ndërkombëtare që vendi ynë ka marrë përsipër, pas ratifikimit të konventave ndërkombëtare, filloi nga funksionimi struktura e re pranë Avokatit të Popullit, që quhet Njësia për Parandalimin e Torturës.

Të gjitha raportet e institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare monitoruese theksojnë se “në Republikën e Shqipërisë janë miratuar pothuajse të gjitha ligjet specifike që kanë si objekt respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut”. Por dihet gjithashtu se hartimi i ligjeve të reja nuk është i mjaftueshëm. Aftësia për t’i zbatuar mirë ato, është elementi thelbësor i garantimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Prej vitesh në Shqipëri, në drejtim të zbatimit me efikasitet të kuadrit ligjor pozitiv, vazhdojnë të hasen një sërë problemesh serioze që kërkojnë zgjidhje.

E drejta e jetës, si e drejtë themelore e njeriut, ka qenë në qendër të vëmendjes dhe angazhimit të Avokatit të Popullit qysh në fillim të veprimtarisë së tij. Kështu, që në Konferencën e parë Kombëtare që Avokati i Popullit ka organizuar në vitin 2001, synimi ka qenë iniciimi i një strategjie kombëtare të përbashkët, nga të gjithë organet shtetërore dhe OJF-të, për masa parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme, në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti, ndaj fenomenit të gjakmarrjes. Pas vitit 2004 ka patur një angazhim më serioz ndaj fenomenit të gjakmarrjes dhe faktikisht, nga organet e policisë raportohet se fenomeni ka rënë. Pozitiv është fakti se Kuvendi ka miratuar Ligjin nr.9389, datë 04.05.2005, “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër Gjakmarrjes”. Në Shkurt 2007 u miratuan ndryshime në Kodin Penal, për të ndëshkuar penalisht nxitësit e gjakmarrjes. Është punuar për t’u siguruar “arsimimin në shtëpitë e tyre” të fëmijëve të ngujuar, madje për këtë është krijuar edhe një qendër në Poliçan dhe kjo është pozitive. Nga ana tjetër, për fat të keq, Këshilli Koordinues është mbledhur vetëm një herë deri tani. Këshilli i Ministrave nuk ka nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji. Veç të tjerave, kjo mangësi bën që të mos dihet me saktësi numri i familjeve në përgjithësi dhe i fëmijëve në veçanti, të cilësuar “në gjakmarrje”. Problemi bëhet më i ndjeshëm po të kemi parasysh se vetëm nga ngujimi i të rriturve dhe fëmijëve, shkelen njëkohësisht një sërë të drejtash, si ajo e lëvizjes, e votës, e shkollimit e kështu me radhë, të gjitha të kushtëzuara nga cënimi i së drejtës themelore të jetës, fakt që u evidentuar në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë në 28 Qershor 2009. Megjithëse që të gjitha institucionet qeveritare e kanë kuptuar se duhet të angazhohen më seriozisht për këtë “plagë”, që e bën të papranueshme Shqipërinë në familjen e madhe të Bashkimit Evropian, edhe gjatë vitit 2009 nuk kemi konstatuar ndonjë zhvillim apo nismë të rëndësishme qeveritare.

E drejta e jetës në Shqipëri, si e drejtë themelore e njeriut, vazhdon të jetë e rrezikuar, për sa kohë që armët vazhdojnë të jenë pa kontrollin e duhur në duart e popullsisë civile. Këto armë përditë marrin jetë njerëzish nëpërmjet krimeve brenda familjes, vetëvrasjeve, krimeve me dashje apo pakujdesive në administrimin e tyre. Ndonëse nga policia ka patur disa rezultate për trafikun e armëve dhe zbatimin e ligjit për armëmbajtësit pa leje është forcuar, numri i armëve pa leje në duart e popullsisë vazhdon të jetë ende i madh. Për t’i dhënë fund kësaj gjendjeje, rritet edhe një here se çarmatimin nuk mund ta presim që ta bëjnë vetëm strukturat e Policisë së Shtetit. Ne vazhdojmë të insistojmë se duhen gjetur zgjidhje të reja që mund të jenë që nga kombinimi i pagesës, për çdo armë të dorëzuar, deri tek ligjësimi rast pas rasti i armëmbajtjes nga çdo individ i

rritur, i përgjegjshëm dhe pa precedentë penale. Këto janë propozime që Avokati i Popullit i ka përsëritur çdo vit.

Liritë dhe të Drejtat Vetjake si liria e shprehjes, e shtypit, medias televizive, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësia e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Për to ka patur dhe do të ketë ankesa dhe mbrojtje të tyre, si nga ana e Avokatit të Popullit, ashtu edhe me anë të proceseve gjyqësore. Mendimi ynë është se këto të drejta dhe liri, përgjithësisht respektohen. Megjithatë, ka patur raste shkeljeje. Opinioni ynë lidhje me këto të drejta është se, autoritetet duhet të reagojnë më shpejt për të identifikuar shkaktarët e shkeljes së të drejtave të gazetarëve dhe për rivendosjen e këtyre të drejtave.

Edhe gjatë vitit 2009 janë evidentuar përpjekje të vetë organeve të medias apo të komunitetit të gazetarëve, për të krijuar mekanizma vetërregullues në drejtim të rritjes së profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë. Ky është një zhvillim pozitiv, pasi mjafton të kujtojmë faktin se, më parë, për një kohë të gjatë, në median tonë nuk konsiderohej shkelje publikimi me hollësi i të dhënave personale që shkelin të drejtën e privatësisë. Por vazhdon të mbetet problematik fakti që nuk kemi ende një ligj që të rregullojë veprimtarinë e gazetarëve në vend, ndonëse kjo është një çështje që është ngritur dhe vazhdon të mbetet e mprehte prej disa kohësh. Miratimi i një ligji, i cili do të rregullonte këtë veprimtari, do të shërbente edhe si një rregullator konkret për ekuilibrimin e të drejtës për të ushtruar gazetarinë dhe të drejtës të të tjerëve për të qenë të garantuar nga abuzimi me lirinë e shprehjes në emër të gazetarisë së lire.

Shumë gazetarë, në kushtet e anonimitetit, ankohen se mungesa e kontratave të punës shpesh pengon aftësinë e tyre për të raportuar në mënyrë objektive dhe kjo konsiderohet autocensurë. Nga ana tjetër, verëhet një përdorim në rritje i gazetarisë investigative përmes emisioneve të ndryshme televizive, siç për shembull emisioni “Fiks Fare” në Televizionin Top Channel, emisioni “Njerëz të Humbur” në TV Klan, “Me zemër të hapur” në TV News 24, apo emisionet “Zone e ndaluar”, “Misioni Vazhdon” dhe “Faktori Plus” në TV “Vizion +”, si dhe emisioni me i ri investigativ “Alarm” në TV “Ora News”. Nisur nga roli informues dhe sensibilizues i këtyre emisioneve, si dhe bazuar në investigimet objektive që bëhen në të rast pas rasti, institucioni i Avokatit të Popullit ka bashkëpunuar dhe vazhdon të bashkëpunojë në realizimin e këtyre emisioneve, nisur nga çështje konkrete të shqyrtuara nder vite.

Rol të madh parandalues duhet të luajnë shoqatat e gazetarëve, nëpërmjet bashkimit në sindikata apo unione aktive si dhe të aftësisë profesionale të tyre. Edhe institucioni ynë duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim, për të vepruar me iniciativë dhe bërë kauza të përbashkëta me gazetarët, për të ngritur opinionin publik kundër shkeljeve në fushën e të drejtës së informimit, mbrojtjes në punë apo shkeljeve të të drejtës së

privatësisë. Veçanërisht për mbrojtjen e të dhënave personale, veprimtaria jone është parë e lidhur ngushtë me veprimtarinë që duhet të ushtrojë Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që për fat të keq duhet thënë se ka rreth një vit e gjysëm që është krijuar, por nuk ka lënë gjurmë të veprimtarisë së tij deri tani.

Si një Institucion Kushtetues, i qëllimuar në veprimtarinë e tij në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, kemi vlerësuar dhe vlerësojmë se një nga të drejtat themelore, e cila meriton një vëmendje të veçantë, është ajo e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtës për informim.

Duke pasur një fushë të gjërë të veprimtarisë së tij, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Ligji Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, por në veçanti Ligji Nr.8503 datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, i ngarkojnë institucionit tone një mision të veçantë, i cili lidhet me atë të kujdestarit të zbatimit dhe respektimit të kësaj të drejte të publikut të gjërë, nga ana e administratës publike.

Pikerisht, duke qenë se Avokati i Popullit është një nga aktoret kryesore për përmirësimin e standarteve për të drejtën e informimit në vend, kemi vlerësuar faktin se puna e filluar gjatë vitit 2009 për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për të drejtën e aksesit në dokumentat zyrtare”, datë 27.11.2008, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, do të përbejë një hap çësor dhe të domosdoshëm në këtë drejtim dhe padyshim është një zgjerim i garancive për respektimin e të drejtës për informim.

Nisur nga përmbajtja e dispozitave të kësaj Konvente, duke filluar nga përcaktimet e bera që në nenin 1 të saj, me kënaqësi e vërejtëm faktin se veprimtaria e Avokatit të Popullit ka qenë dhe është në kohezion të plotë me frymën e këtij akti të rëndësishëm ndërkombëtar, në fushën e të drejtave të njeriut. Rekomandimin i përgatitur në vitin 2007, për hartimin e Rregullores të brendshme Tip për të drejtën e informimit, si një produkt çësor i punës së Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me projektin e USAID “Për shtetin Ligjor në Shqipëri” dhe me Institutin për Studime Politike dhe Ligjore, vërteton këtë fakt. Konceptet dhe përcaktimet e dhëna në këtë rregullore, të cilat kanë synuar që të sigurojnë aksesin e publikut, të ndergjegjësojnë organet e administratës publike për detyrimin e zhvendimit të subjekteve në rastet e vërtetuara të shkeljes së të drejtës për informim, të unifikojnë rrugën procedurale që ndjekin kërkesat për informim dhe të rrisin efektivitetin dhe transparencën e administratës publike, janë në të njëjtën linjë dhe lehtësisht të krahasueshme me konceptet e dhëna në Konventë.

Nderkohe gjykojmë se, legjislativi aktual në fuqi në Republikën e Shqipërisë për sa i përket të drejtës së informimit për dokumentet zyrtare,



është pergjithesisht i harmonizuar me përmbajtjen e dispozitave të kësaj Konvente dhe ky konkluzion i referohet perkatesisht të tre seksioneve të Konventes.

Megjithatë gjykojmë se, është e rëndësishme të theksohet që me ratifikimin e mundshëm të Konventes së Keshillit të Europës “Për të drejtën e aksesit në dokumentat zyrtare”, datë 27.11.2008, dhe bëjës së saj pjesë e legjislacionit normativ të brendshëm, legjislatorit shqiptar i dalin disa detyra konkrete, veçanërisht referuar zbatimit të dispozitave të seksionit të parë të Konventes.

Është vetë përcaktim i Konventes që kërkohet të nënshkruhet, që shtetet pale të marrin masat e nevojshme në legjislacionin e brendshëm, për t’i dhënë fuqi dispozitave mbi aksesin në dokumentat zyrtare të përcaktuara në të. Konkretisht, nisur nga rekomandimet tona dhe propozimet e mëparshme nga aktore të ndryshme që veprojnë në fushën e së drejtës për informim, është i nevojshëm një përmirësim i përmbajtjes së dispozitave të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si dhe plotësim i legjislacionit tjetër ekzistues në fuqi, apo ndoshta edhe krijimi i një legjislacioni të ri, që do t’i përgjigjet me mirë respektimit të standarteve minimale të vendosura në Konvente, si dhe zgjerimit të tyre.

Të tilla përmirësime ligjore, do të konsistojnë në rishikimin e afateve për dhenien e informacionit në procedimet perkatese për kërkesat për akses në dokumentat zyrtare, në format e dhenies së informacionit, institucionalizimin e zyrave të informimit publik, apo edhe të mbrojtjes së veçante të të ashtequajturve individë “Bilbilfryres”.

Liria e ndërjegjes dhe e fesë njihen dhe respektohen nga shteti. Avokati i Popullit nuk ka mundur të trajtojë ankesa që lidhen me respektimin e lirisë së shprehjes dhe të besimit privatisht dhe publikisht. Në disa raste ka mundur të arrijë zgjidhje me mirëkuptim të këtyre rasteve. Gjatë vitit 2008 mund të themi se shteti shqiptar dhe Administrata Publike më së fundi moren përgjegjësinë për të rregulluar sipas Kushtetutës marrëdhëniet midis shtetit dhe fesë, përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me komunitetet fetare dhe ratifikimit të tyre në Parlament, si duke përgatitur një ligj të posaçëm, që pritet të garantojë të drejtën e ushtrimit të besimit dhe të funksionimit të komuniteteve fetare në vend. Në këto kuader në datën 24.10.2008, janë lidhur marrëveshjet ndërmjet shtetit dhe Komunitetit Musliman, Orthodhoks dhe atij Bektashian. Këto marrëveshje janë ratifikuar nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, perkatesisht me ane të miratimit të ligjeve nr.10056 datë 22.01.2009; nr.10057 datë 22.01.2009 dhe nr.10058 datë 22.01.2009. E vlerësojmë pozitivisht realizimin e kësaj detyre nga Qeveria dhe Kuvendi, sepse për 8 vite me radhe Avokati i Popullit e ka ngritur këto çështje në Raportet para Kuvendit.

Modeli sipas të cilit do të hartohet ligji shpresojmë se do të ketë parasysh traditën e bashkekzistencës paqësore fetare në vend, sikundër edhe dimensionin evropian që shteti shqiptar synon të zhvillojë në këtë fushë, ku si shteti, ashtu dhe feja kanë të njëjtin objektiv: individin shqiptar.

Edhe ky rregullim ligjor është ngritur çdo vit në Raportet vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit ka dhënë kontributin e tij institucional në hartimin e projekt-marrëveshjeve të komuniteteve fetare me shtetin, sikundër ka paraqitur mendimin e tij lidhur edhe me permbajtjen e projekt-ligjit të sipercituar, që pritet të diskutohet dhe eventualisht të miratohet nga Parlamenti gjatë vitit 2010.

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit, e tubimeve dhe manifestimeve paqësore, janë të garantuara me ligj. Të gjitha institucionet publike punojnë që ato të respektohen. Për fat të keq për zgjedhjet vazhdojnë diskutimet dhe dyshimet, mungesa e besimit reciprok, rrjedhur nga proceset elektorale të shkuara. Natyrisht ka dhe do të ketë opinione të ndryshme në këto drejtime, sidomos nga partitë politike. Avokati i Popullit ka zbatuar dhe është mbështetur fort në parimin e paanësisë, për të mos u komprometuar në pakënaqësitë e natyrshme të partive politike, që gjithmonë shoqërojnë garat elektorale për pushtetin qendror dhe atë vendor.

Pavarësisht vonesës, me të cilën u shoqërua procesi i krijimit të Regjistrimit të saktë të zgjedhësve dhe pajisjes së shtetasve me karta identiteti, si një element bazë për zgjedhjet e ardhshme të 2009, Avokati i Popullit e ka përshëndetur këtë zhvillim dhe ka inkurajuar shtetasit të kryejnë detyrimet e tyre ligjore në emër të së mirës publike, si parakusht për të përftuar zgjedhje të lira, të ndershme, të pakontestuar.

Në kuadrin e propozimeve për zgjidhjet teknike që do të jepen për zgjedhjet e ardhshme, Avokati i Popullit vazhdon ta konsiderojë si opsion edhe Rekomandimin e tij të hershëm për përdorimin e skanerëve elektronikë për të numëruar votat. Për këtë problem ne kemi paraqitur edhe përllogaritjet tona, si në drejtim të reduktimit të subjektivizmit njerëzor, ashtu edhe në drejtim të kostos me përfitim ekonomik për buxhetin e shtetit. Megjithatë, sa më sipër është një zgjidhje alternative, pasi jemi të ndërgjegjshëm se vendosja e besimit ndërmjet palëve konkurruese kërkon mbi të gjitha vullnet politik, i cili është mjeti më i saktë për të zhvleftësuar ose vlerësuar saktësisht çdo zgjidhje teknike që mund të ofrohet.

Avokati i Popullit ka ngritur me kohë edhe nevojën e zbatimit të së drejtës pozitive, që parashikon kuotën jo më pak se 30 përqind për përfshirjen e grave në formacionet vendimmarrëse në të gjitha nivelet apo funksionimin e gjithë strukturave të shtetit. Kjo është një arsye më shumë që Avokati i Popullit përshëndet sanksionimin e kuotës 30 përqind, në

Kodin e ri Zgjedhor, për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në politikë dhe vendimmarrje. Avokati i Popullit vazhdon të insistojë që në Kodin Zgjedhor të bëhen amendimet përkatëse për të ndaluar me ligj përfshirjen e fëmijëve në fushatat zgjedhore.

Te drejtat e femijeve jane nje nga priroritetet e punes se Avokatit te Popullit. Akoma më i ndjeshëm dhe konkret bëhet problemi nën fokusin e konventave për të drejtat e fëmijëve, të kësaj shtrese që edhe Avokati i Popullit, ashtu si të gjitha strukturat e shtetit dhe shoqëria shqiptare, mendon se i është borxhli, në kuptimin se mund të kishte bërë më shumë brenda mundësive juridiksionale.

Është pozitiv fakti se, po miratohen ligje të posaçme për të drejtat e fëmijëve si dhe për krijimin e një sistemi gjyqësor të veçantë. Gjatë vitit 2009, rekomandimet tona për krijimin sa më parë të qendrave për edukimin e atyre personave që nuk kanë arritur moshën për përgjegjësi penale (nën 14 vjeç), mundësisht edhe një institucion riedukimi i veçantë për ta, nuk kanë gjetur zbatim konkret, veçse me ngritjen e një qendre paraburgimi dhe riedukimi për të miturit mbi 14 vjeç në Kavaje. Veçse kapaciteti i saj për 45 fëmijë është i vogël.

Ka mbetur ende në shqyrtim, propozimi që ne i kemi paraqitur Parlamentit në fund të vitit 2008, ose duke krijuar një institucion më vete, siç mund të jetë Ombudsmani për Fëmijët, ose duke fuqizuar me më shumë burime njerëzore dhe financiare Avokatin e Popullit.

Një problem tjetër, që gjithnjë e më shumë po zë vend në tryezat evropiane për të drejtat e njeriut, ka të bëjë me të drejtat e personave me orientime të ndryshme seksuale. Në të njëjtën gjatësi vale me Zyrën e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës, këndvështrimi i Avokatit të Popullit është se të drejtat e këtyre personave nuk duhen parë vetëm si të drejta të pakicave, por si të drejta humane dhe, si të tilla, nuk duhen trajtuar mbi baza diskriminuese. Avokati i Popullit konsideron se duhen realizuar përpjekje konkrete kundër homofobisë dhe diskriminimit të bazuar mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Jurisprudenca e Strasburgut tashmë ka grumbulluar praktika të mjaftueshme pozitive, bazuar në legjislacionin ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përsa i përket çështjeve të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Fatkeqësisht, modeli i këtyre personave në Tiranë, në mënyre absurde vazhdon të identifikohet me stereotipin e pasqyruar edhe nga media, për disa të mjerë që punojnë si punëtorë seksi diku pas Pallatit të Kulturës. Kjo duhet të marrë fund dhe për këtë duhet të sensibilizohemi të gjithë. Në çdo rast, arbitrariteti ndaj këtyre personave është i papranueshëm.

Në lidhje me trafikun e qenieve njerëzore, nuk duhen mohuar rezultatet pozitive të viteve të fundit që kanë patur të bëjnë sidomos me rritjen e kontrollit të kufijve. Trafikimi i femrave për prostitucion dhe i

fëmijëve ekziston, por rastet janë pakësuar. Çdo ditë e më tepër njoftohet për vënie para ligjit të cilitdo që ka kryer vepra të tilla, qoftë edhe gjatë viteve të shkuara. Besojmë se ndryshimet e kërkuara kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Ligjin e ri “Për gjendjen civile”, të paraqitur tashmë në Kuvend. Me zbatimin e tij shpresojmë t’i jepet fund praktikës, që shumë fëmijë mbeten pa regjistruar në zonat rurale, pasi këta dhe ata të komunitetit Rom janë kontigjentet më të preferuara nga trafikantët.

Avokati i Popullit ka pergatitur dhe i ka derguar më datë 25.11.2009 Kuvendit të Shqipërisë, Raportin e veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit rom në Shqipëri”, pasi çështja e trajtimit të Romëve është një nga temat më të ndjeshme edhe nga partnerët ndërkombëtarë sa herë që diskutohen kapacitetet institucionale të shtetit tonë për respektimin e të drejtave të njeriut.

Ky Raport i Veçantë kishte për qëllim të ishte sa më i saktë në pasqyrimin e realitetit të përditshëm me gamën e problemeve që ndeshet komuniteti Rom dhe të sensibilizojë opinionin publik, shoqërinë civile, mediat, organet shtetërore dhe vendore për këtë realitet, ndryshimi i të cilës në përafrim me standartet e jetesës së pjesës tjetër të popullsisë, kërkon shumë vullnet, shumë punë, shumë programim dhe bashkëveprim të të gjithë aktorëve, shumë njerëz të përkushtuar.

Ne kete raport jane parashtruar edhe nje sere përfundimesh dhe rekomandimesh, të cilat kemi gjykuar se do t’i nevojiteshin Kuvendit të Shqipërisë në reagimet e tij për përmirësimin e një sërë aspektesh të kësaj gjendje. Meqenese ky raport, do te trajtohet ne nje pjese te veçante te raportit vjetor, theksojme se Avokati i Popullit vlereson se zgjidhjet e problemeve të Romëve nuk janë as te lehta, as te thjeshta dhe as te shpejta. Ato janë pjesë integrale, të lidhura pazgjidhshmërisht me zhvillimin tërësor të Shqipërisë edhe me forcimin e vazhdueshëm të ekonomisë.

Është detyrim i gjithë shoqërisë shqiptare për t’u emancipuar dhe për te bere edhe një hap në drejtim të civilizimit. Demokracia, mbi të gjitha prezumon mbrojtjen e pakicës. Respektimi i të drejtave të personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe etnike-gjuhësore, si pjesë e të drejtave humane të njohura universalisht, është një faktor i rëndësishëm për paqen, drejtësinë, stabilitetin dhe demokracinë.

Në lidhje me të drejtat e grave, konstatohet që vitet e fundit ka rënie të ndjeshme të trafikut të femrave. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e fushatave ndërgjegjësuese të ndërmarra nga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Por kryesore ka qenë ndjekja dhe zbatimi me rreptësi i ligjit ndaj trafikantëve, miratimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve të posaçme për mbrojtjen e viktimave të trafikut si dhe monitorimi i këtij procesi nga organizmat që janë krijuar enkas nga strukturat qeveritare. Në këtë drejtim ne kemi patur një bashkëpunim të

mirë edhe me Zyrën e Koordinatorës Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut pranë Ministrisë së Brendshme.

Një çështje tjetër që mbetet problem serioz ka të bëjë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave, fëmijëve apo vajzave. Situata duket që përmirësohet ngadalë. Puna parandaluese, që bëhet nga organizatat joqeveritare, është shoqëruar me miratimin e ligjeve përkatëse për dhunën në familje, por edhe me kujdesin për të hetuar dhe gjykuar me rreptësi çdo shfaqje dhune që përbën vepër penale. Duhet të ketë më shumë mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Duhet punuar më mirë nga organet shtetërore për realizimin e detyrimeve të tyre për t'i shkuar drejtësisë deri në fund, pavarësisht se viktimat e kësaj dhune mund të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër. Nuk duhet harruar se dhuna në familje nuk është atribut vetëm i familjeve të varfra apo atyre me shkollim të pamjaftueshëm. Ajo ka prekur dhe prek edhe familjet në gjendje të mirë ekonomike dhe me arsim të lartë.

Grave u duhen treguar mjetet dhe rrugët për t'u mbrojtur nga dhuna. Ka mundësira të ndryshme për të riparuar dëmet e shkaktuara nga aktet e dhunshme dhe njëra nga ato është përpjekja për zhvillim procesesh gjyqësore kundër autorëve, sipas rastit, civile ose penale. Vajtja në ndonjë "shtëpi për gratë e dhunuara" ose "shtëpi për njerëzit e braktisur" është një mundësi tjetër. Ndihma e specialistëve mund të synojë edhe ndryshimin e raporteve të dhunshme ose largimin e viktimës nga dhunuesi. Gratë, viktima të dhunës, duhet të kenë mundësi të marrin ndihmë mjekësore në atmosferë të ngrohtë mirëkuptimi. Kjo do të thotë që një grua të mos druhet kur të bëjë analizat; që në proceset hetimore të ruhet sfera private dhe dinjteti i viktimës; që zyrat e ndihmës apo këshillimoret të mund të jenë në gjendje të merren me të gjitha llojet e dhunës. Të gjitha këto, duke u bazuar minimalisht në tre parime bazë: t'u besosh grave; të mos i fajësosh gratë; të forcosh përgjegjësinë e tyre personale.

Në Shqipëri vazhdon të jetë problematike situata në lidhje me zbatimin e rregullave për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit në punë, sidomos në sektorët e ndërtimit, metalurgji dhe miniera. Mungojnë shpesh pagesat e sigurimeve për paaftësi të përkohshme për aksidente, për sëmundje ose për pensione, edhe sepse mjaft punëtorë punojnë në të zezë. Kushtet në vendet e punës, sidomos tek punëdhënësit privatë, janë të këqija dhe në disa raste të rrezikshme për jetën. Autoritetet publike dhe mediat shqiptare herë pas here kanë ngritur alarmin se "në Shqipëri, humbjet njerëzore nga mungesat në kushtet e punës dhe siguria në qarkullimin rrugor, janë më të mëdha se ato në raste luftrash apo

fatkeqësisht natyrore”. Avokati i Popullit sugjeron që duhet të ndryshojnë metodat e punës së inspektorateve që shteti ka krijuar për këto fusha. Justifikimet e natyrës së, “duke toleruar shkeljet e rregullave të sigurisë në punë, Qeveria ka dashur të mbështesë biznesin”, janë të dëmshme dhe të dënueshme.

Gjate vitit 2009, problematike është shfaqur situata në lidhje me sigurinë në rrugë për levizjen e udhëtarëve dhe të mjeteve motorrike. Janë pothuajse të përditshme rastet kur në media pasqyrohen aksidente rrugore, shpesh me pasoje humbjen e jetes së individëve drejtues të mjeteve motorrike, pasagjereve apo edhe kalimtarëve të rastesishëm. Duke e vlerësuar këtë gjë si një fenomen rëndësues dhe si cenim të së drejtës për jetën, Avokati i Popullit në muajin Korrik 2009 pas inspektimit të disa akteve rrugore me problematike, i ka rekomanduar institucioneve përkatëse përgjegjëse shtetërore, marrjen e të gjitha masave tekniko organizative për përmirësimin e gjëndjes së ndriçimit dhe sinjalistikës rrugore në akset e inspektuara nga ana jonë, bazuar në konstatimet e bëra. Po kështu është kërkuar edhe fillimi i inspektimeve nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve për evidentimin e mungesës së ndriçimit dhe të sinjalistikës rrugore në të gjitha akset për të cilat kjo drejtori është enti përgjegjës, si dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjëndjes në të gjitha ato akse që do të evidentohen si problematike.

Cilesia e jetes, ka qenë një nga drejtimet e tjera në të cilat është orientuar veprimtaria e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009. Duke shfrytëzuar një kompetencë diskrecionale, Avokati i Popullit ka filluar shqyrtimin me inisiativë të çështjes së bërë publike në media, lidhur me ekzistencën e emetimit në ajër të gazit Radon si një element radiokativ, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe sidomos në zonat urbane. Ky emetim i pakontrolluar cenon një indikator të rëndësishëm të jetes komunitare dhe të respektimit të të drejtave të individëve që jetojnë në këto komunitete, që njihet ndryshe si “cilesi e jetes”.

Është e natyrshme që, individët kudo dëshirojnë të jetojnë të lumtur, të bëjnë një jetë të shëndetshme, të jenë të sigurtë dhe të kenë diçka të dobishme për të bërë. Sigurisht që në këtë kuptim, çdokush dëshiron një cilesi jetë me të mirë. Në vizionin e Avokatit të Popullit, termi “cilesi e jetes” nuk duhet përdorur vetëm dhe thjesht për të vlerësuar mirëqenien e përgjithshme të individëve dhe shoqërive dhe nuk duhet të fokusohet vetëm tek koncepti i standartit të jetesës, i cili bazohet në radhë të parë tek të ardhurat. Ky konkluzion bëhet me evident, edhe për faktin se treguesit e standartit përfshijnë jo vetëm pasurinë dhe punësimin, por gjithashtu edhe mjedisin urban, shëndetin mendor dhe atë fizik, arsimimin, kohën e lire dhe arzetimin, si dhe perkatesinë sociale.

Duke qene se cilesia e jetes eshte bere nje nga çeshtjet me te ndjeshme per komunitetet tashme, ajo konceptohet rreth tre llojesh mjedisesh: mjedisi social, mjedisi urban, dhe mjedisi ekonomik. Ne menyre te padiskutueshme te treja keto “mjedise”, duhet t’i adresohen dhe te jene ne lidhje me njeri-tjetrin, por energjite me te medha komunitare sot jane adresuar tek mjedisi urban. Sikurse shume çeshtje te shendetit publik, si ato te shendetit fizik dhe te shendetit mendor, verehet se lidhen me mjedisin urban.

Pikerisht Avokati i Popullit vlereson se, nje mjedis urban i shendetshem dhe jo vetem, eshte garancia me e mire per te siguruar nje cilesi jetese te denje per te gjithë. Ne keto kushte, sfida e momentit eshte qe te jemi kreative dhe bashkepunues ne gjetjen e rrugeve te reja per te njohur dhe potencializuar asetet tona te konsiderueshme dhe te ndertojme dhe ruajme nje mjedis per te cilin ne te gjithë mund te kujdesemi.

Per kete qellim, gjykojme se eshte e nevojshme qe aktiviteti zbatues per studimin me qellim identifikimin me te hollesishem te legjislacionit europian ne kete fushe dhe perafimin e legjislacionit vendas me kete te fundit, te kete perparesi percaktimin e nje sistemi monitorimi dhe vleresimi te vazhdueshem mbi perhapjen dhe rrezikshmerine e gazit Radon ne te gjithë vendin, veçanerisht ne zonat urbane. Nga ana tjetër, eshte e nevojshme qe te ndermerren te gjitha iniciativat legjislative, me qellim parandalimin e efekteve te demshme te ketij gazi radioaktiv per shendetin e njeriut, sidomos ne rastet e ndertimeve te reja.

Ne kete kendveshtrim, duhet te behet e detyrueshme kryerja e nje studimi te trullit gjeologjik te ndertimeve te reja per vleresimin e rrezikut Radon, materialet e ndertimit para se te perdoren duhet te analizohen dhe te çertifikohen per kete element radioaktiv, si dhe duhet shtuar si kusht ndertimor, kerkesa per çertifikaten e emetimit te Radonit, e cila duhet te leshohet nga institucionet pergjegjese.

E gjithë kjo ndermarrje dinamike dhe emergjente, kerkon nderhyrje ne legjislacionin specifik ne fuqi per plotesimin apo permiresimin e tij, si dhe nxjerrjen e akteve te reja normative, te nevojshme.

Kjo kerkese behet me aktuale, nese i referohemi faktit se ne zbatim te detyrave te percaktuara ne Planin Kombetar per zbatimin e Marrveshjes se Stabilizim Asociimit, te miratuar me VKM-ne nr.463 date 5.07.2006, qofte ne prioritetet afatshkurtra apo edhe ato afatmesme, monitorimi i cilesise se ajrit perben nje aktivitet zbatues, qe duhet te realizohet nga ana e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.

Ne keto rrethana i eshte rekomanduar Ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, qe ne bashkepunim me ministrite dhe entet e tjera publike te interesuara, te pergatiten draftet ligjore, qe ne perputhje

me piken 1, te nenit 81, te Kushtetutes te Republikes te Shqiperise, Qeveria te realizoje iniciativen legjislative, per ndryshimet e nevojshme ligjore, per parandalimin dhe monitorimin e rreziqeve qe vijne nga emetimi ne ajer i gazit radiokativ Radon, ne perputhje me kerkesat e legjislacionit europian ne kete fushe.

Games se katalogut te te drejtave dhe lirive themelore te njeriut te pranuar dhe njohura nderkombetarisht, i jane bashkangjitur dhe shtuar disa nga te drejtat me te reja, te njohura si “Te drejtat e Pacientit”. Mbrojtja ligjore e te drejtave te pacienteve, ashtu si mbrojtja e çdo grupimi tjetër social, eshte nje hap themelor ne forcimin e demokracise dhe shtetit te se drejtes.

Te drejtat e pacientit nuk jane asgje me shume dhe asgje me pak veçse mbrojtja e te drejtave te njeriut ne nje fushe te veçante dhe me konkretisht ne ate te sherbimeve te shendetit. Afirmimi i te drejtave te pacientit u bazua pikerisht ne njohjen se, çdo njeri te pakten nje here ne jeten e tij do te jete patjeter konsumator i sherbimeve mjekesore ose pacient, si dhe ne vleresimin e parimit se çdo njeri qe perdor sherbimet e perkujdesjes shendetesore, ne te vertete eshte nje “konsumator” i sherbimeve mjekesore, prandaj marredheniet mes “Ofruesit te sherbimit” dhe “Konsumatorit”, duhet te rregullohen.

Padyshim qe nje rol specifik ne kete kuader, luan edhe veprimtaria e institucionit te Avokatit te Popullit, qe ne vazhdimesi e ka konsideruar sherbimin shëndetësor një ndër objektivat primare të punës së tij, pasi cilësia e shëndetit dhe e mbrojtjes së tij, është një nga të drejtat më elementare që duhet të garantojë Shteti Shqiptar në dobi të të gjithë individëve që kanë nevojë për të. Ne kete kendveshtrim, pacienti nuk eshte konsideruar thjesht si perfitues sherbimesh apo konsumator i tyre, por ai eshte realisht edhe kontribuesi kryesor financiar i tyre. Ky eshte standardi qe ka percaktuar edhe qendrimin tone konstant ne drejtim te trajtimit te te gjitha ankesave te paraqitura nga ana e qytetareve ne adrese te institucioneve qe ofrojne sherbimin shendetesor, apo te atyre strukturave shteterore te cilat kontrollojne cilesine e ofrimit te ketij sherbimi.

Pra, pacienti duhet te konsiderohet si partner dhe shtyllë kryesore e sistemit shëndetësor. Ky qendrim behet edhe me imperativ, kur procesi i integritimit tone ne Bashkimin Europian kerkon arritjen e standardeve te percaktuara ne dokumente te tilla si “Karta e te Drejtave Themelore”, e nenshkruar ne 7 Dhjetor 2000 nga vendet anetare te BE-se, e pasuar kjo nga “Karta Europiane e te Drejtave te Pacienteve”, nenshkruar nga vendet anetare te BE-se ne vitin 2002.

Te drejtat baze te pacienteve te njohura nderkombetarisht afirmojne dhe garantojne ushtrim efektiv te tyre nga individet per: mjekesine parandaluese; aksesin ne sherbime; informacionin; pelqimin; zgjedhjen e



lire; jeten private dhe konfidencialitetin; respektin per kohen e pacienteve; vrojtimin e standardeve te cilesise; sigurine; novacionet; evitimn e vuajtjeve te panevojshme; evitimn e dhimbjeve te panevojshme; trajtimin e personalizuar, si dhe te drejten per t'u ankuar dhe per te marre demshperblim.

Gama e ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit është shumë e gjerë. Por padyshim qe nje vend te posaçem ne çeshtjet e trajtuara nga ana jone, zene ankesat qe lidhen me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj, si menaxhuesit dhe ofruesit kryesore te sherbimit shendetesor ne vend. Problematika e ketyre ankesave ka qënë kryesisht e lidhur me aspekte te procedurave administrative, si p.sh per protokollin mjekesor per semundjen e talasemise ne spitalet tona, per hartimin e nje strategjie kombetare per sigurimin e gjakut me cilesi dhe ndjekjen nen kontroll te vazhdueshem te femijeve me kete semundje. Por nuk kane munguar, megjithese ne nje numer te paket edhe ankesat qe lidhen me cilesine e sherbimit shendetesor. Nderkohe, Avokati i Popullit ka ushtruar kompetencën që i është dhënë nga ligji për të kryer inspektime në institucionet publike shëndetësore, konkretisht në disa spitale infektive si dhe ne spitalet psikiatrike. Nga keto inspektime te realizuara, ka rezultuar se shërbimi shëndetësor për shëndetin mendor ka të meta si në menaxhimin mjekësor dhe ekonomik, ashtu dhe në zbatimin e ligjit.

Nga ana tjeter konstatohet se, personeli yne mjekesor nuk eshte ende i pergatitur per t'iu pergjigjur kerkesave te pacienteve, sidomos per te respektuar te drejtat e tyre dhe kjo mospergatitje vazhdon te jete e dukshme. Edhe informimi i pacientit per te drejtat e tij, gjate procesit te sherbimit shendetesor qe i ofrohet, rezulton te jete i manget. Por a mund te ekzistojte nje marredhenie e qendrueshme, nese palet nuk kane te qarta te drejtat dhe detyrimet e tyre, per me teper kur nuk ekziston baza e plote normative qe percakton keto te drejta dhe detyrime?

Fakti eshte se sot e kesaj dite nuk kemi miratuar ende nje ligj per mbrojtjen e pacientit dhe kjo ne nje kohe kur permiresimi i shendetit dhe promovimi i te drejtave te pacientit, jane tashme ne qender te vemendjes te Bashkimit European dhe Keshillit te Europes, te cilet nxisin shtetet anetare te krijojne legjislacionin e duhur per te drejtat e pacientit, dhe ta perditesojne ate me legjislacionin e shteteve me te perparuara. Kjo eshte edhe nje nga konstatimet e shumta qe u bene, si dhe nje nga rekomandimet qe dolen nga konferenca kombetare e organizuar nga Avokati i Popullit ne muajin Dhjetor 2008, "Per mbrojtjen e te drejtave te konsumatorit", ku te drejtat e pacientit zune nje vend te veçante. Veçanerisht ky konkluzion eshte theksuar edhe ne tavolinen e rumbullaket te bashke-organizuar nga Institucioni yne me Qendren Kombetare te Cilesise, Sigurise dhe Akredimit te Institucioneve Shendetesore, me date 17 Prill 2009, ne Tirane.

Pikerisht kjo tavoline e rumbullaket, por edhe aktivitete te tjera te organizuara nga Ministria e Shendetesise gjate viti 2009 ku Avokati i Popullit ka qene kontribues aktiv, jane shprehje e angazhimit te perbashket te te gjithë aktoreve ne vend, qe si prioritet lidhur me të drejtat e pacientëve, konstatojne krijimin me urgjencë te legjislacionit të munguar, krijimin e mekanizmave rregullatore, e pa dyshim krijimin e një kulture të re te përgjegjesisë për gjithçka që bëjmë dhe nuk bëjmë per pacientin.

Trajtimi i të shoqeruarve, i te ndaluarve dhe të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, apo të të dënuarve në burgje, megjithë përmirësimet nga viti në vit, vazhdon të ketë probleme dhe ankesa. Edhe trajtimi i të sëmurëve mendorë në spitalet psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues. Inspektimet e kryera nga Avokati i Popullit, në të gjitha institucionet e shëndetit mendor, gjatë vitit 2009, nga Njësia për Parandalimin e Torturës, kanë konstatuar se spitalet vazhdojnë të kenë mungesa stafi, barnash dhe pajisjesh mjekësore, kushte të papranueshme higjieno sanitare dhe mungesa në pajisje për jetesë normale. Për të bërë të mundur rregullimin e gjendjes në standarde të pranueshme ne kemi rekomanduar ndryshime dhe përmirësime të legjislacionit si dhe të infrastrukturës së sistemit të kujdesit për shëndetin mendor në Shqipëri.

Qeveria Shqiptare duhet t'i kërkojë më tepër llogari institucioneve vartëse të drejtësisë, policisë e mjekësisë, që të punojnë më seriozisht për zbatimin e vendimeve të saj, për t'i ndarë përgjegjësitë. Avokati i Popullit ka theksuar vazhdimisht se problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Fillimi i veprimtarisë nga institucioni i lirit nga burgju me provë është një hap pozitiv që besojmë se do japë rezultatenë vitet në vazhdim. Mënyra më efikase për të ulur nivelin e lartë të mbipopullimit në burgje është aplikimi i dënimeve alternative, veç llojit të burgimit apo arrestit me burgim. Prokurorët dhe gjyqtarët ngurojnë t'i zbatojnë dënimet alternative nga frika se mos i akuzojnë se “tregohen të butë ndaj kriminalitetit” apo se “mos i akuzojnë për korrupsion”.

Sfidat dhe veshitësite qe hasen ne permiresimin e sistemit penitenciar ne vendin tone mbartin trashegimi problematike nga e kaluara, te shoqeruara nga fenomene apo praktika negative te sotme qe ndikojne ne keqadministrimin e ketij sistemi. Keta elemente jane dhe mbeten shqetësues dhe njekohesisht objekt i punes se te gjitha organeve shteterore, institucioneve te pavarura dhe grupeve te veçanta te shoqerise civile qe operojne ne kete fushe.

Ne ndjekje te kesaj problematike, Avokati i Popullit krahas funksionimit te Njësise për Parandalimin e Torturës, ne muajin Qershor 2009 ka nenshkruar nje marreveshje bashkepunimi me nje nga shoqatat

jofitimpruresë që vepron në këto fushë, Institutin Europian të Tiranës, me synimin e qartë për të dokumentuar përpjekjet e përbashkëta në përmirësimin e të drejtave të njeriut në sistemin e paraburgimit. Ky bashkëpunim është vlerësuar jo vetëm thjesht si një kërkesë e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, por edhe si një koordinim i punës në këto sektorë, duke kryer vizita të përbashkëta me eksperte të të dyja paleve në qendra të veçanta të paraburgimit në vend.

Produkti i kësaj pune ka qenë Raporti i Monitorimit 2009, mbi zbatimin e masterplanit “Sistemi shqiptar i paraburgimit 2005-2008”. Pikerisht në këto dokument dalin një sërë konstatimesh dhe rekomandimesh për sistemin e paraburgimit në vend. Shtimi i përpjekjeve të autoriteteve përkatëse shtetërore për të ndaluar keqtrajtimet e shkaktuara nga Policia e Burgjeve ndaj të paraburgosurve; ndalimi rreptesisht i praktikave të trajtimit çnjerezor të të paraburgosurve në qendrat e paraburgimit; rekrutimi cilësor dhe trajnimi i vazhdueshëm i personelit të Policisë së Burgjeve për njohjen dhe respektimin e të drejtave të të paraburgosurve; përmirësimi i kushteve në teresi në qendrat e paraburgimit; përmirësimi i procedurave për ofrimin në kohë të shërbimit mjekësor të përgjithshëm apo të specializuar të paraburgosurve; rritja e numrit të psikologeve që punojnë në sistemin e paraburgimit; ndryshimi e përmirësimi i kuadrit ligjor që do të mundësojë këto zhvillime, janë rekomandimet që jepen në këto raport.

Për prokurorinë dhe gjykatat vazhdon të ketë një numër të madh ankesash, sidomos për vonesat e paarsyeshme (zvarritjet) e çështjeve gjyqësore, civile apo penale, sidomos duke kërkuar që të paraburgosurit e padënuar të dalin para gjyqit sa më shpejt që të jetë e mundur. Në këto kushte, në kemi rekomanduar vazhdimisht se duhet vazhduar puna për përmirësimin dhe hartimin e ligjeve të reja për luftën kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor; zbatimin pa kushte të vendimeve gjyqësore; për përjashtjen e legjislacionit vendas me marrëveshjet ndërkombëtare, përmirësimin e marrëdhënieve konkrete të punës së përditshme midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave kundër krimit të organizuar etj.

Për të siguruar më mirë të drejtën e jetës dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, edhe në kuadrin e reformës në drejtësi, Avokati i Popullit ka paraqitur prej vitesh pranë Komisionit Parlamentar të Ligjeve si dhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, propozimin për përgatitjen e një ligji për Investigatorin privat si dhe për pjesëmarrjen e avokatit të personit të dëmtuar (viktimës), qysh në fazën e hetimit, siç e kanë edhe shumë vende të tjera të botës së qytetëruar. Njohja e këtyre dy funksioneve, me të drejta dhe detyrime proceduriale në procesin penal, do të rrisë forcën zbuluese ndaj krimeve, do të parandalojë vonesat në hetime dhe gjykime, si dhe do të reduktojë edhe korrupsionin në prokuroritë dhe gjykatat tona,

veçse edhe krijohet konkurrencë dhe rriten mundësitë e individit në luftën kundër kriminalitetit.

Procesi i trajnimit dhe testimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të vazhdojë, por me kritere e kontroll të rreptë për aftësitë e tyre profesionale. Gjithashtu, atyre u duhen siguruar kushte më të mira jetese dhe sigurie për jetën e tyre. Avokati i Popullit vlerëson se aktet normative të miratuara kohët e fundit, në kuadër të Reformës në Drejtësi, janë një përpjekje serioze në këtë fushë dhe beson se do të rrisin efektivitetin e drejtësisë shqiptare.

Nderkohe përsërisim shqetësimin për mospërkthimin dhe mosbotimin në Fletoren Zyrtare të të gjitha Konventave dhe akteve ndërkombëtare, të nënshkruara nga Qeveria dhe ratifikuara nga Parlamenti. Kjo situatë sjell dëme të mëdha, sepse këto tekste akoma nuk janë në përdorim të të gjitha institucioneve zyrtare të interesuara dhe në veçanti të gjykatave shqiptare, duke dëmtuar si shtetin, ashtu edhe qytetarët.

Në përfundim të kësaj paraqitjeje, theksojmë se Raporti i Avokatit të Popullit nuk përbën një pasqyrë tërësore, shteruese për nivelin e respektimit të të gjitha të drejtave që parashikojnë Kushtetuta dhe ligjet në Republikën e Shqipërisë. Ky Raport është pjesë e një sistemi informacioni, që mbetet për t'u plotësuar me të dhëna të tjera dhe nga burime të tjera.

Është e qartë për të gjithë, se përgjegjëse për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në çdo vend, janë Parlamenti dhe Qeveria e dalë prej tij. Avokati i Popullit mbështet vlerësimet realiste që Qeveria Shqiptare ka bërë përmes Zëdhënëses së saj, njëkohësisht Ministre e Integritimit, botuar në shtypin e përditshëm me 25 Janar 2009, ku thuhet:

“... Shqipëria po bind gjithnjë e më tepër partnerët e BE-së, se është e gatshme për të aplikuar për statusin e vendit kandidat për në këtë organizëm ... Por, tani fillojnë edhe vështirësitë më të mëdha, sepse pas çdo hapi progresiv në këtë proces, shtohen detyrime dhe përgjegjësi edhe më të mëdha. Për ne është e rëndësishme që procesi të jetë cilësor...”.

Institucioni i Avokatit të Popullit e ka të qartë rolin që ka kryer dhe do të vazhdojë të kryejë me rigorozitet në detyrën e tij themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe rritjen e cilësisë mirëqeverisëse në Republikën e Shqipërisë.

### 3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

Institucioni i Avokatit të Popullit që nga krijimi i tij dhe në vazhdimësi ka ndjerë kujdesin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për forcimin dhe konsolidimin e tij. Në vazhdimisht deklarojmë se e ndjejmë veten, “... krahu i zgjatur i Parlamentit mbi Administratën

Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihen qëllimet e ligjvënësit”.

Gjatë gjithë periudhës 10-vjeçare të ngritjes dhe funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit (2000-2009) asnjë organ apo autoritet publik nuk e ka vënë në dyshim rolin pozitiv të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për institucionin tone në vazhdimësi. Edhe gjatë vitit 2009, ashtu si në vitet e mëparshme, Avokati i Popullit ka vazhduar të informojë here pas here me shkrim si Kryesinë e Kuvendit, ashtu edhe komisionet e përhershme parlamentare. Gjithashtu kemi bashkëpunuar edhe me grupe deputetësh për çështje të veçanta, si dhe kemi dhënë mendime për projektligje të veçanta, kur na është kërkuar mendimi. Një vend të veçantë kanë zënë sidomos informacionet dhe rekomandimet tona, me synim që deputetët të informohen si për shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut nga organet, autoritetet dhe institucionet e ndryshme politike, por edhe për nxitjen e nismave legislative direkt nga vetë deputetët. Kryesia e Kuvendit është treguar e gatshme dhe në çdo rast ka pritur homologët e Avokatit të Popullit që kanë zhvilluar vizita zyrtare tek ne si dhe ka shprehur opinionet pozitive të Kuvendit për veprimtarinë tonë.

Si çdo vit më 5 mars 2009 Avokati i Popullit dorëzoi në Kuvendin e Shqipërisë, Raportin për veprimtarinë e tij gjatë viti 2008. Më datën 07.04.2009 Komisioni parlamentar i Çështjeve ligjore, dëgjoji Avokatin dhe në mbledhjen tjetër të datës 14.04.2009 përgatiti Projekt Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2008”.

Për shkak të zgjedhjeve parlamentare që u zhvilluan më datën 28 qershor 2009, Kuvendi i Shqipërisë nuk mundi që të merrte në shqyrtim në seancë të veçantë parlamentare Raportin tonë për vitin 2008, ashtu siç ndodhi edhe me Raportet e disa institucioneve të tjera kushtetuese. Prandaj Avokati i Popullit pati parasysh gjatë punës së tij për vitin 2009 objektivat e Projekt Rezolutës së datës 14.04.2009, si më poshtë:

a) gjetjen e mundësive dhe zgjidhjeve nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit për sensibilizimin e opinionit publik lidhur me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të tij;

b) denoncimin në vijimësi të shkeljeve të të drejtave të shtetasve nga administrata shtetërore, qendrore apo vendore dhe rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të publikut për kërkimin e të drejtave të shkeluara, apo të mohuara;

c) përmbushjen me sukses të programit të inspektimit në komisariate policie, burgje, qendra paraburgimi, spitale, reparte ushtarake etj;

ç) thellimin e bashkëpunimit me Televizionin Publik Shqiptar dhe televizionet e tjera kombëtare apo lokale për të mbajtur një komunikim të drejtpërdrejtë me shtetasit shqiptarë;

d) ndjekjen e rekomandimeve të bëra nga ky institucion deri në realizimin e tyre;

dh) intensifikimin e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe organizatat jofitimprurëse;

e) veprimtaria e njësisë për monitorimin dhe parandalimin e torturës që funksionon pranë Avokatit të Popullit të ketë aksesin e duhur me akte ligjore apo nënligjore si edhe detyrimin për të zhvilluar inspektive

Nga ky Raport që paraqesim para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të shoqëruar me shifrat përkatëse për veprimtaritë konkrete si në fushën e pranimin dhe zgjidhjes së kërkesave apo ankesave të shtetasve, të marrëdhënieve me mediat, bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse apo rekomandimeve për nxjerrjen apo plotësimin e ligjeve apo akteve nënligjore kemi nxjerrë konkluzionin paraprak **se në tërësi gjatë vitit 2008 është punuar më mire edhe në krahasim me vitin 2007 për realizimin e objektivave që na ka caktuar Kuvendi.**

**A.** Gjatë vitit 2009 Kryesia e Kuvendit apo Komisionet e Përherëshme Parlamentare janë informuar me shkrim apo i janë dërguar Rekomandime për 31 çështje, në një kohë që në vitin 2008 është informuar për 25 çështje.

1. Informacion për fitimin nga Avokati i Popullit të Statusit “A”, si Institucion Kombëtar për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, dërguar më datën 12.01.2009.

2. Konkluzionet e Konferencës Kombëtare “Mbrojtja e të drejtave të Konsumatorëve” dërguar më datën 28.01.2009.

3. Rekomandim për ndryshimin e nenit 352 të Ligjit Nr.8191, dt.29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dërguar më datë 02.02.2009.

4. Rekomandimi për marrjen e iniciativës për disa plotësime në ligjin Nr.7952, dt.21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe në Dispozitat Normative për Arsimin, për garantimin sa më të plotë të të Drejtave të fëmijëve, dërguar më datën 02.02.2009.

5. Rekomandime për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, në favor të fëmijëve dhe në kuadrin e Reformës në drejtësi, dërguar më datën 02.02.2009.

6. Rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen përfundimtare të trajtimit ligjor të të sëmureve mendorë që mbahen ende padrejtësisht në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, dërguar më datën 04.02.2009.

7. Rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e Ligjit Nr.8328, dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” në burgun e Burrelit, dërguar më datën 18.02.2009.

8. Rekomandimi për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, dërguar më datën 24.02.2009.

9. Informacionin për ankesën e shtetasit Kujtim Çashku, dërguar më datën 27.02.2009.

10. Rekomandimi për akordimin e menjëhershëm të një fondi për rritjen e kuotës ushqimore të të sëmurëve të spitaleve psikiatrike në vend, dërguar më datën 30.03.2009.

11. Rekomandimi që t’i propozohet Kuvendit për ndryshime dhe shtesa në nenet 147 dhe 417 të Kodit të Procedurës Penale, dërguar më datën 08.04.2009.

12. Gjashtë rekomandime të Avokatit të Popullit dërguar më datën 14.04.2009, për inspektimet e bëra në disa Azile. Shtëpi Fëmije dhe Qendra Zhvillimi.

13. Informacioni mbi studimin e kryer për funksionimin e Komisioneve Mjekësore për rekrutimin e shtetasve në shërbimin e detyrueshëm ushtarak, dërguar më datën 23.04.2009.

14. Rekomandimi për nxjerrjen e një akti nënligjor nëpërmjet të cilit të njoftohen dhe detyrohen të gjitha institucionet publike dhe jopublike për të njohur dhe pranuar letërnjoftimin e ri si dokument bazë identifikimi të shtetasve, dërguar më datën 24.04.2009.

15. Rekomandimi për nxjerrjen e një urdhëri që Drejtoritë Arsimore të ndalojnë përdorimin e shkollave dhe pjesëmarrjen e nxënësve dhe të mësuesve të shkollave në mitingjet elektorale të partive politike të vendit gjatë orarit të mësimin, dërguar më datën 24.04.2009.

16. Informacioni për inspektimet e bëra nga Zyra e Avokatit të Popullit në Drejtoritë e Policisë të Qarqeve Kukës, Dibër, Fier dhe Berat, si dhe në Komisariatet në varësi të tyre, dërguar më datën 09.10.2009.

17. Rekomandimi për sistemimin e të sëmurit mendor Fatmir Rasha në Qendrën e Zhvillimit të Përkujdesit Shoqëror në Vlorë si dhe ngritjen e një qendre e të posaçme për kategorinë e të sëmurëve mendorë, të cilët janë mbi moshën 25 vjeç, dërguar më datën 23.10.2009.

18. Për përmirësimin e përmbajtjes së dispozitës së fundit të ligjeve që do të miratohen në të ardhmen, lidhur me kohën e hyrjes në fuqi të tyre, për ta qartësuar e saktësuar atë, dërguar më datën 26.10.2009.

19. Rekomandimi lidhur me shpejtimin e procedurave për miratimin në Kuvendin Shqipërisë të Projekt Ligjit “Për një shtesë në Ligjin Nr.8053, dt.21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, me ndryshime, dërguar më datën 04.11.2009.

20. Tre rekomandime që kanë lidhje me konfliktin e banorëve të qytetit të Orikumit me Policinë e Shtetit, dërguar më datën 04.11.2009.

21. Dy rekomandime që kanë të bëjnë me kryerjen e hetimeve dhe gjykimeve objektive për veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit nga prokuroritë dhe gjykatat si dhe me marrjen e masave efektive për trajtimin human të shtetasve shqiptarë që kapen për kalim të paligjshëm të kufirit nga policia shqiptare, dërguar më datën 04.11.2009.

22. Studimi i Avokatit të Popullit “Mbi ndalimet dhe arrestimet e kryera nga Policia e Shtetit dhe të shpallura të paligjshme nga gjykatat për vitet 2005-2008”, dërguar më datën 13.11.2009.

23. Rekomandimi për përgatitjen e drafteve ligjore për realizimin e iniciativës legjislative nga Qeveria për parandalimin dhe monitorimin e rreziqeve që vijnë nga emërtimi në ajër i gazit radioaktiv Radon, dërguar më datën 24.12.2009.

Për të gjitha rastet e mësipërme, bashkë me informacionin apo rekomandimin përkatës, Kuvendi apo Komisionet përkatëse janë informuar edhe për institucionet apo organet e administratës publike, të cilëve ju janë dërguar këto materiale, bashkë me propozimet për rrugëzgjdhjen e tyre, sipas këndvështrimit tonë.

**B.** Gjithashtu Kuvendit të Shqipërisë i janë dërguar mendimet dhe propozimet e Institucionit të Avokatit të Popullit për projektligjet e mëposhtme, për të cilat na janë kërkuar mendimet nga Komisionet përkatëse, si dhe kur ka qenë rasti kemi marrë pjesë edhe në diskutimin e tyre në komisionet parlamentare.

1. Për projekt-ligjin “Për gjendjen civile” më datën 27.01.2009.

2. Për projektligjin “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative”, dërguar më datën 02.03.2009 dhe 22.10.2009.

3. Për projekt-ligjin Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dërguar më datën 21.07.2009.

**C.** Kryetares së Kuvendit i është dërguar edhe Raporti i Veçantë Nr.4 “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri”.

Paraqitja e këtyre Raporteve bazohet në nenin 63, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme”, si dhe në nenin 27 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku thuhet se:

“Përveç raportimit në kushtet e nenit 26, Avokati i Popullit mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të



Kryetari të Kuvendit ose të një grupi deputetësh. Kryetari i Kuvendit vlerëson nëse ky raportim do të bëhet:

- në seancë plenare;
- me shpërndarje të raportit;
- në komisionet e përhershme të Kuvendit;”

Sipas ligjit kopje e Raportit të veçantë Nr.4 i janë dërguar edhe Presidentit të Republikës, Kryeministrit, si dhe organit më të lartë epror, vartësit e të cilëve janë përmendur në këtë raport, siç janë Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministri i Shëndetësisë etj.

Në vitin 2008 u bënë tre Raporte të Veçanta dhe ishte hera e parë që Raporte të tilla u përgatiten nga ne. Ato janë bërë në përmbushje të detyrimeve tona kushtetuese si dhe për të vënë në zbatim detyrat e lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë e vitit 2008 për të prezantuar edhe gjatë vitit tematika të rëndësishme të gjendjes së të drejtave të njeriut në formën e Raporteve të Veçanta apo të Posaçme.

Pavarësisht qëndrimit të deritanishëm neglizhues për mosshqyrtimin e tre Raporteve të veçantë, Avokati i Popullit do të vazhdojë ta ketë prioritet të tij detyrën për të informuar dhe bashkëpunuar sa më shumë me Kuvendin e Shqipërisë dhe në veçanti me Komisionet e përhershme të tij, në interes të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve shqiptarë.

#### 4. Raporti i Veçantë Nr.4 dërguar Kuvendit të Shqipërisë

##### **1. Objekti dhe qëllimi i Raportit të Veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri”**

Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tij. Ai ka si mision parandalimin apo zgjidhjen e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit. Në këtë kuadër brenda mandatit dhe juridiksionit të Avokatit të Popullit është edhe veprimtaria për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Romëve.

Pakica rome jeton në Shqipëri përkrah minoriteteve të tjera dhe konsiderohet si minoritet etno gjuhësor. Popullsia Rome në një pjesë të madhe nuk figuron e regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, fenomen i cili është më i përhapur për personat e lindur pas viteve '90. Lidhur me

numrin e pakicës romë në Shqipëri nuk ka statistika të plota dhe të sakta, por sipas përfaqësuesve të organizatave të kësaj pakice ose studimeve të kryera nga institute të pavarura, numri luhet nga 30.000 – 120.000 persona gjithsej. Mungesa e statistikave të sakta ka qënë dhe është një pengesë e madhe për studimin dhe analizimin e saktë të gjendjes së kësaj bashkësie. Përgjithësisht pakica romë banon në zonat periferike të qyteteve dhe në zonat rurale. Përqëndrimet më të mëdha të kësaj popullsie janë në Tiranë, Fier, Elbasan, Durrës, Berat, Korçë, Vlorë dhe Fushë-Krujë.

Në vitin 2003 Banka Botërore bëri studimin e parë të plotë për kushtet e jetesës së këtij komuniteti në Shqipëri. Disa nga problemet kryesore që dolën në pah nga ky studim dhe studime të tjera të mëvonshme janë:

- Niveli i ulët arsimor që konstatohet nga numri i vogël i të regjistruarve në shkolla dhe mbizotërimin e analfabetizmit në radhët e tyre;

- Shumica e familjeve romë jetojnë në varfëri, nën minimumin jetik;

- Pakica romë ka përqindje të lartë të papunësisë, krahasuar me grupet e tjera të popullsisë;

- Kushtet e këqia të jetesës. Shpesh romët nuk kanë strehim të sigurt, u mungon infrastruktura sanitare dhe uji i pijshëm,

- Kujdesi shëndetësor i pamjaftueshëm. Në disa zona të banuara romët nuk kanë mundësi t'u drejtohen institucioneve shëndetësore ose nuk janë në gjendje që të paguajnë për barna apo shërbime mjekësore.

- Për të përballuar varfërinë ka nivel të lartë të trafikimit dhe prostitucionit.

Duke u mbështetur në vlerësimin e gjendjes së kësaj bashkësie dhe duke marrë parasysh analizat, studimet, vëzhgimet dhe raportet e institucioneve shtetërore dhe organizatat jo qeveritare, Qeveria shqiptare miratoi në shtator të vitit 2003 Strategjinë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës romë”, dhe e miratoi atë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.633 datë 18.09.2003. Kjo Strategji çeli një perspektivë për integrimin social dhe përmirësimin e standarteve të jetesës së këtij komuniteti vital, tradicionalisht të vuajtur dhe marginalizuar.

Strategjia ishte iniciativa e parë e ndërmarrë nga Qeveria shqiptare për të trajtuar problemet me të cilat përballej bashkësia romë në Shqipëri. Hartimi dhe zbatimi i saj kishte qëllim të dyfishtë. Së pari, synonte plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga ratifikimi i Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Së dyti, duke

synuar procesin e integritit në BE, Qeveria shqiptare po përpqej të përmbushte kriteret politike të vendosura nga Deklarata e Kopenhagës.

Bashkësia rome e përshëndeti miratimin e Strategjisë nga ana e Qeverisë, duke e konsideruar atë si një zhvillim pozitiv. Zbatimi i kësaj Strategjie është përcaktuar të realizohet për një periudhë 15-vjeçare dhe parashikon në mënyrë të detajuar marrjen e masave që mbulojnë disa fusha.

Në dhjetor 2007 Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë për Minoritetin Rom, pranë Shërbimit Social Shtetëror në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me mbështetjen dhe asistencën e PNUD-it realizoi Raportin e parë të përparimit, në zbatim të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome”. Në këtë Raport u përfshinë të gjitha arritjet, masat e marra nga institucionet shtetërore për realizimin e objektivave kryesore, si edhe u nxorrën në dukje problemet dhe mangësitë kryesore, që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa objektivave të kësaj Strategjie.

Por zbatimi i Strategjisë megjithatë mbetet i ulët tashmë gjashtë vjet pas miratimit të saj. Pavarësisht nga disa iniciativa të suksesshme, objektivat e Strategjisë nuk janë transmetuar në nivel të kënaqshëm si tek Romët, ashtu edhe tek organet dhe institucionet përgjegjëse, si dhe nuk ka patur shumë plane konkrete për zbatimin e saj në praktikë. Struktura përgjegjëse për monitorimin e Strategjisë nuk ka patur burime të mjaftueshme njerëzore e financiare dhe nuk ka autoritetin e mjaftueshëm ligjor për të përmbushur misionin e saj në zbatim të ligjit.

Prandaj në vijim, në tetor 2009 Qeveria Shqiptare miratoi Planin Kombëtar të Veprimit 2010-2015, në kuadër të Dekadës së Përfshirjes së Romëve.

Ky Raport i Veçantë ka për qëllim të jetë sa më i saktë në pasqyrimin e realitetit të përditshëm me gamën e problemeve që ndeshet komuniteti Rom dhe të sensibilizojë opinionin publik, shoqërinë civile, mediat, organet shtetërore dhe vendore për këtë realitet, ndryshimi i të cilës në përafrim me standartet e jetesës së pjesës tjetër të popullsisë, kërkon shume vullnet, shumë punë, shumë programim dhe bashkëveprim të të gjithë aktorëve, shume njerëz të përkushtuar.

Adresimi i problemeve të Romëve në Kuvendin e Shqipërisë bëhet sepse situata e konstatuar në drejtim të respektimit dhe realizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe niveli i reagimit të administratës publike shqiptare ndaj tyre nuk janë në standartet e kërkuara.

Në këtë mënyrë Kuvendi i Shqipërisë do të ketë mundësinë të bëjë vërejtjet, propozimet dhe miratimet e duhura ligjore për problemet që do të parashtrohen në vijim, me qëllimin final që të përmirësohet sa më shpejt gjendja e Romëve në Republikën e Shqipërisë.

Mbrojtja e minoriteteve është cilësuar si një nga kriteret bazë për anëtarësimin në BE (kriteret e Kopenhagës). Nga këto kritere rrjedh vëmendja e veçantë ndaj Romëve. Përmbushja e këtyre kritereve për vendet candidate monitorohet nga Komisioni Europian. Qeveria shqiptare duke aspiruar për t'u anëtarësuar në BE, ka punuar për të përmbushur gjithë kriteret për anëtarësi në BE. Për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të pakicës Rome përveç kuadrit ligjor, i cili është i vlefshëm për të gjithë minoritetet, ajo hartoi në vitin 2003, siç thamë më lart, edhe një Strategji të veçantë, e cila parashikon marrjen e masave konkrete dhe ngritjen e strukturave përgjegjëse për zbatimin e saj me qëllim zbutjen e varfërisë, integrimin dhe përfshirjen e pakicës rome në jetën publike të vendit, si edhe ruajtjen e zhvillimin e vlerave kulturore dhe të identitetit të tyre etnik.

Avokati i Popullit është përpjekur që këto probleme dhe të tjera që hasen rëndom në këtë fushë të pasqyrohen në këtë Raport me vërtetësinë më të madhe, pasi çështja e trajtimit të Romëve është një nga temat më të ndjeshme edhe nga partnerët ndërkombëtarë sa herë që diskutohen kapacitetet institucionale të shtetit tonë për respektimin e të drejtave të njeriut.

## **2. Konstatimet e Institucionit të Avokatit të Popullit për gjendjen e Romëve.**

Jashtë vëmendjes dhe interesimit të Avokatit të Popullit, krahas shtresave të tjera në nevojë dhe të ekspozuara ndaj rreziqeve, si të miturit, te moshuarit, personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, nuk kanë mbetur edhe pjestarët e komunitetit rom. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se me rastin e botimit të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom në Shqipëri, në vitin 2004 Avokati i Popullit, së bashku me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, kanë shkruar se "...kjo strategji është jo vetëm një kontribut konkret, por edhe hap praktik dhe i nevojshëm drejt zbatimit të saj. Prezenca dhe Avokati i Popullit ndajnë mendimin se organet e qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të bëjnë përpjekje me të mëdha, si në drejtim të përqendrimit të punës ashtu edhe në caktimin e fondeve për të përmbushur detyrimet e parashikuara në Strategji. Gjendja e romëve në Shqipëri ka nevojë për përmirësime të thella, në mënyrë që ky komunitet të jetojë me dinjitet në një shoqëri demokratike."

Në institucionin tone nga viti 2000-2008 ka patur shumë pak ankesa nga romët. Mund të përmendim një ankesë të 4 familjeve rome në lagjen "5 Maj" të Elbasanit, për prishjen e banesave të ndërtruara pa leje, ose të disa banorëve nga komuniteti rom të lagjes "Skënderbeu" të qytetit të Lezhës. Kjo vjen kryesisht për shkak të mosnjohjes së statusit dhe të

veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Gjithsësi nga ana jonë ankesat e tyre janë trajtuar me precedencë.

Pozitiv është fakti se kanë rezultuar pak raste të ushtrimit të dhunës fizike apo psikologjike, për motive raciale ndaj anëtarëve të komunitetit rom nga struktura apo persona të veshur me pushtet publik, siç mund të kete qene rasti i çvendosjes nga policia të disa familjeve rome nga vëndbanimet e tyre te përkoheshme, për shkak të bllokimit te planit rregullues të territorit te nje zone prane lumit Lana në Tiranë.

Duke patur parasysh gjendjen e Romëve dhe shkaqet se përse ata shumë pak i janë drejtuar Avokatit të Popullit, në kuadrin e ushtrimit te detyrimeve të tij kushtetuese ne mbrojtje te drejtave, lirive dhe intresave te ligjshme te individeve, Avokati i Popullit, në muajin Qershor – Shtator 2009, ndërmoi nismën për organizimin e Ditëve të Hapura në të gjitha vëndet ku ka komunitete të rëndësishme rome. Gjatë gjithë periudhës 10 vjeçare të aktivitetit të institucionit tone, kontakte te tilla (Ditët e Hapura) kanë qenë në vijueshmëri, me një frekuencë disa ditore, të ndara për gjatë gjithë vitit. Por për komunitetin Rom ky ka qenë rasti i parë i organizimit të Ditëve të Hapura, i realizuar posaçërisht me një program të studjuar që më parë.

Qëllimi i ditëve të hapura ishte që, krahas marrjes së informacionit sa më të gjërë nëpërmjet ankesave te ditës, të bëhej edhe verifikimi nëpërmjet një pyetsori i problemeve dhe shqetësimeve që shoqerojnë Romët në jetën e tyre të përditshme. Pyetësori përmban çështje të tilla si verifikimi i kushteve të banimit, të higjenës dhe mjedisit ku banojnë, problemi i punësimit, mënyrat e sigurimit të të ardhurave familjare, marrëdhëniet me organet e pushtetit vendor dhe me pjesën tjetër të shoqërisë, nëse janë ndeshur me qëndrime abuzive dhe keqtrajtime nga strukturat e rendit, frekuentimi i kopshteve dhe shkollave nga fëmijët, probleme që lidhen me shëndetin, me trafikimin e fëmijeve apo vajzave, me mosregjistrimin e tyre ne regjistrat e gjëndjes civile, etj.

Fillimisht u be një pune parapërgatitore në bashkëpunim te ngushte me Shoqatën “Amaro drom”, me kryetar z Skender Veliaj dhe me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, qe konsistonte ne percaktimin e vendndodhjeve te këtij komuniteti, te personave përgjegjës per çdo vendbanim, të datave dhe të ambienteve ku do të bëheshin takimet me Romët etj.

Takimet e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit u bene në Prefekturën e Fierit, në Fier, Roskovec, Dëmenas, Levan, Qënder Fier, Grabian Savër, Çermë, Gramsh, Zhupan, Dushk, Frakull e Madhe, Drizë, Baltëz, Seman i Ri dhe Hoxharë;

Në Prefekturën e Beratit, në Ura Vajgurore, Kuçovë, Moravë dhe Otlak;

Ne Prefekturën e Durrësit, në ish NISH Tulla, ish Këneta, Sukth, Rrashbull, Katund i Ri dhe në Fushë Krujë;

Në Prefekturën Vlorë, në Vlorë, Novoselë, Shushicë, Delvinë;

Në Prefekturën e Gjirokastrës, në Gjirokastrë, lagja Zinxhiraj, dhe Ura e Lumit;

Në Prefekturën e Tiranës, në njesitë bashkiake nr.2, 5, 7, 11, Bregu i lumit, Paskuqan, Gosë dhe Kashar;

Në Prefekturën e Lezhës, në Lezhë, lagja “Skënderbej” dhe SMT;

Ne Prefekturën e Korçës, në Korçë, Pojan, Pogradec, Bilisht, Qëndër Bilisht dhe Progër;

Ne Prefekturën e Dibrës, në Komunën Qëndër-Tomin e në Shupenzë;

Në Prefekturën e Shkodrës, në Shkodër, Ura e Bunës, pas pikes se Shushicës, Vau i Dejës, Fushë-Arrës, Pukë;

Në Prefekturën e Kukësit, në Kukës dhe

Në Prefekturën e Elbasanit, në Elbasan dhe në Peqin.

Kujdes u tregua për mundësimin e grumbullimit të sa më shumë banorëve të komunitetit rom, duke zgjedhur një orar të përshtatshëm pas kohës së tyre të punës, kryesisht ai i tregtisë së vogël.

Si rrjedhojë u mblodhën 230 ankesa nga individë ose nga grupimet e romëve. Veç këtyre për 72 ankesa ose kërkesa ata u sqaruan ose u këshilluan në vend.

Përsa i takon problematikës së shqetësimeve të ngritura prej tyre, gjendja paraqitet si vijon:

### **2.1. Situata e përgjithshme ekonomike dhe sociale e komunitetit rom**

Gjendja e përgjithshme ekonomike dhe sociale e komunitetit rom në Shqipëri është shumë e vështirë. Nuk zbatohet parimi i barazisë, trajtimit të barabartë dhe dinjitoz të tyre në raport me grupime të ndryshme shoqërore. Shumica e këtyre familjeve jetojnë nën nivelin e varfërisë. Ky nivel jetese shoqërohet me diskriminim, me mungesën e të ardhurave të rregullta mujore, me papunësi, me mosfrekuentimin e shkollës, me mungesën e kushteve të strehimit, me shëndet jo të mirë dhe me shtimin e borxheve. Qytetarët Romë (me ngjyrë) vazhdojnë të përbëjnë grupimin shoqëror më të rrezikuar dhe të privuar nga shumë standarte bazë të një jetese normale. Ata përballen me kërcënime të ndryshme, tepër të vështira për t’u përballur. Komuniteti Rom jeton në kushte të vështira ekonomike dhe i ekspozuar ndaj shumë rreziqeve sociale. Shume familje romë ambientohen me mbijetesën, duke përjetuar nivelin minimal të varfërisë. Romët ndeshen me çështje të tilla, si varfëria, niveli i ulët arsimor dhe kulturor, papunësia, kushte të vështira jetese, mungesa e perfaqësimit dhe probleme të tjera sociale dhe

ekonomike. Problemi i tyre, në mënyrë të përmbledhur, është problemi i një komuniteti me nivelin më të ulët të jetesës në Shqipëri. Punësimi informal dhe i fragmentarizuar, mungesa e kushteve të higjienës kolektive, pa akses ndaj ujit të pishëm në masën deri 25% e tyre, mungesa e kolektoreve të ujrave të bardha dhe të zeza (përmëdim rastet në Savër të Lushnjës dhe në fshatin Moravë të Beratit), mos dhënia e shperblimit për shpronësimet e bera për interesa publike (7 ankesa vetëm në Levan të Fierit), mungesa e energjisë elektrike ose furnizimi me parametra teknike minimale, gjëndja e keqe e rrugëve, mungesa e vëmëndjes ose mosndërrhyrja në sistemim të tyre, standartet minimale të strehimit, mangesitë në personelin mjekësor, në objekte të trajtimit shëndetsor dhe në cilësinë e shërbimit, mos trajtimi me asistencë sociale, marrëdhëniet e vagëta me pushtetin vendor, mungesa e objekteve të arsimit parashkollor dhe atij të detyrueshem, shkalla e lartë e analfabetizimit, ekzistenca e një disnivele të dukshëm kulturor në krahasim me shumicën tjetër të popullsisë janë diferenca që nuk mund të neglizhohen dhe përbëjnë “grupën” e madhe që duhet mbushur. Ata mbeten debitorë të përhershëm ndaj KESH-it dhe Ndërmarrjeve të Ujesjellës-Kanalizimeve. Romët kanë norma të larta papunesie, mos-shkollimi dhe të pastrehësh. Komuniteti rom nuk ka mundur të ketë një grup njerëzish të arsimuar dhe të emancipuar në nivele të tilla që të bëhen liderë dhe promotor për zhvillimin e bashkësisë së tyre. Këto janë problemet dhe ankesat që i ndeshëm në të gjitha vënd-banimet e komunitetit rom gjatë Ditëve të Hapura. Kjo situatë përputhet edhe me konkluzionet e shumicës së monitoruesve apo të studimeve të veçanta që bëhen për gjëndjen e romëve.

## **2.2. Arsimimi për fëmijët romë**

Ekziston një legjislacion i plotë në fushën e arsimit, duke filluar nga arsimi parashkollor deri tek ai pasuniversitar, i cili garanton të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët për t’u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimimit. Në teresi, mbi 50% e komunitetit rom nuk di të shkruajë dhe të lexojë, sidomos vajzat dhe gratë romë. Shifrat e atyre që ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë, janë në minimumet e imagjinuara. Dëshira për të ndjekur shkollën, që ekziston në një pjesë të komunitetit rom, sfumohet për faktin se jetesa në periferi të qyteteve, niveli i mesimdhënis dhe edukimit në institucionet arsimore nuk është cilësor. Edhe mësimi i gjuhës së tyre amtare ndeshet me vështirësi nga mungesa e shkollave romë.

Mungesa e infrastruktures arsimore, e teksteve shkollore në gjuhën amtare, e abetareve dy gjyhëshe, e plan programeve dhe e cilesise se dobet gjatë procesit mesimor janë disa nga problemet, me të cilat perballen fëmijët romë. Fëmijët romë përbëjnë kontingjentin më të madh

të të miturve që kanë mbetur jashtë shkollës, duke u shndërruar në furnizuesin kryesor të armatës së analfabetëve. Në nivele të larta është edhe braktisja e shkollës. Fëmijëve romë ju mungojnë shëmbujt pozitive që t'u tregojnë sesi dhe pse arsimimi i tyre sjell frute. Familja romë, për shume shkaqe, kryesisht ekonomike, nuk ka ndërgjegjesimin për nevojat, të drejtat dhe mundësitë reale të fëmijëve të tyre. Shoqatat romë, bëjnë të ditur faktin se 50 % e fëmijëve të këtij komuniteti mbeten analfabetë, pasi nuk e frekuentojnë arsimin e detyruar. Duke përmendur këto shifra alarmante, Skënder Veliaj, drejtor ekzekutiv i Unionit të Romëve u referohet të dhënave të një studimi të kryer nga disa organizata joqeveritare si UNICEF dhe "Save the Children", në bashkëpunim me Unionin e Romëve të Shqipërisë "Amaro Drom". Në këtë studim janë marrë në pyetje 4300 fëmijë romë. Pas anketimit të kryer, ka rezultuar se më shumë se gjysma e tyre nuk e ndjekin shkollën dhe kanë mbetur analfabetë, ndonëse në moshë jo të vogla. Shkaqet për një situatë të tillë janë nga më të ndryshmet, por si ndër më kryesoret paraqiten pamundësitë ekonomike të familjeve romë. Një tjetër faktor i ndjeshëm në këtë drejtim konsiderohet edhe përjashtimi, si dhe indiferenca e shoqërisë shqiptare ndaj këtij komuniteti. Duke marrë në konsideratë këtë, në fakt shifra e mosfrekuentimit të tyre në institucionet shkollore është akoma më e madhe, sesa ajo që deklarohet. Fëmijet romë ndjejnë me shume se fëmijet e tjere nevojën për t'u arsimuar, argetuar dhe edukuar në mënyrë të organizuar. Por të detyruar, i janë pershtatur asaj mënyrë jetese që askush nuk do ta dëshironte ta kishte pa mbarim. Problemet e moshës së tyre nuk janë të njëjta me ato të prindërve të tyre. Në mentalitetin e një pjese të familjeve romë ekziston koncepti, se koha dhe shpenzimet për arsimim, nuk e justifikojnë veten për mungesën dhe diskriminimin në tregun e punës. Në shkollë fëmijet romë nuk e ndiejnë veten të barabartë me shoket e tyre në klase. Kjo, edhe në sajë të një diskriminimi të heshtur në disa raste nga vetë arsimtarët. Nuk ka mësues nga komuniteti romë. Sipas të dhënave të shoqatës "Amaro Drom", në Levan të rrethit Fier, me rreth 3.500 banorë romë, në vitin shkollor 2008-2009, ishin regjistruar në shkollë afërsisht 100 fëmijë. Por për shkak të keqtrajtimit, të qëndrimeve përbuzëse dhe diskriminuese, në disa raste edhe nga arsimtarët, me kalimin e muajve filloi braktisja e mësimëve. Përpjekjet për të kërkuar të drejtën për arsimim në kushte të njëjta me shumicën, nuk gjejnë gjithnjë mirkuptim dhe vullnet. Shpesh janë vetë fëmijet që transmetojnë paragjykimet e ambienteve të tyre familjare tek shoket e klases me prejardhje etno gjuhësore tjeter. Shkaqet e mungesës së suksesit dhe papershtatshmerisë në edukimin e fëmijëve romë, janë pasojat negative të paragjykimëve që ekzistojnë prej kohësh. Ngritja e disa qendrave ditore për fëmijet e rrugëve, ku ata romë janë në shumicë, duhet parë pozitivisht për sa i takon efikasitetin konkret. Por veçanërisht u



duhet shtuar vëmendje edhe abuzimeve me ta, siç edhe ka ndodhur me Qendrën që e drejtonin disa pedofilë anglezë, të cilët po gjykohen aktualisht. Rol negativ luan tradita në menyren e tyre të veçante të jetesës, ku femijet trajtohen si mundësi potenciale për të siguruar disa të ardhura, kryesisht nepermjet rruges. Megjithatë, sipas prindërve, shkaqet kryesore për mos arsimin e femijeve, janë përparesia e sigurimit të mjeteve të jetesës, ku femijet kanë rol, shpesh përsor, infrastruktura e dobët e transportit, pamundësia e mesimit në shtëpi për shkak të mungesës së kushteve të banimit, sepse shpesh mungon edhe energjia elektrike, si dhe mungesa e shkollave pranë qendrave të tyre të banimit. Edhe në komunitetet romë në fshatin Moravë të Komunës Otllak të Beratit dhe në atë të qytetit të Fushe Krujes, ku janë ngritur dy mini-shkolla fillore me donacione të huaja, sipas vete prindërve, mungojnë shumë gjera të nevojshme që të paktën fëmijët të mësojnë shkrimin dhe leximin në gjuhën shqipe. U konstatua, atje se shoqata “Gruaja beratase në zhvillim” kishte ngritur një qender, ku femijeve ju kishin krijuar kushte për të marrë pjesë në kurse për muzikë, pikturë dhe për zbatimje.

Problem madhor, urgjent dhe shqetësues mbetet punësimi i fëmijëve romë, që janë ndër më të preferuarit nga punëdhënësit private, për shkak të abuzimit me pagesën e ulët. Romët e mitur i sheh neper semaforë si larës makinash, në lavazhe apo si shitës cigaresh e artikujsh të tjerë ose duke lypur në rrugë, ura dhe kryqëzime. Në Tiranë mund të numurohen rreth 1.000 të tillë. Nga ana e saj policia mbetet pasive ndaj kësaj dukurie, për mungesë të akteve ligjore. Ata përdoren si burim fitimi neper rrugë dhe tregje, duke i privuar nga liria e të gëzuarit të feminise. Në muajt e verës një pjesë emigron në Greqi për punësim sezonal. Në keto rrethana, fëmijët romë janë edhe më të pambrojturit ndaj trafikimit. Një vëzhgim i bërë nga Instituti për Studime Bashkëkohore, konfirmon se 40% e familjeve romë, ju kërkojnë dhe i detyrojnë fëmijët të punojnë. Ndaj familjeve që abuzojnë, keqtrajtojnë apo janë indiferente ndaj interesave të femijeve gjatë moshës shkollore, nuk ka asnjë kontroll apo trysni për forcimin e përgjegjësive prindërore. Megjithatë legjislacioni ynë nuk lejon punësimin nën moshën 14 vjeç dhe rregullon sasinë dhe llojin e punës që mund të kryhet nga fëmijët nën moshën 18 vjeç, nuk ka kontroll dhe qendrim të forta nga Inspektoriati i Punës, që verifikon vetëm sektorin formal të punës, nderkohe që femijet romë janë “punësuar” në atë informal.

### **2.3. Pushteti vendor dhe administrata publike në raportet e saj me Komunitetin e Romëve.**

Romët ballafaqohen rrallë me veprimtarinë administrative të organeve vendore shtetërore megjithatë këto organe kanë përgjegjësinë kryesore për gjendjen e tyre. Kjo vjen sepse informimi i romëve mbi

politikat shtetërore, mbi proceset vendim-marrese, për rendin, etj, ka mangësira të mëdha. Komuniteti nuk është i orientuar sa duhet për ku duhet drejtuar për të kërkuar zgjidhjen e shqetësimeve të përditshme. Komuniteti rom shfaq mendim negativ për punën e organeve të qeverisjes vendore, duke i vlerësuar në disa aspekte, si të korruptuara. Nga ana tjetër, një pjesë e administratës publike, për shkak paragjykimesh, i anashkallon problemin që kalon në vazhdimësi komuniteti rom.

**2.3.a.** Problem më i madh, por edhe përparësi për shtetin, për organet e qeverisjes vendore, përben mungesa e tërësive të dhënave personale, familjare dhe përberësive të tjera të gjendjes civile, të një pjesë të madhe të komunitetit rom. Ky realitet është i patolerueshëm për pasojat shumë të rënda juridike me të cilat shoqërohet. Në evidencë vetëm 29 ankesa, por mosdeklarimi dhe mosregjistrimi i vendbanimit, i lindjeve, i vdekjeve, i martesave apo i divorceve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjeve Civile, ka çuar në mos trajtimin e mos përfitimit nga skemat dhe politikat e ndihmave ekonomike, të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nga përfitimi i pasurive të palujtshme, nga e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, e nga shumë të drejta të tjera që i gëzojnë pjesa tjetër e popullsisë. Ka patur ankesa konkrete edhe për mosmarrjen e shpërblimit prej 5 mijë lekësh sipas Ligjit, për regjistrimin brenda afatit të parashikur të lindjeve. Ndryshimet e herëp herë pozitive, me qëllim për të ndihmuar edhe lehtësuar kushtet dhe kriteret e kërkesave të Ligjit "Për gjendjen civile", për komunitetin rom të ekspozuar ndaj rrezikut të trafikimit, nuk kanë sjellë pasojat e shpresuara. Mungesa e të kuptuarit të proceseve ligjore, mosnjohja e ligjeve, shoqëruar me mos kerkimin e ndihmës juridike e vështirësojnë më tej jetesën e tyre.

Pajisja e komunitetit rom me kartat e reja të identitetit dhe me pasaportat biometrike, gjatë dhe pas fushatës të zgjedhjeve parlamentare të këtij viti, thuajse është në parametra të papërfillshme. Pasojat janë dhe do të jenë të mëdha në nivelin e të gjitha fushave të jetesës së tyre, nëse nuk veprohet me forma dhe stimulime të ndryshme për t'i pajisur të gjithë Romët me kartat e identitetit.

**2.3.b.** Edhe në fushën e shërbimeve në favor të romëve ekziston gjendje e rëndë. Komunat dhe bashkitë i ofrojnë komunitetit rom shumë pak shërbime, kryesisht furnizimin pjesërisht me ujë dhe energji elektrike. Kjo infrastrukture, e shërbimeve publike për të cilën u evidencuan 27 ankesa është shumë e dobët në zonat e vendbanimeve të komuniteteve të mëdha romë. Ka mungesa të mëdha në vendbanimet e tyre, si të ndriçimit publik, të mungesës të kanalizimeve të shkarkimeve të ujrave të zeza si dhe të rrugëve publike për të garantuar lëvizjen e lirë. Vendbanimet e komunitetit rom, në shumë raste, nuk lidhen me rrugët nacionale.

Shendetësia është një nga fushat ku ky komunitet thuhet se nuk përfiton, duke rritur jo vetëm nivelin e varfërisë, por sjell pasoja të rënda për cilësinë e jetës dhe jetë gjatësinë e tyre. Kjo e fundit ka tendencë ulje të mëtejshme, kur merr në konsideratë mungesën e theksuar të higjienës dhe të ujit, kushtet e këqija të jetesës, ushqimin e keq dhe vendbanimin, në shumë raste, pranë vend-depozitimit të mbetjeve urbane. Përfituesit e sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe ndihmave sociale janë në minimum. Kjo për shkak të padijes së legjislacionit përkatës, të punësimit në të zezë, të mos regjistrimit në regjistrat themeltare të shtetasve, të mos perballimit të pagimit vullnetar të siguracioneve, të ndryshimit të vëndbanimeve dhe të mungesës së dokumentacionit. Nuk ka statistika për numrin e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet, të përfitimit nga fushatat e vaksinimit të detyrueshem dhe falas (ku mendohet se vërtitet rreth 40%). Në vendbanimet e tyre të njohura mungojnë klinikat e shërbimit shëndetsor, përfshi ato stomatologjik dhe të nënës dhe fëmijës, nuk ka projekte dhe financime për punët publike, për përmirësimin e infrastrukturës në këto vëndbanime, etj. Komuniteti shfrytëzon shërbimin shëndetsor, postar, etj. të komunave, bashkive dhe të zonave të afërta, për aq sa mundet. Përsa i takon përfitimit nga perkujdesja sociale, u evidentuan 67 ankesa. Ato janë për të siguruar shërbime për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara fizike, ku përfshihet edhe akomodimi në qendrat rezidenciale, të cilat thuhet se nuk funksionojnë për romët. Midis tyre ka shumë persona që mund të klasifikohen si persona me aftësi të kufizuara fizike, por që faktikisht nuk përfitojnë nga këto skema.

Në nivele mjerane janë edhe përfitimet e komunitetit rom nga shërbimet që ofrohen për organet e drejtësisë. Janë shumë të pakta rastet, kur ata i adresohen zyrtarëve apo avokatëve, për kryerje të transaksioneve, për marrjen e ndihmës juridike apo për t'u përfaqësuar në procedime gjyqësore dhe administrative. Akoma më rallë ju drejtohen ata gjykatave të shkallës së parë për shqyrtimin e çështjeve civile, familjare, administrative apo tregtare; ose organit të prokurorisë, me denoncime për kryerjen e veprave penale ndaj shëndetit, jetës, pronës apo nderit të tyre etj. Gjithsesi u evidentuan 9 ankesa për prokurorinë dhe policinë e shtetit. Pengesat janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga pamundësia financiare e deri tek mos njohja e ligjit dhe e të drejtave të tyre. Në shumë raste, konfliktet i zgjidhin me vetë gjyqësi, duke rënduar shpesh pozitën e tyre juridike. Mos njohja e legjislacionit civil apo penal dhe të pasojave reale që rrjedhin nga shkelja e tyre, i bën shumë të ekspozur në kryerjen e veprimeve të paligjshme, përfshirë edhe ato pa dashje dhe në bashkëpunim.

**2.3.c.** Niveli i papunësisë në rradhët e Romëve është tepër i lartë, disa here mbi shifrat zyrtare në vend. U evidentuan 33 ankesa për punësim por kjo nuk do të thotë se ishin vetëm 33 Romë të papunë, nga

numri prej disa qindrash që ne takuam gjatë Ditëve të Hapura. Mbyllja e shumë aktiviteteve publike, si të ndërmarjeve artistike, të riparim-sherbimeve, të ndermarjeve komunale apo të mirëmbajtjes së banesave shtetërore, etj, pas viteve 90', ku ishte punësuar një pjesë e mirë e komuniteteve romë, u shoqërua me rritje të ndjeshme të papunësisë së tyre. Mungesa e kualifikimit dhe e arsimimit, aktualisht ndikojnë shumë në pamundësinë e futjes së tyre në tregun e punës. Shumë prej tyre janë të vetëpunësuar në sektorin informal, në punë të rastësishme, kryesisht në tregtimin e mallrave të përdorura. Por kjo veprimtari nuk ka të ardhura të mëdha dhe të qëndrueshme. Ankesat për punësim nga meshkujt janë më të pakta. E kundërta është me gratë. Tek ato ka një dëshirë të madhe për t'u punësuar. Por politikat dhe projektet e punësimit nuk kanë patur efikasitet në tregun e punës. Vëndet e reja të punës për romët kanë qenë shumë të pakta. Ka munguar asistencë e veçantë për trajnim dhe punësim të antarëve të komunitetit rom.

**2.3.d.** Strehimi ka qenë dhe mbetet një problem tjetër i madh për Romët. Ndonjëse u evidentuan 31 ankesa për strehim, ankesa të këtij lloji mund të evidentohen me dhjetra në çdo qendër ku ata banojnë. Në kontrast me pjesën tjetër të popullsisë, ku këto kushte, për shumë shkaqe (kujtojmë privatizimin e banesave shtetërore që kanë në përdorim), kanë njohur rritje shumë më cilësore se më parë, gjendja e familjeve romë lë shumë për të dëshiruar. Ky komunitet banon në periferi të qyteteve, në banesa të improvizuara apo të krijuara me mjete të lehta ndertimi, kryesisht plastike, çadra dhe llamarinë. Ndonjë rast shumë i rallë është trajtuar si i pastrehë nga këshillat komunale dhe bashkiake. Për një pjesë të tyre, shpenzimet procedurale për të plotësuar dokumentacionin si të pastrehe, janë të kushtueshme, fakt që ka bërë që aplikimet e tyre për strehim të jenë të pakta zyrtarisht. Nuk ekzistojnë evidencë të nevojave për strehim, nuk ka parashikime për dhenie të trojeve për ndërtime individuale. Është interesant fakti, se janë shumë të ralla rastet kur romët kanë zënë dhe pushtuar trojet private për ndërtime informale. Ndërtimet e reja i kanë bërë vetëm në troje shtetërore, dhe kjo ju ka sjellë edhe probleme me pushtetin vendor. Zbutja e problemit të strehimit shprehet te kryhet me alokimin e fondeve për banesa të veçanta për romët, si dhe me inkurajimin e tyre për të kontribuar me punë në ndërtimin e banesave publike, në pronësi të komunave apo bashkive.

**2.3.e.** Gruaja romë është e diskriminuar brenda dhe jashtë familjes, si grua dhe si romë, si dhe e ekspozuar ndaj fenomeneve të keqtrajtimit, trafikimit, prostitucionit, abuzimeve seksuale si dhe ndaj pasojave negative të divorceve. Në rradhët e tyre ekziston edhe shitja e trafikimi i të porsalindurve. Sipas statistikave, në Tiranë, rreth 33% të punonjëseve ilegale të seksit, janë nga komuniteti rom. Planifikimi familjar, rregullat e mbrojtjes së shëndetit të nënës dhe fëmijës dhe ndërgjegjësimi për rolin e

tyre në familje, nuk njihen nga gratë rome. Tre të katërtat e tyre nuk e mbarojnë arsimin fillor. Martesat në mosha të mitura 13-14 vjeçare, sipas traditës, kur akoma nuk kanë pjekurinë për të kuptuar aktin dhe marrjen e përgjegjësisë si nëna, mos njohja e pasojave serioze që ju vinë grave nga abortet e paasistuar, janë disa nga dukuritë më të pranishme në realitetin rom. Shumë prej tyre i sigurojnë mjetet për rritjen e fëmijëve nga shitja e gjakut. Asistenca, e parashikuar, për dhënien e medikamenteve dhe e ndihmës mjeksore falas për familjet e varfëra dhe me shumë fëmijë, nuk rezulton të jetë zbatuar. Integrimi i grave Rome në tregun e punës do të përmirësonte statusin e tyre social dhe financiar.

#### **2.4. Perfaqesimi i Romëve në organet e pushtetit**

Komuniteti rom nuk di ku dhe si të kerkojë integrimin e tij në mjedisin shoqëror, edhe nga mungesa e perfaqësimit. Nuk ka të dhëna zyrtare për shkallën e pjemarrjes të komunitetit rom në organet vendimmarrëse administrative publike, në shërbimin civil, në entet publike të niveleve të ndryshme të shtetit dhe administratës publike. Sipas verifikimeve të bëra në Ditët e Hapura, konkludohet se romët nuk kanë asnjë përfaqësues në këshillat e komunave, bashkive apo qarqeve. Megjithatë ekzistencën e mekanizmave ligjore, ata e ndjejnë veten të përjashtuar nga pjesëmarrja në vendimmarrje mbi aspekte të rëndësishme që influencojnë në menyrën e organizimit të jetesës së tyre. Edhe marrëdhëniet e tyre me partitë politike janë të ngjira. Shumica e komunitetit Rom në fakt nuk kanë besim tek faktori politik. Asnjë rom nuk është emëruar në nivelet e larta të strukturave shtetërore apo zgjedhur deputet në Kuvend në të gjitha legjislacionet pas vitit 1990 deri sot. Në fushatën e fundit elektorale, një pjesë e partive politike, renditën në listat e tyre emërore për deputetë, disa figura nga më përfaqësueset, e komunitetit rom, përfshirë edhe gra. Por renditja e tyre në vendet e fundit të listave zbulon se ajo vllente vetëm për afrimin e tyre tek kutia e votimit, dhe realisht mungonte qëllimi i mirë për të futur realisht në sallën e Parlamentit ndonjë rom. Shpresojmë të mbetet një nga opsionet prioritare për në zgjedhjet e ardhshme për organet e pushtetit vendor perfaqesimi i tyre në to, për t'i realizuar idetë e partneritetit në baza barazie. Në mekanizmat mbrojtës ligjorë dhe në përmirësimet e pritshme të Kodit Zgjedhor ka vend për rishikime dhe trajtime më taksative, për kthimin e vëmendjes së partive politike edhe nga komunitetet etno-gjuhesore.

#### **2.5. Mediat vizive dhe të shkruara.**

Pa mohuar rolin e deritanishëm jashtëzakonisht të madh të mediave në pasqyrimin e realitetit të shoqërisë shqiptare, perseri ka shume për të bërë që t'u lenë hapësira më të mëdha mediatike problemeve të Romëve. Veçanërisht të inkurajohet ngritja e përgjegjësisë, si në fushën autovizive, ashtu edhe në shtypin e shkruar, për përgjegjësinë e veçantë që Mediat

mbajnë për të mos transmetuar paragjykime, ndjenja, mendësi të padrejta dhe të paarsyeshme. Nga përfaqësuesit e Romëve është kërkuar që Radio Televizioni Publik Shqiptar të transmetojë programe të veçanta, disa orë në javë me lajme në gjuhën Rome si dhe aktivitete të tyre. Kjo kërkesë gjykohet me vend nga ana jonë.

## **2.6. Shoqatat e komunitetit Rom dhe organizatat jo fitimprurëse që punojnë me Romët.**

Shoqatat që përfaqësojnë komunitetin rom në Shqipëri, megjithë punën që bëjnë, janë të copëzuara dhe të paafta që të mbrojnë siç duhet të drejtat dhe interesat e anetareve të tyre. Sot, numri i shoqatave që përfaqësojnë komunitetin rom në nivel kombëtar, është i zgjeruar, por veçohen katër të tilla, si “Bashkimi Demokratik i Romëve në Shqipëri”, “Grupi për Zhvillimin e Kulturës Rome”, “Romano Baxt” dhe “Amaro Drom”. Kjo e fundi ka një bërthamë qendrore në Tiranë dhe zhvillon veprimtari të mbështetura nga disa qendra koordinuese në Fushë Krujë, Lushnjë, Fier, Berat, Kuçovë dhe Korçë. Shoqata ka gjithashtu Forumin e Rinisë dhe një buletin mujor, “Ylli i Karvanit”. U zhvillua festivali i Fëmijëve të Pakicave Kombëtare, si “Pellumbi i Bardhë” ku u përfaqësuan edhe grupet artistike të fëmijëve nga të gjitha pakicat kombëtare dhe gjuhësore. Këto shoqata rol të madh luajnë edhe në ruajtjen e gjuhës, folklorit të pasur dhe artit të muzikës. Amaro Drom ka krijuar një sërë grupesh me instrumentiste, këngëtarë dhe valltarë. Ka aktivizuar edhe një ekip futbollit, që ka marrë pjesë në shumë veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. Veprimtari të ngjashme zhvillon edhe shoqata “Amaro Divas”, e cila ka grupin artistik dhe ka hapur një kurs për mesimin e instrumentave muzikore. Edhe kjo shoqatë boton një buletin mujor me të njëjtin emër.

Komuniteti Rom mbart në vetvete dhe reflekton edhe shumë vlera. Nga gjiri i tyre kanë dalë muzikantë shumë të mirë apo biznesmenë të suksesshëm. Komuniteti Rom po ndërgjegjësohet gjithnjë e më shumë për të kërkuar në mënyrë qytetare të drejtat për t’u trajtuar dhe për të gëzuar të gjithë të drejtat dhe liritë kushtetuese, si pjesa tjetër e shoqërisë. Ka emigracion të shumë familjeve dhe individëve romë, kryesisht në Europë. Por nga Romët kërkohen stimulime nga shteti dhe perkrahje financiare për shpeshimin e kontakteve dhe forcimit të lidhjeve kulturore midis komunitetit rom në Shqipëri, me si vëllezerit e tyre në mbarë hapësirën Europiane.

Një rol të veçantë në procesin e shpejtimit të integritetit të komuniteteve etniko gjuhësore në shoqëri, kanë edhe organizatat jo fitimprurëse që punojnë për Romët. Forcimi i kapaciteteve të brëndshme në nivelin organizativ, advokues, zhvillimi i standarteve vetërregulluese, monitorues dhe lobues ndikojnë në hartimin e politikave me synim

përmirësimin e gjëndjes së cilësisë së jetës. Qëllimi kryesor i projekteve të fundit, është të ndihmojë në zhvillimin e fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri, duke siguruar krijimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare, shoqatave profesionale dhe krijimin e mekanizmave që nxisin dhe sigurojnë rritjen e transparencës dhe përmirësimin të imazhit të tyre publik. Problem mbetet kontrolli mbi transparencën e investimeve, donacioneve dhe fondeve të konsiderueshme financiare të akorduara për Romët që të materializohen në përmirësimin e jetesës për grupimin për të cilat ato janë destinuar.

### **3. Përfundime dhe Rekomandime**

Pavarësisht vështirësive dhe sfidave me të cilat përballet shoqëria shqiptare, të cilat janë pjesë e procesit të zhvillimit dhe të përpjekjeve për t'u bërë partnere dinjitoze në strukturat europiane, vlen të theksohet fakti i konstatuar dhe i njohur nga të gjithë aktorët në vënd dhe nga organizmat ndërkombëtare, se përsa i takon frymës së tolerancës, bashkëjetesës paqësore, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të shqiptarëve me personat që u përkasin minoriteteve që jetojnë në vëndin tonë, Shqipëria mund të shërbejë si model për rajonin. Secila nga pakicat, gjatë kësaj bashkëjetese në vite, ka demonstruar origjinalitetin e vet, që është ruajtur dhe trashëguar. Por kjo nuk duhet të behet shkak për të mbuluar shfaqjet e veçanta apo të pakta të racizmit apo diskriminimit të shoqërisë shqiptare ndaj Romëve.

Ne përfundim të prezantimit të një sere çështjesh që shqetësojnë sot Romët në vëndin tonë, Avokati i Popullit ndjen nevojën të parashtrijë në këtë pjesë të fundit të Raportit disa përfundime dhe rekomandime, të cilat shpresojmë që do t'i shërbejnë Kuvendit të Shqipërisë në analizën dhe reagimet e tij për përmirësimin e një sërë aspektesh të kësaj gjëndje. Institucioni ynë ka arritur në këto përfundime:

**3.1.** Komuniteti rom është pak a shumë i paragjykuar nga shoqëria shqiptare. Ndërgjegjesimi i Shtetit dhe i shoqërisë shqiptare ndaj realitetit rom, nuk është në parametrat e një shoqërie integruese. Ekziston mentaliteti që vështirësitë e jetesës së këtij komuniteti t'i paraqesin si çështje mentaliteti dhe kulture të vetë komunitetit rom. Këto paragjykime e anashkalojnë diskriminimin social ndaj tyre. Pjesëtarët e këtij komuniteti kategorizohen në shumicën e rasteve, si romë, me një konotacion negativ.

**3.2.** Vetëm ekzistenca e korpusit të të drejtave dhe lirive kushtetuese të njeriut, e parimit të mosdiskriminimit apo e disa strukturave shtetërore të cilave deri tani nuk ju duken rezultatet e legjitimitetit të ekzistencës së tyre, nuk janë të mjaftueshme për të mbrojtur dhe ruajtur identitetin dhe veçoritë e grupimeve etno-gjuhësore. Ndërkohë që legjislativi shqiptar dhe praktika e gjykatave shqiptare

duhet të plotësohet edhe me qëndrimet e Gjykatës të të Drejtave të Njeriut, që të parandalojë dhe të dënojë çdo lloj diskriminimi direkt ose indirekt që mund të bëhet ndaj çdo individi, qoftë edhe Rom. Shteti ka për detyrë të marre “masa pozitive”, jo vetëm për të siguruar në të gjitha fushat ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, një barazi të plote dhe efektive ndërmjet personave që i përkasin një minoriteti dhe atyre që i përkasin shumicës, por gjithashtu për t’ju krijuar mundësinë të pareve për të zhvilluar identitetin e tyre. Mbi këtë bazë, Romëve duhet t’iu njihen të drejta specifike pa i konsideruar këto si masa diskriminuese kundrejt shumicës.

**3.3.** Megjithë se kemi një legjislacion të brendshëm të standarteve nga më të lartat, kemi aderuar në shumë Konventa dhe Marrëveshje Ndërkombëtare apo kemi ndërtuar edhe një Strategji Kombëtare për Romët, zbatimi i tyre lë shumë për të dëshiruar. Komuniteti Rom, i vendosur prej shekujsh në vendin tonë, nuk po gjen një habitat normal bashkëjetese me shumicën tjetër të popullsisë, për shkak të ekzistencës së mentalitetit dhe paragjytimeve, fakt që ka ndikuar në një farë vetizolimi. Komuniteti Rom përballë me probleme të përditshme dhe të shumta, që fillojnë dhe që lidhen ngushtë me pamundësinë e punësimit, dhe deri me pamundësinë ose masën e papërfillshme të përfitimit nga shërbimet publike.

**3.4.** Mbrojtja e të drejtave të minoritetit Rom dhe integrimi i tyre në shoqëri, në sajë të Strategjisë dhe të Planit Kombëtar të Veprimit, nga pikëpamja formale, është futur në një stad tjetër përse i përket programimit dhe përbën një nga sfidat e Shtetit shqiptar, dhe të institucioneve të tij si dhe të aktorëve të tjerë që janë vetë Minoriteti Rom, shoqëria civile dhe sektori privat. Problem të veçantë përbën fakti, se sa dhe si do të njihet komuniteti Rom me këtë Strategji dhe Planin e Veprimit. Njohja e saj përbën domosdoshmëri dhe premise për ndërgjegjësimin e komunitetit për kërkimin e të drejtave të tyre konkrete, për të mundësuar faktin që vete Strategjia dhe Plani të konvertohen dhe materializohen në jetën e përditshme. Ky proces, nga sa kemi konstatuar si Institucion, thuajse nuk njihet nga Romët. Personat më të shumtë që rezultojnë të kenë dijeni, janë ata që kanë kontribuar në përgatitjen e Strategjisë për Romët dhe të Planit Kombëtar të Veprimit për Romët.

**3.5.** Plani Kombëtar 2010-2015 ka parashtruar para Qeverisë Shqiptare kërkesa për veprime dhe financime për krijimin e kushteve më të mira për këtë kategori qytetarësh. Kërkohen masa konkrete për përmirësimin e kushteve të jetesës së Romëve, hartimi i një buxheti të nevojshëm dhe të mjaftueshëm vjetor, rritjen e nivelit të qytetarisë nëpërmjet edukimit, ngritjes së strukturave përgjegjëse, në përpjekjet për arsimimin e fëmijëve romë, e shumë nisma të tjera.



**3.6.** Investigimi i gjendjes reale social ekonomike, kulturore, arsimore dhe institucionale te romëve dhe ofrimi i këtyre të dhënave organeve shtetërore duhet shoqëruar me saktësimin sa me shpejt te statistikave mbi numrin e përgjithshëm të komunitetit rom ne vendin tonë, mbi përqendrimet dhe vendbanimet e përhershme, të dhënat mbi nivelin arsimor, mbi shkallën e punësimit ne punët publike apo ato private, mbi aftësimin profesional, mbi gjendjen e strehimit, e shume te dhëna te tjera, që janë baza mbi të cilën ndërtohen politikat shtetërore.

**3.7.** Arsimimi i komunitetit rom dhe punësimi i tyre, duhet pare nga Qeveria, jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat me efikase për integrimin e tyre te plote ne shoqëri. Pa ndërhyrje energjike ne këto dy fusha prioritare për daljen e komunitetit rom nga gjendja ku ndodhet, nuk mund të flitet për pjesëmarrjen e barabartë, ne kuptimin e plote te fjalës, në një shoqëri të hapur dhe ne përputhje me qëndrimet e Gjykatës të të Drejtave të Njeriut, që kërkojnë parandalimin dhe dënimin e çdo lloj diskriminimi direkt ose indirekt që mund të bëhet ndaj çdo individi.

**3.8.** Fëmijët romë përbejnë shtresën me të rrezikuar nga përjashtimi social, nga liria dhe të gëzuarit e fëminisë, janë të keqtrajtuar brenda komunitetit dhe jashtë tij, duke qenë kështu një gjeneratë e pasigurtë. Niveli shumë i ulët familjar i kulturës dhe arsimimit, për arsye mentaliteti, varfërie, diskriminimi apo përjashtimi, nuk i ka lejuar te hedhin hapa drejt civilizimit dhe te bëhen pjese integrale e shoqërisë shqiptare.

**3.9.** Mund të ndërmerren fushata sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi për kurse te gjuhës shqipe, hapje kursesh te ndryshme kualifikimi dhe trajnimi profesional për rritjen e mundësive të punësimit, shtrirja e rrjetit të shërbimeve ne vendbanimet e romëve, akses ne informacion, saktësime dhe nisma në politik-bërje, përmirësimi i mjedisit formal te biznesit dhe te investimeve, ngritja e qendrave kulturore për te rinjtë, kurse për përdorimin e veglave muzikore, konferenca me karakter etnografik, folklorik apo e traditave. Duhet punuar për të nxjerrë në dukje vlerat e veçanta kulturore që mbart komuniteti rom Po ashtu, mund të bëhen sponsorizime nga OJF për takime sportive dhe muzikore, për ekspozimin e krijimeve artizanale, te veglave te punës dhe të traditës, për botime librash me autor të rinj romë, mundësinë e botimit te një gazete apo reviste, vendosja e emrit të një njeriu të nderuar rom, një rruge ose objekti në brendësi të vendbanimit të komunitetit. Këto dhe të tjera nisma, në dukje si të vogla, janë domethënëse, ato rizgjojnë ndjenjat e krenarisë etnike dhe përcjellin mesazhin e të qenit si gjithë të tjerët në objektivin e trajtimit dhe të vëmendjes të shtetit dhe të shoqërisë.

**3.10.** Kryesorja mbetet gjendja e burimeve te duhura financiare për shpejtimin e zbatimit te Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e

kushteve te jetesës se minoritetit rom” dhe të Planit të Veprimit ne Shqipëri. Deri tani, praktika e bërjes diçka ne ndihme te komunitetit rom, me buxhetin e organeve te qeverisjes vendore apo donacionet, nuk ka patur efikasitet.

Nisur nga kjo gjendje Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon:

1) Ky Raport të shqyrtohet në një nga mënyrat që përcakton neni 27 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, sipas vlerësimit që do të bëjë kryetarja e Kuvendit.

2) Në një kohe te përshtatshme, një grup deputetesh se bashku me Avokatin e Popullit, mund te vizitojnë disa nga Komunitat dhe Qendrat Komunitare të Romëve për te pare nga afër respektimin e te drejtave te tyre.

3) Mbledhja që do të bëhet për të analizuar këtë Raport t’u kërkojë Ministrive përkatëse qe te japin shpjegime për shkeljet e konstatuara ne këtë Raport dhe për masat që do të marrin për shpejtimin e realizimit të Planit të Veprimit për Romët.

4) Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet Komisioneve të përhershme parlamentare të mbajë në një vëmendje afatgjatë problematikat e ngritura dhe në mënyrë periodike të kërkojë nga ministritë e linjës informacione për realizimin e Planit Kombëtar të Veprimit gjatë Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2010-2015.

\*

\* \*

Avokati i Popullit nënvizon se zgjidhjet e këtyre problemeve të Romëve nuk janë as te lehta, as te shpejta, por jo të pamundura. Ato janë pjesë integrale, të lidhura pazgjidhshmërisht me zhvillimin tërësor të Shqipërisë edhe me forcimin e vazhdueshëm të ekonomisë.

Është detyrim i gjithë shoqërisë shqiptare për t’u emancipuar dhe për te bere edhe një hap në drejtim të civilizimit. Demokracia, mbi të gjitha prezumon mbrojtjen e pakicës. Respektimi i të drejtave të personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe etnike-gjuhësore, si pjesë e të drejtave humane të njohura universalisht, është një faktor i rëndësishëm për paqen, drejtësinë, stabilitetin dhe demokracinë.

## 5. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese

Kërkesa e paraqitur më datën 23.06.2009 me objekt:

1. Shfuqizimin si antikushtetues të paragrafëve të dytë dhe të tretë, të nenit 10, të Ligjit nr.7843, dt. 13. 07. 1994 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me ndryshimet e bëra.

2. Shfuqizimin si antikushtetues të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, dt. 21. 11. 2007, “Për miratimin e procedurës së fshirjes

së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

3. Shfuqizimin si antikushtetues të neneve 2 dhe 6, të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, dt. 31. 01. 2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Kjo kërkesë u argumentua si vijon:

Pranë institucionit tonë, kohët e fundit, kanë ardhur ankesa nga persona fizikë dhe juridikë, në të cilat shprehet shqetësimi, lidhur me veprimet dhe vendimet administrative të regjistruarve të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në rrethe dhe të Kryeregjistruarve në qendër, që rrjedhin nga një akt ligjor, ligji nr.9701, dt. 02.07.2007 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7843, dt.13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” si dhe nga Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.4, dt.21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. P.sh. Shoqëria “Dudaj Construction” shpk, si pjesë e Grupit “Dudaj”, prej 17 vjetësh ushtron aktivitetin e saj privat, duke investuar në sektore të ndryshme të ekonomisë ka ngritur pranë nësh shqetësimit të saj lidhur me aktet ligjore të sipërcituara të cilat prekin direkt interesat e saj. Konkretisht, ajo sqaron se ndër të tjerë, ka realizuar blerjen e një sipërfaqe tokë prej 59.090 m<sup>2</sup> në Gjirin e Lalzit, Durrës, për të cilën kanë përfunduar të gjitha procedurat ligjore lidhur me regjistrimin e saj pranë ZVRPP Durrës, duke patur kështu titull pronësie për këtë pronë. Mbi këtë bazë dhe në funksion të programit të zhvillimit të pronës, shoqëria është miratuar dhe një kredi prej 8 milion euro për realizimin e investimit përkatës prej 4.89 milion euro. Kjo shoqëri investitore, pretendon se po pengohet të vazhdojë implementimin e projektit, sepse një palë e tretë ka pretendime për pronësinë e tokës, pretendime këto të cilat ndonëse janë paraqitur jashtë të gjitha afatëve ligjore kanë vënë në levizje Kryeregjistruarë dhe Drejtorin e Përgjithshëm të AKKP-së të shqyrtojnë çështjen në bazë të përcaktimeve të bëra në ligjin nr.7843, dt. 13. 07. 1994 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me ndryshimet e bëra dhe Udhëzimet e dala në zbatim të tij dhe të renditura në këtë kërkesë dhe kanë filluar procedurat për çregjistrimin e titullit të pronësisë të shoqërisë duke anashkaluar gjykatat dhe duke cenuar realisht investimin dhe pronësinë e shoqërisë. Nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, kjo ankesë konsiderohet e drejtë dhe dispozitat përkatëse të ligjit dhe akteve të Qeverisë konsiderohen antikushtetuese sepse:

Me ndryshimet e bëra me Ligjin nr. 9701, dt.02.04.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7843, dt.13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të ndryshur”, neni 10, me dy paragrafet e shtuara, ka këtë formulim :

“Ne rastet kur, per te njejten pasuri, jane bere me shume se disa regjistrime, te cilat nuk kane rrjedhur nga njeri tjetri, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, regjistruesi, me vendim te arsyetuar, i kerkon Kryeregjistruesit te vendose fshirjen e regjistrimeve te kryera pas regjistrimit te pare, kur ky i fundit eshte ne perputhje me nenet 192-197 te Kodit Civil, duke bere shenimin ne kolonen perkatese. Deri ne nxjerrjen e vendimit te Kryeregjistruesit per miratimin ose refuzimin e kesaj kerkese, regjistruesi ben pezullimin e regjistrimit dhe mbi pasurine nuk mund te kryhen veprime, si dhe njofton palen/palet e interesuara brenda 10 diteve. Konfirmimi i marrjes se njoftimit depozitohet ne dosjen perkatese.

Kryeregjistruesi merr vendim brenda 30 diteve nga marrja e kerkeses. Ne rast te mosmarrjes se vendimit nga Kryeregjistruesi, zbatohet neni 328 i Kodit te Proçedures Civile. Vendimi i Kryeregjistruesit i njoftohet pales/paleve te interesuara brenda 10 diteve dhe konfirmimi i marrjes se njoftimit depozitohet ne dosjen perkatese”.

Kjo dispozite, e cila rezulton absurde dhe e paprecedent ne legjislacionin shqiptar, te pakten pas viteve 90-te, qe mbart mentalitetin etatist, nuk ben gje tjeter veçse, ne rruge dhe me akt administrativ, ju heq te gjitha tagrat pronareve mbi pronat e tyre te palujtshme, sendin me shenjte dhe me te rendesishem ne qarkullimin civil. Regjistruesi i Zyres se Regjistrimit te Pasurive ne rreth, “me vendim te arsyetuar”, pezullon kryerjen e veprimeve nga pronari legjitim me pasurine e tij, dhe i kerkon Kryeregjistruesit fshirjen e regjistrimit te bere pas te parit, ne mbivendosjet qe nuk rrjedhin nga njeri- tjetri. Ky i fundit merr vendim, ose jo, per fshirjen e pasurise se palujtshme, kompetenca qe Kushtetuta ja ka deleguar pushtetit gjyqesor. Nese i shkohet llogjikes se kesaj praktike te re administrative deri ne fund, ne rastin kur pronari nuk ankohet brenda afatit 30 ditor ne Gjykate kunder vendimit te Kryeregjistruesit per fshirjen e prones, atij i hiqet e drejta e prones administrativisht, nje nga te drejtat me themelore te njeriut dhe nga me te garantuarat. Paragrafi i dyte dhe i treti i ketij neni, eshte nje perzjerje dhe konfondim i marredhenieve juridike civile te pronesise, te percaktuara ne Kodin Civil, me marredheniet ne fushen administrative, si teresi e akteve dhe veprimtarise nepermjet te cilave formohet dhe manifestohet vullneti i kesaj administrate dhe ekzekutimi i ketij vullneti.

Neni 10 i Ligjit 7843, dt. 13.7.1994 “Per regjistrimin e pasurive te palujtshme”, me ndryshimet e bera, ne menyre teper te dukshme, eshte ne kundërshtim me Kushtetuten e RSH, prandaj e kontestojme para kesaj Gjykate, teper te respektuar per keto arsye:

1. Ne Kushtetuten e Shqiperise ka nje nen qe i kushtohet teresisht prones private, **neni 41**, ne te cilin parashikohet mbrojtja dhe garantimi i nje prej te drejtave themelore te njeriut, ajo e prones private, duke i dhene nje dimension te ri:

“1) E drejta e pronës private është e garantuar.

2) Prona fitohet me dhurim, me trashëgim, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3) Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesat publike.”

4) Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimet, lejohen vetëm kundërsht një shpërblimi të drejtë.

5) Për mosmarreveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të behet ankimi në gjykatë.”

Pronësia, si e një e drejtë për të gezuar dhe disponuar lirisht sendin, brenda kufijve të caktuar nga ligji, si një marrëdhënie juridike civile pasurore, është jo vetëm një nga të drejtat me kryesore të njeriut, një nga mënyrat e begatimit të tij dhe që mbart një bagazh të madh trajtimi teoriko-juridik, por edhe elementi bazë i një shoqërie demokratike të bazuar në ekonomine e tregut të lirë dhe të konkurrencës së ndershme. Si e tillë ajo ka garancinë e një mbrojtjeje të veçantë në Republikën e Shqipërisë, në atë masë, parametra dhe mjete ligjore si në të gjitha vendet e tjera të zhvilluara. Ligjvënësi, për keto dhe shkaqe të tjera, nuk ka bërë dallim në Kushtetute, për sa i takon mbrojtjes nga çdo dhunim, midis pronës private dhe asaj shtetërore ose publike.

Norma e sipërcituar kushtetuese, gjen pasqyrim edhe Kodin Civil; kështu në nenin 153 të tij, në mënyrë taksative parashikohet se : “Askush nuk mund të shpronësohet ose t’i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës së pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këto e kërkojnë interesat publike dhe kurdoherë kundërsht një shpërblimi të drejtë”, ndërsa paragrafi i parë i nenit 191 i KC parashikon humbjen e pronësive: “Pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër ose kur hiqet dorë prej saj”.

Mënyra e fshirjes së regjistrimeve nga ZRPP në rrethë, sipas paragrafeve 1 dhe 2 të nenit 10 të Ligjit nr.7843, dt.13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të palujtshme”, të ndryshuar, bie ndesh hapur me garancitë kushtetuese për pronën.

**2. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet garancia kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor :**

“1) Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2) Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Keto garanci janë jo vetëm në kuptimin procedurial por edhe në kuptimin thelbësor të atyre çështjeve që i paraqiten gjykatës për zgjidhjen

ne themel. Pezullimi i veprimeve mbi pronen dhe fshirja e regjistrimit të mbivendosjeve nga regjistruesi dhe kryeregjistruesi, pa një proces të rregullt gjyqësor, ka cenuar rendin e drejtës kushtetuese të gezimit, posedimit dhe disponimit të pronës private nga pronari. Shteti, me anën e funksionit të tij ligjvënës, vendos norma që përbejnë rendin e tij juridik, ndërsa me anën e funksionit gjyqësor, garanton mbrojtjen e të drejtave dhe normave kryesore me qëllimin e vetëm të sigurimit të një jete normale sociale. Në rrugë administrative (alternative me atë gjyqësore), mund të korrigjohen dhe rivendosen disa cenime që i bëjnë gezimit dhe posedimit të pronës, të parashikuara në ligj, siç është rasti i nenit 21 të Ligjit nr.7501, dt 19.07.1991 “Per token”, i ndryshuar, që parashikon marrjen e një vendimi nga Këshilli i Komunes/Bashkise, në rastet e pushtimit, zënies, përdorimit, ndertimeve të paligjshme dhe demtimeve të tokës bujqësore nga personat të tretë, fizike apo juridike. Por, nuk mund të hiqet administrativisht, në asnjë rast, me përjashtim të shpronësimit për interesat publike, tagri me i rëndësishëm i pronarit që e dallon nga poseduesit e paligjshëm, disponimi i pronës. Kushtetuta ka epersinë e dispozitave të saj ndaj atyre ligjore, përmban atë që konsiderohet kushtetueshmeri dhe hierarki të rendit juridik. Ligjshmeria nënkupton ndertimin e raporteve të veçanta midis pushtetit dhe shtetasve në bazë të ligjit, garantimin e të drejtave të njeriut, respektimin e ligjit edhe nga organet e administratës shtetërore. Neni 296 i Kodit Civil, sanksionon që : “Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues apo mbajtës. Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkepronar për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t’i dorëzohet gjithë bashkepronarëve.

**3. Neni 7** i Kushtetutës parashikon një nga parimet bazë mbi të cilin organizohet dhe funksionon një shtet me tipare demokratike:

“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”.

Me këtë nen, pushteti kufizohet, kontrollohet dhe ndahet midis organeve të ndryshme sipas funksioneve të ndryshme. Çdo organi kushtetues i jepet një funksion i qartë aktiv dhe njëkohësisht parandalohen abuzimet e ndryshme. Dhenia e drejtësisë është e ndare nga organet dhe drejtuesit e organeve që marrin vendime me karakter politik, qofshin të pushtetit ekzekutiv apo legjislativ.

Fakti që neni 10 parashikon që kundër vendimit të fshirjes së regjistrimit të pronës nga Kryeregjistruesi, mund të bëhet ankim në gjykatë, nuk mund të përliqet në asnjë rast dhe me asnjë argument cenimin e pronës administrativisht. Çdo pronar, përfshirë edhe shtetin, si subjekt i barabartë me subjektet e drejta të të drejtës civile, nëse i është tjetërsuar pasuria e palujtshme dhe regjistruar në ZRPP, mund të kërkojë

gjyqesisht deklarimin e pavlefshmerise absolute te aktit te tjetersimit dhe kthimin e paleve ne gjendjen e meparshme. Kjo e drejte nuk mund t'i delegohet nje organi administrativ; per me teper organit qe ben regjistrimin e pasurive te palujtshme dhe te drejtave reale mbi to.

Ne nenin 2/1, te Ligjit nr.7843, dt.13.07.1994 "Per regjistrimin e pasurive te palujtshme", i ndryshuar, percaktohet objekti i veprimtarise se Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Palujtshme: "Objekt i veprimtarise se zyres se regjistrimit te pasurise se palujtshme eshte regjistrimi i titujve te pronesise dhe te drejtave te tjera reale per pasurite e palujtshme ne baze te dokumentave ligjore qe vertetojne pronesine mbi pasurine e palujtshme, si dhe pergatitja, mbajtja dhe administrimi i regjistrave te pasurive te palujtshme, hartave treguese te regjistrimit dhe dokumentacionit, qe vertetojne te drejten e pronesise dhe te drejtat e tjera reale mbi pasurine e palujtshme". Shtesat ne nenin 10, pervec pabazueshmerine e tyre ne Kushtetute dhe ne ligj, dhe me vullnetin e ligjvenesit, kane zgjeruar objektin e veprimtarise se ZRPP ne rrethe.

Sistemi i regjistrimit te pasurive te palujtshme, eshte nje baze te dhenash ligjore te rendesishme, qe percakton statusin e tokes, te ndertesave si objekte te drejtes civile dhe evidenton pronesine dhe te drejtat reale mbi to. Ne te perfshihen te dhena saktesisht te percaktuara si: vendndodhja e sakte e çdo njesie te pasurise, permasat dhe kufinjte, identitetin e pronarit, ekzistencen e te drejtave reale mbi pasurine (qiramarrja, servituti, e drejta e perdorimit, hipoteka) dhe personat qe mbajne keto te drejta. Ne menyre te sforcuar, dhe ne kundersizim jo vetem me Kushtetuten, por edhe me vete ligjin perkates organik, me dy paragrafe te nenit 10, qe kontestojme, keto zyra, nga organe qe mund te quhen "banka", te evidentimit, te mirembajtjes, perditesimit e te ruajtjes te titujve te pronesise se palujtshme dhe transaksioneve, qe pervec te qenit prone private, eshte edhe pasuri kombetare dhe faktor real i thithjes se investimeve, jane shndruar ne organe administrative qe kane te drejten e heqjes se prones dhe si rrjedhoje mund te konsiderohen strukture administrative antikushtetuese.

**4.** Ne piken 1, te **Nenit 4**, te Kushtetutes tone, sanksionohet qe:

"E drejta perben bazen dhe kufinjte e veprimtarise se shtetit"

Neni 10 i Ligjit te lartpermendur, cenon parimin e sigurise juridike me mos garantimin e prones private, krijon ambient pasigurie per nje mase shume te madhe pronaresh, humbet besueshmeria e shtetasve tek shteti, nuk jep garanci per vijueshmeri dhe mos-ndryshime legjislacioni, dhe qe le shteg te gjere per abuzime, subjektivizem dhe selektivitet gjate zbatimit te tij. Per me teper, me kete procedure behet edhe fshirja e regjistrimeve, per konfliktet te mbivendosjeve, qe jane duke u shqyrtuar ne rruge gjyqesore. Per gjate 15 vjeteve te fundit, me pronat e palujtshme te fituara ne baze te legjislacioni perkates, jane bere tjetersime ne mijra

raste, ajo ka ndryshur disa here pronar dhe per me teper, ne to jane bere tashme investime te medha nga subjekte te ndryshme. Neni 10 i Ligjit, per nga qellimi i “shkurtimit te rruges” per korrigjimin e veprimeve antiligjore ne kalimet e pronesise dhe veprimet ne Zyrat e Regjistrimit te Pasurive te Palujtshme, i mungon perkujdesja per te zgjidhur ne keto raste pasojat, kthimin e paleve ne gjendjen e mepareshme. Kjo per shkak se ankimi ne gjykate per vendimin e Kryeregjistruesit per fshirjen e regjistrimit do behet kundra aktit te tij administrativ, dhe jo per themelin e konfliktit te prones. Ne kete menyre do krijohen shume konflikte te reja ne shoqerine tone qe eshte jo pak e mbarsur me to.

Ligji eshte ne kundertshtim me parimin e sigurise juridike.

Ashtu siç e thame dhe me lart, siguria juridike presupozon besueshmerine e shtetasve tek shteti dhe pandryshueshmerine e ligjit per marredheniet juridike te krijuara. Shtetasi nuk duhet te shqetesohet vazhdimisht me lloje ndryshimesh qe sjellin efekte negative ne gjendjen e vendosur me akte te meparshme. Nga patja parasyshe e parimit te sigurise juridike, mbrohen jo vetem lirite dhe te drejtat themelore te njohura ne Kushtetute, por edhe te drejtat subjektive materiale te individeve te njohura nga ligjet e zakonshme.

Me ligjet nr.7501, dt.19.07.1991 “Per token”, i ndryshuar, nr.8053, dhe ate me dt.21.12.1995 “Per kalimin ne pronesi, pa shperblim, te tokes bujqesore” dhe me akte te tjera nenligjore, shume subjekte kane fituar te drejten e pronesise mbi token bujqesore. Ndersa me Ligjin qe kontestojme per papajtueshmeri me Kushtetuten, organet administrative kane te drejten te verifikojne, shqyrtojne dhe anullojne titujt e pronesise.

Ligjvenesit nuk mund te perkeqesoje ne menyre te paarsyeshme gjendjen ligjore te personave, te mohojte te drejtat e fituara ose te shperfillte interesat legjitime te tyre. Ne nje shoqeri me kah demokratik, ligji duhet te garantoje siguri, qartesi dhe vazhdimesi ne menyre qe individet t’i drejtojne veprimet e tyre ne menyre korrekte e ne perputhje me te dhe, nga na tjeter, vete ligji te mos qendroje statik nese duhet t’i jape forme nje koncepti, siç eshte ai i drejtesise, ne nje shoqeri qe ndryshon me shpejtesi. Çdo shoqeri qe synon nxitjen dhe mbrojtjen e te drejtave te njeriut, ka si parim thelbesor epersine e ligjit. Regullime ligjore mund te kryhen vetem ne perputhje me nje procedure te percaktuar me pare dhe pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese. Parimi i sigurise juridike duhet respektuar nga te gjitha institucionet dhe se pari nga vete Kuvendi.

Ligji, nenet e te cilit kerkojme te shfuqizohen si antikushtetues, parashikojne procedure qe prekin brutalisht parimin e sigurise juridike, perkeqeson gjendjen ligjore te shtetasve duke ju hequr te drejten e prones te fituar para shume viteve dhe te regjistruar. Nga ana tjeter, ky ligj nuk merr parasyshe afatet e parashkrimit te padise, neni 103 i Kodit Civil, dhe



ate per fitimin e pasurise se palujtshme me parashkrim fitues.Parimi i sigurise juridike preket pervec sa me lart, edhe me faktin se ligjit i eshte dhene fuqi prapavepruese.

**5. Neni 15/1** i Kushtetutes sanksionon se :

“Te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te pandashme, te patjetersueshme e te padhunueshme dhe qendrojne ne temel te te gjithë rendit juridik

Organet e pushtetit publik, ne permbushje te detyrave te tyre, duhet te respektojne te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, si dhe te kontribuojne ne realizimin e tyre.”

Zyrat e regjistrimit te pasurive te palujtshme, ne veprimtarine e tyre duhet t’u permbahen detyrave te tyre per te cilen jane krijuar, te respektojne te drejtat kushtetuese te pronareve dhe jo te kontribuojne ne shkeljen e tyre.

**6. Neni 17** i Kushtetutes parashikon se :

“Kufizime te te drejtave dhe lirive te parashikuara ne kete Kushtetute mund te vendosen vetem me ligj per nje interes publik dhe per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve. Kufizimet duhet te jene ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar ate.

Keto kufizime nuk mund te cenojne thelbin e lirive dhe te drejtave dhe ne asnje rast nuk mund te tejkalojne kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut”.

Ne kete menyre disiplinohen kufizimet qe mund t’u behen te drejtave dhe lirive kushtetuese te individeve, kufizime qe nuk mund te cenojne thelbin e te drejtave, ku e drejta e prones eshte nga me thelbesoret.

**7. Neni 5** i Kushtetutes afirmon qarte faktin qe :

“Republika e Shqiperise zbaton te drejten nderkombetare te detyrueshme per te”.

Me Ligjin nr.8137, dt. 31.07.1996 vendi yne ka ratifikuar Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut, duke e inkluduar ne legjislacionin tone te brendshem te detyrueshem per zbatim. Ne nenin 1 te Protokollit nr.1 te Konventes, parashikohet qe çdo person fizik apo juridik ka te drejten qe t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund te privohet nga prona e tij, pervecse per arsye te interesit publik dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare. Protokolli 1 i Konvente Europiane per te Drejtat e Njeriut, garanton te drejten e garantimit te pacenueshem te prones, qe ne rastin konkret eshte anashkaluar.

**8. Pika 1, i nenit 18** te Kushtetutes:

“Te gjithë jane te barabarte perpara ligjit”

Barazia perpara ligjit, ose barazia formale, u siguron te gjithë shtetasve barazi te drejtash. Ky parim i drejtohet kryesisht shtetit dhe te

gjitha enteve sociale, sipas kompetencave, per te marre te gjitha masat e duhura per realizimin e saj ne praktiken administrative te perditeshme. Por paragrafi dyte dhe i trete i nenit 10 te Ligjit nr.7843, dt.13.07.1994 “Per regjistrimin e pasurive te palujtshme”, nuk garanton kete barazi. Ne vetvete ai mban faren e pabarazise, se selektivitetit dhe te abuzimit gjate zbatimit te tij. Norma parashikon vetem fshirjen e regjistrimeve qe nuk kane rrjedhur nga njeri tjetri. Nuk ka argument pse e njejta procedure te mos shtrihet te te gjitha mbivendosjet. Deri tani, ligji i lartpermendur, ka pesuar disa ndryshime, i fundit eshte ai me nr.9701, dt. 02.04.2007, te cilat kane hequr dhe shtuar nene dhe paragrafe qe kane ndryshuar vullnetin fillestar te ligjvenesit, duke sajuar standarte te ndryshme, ne kohe te ndryshme (per te njejten marredhenie juridike, sipas ligjit material, ne proceduren e regjistrimit te titujve te pronesise), dhe te fshirjes e tyre ne raste mbivendosjesh, qe ne fakt, eshte konflikt pronesie midis paleve dhe i zgjidhshem ne rruge gjyqesore.

Per sa me lart kerkuam shfuqizimin si te papajtueshem me Kushtetuten e Shqiperise, te paragrafeve te dyte dhe te trete te nenit 10, te Ligjit nr.7843, dt.13.07.1994 “Per regjistrimin e pasurive te palujtshme” i ndryshuar.

Te njejten gje kerkuam edhe per Udhezimin nr.4, dt.21.11.2007, te Keshillit te Ministrave, “Per miratimin e procedurese se fshirjes se regjistrimeve te kryera ne kundershtrim me ligjin dhe te atyre, qe krijojne mbivendosje ne zyren e regjistrimit te pasurive te palujtshme.” dhe Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr.1, dt.31. 01. 2007 “Per proceduret e regjistrimit ne zyrat e regjistrimit te pasurive te palujtshme” me qe aktet normative, kane dale ne mbeshtetje te neneve 10 dhe 56 te Ligjit nr.7843, dt.13.07.1994 “Per regjistrimin e pasurive te palujtshme”, te ndryshuar, te njejtat argumenta ekzistojne edhe per papajtueshmerine e tyre me Kushtetuten.

Kjo çështje u shqyrtua nga Gjykata Kushtetuese në seancë të hapur më datën 20.10.2009, por vendimi përfundimtar i saj akoma nuk është dhënë.

## **II. Kërkesa e paraqitur më datën 23.06.2009 me objekt:**

Shfuqizimi si, antikushtetues te Ligjit nr.9948, dt.07.07.2008, “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore.”, si dhe te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.1269, dt.17.09.2008 “Per perberjen, menyren e funksionimit dhe detyrat e pergjegjesite e strkturave shteterore te ngarkuara per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”.

Kjo kërkesë u argumentua si vijon:

Prane institucionit tone, kohet e fundit, kane ardhur ankesa nga persona fizike dhe juridike, ne te cilat shprehet shqetsimi, lidhur me Ligjin nr.9948, dt.07.07.2008 “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”. Permendim ketu rastin e shtetasit Nazmi Drizi, banues ne Fshat Kastriot, Komuna Kastriot, Diber, qe ka pretendime ndaj menyres se funksionimit te Komisionit Vendor prane Prefektures.

Subjektet e lartpermendur, mendojne se fryma e ketij ligji dhe nene te veçante te tij, bien ndesh me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise.

Sipas mendimit te Avokatit te Popullit ky ligj le shteg te gjere per abuzime, subjektivizem dhe selektivitet gjate zbatimit te tij.

Ligji ne teresine e tij, perveç te tjerave, paralelizon dhe zevendeson dispozitat e Kushtetutes dhe te Kodit Civil me ato te Kodit te Proçedurave Administrative. Ligji nr.9948, dt. 07.07.2008 “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore” krijon struktura shteterore, paralele me gjykatat. Komisioni Qeveritar i Tokave dhe Komisionet Vendore prane Prefektit ne qarqe, sipas neneve 6, 7, dhe 8 te Ligjit, ushtrojne kompetenca te tilla, si “zgjidhin mosmarreveshjet midis shtetasve”, “zgjidhin konflikte juridiksionale” dhe “japin ose heqin tituj pronesie”; kompetenca qe jane ekskluzive per pushtetin gjyqesor.

### **1. Ligji eshte ne kundërshtim me parimin e sigurise juridike.**

Neni 10 i Ligjit te lartpermendur, cenon elementet dhe tiparet themelore te parimit te sigurise juridike, krijon ambient pasigurie per nje mase shume te madhe pronarësh, humbet besueshmeria e shtetasve tek shteti, nuk jep garanci per vijueshmeri dhe per ndryshime legjislacioni ne perputhje me Kushtetuten.

Me ligjet nr.7501, dt.19.07.1991 “Per token”, i ndryshuar, nr.8053, dhe ate me dt.21.12.1995 “Per kalimin ne pronesi, pa shperblim, te tokes bujqesore” dhe me akte te tjera nenligjore, shume subjekte kane fituar te drejten e pronesise mbi token bujqesore. Ndersa me Ligjin qe kontestojme per papajtueshmeri me Kushtetuten, organet administrative kane te drejten te verifikojne, shqyrtojne dhe anullojne titujt e pronesise. Ligjvenesit nuk mund te perkeqesoje ne menyre te paarsyeshme gjendjen ligjore te personave, te mohoje te drejtat e fituara ose te shperfillte interesat legjitime te tyre. Ne nje shoqeri me kah demokratik, ligji duhet te garantoje siguri, qartesi dhe vazhdimesi ne menyre qe individet t’i drejtojne veprimet e tyre ne menyre korrekte e ne perputhje me te dhe, nga na tjetër, vete ligji te mos qendroje statik nese duhet t’i jape forme nje koncepti, siç eshte ai i drejtësisë, ne nje shoqeri qe ndryshon me shpejtesi. Çdo shoqeri qe synon nxitjen dhe mbrojtjen e te drejtave te njeriut, ka si parim thelbësor epersine e ligjit. Rregullime ligjore mund te kryhen

vetem ne perputhje me nje procedure te percaktuar me pare dhe pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese. Parimi i sigurise juridike duhet respektuar nga te gjitha institucionet dhe se pari nga vete Kuvendi.

Ligji nr.9948, dt.07.07.2008 ben pikerisht te kunderten e kesaj kerkese te parimit te sigurise juridike dhe perkeqeson ne menyre te paarsyeshme gjendjen ligjore te shtetasve, pasi u heq atyre te drejten e prones. Nenet 2, 3 dhe 4, ne korelacion me nenin 9 dhe 10 te Ligjit krijon bazen ligjore te heqjes se titullit te pronesise, te dhene qe para shume vitesh. Ligji nuk merr parasysh afatet e parashkrimit te padise, neni 103 i Kodit Civil, dhe ato per fitimin me parashkrim fitues te prones, me mirebesim dhe ne baze te nje veprimi juridik qe nuk eshte i ndaluar nga ligji, neni 168 po i Kodit Civil. Parimi i sigurise juridike cenohet, pervec sa me lart, edhe per faktin se Ligjit i eshte dhene fuqi prapavepruese. Nenet 2, 3, dhe 4 vendosin kriteret per vlefshmerine e veprimeve juridike te kalimit ne pronesi te tokes bujqesore, duke anashkuar kriteret e pavlefshmerise se veprimit juridik dhe pasojave, te parashikuara ne nenet 92-111 te Kodit Civil. Dhenia e fuqise prapavepruese ketyre neneve, te kritereteve te reja qe vendosin, perkeqeson gjendjen juridike te pronareve te tokes bujqesore, sepse as parashkrimi fitues nuk i mbron nga veprimet dhe vendimet e Komisioneve Vendore dhe Komisionit Qeveritar te Tokes.

**2. Ligji eshte ne kundersiztim edhe me nenin 7 te Kushtetutes,** norme qe parashikon nje nga parimet baze mbi te cilin organizohet dhe funksionon nje shtet me tipare demokratike, ate te ndarjes dhe ballancimit te pushteteve :

“Sistemi i qeverisjes ne Republiken e Shqiperise bazohet ne ndarjen dhe balancimin ndermjet pushteteve ligjvenes, ekzekutiv dhe gjyqesor”.

Me kete nen, pushteti kufizohet, kontrollohet dhe ndahet midis organeve te ndryshme sipas funksioneve te ndryshme; çdo organi kushtetues i jepet nje funksion i qarte aktiv dhe njekohesisht parandalohen abuzimet e ndryshme. Dhenia e drejtesise eshte e ndare nga organet dhe drejtuesit e organeve qe marrin vendime me karakter politik, qofshin te pushtetit ekzekutiv apo legjislativ. Klasifikimi i pushteteve e mbron shtetasin nga arbitrariteti dhe i lehteson atij njekohesisht te kuptuarit e procesit te qeverisjes. Vetem fakti, qe organet ekzekutive kane marre kompetencat e pushtetit gjyqesor, eshte i mjaftueshem per t’a shpallur si antikushtetues Ligjin nr. 9948, dt. 07.07.2008 “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”. Ligji nuk dallon as ato raste kur gjykatat jane duke shqyrtuar konfliktet e pronesise se tokes bujqesore. Ne keto kushte veshtiresohet perfundimi i proceseve gjyqesore, krijohen zvarritje dhe, me e keqja :

Prefekti perseri mund ta anulloje titullin e pronesisë, Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi.

Duke ja deleguar të drejtën e konstatimit të vlefshmërisë së titujve të pronesisë pushtetit ekzekutiv (komisioneve vendore dhe prefektit), ligji e ve pushtetin gjyqësor në pozitën e rivefikuesit të pavlefshmërive të titujve të pronesisë, duke denatyrizuar arsyen e ekzistencës së tyre dhe shkelur rëndë parimin e ndarjes dhe ballancimit të pushteteve. Në këtë mënyrë krijohet një precedent i ri, tepër negativ, që për arsye të ndryshme të çelën, herë pas here, procedura rishqyrtimi dhe rivefikimi për shumë raste të tjera. Rivefikimi i vlefshmërisë së titujve të pronesisë mbi token bujqësore, pa një proces të rregullt gjyqësor, ka çuar rëndë të drejtën kushtetuese të gezimit, posedimit dhe disponimit të pronës private nga pronari. Shteti, me anën e funksionit të tij ligjvënës, vendos norma që përbejnë rëndin e tij juridik. Nëse me anën e funksionit gjyqësor, garanton mbrojtjen e të drejtave dhe normave kryesore me qëllimin e vetëm të sigurimit të një jete normale sociale për njerezit.

Nga ana tjetër Ligji penalizon mbajtësin e titullit të pronesisë për gabime apo shtremberime në zbatimin e ligjit nga ish komisionet e tokave, gjë që bie në dësh me funksionimin normal të shtetit të së drejtës dhe cenon garantimin e të drejtave dhe lirive të individit.

Keto garanci janë jo vetëm në kuptimin procedural, por edhe në kuptimin thelbësor të atyre çështjeve që i paraqiten.

**3. Ligji është në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës** në të cilin parashikohet mbrojtja dhe garantimi i një prej të drejtave themelore të njeriut, ajo e pronës private.

“1) E drejta e pronës është e garantuar.

2) Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3) Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e të drejtës së pronës vetëm për interes publikë”.

Pronësia, si e një e drejte për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendin, brenda kufinjve të caktuar nga ligji, si një mardhenie juridike civile pasurore, është jo vetëm një nga të drejtat me kryesore të njeriut, një nga mënyrat e begatimit të tij dhe që mbart një bagazh të madh trajtimi teoriko-juridik, por edhe elementi baze i një shoqërie demokratike të bazuar në ekonomine e tregut të lirë dhe të konkurrencës së ndershme. Si e tillë prona ka garancinë e një mbrojtjeje të veçantë në Republikën e Shqipërisë, në atë masë, parametra dhe mjete ligjore si në të gjitha vendet e tjera të zhvilluara. Ligjvënësi, për keto dhe shkaqe të tjera, nuk ka bërë dallim në Kushtetute, për sa i takon mbrojtjes nga çdo dhunim, midis pronës private dhe asaj shtetërore ose publike.

Në nenin 153 të Kodit Civil, në mënyrë taksative parashikohet se: “Askush nuk mund të shpronësohet ose t’i kufizohet e drejta e ushtrimit

te se drejtes se prones qe barazohet me shpronessimin, pervecse kur kete e kerkojne interesat publike dhe kurdohere kundrejt nje shperblimi te plote dhe paraprak”.

Ka shume subjekte qe gjate viteve 1993-2009 kane fituar pronesine e tokes bujqesore me vendim gjyqesor te formes se prere. Edhe ne keto raste, Ligji tregon prepotence, me shfuqizimin qe ju ben faktikisht, vendimeve gjyqesore te formes se prere.

Kushtetuta, ka prevalence te dispozitave te saj ndaj atyre ligjore. Ajo permban ate qe konsiderohet kushtetueshmeri dhe hierarki e rendit juridik. Ligjshmeria nenkupton ndertimin e raporteve te vecanta midis pushtetit dhe shtetasve ne baze te ligjit, garantimin e te drejtave te njeriut, respektimin e ligjit edhe nga organet e administrates shteterore. Neni 296 i Kodit Civil, sansionon qe : “Pronari ka te drejte te ngreje padi per te kerkuar sendin e tij nga çdo posedues apo mbajtes. Kete te drejte e ka edhe çdo bashkepronar per sendin e perbashket, me qellim qe ai t’i dorezohet gjithë bashkepronareve”

#### **4. Ligji eshte ne kundershtrim edhe me nenin 42/2 te Kushtetutes,**

“1) Liria, prona dhe te drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligji nuk mund te cenohen pa nje proces te rregullt ligjor.

2) Kushdo, per mbrojtjen e te drejtave, te lirive dhe te interesave te tij kushtetues dhe ligjore, ose ne rastin e akuzave te ngritura kunder tij, ka te drejten e nje gjykimi te drejte dhe publik brenda nje afati te arsyeshem nga nje gjykate e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”

Keshtu garantohet nderhyrja e pushtetit gjyqesor per te mbrojtur te drejtat, lirite dhe interesat kushtetuese dhe ligjore te individeve. Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.32, te vitit 2003, ka konstatuar se, kontrolli gjyqesor ndaj akteve me karakter administrativ, duke qene shprehje e parimit te kontrollit dhe ballancimit te pushteteve e duke qendruar ne themel te pavaresise se organeve, ka ndryshime thelbesore nga kontrolli administrativ qe kryhet ne rruge hierarkike apo nga organe te krijuara posaçerisht. Aksesi per t’iu drejtuar gjykates eshte nje nga elementet e se drejtes per nje proces te rregullt gjyqesor.

#### **5. Neni 15/1 i Kushtetutes sanksionon se:**

“Te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te pandashme, te patjetersueshme e te padhunueshme dhe qendrojne ne themel te te gjithë rendit juridik

Organet e pushtetit publik, ne permbushje te detyrave te tyre, duhet te respektojne te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, si dhe te kontribuojne ne realizimin e tyre”.

Ish komisionet e Tokave, te krijuara ne fshat, komune, bashki, qark dhe ne qeveri, ishin strukura shtetore ekzekutive ne zbatim te Ligjit nr.7501, dt.19.07.1991 “Per token” dhe atij me nr.8053, dt.21.12.1995

“Per kalimin ne pronesi pa shperblim te tokes bujqesore”, dhe te tilla duhej te mbeteshin deri ne fund te procesit.

Gjate gjithë segmentit kohor nga nxjerrja e aktit administrativ deri ne ekzekutimin e tij, organi kompetent ka te drejte ta revokoje apo ta shfuqizoje ate. Akti administrativ i Komisioneve, Akti i Marrjes se Tokes ne Pronesi, i ka sjelle pasojat e tij juridike me regjistrimin ne ZRPP te rrethit. Ne kete moment, akti administrativ nga nje maredhenie juridike individ-administrate publike, shndrohet ne nje maredhenie juridike pronesie, midis te njejtut individ dhe prones. Ketu eshte edhe kufiri qe e ndan proceduren administrative dhe pushtetin ekzekutiv nga pushteti tjetër, ai gjyqesor.

**6. Neni 17** i Kushtetutes parashikon se:

“Kufizime te te drejtave dhe lirive te parashikuara ne kete Kushtetute mund te vendosen vetem me ligj per nje interes publik dhe per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve. Kufizimet duhet te jene ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar ate.

Keto kufizime nuk mund te cenojne thelbin e lirive dhe te drejtave dhe ne asnje rast nuk mund te tejkalojne kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut”.

Ne kete menyre disiplinohen kufizimet qe mund t’u behen te drejtave dhe lirive kushtetuese te individeve, kufizime qe nuk mund te cenojne thelbin e te drejtave, ku e drejta e prones eshte nga me thelbesoret.

**7. Neni 5** i Kushtetutes afirmon qarte faktin qe:

“Republika e Shqiperise zbaton te drejten nderkombetare te detyrueshme per te”.

Me ratifikimin e Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut, kjo e fundit eshte inkluduar ne legjislacionin tone te brendshem, te detyrueshem per zbatim. Ne nenin 1, te Protokollit nr.1 te Konventes, parashikohet qe çdo person fizik apo juridik ka te drejten qe t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund te privohet nga prona e tij, perveçse per arsye te interesit publik dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare. Protokolli 1 i Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut, garanton te drejten e garantimit te pacenueshem te prones, qe ne rastin konkret eshte anashkaluar.

Edhe Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.1269, dt.17.09.2008 “Per perberjen, menyren e funksionimit dhe detyrat e pergjegjesite e strukturave shtetore te ngarkuara per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”, per te njejtat arsye, ka te njejten papajtueshmeri me Kushtetuten si dhe Ligji, ne mbeshtetje dhe per zbatim te te cilit ka dale, prandaj duhet shfuqizuar si antikushtetues.

Ne keto kushte, ne baze te nenit 131, germa “dh” te Kushtetutes se Shqiperise dhe nenit 24, germa “c” te Ligjit nr.8454, dt.04.02.1999 “Per Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, i kemi kerkuar Gjykatës Kushtetuese: Shfuqizimin si, antikushtetues te Ligjit nr.9948, dt.07.07.2008, “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit e titujve te pronesise mbi token bujqesore”, si dhe te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.1269, dt.17.09.2008 “Per perberjen, menyren e funksionimit dhe detyrat e pergjegjesite e strukturave shtetore te ngarkuara per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”.

Kjo çështje u shqyrtua në seancë të hapur në Gjykatën Kushtetuese më datën 17 shtator 2009, por vendimi përfundimtar i saj akoma nuk është dhënë.

### **III. Kërkesa e paraqitur më datën 15.07.2009 me objekt:**

Shfuqizimi i neneve 3/3; 4/2; 12/1,2,3; 14/1; 22; 27 dhe 29/2 të ligjit nr. 10142, dt. 15.05.2009, si të papajtuëshëm me Kushtetutën, sepse çënojnë të drejtat ekonomiko-financiare të punonjësve të Policisë së Shtetit, të përfituara me aktet normative të mëparshme.

Kjo kërkesë u argumentua si vijon:

Në institucionin tonë ka bërë ankesë Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe 21 qytetarë (punonjës të Policisë së Shtetit në detyrë dhe ish punonjës të Policisë së Shtetit të cilët trajtohen me pagesë kalimtare apo me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi), kundër disa dispozitave të ligjit nr. 10142, dt. 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka hyrë në fuqi më datën 28.06.2009.

Në ankesën e saj sindikata shprehet se në përmbushje të detyrimit ligjor, social e profesional për të mbrojtur të drejtat dhe interesat sociale të punonjësve të Policisë së Shtetit, ajo ka ndjekur me shqetësim procedurat e miratimit të ligjit “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”. Sipas saj përgatitja e projektligjit është kundërshtuar fuqimisht nga të gjitha grupet e interesit, si strukturat e Policisë së Shtetit, Sindikata e Policisë dhe shoqatat e punonjësve të policisë në rezervë, por ky fakt nuk është marrë në konsideratë nga strukturat ligjberëse përkatëse.



Në ankesën e saj, Sindikata e Policisë shprehet se aktualisht ka disa akte normative që rregullojnë marrdhëniet juridike në këtë fushë, si ligji nr. 8661, dt. 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, neni 89 i ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, VKM nr. 443, dt. 16.06.2005 “Për kushtet, kriteret dhe masën e përfitimeve nga sigurimi shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe anëtarëve të familjeve të tyre, në rastet kur punonjësi ndërpret karrierën”, Udhëzimi i përbashkët nr. 1752/1, dt. 29.07.2005 i Ministrisë të Rendit Publik dhe nr. 3584, dt. 01.08.2005 i Ministrisë të Financave “Për zbatimin e VKM nr. 443, dt. 16.06.2005 “Për kushtet, kriteret dhe masën e përfitimeve nga sigurimi shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe anëtarëve të familjeve të tyre, në rastet kur punonjësi ndërpret karrierën”, Urdhëri nr. 1783, dt. 05.08.2005 i Ministrisë të Rendit Publik “Për realizimin e të drejtave të punonjësve të Policisë së Shtetit për përfitime suplementare” dhe Urdhërshërbimi nr. 476, dt. 09.08.2005 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga aktet normative për përfitimet suplementare të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të cilat janë miratuar vitet e fundit dhe me asistencën ndërkombëtare. Trajtimi i punonjësve të policisë sipas akteve të mësipërme është parashikuar edhe në nenet 88 dhe 89, të ligjit të ri nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Ligji “Për Policinë e Shtetit”, është përgatitur me grup pune të përbashkët me specialistë nga Policia e Shtetit Shqiptar, Misionet Policore Ndërkombëtare që asistojnë Policinë e Shtetit, si PAMECA e ICITAP dhe OSBE-ja, dhe se ky ligj u vlerësua si ligj më i mirë për Policinë e Shtetit Shqiptar.

Konkretisht qytetarët ankues, të cilët janë punonjës policie në detyrë apo të liruar, por që trajtohen me pagesë kalimtare ose me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, ankohen për cënime të disa të drejtave të fituara apo të pritshme nga ligji nr. 8661, dt. 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”. Sipas tyre ligji i ri nr. 10142, dt. 15.05.2009 që kontestohet ul në mënyrë të ndjeshme masën e përfitimit, përkeqëson pagesën sipas gradave dhe sipas kontributeve të secilit punonjës policie. Pagesa sipas këtij ligji është e njëjtë për të gjithë punonjësit e policisë. Kështu sipas ligjit të ri, punonjësit që paguajnë kontribute më të mëdha në sigurime dhe kanë grada të larta policore, do kenë të njëjtën pagesë me ata me kontribute më të vogla dhe grada të ulta.

Barazimi që i bëhet trajtimit të punonjësve të Policisë së Shtetit me efektivat e strukturave të tjera është i pamotivuar, pasi natyrat e punës janë të ndryshme.

Gjithashtu nga subjektet ankues kundërshtohet edhe fuqia prapavepruese e këtij ligji (neni 29 “Rillogaritja e të drejtave të njohura”),

e cila bie haptas në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe parimet bazë të së drejtës, sidomos parimin kushtetues të sigurisë juridike.

Në përfundim të ankesës, sindikata dhe ankuesit e tjerë kërkojnë që Policia e Shtetit të mos përfshihet në ligjin e ri, por të vazhdojë të trajtohet sipas përcaktimit të bërë në nenin 89, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, ku përcaktohet se: “Punonjësi i Policisë ... gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera shtesë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

Për të arritur këtë qëllim ankuesit kërkojnë ndërhyrjen ligjore të Avokatit të Popullit për të mbrojtur interesat ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilat janë cënuar rëndë nga ligji nr. 10142, dt. 15.05.2009.

Nga studimi i këtij ligji dhe krahasimi i tij me ligjin nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, Avokati i Popullit konstatoi se ligji i ri nr. 10142, dt. 15.05.2009 cënon rëndë disa të drejta dhe përfitime suplementare të punonjësve të Policisë së Shtetit të përfituara nga ligji i mëparshëm nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit” dhe neni 89 i ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të drejta të cilat i kanë përfituar një masë e konsiderueshme e tyre. Kështu mund të përmëndim:

1. Është rritur koha e vjetërsisë në shërbim për efekt të përlllogaritjes së përfitimeve. Sipas nenit 3, pika 3 e ligjit të ri, viti i shërbimit njihet vetëm kur është vit i plotë. Ndërsa sipas nenit 5, gërma “a” të ligjit të mëparshëm, në çdo rast, periudha 6 muaj e 1 ditë quhet vit i plotë.

2. Është ulur masa e pagës referuese, e cila është bazë për llogaritjen e përfitimeve nga ligji. Sipas nenit 4 të ligjit të ri, paga referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas viteve të qëndrimit në atë gradë apo funksion. Ndërsa sipas nenit 5, gërma “b” të ligjit të mëparshëm, paga referuese është paga bazë mujore së bashku me shtesat me karakter të përhershëm, që përfitonte punonjësi në çastin e ndërprerjes së karrierës, por jo më e vogël se paga që ka përfituar në muajin e fundit kalendarik të shërbimit.

3. Është shtyrë koha për fillimin e trajtimit financiar me pagesë kalimtare të punonjësve të policisë. Sipas nenin 12 të ligjit të ri, pikat 1 e 2, pagesa kalimtare fillon pas dy muajsh nga koha që ai nxirret në rezervë apo lirim d.m.th. në muajin e tretë nga data e nxjerrjes në rezervë apo lirim. Ndërsa sipas nenit 6 të ligjit të mëparshëm, trajtimi financiar me pagesë kalimtare fillonte nga data e ndërprerjes së marrdhënieve financiare d.m.th. menjëherë pas nxjerrjes në rezervë apo lirim.

4. Është ulur koha maksimale e trajtimit me pagesë kalimtare. Sipas nenit 12 të tij, pika 3, ajo është bërë deri në 24 muaj (dy vjet), ndërsa sipas nenit 6 të ligjit të mëparshëm, koha maksimale e trajtimit me pagesë kalimtare ishte deri në tre vjet.

5. Është ulur masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Sipas nenit 14, pika 1 e ligjit të ri, pensioni i parakohshëm për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit, është 50 % e pagës mesatare referuese mujore. Ndërsa sipas nenit 12 të ligjit të mëparshëm ajo ishte 50 % e pagës referuese, që sipas nenit 5, gërma “b” të ligjit të mëparshëm, paga referuese është paga bazë mujore së bashku me shtesat me karakter të përhershëm, që përfitonte punonjësi në çastin e ndërprerjes së karrierës, por jo më e vogël se paga që ka përfituar në muajin e fundit kalendarik të shërbimit.

6. Është hequr përfitimi për shpenzimet e varrimit dhe ndihma e menjëhershme për pjestarët e familjes së punonjësit të policisë që nuk është në detyrë në rast vdekje. Sipas nenit 22 të ligjit të ri, këtë të drejtë e përfitojnë pjestarët e familjes së punonjësit të policisë që humb jetën në detyrë apo për shkak të detyrës, d.m.th. kur ai është në detyrë (punë). Ndërsa sipas nenit 11 të ligjit të mëparshëm, këtë të drejtë e përfitonin jo vetëm familjarët e punonjësit të policisë aktiv, por edhe familjarët e punonjësit të policisë në dispozicion, të pezulluar, me pagesë kalimtare, në pension, student, kursant ose ushtar.

7. Sipas nenit 27 të ligjit të ri, nuk përfitojnë nga ky ligj ushtarakët e nxjerrë në lirim, për shkak se janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje.

Përrjashtimi i kësaj kategorie (ushtarakët e dënuar me burgim) për të përfituar nga ky ligj është diskriminues, nuk është i drejtë dhe kushtetues sepse bie ndesh me qëllimin e vetë ligjit. Kuptohet qartë se të gjitha subjektet përfituese nga ky ligj iu garantohen këto përfitime suplementare për shkak të vështirësive të punës e profesionit, rreziqeve të mundshme, të privimit nga shumë të drejtave që gëzojnë kategoritë e tjera të punonjësve, si dhe për shkak se gjatë kohës që ata janë aktiv paguajnë kontribut shtesë në masën 2% të pagës referuese. Përfitimi në këtë rast nuk jepet si shpërblim për “punë të mirë”, “për ndershmëri” dhe “për figurë morale të mirë”, sepse për demonstrimin në punë të këtyre cilësive, jepen dhe aplikohen në mënyrë individuale stimuj material dhe moral për punonjësit. Pra përderisa edhe personat e dënuar me burgim për krime me dashje kanë punuar në të njëjta kushte dhe kanë paguar nga paga e tyre kontribut shtesë njëloj sikurse kolegët e tyre, për rrjedhojë edhe ata duhet të përfitojnë nga ky ligj. Ata, për shkak krimin të kryer nuk mund të rikthehen në vendin e punës dhe të punojnë pas dënimit të tyre në këto struktura, por nuk mund të privohen nga të drejtat social-ekonomike të garantuara nga disa akte normative si:

a) Neni 18/1 i Kushtetutës tonë, sipas te cilit, të gjithë janë të barabartë para ligjit, si dhe me nenin 49/2, sipas të cilit, të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.

b) Nenin 1 i “Deklaratës universale të të drejtave të njeriut”, miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 217 A, të 10 dhjetorit 1948, në të cilën përcaktohet se: “Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikpamja e dinjitetit dhe e të drejtave”.

Gjithashtu, është me rëndësi t’ju bëjmë me dije se një mohim i të njëjtës natyrë të kësaj të drejte ka patur edhe ligji nr. 8087, dt. 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar me ligjin nr. 8521, dt. 30.07.1999. Sipas këtij ligji nuk përfitonin këto të drejta ushtarakët e liruar me motivacionin “për braktisje detyre”. Mirëpo me rekomandimin e Avokatit të Popullit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 8948, dt. 03.10.2002, bëri ndryshimin në nenin 19/1 të ligjit të cituar më sipër, duke hequr shprehjen “për braktisje detyre” dhe shtuar një paragraf, i cili i jep fuqi prapavepruese kësaj dispozite.

Heqjen nga ligji të dispozitave përjashtuese nga përfitimi i të drejtave shoqërore suplementare ne e kemi patur objekt të punës tonë edhe vitin e kaluar, lidhur me nenin 21 të ligjit nr. 8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”. Sipas kësaj dispozite, nuk përfitonin të ardhura suplementare punonjësit e policisë të përjashtuar nga policia për braktisje të detyrës ose që janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë. Meqënëse kishte kaluar afati për t’u drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ne i bëmë rekomandim Kuvendit për shfuqizimin e kësaj dispozite. Mirëpo megjithse me ne u bashkua edhe një grup prej 12 deputetësh që paraqiti projektligjin, Kuvendi nuk arriti ta merrte në shqyrtim atë.

8. Në nenin 29 të ligjit të ri është parashikuar rillogaritja e pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të caktuar me ligjin nr. 8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

Kjo dispozitë ju mohon në mënyrë të hapur të drejtat e njohura dhe përfituara nga ligji i mëparshëm apo nga vendimet e gjykatave për një numër të konsiderueshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët janë nxjerrë në lirim për shkak të reformës në Policinë e Shtetit dhe trajtohen me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, me pension suplementar apo me vendime gjyqësore.

Në bazë të nenit 142/3 të Kushtetutës, organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore. Ndërkoh kujtojmë se në

asnjë akt normativ që ka fuqi në Republikën e Shqipërisë nuk është parashikuar që vendimet gjyqësore të shfuqizohen me ligj. Ato mund të ndryshohen dhe shfuqizohen vetëm nga gjykatat më të larta.

Ne gjykojmë se dispozitat e këtij ligji çenojnë rëndë një nga parimet e rëndësishme të ndërtimit dhe funksionimit të shtetit të së drejtës, atë të sigurisë juridike, për të drejtat e fituara dhe të besimit të qytetarëve të shteti, parim që është sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës tonë. Ky parim mund të preket vetëm në raste përjashtimore, kur është fjala për të mbrojtur një interes publik. Në këtë rast nuk ndodhemi në kushte të tilla, sepse nuk kemi asnjë interes publik të cënuar nga përfitimet e mëparshme të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Në të njëjtën kohë dispozitat e ligjit të ri shkelin hapur të drejtën kushtetuese të barazisë para ligjit dhe atë të mbrojtjes shoqërore në punë e të punësuarve, të garantuara nga neni 18/1 dhe 49/2 të Kushtetutës tonë.

Gjithashtu konstatojmë se ligji i ri vjen në kundërshtim edhe me frymën e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë të shprehur në mënyrë të qartë në disa vendime të saj. Kështu mund të përmëndim:

Në vendimin nr. 9, datë 26.02.2007, të Gjykatës Kushtetuese, në një çështje analoge si kjo (fuqia prapavepruese e një ligji për sigurimet shoqërore suplementare lidhur me të drejtat që janë njohur), theksohet se: “Si element i shtetit të së drejtës, siguria juridike presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë ose për pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të çenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme”. “Duke qënë se një ndër elementët më thelbësorë të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, del se rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojë përmirësimin dhe rritjen e standarteve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarësyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të

ndërtimit të shtetit të së drejtës”. Gjithashtu në këtë vendim gjykata thekson se: “Duke i dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, do të çenohet parimi i sigurisë juridike dhe, rrjedhimisht, do të shkelet parimi i shtetit të së drejtës. Cënimi i parimit të sigurisë juridike bëhet veçanërisht më i ndjeshëm në marrëdhëniet e sigurimeve shoqërore të disa kategorive punonjësish, me qenë se kjo marrëdhënie mbështetet në strukturën ligjore të mbajtjes së besimit dhe në bindjen e të siguruarve për seriozitetin dhe korrektësinë e shtetit”.

Kujtojmë se për parimin kushtetues të sigurisë juridike për të drejtat e fitura, Gjykata Kushtetuese është shprehur në favor të tij edhe në vendimin nr. 26, dt. 02.11.2005; nr. 36, dt. 15.10.2007, ku thekson se: “Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarësyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre”.

Lidhur me parimin e barazisë, Gjykata Kushtetuese në këtë vendim shprehet se: “Respektimi i parimit të barazisë kërkon ndërmjet të tjerave mosdiskriminimin e grupeve në kushte të njëjta të shtetasve pa arsye të përligjura. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhet trajtim i diferencuar kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet”.

Në vendimin nr. 11, dt. 27.08.1993, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk parakupton zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme, por ajo parakupton kryesisht barazinë e individëve që ndodhen në kushte të njëllojta”. Në rastin që po shqyrtojmë janë barazuar në trajtim kategori punonjësish që ndodhen në kushte të ndryshme pune dhe ndërkohë diferencohen në trajtim individ që janë në kushte të njëjta pune.

Në vendimi nr. 34, datë 20.12.2005 Gjykata Kushtetuese thekson se: “Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në Preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues”.

Në vendimin e saj nr. 1 datë 31.01.2003, Gjykata Kushtetuese është shprehur se sa i takon “...nacionit të fuqisë prapavepruese, doktrina ka pranuar se kjo është e pranishme në rastet kur një normë ligjore aplikohet

për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cënon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese”.

Nga analiza e fakteve të pëshkruara më lartë rezulton, se disa dispozita të ligjit nr. 10142, dt. 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” vijnë në kundërshtim të hapur me frymën e Kushtetutës dhe disa vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, duke shkelur hapur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit të cilat ata i kanë përfituar më parë. Dispozitat e tij nuk respektojnë kërkesat kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të fituara, por cënojnë pozitën juridike të punonjësve të Policisë së Shtetit në detyrë, në pension të parakohshëm dhe të atyre që përfitojnë pension suplementar duke prekur nevojat jetike të tyre. Ligji i mëparshëm nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit” dhe ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” kishin përcaktuar një pozitë ekonomiko-financiare më të favorshme. Ndërsa ligji objekt shqyrtimi ndryshon disa kriterë përfitimi duke i përkeqësuar ato dhe mohon ose cënon disa të drejta të përfituara më parë me ligj, megjithse kushtet e subjekteve përfituese mbeten të pandryshueshme. Gjithashtu ligji i ri barazon në trajtim punonjësit e Policisë së Shtetit me ushtarakët etj, ndërkohë që ata nuk kanë kushte pune e vështirësie të njëjta. Gjithashtu ai diskriminon hapur ata punonjës që janë dënuar duke ju dhënë një dënim tjetër kryesor, të pa caktuar me ligj.

Në kuadër të sqarimit të rrethanave kushtetuese dhe ligjore të legjitimitetit të Avokatit të Popullit në cilësinë e kërkuesit pranë Gjykatës Kushtetuese për çështjen konkrete, referuam argumentat si më poshtë vijon:

1. Avokati i Popullit mban në konsideratë gjatë parashtrimit të kësaj kërkesë rolin dhe kompetencat e tij që burojnë nga neni 60 i Kushtetutës dhe ligji nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Per Avokatin e Popullit” (i ndryshuar). Konstatohet se këto kompetenca janë gjithashtu në përputhje me nenin 49 pika 2 e ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

2. Me ndryshimet e reja në ligjin nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me anë të ligjit nr. 9398 dt. 12.05.2005, Avokatit të Popullit ju njoh e drejta për të marrë në shqyrtim raste të tilla, duke shfuqizuar paragrafin e dytë të nenit 25, ku ligji dhe aktet e tjera normative ishin jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit.

3. Kërkuesi ka ardhur në dijeni për çështjen e mësipërme nga ankesat që i kanë drejtuar Sindikata e Policisë së Shtetit dhe disa punonjës policie në detyrë dhe të liruar (në rezervë) për shkeljen e të drejtave kushtetuese e ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit nga ligji nr. 10142, dt. 15.05.2009.

4. Në çështjen në shqyrtim, Avokati i Popullit vëren se interesi i tij për të ndërhyrë me mjetet e njohura nga ligji, është korrigjimi i përmbajtjes antikushtetuese të dispozitave të ligjit nr. 10142, dt. 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, e cila krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera. Ky interes i kërkuesit në kontekstin kushtetues, gjen gjithashtu përputhje të plotë me vendimin interpretues të Gjykatës Kushtetuese nr. 49 dt. 31.07.2000.

Në këto kushte, në bazë të nenit 131, gërma “a”, 134, gërma “dh” të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 24, gërma “c” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” (i ndryshuar), kemi kërkuar

1. Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të ligjit nr. 10142, dt.15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim parandalimin e pasojave që mund të vijnë nga zbatimi i menjëhershëm i dispozitave të këtij ligji.

2. Shfuqizimin e neneve 3/3; 4/2; 12/1,2,3; 14/1; 22; 27 dhe 29/2 të ligjit nr. 10142, dt.15.05.2009, si të papajtueshëm me Kushtetutën, ligjin nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit” dhe ligjin nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” sepse çënojnë rëndë të drejtat ekonomiko-financiare të punonjësve të Policisë së Shtetit të përfituara me aktet normative të mëparshme.

Kjo çështje u shqyrtua në seancë të hapur në Gjykatën Kushtetuese më datën 12 nëntor 2009, por gjykimi do të vazhdojë sepse Gjykata i ka kërkuar Kuvendit të Shqipërisë t’i dërgojë dokumentacionin e procedurës së zhvilluar për miratimin e këtij ligji.



#### **IV. Kërkesa e paraqitur më datën 11.09.2009 objekt:**

Shfuqizimin, si antikushtetues te gërmes “ç”, te pikes 1, te nenit 16, dhe heqjen e fjales “kryesisht” nga paragrafi i dyte i nenit 18 te Ligjit nr.9235, dt.29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e prones”, ndryshuar me nenin 1/ “ç” dhe me paragrafin e dyte te nenit 2 te Ligjit nr.9684, dt.06.02.2007 “Per ndryshime ne ligjin nr.9235, dt.29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e prones”.

Kjo kërkesë u argumentua si vijon:

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka administruar ne vijim disa ankesa qe kane te bejne me permbajtjen e gërmes “ç”, te pikes 1, te nenit 16, te Ligjit nr.9235, dt.29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e prones”, ndryshuar me nenin 1/ç, te Ligjit nr.9684, dt.06.02.2007 “Per ndryshime ne ligjin nr.9235, dt.29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e prones””, ne te cilin parashikohet se : “Zyra e AKKP-se ne qender ka keto pergjegjesi :...ç) mund te shqyrtoje, me nismen e vet, vendimet e dhena nga zyrat rajonale te AKKP-se ne qark apo ish komisionet vendore per kthimin dhe kompensimin e pronave dhe te ish komisioneve te rretheve ose bashkive per kthimin ose kompensimin e pronave ish pronareve”. Ne zbatim te pergjegjesive te veta per kompensimin, zgjidhjen e ankimeve dhe shqyrtimin kryesisht te vendimeve te dhena nga zyrat rajonale te AKKP-se ne qark apo ish komisionet vendore per kthimin dhe kompensimin e e pronave dhe te ish komisionet e rretheve ose bashkive per kthimin ose kompensimin e pronave ish pronareve, Drejtori i Pergjithshem i AKKP-se shprehet me vendim”.

Duke shqyrtuar keto pretendime. Institucioni i Avokatit te Popullit gjykon se:

#### **1. Ligji i kontestuar ne dispozita te veçanta, eshte ne kundërshtim parimin e sigurise juridike.**

Neni 10 i Ligjit te lartpermendur, cenon elementet dhe tiparet themelore te parimit te sigurise juridike, krijon pasiguri per nje mase shume te madhe pronaresh, humbet besueshmeria e shtetasve tek shteti, nuk jep garanci per vijueshmeri dhe per ndryshime legjislacioni ne perputhje me Kushtetuten.

Me ligjin nr.9235, dt.29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e prones”, i ndryshuar, shume subjekte kane fituar te drejten e kthimit te prones tek te shpronesuarit nga sistemi i kaluar.

Ndersa me ndryshimet e bera Ligjit, dispozita te te cilit kontestohen per papajtueshmeri me Kushtetuten, organet administrative kane te drejten te verifikojne, shqyrtojne dhe anullojne njohjen dhe kthimin e pasurise se paluajtshme. Ligjvenesit nuk mund te perkeqesoje ne menyre te paarsyeshme gjendjen ligjore te personave, te mohojte te drejtat e fituara ose te shperfillte interesat legjitime te tyre. Nderkohe qe, ligji

duhet te garantoje siguri, qartesi dhe vazhdimesi ne menyre qe individet t'i drejtojne veprimet e tyre ne menyre korrekte e ne perputhje me te dhe, nga na tjeter, vete ligji te mos qendroje statik nese duhet t'i jape forme nje koncepti, siç eshte ai i drejtesise, ne nje shoqeri qe ndryshon me shpejtesi. Çdo shoqeri qe synon nxitjen dhe mbrojtjen e te drejtave te njeriut, ka si parim thelbësor epersine e ligjit. Rregullime ligjore mund te kryhen vetem ne perputhje me nje procedure te percaktuar me pare dhe pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese. Parimi i sigurise juridike duhet respektuar nga te gjitha institucionet dhe se pari nga vete Kuvendi. Nje fakt i tille konfirmohet edhe nga Gjykata Kushtetuese ne vendimin e saj nr.9, date 26.02.2007.

Ndryshimet e bera ne Ligjin nr.9235, dt.29.07.2004, bejne pikerisht te kunderten e kesaj kerkese te parimit te sigurise juridike duke perkeqesuar ne menyre te paarsyeshme gjendjen ligjore te shtetasve, pasi krijon mundesi qe t'i heqe atyre te drejten e prones. Neni 16/”ç” dhe fjala “kryesisht” ne nenin 18/paragrafi i dyte, ne Ligj, krijon bazen ligjore te heqjes se titullit te pronesise, te dhene qe para shume vitesh. Ligji nuk merr parasysh afatet e parashkrimit te padise, neni 103 i Kodit Civil, dhe ato per fitimin me parashkrim fitues te prones, me mirebesim dhe ne baze te nje veprimi juridik qe nuk eshte i ndaluar nga ligji (neni 168 po i Kodit Civil). Parimi i sigurise juridike cenohet, perveç sa me lart, edhe per faktin se Ligjit i eshte dhene fuqi prapavepruese. Ndryshimet e bera, vendosin parametra antikushtetuese per vlefshmerine ose jo, te vendimeve te ish KKKP-ve ne komuna, bashki dhe ish keshilla rrethesh, duke anashkaluar kriteret e pavlefshmerise se veprimeve juridike dhe te pasojave, te parashikuara ne nenet 92-111 te Kodit Civil. Dhenia e fuqise prapavepruese ketyre neneve, te vendosjes se shqyrtimit administrativ mbi vendimet gjyqesore te formes se prere, perkeqeson gjendjen juridike te pronareve, sepse as parashkrimi fitues nuk i mbron nga veprimet dhe vendimet arbitrare te Drejtorit te Pergjithshem te AKKP-ve.

**2. Ligji eshte ne kundërshtim edhe me nenin 7 te Kushtetutes,** norme qe parashikon nje nga parimet baze mbi te cilin organizohet dhe funksionon nje shtet me tipare demokratike, ate te ndarjes dhe ballancimit te pushteteve:

“Sistemi i qeverisjes ne Republiken e Shqiperise bazohet ne ndarjen dhe balancimin ndermjet pushteteve ligjvenes, ekzekutiv dhe gjyqesor”.

Me kete nen, pushteti kufizohet, kontrollohet dhe ndahet midis organeve te ndryshme sipas funksioneve te ndryshme; çdo organi kushtetues i jepet nje funksion i qarte aktiv dhe njekohesisht parandalohen abuzimet e ndryshme. Dhenia e drejtesise eshte e ndare nga organet dhe drejtuesit e organeve qe marrin vendime me karakter politik, qofshin te pushtetit ekzekutiv apo legjislativ. Klasifikimi i pushteteve e

mbron shtetasin nga arbitrariteti dhe i lehtëson atij njekohesisht të kuptuarit e procesit të qeverisjes. Vetëm fakti, që organet ekzekutive kanë marrë kompetencat e pushtetit gjyqësor, është i mjaftueshëm për t'i shpallur si antikushtetuese ndryshimet në Ligjin nr. 9235, dt. 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës". Ligji nuk dallon as ato raste kur gjykatat janë duke shqyrtuar kundërshtimet e vendimeve të AKKP-ve. Në këto kushte vështirohet përfundimi i proceseve gjyqësore, krijohen zvarritje dhe, me e keqja, regjistruesi i ZRPP-se mund të bëjë fshirjen e pronësive në regjistrat përkatës në bazë të vendimeve të dhëna nga AKKP.

Duke ja deleguar të drejtën e konstatimit të vlefshmërisë ose jo, të vendimeve të AKKP-se dhe të ish KKKP-ve, ligji e vë pushtetin gjyqësor në pozitën e rivefikuesit të pavlefshmërive të titujve të pronësive, duke denaturizuar arsyen e ekzistencës së tyre dhe shkelur rëndë parimin e ndarjes dhe ballancimit të pushteteve. Në këtë mënyrë krijohet një precedent i ri, tepër negativ, që për arsye të ndryshme të çelën, herë pas here, procedura rishqyrtimi dhe rivefikimi për shumë raste të tjera. Nga ana tjetër Ligji penalizon mbajtësin e titullit të pronësive për gabime apo shtremberime në zbatimin e ligjit nga ish komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave apo AKKP-ja e tanishme, që bie ndesh me funksionimin normal të shtetit të së drejtës dhe për garantimin e të drejtave dhe lirive të individit.

Keto garanci janë jo vetëm në kuptimin procedural por edhe në kuptimin thelbësor të atyre çështjeve që i paraqiten.

**3. Ligji është në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës** në të cilin parashikohet mbrojtja dhe garantimi I një prej të drejtave themelore të njeriut, ajo e pronës private.

“1) E drejta e pronës është e garantuar

2) Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil

3) Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike”

Pronësia, si një e drejtë për të gezuar dhe disponuar lirirrisht sendin, brenda kufijve të caktuar nga ligji, si një marrëdhënie juridike civile pasurore, është jo vetëm një nga të drejtat me kryesore të njeriut, një nga mënyrat e begatimit të tij dhe që mbart një bagazh të madh trajtimi teoriko-juridik por edhe elementi bazë i një shoqërie demokratike të bazuar në ekonomine e tregut të lirë dhe të konkurrencës së ndershme. Si e tillë prona ka garancinë e një mbrojtjeje të vecantë në Republikën e Shqipërisë, në atë masë, parametra dhe mjete ligjore si në të gjitha vendet e tjera të zhvilluara. Ligjvënësi, për keto dhe shkaqe të tjera, nuk ka bërë dallim në Kushtetute, pjesë I takon mbrojtjes nga çdo dhunim, midis pronës private dhe asaj shtetërore ose publike.

Ne nenin 153 te Kodit Civil, ne menyre taksative parashikohet : “Askush nuk mund te shpronosohet ose t’i kufizohet e drejta e ushtrimit te se drejtes se prones qe barazohet me shpronosimin, pervecse kete kur e kerkojne interesat publike dhe kurdohere kundrejt nje shpreblimi te plote dhe paraparak”.

Ka shume subjekte qe kane fituar te drejten e prones se shpronosuar, te shtetezuar apo konfiskuar ne vite, edhe me vendime gjyqesore te formes se prere, per ndryshimin apo anullimin e vendimit te AKKP-se apo KKKP-se. Edhe ne keto raste, Ligji tregon prepotence, me shfuqizimin qe ju ben faktikisht, vendimeve gjyqesor te formes se prere.

Kushtetuta, ka epersine e dispozitave te saj ndaj atyre ligjore, permban ate qe konsiderohet kushtetutshmeri dhe hierarki te rendit juridik. Ligjshmeria nenkupton ndertimin e raporteve te vecanta midis pushtetit dhe shtetasve ne baze te ligjit, garantimin e te drejtave te njeriut, respektimin e ligjit edhe nga organet e administrates shteterore. Neni 296 I Kodit Civil, sanksionon qe : “Pronari ka te drejte te ngreje padi per te kerkuar sendin e tij nga çdo posedues apo mbajtes. Kete te drejte e ka dhe çdo bashkepronar per sendin e p[er]bashket, me qellim qe ai ti dorezohet gjithë bashkepronareve”.

#### **4. Ligji eshte ne kundërshtim edhe me nenin 42/2 te Kushtetutes,**

1) Liria, prona dhe te drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligji nuk mund te cenohen pa nje proçes te rregullt ligjor.

2) Kushdo, per mbrojtjen e te drejtave, te lirive dhe te interesave te tij kushtetues dhe ligjore, ose ne rastin e akuzave te ngritura kunder tij, ka te drejten e nje gjykimi te drejte dhe publik brenda nje afati te arsyeshem nga nje gjykate e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”

Keshtu garantohet nderhyrja e pushtetit gjyqesor per te mbrojtur te drejtat, lirite dhe interesat kushtetuese dhe ligjore te individeve. Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.32, te vitit 2003, ka konstatuar se, kontrolli gjyqesor ndaj akteve me karakter administrativ, duke qene shprehje e parimit te kontrollit dhe ballancimit te pushteteve e duke qendruar ne themel te pavaresise se organeve, ka ndryshime thelbesore nga kontrolli administrativ qe kryhet ne rruge hierarkike apo nga organe te krijuara posaçerisht. Aksesit per t’iu drejtuar gjykates eshte nje nga elementet e se drejtes per nje proçes te rregullt gjyqesor. Individet nuk mund te cenohen ne te drejten e tyre te pronesise me nje akt administrativ dhe jo si rezultat i nje vendimi gjyqesor. Juridiksioni dhe kompetencat e sistemit gjyqesor nuk mund te merren ne menyre arbitrare nga pushtetet te tjera. Prandaj çdo individ qe ka patur dhe ka pretendime per prona te fituara “padrejtësisht”, e ka patur dhe e ka te hapur deren e gjykates per te kerkuar te drejtat qe pretendon. Pra nuk ka pse te legjitimohet administrata te beje “drejtësi” ne nje kohe qe çdo pretendues per çeshtje

me kete objekt mund t'i drejtohet gjykates per te shqyrtuar kerkesat e tij. Ne gjykimin tone, funksioni i Drejtorit te Pergjithshem te AKKKP-se, nuk permbush kriteret e nenit 42 pika "2" te Kushtetutes dhe nenit 6/1 te Konventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut per te qene "gjkate e pavarur dhe e paanshme" qe te mund te ushtroje kompetencen e rishikimit te vendimeve administrative. Gjykata e te Drejtave te Njeriut ne Strasbourg ne çeshtjen "Dauti kunder Shqiperise", nder te tjera ka trajtuar edhe kriteret qe duhet te permbushe nje autoritet per t'u vleresuar si gjkate e pavarur dhe e paanshme.

**4. Neni 15/1** i Kushtetutes sanksionon se:

"Te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te padnashme, te patjetersueshme e te padhunueshme dhe qenrojne ne temel te te gjithe rendit juridik.

Organet e pushtetit publik, ne permbushje te detyrave te tyre,duhet te respektojne te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, si dhe te kontribuojne ne realizimin e tyre."

Gjate gjithe segmentit kohor nga nxjerrja e aktit administrativ deri ne ekzekutimin e tij,organi kompetent ka te drejte ta revokoj apo shfuqizoj ate.Akti administrativ i Komisionereve te Kthimit te Pronave, i ka sjelle pasojat e tij juridike me regjistrimin e pasurive te paluajtshme te kthjera, ne ZRPP te rrethit.Ne kete moment, akti administrativ nga nje marredhenje juridike individ-administrate publike, shnderrohet ne nje marredhenje juridike pronesie, midis te njejtit individ dhe prones.Ketu eshte edhe kufiri qe e ndan proçeduren administrative, pushtetin ekzekutiv nga pushteti tjetër, ai gjyqesor.

**6. Neni 17** i Kushtetutes parashikon se:

Kufizime te te drejtave dhe lirive te parashikuara ne kete Kushtetute mund te vendosen vetem me ligj per nje ineteres publik dhe per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve.Kufizimet duhet te jene ne perpjestim me gjendjen qe e ka diskutuar ate.

Keto kufizime nuk mund te cenojne thelbin e lirive dhe te drejtave dhe ne asnje rast nuk mund te tejkalojne kufizimet e parashikuara ne Konventen Evropiane per te Drejtat e Njeriut".

Ne kete menyre disiplinohen kufizimet qe mund t`u behen te drejtave dhe lirive kushtetuese te individeve, kufizime qe nuk mund te cenojne thelbin e te drejtave,ku e drejta e prones eshte nga me thelbesoret.

**7.Neni 5** i Kushtetutes afirmon qarte faktin qe:

"Republika e Shqiperise zbaton te drejten nderkombetare te detyrueshme per te".

Me ratifikimin e Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut, kjo e fundit eshte inkluduar ne legjislacionin tone te brendshem, te detyrueshem per zbatim. Ne nenin 1, te Protokollit nr.1 te Konventes,

parashikohet qe çdo person fizik apo juridik ka te drejten qe t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund te privohet nga prona e tij, perveçse per arsye te interesit publik dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare. Protokolli 1 i Konventes Europiane per te Drejttat e Njeriut, garanton te drejten e garantimit te pacenueshem te prones, qe ne rastin konkret eshte anashkaluar.

Ndryshimet e bera ne Ligjin "Per kthimin dhe kompensimin e prones", jane nje shembull i qarte, se si nuk duhen bere korrigjime te gabimeve (nese ka te tilla) me pronat e paluajtshme, me norma te reja ligjore teresisht antikushtetuese. Nje gje e tille eshte shpronasim i ri i ish pronareve.

Ne keto kushte, ne baze te nenit 131, germa "a" te Kushtettes se Shqiperise dhe nenit 24, germa "c" te Ligjit nr.8454, dt.04.02.1999 "Per Avokatin e Popullit", i ndryshuar: Avokati i Popullit ka kerkuar

Shfuqizimin si antikushtetues te gemes "ç", te pikes 1, te nenit 16, dhe heqjen e fjales "kryesisht" nga paragrafi i dyte i nenit 18 te Ligjit nr.9235, dt.29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e prones", ndryshuar me nenin 1/ "ç" dhe me paragrafin e dyte te nenit 2 te Ligjit nr.9684, dt.06.02.2007 "Per ndryshime ne ligjin nr.9235, dt.29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e prones".

Kjo çështje u shqyrtua në seancë të hapur në Gjykatën Kushtetuese më datën 24 nëntor 2009, por vendimi përfundimtar i saj nuk është dhënë akoma.

## 6. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun

Themeluesit e konceptit modern të Marrëdhënieve me Publikun, Edward Bernays dhe Iv Lee, qysh në fillim te viteve 1900 i përkufizuan ato si menaxhim të qëndrimeve publike për të përçaruar politikën, procedurat dhe interesat e një organizate tek masa e gjerë e popullit. E gjitha kjo strategji kërkon edhe një plan veprimi, përmes të cilit synohet të arrihet mirëkuptimi i publikut si dhe pranueshmëria prej tij.

Nëse ka një institucion, i cili i ka marrëdhëniet me publikun përmes medias, pjesë jetike dhe kusht të domosdoshëm për të justifikuar ekzistencën e tij, ai është Avokati i Popullit. Në të gjitha forumet ndërkombëtare për Institucionin e Ombudsmanit, thuhet rëndom se "një Ombudsman i panjohur nuk mund të jetë Ombudsman". Kjo lidhet së pari me informacionin që Zyra e Avokatit të Popullit duhet t'i përçojë publikut. Qëllimi nuk është vetëm informimi i publikut me atë çka bën kjo zyrë, por mbi të gjitha informimi i publikut për ta ndërgjegjësuar atë me të drejtat e tij si taksapagues, që do të thotë brendësimi i tij me

ndërgjegjen qytetare për të qenë gjithmonë e më kërkues ndaj shtetit të tij. Faktori i dytë është forca e moderuar imponuese e Avokatit të Popullit. Jemi të ndërgjegjshëm se në një mjedis institucional deficitar përsa i përket ndërgjegjes ligjzbatuese, stokut të vendimeve të pazbatuara gjyqësore, nuk është e vështirë t'i shtohen edhe disa apo shumë rekomandime të pazbatuara të një Institucioni joimponues, sikurse është Avokati i Popullit. Arsyeja është e thjeshtë: Rekomandimi, si instrumenti thelbësor i Avokatit të Popullit përfaqëson në vetvete raportin midis efektivitetit dhe efikasitetit. E shprehur në termat e doktrinës juridike, kjo do të thotë se rekomandimi i Avokatit të Popullit është efikas dhe frutdhënës, edhe pa qenë nevoja të jetë efektiv, në kuptimin e prodhimit të efekteve juridike, sikundër prodhon, fjala vjen, vendimi i gjykatës ose një urdhër administrativ i organeve më të larta ndaj atyre më të ulëta në hierarkinë e administratës shtetërore.

Kjo kushtëzon në një masë të madhe edhe detyrimin e Avokatit të Popullit për të përdorur si mjet shtesë, fuqinë e medias dhe të shtypit. Thënë ndryshe, kemi të bëjmë me një bashkëpunim të detyruar midis rojtarëve publikë dhe mbrojtësit të qytetarëve. Kjo do të thotë se fusha e veprimit është e njëjtë, publiku. Dhe rruga për tek ai, natyrshëm, kalon përmes një mediumi apo ndërmjetësi që është shtypi.

Teknikat e përdorura për të kaluar informacionin nga Avokati i Popullit tek gazetari kanë qenë të larmishme. Së pari, Avokati i Popullit ka synuar të qartësojë median se ai nuk është një burim nga i cili pritet të dalin lajme sensacionale. I ndërgjegjshëm për postulatit informativ “lajm i mirë është lajmi i keq”, Avokati i Popullit nuk ka nguruar ta lançojë “lajmin e keq”, por gjithmonë vetëm pasi ai të ketë kaluar nëpër procedurën e një investigimi profesional.

Ne tashmë prej vitesh funksionojmë mbi bazën e një strategjie të hartuar në detaje, e cila ka parashikuar edhe promovimin e funksionit tonë, edhe atë të të drejtave të njeriut që ne mbrojmë, edhe rrugët dhe mënyrat e komunikimit tonë të përditshëm me Median. Duke synuar njohjen tonë nga publiku, qëllimi ka qenë dhe mbetet rritja e autoritetit të Institucionit të Avokatit të Popullit në të mirë të zgjidhjes sa më të shpejtë të problemeve që qytetarët ngrejnë pranë këtij Institucioni. Konkretisht, duke pasuruar më tej faqen tonë të Internetit, ne mendojmë se kemi vënë në dispozicion të publikut dhe gazetarëve të gjithë problematikën tonë të ditës. Nga ana tjetër, këtë vit kemi vazhduar shpërndarjen e pesë fletëpalosjeve të përditësuar, të qëllimuar për grupe të popullsisë në përgjithësi si dhe për grupe të veçanta, sikurse janë të burgosurit, policia, forcat e armatosura, gratë, fëmijët dhe nëpunësit publikë.

Praktika na ka mësuar se marrëdhëniet me median duhen menaxhuar me qartësi dhe gjakftohtësi, që do të thotë edhe informim intensiv i publikut mbi gjithçka të prodhuar nga Zyra jonë, por edhe

kujdes për të mos rënë në protagonizëm të pajustificuar, kur dhënia e informacionit bëhet qëllim në vetvete dhe rrezikon të komprometojë marrëdhëniet institucionale si me qytetarët, ashtu dhe me përfaqësuesit e institucioneve të tjera, karshi të cilëve ata presin qëndrimin ndërmjetësues të Avokatit të Popullit.

Efekti i parandalimit vlen edhe për uljen e rasteve që paraqiten në Gjykata, e për pasojë edhe të ngarkesës së punës së tyre, mjaft që qytetarët të orientohen për të shteruar të gjitha rrugët e ankimimit administrativ.

Në tabelat përkatëse të paraqitura në fund të këtij raporti, për mbulimin mediatik të veprimtarisë tonë, viti 2009 paraqitet me një mbulim mediatik të dendur, referuar kjo si medias së shkruar, ashtu edhe asaj elektronike. Kështu, gjatë vitit 2009, Avokati i Popullit dhe problematika e ndjekur prej tij ka qenë e pranishme 370 herë në median e shkruar dhe 97 herë në atë elektronike, ndërkohë që, për vitin 2008, ka qenë respektivisht 299 herë në median e shkruar dhe 106 herë në atë elektronike.

Për t'iu rikthyer bashkëpunimit tonë me median, ritheksojmë faktin se mediat dhe shtypi i përditshëm përbën burimin tonë më të sigurtë për vjeljen e informacionit me interes publik, gjë që na jep edhe mundësinë për të filluar çështje ex officio, pra me iniciativë. Kontrolli i imtë i shtypit të përditshëm ka qenë dhe mbetet detyrë parësore, jo vetëm për personin që e mbulon këtë fushë, por edhe për të gjithë të tjerët, të cilët nuk mund të qëndrojnë indiferentë ndaj problemeve që ngre shtypi dhe gazetarët, të cilët ne i kemi konsideruar sikurse ata janë, pra “rojtare publikë” dhe “avokatë në terren” të të drejtave të qytetarëve.

Përfundimisht, tabloja e vërtetë e kësaj pranie mediatike del e qartë, qoftë edhe duke i hedhur një sy titujve të shtypit të shkruar dhe atij televiziv. Për këtë mund t'u referoheni tabelave përkatëse të mbulimit mediatik të Institucionit, pa komente, që ndodhen në fund të këtij Raporti.

## **a) Sektori i pritjes së popullit**

### **1. Organizimi i punës**

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, që prej vitit 2001 funksionon me sukses Sektori i Pritjes së Popullit. Kjo zyrë u krijua për përbalimin në vazhdimësi të fluksit në rritje të individëve, të cilët paraqiten pranë nesh për të parashtruar ankesa, kërkesa, apo njoftime në lidhje me shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre. Ky shërbim ndaj qytetarëve vazhdon me ritme të larta dhe ka krijuar një fizionomi pozitive për institucionin e Avokatit të Popullit, duke u shfaqur më afer ankuesve dhe duke i orientuar drejtë ata për zgjidhjen e problemit të tyre.



Për këtë një nga juristët e institucionit tonë, në një zyrë të posaçme, lehtësisht të arritshme për qytetarët, pret në çdo kohë gjatë orarit zyrtar, pa pengesa, me kulturë e profesionalizëm, ankesat e individëve të ndryshëm. Duke u udhëhequr nga motoja e Institucionit tonë “Avokati i Popullit- një dere e hapur për ju”, kjo zyrë u mundëson qytetarëve që paraqiten për ankesa apo kërkesa, të ndjehen të mirëpritur dhe të përfitojnë në kohë të shkurtër, shërbimet që mund t’u ofrojë institucioni ynë.

Duke koordinuar punën edhe me pjesëtarë të tjerë të stafit, është arritur që ky shërbim të vijë gjithnjë në rritje për nga cilësia dhe profesionalizmi. Ai ka rritur besimin tek qytetarët dhe për rrjedhojë numri i ankesave dhe kërkesave shtohet nga viti në vit.

Spektori i Pritjes së Popullit, si pikë takimi e parë e Marrëdhënieve me Publikun, ka ofruar shërbimin e tij, si nëpërmjet përpilimit të ankeses apo kërkesës që individë të ndryshëm parashtrajnë, ashtu dhe nëpërmjet këshillimeve ose orientimeve ligjore profesionale që ata kërkojnë, kur çështja që parashtrohet prej tyre nuk është objekt i veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Përveç materialeve të gatshme, të prodhuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, që ndodhen në dispozicion të qytetarëve, këtyre të fundit u ofrohet informacioni i kërkuar dhe njohja me legjislacionin në fuqi, si dhe u jepen sqarime të mëtejshme për rrugën që ndiqet pas ankesës së bërë.

Nëpërmjet sqarimeve me gojë dhe përgjigjeve me shkrim ne kemi mundur t’u vijme në ndihmë qytetarëve, me synimin për të eliminuar sa më shumë sorollatjet e tyre në dyert e Administratës Publike, ku shpesh hasin mjaft pengesa burokratike. E gjithë kjo procedurë, direkt në kontrollin dhe kujdesin e Avokatit të Popullit, rrit besimin te qytetarët dhe bën të mundur shtimin e ankesave apo këshillimeve nga viti në vit. Ngarkesa e punës e kesaj njësie paraqitet si më poshtë:

## **2. Statistikat përmbledhëse**

Gjatë vitit 2009, numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Pritjes së Popullit, është **1547 ankesa apo kërkesa**. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimit të atyre që kanë qenë brenda juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit.

<b>Muaji</b>	<b>Ankesa gjithësej</b>	<b>Ankesa për tu shqyrtuar</b>
Janar	127	73
Shkurt	119	64
Mars	155	77
Prill	161	68
Maj	143	61
Qershor	135	57
Korrik	84	39
Gusht	29	19
Shtator	120	55
Tetor	196	91
Nëntor	161	69
Dhjetor	117	51
<b>Totali</b>	<b>1547</b>	<b>724</b>

Siç mund të shikohet nga numri i përgjithshëm i ankesave ose kërkesave verbale që janë paraqitur pranë Zyrës së Pritjes së Popullit, janë pranuar për shqyrtim 724 ankesa apo kërkesa të cilat u janë bashkuar ankesave, kërkesave apo njoftimeve të tjera që i janë dërguar Avokatit të Popullit me letra, fax, telegram etj. Këto gjejnë pasqyrim në pjesë të tjera të raportit sipas fushave dhe organeve të administratës publike.

Zyra e Pritjes së Popullit në përmbushje të detyrave të saj funksionale gjatë vitit 2009, ka pritur, këshilluar, orientuar dhe kthyer përgjigje të menjëhershme 823 kërkesave dhe ankesave të paraqitura verbalisht. Është konstatuar se këto ankesa apo kërkesa kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit. Megjithatë të gjithë këtyre individëve ju është dhënë një këshillim profesional, mbi rrugën ligjore dhe institucionale që duhet të ndjekin dhe afatet që duhen të respektohen për zgjidhjen e ankesës së tyre.

### **3. Problematikat e shfaqura**

Ashtu si edhe vitin e kaluar Sektori i Pritjes së Popullit, ka evidentuar e monitoruar me kujdes, problematikat e ankesave që individë të ndryshëm kanë paraqitur, por që nuk janë pranuar për shqyrtim pasi janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Ankuesve u është dhënë konsulenca e nevojshme juridike, si dhe adresa e institucioneve në të cilat duhet të paraqiten për zgjidhjen e ankesave të tyre.

Nga ky evidentim del se ankesat jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit kanë qenë si më poshtë:

Ankesa ndaj vendimeve të Gjykatave Shqiptare	141
<b>Kërkesa per përfaqesim në gjykatë</b>	<b>119</b>
Konflikte midis individëve	62
Ankesa ndaj subjekteve private	98
Konflikte në familje	73
Kerkesa per punësim	71
Ankesa ndaj kompanive të huaja private	54
Ankesa ndaj gjykatave të shteteve te huaja	42
Ankesa ndaj perfaqesive të huaja në Shqipëri	56
Ankesa ndaj shteteve të huaja	47
Ankesa ndaj organeve të policise se shteteve te huaja	40
Te tjera	20
	<b>823</b>

Siç mund të shikohet në tabelën e mësipërme numri më i madh i këtyre ankesave, drejtohet ndaj gjykatave shqiptare të të gjitha niveleve. Këto ankesa zënë rreth 17% të të gjitha ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Sipas ankesave të individëve të paraqitur vendimet e gjykatave shqiptare mbartin padrejtësi, paragjykim, pavërtetesi dhe njëanshmeri. Ata nuk janë dakort me vendimet e gjykatave, kanë pretendime për trupin gjykues, ankohen për korrupsion si dhe marrje rryshfeti. Gjithashtu, ankohen për punën pa nivel të avokatëve mbrojtës, të cilët në disa raste, sipas ankuesve, bëjnë lojë (mbrojtje) të dyfishtë kundrejt rryshfetit.

Edhe gjatë këtij viti, mjaft qytetarë janë ankuar se nuk mund të kundërshtojnë vendimet e gjykatave për çështje penale mbasi këtë të drejtë ligji ia njeh vetëm Prokurorisë, e cila në mjaft raste, sipas tyre kërkon masë ndëshkimi të ulët në krahasim me pretendimet e të dëmtuarve. Ky problem është ngritur shpesh nga Avokati i Popullit, për të ndryshuar Kodin e Procedurës Penale në mënyrë që familjet e dëmtuara të kenë të drejtë ankimi. Kjo për faktin se në të shumtën e rasteve janë familjarët e viktimave që mendojnë se vendimi nuk ka qenë i drejtë, por prokurorët nuk bëjnë ankime të vendimeve.

Një problem tjetër që është evidentuar gjatë pritjes së individëve në Zyrën e Pritjes së Avokatit të Popullit, janë konfliktet në familje si dhe konfliktet midis individëve. Keto ankesa zënë rreth 16.4% të ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Në më të shumtën e rasteve, problematika e këtyre ankesave kanë të bëjnë me probleme në familje, burre e grua, kanë të bëjnë me femijët, probleme trashëgimie, të pronës etj. Nga ana jonë, është bërë kujdes në dhenien e konsulences për mënyrën e zgjidhjes së ankesave, duke këshilluar për rrugën e saktë ligjore që duhet të ndiqet, me qëllim eliminimin e konflikteve të mundëshme. Për këtë, veç konsultave tona, është bashkëpunuar me

organizata jo qeveritare si dhe me organizata për mbrojtjen e të drejtave të grave e fëmijëve, gjithmonë në funksion të parandalimit të konflikteve të mundëshme.

Për sa i përket kërkesave për punësim, vihet re një rritje e numrit të tyre, krahasuar me vitin e kaluar. Ato zënë rreth 8.6% të ankesave të papranuara si jashte juridiksionit të Avokatit të Popullit. Në keto raste, qytetarët janë këshilluar të paraqiten në zyrat e punës. Në këtë mënyrë, mendojme se kemi kontribuar sado pak në uljen e informalitetit në këtë sektor si dhe për edukimin e qytetarëve për ndjekjen e rruges ligjore në përmbushjen e qëllimeve të tyre. Kjo statistikë mund t'i shërbejë organeve kompetente shtetërore në hartimin e strategjive efikase për punësim.

Rreth 12% e ankesave kanë qenë kundër subjekteve private. Problemet janë të ndryshme, mosrespektim dhe prishje e njëanshme e kontratave, sidomos nga ndërtues që nuk zbatojnë kontratat e sipërmarrjes dhe të shitjes si dhe afatet e përcaktuara, mos dhenie e pagës nga punëmarresit, largime nga puna, mospagim i Sigurimeve Shoqërore e të tjera probleme që rëndojnë mbi qytetarët edhe për shkak se strukturat e tjera të shtetit nuk veprojnë.

Si dhe vitet e kaluara, një numer i madh ankesash drejtohet ndaj përfaqesive të huaja, të cilat ndaj kërkesave të shtetasve për paisje me vizë, reagojnë me sjellje aspak dinjitoze dhe diskriminuese. Ky diskriminim, i vërejtur pothuajse në pjesën më të madhe të përfaqesive të huaja në vend, shprehet shpeshherë, me mos dhënie të arsyes për mospaisjen me vize ndaj individëve, të cilët kanë bërë një kërkesë të tillë. Gjithashtu, një numër i madh ankesash drejtohet ndaj institucioneve të shteteve të huaja, që kanë të bëjnë me padrejtesi të ndryshme ndaj shtetasve shqiptarë që jetojnë në shtete të tjera.

Per sa i përket ankesave drejtuar shteteve apo përfaqesive të huaja, Avokati i Popullit, ka bashkërenduar punën me Ministrinë e Jashtme dhe përfaqesite tona jashtë vendit. Por duhet edhe këtë vit të theksojme se puna e përfaqesive tona jashtë vendit, duhet të jetë më afër problemeve dhe shqetësimeve të shtetasve Shqiptarë, sepse ka shumë ankesa për pa aftësi dhe zvarritje në punën e tyre.

Në të gjitha rastet, ankuesve iu është bërë e qartë se Avokati i Popullit është i gatshëm të nderhyjë me kompetencat që i jep ligji, vetëm kur organet apo autoritetet për të cilat ka ankesa apo kërkesa, janë pjese e Administratës Publike Shqiptare, dhe kur prej tyre nuk konstatohet angazhimi i duhur institucional. Në rastet e tjera, qytetarëve i është ofruar këshillim ligjor, ose orientim dhe sugjerim për zgjidhjen e problemeve të prezantuara.

Nga konkluzionet e arritura, si rrjedhim i një eksperience prej rreth 10 vjetësh të Zyrës së Pritjes së Popullit dhe të marrëdhënieve me

individë në përgjithësi, mendojmë se angazhimi ynë në të ardhmen është i domosdoshëm për t'i ardhur sa më tepër në ndihmë qytetarëve që kërkojnë ndihmën e Avokatit të Popullit.

### **b. “Ditët e Hapura” – Përvojë për t'u vazhduar**

Gjatë vitit 2009 ne vazhduam praktikën tashmë të konsoliduar të komunikimit të drejtëpërdrejtë me qytetarët, që ne i kemi quajtur “ Ditë të Hapura “.Kjo ka rezultuar të jetë një praktikë shumë e frutshme që jo vetëm shkurton procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, por edhe manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve, pa folur këtu edhe për vlerën njohëse që ka kjo praktikë edhe për vetë stafin e Avokatit të Popullit, duke u mundësuar atyre prekjen nga afër të halleve dhe shqetësimeve të qytetarëve. Parimi është se, nëse procedurat zbatohen me korrektesë, qytetari nis të rrisë besimin tek shteti i vet, tek institucionet dhe ligji, dhe kjo fillon qysh nga njësia më e vogël administrative.

Orientimi i qeverisë shqiptare drejt atij që quhet “shtet i vogël”, si një filozofi e caktuar e demokracisë liberale, ka sjelle vetvetiu edhe lëshimin e mjaft kompetencave nga pushteti qëndror në drejtim të pushtetit vendor. Problemet që kanë të bëjnë me shërbime të tilla publike si energjia elektrike, ujësjelles kanalizime, probleme të pronësisë, zyrat e regjistrimit të pasurive nëpër rrethe, marrëdhëniet e punës, sigurimet shoqërore e kështu me radhë, natyrshëm çojnë në orientimin se më e mira është që problemet të zgjidhen atje ku lindin dhe me ata persona që i kanë krijuar këto probleme.

Gjatë vitit 2009 ekspertët e Avokatit të Popullit kanë organizuar “Ditët e Hapura” në 40 bashki, nga ku janë pritur gjithsej 609 ankues, nga të cilat janë pranuar 394 ankesa, por në vënd janë sqaruar dhe këshilluar 215 ankues.Një numër i konsiderueshem i tyre i përket ankesave të parashtruara nga anetarët e komunitetit ‘Romë’.

Takimeve tona në “ Ditët e Hapura “ u kanë paraprirë bisedat në televizionet lokale nga ekspertët e Zyrës së Avokatit të Popullit, si dhe njoftimet e bëra nga zyrtarët e bashkive dhe komunave përkatëse.Ka rezultuar se në shumicën e rasteve, objekti i ankesave të tyre ka patur të bëjë me politikat sociale të shtetit ( punësimi, strehimi, ndihma sociale etj), me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me procedurat e ndjekura nga Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, konflikte të lindura në marrëdhëniet e punës, ankesa në lidhje me shtesat e pensioneve apo dhe probleme të tjera.

Avokati i Popullit gjatë zhvillimit të “Ditëve të Hapura” për herë të parë për vitin 2009 ka organizuar takime me komunitetin “Rom” pothuajse në të gjitha qytetet e vëndit dhe në vecanti në të gjitha ato

vende që janë të banuara nga ky komunitet. Në keto takime janë pritur 380 ankesa siç e kemi spjeguar në Raportin e Veçantë Nr.4 për Romët..

Qellimi i kësaj praktike ishte njohja më nga afër e problemeve të shumta që anëtarët e këtij komuniteti hasin çdo ditë nga veprimet dhe mosveprimet administratës publike, qëndrore dhe asaj vendore në mënyrë që ndërmjetesimi i Institucionit të ‘Avokatit të Popullit’ pranë këtyre organeve të sherbeje për një zgjidhje sa më efikase të shqetësimeve të këtij komuniteti.

Përvoja e fituar në “Ditët e Hapura”, por dhe në disa inspektive me grupe pune, me objekt të caktuar, siç janë inspektimet në burgje, takimet me efektiva të reparteve ushtarake etj, për t’u njohur nga afër se sa zbatohen të drejtat që janë të sanksionuara me ligj, na ka nxjerrë si domosdoshmëri që kjo punë të thellohet në të ardhmen, me synim rritjen e efikasitetit dhe shpejtesinë e zgjidhjes së ankesave atje ku lindin.

## 7. Konferenca Ndërkombëtare me temë “Të Drejtat e Njeriut, Mirëqeverisja dhe Performanca e Ombudsmanit”

Në vazhden e aktiviteteve vjetore në fushën e të drejtave të njeriut, me 10 Dhjetor 2009, Zyra e Avokatit të Popullit organizoi Konferencën Ndërkombëtare me temë “Të drejtat e njeriut, mirëqeverisja dhe performanca e Ombudsmanit”.

Organizimi i kësaj Konference u motivua dhe nga 10 vjetori i ngritjes së Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri si dhe nga 61 vjetori i Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, e cila është aprovuar me 10 Dhjetor të vitit 1948.

Në këtë aktivitet morën pjesë Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Bamir Topi, Zëvendëskryetari i Kuvendit, z. Ardian Turku, Ministri i Shtetit z. Genc Pollo si dhe shumë personalitete nga vendi dhe bota. Me këtë rast, Presidenti i Republikës i akordoi Institucionit të Avokatit të Popullit Urdhërin “Nënë Tereza”, me motivacion profesionalizmin, kurajon dhe pavarësinë e dëshmuar në 10 vite nga ky institucion gjatë punës së tij. Në fjalën e tij, me këtë rast, Avokati i Popullit falenderoi Presidentin, duke e siguruar atë se “zyra e tij e siguronte edhe një herë atë dhe opinionin publik se do të vazhdojë të ndjekë filozofinë, sipas së cilës ky institucion do të jetë gjithmonë një oponent për mirëqeverisje”.

Në Konferencë morën pjesë përfaqësues nga shume zyra të Ombudsmanit, ndër të cilët Ombudsmani Danez, Hans Gammeltoft Hansen, Ombudsmani Parlamentar Suedez, Zj. Kerstin Andre, Ombudsmani Bullgar z. Ginyo Ganey, Ombudsmani i Maqedonisë, z. Ixhet Memeti, Ombudsman i Katalonjes, z. Rafael Ribo, Ombudsmani i Kosovës z. Sami Kurteshi, Zëvendësombudsmani grek, z. George

Moschos, Zevendësombudsmani i Holandës, zj. Adriana Stehouëer si dhe përfaqësues të tjerë nga zyrat homologe të Avokatit të Popullit.

Në fjalën hyrëse të Konferencës, Avokati i Popullit, z. Ermir Dobjani shpjegoi thelbin e filozofisë së funksionimit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, sipas te cilit “Avokati i Popullit nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë asnjëherë Opozitë kundër Qeverisë, pavarësisht se cilat forca politike do të kenë pushtetin, por do të jetë gjithmonë një Oponencë për Mirëqeverisje”. Më tej, Avokati i Popullit foli për parimet e shpallura të funksionimit të zyres së tij si paanësia, pavarësia, profesionalizmi dhe konfidencialiteti, paanësia politike dhe pavarësia nga tre pushtetet, parime të cilat janë zbatuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë tonë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë edhe qeverisjen e mirë.

Nga ana e tij, Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Bamir Topi tha se “konsolidimi i procesit demokratik të qeverisjes, arritja e mirëqeverisjes dhe respektimi i të drejtave të njeriut e kërkojnë gjithmonë e më tepër rolin e Avokatit të Popullit. Natyrisht, ushtrimi në mënyrë të efektshme i përgjegjësi në mbrojtje të të drejtave të njeriut lidhet domosdoshmërisht me një qeverisje të kontrollueshme, një parlament pluralist dhe një gjyqësor të pavarur. Por, shoqëritë moderne po provojnë çdo ditë e më shumë se ekzistenca e këtyre institucioneve sipas ndarjes klasike të tre pushteteve është e paplotë pa veprimtarinë e institucioneve të tjera të pavarura, të cilat së bashku bëjnë të mirëfunksionojë sistemi i kontrollit dhe balancës së pushteteve dhe në të cilin luajnë rol të rëndësishëm një shoqëri civile e fortë dhe një shtyp i lirë dhe i përgjegjshëm. Pikërisht, në këtë sistem, pranë sferës së qeverisjes dhe shoqërisë civile është vendosur Avokati i Popullit, në garanci të demokracisë dhe mirëqeverisjes.”

Në fjalën tematike të tij, z. Dobjani u ndal në temën “Performanca dhe sfidat e punës së Avokatit të Popullit në Shqipëri për të drejtat e njeriut dhe mirëqeverisjen”. Ai theksoi së “për Këshillin e Evropës, Ombudsmani dhe institucione të tjera të ngjashme përbëjnë elementin themelor të infrastrukturës së të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike. Siç thanë profesorët e nderuar, Karta e të Drejtave të Njeriut të vendeve të Bashkimit Europian, e miratuar në Samitin e Nisës në dhjetor 2000 është teksti i parë zyrtar në botë në fushën e të drejtave të njeriut që sanksionoi zyrtarisht të drejtën e mirëadministrimit, si të drejtë themelore të njeriut. Në të vërtetë përcaktimi në këtë Kartë i të drejtës së mirëadministrimit, të drejtës së aksesit në dokumentet zyrtare dhe të Institucionit të Ombudsmanit, kanë qenë një zhvillim i ri dhe mjaft pozitiv për përparimin e të drejtave të njeriut jo vetëm në gjirin e vendeve të Komunitetit Europian, por edhe në vende të tjera të Evropës dhe më gjerë. Vetë fakti i ekzistencës së Institucionit të Avokatit të Popullit ka

një ndikim pozitiv në administratë, së paku për arsyen e thjeshtë se kjo e fundit e di se është një palë e tretë që e vëzhgon performancën e saj në raport me qytetarin. Nga ana tjetër, “ne kemi punuar dhe punojmë që njerëzit ta dinë se mund të ankohen pranë nesh, përmes një procedure të lehtë dhe pa shpenzime, për ato vendime të administratës, që i konsiderojnë të padrejta ose të pafavorshme për ta”, tha Avokati i Popullit.

Nga pjesëmarrësit e tjerë mund të vëmë në dukje fjalën e z. Adrian Kati, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, i cili tha se “në Shqipëri, një ndër problemet themelore në respektimin e të drejtave të njeriut mbetet pazbatueshmëria e konventave ndërkombëtare. Kjo çështje u vu në themel të bashkëpunimit tonë me institucionin e Avokatit të Popullit. Që prej themelimit të këtij insitucioni, në garantim të të drejtave themelore të individit, bashkëpunimi tone ka konsistuar në shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës për fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut, në garantim të të drejtave themelore”.

Në konferencë u vlerësua se Protokollin Opsional për Parandalimin e Torturës u bë forca sensibilizuese e cila kërkoi angazhimin e përbashkët me Avokatin e Popullit për krijimin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës dhe atashimin e tij pranë Avokatit, duke zgjedhur në këtë mënyrë modelin më të përshtatshëm për Shqipërinë. Ky model mori jetë me ndryshimet në Ligjin “Për trajtimin e personave që ndodhen në vendet e vuajtjes së dënimit”, ku përveç përbushjes së detyrimeve që lindin nga OPCAT, u sanksionua me ligj kontributi i shoqërisë civile në monitorimin e vendeve të vuajtjes së dënimit (burgje dhe paraburgim).

Nga ana e tij, me cilësinë aktuale të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit Jo Publik UFO, por edhe të pedagogut të së drejtës procedurale penale për vite me rradhe, Prof. Dr. Fatmir Tartale foli për “Kontributin e Avokatit të Popullit për edukimin e juristëve të rinj”, duke vërejtur se krahas vlerave të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit është shndërruar në këto 10 vite një subjekt kryesor institucional, i cili ka ndikuar ndjeshëm në emancipimin publik mbi rëndësinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe për edukimin e administratës publike shqiptare, me standartet më të larta të mirëqeverisjes. Ai theksoi se puna e këtij institucioni në fushën e të drejtave të njeriut, ka zgjuar një interes të veçantë, jo vetëm për qytetarët e thjeshtë, si palë të interesuara në procedime të ndryshme administrative, por dhe tek studentët dhe juristët e rinj, të cilët shfaqin ambicje për të përvetësuar më shumë dije në këtë fushë.

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi foli për konceptin e qeverisjes së mirë si një derivat i natyreshëm i konceptit themelor të qeverisjes, si një koncept



po aq i hershëm sa edhe vetë jeta e bashkësisë njerëzore të organizuar politikisht. Ai tha se qeverisja kuptohet zakonisht si uniteti i procesit të vendimmarrjes apo vendimbërjes me procesin e zbatimit të vendimeve të miratuara. Kur flitet për qeverisje nënkuptohet qeverisja në të gjitha nivelet, në nivel rajonal e kombëtar, brenda një vendi dhe më gjerë, në nivel ndërkombëtar.

Koncepti i qeverisjes, për një varg rrethanash e arsyesh ka qënë e vazhdon të shfaqet si mirëqeverisje dhe si keqqeverisje. Mirëqeverisja ose qeverisja e mirë përfaqëson një interes të përhershëm, një dëshirë të vazhdueshme, një ideal, nga realizimi i të cilëve jeta e shoqërisë njerëzore do të përmirësohet ndjeshëm dhe njeriu, si pjesëtar i bashkësisë politike, do të ndjehej në këtë rast si subjekt i së drejtës, i plotësuar në masën e duhur. Qeverisja e mirë është dinamike, inkurajon besimin publik dhe pjesëmarrjen e gjerë.”

Nga ana e tyre, Prof. Dr. Adem Tamo dhe Prof. Dr. Gjergj Sinani, nga Universiteti i Tiranës mbajtën kumtesën me temë “Avokati i Popullit: institucion-faktor për një psikologji sociale më optimiste”. Ndër të tjera ata u ndalën në disa aspekte të krizës së sotme morale të shoqërisë dhe në rolin që ka institucioni i Avokatit të Popullit për të ndikuar në të. Kështu, sipas tyre, “kalimi nga totalitarizmi në demokraci u shoqërua në të gjitha vendet europiane me disa fenomene që më parë shoqëria nuk i njihte: papunësia, emigracioni, krimi, prostitucioni, droga, sida, ndotja ekologjike e konfliktet sociale. Këto fenomene të reja e pjesërisht të reja kanë prodhuar e prodhojnë me shumicë varfëri, ndarje e divorc, adiktivitet, infeksione, korrupsion, humbje dhe, përveç këtyre strese, ankthe, konflikte, frikë, pasiguri, mosbesim. Ky kalim i ëndërruar dhe i kërkuar, prodhon për fat të keq edhe shumë vuajtje e mjerim”. Në këtë drejtim, roli i Avokatit të Popullit vjen e bëhet gjithmonë e më i rëndësishëm, sidomos në drejtim të rritjes së efikasitetit të tij për rritjen e cilësisë së mirëqeverisjes si e drejtë e njeriut.

Në panelin e dytë Ombudsmani i Bullgarisë, Z. Ginio Ganev, Ombudsmania e Suedisë Zj. Kërstin Andre, Ombudsmani i Provinës së Katalonjës Spanjë Z. Rafael Ribo si dhe përfaqësues nga zyrat e Ombudsmanëve të Danimarkës dhe Greqisë, folën për përvojat pozitive të zyrave të tyre për trajtimin e ankesave për keqqeverisje.

Në panelin e tretë folën përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që kanë bashkëpunuar me Avokatin e Popullit si Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut, Shoqata e Romëve Amaro Drom etj.

Meqenëse kjo Konferencë u organizua në kuadrin e një aktiviteti jubilar, nuk u gjykua të dilej me rekomandime të veçanta, por materialet e saj është vendosur të botohen në dy gjuhë si dhe do tu shpërndahen instancave më të larta shtetërore si dhe zyrave homologe të Avokatit të

Popullit.

## 8. Bashkepunimi me Organizatat joqeveritare dhe aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009.

Në bazë të nenit 30 dhe 31 të Ligjit nr. 8454 “Për Avokatin e Popullit”, njeri nga tre seksionet e Zyres së Avokatit të Popullit merret edhe me bashkepunimin me Shoqërië Civile, dhe konkretisht me OJF-te që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me këto organizma joqeveritare, duke marrë në mënyrë periodike mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave të njeriut, si dhe organizimin një herë në vit të një veprimtarie kombëtare për një problematike të caktuar që paraqet gjendja e të drejtave të njeriut në vend. Për vitin 2009 u organizua një Konferencë Ndërkombëtare ku morën pjesë, ashtu siç është përshkruar në pjesën përkatë të raportit, përfaqësues të zyrave homologe dhe shumë organizata jofitimprurëse. Tema që u trajtua ishte “Të drejtat e njeriut, mirëqeverisja dhe performanca e një Omdusmani”.

Krahas ndjekjes së problematikës së përditshme për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve, Avokati i Popullit ose përfaqësues të tij, kanë marrë pjesë duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete të ndryshme, organizuar nga organizma qeveritare dhe të shoqërisë civile. Ashtu siç kemi theksuar dhe në Raportet Vjetore të mëparshme një gjë e tillë ka qenë dhe mbetet një angazhim sa institucional, aq edhe qytetar i Institucionit të Avokatit të Popullit, për t’u investuar dhe thënë fjalën e tij për një problematikë edhe më të gjerë se ajo që paraqitet në statistikat e punës së tij normale.

Më poshtë po ju njohim thjesht me tematikën e këtyre aktiviteteve, që janë organizuar së bashku apo vetëm nga partnerë të tjerë dhe ku Institucioni i Avokatit të Popullit ka kontribuar bashkë me grupet e interesit.

1. Pjesëmarrje në Konferencën “Prezantimi i Linjës Kombëtare për Fëmijët” organizuar nga CRCA, Shkurt 2009.

2. Tryezë e rumbullakët e organizuar nga Avokati i Popullit dhe Instituti Europian i Tiranës me temë “ Situata e paraburgimit në Shqipëri për respektimin e të drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve”, Shkurt 2009.

3. Pjesëmarrje në Tryezën e Rumbullakët “Integrimi i të rinjve pa kujdes prindëror”, organizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shkurt 2009.

4. Pjesëmarrje në Workshopin “Integrimi i të miturve në konflikt me ligjin”, organizuar nga CRCA dhe UNICEF, Zyra për Shqipërinë, Mars 2009

5. Konferenca Evropiane e organizuar nga Avokati i Popullit me ombudsmanët Evropiane me temë “Liria e informimit, çfarë mund të bëjë një zyrë ombudsmani”, mars 2009.

6. Konferenca: “Zbatimi i politikës dhe ligjit të konkurrencës në ekonomitë e vogla dhe informale”, zhvilluar nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, Mars 2009.

7. Workshop i organizuar nga Avokati i Popullit dhe Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Viktimave të Torturës me Temë” Gjendja e konsolidimit të Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës në Shqipëri dhe Rajon, Mars 2009.

8. Pjesëmarrje në Workshopin “Rëndësia e bashkëpunimit Ndërsektorial në mbrojtje të fëmijëve”, organizuar nga CRCA, Mars 2009.

9. Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Të drejtat e Pacientit në Shqipëri-Promovimi dhe respektimi i tyre”, organizuar nga Avokati i Popullit dhe Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore”, prill 2009.

10. Seminari Ndërkombëtar organizuar nga OSBE me temë “Të drejtat dhe trajtimi i personave të privuar nga liria dhe konsolidimi i Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës”, Prill 2009

11. Tryezë e rrumbullakët e organizuar nga KSHH me temë: “Respektimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe të personave të kthyer në Shqipëri”, qershor 2009.

12. Workshopi me Temë “Sistemi i drejtësisë për viktimat e torturës dhe keqtrajtimit dhe shërbimi ligjor alternativ” organizuar nga Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Viktimave të Torturës, Avokati i Popullit dhe Universiteti Europian i Tiranës. Qershor 2009

13. Tryezë e rrumbullakët e organizuar nga Transparency International, me temë: “Masat Alternative-Mundësi për Edukim dhe Riintegrim”, qershor 2009.

14. Workshop: “Mbi ndryshimet e ligjit “Per mbrojtjen e konkurrencës” dhe rregulloret “Per gjobat dhe lehtësimin prej tyre” dhe “Per marreveshjet me rëndësi të vogël”, zhvilluar nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, Korrik 2009

15. Pjesëmarrje në takimin koordinues “Linja Kombëtare për Fëmijët në Shqipëri dhe bashkëpunimi midis Institucioneve Publike” organizuar nga CRCA. Qëllimi i Takimit Koordinues ishte prezantimi i ecurisë së Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijët në Shqipëri dhe të sigurohet bashkëpunimi i institucioneve publike dhe jopublike në mbrojtje të fëmijëve në Shqipëri, Shtator 2009

16. Seminari me temë: “Monitorimi i të drejtave të njeriut që ndodhen në paraburgim dhe përfaqësimi i tyre ligjor në gjykatë” organizuar nga

Avokati i Popullit, Instituti European i Tiranës dhe Shërbimi Ligjor Falas (TLAS). Tetor 2009 Tiranë

17. Konferenca me Temë “ Forcimi i veprimtarisë së Shërbimit të Provës” organizuar nga Ministria e Drejtësisë. Tetor 2009 Tiranë

18. Pjesëmarrje në Forumin e Hapur me titull “Masat në mbrojtje të fëmijëve nga dhuna dhe keqtrajtimi”. Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët në Shqipëri - 116, një iniciativë e përbashkët e UNICEF dhe CRCA/DCI Shqipëri, në kuadër të 19 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Fëmijëve, Nëntor 2009.

19. Pjesëmarrje në seancën dëgjimore publike, që Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) zhvilloi, lidhur me kërkesat për rritjen e çmimit të energjisë Elektrike nga kompanitë respektive të prodhimit, transmentimit dhe shitjes së saj, sikundër ishin KESH sh.a. OST sh.a. dhe OSSH sh.a, nëntor 2009.

20. Tryeze e rrumbullaket: “Per hartimin dhe formulimin e Kartes Shqiptare te te Drejtave te Pacientit (draft)”, zhvilluar nga ana e Ministrise se Shendetesise dhe Qendres Kombetare te Cilesise, Sigurise dhe Akreditimit te Institucioneve Shendetesore, Nëntor 2009

21. Workshopi me Temë “Implementimi i vendimeve te Gjykates Eurpiane te te drejtave te Njeriut” organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Misioni EURALIUS. Nëntor 2009 .

22. Konferenca Kombetare me Temë “Standartet e sistemit të Paraburgimit dhe respektimi i të drejtave të të paraburgosurve” organizuar nga Avokati i Popullit dhe Instituti European i Tiranës, Nëntor 2009.

23. Konferenca Ndërkombëtare e zhvilluar nga Zyra e Avokatit të Popullit, me rastin e 10 vjetorit të Institucionit të Avokatit të Popullit me temë: Të drejtat e njeriut, mirëqeverisja dhe performanca e një Ombudsmani”, dhjetor 2009.

24. Workshop me temë “Forcimi i asistencës shendetësore ndaj te dënuarve dhe paraburgosurve” organizuar nga Qendra Shqiptare e Rehabilitimit te Viktimave te Torturës dhe Avokati i Popullit. Dhjetor 2009 Tiranë.

25. Konferencë Kombëtare me temë “Raporti i pare alternativ mbi situatën ne paraburgime” organizuar nga Instituti European i Tiranës dhe Avokati i Popullit në Dhjetor 2009 Tiranë

26. Tryezë e Rrumbullakët e organizuar nga OSBE dhe EURALIUS “Mbi bashkëpunimin midis medias dhe pushtetit gjyqësor”, Dhjetor 2009.

Në të gjitha këto aktivitete dhe të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato të shoqërisë

civile. Problematika e diskutuar në to na ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Kjo pjesëmarrje aktive do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi bashkëpunimin me organet e administratës publike si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë.

## KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat apo njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit zhvillohet lidhur ngushtë dhe në bashkëpunim konkret me organet e ekzekutivit shqiptar dhe në veçanti me Kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë së tij.

**Gjatë vitit 2009 Qeverisë, të kryesuar nga Kryeministri, zoti Sali Berisha, i kemi dërguar zyrtarisht këto rekomandime, propozime apo informacione.**

1. Informacion për fitimin nga Avokati i Popullit të Statusit “A”, si Institucion Kombëtar për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, dërguar Kryeministrit dhe disa ministrave, më datën 12.01.2009.

2. Konkluzionet e Konferencës Kombëtare “Mbrojtja e të drejtave të Konsumatorëve” dërguar Kryeministrit, Ministrit të Ekonomisë, Ministrit të Bujqësisë, Ministrit të Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, Ministrit të Shëndetësisë etj, më datën 28.01.2009.

3. Rekomandim për ndryshimin e nenit 352 të Ligjit Nr.8191, dt.29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Punës më datë 02.02.2009.

4. Rekomandimi për marrjen e iniciativës për disa plotësime në ligjin Nr.7952, dt.21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe në Dispozitat Normative për Arsimin, për garantimin sa më të plotë të të Drejtave të fëmijëve, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës më datën 02.02.2009. Përsëritja e rekomandimit më datën 18.11.2009.

5. Rekomandime për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, në favor të fëmijëve dhe në kuadrin e Reformës në drejtësi, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë më datën 02.02.2009.

6. Rekomandimi për marrjen e masave për heqjen e taksës së ç’regjistrimit në regjistrat e gjendjes civile të shtetasve që lënë shtetësinë shqiptare dhe pastrimi i Regjistratit Kombëtar të Zgjedhësve, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave më datën 03.02.2009.

7. Rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen përfundimtare të trajtimit ligjor të të sëmurëve mendorë që mbahen ende padrejtësisht në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë më datën 04.02.2009.

8. Rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e Ligjit Nr.8328, dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” në burgun e Burrelit, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë më datën 18.02.2009.

9. Rekomandimi për marrjen e menjëhershme të masave të nevojshme teknike dhe organizative për korrigjimin e mangësive të konstatuara dhe mbarëvajtjen e procesit të pajisjes me letërnjoftime të shtetasve shqiptarë, krijimin e më shumë mundësive dhe të kushteve lehtësuese për qytetarët dhe të transparencës për procesin, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm më datën 12.03.2009.

10. Rekomandimi për marrjen e masave urgjente për sigurinë e jetës të pacientëve dhe stafit mjekësor në shërbimin spitalor psikiatrik, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Shëndetësisë më datën 20.03.2009.

11. Rekomandim për rritjen e sigurisë të digave të rezervuarëve dhe dambave të ujit, dërguar Kryeministrit më datën 27.03.2009.

12. Rekomandim për akordimin e menjëhershëm të një fondi për rritjen e kuotës ushqimore të të sëmurëve të spitaleve psikiatrike në vend, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Financave, më datën 30.03.2009.

13. Rekomandimi për hartimin e një projekt ligji të ri “Për Falje”, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë më datën .07.04.2009.

14. Informacioni mbi masat që duhen marrë për vënien në zbatim të VKM nr.334, dt.20.05.2005 “Për hapjen e pikës së kalimit kufitar në fshatin Borje të Kukësit, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Kosovën”, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme më datën 08.04.2009.

15. Rekomandimi që t’i propozohet Kuvendit për ndryshime dhe shtesa në nenet 147 dhe 417 të Kodit të Procedurës Penale, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë, më datën 08.04.2009.

16. Rekomandimi për krijimin e kushteve për transferimin e të sëmurëve mendorë që mbahen padrejtësisht në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, duke rikonstruktuar burgun e Krujës, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë më datën 18.04.2009.

17. Informacioni mbi studimin e kryer për funksionimin e Komisioneve Mjekësore për rekrutimin e shtetasve në shërbimin e detyrueshëm ushtarak, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm më datën 23.04.2009.

18. Rekomandimi për nxjerrjen e një akti nënligjor nëpërmjet të cilit të njoftohen dhe detyrohen të gjitha institucionet publike dhe jopublike për të njohur dhe pranuar letërnjoftimin e ri si dokument bazë identifikimi të shtetasve, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, më datën 24.04.2009.

19. Rekomandimi për nxjerrjen e një urdhri që Drejtoritë Arsimore të ndalojnë përdorimin e shkollave dhe pjesëmarrjen e nxënësve dhe të mësuesve të shkollave në mitingjet elektorale të partive politike të vendit gjatë orarit të mësimit, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, më datën 24.04.2009.

20. Rekomandimi për korrigjimin e menjëhershëm të praktikave të gabuara të mobilizimit të detyrueshëm ushtarak, në shkelje të Ligjit nr.9047, dt.10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, më datën 30.04.2009.

21. Rekomandimi për ndryshimin e germës “dh”, të pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787 dt.26.11.2003 “Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve”, dhe tabelës C.f bashkangjitur këtij vendimi, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Financave, më datën 22.05.2009.

22. Rekomandimi që t’i kërkohej Kompanisë Konçensionare “Sagem”, krijimi i kushteve lehtësuese për personat që aplikojnë për pajisjen e tyre me letërnjoftime dhe pasaporta biometrike, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm më datën 22.07.2009.

23. Rekomandim për marrjen e masave dhe përmirësimin e sinjalistikës rrugore në akset rrugore, të inspektuara nga ana jonë në datën 27.07.2009, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve Publike më datën 28.07.2009.

24. Rekomandimi për përgatitjen e projektit të VKM-së “Për pagat referuese të njesuara dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese për të gjithë karrierën” dhe dërgimin e tij për miratim në Këshillin e Ministrave, në bazë dhe për zbatim të neneve 4 dhe 30 të ligjit nr.10142, dt.15.05.2009, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm, më datën 09.10.2009.

25. Kërkesa për shpjegime për digën e Liqenit Artificial të Tiranës, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve Publike, më datën 08.10.2009. Përsëritur kërkesa më datën 09.11.2009.

26. Rekomandimi për përgatitjen e projektit të VKM-së “Për rregullimin e marrëdhënieve të Policisë së Shtetit me të tretët, për llojet e shërbimeve policore shitesë që ofron policia dhe tarifatat e pagesës për këto shërbime”, si dhe dërgimin e tij për miratim në Këshillin e Ministrave, në bazë dhe për zbatim të neneve 48 dhe 129 të ligjit nr.9749, dt.04.06.2007



“Për Policinë e Shtetit”, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm në datën 30.10.2009.

27. Rekomandimi i përsëritur për përshejtimin e zgjidhjes së problemit të pagesës së sigurimit të bashkëshorteve/it që shoqërojnë nëpunësin në përfaqësitë tona diplomatike, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, më datën 04.11.2009.

28. Rekomandimi lidhur me shpejtimin e procedurave për miratimin në Kuvendin Shqipërisë të Projekt Ligjit “Për një shtesë në Ligjin Nr.8053, dt.21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, me ndryshime, dërguar Kryeministrit dhe Kuvendit më datën 04.11.2009.

29. Informacioni për përdorimin e letër njoftimeve si dokument identifikimi, dërguar Ministrit të Shtetit më datën 02.12.2009.

30. Rekomandim pas ngjarjes së vetëvrasjes së shtetasit Klodian Bushi në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Durrës, dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm, më datën 04.12.2009.

31. Rekomandimi për marrjen e masave për dhënien e menjëhershme të dëmshpërblimit për të dënuarit politikë gjatë regjimit komunist që janë deklaruar të pafajshëm dhe që aktualisht janë gjallë, me parë se kategoritë e tjera, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm, më datën 23.12.2009.

32. Rekomandimi për përgatitjen e drafteve ligjore për realizimin e iniciativës legjislative nga Qeveria për parandalimin dhe monitorimin e rreziqeve që vijnë nga emërtimi në ajër i gazit radioaktiv Radon, dërguar Kryeministrit, Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë më datën 24.12.2009.

Gjithashtu Kryeministrit dhe disa ministrave që lidhen me çështjen u është dërguar Raporti i Veçantë Nr.4 “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Komunitetit Rom në Shqipëri”, më datën 25.11.2009.

Duke e krahasuar me shifrat e raportit tonë për vitin 2008, rezulton se edhe në zërat e mësipërme veprimtaria e Avokatit të Popullit ka patur rritje në vitin 2009. Si rrjedhojë Qeveria Shqiptare është informuar dhe është vënë në lëvizje nga Avokati i Popullit më shumë dhe më mirë. Në përgjithësi rekomandimet tona janë mirëpritur nga Qeveria dhe ka patur mirëkuptim dhe angazhim nga ajo për t’u marrë dhe për të zgjidhur problemet që ka ngritur Avokati i Popullit.

## 2. Ministria e Drejtësisë

Gjatë vitit 2009 janë trajtuar gjithësej 583 ankesa që kanë të bëjnë me autoritete në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, e konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Zyrat e Përmbarrimit, Zyrat e

Rregjistrimit të Pasurive të Palujtëshme, Agjensinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve etj.

#### **A. Ankesat per administraten e burgjeve dhe paraburgimit.**

Gjate vitit 2009 Avokati i Popullit ka trajtuar gjithsej 244 ankesa te paraqitura nga te denuar dhe të paraburgosur për administratën e burgjeve dhe paraburgimeve. Krahas kesaj gjate vitit 2009 jane takuar rreth 850 te denuar dhe paraburgosur dhe jane ndihmuar me keshilla juridike me ane te linjes telefonike pa pagese 270 te denuar. Gjithashtu jane hartuar dhe paraqitur 30 rekomandime, ne lidhje me permiresimin e standarteve te drejtave dhe trajtimit te individeve qe strehohen ne keto institucione. Nje rol te madh ne evidentimin e problematikave ne burgje dhe paraburgime kane luajtur edhe vizitat dhe inspektimet e shpeshta te kryera gjate vitit 2009 nga Avokati i Popullit ne rolin e Mekanizmit Kombetar te Parandalimin e Tortures ne te gjitha burgjet dhe paraburgimet ne vend.

#### **Problematikat e sistemit penitenciar nga ankesat e vitit 2009.**

1) Gjate vitit 2009 disa prej burgjeve dhe paraburgimeve ne vend vijojne te vuajne nga probleme te amortizimit dhe kushteve te papershtatshme te tyre, veçanerisht te lageshtires (Burgjet 325 Tirane, Rrogozhine, Tepelene, Lezhe, Kosove e Lushnjes, Burrel, Paraburgimet Berat, Sarande, 313 dhe 302 Tirane), mungeses se ujit, sidomos gjate periudhes se veres (Burgjet Rrogozhin, Peqin, Fushe-Kruje), pranise periodike te brejtesve (Burgu 313), kushteve jashte standarteve te tualeteve, dusheve, ambjenteve te ajrimit, dhomave te izolimit, mungeses se ambjenteve te edukimit, ushtrimit te riteve fetare, veprimtarise sportive etj. (Burgjet Burrel, Lezhe, Tepelene, Kosove e Lushnjes dhe Paraburgimet Sarande, Berat, 313 dhe 302 Tirane). Ne kemi insistuar dhe institojmë që të mbyllet burgu i Burrelit sepse nuk plotëson standartet përkatëse.

Avokati i Popullit gjate inspektimeve dhe ri-inspektimeve te kryera gjate vitit 2009 ne te gjitha keto institucione ka perseritur nevojen urgjente per investime kryesisht te pjesshme qe do te permiresojne ndjeshem kushtet ekzituese. Keto probleme jane adresuar fillimisht prane Ministrise se Drejtesise dhe Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve, por mendojme se ato jane nje çeshtje qe i takon per zgjidhje edhe Qeverise Shqiptare per vete nivelin e financimit qe nevojitet. Ne kete rast periudha tranzitore deri ne ngritjen e burgjeve apo paraburgimeve te reja nuk duhet kurrsesi t`ju mohoje te denuarve dhe paraburgosurve kushte me te mira jetese ne ambjentet aktuale. Kjo periudhe tranzitore nuk duhet te reklamohet aspak si justifikim ndaj pranise se kushteve te papranueshme,

pasi ne çdo rast konstatimi i tyre konsiderohet shkelje flagrante, si nga institucionet kombetare, ashtu dhe nga ato nderkombetare, pa marre parasysh planet investuese per te ardhmen.

2. Një nga problematikat kryesore që vijon të mbetet shqetësuese për Avokatin e Popullit është mosgjëja e një zgjidhje perfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marre masë nga gjykata për mjekim të detyruar . Avokati i Popullit e ka ngritur çdo vit këte çështje, madje gjate vitit 2008 nepermjet Raportit të Veçante Nr.2 “Per Gjendjen e Shendetit Mendor” paraqitur Kuvendit të Shqipërisë dhe nuk është pajtuar aspak me situatën në të cilën ende këta persona mjekohen brenda ambjentëve të sistemit të burgjeve. Gjate vitit 2009, fale një angazhimi të drejtperdrejt të vetë Avokatit të Popullit dhe Drejtorit të Pergjithshëm të Burgjeve u arrit që të dilej në një qëndrim të përbashkët jo vetëm për nevojën urgjente të sistemit të tyre, por edhe të parashtrimit të propozimeve konkrete. Ky bashkëpunim erdhi pas deshtimit të strehimit të personave me mjekim të detyruar në Qendrën Spitalore Psikiatrike Ligjore që u hap në Durrës, për shkak se ambjentet e këtij spitali nuk ofruan minimumin e pershtatshmerisë së ambjentëve për trajtimin e këtyre personave. Aktualisht jemi në dijeni se nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë po merren masat që të kalojë sa më parë në administrim nga ana e tyre një seksion i veçantë në Burgun Krujë për të trajtuar këta persona sipas ligjit, ashtu siç ka rekomanduar edhe Avokati i Popullit.

3. Një problem tepër serioz që është ngritur në mjaft komunikime konfidenciale me të denuarit dhe paraburgosurit është ai i korrupsionit në disa segmente të administratës së burgjeve. Ky korrupsion ka bërë që në disa raste të pretendohet për cenim të rëndë të të drejtave dhe trajtimit të individëve brenda këtyre institucioneve. Avokati i Popullit megjithatë është munduar të verifikojë disa raste të denoncuar për korrupsion e ka patur mjaft të vështirë të mundesoje zbardhjen e së vertetës. Ky rezultat ka qënë i ndikuar nga disa elemente, si intimidimi i denoncuesve, mungesa e fakteve dhe dëshmitarëve etj. Megjithatë nisur nga filmime të bëra publike për raste mitmarrje nga emisioni Fiks-Fare, nisur nga gjetja periodike e sendeve të ndaluara në qeli të veçanta, apo nga trajtimi i pabarabartë dhe me tepër privilegje që ju bëhet disa të denuarve dhe paraburgosurve në vend, në mënyrë indirekte lihet të kuptohet se korrupsioni në sistemin penitenciar është mjaft prezent dhe përben kërcënim për mbarevajtjen e trajtimit të të drejtave të individëve të denuar ose të paraburgosur. Avokati i Popullit në vitin në vijim ka planifikuar të kryejë disa sondazhe për këte fenomen.

4. Gjate vitit 2009 shërbimi shëndetësor në sistemin penitenciar u konstatua se këre me përmirësime të dukshme aktivitetin e tij. Por në disa raste u vënë re mangësi, kryesisht në mungesën e mjeteve të transportit

(ambulanca) ne disa burgje, ne mungesen e shtimit te personelit mjeksor te specializuar, ne mos krijimin e ambjenteve optimale te sherbimit shendetesor, etj.

Disa prej burgjeve dhe paraburgimeve ne vend u konstatuan se gjate vitit 2009 nuk ofronin ambulanca te kompletuara me mjetet e domosdoshme te ndihmes se pare, por thjesht disa mjete transporti (furgon) per tranferimin e te semureve ne spitale. Madje ne disa raste keta te fundit u verifikuan se ishin transferuar ne spitale civile me makina te personelit te burgjeve. Ne burgjet e medha si ne Lezhe, Peqin dhe Korçe eshte vene re nevoja per shtimin e personelit mjeksor te kualifikuar pasi jane evidentuar rritje te numrit te te semureve kronike, veçanerisht nga diabeti, hipertensioni, zemra, veshka, probleme te shendetit mendor etj. Krahas sa me lart, per shkak te mbipopullimit dhe amortizimit te ambjenteve, ne disa prej qendrave te burgjeve dhe paraburgimit dhomat e vizitave mjeksore jane te papershtatshme dhe nuk mundesojne nje sherbim normal shendetesor.

Nga monitorimet e Avokatit te Popullit u konstatua se trajtimi financiar i personelit shendetesor ne burgje eshte i pamjaftueshem dhe jo i barabarte me sherbimin shendetesor civil. Per kete arsye shume shpejt do te kerkohet qe sherbimi shendetesor penitenciar, te kaloje ne varesi te Ministrise se Shendetesise per t'i hapur rruge jo vetem trajtimit te barabarte te tyre, por dhe per te nxitur integritetin e mjekeve ne denoncimet e dhunes si dhe per te forcuar autoritetin shendetesor ne burgje, ose të rritet paga e tyre.

**5.** Gjate vitit 2009 efektivat e policise se burgjeve kryen nje veprimtari ku u evidentua veçanerisht shtimi i trajnimeve. Megjithate ne disa raste, disa prej ketyre efektivave u denoncuan per dhune fizike dhe psikike ndaj te denuarve dhe paraburgosurve. Avokati i Popullit edhe gjate vitit 2009 konstatoi se shumica e policeve te rolit baze ne burgje nuk perfituan shperblimet per disa raste te kryerjes se sherbimit jashte orari apo diteve te pushimit. Rroga e tyre eshte ne nivele jo motivuese, krahasuar me veshtiresite e punes dhe mungon ende nje uniforme e veçante me shenja identifikuese per çdo punonjes. Nisur nga disa raste vetevrasjesh te disa prej ketyre efektivave te bera publike gjate vitit 2009, Avokati i Popullit ka ngritur shqetesimin per faktorin psikologjik qe shoqeron punen e policise se burgjeve dhe per rrjedhojat ne shendetin e punonjesve te ketij sherbimi. Per kete qellim shume shpejt do te kerkohet nje plan masash per monitorimin psiko-social te sejcilit punonjes, per t'i paraprire çdo lloj anomalie ne performancen qe ata ofrojne ndaj te denuarve dhe paraburgosurve.

**6.** Gjate vitit 2009 ne burgje dhe paraburgimet u konstatuan nje sere mungesash ne sistemin e surveillances. Mungesa e kamerave te sigurise apo mjeteve te komunikimit operativ u evidentuan si probleme qe

mund të sjellin një sere precedentesh negative (Burgu Korçe, Burgu Kosove e Lushnjës etj). Mungesa e ketyre mjeteve është bërë në disa raste shkak për mos evidentimin e ngjarjeve të dhunës, si dhe në mos marrjen në kohë të masave për dhenien e ndihmes së pare apo nderhyrjen në kohë për ngjarje të veçanta brenda rregjimeve të sigurisë.

7. Vijnë të mbetet problem edhe gjatë vitit 2009 llogaritja e kohës së paraburgimit, duke qëndruar në këtë rregjim edhe mbasi vendimet gjyqësore kanë marrë formë të prerë. Në këtë drejtim është kërkuar nga të dënuarit që ndaj tyre të zbatohen kërkesat e nenit 57 të K.Penal, ku 1 ditë paraburgim t'u njihet e barabartë me 1 ditë e gjysëm burgim. Nga institucioni ynë ky problem është ngritur disa here, madje edhe Kuvendi të Shqipërisë për faktin se disa persona kanë qëndruar nga disa muaj në paraburgim mbasi vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Për këtë është kërkuar të bëhet plotësim i ligjit nr.7941 datë 31.05.1995 "Për hyrjen në fuqi të Ligjit nr.7895 datë 27.01.1995 Për Kodin Penal në RSH", që të përfitojnë edhe personat e dënuar dhe të mbajtur për disa kohë në kushte paraburgimi. Kjo kerkese megjithë interesimin e institucioneve të burgjeve nuk ka marrë ende një zgjidhje perfundimtare nga Kuvendi.

8. Megjithë hapjen e institucioneve të reja të vuajtjes së denimit dhe venien në funksionim të Sherbimit të Proves, mbipopullimi vijon të mbetet një problem kryesor në burgje dhe paraburgime. Avokati i Popullit e ka nenvizuar shpesh rëndësinë e uljes së numrit të të dënuarve në këto institucione, duke respektuar standartet e hapësirës për jetesë, pasi mbipopullimi është shkak kryesor i amortizimit të ambienteve të burgjeve dhe cilesisë së dobët të sherbimeve ndaj të dënuarve dhe paraburgosurve. Gjithashtu mbipopullimi ka sjelle në shumë raste paraqitjen e ankesave nga ana e të dënuarve të cilët pretendojnë se nuk respektohet vuajtja e denimit pranë qendres së banimit siç percakton ligji. Gjithashtu mbipopullimi ka shkaktuar shpesh fenomenin që të dënuarit ose të paraburgosurit me rregjim të ndryshëm sigurie apo të kategorive të veçanta (madhor-te mitur) të sistemohen brenda të njëjtit ambient. Po ashtu edhe vendosja e të dënuarve për afatë të gjata kohore në dhomat e izolimit (pa qene të dënuar me masa disiplinore) ka qene njëra nga masat ekstreme që kanë ndermarre kryesisht administratat e Burgjeve në Peqin dhe Vaqarr për të ulur sadopak numrin e të dënuarve për qeli. Krahas kësaj, në mjaft raste mbipopullimi është bërë shkak për reduktimin e ambienteve të brendshme të burgjeve dhe paraburgimeve për qëllime edukative, shendetësore etj. Fenomene të tilla në vetvete janë një shkelje e të drejtave dhe trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve ndaj del si detyrë emergjente që të vijojnë me shpejteshi procedurat ligjore për lirimin para kohë dhe venien në dispozicion të Sherbimit të Proves të të dënuarve që plotësojnë kriteret. Njekohësisht duhet të shpejtohet procesi i ngritjes

dhe venies ne funksionim të qendrave te reja penitenciare sipas projekteve tashme te miratuara, veçanerisht ne Shkoder, Kukës, Fier, Gjirokastrë etj. Avokati i Popullit shtron gjithashtu si nevojë emergjente planifikimin dhe ngritjen sa me pare te nje qendre te unifikuar te paraburgimit ne Tirane, pasi dy institucionet aktuale 313 dhe 302, mbartin nje sere problematikash te pazgjidhshme per kushtet infrastrukturore qe ofrojne.

**9.** Edhe gjate vitit 2009 nje nga pretendimet qe kane ngritur shpesh te denuarit jane masat e tyre disiplinore, te cilat nuk parashkruhen ne rastin e kalimit te periudhes 6 mujore dhe pasqyrohen ne dokumentat qe paraqiten ne gjykate per uljet vjetore te denimit te denuarve ose lirimit para kohe. Ne keto raste ne menyre absurde masat e marra pasqyrohen ne kartelen e te denuarit dhe perbejne pengesen kryesore per nje vendim te drejte te gjykates ne favor te te denuarve. Avokati i Popullit edhe gjate vitit 2009 ka kerkuar me insistim prane disa burgjeve qe kjo praktike te ndryshoje dhe t'i hapet rruge lehtesimit te pozites se te denuarit. Ne kushtet kur parashkruhen vepra penale eshte e palejueshme qe kjo te mos ndodhe edhe per shkeljet disiplinore ne burg.

**10.** Nga disa inspektime te kryera gjate vitit 2009 eshte konstatuar se burgjet dhe paraburgimet ne vend nuk plotesojne kushtet minimale per te strehuar dhe per te trajtuar persona me aftesi te kuafizuar. Rast perjashtimor jane vetem kushtet qe ofrohen ne Burgun e Krujes dhe Qendres Spitalore te Burgjeve Tirane. Ky konkluzion ka dale per shkak te mungeses se personelit per t'ju pergjigjur te gjitha nevojat e kesaj kategorie personash, si dhe mungeses se pajisjeve per te mundesuar nje trajtim sa me te pershtatshem te paafetise se tyre. Ne keto kushte del si detyre emergjente qe Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve te mundesoje hapjen e qelive te veçanta, blerjen e pajisjeve te posaçme dhe shtimin e personelit per te trajtuar sipas standarteve kete kategori. Po keshtu duhen marre masa edhe per personat qe kane probleme me shikimin, degjimin apo komunikimin "shurdhe-memece" (rasti i nje te paraburgosuri ne I EVP-ne 313 Tirane), duke ju ofruar atyre qofte dhe me kohe te pjesshme personel per te kuptuar dhe paraqitur nevojat apo kerkesat e tyre te perditshme.

**11.** Burgjet dhe paraburgimet ne vendin tone nuk ofrojne nje sherbim te posaçem per te komunikuar me te denuarit apo paraburgosurit e huaj ne gjuhen e tyre per te gjitha procedurat dhe sherbimet qe atyre duhet t'ju ofrohen si gjithe personat e tjere. (rasti i nje shtetasi grek ne Burgun Vaqarr Tirane). Shpesh administratat e burgjeve apo paraburgimeve kane kerkuar ndihmen e te denuarve apo paraburgosurve te tjere qe njohin gjuhe te huaja per te komunikuar me keta persona. Per te respektuar standartet e kerkuara ne kete rast ne mbrojtje te te drejtave te te huajve, Ministria e Drejtesise dhe Drejtoria e Pergjithshme e

Burgjeve duhet te pajtojnë qofte dhe me kohe te pjesshme perkthyes per te huajt. Madje ne rastet kur kerkohet qe keta te fundit te njihen me akte apo praktika gjyqesore, disiplinore, administrative, financiare etj, duhet medoemos qe perkthyesi te jete i licensuar per te kryer nje detyre te tille.

**12.** Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Burgjeve duhet te orientojne sa me pare strukturat vartese te tyre prane çdo burgju dhe paraburgimi mbi nevojën per te hetuar dhe dokumentuar kryesisht jo vetem rastet e dhunes verbale apo fizike te ndodhura brenda ketyre institucioneve, por dhe çdo lloj informacioni qe tregon per ngjarje abuzimi, keqtrajtimi apo presioni psikologjik midis te denuarve apo paraburgosurve. Kjo mase duhet te merret me qellimin per te hetuar dhe provuar zyrtarisht ekzistencën ose jo te ketyre ngjarjeve apo informacioneve dhe per te dhene qendrimin e duhur institucional mbi keto te fundit

## **II. Rekomandimet kryesore te Avokatit te Popullit per vitin 2009, lidhur me permiresimin e kushteve dhe trajtimit te te denuarve dhe paraburgosurve dhe propozimet per masat ne parandalimin e dhunes dhe trajtimit çnjerezor.**

**1.** Avokati i Popullit nisur nga nje informacion i ardhur ne rruge konfidenciale, eshte njoftuar se ne Burgun Lezhe kishte patur nje konflikt fizik midis disa te paraburgosurve, si dhe ishte pretenduar se eshte ushtruar dhune edhe nga punonjësit e Policisë së Paraburgimit Lezhë.

Ne kete informacion behej e ditur se si pasoje e ketij konflikti ishin demtuar fizikisht dhe ishin izoluar me pas disa te paraburgosur. Ne baze te ketij informacioni, Avokati i Popullit ne rolin e Mekanizmit Kombetar te Parandalimit te Tortures ka urdhëruar kryerjen e një hetimi administrativ nga ana e Njesise se Parandalimit te Tortures.

Njesia e Parandalimit te Tortures ka kontaktuar fillimisht në dhomat e izolimit me te paraburgosurit e perfshire ne ngjarje duke i intervistuar individualisht dhe me pas me ndihmen e nje eksperti te Qendres Shqiptare te Rehabilitimit te Viktimave te Tortures eshte bere edhe ekzaminimi i tyre mjekesor. Me pas, ne prani edhe te Drejtorit te Burgut Lezhe jane pare filmimet perkatëse te kamerave te sigurise per ngjarjen e ndodhur.

Nga te gjitha veprimet e mesipërme rezultoi se më datë 10.09.2009 rreth orës 13.00 i dënuari A.P, ka shkuar në ambjentet e paraburgimit për të marrë disa sende vetjake. Rreth 30 minuta më vonë ky i denuar së bashku me të paraburgosurin E.G janë konfliktuar në korridorin e katit të tretë të paraburgimit me të paraburgosurin e këtij kati, shtetasin S.S. Me ndërhyrjen e të paraburgosurve të tjerë të cilët ndodheshin rastësisht në korridor konflikti është eliminuar. Në orën 14.00 gjatë ndërrimit të

turneve punonjësi i policisë M.V, ka shkuar në godinën nr.1 të paraburgimit, kati i tretë dhe ka hapur dhomën nr.2. Ai është futur brënda dhe ka biseduar me të paraburgosurit e kësaj dhome. Më pas ai ka hapur edhe dhomën Nr.3 dhe ka marrë takim dhe me të paraburgosurit e kësaj dhome. Me tej ai ka bashkuar te paraburgosurit e të dyja dhomave të mesiperme ne nje te vetme (Dhoma Nr.3).

Rreth orës 14.20 po ky punonjës policie ka hapur dhomën Nr.5 dhe ka kërkuar që të dalë i paraburgosuri S.S me pretekstin se e kërkonin të paraburgosurit e dhomës 2 dhe 3 për të pirë kafe. Sapo ky i paraburgosur ka dalë nga dhoma ai është sulmuar befasisht nga të gjithë të paraburgosurit e dhomave 2 dhe 3. Ai është goditur me grushta e shqelma dhe për pasojë ka shfaqur dëmtime ne disa pjesë të trupit si fytyrë, buzë, gjoks dhe shpinë. Gjatë sulmit që po i bëhej shtetasit S.S, shokët e tij banor të dhomave 4 dhe 5 kanë reaguar duke bërëtitur dhe duke goditur dyert e dhomave për të ndërhyrë policia ndaj këtij sulmi brutal. Pak minuta më vonë në katin e tretë të kësaj godine, kanë shkuar grupet e gatëshme të cilët kanë ndërhyrë dhe kanë shoqëruar në dhomat e izolimit forcërisht të paraburgosurit dhomave 4 dhe 5.

Ne perfundim te mbledhjes dhe administrimit te plote te deklarimeve, filmimeve dhe dokumentacionit perkates, si dhe pas nje analize te pergjithshme mbi kete ngjarje, Avokati i Popullit paraqiti rekomandimin per marrjen e masave per nxjerrjen e pergjegjesive disiplinore ndaj punonjesve te policise se burgjeve qe kishin shkaktuar kete trazire ne ambjentet e paraburgimit.

Siç vërehet sa më lart, në veprimtarinë e tyre gjatë shërbimit, punonjësit e policisë së burgjeve, nuk kishin zbatuar me rigorozitet kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Brëndshme të Policisë së Burgjeve, e cila bën fjalë për **Veprimtarinë e Policisë së Burgjeve**, të parashikuar nga neni 22 i saj. Në këtë nen përcaktohet qartë detyrimi i punonjësvë të policisë së burgjeve që për çdo veprim të kryer duhet të bazohen ne kete rregullore.

Duke analizuar në tërësi provat e administruara rezulton se, nga ana e punonjësvë të policisë në I.E.V.Penale Lezhë, janë kryer veprime me dashje në kundërshtim me nenin 22 të Rregullores së Brendshme të Policisë Burgjeve, te cilat kane sjelle per pasoje shkaktimin e nje konflikti fizik midis te paraburgosurve. Veprime te tilla kane vene ne rrezik jeten dhe shendetin e te paraburgosurve ne keto ambiente, ndaj dhe masat qe duhet te merren duhet te jene ne proporcion me rrezikshmerine e larte qe paraqesin ato.

Ne pergjigjen e paraqitur per kete propozim, Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve ka njoftuar marrjen e masave disiplinore per 12 punonjes te policise se Burgut Lezhe, ku 3 prej tyre jane larguar nga puna, ndersa per 9 te tjere jane marre verejtje me paralajmerim.



2. Ashtu siç jeni ne dijeni, Avokati i Popullit që në vitin 2002 e në vazhdim e ka konsideruar shkelje flagrante të të drejtave të njeriut, mbajtjen e të sëmurëve mendore në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, kur ndaj tyre gjykatat kanë vendosur mjekimin e detyruar në një qendër spitalore civile të specializuar.

Ne perfundim te nje vizite te perbashket me Drejtorin e Pergjithshem te Burgjeve te Burgut Kruje, Avokati i Popullit kërkoi me ane te nje rekomandimi që të merreshin masa të menjëhershme për sistemimin e te semureve mendore per te cilet gjykata kishte vendosur shtrim te detyruar ne nje qender spitalore. Parimisht nga pergjigjet e paraqitura ky rekomandim eshte pranuar dhe aktualisht Ministria e Shendetesise po pergatit masat e duhura administrative per adoptimin e nje pjese te ambjenteve te Burgut Kruje per te kryer kete sherbim. Kjo nderhyrje erdhi ne perfundim te inspektimit te perbashket edhe te Institutit te Psikiatrise Ligjore ne Durres, ku u konstatua se modelimi i ambjenteve te ketij institucioni nuk permbushte aspak nevojat e rreth 84 te semureve mendore qe duhet te trajtohen jashte sistemit penitenciar. Avokati i Popullit do te vijoje te ndjeke deri ne fund kete proces pasi ka nje rendesi shume te madhe qe te drejtat e njeriut per kete kategori individesh te respektohen maksimalisht.

3. Avokati i Popullit ne rolin e Mekanizmit Kombetar per Parandalimin e Tortures prezantoi nje rekomandim prane Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve lidhur me nevojen e investimeve te plota per monitorimin me kamera te te gjitha burgjeve dhe ambjenteve te paraburgimit. Ky rekomandim u hartua ne perfundim te inspektimeve ne disa prej qendrave penitenciare me numer te larte te denuarish dhe paraburgosurish si Burgu Fushe-Kruje dhe Burgu Korçe ku u konstatua mungesa e pajisjeve monitoruese, megjithese ishin te planifikuara si fonde investimi. Si nevoje emergjente per realizimin sa me shpejt te ketij procesi u konsiderua edhe respektimi i Protokollit te Stambollit miratuar me 9 Gusht 1999 nga Ansambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara dhe Komisioneri per te Drejtat e Njeriut i OKB-se, ku kerkohet nga shtetet pale te te krijojne mundesine per dokumentimin apo parandalimin e rasteve te tortures, trajtimit çnjerezor dhe degradues. Ne pergjigjen e paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve vonesat e vendosjes se kamerave u argumentuan me anullimin e procedurave te tenderave. Nderkohe aktualisht jemi informuar se instalimi i kamerave te sigurise ka perfunduar dhe eshte vene plotesisht ne funksionim.

4. Gjate periudhes parazgjedhore Qershor 2009, Avokati i Popullit tregoi interesimin e tij qe çdo te denuari dhe paraburgosuri t`i garantohej e drejta kushtetuese per te zgjedhur. Per kete qellim u paraqit nje rekomandim prane Ministrise se Drejtesise dhe Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve ku u kerkua qe te fillonte sa me pare procedura

e pajisjes me karta identiteti te te denuarve dhe paraburgosurve. Nga informacionet e paraqitura u vume ne dijeni se kishin filluar me shpejtesi procedurat per rregjistrimin e kesaj kategorie individesh dhe se shpejti do te fillonte edhe shperndarja e kartave te identitetit. Gjate procesit zgjedhor nuk u paraqiten ankesa per mungese te kartave te identitetit.

5. Avokati i Popullit e konsideron venien ne funksionim te sherbimit te proves si nje zhvillim mjaft pozitiv ne rritjen e standarteve te trajtimit te te denuarve ne vendin tone dhe ka shprehur shpesh mbeshtetjen per nje realizim sa me te shpejte dhe efikas te ketij institucioni ne sherbim te te drejtave dhe interesave te te denuarve. Në këtë kuadër institucioni yne u perfshi ne procesin e paraqitjes se rekomandimeve per permiresimin aspekteve te veçanta te projekt-rregullores “ Mbi standartet dhe procedurat e mbikqyrjes se ekzekutimit te denimeve alternative, si dhe organizimin dhe funksionimin e sherbimit te proves”

Në përfundim të miratimit te kesaj projekt-rregullore, jemi njohur se shumica e sugjerimeve dhe verejtjeve tona kishin gjetur pasqyrim te plote ne draftin final te miratuar.

6. Avokati i Popullit ne rolin e Mekanizmit Kombetar per Parandalimin e Tortures kreu se bashku me Institutin European te Tiranës nje vizite ne Burgun e Korçes ku u mor takim midis te paraburgosurve te mitur edhe me shtetasin A.I. 15 vjeç, i cili denoncoi se ndaj tij nje paraburgosur tjetër kishte ushtruar dhune seksuale. Konkretisht nga deklarimet e marra nga ky i mitur, rezultoi se para rreth 1 Muaji, ne Dhomen 4 te Seksionit te Paraburgimit per te miturit ne Burgun Korçe, i mituri ishte perballur me nje dhune seksuale nga i paraburgosuri K. R me moshe 19 vjeç. I mituri ka shpjeguar se pas kesaj, i paraburgosuri dhunues ishte ndeshkuar dy dite me izolim dhe me pas ishte transferuar ne seksionin tjetër te paraburgimit, ku qendrojne personat ne moshe madhore. Ne përfundim te kesaj deklarate, i mituri pohoi se pas kesaj ngjarje atij i mbahej dera e qelise e mbyllur dhe nuk lejohej nga policia e burgut te komunikonte me te paraburgosur te tjere, pasi sipas tij ata nuk donin qe te merret vesh kjo ngjarje. Perfaqesues te Njesise se Parandalimit te Tortures se Avokatit te Popullit, pasi kane degjuar rrefimin e ketij te mituri, kane kerkuar shpjegime per kete ngjarje edhe tek Drejtori i Burgut Korçe ne prani te Shefit te Policise, Shefit te Seksionit te Edukimit dhe Shefit te Sektorit Juridik te ketij institucioni. Nga keta te fundit eshte marre deklarimi se kjo ngjarje ka qene vetem nje thashethem i perhapur nga vete te paraburgosurit dhe personi i mitur nuk ka paraqitur asnjehere ankese per kete problem.

Avokati i Popullit ka paraqitur dy rekomandime per kete ngjarje te denoncuar. Fillimisht eshte referuar kallzimi i te miturit ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Korçe dhe me tej eshte paraqitur rekomandim prane

Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve per te marre ne analize urgjente dhe per te nxjerre pergjegjesite konkrete per kete ngjarje. Edhe pse mundesia e provueshmerise se nje vepre dhune te tille pas nje periudhe 1 mujore nuk kishte shume gjasa, Avokati i Popullit u ndal me teper ne kete ceshtje per dy probleme kryesore.

Se pari per te bere te ndjeshem sa me shume sistemin penitenciar ne rendesine e parandalimit te fenomeneve te tilla, duke marre te gjitha masat per ndarjen e ambjenteve te paraburgimit midis te miturve dhe te rriturve. Ky eshte nje prej detyrave kryesore qe duhet te kishte realizuar ne kohe Burgu Korçe dhe qe perben nje shkelje te rende te te drejtave te paraburgosurve.

Se dyti per te korrigjuar praktikat e dobta te veprimit te administrates se burgjeve per t`i dale perpara çdo denoncimi te tille, duke marre masat per hetimin dhe dokumentimin kryesisht te ngjarjes (qofte dhe thashethem) si dhe referimit te çdo kallzimi ne Prokurori.

Megjithese reagimi i Prokurorise, Ministrise se Drejtesise dhe Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve ishte i shpejte, ne perfundim te hetimeve dhe analizes nga keto organe nuk u arrit jo vetem te provohej ngjarja, por dhe te nxirreshin pergjegjesite administrative per indiference ndaj situatave te tilla nga personat pergjegjes. Avokati i Popullit me keqardhje konstaton se qendrimet e zbutura te mbajtura ne kete rast nga Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve nuk i sherbyen aspak respektimit te te drejtave dhe trajtimit te te paraburgosurve. Gjithashtu roli i Sherbimit te Kontrollit te Brendshem te Burgjeve ne kete ngjarje ishte mjaft siperfaqesor dhe nuk i sherbeu performances se saj si strukture e pavarur.

7. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i dënuari A. R, në të cilën ankohej lidhur me moszbatimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve per te perfituar vijimin e arsimit ne shkollen e larte. Konkretisht, në ankesë i dënuari shprehej se është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Shkodër me 6 vjet e 8 muaj burg dhe aktualisht ai pretendon se duhet të ndjekë studimet e larta te nderprera në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër në degën Cikël i Ulët.

Avokatit i Popullit bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ku përcaktohet se **“Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit për aq sa është e mundur praktikisht lejon të dënuarit, të cilët kanë mbaruar një shkollë të nivelit më të ulët, të ndjekin një shkollë të mesme apo të lartë në universitetet brenda ose jashtë burgut me ndihmën e mundshme të edukatorëve e profesorëve të jashtëm vullnetarë apo me shpërblim ”**, parashtrroi nje rekomandim per te marre masat ne lejimin e ketij te denuari per te ndjekur arsimin e larte.

Megjithese realizimi i nje kerkese te tille kerkon angazhim organike shtese ne sherbimet e policise se burgjeve nga ana e Burgut Lezhe u la e hapur mundesia e permbushjes se kesaj kerkese sa here do te krijohej mundesia. Ndodhur ne keto kushte Avokati i Popullit do te vijoje te insistoje qe detyrime te tilla ligjore nuk mundet te justifikohen nga administrata e burgjeve me numrin e pakte te personelit. Ndaj edhe ne te ardhmen do te kerkojme qe per kete problem te merren masa te pergjithesuara ne çdo institucion ku do te ndihet e nevojshme.

**8.** Gjate nje vizite qe perfaqesues te Avokatit te Popullit kryen ne Burgun e Shenkollit Lezhe, ne ambjentet e veçimit te ketij burgu u ndeshen me nje rast flagrant te mosveprimit te organeve shteterore dhe trajtimit poshterues dhe degradues ndaj nje te burgosuri te semure mendor.

Konkretisht shtetasi P.G. mbahej ne ambjentet e veçimit ne gjendje te rende te shendetit mendor, ne kushte higjenike degraduese dhe i pa denuar qe nga muaji Gusht i vitit 2004, date kjo qe perkon me arrestimin e tij sipas urdhrorit te Prokurorise. Per rastin ne fjale Avokati i Popullit ne rolin e Mekanizmit Kombetar te Parandalimit te Tortures konstatoi se shtetasi P.G. kishte humbje te afateve te gjykimit, mbahej ne burg 4,5 vjet i pa denuar dhe i izoluar per shkak te semundjes se tij.

I semuri mendor mbahej ne ambiente te veçimit per nje kohe te gjate ne kushte degraduese higjene dhe moskujdesi shendetsor etj. Per te gjitha sa me lart Avokati i Popullit paraqiti nje rekomandim kur kerkoi urgjentisht transferimin e ketij shtetasi ne Qendren Spitalore te Burgjeve Tirane, duke e konsideruar kete trajtim si shkelje flagrante të të drejtave të njeriut. Ne pergjigje te ketij rekomandimi u be e mundur qe ky shtetas te transferohej ne Qendren Spitalore te Burgjeve Tirane deri ne dhenien e nje vendimi gjyqesor perfundimtar.

**9.** Avokati i Popullit nisur nga nje ankese e familjareve te nje te paraburgosuri me aftesi te kufizuara inspektoi nga afer gjendjen dhe trajtimin shendetesor ne Institucionin e Paraburgimit Nr.302 Tirane.

Nga kontakti me Drejtorin e Burgut 302 Tirane, stafin shendetesor dhe vete te paraburgosurin ne fjale, Avokati i Popullit konstatoi se per kete te paraburgosur nuk ishin ofruar sherbime te mjaftueshme per te bere te mundur trajtimin e tij specifik (si person me aftesi te perkoshme te kufizuara) dhe per rrjedhoje gjendja e tij kishte filluar te rendohej me gjasa deri ne rrezikim serioz te jetes se tij, konstatuar kjo se fundi edhe nga vete mjeku i paraburgimit. Per sa me lart, ne rekomandimin qe Avokati i Popullit paraqiti per kete rast prane Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve u ngrit nevoja e transferimit urgjent te ketij te paraburgosuri ne Qendren Spitalore te Burgjeve (QSB). Gjithashtu Avokati i Popullit shpalosi qendrimin e tij se burgjet dhe paraburgimet ne vendin tone nuk ofrojne sherbime shendetesore te kualifikuara per personat me aftesi te

kufizuara. Perjashtim bejne vetem QSB Tirane dhe Burgu Kruje. Per pasoje duhet te unifikohet sa me pare praktika per te trajtuar njelloj te gjitha rastet qe paraqiten me probleme te tille. Ne pergjigjen e paraqitur per kete rekomandim u be e njohur se personi ne fjale ishte transferuar ne QSB Tirane.

**10.** Avokati i Popullit gjate nje inspektimi në I.E.V.P. Burrel konstatoi se i dënuari V. H kishte hyrë prej disa ditësh në grevë urie dhe se shkak u ishte transferimi i padrejtë nga I.E.V.P. Fushë-Krujë. Ky i dënuar sqaroi se, transferimi i tij nga I.E.V.P.Fushë-Krujë në I.E.V.P.Burrel ishte kryer për arsye se sipas tij kishte denoncuar nje ngjarje dhune ku protagonist kishin qene punonjës te policisë te ketij burgu. Për rrjedhojë ai pretendoi se transferimi tij në I.E.V.P.Burrel ishte tendencioz.

Avokati i Popullit nga analiza dhe verifikimi në tërësi i kësaj ankese konstatoi se pretendimet e këtij te dënuari ishin te drejta dhe rekomandoi marrjen e masave të menjëhershme me qëllim transferimin e të dënuarit për në I.E.V.P. Fushë -Krujë. Rekomandimi eshte pranuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve duke kryer brenda nje kohe te shkruter transferimin perkates.

### **III. Konstatime nga veprimtaria e inspektimit te Avokatit te Popullit ne burgje dhe paraburgime**

Avokati i Popullit ne rolin e Mekanizmit Kombetar per Parandalimin e Tortures ka kryer gjate vitit 2009 nje veprimtari te denuar inspektimi dhe ri-inspektimi ne te gjitha burgjet dhe paraburgimet ne vend. Çdo inspektim eshte shoqeruar me rekomandimet perkatese te cilat kane synuar te ndikojne sa me shume ne permiresimin e kushteve dhe trajtimit te denuarve dhe paraburgosurve. Ne vijim po listojme ne menyre te permbledhur disa prej konstatimeve tona te parashtruara si problematika per zgjidhje prane Ministrise se Drejtesise dhe Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve per te cilat eshte treguar angazhim i vecante deri ka patur zgjidhje pozitive.

**1.** Nga perfundim te disa inspektime te kryera gjate vitit 2009 ne Institucionin e Paraburgimit Nr. 313 Tirane eshte rekomanduar fillimi sa me pare i rikonstruksionit te ambjenteve te burgut, permiresimin e plote te kushteve te te paraburgosurve, veçanerisht te seksionit te grave, evitimin e lageshtires ne dhoma, korridore dhe ambjente te tjera. Jane kerkuar masa per dizinfektimin e ambjenteve per zhdukjen e minjve dhe insekteve, evitimin e dëgjimit të takimeve nga ana e personelit mbikqyrës, shtimin e nje psikologu dhe kujdestareve ne regjimin e femrave, shtimin e lavatriçeve per permbushjen plotesisht te nevojave per larje, krijimin e kushteve per ngrohje ne stinen e dimrit ne paraburgimin e

femrave dhe te te miturve etj. Ne vijim te masave te marra jemi vene ne dijeni se po rikonstruktohet plotesisht ambjenti i paraburgimit per grate dhe eshte dezinfektuar i gjithe paraburgimi.

2. Nga inspektimet e kryera ne IEVP-ne Nr.325 Tirane gjate vitit 2009, Avokati i Popullit ka rekomanduar fillimin sa me pare te rikonstruksionit te ambjenteve te burgut per permiresimin e plote te kushteve te te denuarve, veçanerisht në tualete dhe furnizimit normal me uje, evitimit te lageshtires, etj. Gjithashtu eshte kerkuar sistemimi i të sëmureve mendore që vuajnë nga skizofrenia në ambjentet e spitalit të burgut, përmirësimi i nivelit te cmimeve ushqimore dhe artikujve te tjere brenda atyre reale te tregut, për të evituar abuzimet ne çmime, rregullimi sa me pare me ane te nje grafiku te takimeve te te afermeve te denuarve, edhe në ditët e shtuna, si dhe marrjen e masave për shtimin e një kabine tjetër telefonike. Nga informacionet e paraqitura per kete rekomandim jemi informuar se jane planifikuar per t'u bere investime te plota ne Burgun Rrogozhine per transferimin e seksionit te grave ne kete institucion. Gjithesesi ne masat e tjera te marra per problemet e ngritura ishte kryer vendosja e lavatriceve, zgjidhja e problemit te ujit dhe dritave pa nderprerje 24 ore, ishin grupuar ne nje seksion te vecante kategoria e te denuarave femra qe vuajne nga semundje mendore te lehta, ishte evituar abuzimi me çmimet e mallrave ushqimore, duke ngritur nje komision te posacem monitorimi, ishte zgjidhur plotesisht problemi i takimit ditën e shtune me familjaret e te denuarve, si dhe ishte zgjidhur edhe vendosja e dy kabinave te reja telefonike.

3. Nga inspektimi i kryer ne IEVP-ne Sarande, Avokati i Popullit, nisur nga kushtet teper te papershtatshme te ketij paraburgimi per ofrimin sipas standarteve te sherbimeve, ka rekomanduar planifikimin dhe sigurimin e fondeve për krijimin e amjenteve të reja të Paraburgimit Sarandë. Ne pergjigjen e paraqitur per kete rekomandim jemi vene ne dijeni se eshte planifikuar qe paraburgimi Sarande te kaloje si seksion i veçante ne Burgun e ri qe do te ndertohet ne qytetin e Gjirokastrës. Gjithesesi deri ne realizimin e ketij transferimi, Drejtoria e Pergjithme e Burgjeve shprehu angazhimin per te permiresuar disa elemente emergjente ne kete institucion, si furnizimin me uje dhe drita, lysterjen e mureve dhe shtimin e pajimeve, shtimin e seancave te ajrimit per te paraburgosurit etj.

4. Nga inspektimet e kryera ne vitin 2009 ne IEVP-ne Kruje, Avokati i Popullit ka rekomanduar planifikimin e fondeve për rikonstruksionin sa më të shpejtë të disa elementeve kryesore të godinave të burgut, tejet të amortizuar, për të eliminuar lagështiren sidomos në ambjentet e dusheve dhe tualeteve, marrjen e masave të menjëhershme për zevendësimin e zgarave të vjetra të ndriçimit dhe adaptimin e tyre me një model ndriçuesi te sigurtë në përputhje me standartet e sigurise në

burgje, planifikimin dhe sigurimin e fondeve për zëvendësimin e dritareve tejet të amortizuara prej druri, zëvendësimin e pllakave manjoliqe të thyera në tualete dhe koridore, paisjen e të denuarve të papërgjegjshëm nga ana fizike me pajime higjienike të veçanta të cilat janë të domosdoshme në kryerjen e nevojave të tyre personale, marrja e masave urgjente për mbrojtjen me roje të burimit të ujit me të cilin furnizohet institucioni,. planifikimin dhe sigurimin e fondeve për përshtatjen e një ambjenti në një laborator mjeksor brenda institucionit, i cili të mundësojë kryerjen e analizave të përditshme, paisjen e institucionit me një ambulancë të përshtatshme me parametra normal për të transferuar të semurë, plotësimin e vendit vakant të mjekut psikiater, i domosdoshëm për ofrimin e shërbimit psikiatrik ndaj 70 të sëmurëve mendor të këtij institucioni, si dhe ngritjen e propozimeve përkatëse pranë Qeverisë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore që mundëson lidhjen e këtij burgu me qytetin e Krujës. Në përgjigje të rekomandimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Burgut Krujë kanë informuar për një sërë masash të marra për përmirësimin e kushteve. Konkretisht ishin mundësuar investime të pjesshme për eliminimin e lageshtirës, sigurimin e pajimeve për të semurët, vendosjen e mjeteve mbrojtëse për ndriçimin, zëvendësimin e dritareve, punësimin e një psikiatri me kohë të plote, si dhe ishte propozuar dhe miratuar në parim investimi për rregullimin e rrugës së Burgut Krujë.

5. Nga inspektimet e kryera gjatë vitit 2009 në IEVP-në Korçë, Avokati i Popullit rekomandoi punësimin e një mjeku neuropsikiater dhe një psikologu, ndërtimin sa më parë të depozitave të furnizimit me ujë, krijimin e kushteve të përshtatshme të ajrosjes dhe paisja sa më parë e këtij ambjenti me tenda mbrojtëse dhe çezma në mënyrë që të bëhet e frekuentueshme dhe në stinën e nxehtë të verës nga të denuarit, instalimin e kamerave vëzhguese, pajisjen e këtij Institucioni me mjete të domosdoshme të transportit si ambulance dhe mjet transporti shoqërimi, si dhe ndarjen e ambjentit të kultit në dy salla ku të sigurohet ushtrimi i besimit në dy ambiente të veçanta.

Nga përgjigja e paraqitur nga Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Burgut Korçë jemi njohur me një sërë masash të marra sipas rekomandimeve tona, veçanërisht në përfundimin e depozitave të ujit që aktualisht mundëson furnizimin normal me ujë të këtij burgu, në miratimin e fondeve për vendosjen e kamerave të sigurisë, pajisjen me një autoambulancë etj. Lidhur me propozimet e tjera Avokati i Popullit do të inisitojë edhe gjatë vitit 2010 që të merren masat përkatëse për kryerjen e investimeve.

6. Nga inspektimi i kryer në IEVP-në Berat gjatë vitit 2009, Avokati i Popullit, nisur nga kushtet tepër të papërshtatshme dhe të amortizuara të këtij paraburgimi për ofrimin e shërbimeve sipas

standarteve, ka rekomanduar planifikimin dhe sigurimin e fondeve për krijimin e amjenteve të reja të Paraburgimit Berat. Ne pergjigjen e paraqitur per kete rekomandim jemi vene ne dijeni se ishte planifikuar qe paraburgimi Berat te kalonte ne nje ambjent te ri prane Kombinatit Tekstil, ku paraprakisht po kryeshin edhe punime per kete qellim. Gjithesesi deri ne realizimin e ketij projekti Drejtoria e Pergjithme e Burgjeve shprehu angazhimin per te permiresuar disa elemente emergjente ne kete institucion, si furnizimin me uje, lysterjen e mureve dhe shtimin e pajimeve, shtimin e seancave te ajrimit per te paraburgosurit, mbajtjen e nje niveli te larte higjene etj.

7. Nga disa inspektime dhe vizita te kryera gjate vitit 2009 ne IEVP-ne Rrogozhine, Avokati i Popullit, rekomandoi pajisjen e ketij Institucioni me nje makinë ambulancë, krijimin e kushteve të përshtatshme të ajrosjes dhe pajisja sa më parë e ketij ambjenti me tenda mbrojtëse në mënyrë që të bëhet e shfrytëzueshme në stinën e nxehtë të verës, lejimin e të dënuarve për të telefonuar të djelave, heqjen e rretave të hekurit, krijimin e një regjimi më të zbutur ajrimi dhe eliminimin e lagështirës në ambjentet e izolimit, ofrimin e produkteve ushqimore dhe artikujve te tjere brenda niveleve reale te tregut, duke evituar abuzimet ne çmime marrjen e masave për furnizimin e rregullt me ujë, si dhe informimin e të dënuarve me procedurën e punësimit dhe transparencën për orët e punës qe ata kryenin. Nga pergjigjet e paraqitura jemi vene ne dijeni se ishin marre masat per furnizimin me uje, krijimin e oreve shtese per ajrim, informimin per oret e punes, si dhe po kryen disa investime te pjeshshme per eliminimin e lageshtires veçanerisht per dhomat e izolimit.

8. Nga inspektimi i kryer ne IEVP-ne Durres gjate vitit 2009, Avokati i Popullit rekomandoi kalimin brenda një kohe sa më të shkurtër të të miturve në një seksion të veçuar nga të rriturit, pajisjen e ketij institucioni me nje makinë-ambulancë dhe mjete mjeksore per ndihmen e shpejte, si dhe sigurimin e fondeve për ndërtimin e një vëndqëndrimi në hyrje të Institucionit për familjarët e të paraburgosurve. Nga pergjigjet e paraqitura per kete rekomandim jemi vene ne dijeni se ishin marre masat veçanerisht per sigurimin e pajisjeve mjeksore, rregullimin e nje vendqendrimi per familjaret si dhe te miturit ishin sistemuar ne nje seksion te veçante ne kete institucion te ndare nga madhoret.

9. Nga disa inspektime dhe vizita te kryera ne IEVP-ne Peqin gjate vitit 2009, Avokati i Popullit ka rekomanduar fillimin sa më parë të rikonstruksionit të ambjenteve të burgut për përmirësimin e plotë të kushteve të të dënuarve, veçanerisht të rivendosjes së furnizimit normal dhe cilësor me ujë, evitimit të lagështirës, plotesimin e organikës së shërbimit mjeksor të burgut me mjek të përgjithshem dhe psikiatër, si dhe krijimin e mundësive për punësimin e mjekëve specialistë të tjerë, qoftë edhe me sistem të përkohshëm pune (part-time), hartimin e një plani për



ofrimin e produkteve ushqimore dhe artikujve të tjere brenda niveleve reale të tregut, duke evituar abuzimet në çmime, rregullimin sa me parë me anë të një grafiku të takimeve të të afërmeve të dënuarve, duke vënë në dispozicion edhe një numër telefoni nga administrata e burgut për këtë qëllim, si dhe hartimin e një programi të diferencuar për të dënuarit me burgim të përjetshëm, të moshuar etj, si dhe mundësimin e kontakteve të familjeve me të dënuarit nga ana e sektorit të edukimit të Burgut Peqin. Ne pergjigjet e paraqitura për keto rekomandime, jemi vene ne dijeni se jane marre masat per rikonstruksionin e plote te disa prej ambjenteve të institucionit, si dhe ndërtimin e tualeteve në çdo qeli. Gjithashtu ishte vendosur furnizimi i vazhdueshëm me ujë pas ndërtimit të një linje të dytë ujësjellësi, ishte eliminuar lagështira nga tualetet e përbashkëta, ishte plotesuar organika e stafit mjeksor, ishte zgjidhur problemi i reklamimit të çmimeve të ushqimeve duke eliminuar abuzimet e mundshme, si dhe ishte vendosur një numër telefoni me familjaret e të dënuarve për të caktuar ditën e takimit me qëllim eliminimin e rradheve të gjata.

**10.** Nga inspektimet dhe vizitat e kryera gjatë vitit 2009 në IEVP-ne Tepelene, Avokati i Popullit, rekomandoi krijimin e një mjedisi sipas standarteve për shërbimin shëndetsor dhe një tjetër për avokatët, hartimin e një programi të diferencuar për të dënuarit me afate të gjata burgimi, si dhe mundësimi i kontakteve të familjeve me të dënuarit, përmirësimi i cilesise se ushqimit dhe krijimi i një ambjenti të mbuluar për pritje për familjaret.

Ne pergjigjen e paraqitur për keto rekomandime jemi vene ne dijeni se ishin marre masa për përmirësimin e cilesise se ushqimit, krijimit të ambjenteve të mbuluara për familjaret, si dhe hartimin e programeve të reja psiko-sociale për të dënuarit me afate të gjata burgimi. Problem mbetet krijimi i dhomave të veçanta për asistencën shëndetësore dhe avokatet, për të cilat po kërkohen fonde shtese.

**11.** Nga inspektimet dhe vizitat e kryera në IEVP-ne Burrel gjatë vitit 2009, Avokati i Popullit rekomandoi pajisjen sa më shpejt të ambjenteve të ajrosjes me tendë mbrojtëse, në mënyrë që të jetë e shfrytëzueshme si në stinën e nxehtë të verës ashtu dhe në kohë me shi, investimin me qëllim evitimin e lagështisë në disa mjedise e dhoma të të dënuarve, furnizimin e rregullt me ujë, krijimin e bibliotekës dhe krijimin e ambjentit për ushtrimin e rriteve fetare, vendosjen e çmimeve dhe ofrimin e produkteve ushqimore dhe artikujve të tjerë me cilësi të brënda çmimeve reale të tregut duke evituar abuzimet me çmimet. Megjithatë ky burg është kritikuar disa herë nga Avokati i Popullit për papershtatshmerinë e ambjenteve dhe kapaciteteve që ofron, është synuar që deri në mbylljen e plote të tij për shkak të ndërtimit të bugut të ri në Shkoder dhe Paraburgimit Diber të monitorohen elementet me të

rendesishem qe kane lidhje direkt me trajtimin e te denurarve dhe paraburgosurve.

Nga pergjigjet e paraqitura per rekomandimet e mesiperme, jemi vene ne dijeni se edhe per vitin 2010 ne Burgun e Burrelit do te vijojne meremetimet e pjesshme per eleminimin e lageshtires, si dhe riparimet e sistemit per furnizimin normal me uje. Nderkohe jane marre masat per monitorimin dhe kontrollin e çmimeve te produkteve ushqimore qe blihen nga te denuarit, si dhe ne disa pjese te ajrimit po planifikohet te vendosen disa tenda. Problem mbetet krijimi i ambjenteve te ushtrimit te kultit.

**12.** Nga inspektimi i kryer ne IEVP-ne Kukes gjate vitit 2009, Avokati i Popullit per shkak te amortizimit te madh te ketij institucioni, rekomandoi përsheptimin e procedurave për fillimin e punimeve në ndërtesën e re të Institucionit të Paraburgimit Kukës, vendosjen e krevateve në dhomat e paraburgimit, furnizimin me ujë të vazhdueshëm, vendosjen e aparatit telefonik në pozicion të përshtatshëm që të garantojë aksesin dhe privatësinë e të drejtës për telefonim të të paraburgosurve me familjet e tyre, si dhe krijimin e mjedisit të përshtatshëm për realizimin e takimit të të paraburgosurve me familjarët e tyre. Nga pergjigjet e paraqitura jemi vene ne dijeni se ne 6 mujorin e pare te vitit 2010 fillojne punimet per ngritjen e Paraburgimit te ri ne Kukes, i cili do te zgjidhe te gjitha problemet lidhur me kushtet e ambjenteve aktuale. Nderkohe jane marre masa per garantimin e ujit te pijshem ne menyre te vazhdueshme, vendosjen e disa krevateve portative, si dhe jane pershtatur ambjentet per takimet me familjaret dhe komunikimit me telefon.

**13.** Avokati i Popullit gjate vitit 2009 ka kryer nje vizite edhe ne Paraburgimin Tropoje, i cili ishte ne fazen e rikonstruksionit te pergjithshem. Aktualisht jemi vene ne dijeni se pritej vetem lidhja e godines me rrjetin e ujit te pijshem dhe brenda muajit Shkurt 2010 Paraburgimi i ri i Tropojes do te filloje punen.

### **Vleresime te pergjithshme**

Sistemi penitenciar ne vendin tone eshte ne nje proces tranzicioni te shpejte, ne te cilen jane perqendruar investime te medha per rritjen e standarteve te kerkuara. Ne te gjithe veprimitarine e tij ne kete fushe, Avokati i Popullit ka vleresuar gjuhen e sinqerte te bashkepunimit veçanerisht me Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve dhe me te gjithe administraten e IEVP-ve. Dialogu dhe komunikimi i vazhdueshem me kete administrate ka sjelle ne praktike zgjidhjen e shume problemeve ne dukje te vogla, por qe kane patur nje peshe te madhe ne ankesat e te denuarve dhe paraburgosurve.

Avokati i Popullit vlereson angazhimin e vazhdueshem te efektiveve te policise se burgjeve per te vijuar me intensitet trajnimet e

tyre ne fushen e te drejtave te njeriut. Gjate vitit 2010 pjese e ketyre trajnimeve do te jene edhe eksperte te Avokatit te Popullit, te cilen me eksperiencen e tyre do te promovojne njohuri te reja mbi respektimin e te drejtave te te denuarve dhe paraburgosurve.

Gjithashtu eshte per tu vleresuar prania e shtuar e drejtuesve te administrates se burgjeve ne çdo seminar, workshop apo tryeze te rumbullaket qe organizohet nga Avokati i Popullit, objekt i se ciles jane standartet e te drejtave te njeriut ne fushen penitenciare.

Ne shpresojme qe ky nivel dialogu konstruktiv dhe bashkepunim te ndersjelle te vazhdoje me te njejtin ritim edhe ne te ardhmen.

## **B. Ankesat për Zyrat e Shërbimit Përmbartimor**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka treguar një vëmendje të veçantë për veprimtarinë e Zyrave Përmbartimore në Rrethe lidhur me ekzekutimin e titujve ekzekutiv prej tyre. Gjatë vitit 2009, janë mbartur prej vitit 2008 gjithësej 45 ankesa, si dhe janë depozituar gjatë këtij viti 85 ankesa me anë të të cilave shtetasit kanë ngritur pretendimet e tyre rreth moskryerjes, zvarritjes apo kryerjes së veprimeve përmbartimore në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Nga 130 ankesat e trajtuara prej Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2009, për moszbatimin e titujve ekzekutiv nga Zyra Përmbartimore apo organet dhe institucionet e administratës publike janë përfunduar 95 ankesa, nga të cilat 40 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Për qëndrimet e mbajtura nga Zyra Përmbartimore në ekzekutimin e titujve ekzekutiv janë bërë 27 rekomandime, nga të cilat 16 janë pranuar prej Zyrave Përmbartimore apo organet dhe institucionet të cilave i jemi drejtuar, 5 nuk janë pranuar dhe për 6 rekomandime ende nuk është dhënë përgjigje apo janë në proces shqyrtimi.

Gjithashtu nga 130 ankesa të trajtuara gjatë vitit 2009, 17 ankesa kanë rezultuar të pabazuara, 3 kanë qënë jashtë juridiksionit, 11 jashtë kompetencës dhe nuk ka rezultuar heqja dorë prej ankesës nga ndonjë ankues.

Sipas statistikave konstatohet se numri më i madh i ankesave të trajtuara gjatë vitit 2009 është ndaj Zyrës Përmbartimore Tiranë, gjithësej 51 ankesa. Po kështu rezulton se 4 ankesa janë kryer kundër Zyrës Përmbartimore Fier, 5 ndaj Zyrës Përmbartimore Pogradec, 9 ndaj Zyrës Përmbartimore Gjirokastër, 7 ndaj Zyrës Përmbartimore Korçë, 3 ndaj Zyrës Përmbartimore Shkodër, 4 ndaj Zyrës Përmbartimore Lezhë, 6 ndaj Zyrës Përmbartimore Elbasan, e më pas vijnë ankesa ndaj Zyrës Përmbartimore, Vlorë, Durrës, Kurbin, Kukës, Përmet, Berat, Mat, Mirditë, Krujë, Tepelenë, Kavajë, Tropojë, Sarandë etj.

Rezulton se më shumë ankesa për shërbimin përmbartimor pas ndërhyrjes tonë, janë përfunduar nga Zyra e Përmbartimit Tiranë e cila rezulton të ketë trajtuar dhe numrin më të madh të çështjeve siç është thënë më sipër.

Në marrëdhënie me Avokatin e Popullit për vitin 2009, përgjithësisht Zyrat Përmbartimore, kanë dhënë informacion dhe shpjegime brenda afateve të kërkuara si dhe kanë lëshuar kopjet e akteve për veprimet proceduriale përmbartimore të kryera. Por ka dhe raste të tjera kur Zyrat Përmbartimore në Rrethe si ajo e Durrësit e cila për rastin e ankesës së shtetasës A.K. ka kryer dhënien e shpjegimeve pas 7 muajsh, nga data e kërkesës sonë të ripërsëritur.

Për vitin 2009 janë depozituar 25 ankesa në Institucionit tonë, të cilat kanë të bëjnë me mosëkzekutimin e titujve ekzekutiv ku si palë debitore janë organet apo institucionet shtetërore të cilat janë të detyruar të kthejnë shuma të caktuara në lekë ndaj subjekteve private. Shqetësues, ky problem, është për ato raste kur gjyqfituesit presin me vite të tëra për marrjen e detyrimit financiar prej organit apo institucionit shtetëror, por gëzimi i së drejtës nga ana e tyre nuk është i mundur ende sot e kësaj dite, për shkak se pala debitore si dhe organi epror financiar i palës debitore, nuk kanë repektuar detyrimin ligjor të sanksionuar në nenin 589 të K.Pr.C. Gjithashtu nuk zbatojnë nenin 20 të Ligjit Nr.8510, datë 15.07.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, ku përcaktohet se: ”Të gjitha detyrimet për shkaktimin e dëmit, që organet e administratës shtetërore kanë kundrejt personave fizikë a juridik privat, në rast se nuk paguhen menjëherë për pamundësi financiar futen si zë i veçantë në ligjin e buxhetit të shtetit në vitin pasardhës”.

Mosrespektimi i detyrimit ligjor të sipërcituar ka ndodhur dhe ndodh në mosdhënien e detyrimit financiar shtetasit E.T, prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave Tiranë, konform përcaktimit të kryer në Titullin Ekzekutiv Nr. 81, datë 29.06.2006, të Gjykatës së Apelit, Tiranë. Sikur të mos mjaftojë dëmi ekonomik, i cili i shtohet nga dita në ditë palës debitore, pra Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave Tiranë, titullari i këtij organi “justifikon” mospërmbushjen e detyrimit ligjor me pretendime absurde si “...nuk mund të fillojë procedura e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Nr.81, datë 29.06.2006, pa u paraqitur kopje orgjinale e vendimeve nga Zyra Përmbartimore...”. Të njëjtin qëndrim në kundërshtim me ligjën, por në një formë tjetër mban dhe Drejtori i Përgjithshëm e Tatim-Taksave, lidhur me përmbushjen e detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor Nr. 1827, datë 07.07.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, sipas të cilit është vendosur detyrimi për pagimin e pagës dhe rikthimin në vendin e mëparshëm të punës të shtetasit S.T. nga Korça. Nga ana e tij Drejtori i Përgjithshëm e Tatim-

Taksave, shprehet se "... Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave ka ushtruar rekurs ndaj Vendimit Gjyqësor Nr. 345, datë 03.12.2008, të Gjykatës së Apelit Korçë, dhe se pas shqyrtimit të rekursit do të ndiqen procedurat ligjore për ekzekutimin e vendimit". Ky qëndrim bie në kundërshtim me përcaktimin e kryer në dispozitën urdhëruese të K.Pr.C., neni 451/ç, si dhe neni 142/3 të Kushtetutës së Shqipërisë.

Me të drejtë Zyra Përmbaremore, Tiranë, bazuar jo vetëm në nenin 606 të K.Pr.C., por dhe në rekomandimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, ka vendosur më datë 27.01.2009, gjobitjen e titullarit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave, Tiranë. Po kështu ka vepruar edhe Zyra Përmbaremore Tiranë, në rastin e ekzekutimit të Titullit Ekzekutiv Nr. 6642, datë 23.11.2006, kur prej saj është vendosur më datë 20.02.2009, sanksioni i gjobitjes ndaj Prefektit të Qarkut, Tiranë.

Përmbushja e detyrimit ligjor prej Zyrës Përmbaremore Tiranë, konstatohet në këto raste se nuk është bërë në mënyrë konsekuente, pra me vendosjen e sanksionit të gjobitjes jo vetëm rast pas rasti, por dhe në mënyrë të përsëritur ndaj titullarit të palës debitore, vjeljes së tyre, si dhe kryerjes së kallzimit penal ndaj tij për kryerjen e veprës penale të "Pengimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor", parashikuar në nenin 320 të K.Penal.

E njëjta situatë juridike është dhe për 25 ankesat e trajtuara ose në trajtim prej Institucionit të Avokati të Popullit, ku organe apo institucione si Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Policisë Qarku, Korçë, Prefektura e Qarkut Tiranë, Bashkia Himarë, Bashkia Kuçovë, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, Komunat Hotolisht e Qukës Librazhd, Drejtoria e Arsimit Kukës, Universiteti Bujqësor Tiranë, Ndërmarrja e Rrugëve, Rurale Gjirokastrë, Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik Kombëtar, nuk përmbushin detyrimet ligjore të dorëzimit të shumave në lekë gjyqfituesve apo rikthimin e gjyqfituesve në vendet e mëparëshme të punës sipas përcaktimit të kryer në dispozitivet e titujve ekzekutiv.

Krahas rasteve të përmendura më sipër, të cilat ende nuk janë zgjidhur në favor të ankuesve, vlen të përmendim edhe raste sikurse është përmbushja e detyrimit financiar nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit Fier, në zbatim të Vendimit Gjyqësor Nr. 715, datë 08.05.2007, ndaj shtetasit D.Xh. me ndërhyrjen e Institucionit tonë apo përmbushja e detyrimit financiar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ndaj shtetasit F.L.

Kjo situatë ka bërë që ndonjë gjyqfitues t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar "Konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për kryerjen e një procesi të rregullt ligjor" duke qenë se

zhvillimi i procedurës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv nuk është kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Mund të përmendim në këtë rast kërkesën e kryer nga shtetasi A. B., para Gjykatës Kushtetuese e cila në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, me Vendimin Nr. 01, datë 19.01.2009, ka vendosur “Për konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhje e moszbatimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.18, datë 21.03.2006 të Gjykatës së Apelit, Tiranë”.

Në 8 prej rasteve ku organet apo institucionet shtetërore e sipërpërmendura janë debitore për dorëzim detyrimesh në lekë sipas tujve ekzekutiv, është vendosur dhe detyrimi i tyre të rikthejnë subjektet gjyqfitues në vendin e mëparshëm të punës.

Në asnjë prej 8 rasteve të paraqitura pranë Institucionit tonë, deri më sot, nuk është bërë i mundur rikthimi i gjyqfituesve në vendin e mëparshëm të punës, duke bërë në këtë mënyrë jo vetëm rritjen e dëmit ekonomik ndaj organit apo institucionit shtetëror, por dhe mohimin e gëzimit të së drejtës ligjore të fituar në rrugë gjyqësore prej shtetasve.

Mungesa e vullnetit prej drejtuesve të organeve dhe institucioneve shtetërore për përmbushjen e detyrimeve ligjore në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ka krijuar precedent të cilët çenojnë më tej imazhin e Shtetit Shqiptar në rast se subjektet do të bënin kërkesë pranë Gjykatës për të Drejtat e Njeriut në Strasburg për shkeljen e të drejtave të tyre, fituar prej tyre në Gjykatat Shqiptare.

Për qëndrimin e mbajtur prej organeve dhe institucioneve shtetërore, në kundërshtim me nenin 589 të K.Pr.C. si dhe nenin 20 të Ligjit Nr.8510, datë 15.07.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, Zyrat Përmbartimore në rrethe përgjithësisht nuk kanë kryer përmbushjen e detyrimit ligjor për gjobitjen e subjekteve përkatës sikurse është përcaktuar në nenin 606 të K.Pr.C. Kështu ka ndodhur në rastin e Vendimit Gjyqësor Nr.81, datë 29.06.2006, të Gjykatës së Apelit, Tiranë, dhe Nr. 6642, datë 23.11.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhënë në favor të shtetasve E.T. dhe I.H., prej Zyrës Përmbartimore, Tiranë.

Për rastet e ankesave të shtetasve kundër zyrave përmbartimore në rrethe për moszbatimin e tujve ekzekutiv me objekt detyrimin e organeve dhe institucioneve shtetërore të paguajnë shuma të caktuara në lekë apo kthimin e gjyqfituesve në vendin e mëparshëm të punës, Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë 22 rekomandime sipas të cilave është kërkuar marrja e masave të menjëhershme për zbatimin e detyrimit ligjor sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, vendosjen e sanksioneve ligjore ndaj subjekteve të palës debitore, të cilët me mosveprim pengojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore, kërkimin prej Zyrës Përmbartimore në Ministrinë e Financave ose organit epror të palës debitore caktimin e

fondit të nevojshëm ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit. Detyrimet e mbartura nga viti në vit jo vetëm që nuk kanë gjetur zgjidhje, por konstatohet se debiti po shtohet si nga vendimet gjyqësore të reja, ashtu edhe nga ato për pagimin e interesave apo fitimit të munguar, duke u bërë kështu shqetësim kryesor si për Shërbimin Përmbartimor, ashtu edhe për Institucionin e Avokatit të Popullit.

Në këto raste të dëmtuar janë si gjyqfituesit, të cilët pasi kanë ndjekur procedurat në gjykatë për vite të tëra duhet të përballen dhe me zvarritje të pajustificueshme për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, ashtu dhe buxheti i shtetit i cili për çdo ditë vonesë në ekzekutimin e titujve ekzekutiv duhet të paguaj një shumë më të madhe në lekë për zbatimin e tyre.

Në nderhyrjet tona sipas kompetencave të njohura nga ligji, jemi përpjekur në rradhë të parë të tërheqim vëmendjen e Qeverisë dhe institucioneve apo organeve shtetërore debitore, duke kërkuar prej tyre zbatimin me rigorozitet të nenit 142/3 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut si dhe në ndryshimin e mentalitetit të disa drejtuesve të cilët nuk kuptojnë drejt fuqinë detyruese të vendimit gjyqësor që ka marrë formë të prerë.

Me vëmendje janë trajtuar prej Institucionit të Avokati të Popullit ankesat ndaj Zyrave Përmbartimore në rastet e zbatimit të titujve ekzekutiv me objekt “Takim fëmije”, gjithësej 2 raste, apo “Pagim pensioni ushqimor”, gjithësej 2 raste.

Për rastet në fjalë kanë përfunduar së trajtuari një rast me objekt “Pagim pensioni ushqimor” në favor të ankueses dhe rasti i ankesës me objekt sipas titullit ekzekutiv “Takim fëmije” ka rezultuar i pabazuar në ligj. Për dy rastet e tjera Institucioni i Avokatit të Popullit, është në vazhdim të kryerjes së procedurave ligjore.

Gjithashtu një problem tjetër që ka dalë nga trajtimi i ankesave ka qënë edhe niveli jo gjithmonë i kënaqshëm i cilësisë së veprimeve të përmbartuesve gjyqësore, bazuar në kërkesat ligjore të Kodit të Proçedurës Civile. Në shumë raste, gjatë verifikimeve të ankesave në dosjet përmbartimore, rezulton se ka veprime ose mosveprime, që janë tregues të mangësive të formimit profesional, pavarësisht shkakut apo motivit konkret, si mungesë e njohjes së legjislacionit civil dhe atij proçedural civil, keqinterpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor, nënvleftësim, harresë, ngutje, mungesë etike në komunikim, etj.

Ndër shkaqet kryesore që kanë penguar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ka qënë edhe qëndrimi jo konsequent i përmbartuesve për zbatimin e kërkesave të ligjit. Janë jo të pakta rastet kur përmbartuesit gjyqësorë nuk respektojnë detyrimet ligjore të sanksionuar në K.Pr.C., veçanërisht nenin 606 të Kodit të Proçedurës Civile për dënim me gjobë të të gjithë subjekteve që me veprim apo mosveprim nuk

përmbushin detyrimin ligjor të njoftuar apo urdhëruar nga Zyrat Përmbarimore. Po kështu, konstatohet në veprimtarinë e Zyrave Përmbarimore moskryerja e kërkesës për fillimin e procedimit penal ndaj subjekteve të cilët me veprim apo mosveprim kanë konsumuar veprën penale të “Pengimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor”, e parashikuar e dënueshme në nenin 320 të K.Penal.

Në veprimtarinë e Zyrave Përmbarimore, është e domosdoshme ndryshimi i kuadrit ligjor lidhur me moskushtëzimin e kryerjes së rregjistrimit dhe fillimit të veprimeve përmbarimore me pagimin e taksës së ekzekutimit, për çështjet që depozitohen pranë tyre për veprim.

Ky qëndrim i Zyrave Përmbarimore është mbështetur në nenin 525 të Kodit të Procedurës Civile. Gjyqfituesi në rast se nuk ka mundësi për kryerjen e pagimit të taksës së ekzekutimit në masën 3 % apo 7%, i mohohet e drejta e gëzimit të së drejtës, fituar prej tij në rrugë ligjore (gjyqësore).

Kjo situatë paraqet domosdoshmërinë e zgjidhjes sa më parë të problemit në favor të gjyqfituesve, me anë të akteve ligjore të reja. Ashtu sikundër nuk mund të pengohet dhe pushohet gjykimi i çështjeve civile për shkak të mospagimit të shpenzimeve gjyqësore nga paditësi (ose kërkuesi), po kështu nuk mund të pengohet dhe kushtëzohet kryerja e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv me parapagimin e taksës së ekzekutimit.

Të shumta janë rastet kur Zyrat Përmbarimore rikthejnë taksën e ekzekutimit për shkak të mosekzekutimit të titullit ekzekutiv në ngarkim të debitorit, pasi ky i fundit rezulton të mos ketë pasuri të sekuestrueshme. Kjo praktikë përforcon mendimin se pagimi i taksës së ekzekutimit duhet të kryhet pas vjeljes së saj palës debitore, në raport me shumën e vjelë në ngarkim të saj.

Qëndrime të tilla ndaj personave gjyqfitues, kanë ulur besimin e shtetasve ndaj organeve dhe nëpunësve të administratës, duke cënuar reputacionin e shkallën e besueshmërisë në sistemin tonë të drejtësisë. Sot në Shqipëri ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një handikap në sistemin e dhënies së drejtësisë, që në raste të veçanta vë në dyshim funksionimin e vetë sistemit.

Ndër rastet e paraqitura pranë Institucionit tonë mund të përmendim:

1. Ankesën e shtetasit B.P, i cili ankohej për mosekzekutimin dhe zvarritjen pa asnjë shkak ligjor të Vendimit Gjyqësor Nr. 5624, datë 16.07.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas Vendimit Gjyqësor në fjalë është vendosur detyrimi i një subjekti juridik privat të dorëzojë ambjente të caktuara në një godinë të ndërtuar sipas akt-marrëveshjes të kryer midis B.P dhe Shoqërisë “Alba-Flor” tyre. Po kështu sipas Vendimit Gjyqësor Nr. 5624, datë 16.07.2007, është



vendosur detyrimi i subjekti juridik privat të kryej dhe pagimin e shumave të caktuara në lekë ankuesit B.P. Zyra Përmbartimore, Tiranë, për rastin në fjalë megjithëse ka kryer nxjerrjen e akteve për zbatimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Nr. 5624, datë 16.07.2007, qysh më datë 23.01.2009, ende sot e kësaj dite nuk përmbush në mënyrë të rregullt detyrën në kryerjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor të sipërcituar. Për këtë rast Institucioni i Avokatit të Popullit, ka rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme për ekzekutimin e Vendimit, si dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbartuesit gjyqësor. Deri më sot detyrimin për dhënien e përgjigjes për pranimin ose jo të rekomandimeve Zyra Përmbartimore Tiranë, e “justifikon” me Shkresën Nr. 229/1, datë 27.03.2009, të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor. Për vetë përmbajtjen e kësaj Shkrese si dhe kompetencat e përcaktuara në Ligjin Nr.8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbartimit gjyqësor”, Drejtori i Përgjithshëm i këtij shërbimi nuk mund të ndërhyjë gjatë zhvillimit të procedurave përmbartimore nga përmbartuesi gjyqësor. Në asnjë dispozitë të K.Pr.C. nuk i njihet e drejta Drejtorit të Përgjithshëm apo Kryetarit të Zyrës Përmbartimore të ndërhyjë gjatë zhvillimit të procedurave për ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor. Në mënyrë aspak profesionale dhe në abuzim me kompetencat e njohur nga ligja për Institucionin e Avokatit të Popullit, përmbartuesi gjyqësor i çështjes për zvarritjen sa të jetë e mundur të ekzekutimit të Titullit Ekzekutiv, ka kryer më datë 13.01.2010, marrjen e vendimit “Për refuzimin e zbatimit të ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Nr. 5624, datë 16.07.2007”.

Kjo situatë absurde e krijuar nga Zyra Përmbartimore Tiranë, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, meriton vëmendjen për nxjerrjen e përgjegjësive ndaj personave përgjegjës të cilët vijnë shkëlqen e gëzimit të së drejtës, fituar prej shtetasit B.P. në rrugë gjyqësore.

2- Një qëndrim aspak profesional dhe në vlerësimin tonë abuzues është dhe moskryerja apo refuzimi i kryerjes më tej të veprimeve përmbartimore në rastet e ekzekutimit të Vendimeve Gjyqësore Nr.1189, datë 03.03.2005, nga Zyra Përmbartimore Tiranë, Vendimit Gjyqësor Nr. 98, datë 20.02.1992, nga Zyra Përmbartimore Fier, dhe Vendimit Gjyqësor Nr.946, datë 07.11.2005, nga Zyra Përmbartimore Gjirokastrë,

a) Për rastin e zbatimit të Vendimit të Gjyqësor Nr.1189, datë 03.03.2005, konstatohet se ankuesi B.B. nga Tirana, ka fituar të drejtën e lirit dhe dorëzimit të një sipërfaqeje të caktuar toke. Rezulton se Zyra Përmbartimore, Tiranë, ka kryer regjistrimin e çështjes që më datë 17.03.2007 dhe se deri më datë 24.03.2009, nuk është bërë i mundur ekzekutimi. Që më datë 24.03.2009 përmbartuesi gjyqësor i çështjes pa

asnjë shkak ligjor zvarrit ekzekutimin dhe kryen veprime përmbarimore të cilat janë jashtë objektit të ekzekutimit të Vendimit të Gjyqësor Nr.1189, datë 03.03.2005, për “justifikimin” e zvarritjes së mëtejshme të ekzekutimit të këtij Vendimi. Më tej kjo Zyrë, ka kryer marrjen e Vendimit Nr. 18361, datë 25.11.2009, “Për caktimin e ekspertit për vlerësimin e sendeve të paluajtshme” apo urdhërimin e Z.V.RR.P.P., Tiranë, me Shkresën Nr. 18461, datë 25.11.2009, për dhënie kopje aktesh pronësie për pasurinë objekt ekzekutimi.

Aktet e pronësisë mbi pasurinë objekt ekzekutimi, ankuesi, njeherazi gjyqfitues, i ka depozituar si në Zyrën Përmbarimore Tiranë, ashtu dhe pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Këto akte gjithashtu janë të administruar në dosjen gjyqësore të krijuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazë të të cilave është kryer dhe dhënia e Vendimit Gjyqësor Nr. 1189, datë 03.03.2005. Në rast se përmbaruesi gjyqësor dëshiron të njihet me aktet që ekzistojnë dhe mbi bazë të cilave është i detyruar të kryej procedurat përmbarimore, nuk ka përse thërret ekspert, nuk ka përse i kërkon ato pranë Z.V.RR.P.P., Tiranë, pasi ato në bazë të nenit 26/2 të Ligjit Nr.8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor” mund t’i mbledhë ose t’i kërkojë t’i vihen në dispozicion nga sistemi i drejtësisë. Thirrja e ekspertit nga ana e tij, për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor Nr. 1189, datë 03.03.2005, me këtë lloj objekti ekzekutimi është fund e krye e paligjshme. Kjo më së miri konstatohet dhe në referencat ligjore të kryera prej tij me rastin e marrjes së Vendimit 18361, datë 25.11.2009. Paradoksale është fakti se përmbaruesi gjyqësor thërret si ekspert po atë që ka thirrur Gjykata me rastin e dhënies së Vendimit Gjyqësor Nr. 1189, datë 03.03.2005, dhe se këtij ekspertit i kërkohet të kryej të njëjtin ekspertim që ka kryer kur është caktuar si ekspert nga Gjykata. Ky qëndrim i përmbaruesit gjyqësor J.A. në kuptim dhe zbatim të nenit 29/3 të Ligjit Nr.8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor” është i ndëshkueshëm.

b) Lidhur me rastin e zbatimit të Vendimit Gjyqësor Nr.98, datë 20.02.1992, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, në favor të B.Z. dhe D.Z. me objekt “Detyrim për lirim dhe dorëzim sendi (sipërfaqe toke bujqësore)” nga hetimi i kryer prej Institucionit të Avokatit të Popullit rezulton se është shkuar nga përmbaruesi gjyqësor në vendin e objektit të ekzekutimit dhe se pas këtij veprimi Zyra Përmbarimore Fier, me Vendimin Nr.387/gj, datë 21.10.2009, ka vendosur të refuzojë zbatimin e Titullit Ekzekutiv Nr.98, datë 20.02.1992, me pretendimin se mbi sipërfaqen e tokës objekt ekzekutimi ndodhen të ndërtuara objekte të paluajtshme për të cilat Gjykata nuk është shprehur nëse duhen prishur ose jo.

Ky qëndrim i përmbaruesit gjyqësor është i pajustificueshëm dhe në kundërshtim me përcaktimin e kryer në nenin 603 të K.Pr.C. Është detyrim i Zyrës Përmbarimore Fier, të kryej ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Nr.98, datë 20.02.1992, duke prishur dhe larguar nga sipërfaqja e tokës objekt ekzekutimi çdo send të ndërtuar apo ndodhur mbi të. Duke qenë se veprimet përmbarimore sipas nenit 610 të K.Pr.C. kundërshtohen vetëm në Gjykatë si organ i vetëm i ngarkuar nga ligja për vlerësimin ligjor të veprimeve përmbarimore, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të kryej kërkesë apo rekomandim Zyrës Përmbarimore Fier, për revokimin e Vendimit Nr. 387/gj, datë 21.10.2009 të Zyrës Përmbarimore, Fier.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor ka detyrimin të mbaj qëndrim lidhur me anulimin apo shfuqizimin e veprimeve përmbarimore të kryera nga Gjykata si dhe të sigurojë zbatimin e njëjtë të praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit, duke përfshirë detyrimin e Zyrave Përmbarimore në rrethe që të kryjnë të njëjtat veprime për ekzekutim kur vjen fjala për zbatimin e titujve ekzekutiv me objekt sikurse Vendimi Gjyqësor Nr.98, datë 20.02.1992.

Në asnjë rast, kur janë bërë objekt shqyrtimi para Gjykatave, nuk është lënë në fuqi vendimi për refuzimin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për vendimet gjyqësore me objekt sikurse Vendimi Gjyqësor Nr.98, datë 20.02.1992.

c) Megjithëse kjo situatë juridike është e kuptueshme dhe nuk ka arsye ligjore të përsëritet, ajo ndeshet herë pas here në veprimet e Zyrave Përmbarimore në rrethe. Në vlerësimin e Institucionit tonë praktikimi prej Zyrave Përmbarimore i marrjes së vendimeve për refuzimin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi”, nuk është vetëm mungesë profesionalizimi. Kjo më së miri konstatohet në moskryerjen e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm nga Zyra Përmbarimore Gjirokastër, të Vendimit Gjyqësor nr.946, datë 07.11.2005, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyësor, Gjirokastër, me Objekt: “Detyrim për lirim banese e trualli”. Megjithëse kërkesa për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor në fjalë është depozituar që në Nëntor të vitit 2007, prej gjyqfituesit V.K., konstatohet se përmbaruesi gjyqësor i çështjes nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për kryerjen e veprimeve përmbarimore në përputhje me përcaktimet e kryera në K.Pr.C. Pas afro 1(një) viti të depozitimit të kërkesë për ekzekutim të këtij Vendimi Gjyqësor, përmbaruesi gjyqësor i çështjes “kujtohet” se zbatimi i këtij titulli ekzekutiv duhet refuzuar pasi sipas tij ekzisitojnë “shkaqe ligjore”, të cilat justifikojnë marrjen e Vendimit Nr.24, datë 14.11.2008. Ky Vendim i përmbaruesit gjyqësor është anuluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me Vendimin Nr.11, datë 12.01.2009. Me marrjen

formë të prerë të Vendimit Gjyqësor Nr.11, datë 12.01.2009, Zyra Përmbartimore deri më datë 02.08.2009, përsëri nuk kryen veprimet për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Nr. 949, datë 07.11.2005. Shprehemi deri më datë 02.08.2009, për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me Vendimin Nr. 144, datë 02.08.2009, ka vendosur për “Pezullimin e zbatimit të Vendimit Gjyqësor Nr. 946, datë 07.11.2005”. Për këtë vendimmarrje të kryer nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, e cila vlerësohet nga ana jonë e paligjshme, mbi bazë të ankesës së shtetasit V.K. e kemi dërguar për kompetencë pranë Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Rast tjetër kur gjykatat kanë vendosur për anulimin e vendimit të zyrave përmbartimore për refuzimin e kryerjes së veprimeve përmbartimore në ekzekutimin e titujve ekzekutiv me objekt sikurse Vendimi Gjyqësor Nr.98, datë 20.02.1992, është Vendimi Gjyqësor Nr.272, datë 23.02.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Elbasan, sipas të cilit është anuluar Vendimi Nr.10, datë 31.10.2005, i Zyrës Përmbartimore, Elbasan, për refuzimin e zbatimit të Vendimit Gjyqësor Nr. 729, datë 27.05.2002, për të cilin është lëshuar Urdhëri i ekzekutimit Nr. 36, datë 24.01.2003 nga kjo Gjykatë. Shkak për moszekutimin e këtij vendimi është bërë mungesa e një fadrome prishëse për rrethin e Elbasanit.

3. Ankesa e shtetasit S.G. ndaj Zyrës Përmbartimore, Durrës, për mosdhënie informacioni si dhe moskryerje veprimesh për verifikimin dhe sekuestrimin e pasurive të debitorit në zbatim të Titullit Ekzekutiv Nr. 3078, datë 17.11.2008, ka gjetur rrugën ligjore të zgjidhjes me ndërhyrjen e kryer si dhe dhënien e rekomandimit përkatës kësaj zyre.

Nga shqyrtimi i të gjitha rasteve që kanë patur të bëjnë me moszekutimin e vendimeve gjyqësore, duam të ritheksojmë dhe njëherë së është koha që institucionet që administrojnë financat shtetërore, të ballafaqohen me këtë realitet, të mbajnë përgjegjësitë që ju takojnë dhe të punojnë për zbutjen e problemit me mundësitë reale financiare të disponueshëm. Gjithashtu i duhet kushtuar vëmendje forcimit të ndjenjës së përgjegjësisë së administratorëve shtetërorë në raport me ligjin, që në veprimet e tyre të përditshme në marrëdhënie me individët, të jenë të kujdesshëm në raporte të tilla të ndjeshme, si dhe respektimin e pronës private, të marrëdhënieve të punës, të interesave të tjera të ligjshme të individëve, pasi cënimi i tyre pa të drejtë, jo vetëm që cënon demokracinë, por rëndon buxhetin e shtetit.

Reforma për rritjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë mbetet një nga shqetësimet e vazhdueshme për sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Reformat në këtë sektor janë në proces dhe janë përqëndruar në ndryshimet legjislative të cilat synojnë të përmirësojnë shërbimin përmbartimor. Për këtë arsye janë propozuar ndryshime në

Kodin e Procedurës Civile të cilat lidhen ekskluzivisht me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor që synon rritjen e numrit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, forcimit të imazhit publik të shërbimit përmbartimor në Shqipëri, rritjes së efektivitetit, transparencës, profesionalizmit dhe të buxhetit financiar të këtij shërbimi ka ligjësuar liberalizimin e shërbimit përmbartimor ose më saktë ofrimin alternativ të shërbimit përmbartimor privat.

Nga një raport i Bashkimit Europian për vitin 2008, lidhur me konkluzionet e progres raportit për Shqipërinë evidentohet se ka patur progresi të vogël në reformat e sistemit gjyqësor, por zbatimi i vendimeve gjyqësore në mënyrë të veçantë për çështjet civile është ende shumë i ngadaltë. Problemi kryesor që evidentohet është mosfunksionimi në mënyrë eficiente i shërbimit përmbartimor pasi ekzekutimi i vendimeve gjyqësore pengohet për shkak të mungesës së fondeve, paqartësisë së vendimeve gjyqësore dhe refuzimit të shumë organizmave qeveritare për të përmbushur detyrimet e tyre. Numri i vendimeve gjyqësore të ekzekutuara vazhdon të jetë ende në nivele të ulëta për shkak të ndikimit të faktorëve të tillë si: situata ekonomike e debitorëve, pengesa në gjetjen e vendbanimeve të debitorëve, situata gjeografike e territorit të vendit, aftësia profesionale e përmbartuesve, kushtet e vështira të punës etj. Vërehet edhe rënia e interesit të ekzekutimit nga organet shtetore, krahasuar me vitin 2005, kur vetë kryeministri Z. Berisha bëri thirrje të vazhdueshme për ekzekutimin e të gjithë vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Pavarësisht se u përqendruam tek mangësitë e zyrave të përmbartimit, theksojmë se sistemi i përmbartimit gjyqësor, ka edhe shumë shëmbuj e praktikë të mirë, dukshëm shumë më të mirë se vitet paraardhëse. Sfida që ka marrë shteti Shqiptar në kuadrin e intergimit në strukturat Euro-Atlantike dhe B.E. pa dyshim që ka në fokusin e saj si objektiv primar fushën e drejtësisë në kryerjen e reformave të thella dhe veçanërisht për rritjen e vendimeve të ekzekutuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe në të ardhmen do t'i kushtojë vëmendjen e duhur ankesave ndaj përmbartimit gjyqësor që çënojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të palëve në procesin gjyqësor.

### **C. Ankesa për Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)**

Për vitin 2009 pranë Institucionit tonë janë paraqitur 126 ankesa, që si objekt të tyre kanë patur pretendime për zvarritje në regjistrimin e pasurisë të ankuesve si dhe zvarritje në procesin e marrjes së certifikatës së pronësisë, veçanërisht për apartamente dhe oborre të banesave private,

si dhe zvarritje të procedurave administrative që këto Zyra duhet të përmbushin në kuadër të afateve ligjore të parashikuara shprehimisht në aktet që rregullojnë veprimtarinë e këtyre zyrave. 27 ankesa kanë qënë të mbartura nga viti 2008.

Nga 153 ankesa gjithsej janë shqyrtuar 124, nga të cilat 59 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Ndërsa 29 të tjera kanë kaluar për shqyrtim të mëtejshëm për vitin 2010.

Gjatë vitit 2009 ka patur një rritje të konsiderueshme të numrit të rasteve të zgjidhura në favor të shtetasve, krahasuar edhe në raport me vitet e tjera, çka tregon një përkushtim maksimal të institucionit të Avokatit të Popullit në verifikimin dhe shqyrtimin e pretendimeve të ankuesve brenda kuadrit ligjor në fuqi .

1. Ndër ankesat e zgjidhura në favor të shtetasve, përmendim ankesën e shtetasës L.A., ndaj ZVRPP Tiranë për zvarritje në ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë për regjistrimin e pjesës së saj takuese, pas zgjidhjes së martesës. Për këtë ankesë i jemi drejtuar me anë të disa shkresave zyrtare ZVRPP-së Tiranë, por duke parë neglizhencën e punonjësve të ngarkuar me përpunimin e të dhënave të praktikës së ankueses, u kryen verifikime në vend pranë ZVRPP Tiranë. Në vijim të tyre u konstatua se punonjësja e ngarkuar me praktikën e ankueses, kishte kryer të gjitha veprimet proceduriale në regjistrat e pasurive të paluajtshme në kuadër të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, çka përbënte edhe objektin e ankesës së parashtruar pranë Institucionit tonë, dhe se ankueses i ishte dërguar tashmë me anë të shërbimit postar dokumenti i pronësisë me shënimet përkatëse sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor.

2. Ankesa e shtetasit V.Gj. ndaj Z.V.R.P.P Tiranë për zvarritje në procedurat e fshirjes së një regjistrimi që pretendohet si i paligjshëm dhe që kishte krijuar mbivendosje me pronën e tij. Në kuadër të dispozitave ligjore dhe nënligjore, ankuesi kishte iniciuar një procedim administrativ pranë kësaj Zyre duke kërkuar fshirjen e regjistrimit me paraqitjen paraprake të kërkesës për fshirje, e cila nuk po shqyrtohej brenda afateve ligjore. Në këto kushte Avokati i Popullit iu drejtua Regjistruesit të ZVRPP-së Tiranë, duke vënë në dijeni edhe Kryeregjistruesin, i cili në përgjigje të shkresave tona, ka tërhequr vëmendjen nëpunësve të sektorit përkatës pranë ZVRPP-së Tiranë, duke dhënë njëkohësisht edhe udhëzimet dhe afatet përkatëse për mbylljen e procedimit të filluar administrativ dhe shprehjen e kësaj zyre me një akt administrativ respektiv, i cili më pas do t'i kalonte për miratim Kryeregjistruesit, ashtu siç parashikohet në Udhëzimin përkatës.

3. Ankesa e shtetasit J.B., ndaj ZVRPP Tiranë për mosregjistrim të plotë të një sipërfaqeje të njohur dhe kthyer me Vendim të ZRKKP-së të Qarkut Tiranë, me pretendimin e punonjësve të ZVRPP-së se ky titull

pronësie ishte atakuar tashmë në rrugë gjyqësore dhe në këto kushte nuk mund të regjistrohej si i tërë. Ky fakt pranohej nga ankuesi, por nga ana tjetër ai dëshmonte dhe paraqiti prova konkrete me anë të kërkesë padisë dhe akteve të tjera të lëshuara nga Gjykata, se objekt i procesit gjyqësor ishte vetëm 1/10 e pronës së përfitur, dhe se për pjesën tjetër nuk kishte asnjë pengesë ligjore që ajo të regjistrohej, dhe përfituesit e saj të pajiseshin me dokumentacionin përkatës të pronësisë. Pas ndërhyrjeve tona institucionale dhe ballafaqimit të fakteve dhe provave gjatë një inspektimi në ZVRPP- në Tiranë edhe me punonjësit e ngarkuar me regjistrimin e kësaj prone, Regjistruesja e ZVRPP-së Tiranë na bëri të ditur se ankuesi mund të pajisej me certifikatë pronësie për sipërfaqen e pasurisë që nuk do të krijonte mbivendosje për atë pjesë që po shqyrtohej në rrugë gjyqësore, pasi ankuesi të paraqiste pranë kësaj Zyre një Deklaratë Noteriale të të gjithë bashkëpronarëve për pajisjen e tij me dokumentacionin e pronësisë.

4. Ankesa e shtetasit B.Sh., ndaj Z.Q.R.P.P Tiranë lidhur me zvarritje të procedurave të konfirmimit të një vendimi për fshirjen e një regjistrimi që ZVRPP Lezhë kishte marrë për një pasuri që ishte regjistruar në kundërshtim me Ligjin dhe krijonte mbivendosje me pronën e ankuesit. Pas verifikimeve tona pranë ZQRPP Tiranë dhe ZVRPP Lezhë u konstatua mbyllja e procedimit administrativ nëpërmjet fshirjes së regjistrimeve të paligjshme dhe që krijonin mbivendosje me pronën e ankuesit B.Sh, çka përbënte edhe objektin e ankesës së parashtruar pranë Institucionit tonë, duke i bashkëngjitur ankuesit në përgjigjen tonë zyrtare edhe vendimet respektive të ZQRPP-së.

5. Shtetasi F.D., ankohej ndaj Z.V.R.P.P. Tiranë e cila nuk kishte përmbushur në mënyrë të rregullt trajtimin e praktikës së ankuesit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave të paraqitura nga ankuesi, Avokati i Popullit rekomandoi ekzekutimin e Vendimit Nr. 5090 datë 11.06.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në favor të ankuesit dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve që ishin bërë pengesë në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Vendimi i sipërcituar përbënte një titull ekzekutiv të detyrueshëm për regjistrim, i cili nuk mund të interpretohej më tej në elementët e veçantë të tij nga një nëpunës i administratës publike. Në vijim të rekomandimit tonë, nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, kishim një përgjigje zyrtare për rastin konkret, me të cilën u informuam se tashmë kishte filluar procedura për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, duke kërkuar konfirmimin e kontratës së privatizimit me të cilën shitësi fillestar i pronës, e kishte privatizuar që në vitin 1991 pasurinë që kërkohej të regjistrohej, në përmbushje të dispozitave ligjore dhe nënligjore që parashikohen në Ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për

regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Pikërisht lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit është në pritje të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese për tu shprehur mbi kushtetueshmërinë e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, në bazë të të cilit Regjistruesi ka të drejtë të verifikojë elementë të veçantë të vendimit gjyqësor, kërkesë e parashtruar nga një Gjyqtar i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit gjykon se edhe nga ana e Zyrave të Shërbimit Përmbarimor duhet të merren masa shtrënguese, deri edhe në ndjekje penale, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim që të shmagen qëndrime të tilla të padrejta të punonjësve të administratës gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si pjesë e procesit të rregullt ligjor në kuptim edhe të nenit 6 të Koventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Përveç ankesave të përfunduara në favor të shtetasve, 51 ankesa kanë rezultuar të pa bazuara, jashtë juridiksionit tonë ose jashtë kompetence, pasi kanë qënë në vetvete konflikte pronësie që kërkojnë zgjidhje gjyqësore. Janë konsideruar të pabazuara për faktin se thuajse të gjithë ankuesit konsiderojnë cënim të të drejtave të tyre, përmbushjen e një detyrimi ligjor siç mund të jetë paraqitja pranë sporteleve të ZVRPP e mbajtësit të titullit të pronësisë apo plotësimi dhe dorëzimi i dosjes së pronës që kërkojnë të regjistrohet. Ky fenomen vihet re zakonisht gjatë procedurave që ndiqen nga qytetarët për regjistrimin e apartamenteve të privatizuara, të cilët megjithëse orientohen për detyrimin e tyre ligjor për të dorëzuar dosjen e plotë të privatizimit të apartamentit, të cilën duhet ta tërheqin nga noteri ku është lidhur kontrata e privatizimit, nuk e përmbushin një detyrim të tillë, dorëzojnë vetëm një kopje të kontratës së shit-blerjes dhe më pas ankohen nëpër institucione të ndryshme për zvarritje të procedurës së regjistrimit.

Të pabazuara janë klasifikuar edhe rastet kur shtetas të ndryshëm kanë kërkuar ndërhyrjen tonë me qëllim që t’u shmangeshin detyrimeve financiare që ato duhet të shlyenin ndaj ZVRPP për të bërë të mundur fillimin e procedurës respektive.

Mos njohja e ligjit dhe mos përgatitja e dokumentave të duhura për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, janë shkaku kryesor që mosveprimet e Z.V.R.P.P.-ve në rrethe, një pjesë e madhe e individëve t’i konsiderojnë shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit ka konstatuar se punonjësit e ZVRPP-ve, sidomos në Tiranë, në mënyrë abuzive dhe arrogante u mohojnë qytetarëve të thjeshtë informacione formale dhe të rëndësishme



për veprimet e transaksionet e ndryshme që shtetasit dëshirojnë të kryejnë më pronat e tyre.

Duhet theksuar fakti se gjatë këtij viti, nga ana e ekspertëve të Avokatit të Popullit janë kryer verifikime dhe inspektime të herë pas hershme kryesisht pranë ZVRPP Tiranë, gjatë të cilave kemi hasur në vështirësi subjektive në komunikimin me personat përgjegjës, vështirësi që kanë filluar që nga punonjësit e policisë private që është e ngarkuar me sigurimin e ambienteve, të cilët nuk kuptojnë dhe nuk veprojnë në përputhje me kërkesat e Ligjit për t'u siguruar punonjësve të administratës shtetërore akses të plotë në ZVRPP, dhe për të vazhduar më tej me specialistët e ZVRPP-së. Duhet veçuar punonjësit e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Institucionet dhe përgjegjësit e Zonave Kadastrale, që rezultojnë se nuk kanë njohuritë e nevojshme lidhur me transparencën dhe të drejtën për informim, qoftë të qytetarëve të thjeshtë, ashtu edhe të ekspertëve të Zyrës së Avokatit të Popullit. Në shumë raste, është dashur ndërhyrja jonë pranë ZQRPP-së, për të siguruar futjen e ekspertëve brenda ambienteve të ZVRPP-së, fakt ky absurd duke patur parasysh se Avokatit të Popullit dhe ekspertëve të autorizuar nga ana e tij u lejohet nga ligji hyrja pa paralajmërim dhe pa pengesa në të gjitha institucionet e administratës publike, në kuadër të verifikimit dhe shqyrtimit të ankesave të parashtruara pranë Institucionit tonë apo edhe të iniciuara kryesisht nga Avokati i Popullit.

Pengesat e konstatura kanë të bëjnë edhe me faktin se pranë ZVRPP Tiranë nuk ka një sistem të kontrollimit dhe menaxhimit të dokumentacionit apo shkresave zyrtare, duke sjellë amulli dhe mosnjohje të kërkesave zyrtare që u drejtohen Regjistruesve, të cilët për rrjedhojë nuk janë në gjendje të kontrollojnë përmbushjen e kërkesave tona zyrtare brenda afateve ligjore, e për më tepër që verifikimi i shkresave tona duhet të bëhet personalisht nga ekspertët e Avokatit të Popullit pranë Zyrës së Protokollit të ZVRPP-së, për t'iu drejtuar më pas specialistëve që i marrin shkresat, por nuk i përpunojnë, jo vetëm se nuk kanë njohuritë e duhura për të ushtruar një veprimtari të tillë në një sektor kaq delikat, por edhe se mungon kontrolli nga eprorët direkt apo institucioni hierarkik më i lartë. Një fakt i tillë konfirmohet edhe nga shkresat e ZQRPP-së drejtuar ZVRPP-ve në rrethe, ku megjithëse nga ana e Avokatit të Popullit vihen në dijeni për shkelje të ndryshme apo tejkalim të afateve, ZQRPP-ja ua kalon më tej për kompetencë apo i tërheq vëmendjen për veprim, pa ndërmarrë kontrole apo verifikime konkrete si edhe masa administrative deri në largim nga puna të personave që nuk përmbushin standartet më minimale të njohjes së Ligjit dhe të veprimtarisë së ZVRPP-ve.

Gjatë vitit 2009 është vënë re gjithashtu edhe një mugesë e theksuar e personelit administrativ të këtyre Zyrave në periudha ta caktuara, për shkaqe që nuk lidhen absolutisht më përmbushjen e detyrës,

çka ka sjellë edhe vonesa në trajtimin e aplikimeve të qytetarëve brenda afateve ligjore. Ashtu siç është konstatuar edhe fakti se gjatë këtyre periudhave, në sportelet ku shtetasit marrin kontakt dhe duhet të kryejnë aplikimet përkatëse, angazhohen punonjës që jo vetëm nuk njohin kërkesat dhe dokumentacionin e domosdoshëm për regjistrim, por nuk kanë as aftësitë dhe dijenitë bazë për të kryer një aplikim elektronik me kompjuter, pasi nuk njohin edhe kodet respektive që duhet të plotësohen në sistem për çdo lloj kërkesë të parashtruar nga shtetasit, por edhe u përgjigjen në mënyrë arrogante dhe të papërgjegjshme interesimit të tyre të vazhdueshëm.

Problematik është edhe fakti se ZVRPP-ja pas çdo aplikimi të thjeshtë, kërkon verifikimin dhe konfirmimin e dokumentacionit që ajo vetë e disponon në arshivën e saj dhe që ka shërbyer për lëshimin e akteve të pronësisë, siç është rasti kur për rifreskimin e një Vërtetimi pronësie, kërkohet konfirmimi i Lejes së Ndërtimit nga organi i pushtetit lokal, në një kohë që Leja origjinale ekziston në arshivën e Zyrës dhe ka shërbyer si dokumenti bazë për lëshimin fillestar të Aktit të Pronësisë para disa vitesh. Dhe pikërisht kjo procedurë sjell edhe zvarritje në trajtimin e aplikimit dhe tejkalim të afateve ligjore, të cilat formalisht shfaqen në aplikimet elektronike, por asnjëherë nuk zbatohen.

Avokati i Popullit e konsideron të padrejtë qëndrimin e ZVRPP-ve, në momentin kur refuzohet regjistrimi i pasurive të vjetra, pronarët e të cilave, pavarësisht viteve të tëra që kanë kaluar, disponojnë dokumentacione të vlefshme që mund të merren në konsideratë nga ZVRPP-ja si edhe të verifikohen në vend nga ekspertët e saj, për të konkluduar më pas me regjistrimin dhe pajisjen e shtetasve me dokumentacionin përkatës ligjor.

Është absurd fakti që nuk bëhet i mundur regjistrimi i pronave të ligjshme të vjetra të shtetasve që përballen me këtë problematikë në sportelet e ZVRPP-ve të cilat i gëzojnë, disponojnë dhe posedojnë të qetë dhe pa patur konflikt me asnjëri, ndërkohë që një kategori e caktuar popullsie pajiset me titull pronësie të regjistrueshëm për një pasuri të cilën e ka pushtuar dhe për të cilën shteti ka pajisur me titull pronësie edhe pronarin real të saj.

Lidhur më këtë fakt mund të përmendim ankesën e shtetasit F.K. i cili shpreh pretendimet e tij ndaj ZVRPP Tiranë për moslëshim të akteve të pronësisë për një ambient banimi, megjithëse kishte kryer aplikimin përkatës pranë kësaj Zyre që në vitin 2002 dhe ende zvarritej nga nëpunësit e ZVRPP-së me pretendimet dhe arsye të pabazuara ligjërisht, duke shkaktuar zvarritjen e procedurave të pajisjes së tij me dokumentacionin e pronësisë. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka kryer të gjitha veprimet proceduriale për shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit, duke arritur në konkluzionin se ato ishin të bazuara dhe se

qëndrimi i nëpunësve të ZVRPP-së ishte abuziv, duke i mohuar atij pajisjen me dokumentacionin përkatës për një pasuri të vjetër që e gëzonte prej vitesh. Në këto kushte i kemi rekomanduar Regjistruesit të ZVRPP-së Tiranë dhe Kryeregjistruesit të ZQRPP, marrjen e masave administrative ndaj dy nëpunësve të ZVRPP-së Tiranë që abuzonin me detyrën dhe anashkalonin detyrimet e tyre për kryerjen e regjistrimit për një periudhë disa vjeçare. Ky rekomandim është pranuar pjesërisht dhe ndaj këtyre nëpunësve janë marrë masat përkatëse, ndërkohë që mbetet akoma i pazgjidhur problemi i pajisjes së ankuesit me dokumentacionin e pronësisë.

Zvarritja e një procedure të tillë ligjore krijon premisa për mospërmbushje të funksioneve të njohura me ligj Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në përgjithësi tek shtetasit që i drejtohen Z.V.R.P.P. një zvarritje e tillë krijon idenë se kjo bëhet për qëllime të caktuara dhe përfitime materiale personale të nëpunësve të veçantë të këtyre Zyrave.

Në një kohë që për këto pronë që nga ndërtimi apo meremetimi i tyre dhe deri sot nuk ka asnjë kontestim nga kufitarët apo shtetas të tjerë, lidhur me veprimin juridik të humbjes dhe fitimit të pronës për këto pasuri, mendojmë se ekzistojnë mjete dhe mundësi zgjidhje ligjore të çështjes, së pajisjes me certifikatë pronësie të këtyre shtetasve, të cilat sorollaten me aktet e vjetra dhe vendimet gjyqësore që ato disponojnë prej vitesh, pasi ishte pikërisht ky dokumentacion bazë që shërbente për regjistrimin e pronave në sistemin e hipotekës, dhe punonjësit e ZVRPP-ve nuk mund t'i japin fuqi prapavepruese Ligjit organik që rregullon veprimtarinë e tyre dhe parashikon procedurat e regjistrimit për akte zyrtare dhe ligjore që janë lëshuar nga autoritetet shtetërore para hyrjes në fuqi të Ligjit.

Gjithsesi për një zgjidhje ligjore të këtij problemi, Avokati i Popullit e gjen me vend të kërkojë marrjen e masave të nevojshme, për kryerjen e veprimeve nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të pajisjes së shtetasve me certifikatë pronësie, por duke synuar edhe në propozimin apo ndërmarrjen e iniciativave konkrete, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje afatgjatë, për zgjidhjen e ngërçeve të tilla burokratike që shkaktojnë cënim të të drejtave të shtetasve në pajisjen e tyre me dokumentacione pronësie, duke i kufizuar kështu ato në kryerjen e veprimeve të ndryshme me pronat e tyre të ligjshme.

Probleme të tilla janë konstatuar edhe gjatë kalimit të pasurive të paluajtshme nga sistemi sporadik në sistemin fillestar të regjistrimit të pasurive, gjatë të cilit hapet një kartelë e veçantë pasurie për çdo pronë. Por nga ana tjetër verifikohet edhe origjina e pronës apo dokumentacioni bazë që ka shërbyer për regjistrimin e saj, dhe në rast se Sektori i Verifikimit të Regjistrimeve pranë ZVRPP-së konstaton se kjo pronë

mund të jetë regjistruar me një vendim gjyqësor, pavarësisht se ai është i vlefshëm dhe ka qenë i detyrueshëm për regjistrim nga hipoteka, ZVRPP-ja me iniciativën e saj mund të kërkojë fshirjen e këtij regjistrimi, duke lënë vend të hapur për abuzim dhe për ushtrim presioni ndaj shtetasve për pasuritë e tyre të ligjshme.

Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit është në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të Udhëzimit Nr. 04, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave të fshirjes të rregjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që mbivendosen”.

Avokati i Popullit gjykon se një akt i tillë nënligjor ka sjellë cënim të parimeve kushtetuese, amulli në veprimtarinë e ZVRPP-ve dhe ZQRPP-së, të cilat abuzojnë me kompetencat e njohura me këtë Udhëzim, duke vepruar në pasuri të caktuara sipas interesave subjektive apo duke tejkalar çdo afat ligjor për një kërkesë të ligjshme të paraqitur nga një shtetas i thjeshtë që ka konstatuar cënim të të drejtave të tij të pronësisë nëpërmjet regjistrimit të paligjshëm të një titulli pronësie, i cili ka sjellë edhe mbivendosje të pronave. dhe kështu edhe fillimin e një rruge të gjatë nëpër Gjykata për mbrojtjen e pronës së tij, si një e drejtë themelore e mbrojtur nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, por lehtësisht e cënueshme në Shqipëri me një akt administrativ apo nga një nëpunës i paaftë i administratës publike.

Një mangësi që sjell zvarritje në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe keq kuptime në marrëdhëniet tona me ankuesit, janë vonesat e pajustificuara në kthimin e përgjigjeve nga disa Z.V.R.P.P. në rrethe, që nuk respektojnë afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve apo të ecurisë së rekomandimeve konkrete, duke shkelur Kodin e Procedurave Administrative. Kjo vazhdon të mbetet një e metë e madhe e këtyre zyrave.

Shkak i vonesave të dhënies së informacionit dhe shpjegimeve të kërkuara nga ana e Regjistruarëve të ZVRPP në rrethe, vazhdon të jetë neglizhenca dhe mosrespektimi i detyrimeve ligjore për t'i kthyer përgjigje brenda afateve ligjore si kërkesave të qytetarëve, ashtu edhe Institucionit tonë. Megjithëse ka patur edhe raste të shumta ku pengesë në shqyrtimin e rasteve dhe identifikimin e saktë të problemit të ngritur ka qenë edhe mosplotësimi i saktë i dokumentacionit për aplikim. Pas sugjerimit tonë për plotësimin e këtyre mangësive, kërkesat e ankuesve janë përmbushur nga ana e Z.V.R.P.P.

Gjithashtu theksojmë se është e domosdoshme përsheptimi i procedurave konkrete në reformën e tokës dhe regjistrimin fillestar të saj, me qëllim që të kemi një përjasje jo vetëm të legjislacionit tonë kombëtar me Acquis Communautaire në kuadër të detyrimeve që ka marrë vendi ynë me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe fazës

aktuale për marrjen e e statusit të vendit Kandidat për në Bashkimin European , por edhe të situatës faktike ku çdo shtetas shqiptar të ushtrojë mbi pronën e tij të gjitha tagret e pronarit si edhe të disponojë një akt të ligjshëm që vërteton qënien e tij si pronar, ashtu si çdo qytetar european i Europës së bashkuar.

Në përfundim do të donim të nënvizonim nevojën për gjetjen e një sistemi të ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i cili nuk do të krijonte premisa për shkeljet që i janë bërë prezente Kuvendit nga Avokati i Popullit nëpërmjet raporteve vjetore këto 10 vjet.

### **ç) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**

Gjatë vitit 2009 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 92 ankesa, midis të cilave edhe nga komunitete dhe grupe individësh, shoqata dhe bashkësi fetare, që kanë të bëjnë me problematikën e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave nga AKKP si në qëndër ashtu edhe në qarqe. Pesë ankesa kanë qenë të mbartura nga viti 2008.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2009, janë përfunduar 82 prej tyre, nga të cilat 29, të barabarta me 30 %, janë zgjidhur në favor të ankuesve, 10 kanë qenë të pabazuara, 48 ankesa ishin jashtë juridiksionit dhe kompetencave të institucionit të Avokatit të Popullit 5 ankesa janë arkivuar për heqje dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm. Dhjetë prej tyre, të depozituara pranë nesh në fund të vitit 2009 mbarten për vazhdimin e trajtimit për vitin 2010.

Objekti i ankesave vazhdon të jenë pretendimet për zvarritje në shqyrtimin e kërkesave nga agjencitë rajonale dhe ajo qëndore për njohjen dhe kthimin e pasurive të paluajtshme brënda dt. 31.06.2009, afati i përfundimit të procesit, ankesa kundër vendimeve përfundimtare, pretendime për mos fillimin e kompensimit fizik, shkelja e të drejtave të informimit dhe kërkesa për t'u njohur me procedurat për të aplikuar pranë agjencive të kthimit dhe kompensimit të pronave etj.

Ende ka persona që për shkaqe të ndryshme nuk kanë aplikuar pranë agjencive rajonale për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës dhe që kërkojnë asistencë ligjore lidhur me procedurat.

Nga verifikimet e bëra rast pas rasti, ka dalë se një pjesë e konsiderueshme e ankesave ishin të pabazuara, jashtë kompetencave dhe juridiksionit, pasi aktet e depozituara pranë agjencive kanë patur mangësi të theksuara; të tilla si mungesa dokumentacioni dhe të gen-planeve, mospërcaktimin e saktë të kufijve për identifikim të pronës së pretenduar, mungesës të vendimeve gjyqësore në rastet e mos pasjes së aktit të pronësisë, e të tjera si këto, që kanë bërë praktikisht të pamundur shqyrtimin e tyre.

Objekt ankese ka qënë e drejta qe ju dha nëpërmjet një ndryshimi ligjor, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që të shqyrtojë, edhe kryesisht, vendimet e dhëna nga ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronës dhe të vendosë lënien në fuqi të vendimit, kthimin për rishqyrtim në zyrën rajonale të AKKP-së dhe shfuqizimin dhe zgjidhjen në themel të tij. Kjo e fundit u konsiderua si veprim abuziv, selektiv, subjektiv dhe antikushtetues, pasi bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, me pandashmërinë dhe patjetërsueshmërinë e të drejtave themelore të njeriut si dhe me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për vëndin tonë.

Për këto arsye ligjore, Avokati i Popullit kërkoi nga gjykata Kushtetuese shfuqizimin, si antikushtetues të gërmës “ç”, të pikes 1, të nenit 16, dhe heqjen e fjalës “kryesisht” nga paragrafi i dytë i nenit 18 të Ligjit nr.9235, dt.29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, ndryshuar me nenin 1/ “ç” dhe me paragrafin e dytë të nenit 2 të Ligjit nr.9684, dt.06.02.2007 “Për ndryshime në ligjin nr.9235, dt.29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”. Gjykimi ka përfunduar dhe pritet shpallja e vendimit pëfundimtar.

Ndërkohë që ka patur edhe ankesa, objekt i të cilave ka qënë pretendimi i shtetasve për njohje e kthim prone vetëm mbi bazën e një vendimi gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë mbi sipërfaqe të caktuara, vendime deklarative që nuk regjistrohen në ZRPP të rretheve. Këto ankese janë konsideruar të pabazuara në ligj nga ana jonë.

Për të gjitha këto raste, është sugjeruar plotësimi sa më shpejt i dokumentacionit të duhur, që mund të sigurohet në Arkivin e Shtetit apo në ato të rretheve, në zyrat e taksë-tatimeve, në kadastër, etj, shoqëruar me sqarime ligjore dhe proceduriale për realizimin e pretendimeve si ish të shpronësuar.

Nga çështjet që kishin të bënin me kontestimet për vendimet e A.K.K.P., ju është bërë e ditur se duhet bërë kundërshtimi i tyre në rrugë gjyqësore, sepse vetëm në këtë mënyrë, mund të arrihet në një zgjidhje me fuqi vendimi të detyrueshëm për zbatim nga të gjithë palët dhe organet shtetërore.

Nga shqyrtimi i një pjese të ankesave, rezultojnë pakënaqësi ndaj Agjencisë Qendrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe për mungesë të transparencës për kompensimin financiar që duhej realizuar në fund të vitit, si dhe për ndryshimin e shpeshtë të vlerës së trojeve, me tendencë uljeje. Megjithëse ankuesit i kishin plotësuar dhe dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara për këtë rast, nuk janë vënë në dijeni nëse përfitonin ose jo nga shuma e vënë në dispozicion të të shpronësuarve për vitin 2009. Të njëjtat shqetësime ngrihen edhe në disa ankesa të tjera, ku ish pronarët kërkojnë kompensimin fizik të pronave të tyre, të njohura me

vendim të KKKP, por që asnjëherë nuk janë bërë të ditura të dhënat për sasinë dhe zonat ku mund të përfitojnë nga ky fond.

Një nga çështjet e shqyrtuara kryesisht me iniciativën tonë dhe që është zgjidhur në favor të ankuesve është ajo që i takon shtetasit B. J. dhe Shoqatës “Për mbrojtjen e Tokës Bujqësore” në Orikum, për mos kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës marrë në përdorim nga ish punonjësit e ish NB-së “Rinia” në Orikum, në bazë të Ligjit nr. 8053, dt.21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”.

Nga takimet me ish punonjësit e ish NB-së, me drejtuesit e pushtetit vendor në Orikum dhe nga analiza e pretendimeve, fakteve dhe dokumentacionit, ju rekomanduam Këshillit të Ministrave dhe Kuvëndit të Shqipërisë, shpejtimi i procedurave për miratimin e Projekt Ligjit “Për një ndryshim në Ligjin nr.8053, dt. 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, me ndryshime. Rekomandimi u mor parasysh dhe projekti kaloi në Kuvënd për miratim.

Nga ankesat e zgjidhura pozitivisht përmendim atë të shtetasës B.H. banuese në Tiranë që pretendonte për zvarritje nga ZRKK-ja në shqyrtimin dhe ndryshimin pjesërisht të vendimit të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

Në përgjigjen zyrtare lidhur me problemin e parashtruar, zyra rajonale na informoi se pas verifikimit të akteve të dërguara nga Avokati i Popullit, u ngrit grupi i punës për vlerësimin ligjor që u konkretizua me vendimmarrjen përkatëse.

Me të njëjtin objekt ankimi ishin edhe ankesat e shtetasve N. M. banuese në Tiranë, S.J. banues në Korçë dhe L.I. banues në Vlorë, që morën zgjidhjen e kërkuar.

Marrëdhëniet tona institucionale me Agjencinë Qëndrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyrat Rajonale për vitin 2009 kanë qënë relativisht të mira. Por në shumë raste përgjigjet e kthjera, kanë qënë jashtë afateve ligjore. Edhe shkaku i mbartjes së disa ankesave për vitin 2010 është pikërisht mos-kthimi i përgjigjeve.

### 3. Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe gjykatat janë dy institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndihma e institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për rritjen e efektivitetit dhe besimit të publikut tek gjyqësori.

Në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit “Për Avokatin e Popullit” juridiksioni i Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin është i tillë, që

as prek dhe as rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Avokati i Popullit gjatë kësaj periudhe ka patur akses të kufizuar në gjykatë dhe në asnjë rast gjatë veprimtarisë së tij, nuk ka prekur apo cënuar pavarësinë e gjyqësorit.

Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ka parashikuar disa të drejta dhe kompetenca të tjera në funksion të veprimtarisë së institucionit tonë. Këto shtesa dhe ndryshime u bënë duke u bazuar në eksperiencën e fituar gjatë këtyre viteve dhe përvojës së mirë të Ombudsmanëve të vendeve të tjera, në mënyrë të veçantë të Ombudsmanit të Polonisë.

Në paragrafin e fundit të nenit 25 të këtij ligji parashikohet se Avokati i Popullit, pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë, dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve.

Në këto rrethana me këto ndryshime të ligjit ne si institucion jemi të detyruar për të pranuar për shqyrtim çdo ankesë, apo kërkesë që bëhet ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Por ndryshimi i ligjit nuk zgjidh problemin se cili do të jetë mjeti ligjor i reagimit të Avokatit të Popullit ndaj këtyre vendimeve të formës së prerë. Për zgjidhjen e këtij problemi është e nevojshme që të bëhen disa shtesa dhe plotësime në Kodin e Proçedurës Civile, dhe Kodin e Proçedurës Penale. Ne e kemi ngritur këtë çështje në Kuvend dhe Qeveri, por deri tani nuk ka ndonjë projektligj për këtë qëllim.

Lidhur me këtë duhet të shihet edhe Rekomandimi Nr.(2000) 2 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare lidhur me rishqyrtimin ose rihapjen e çështjeve gjyqësore të caktuara në nivel të brendshëm, mbështetur në vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 janar 2000.

Në Rekomandim thuhet se “Komiteti i Ministrave, në përputhje me parashikimet e nenit 15 “b” të Statutit të Këshillit të Europës, “Inkurajon palët kontraktuese, në veçanti të shqyrtojnë sistemet e tyre ligjore kombëtare, me synimin e garantimit të ekzistencës së mundësive të mjaftueshme për rishqyrtimin e një çështjeje, përfshi edhe rihapjen e procedimeve, në ato faza ku gjykata konstaton shkelje të Konventës, veçanërisht kur:

i) Pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasojat tepër negative, të cilat janë rezultat i vendimit që ankimohet, të cilat nuk janë korrigjuar në mënyrë të mjaftueshme nga shpërblimi i drejtë dhe nuk mund të ndreqen veçse nëpërmjet rishqyrtimit ose rihapjes dhe



ii) Vendimi i Gjykatës të çon në konkluzionin se:

a) vendimi i brendshëm i ankimuar është në themel në kundërshtim me Konventën ose

b) shkelja e konstatuar është mbështetur në gabime procedurale ose mangësi të tilla të rënda që vënë në dyshim serioz rezultatin e procedurave të brendshme të ankimuarat”.

Implementimi i këtij Rekomandimi duhet të bëhet pjesë e Reformës në Drejtësi, proces që ka filluar nën drejtimin e Kuvendit të Shqipërisë dhe që duhet të rregullojë edhe çështjen e mësipërme.

### **Problematikat e ankesave për Gjykatat**

Gjatë vitit 2009 ndaj gjykatave kanë ardhur me shkrim për shqyrtim gjithsej 258 ankesa, nga të cilat 121 prej tyre kanë qënë kundër vendimeve gjyqësore dhe si të tilla nga ana jonë janë refuzuar, duke sqaruar faktin se akoma nga Parlamenti nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme në Kodet përkatëse të Proçedurave. Në këtë numër nuk përfshihen edhe ankesa të tjera për vendimet gjyqësore që i ka pritur Sektori i Pritjes së Popullit dhe i ka dhënë ndihmë juridike ankuesve. Për 137 ankesat e tjera, duke i analizuar sipas objektit të tyre, ato kanë qënë për këto probleme:

1. Vendin kryesor të ankesave të ardhura gjatë këtij viti ndaj gjykatave e zënë ato për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimeve për çështje të ndryshme si në fushën penale dhe atë civile.

2. Në disa ankesa ndaj gjykatave është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për të përfaqësuar palët ndërgjyqëse në shkallët më të larta të gjyqësorit, në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese, me arsyetim se ato nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar marrjen e një avokati privat. Legjislacioni ynë e njeh të drejtën e shërbimit ligjor falas, por ky shërbim rezulton të ketë probleme sidomos në rastin e kërkesave për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë pranë Gjykatës së Lartë për çështje të ndryshme penale.

Për shkak të vështirësive ekonomike shumë qytetarë nuk kanë mundësi financiare për të siguruar një avokat privat dhe klinikat ligjore që ofrojnë këtë mundësi janë shumë të pakta, për të mos thënë mosekzistente nëpër rrethe të ndryshme të vendit (ka vetëm 2 klinika ligjore falas në Tiranë). Për më tepër legjislacioni penal ka zbrazëti pasi mundësia për të patur një avokat falas të siguruar nga shteti njihet vetëm në shkallë të parë dhe të dytë të gjykimit, dhe jo në gjykimin në Gjykatën e Lartë, duke i mohuar kështu të drejtën e njohur me Kushtetutë të të pandehurit për t’u mbrojtur gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Ky boshllëk ligjor u plotësua nga Kuvendi i Shqipërisë, me daljen e Ligjit Nr.10039, datë 22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike” ku

parashikohen kushtet, lloji i ndihmës ligjore, mënyra dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti për mbrojtjen e lirive e të drejtave themelore të individit si dhe të interesave të tjera të ligjshme të tij. Por pritet që ky ligj të futet në zbatim.

**3.** Ankesa kanë ardhur edhe ndaj gjykimeve dhe vendimeve gjyqësore të marra në mungesë të palëve, ose të subjekteve përkatëse. Palët mbas vënies në dijeni të këtyre gjykimeve dhe vendimeve të marra janë ankuar tek ne duke kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen tonë për prishjen e këtyre vendimeve nga organet më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim më shumë ka ankesa që bëjnë fjalë për gjykimet në mungesë si në çështjet penale ashtu edhe në gjykime civile.

Mbasi janë studiuar me kujdes ankesat, personat janë sqaruar për kërkesat e ligjit për rastet e gjykimeve në mungesë dhe këshilluar që për realizimin e të drejtave të tyre ata, sipas nenit 2 të Ligjit nr.9101, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, duhet të kërkojnë ndihmën e një avokati privat.

**4.** Edhe gjatë këtij viti kanë ardhur në disa raste ankesa për veprime e qëndrime të njëanshme të gjyqtarëve të veçantë gjatë gjykimeve konkrete dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja jonë për përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes. Nga ana jonë ankuesit janë sqaruar mbi kërkesat e ligjit për përjashtimin e gjyqtarëve dhe rrugën ligjore që duhet të ndjekin për realizimin e këtyre të drejtave.

**5.** Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë ndaj të cilave është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor derisa të shqyrtohet rekursi nga Gjykata e Lartë.

**6.** Po kështu, ka patur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë kur palët kanë zbuluar prova të reja shkresore dhe për këtë, është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për t’ju drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim vendimi. Edhe në këto raste ne kemi bërë sqarimet e nevojshme se për realizimin e këtyre të drejtave ankuesit duhet të konsultoheshin me një avokat privat, të cilët marrin pjesë në Gjykatën e Lartë si mbrojtës të tyre, detyrë e cila nuk mund të kryhet nga institucioni ynë, mbasi nuk e lejon ligji.

**7.** Në disa raste ankesa kanë ardhur ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke pretenduar se nga gjykatat, gjatë gjykimit të çështjeve të tyre, nuk janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit material e procedural për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, për të kërkuar që vendimet gjyqësore të deklarohen antikushtetuese.

**8.** Edhe gjatë këtij viti, në disa raste, kanë ardhur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave për të cilat janë ezauruar të gjitha mjetet e ankimit, duke përfshirë edhe ankimin kushtetues dhe kërkohet ndihma jonë që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën e Strasburgut.

Krahas sqarimit ligjor nga ana jonë, ankuesve në këto raste u është dhënë edhe formulari përkatës që duhet të plotësohet prej tyre dhe të kërkojnë ndihmën e një avokati privat.

**9.** Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore ku janë marrë masa të rënda dënimi nga gjykata dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, me qëllim që ndaj tyre të zbatohet Amicus Curie (Miku i gjykatës). Në këtë drejtim ka vend për t'u ndalur më shumë në të ardhmen duke patur parasysh rastet e të miturëve dhe të grave të akuzuara për vepra të ndryshme penale.

**10.** Ankesa kanë ardhur edhe për zvarritje të padrejta nga administrata e gjykatave në drejtim të dërgimit të dosjeve për gjykim nga Gjykatat e Rretheve në Gjykatat e Apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas.

**11.** Po kështu ankesa kanë ardhur edhe për faktin se, ndonëse kanë përfunduar gjykimet, palëve nuk u jepen kopjet e vendimeve nga administrata gjyqësore.

**12.** Gjatë vitit 2009 ankesa kanë ardhur edhe ndaj gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të Shkallës së Parë apo të Gjykatave të Apelit duke i akuzuar ato për veprime të ndryshme korruptive dhe kërkohet që nga Avokati i Popullit të fillohet procedimi disiplinor si për shkelje të ndryshme ligjore në detyrë, ashtu dhe për veprime të ndryshme korrupsioni.

Nga analiza e ankesave të ardhura ndaj gjykatave vërehet se, në përgjithësi njerëzit kanë besim ndaj institucionit tonë, dhe në disa raste arrihet deri aty sa ankuesit të paraqesin edhe dokumente apo fakte të ndryshme ligjore për të argumentuar të drejtat e tyre dhe ne të bëjmë vlerësimet e vendimeve gjyqësore.

Në këtë drejtim ne kemi bërë sqarimet ligjore duke sugjeruar se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore për sa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë.

Gjatë vitit 2009 për gjithë ankesat e ardhura ndaj gjykatave, në 25 raste ato janë zgjidhur në favor të ankuesve.

### **a. Ankesat e ardhura ndaj gjykatave të Rretheve Gjyqësore**

Nga 258 ankesa të ardhura gjatë vitit 2009, ndaj Gjykatave të Rretheve Gjyqësore kanë qenë 189 ankesa.

Nga verifikimi i këtyre ankesave ka rezultuar se, në pjesën më të madhe ankuesit nuk kanë patur të drejtë, mbasi gjyqtarët e akuzuar për shkelje kanë bërë “kujdes” që nga ana ligjore të mos vërtetohet ndonjë shkelje e dispozitave ligjore.

Ja disa nga rastet e ankesave të ardhura ndaj Gjykatave të Rretheve Gjyqësore gjatë vitit 2009 dhe për të cilat ankuesit janë ndihmuar nga ana jonë:

1. Ankuese F.D. nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje civile me objekt:” Anullimi i aktit administrativ të lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr.1 Tiranë, për lirimin e banesës së saj private të palegalizuar nga organet kompetente”.

Duke analizuar rastin dhe rrethanat e zbatimit të këtij akti nga administrata e Njesisë Bashkiake nr.1 Tiranë, nga ana jonë u bënë ndërhyrjet e nevojshme në gjykatë duke ndikuar në shpejtimin e gjykimit të kësaj çështje. Në përfundim gjykata mbasi mori në shqyrtim të gjitha provat e nevojshme, vendosi përfundimin e këtij gjykimi dhe pranimin e kërkesës së ankuese F.D. si të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe në prova.

2. Ankuesi R.Dauti nga Rrethi i Dibrës, është ankuar se megjithëse me vendimin datë 03.02.2009 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ishte vendosur pranueshmëria e ankimit të tij për shkeljen e nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, dhe detyrimi i Qeverisë Shqiptare për t’i paguar atij shumën 6000 Euro, kjo shumë atij nuk i paguhej pa shkaqe ligjore.

Nga verifikimi ynë rezultoi se Ministria e Financave kishte dhënë mendimin e saj pozitiv lidhur me projekt/vendimin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 03.02.2009 për çështjen nr.19205/05”Dauti kunër Shqipërisë” dhe kjo shumë ju pagua ankuesi R.D. në një kohë të shkurtër.

3. Ankuese L.V. nga Tirana ishte ankuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, se djali i saj M.V. i mitur, është arrestuar padrejtësisht nga Policia dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Nga verifikimi ynë rezultoi se ky arrestim ishte kryer nga Policia me datën 18.12.2008 duke e akuzuar atë për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim dhe ndaj tij gjykata kishte vendosur masën e arrestit me burg pa afat.

Gjatë hetimeve paraprake është konstatuar se personi i arrestuar ishte i mitur dhe materialet në ngarkim të tij janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ndodhet

Seksioni për të miturit i kësaj zone. Nga ana jonë rezultoi se personi i mitur, i arrestuar mbahej në Burgun e Lezhës së bashku me të dënuarit e tjerë të rritur dhe me këtë rast, u ndërhy me rekomandim në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila ka vendosur transferimin e tij menjëherë në Burgun 313 Tiranë në Sektorin e të Miturëve.

Nga ana tjetër, avokati i të arrestuarit kishte paraqitur një kërkesë për ndryshimin e masës së sigurimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbasi shqyrtoi kërkesën e tij, vendosi ndryshimin e masës së sigurimit nga arrest me burg pa afat, në detyrim për tu paraqitur në Prokurorinë e Rrethit. Pra u bë e mundur që ai të ndiqet penalisht në gjendje të lirë në të ardhmen.

Kjo ankesë u zgjidh në favor të ankuesit, pasi ai si i mitur qëndronte së bashku në një burg me të dënuarit e rritur dhe ndaj tij u bë ndryshimi i masës së sigurimit nga ajo me arrest në burg pa afat, në detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore.

4. Ankuesja E.Xh. nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje civile.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se kërkesa padia e saj me objekt pjestim i pasurisë së përbashkët, në bazë të nenit 207 të Kodit Civil, ishte paraqitur për gjykim në gjykatë me datën 08.07.2003. Rezultoi se ishin ndërruar disa gjyqtarë dhe çështja nuk kishte përfunduar akoma nga gjykata. Duke analizuar shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore rezultoi se i padituri duke qënë biznesmen, ishte i interesuar të shtyhej sa më gjatë gjykimi me qëllim që atij të mos i cënohej biznesi.

Nisur nga rasti konkret, nga ana jonë u njoftua Ministri i Drejtësisë dhe Inspektoriati i KLD-së, të cilët morën masat e nevojshme për zhvillimin normal të këtij gjykimi në të ardhmen.

5. Ankuesi V.L. i dënuar në Burgun e Fushë- Krujës është ankuar ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimin të një kërkesë për lirim para kohe me kusht.

Nga verifikimi ynë rezultoi se nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore atij i lëshohej çertifikata se ai “nuk ishte i dënuar” në një kohë që ai po vuante një dënim me burgim në Burgun e Fushë-Krujës.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se me vendimin nr.161 datë 03.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur njohja e vendimit nr.38 datë 06.03.2003 i Gjykatës së Shkallës së Parë Malmoe Suedi, dhe dënimi i tij me 10 vjet burgim dënim të cilin ai po e vuan në Burgun e Fushë- Krujës.

Mbi ndërhyrjen tonë nga administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u plotësua dhe u dërgua buletini i dënimit dhe Ministria e Drejtësisë me datën 11.11.2009 i ka lëshuar vërtetimin e gjendjes gjyqësore mbi veprën penale të gjykuar dhe masën e dënimit.

Në këto rrethana gjykata mbasi e shqyrtoi kërkesën e tij vendosi pranimin e kërkesës së tij, për lirim para kohe me kusht.

Mbi shkeljet e konstatuara nga gjykata, nga ana jonë ju dërgua një rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që në rastet e njohjes së vendimeve të gjykatave të huaja, mbasi vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë, të plotësohet dhe të dërgohet buletini i dënimit menjëherë në Ministrinë e Drejtësisë. Ky rekomandim u pranua dhe Ministri i Drejtësisë ka lëshuar një urdhër për këtë qëllim.

6. Ankuesja M.K. nga Kuçova ankohej se djali i saj ndodhej i arrestuar dhe i dënuar për një vepër penale për të cilën ajo pretendonte se ishte gjykuar e dënuar edhe një herë tjetër më parë me vendim të formës së prerë të Shtetit Zvicëran.

Ankuesja pretendonte gjithashtu se ajo ka kërkuar një kopje vendimi penal për dënimin e djalit të saj në Zvicër, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, dhe kjo ministri nuk i kishte kthyer asnjë përgjigje.

Nga verifikimi ynë rezultoi se kopja e vendimit penal për gjykimin e djalit të ankuses në Zvicër kishte ardhur në Drejtorinë e Bashkëpunimit Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë, dhe ky vendim ishte dërguar sipas procedurave ligjore Prokurorisë së Përgjithshme, për ta paraqitur gjatë gjyqimit në Gjykatën e Apelit Vlorë.

7. Ankuesi H.K. nga Dibra është ankuar ndaj vendimit gjyqësor Nr.53 datë 12.05.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me të cilin është gjykuar dhe dënuar në mungesë djali i tij me 1 vit burgim.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se në dispozitivin e vendimit gjyqësor thuhej se ndaj atij vendimi lejohet ankim dhe për të gjykuarin në mungesë, ky afat fillon nga dita e komunikimit të vendimit.

Në këto rrethana ankuesi u sqarua se ai ka të drejtën e kërkesës për rivendosje në afat në bazë të nenit 147/2 të Kodit Procedurës Penale.

Po kështu, në bazë të nenit 427/4 të Kodit Procedurës Penale, ankuesi u sqarua se Gjykata e Apelit vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë, sepse nuk ka marrë dënimin ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore në gjykim.

Në bazë të nenit 2 të Ligjit nr.9101 datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", ankuesi u sqarua gjithashtu se këto të drejta mund të mbrohen në Gjykatën e Apelit me ndihmën e një avokati privat, i cili jo vetëm harton kërkesën ankimore, por bën edhe mbrojtjen në gjykatë.

8. Ankuesi H.K. nga Rrethi i Pogradecit është ankuar ndaj vendimit civil Nr.99, datë 02.03.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i marrë në mungesë duke pretenduar se ai nuk është vënë në dënim të këtij gjykimi dhe nuk i është bërë komunikimi i kopjes së vendimit gjyqësor sipas procedurave ligjore.

Nga ana jonë u bënë sqarimet e nevojshme ligjore se problemin duhej ta ankimonte në shkallë të dytë në Gjykatën e Apelit Korçë, duke u konsultuar me një avokat privat, i cili duhej ti hartonte kërkesën ankimore dhe të bënte mbrojtjen e çështjes së tij në Gjykatën e Apelit.

9. Ankuesit G.A. etj nga Rrethi i Sarandës, janë ankuar në institucionin tonë ndaj vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të marrë në mungesë duke pretenduar se ata nuk janë njoftuar për vendimin si nga organi i procedimit penal, ashtu edhe nga gjykata.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se në dosjen penale ndodheshin fletë thirrjet për njoftimin e tyre dhe se ata nuk ishin paraqitur pa shkaqe ligjore ndaj gjykimi në gjykatë është bërë në mungesë të tyre duke caktuar një avokat mbrojtës kryesisht.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se në dosjen penale ndodhen të gjitha njoftimet e bëra nga gjykata në adresën e tij, të cilat janë firmosur nga familjarët e tij dhe në bazë të nenit 410/2 të Kodit Procedurës Penale, ai mund të ankohet në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, duke ngritur para saj të gjitha shkeljet dhe pretendimet që mendohet se janë kryer nga gjykata e shkallës së parë. Ankuesi u sqarua se duhet të konsultohet me një avokat privat.

Edhe gjatë vitit 2009 kanë ardhura ankese të ndryshme ndaj gjyqtarëve dhe avokatëve privat, duke i akuzuar ato për shkelje ligji të kryera në kryerjen e detyrës së tyre.

Nga ana jonë, në zbatim të kërkesave të nenit 17/b të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ankesat e bëra, së bashku me dokumentat shoqëruese të tyre, i janë dërguar për shqyrtim organit kompetent, Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Ministrisë të Drejtësisë i cili ka të drejtën e procedimit penal ndaj gjyqtarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe ato të Gjykatave të Apelit, dhe për avokatët privat në Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

Në përgjithësi në këto ankese bëhet fjalë për gjyqtarë të veçantë të cilët gjatë kryerjes së detyrës së tyre pretendohet se janë treguar të njëanshëm dhe jo objektiv për raste konkrete, duke dhënë dënime të buta në kundërshtim me parashikimet e ligjit përkatës.

Po kështu në disa raste të tjera ankuesit, duke qënë të mërzhitur nga tejzgjatja e proceseve gjyqësore nga njëra shkallë e gjykimit tek tjetra nuk binden me përgjigjen e kthyer nga ana jonë, sidomos me arsyetimin “se vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit tonë”.

Ankuesit nga ana e tyre këmbëngulin se Avokati i Popullit duhet të bëjë patjetër vlerësimin e vendimeve gjyqësore mbasi sipas tyre ato janë hapur të padrejtë dhe të pa mbështetur në ligj. Ato paraqesin tek ne edhe dokumenta apo prova të tjera shkruesore me të cilët këmbëngulin që ne të krijojnë bindje me çdo kusht se ato kanë të drejtë, por kjo e drejtë atyre nuk u jepet nga gjykatat, mbasi sipas tyre ato janë të korruptuara.

Në lidhje me ankesat e ardhura gjatë kësaj periudhe ne kemi bërë të gjitha sqarimet e nevojshme se për vendimet gjyqësore nuk mund të ndërhyhet nga ne derisa të bëhen ndryshimet përkatëse si në Kodin e Proçedurës Penale, ashtu edhe në Kodin e Proçedurës Civile.

Në lidhje me problemet e zvarritjeve të gjykimeve të ndryshme për çështje penale për mendimin tonë del nevoja e rishikimit të disa dispozitave në Kodin e Proçedurës Penale, me synim shkurtimin e afateve si të hetimit, ashtu edhe të gjykimit të proçedimeve.

Në këtë përfundim arrihet në fakt sepse me afatet ekzistuese lihet shteg për abuzim nga punonjës të veçantë si të prokurorisë në fazën e hetimit paraprak, ashtu edhe nga gjyqtarë të veçantë në fazën e gjykimit të proçedimeve penale.

Për mendimin tonë, në lidhje me afatet e hetimit dhe të gjykimit, ka vend që të bëhen studime dhe përgjithsime për të parë mundësinë e rishikimit të tyre, duke patur parasysh periudhën e gjatë të miratimit të Kodit të Proçedurës Penale, (1995) dhe problemet që kanë dalë gjatë zbatimit të tij në praktikën gjyqësore.

Edhe në drejtim të zvarritjeve në gjykimin e çështjeve civile mendojmë se duke u bazuar edhe në ankesat e ardhura në Institucionin e Avokatit të Popullit, ku vendin kryesor të tyre e zënë zvarritjet pa shkaqe ligjore, ka vend për t'u bërë rishikim dispozitave të Kodit të Proçedurës Civile për sa u takon afateve të gjykimit.

Gjithashtu ka vend për të parë mundësinë e rritjes së numrit të çështjeve civile që gjykohen me 1 gjyqtar, në raport me çështjet që sot shqyrtohen nga gjykata me 3 gjyqtarë. Për këtë duhet patur parasysh se gjyqtarë të një gjykate shpesh konsumohen në gjykimin e çështjeve, të cilat shpesh kthehen për rigjykim disa herë nga gjykatat më të larta. Kështu gjyqtarët kanë pengesa ligjore për gjykimin e tyre. Ky problem deri tani është zgjidhur duke u komanduar sipas rastit gjyqtarë nga Gjykatat e rretheve të tjera gjyqësore, me vendim të KLD-së, veçse zvarritjet nuk shmangen dhe qytetarët ankohen me të drejtë për sorollatje dhe zvarritje gjykimi.

#### **b. Ankesat ndaj Gjykatës së Apelit**

Gjatë vitit 2009 ndaj gjykatave të Apelit kanë ardhur gjithsej 42 ankesa, nga të cilat 21 janë me objekt kundërshtim vendimi gjyqësor. Për ato është vendosur refuzimi i tyre mbasi kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Për 21 raste të tjera ankesat kanë patur si objekt shpejtimin e gjykimit ose është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja jonë për uljen e masave të dënimit të dhëna nga Gjykatat e Shkallës së Parë, ose na janë kërkuar ndërhyrje për dhënie kopje vendimi për të ushtruar rekurs brenda afatit



ligjor, mbasi ka përfunduar gjykimi dhe nga gjyqtarët nuk janë arsyetuar vendimet, për dhënien e vërtetimeve të ndryshme gjyqësore etj.

1. Ankuesi L.K. nga Gjirokastra është ankuar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë me të cilin është gjykuar dhe dënuar djali i tij, duke pretenduar se nga kjo gjykatë nuk janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë të gjitha pretendimet për një hetim të plotë të gjitha rrethanave të çështjes gjatë gjykimit.

Nga ana e ankuesit kërkohet ndihma dhe ndërhyrje e institucionit tonë në Gjykatën e Lartë për të marrë pjesë në gjykim dhe për të vendosur prishjen e këtij vendimi dhe lirim nga burgu të djalit tij duke arsyetuar se ndaj tij nuk ka prova dhe fakte dhe se ai është i pafajshëm.

Nga ana jonë mbasi u bë verifikimi i rastit dhe ju dhanë sqarimet e nevojshme se këto veprime kryhen nga një avokat privat, dhe se institucioni i Avokatit të Popullit, nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e Gjykatës së Lartë, pasi një veprim të tillë nuk e parashikon ligji.

2. Ankuesi A.B. nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje civile.

Nga verifikimi rezultoi se Gjykata e Apelit Tiranë, ka marrë në shqyrtim ankesën e bërë dhe me vendimin e saj nr.556 datë 21.04.2009 ka vendosur prishjen e vendimit nr.6599 datë 11.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Ky gjykim rezultoi se është zhvilluar nga Gjykata e Apelit Tiranë, në mungesë duke u mjaftuar me shpalljen e listës së gjykimit.

Në rastin konkret ankuesi u sqarua se në rast se ka pretendime ndaj këtij vendimi ka të drejtën e rekursit brenda 30 ditëve në Gjykatën e Lartë, dhe ky afat i fillon nga dita e komunikimit të vendimit gjyqësor. Për realizimin e këtyre të drejtave ankuesi u sqarua se mund të konsultohet me një avokat privat, i cili mund të bëjë mbrojtjen e tij në gjykatë.

3. Ankuesi A.I. nga Tirana ankohet ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, se ka gjykuar në mungesë një çështje civile. Nga verifikimi i bërë rezultoi se kjo çështje është gjykuar në mungesë nga Gjykata e Apelit Tiranë duke u mjaftuar me njoftimin e shpallur vetëm në listat e gjykimit dhe nuk janë bërë njoftimet zyrtarisht për datën dhe orën e gjykimit.

Në këto kushte ankuesi u sqarua nga ana jonë se ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë, duke parashtruar para saj të gjitha shkeljet që pretendohen se janë kryer nga gjykata. Ky veprim duhet bërë me ndihmën e një avokati privat, i cili pregatit dokumentat e nevojshme dhe bën mbrojtjen në gjykatë.

4. Ankuesi A.Z. nga Rrethi i Matit është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se Gjykata e Apelit Tiranë, ka shqyrtuar në mungesë çështjen penale ndaj ankuesit A.Z. dhe në

përfundim të gjykimit me vendimin e saj me nr.554, datë 17.06.2009 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me objekt, shuarje dënimi për shkak të përfitimit nga ligji nr.9678, datë 13.01.2007 “Për dhënien e amnistisë”. Në rast se nuk është dakord me këtë vendim ai u sqarua se mund të ushtrojë rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë brenda afati 30 ditor dhe ky afat fillon nga dita e komunikimit të vendimit të marrë në mungesë nga Gjykata e Apelit.

Po kështu ankuesi është sqaruar se rekursi dhe mbrojtja në Gjykatën e Lartë bëhet me ndihmën e një avokati privat.

5. Ankuesi I.Gj. nga rrethi i Fierit është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Vlorë, për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje civile me objekt pagimin e dëmshpërblimit për vjetërsi në punë, për largim nga puna padrejtësisht të bërë nga kompania private ARMO Fier.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se mbasi është bërë komunikimi i ankimit nga Gjykata e Rrethit Fier, dosja civile ka shkuar për gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila në bazë të shortit elektronik ka caktuar edhe gjyqtarin relator. Duke patur parasysh kushtet ekonomike e familjare dhe ato shëndetësore të ankuesit, Gjykata e Apelit Vlorë mori masat e nevojshme për shpejtimin e këtij gjykimi pas ndërhyrjes tonë.

Në përfundim të gjykimit Gjykata e Apelit Vlorë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Kështu që ankesa u zgjidh në favor të ankuesit.

6. Ankuesi L.B. nga Berati ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, duke pretenduar se gjykatat ndaj tij kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor.

Mbasi u studjuan materialet gjyqësore nga ana jonë ju bë rekomandim Gjykatës së Lartë për shpejtim gjykimi duke marrë në konsideratë pretendimet e ankuesit. Gjykata e Lartë mori në konsideratë rekomandimin tonë duke shpejtuar gjykimin e çështjes dhe me vendimin e saj nr.443, datë 25.09.2009 ka vendosur mospranim rekursi. Për pretendimet e tjera ndaj këtij vendimi ankuesi u sqarua se mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese dhe pas saj Gjykatës së Strasburgut, duke u konsultuar për realizimin e këtyre të drejtave me një avokat privat.

Nga ana jonë në çdo rast janë bërë sqarimet e nevojshme ligjore për rrugën që mund të ndjek ankuesi për zgjidhjen e problemit si me kërkesë për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 131 germa “f” të Kushtetutës, ashtu edhe me kërkesë për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë, në bazë të nenit 494 të Kodit Procedurës Civile, duke kërkuar për realizimin e këtyre të drejtave edhe ndihmën e një avokati privat.

### **c. Ankesat ndaj Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda**

Gjatë vitit 2009 në institucionin tonë kanë ardhur gjithsej 3 ankesa ndaj Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda.

Në të 3 rastet ankesat kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore dhe nga ana jonë, duke i konsidruar jashtë juridiksionit të institucionit tonë, i kemi refuzuar ato.

#### **ç. Ankesat ndaj Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda**

Gjatë këtij viti në intitucionin tonë kanë ardhur vetëm 3 ankesa ndaj Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

1. Ankuesi S.E. i dënuar në Burgun e Fushë- Krujës, ankohej ndaj vendimeve nr.20 datë 31.03.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për krimet e Rënda Tiranë, dhe vendimit nr.41 datë 07.07.2008 të Gjykatës së Apelit Për Krimet e Rënda Tiranë, me të cilin ai ishte dënuar me 11 vjet burgim, ndërsa gruaja e tij ishte dënuar si bashkëpunëtoare në krim me 10 vjet burgim.

Ankuesi është sqaruar se vendimet gjyqësore prishen ose ndryshohen mbi bazën e ankimit dhe të rekursit në gjykatat më të larta dhe se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë.

2. Ankuesi P.Ll. nga Mirdita ankohej ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit për krimet e Rënda Tiranë, me të cilin ai ishte dënuar me 9 vjet burgim duke pretenduar se vendimi është i padrejtë dhe i pabazuar në prova dhe në ligj.

Meqenëse ndaj këtij vendimi ai kishte ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, u sqarua se pretendimet e tij t'i parashtrojë gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë e cila në bazë të nenit 441 të Kodit Proçedurës Penale, vendos prishjen e vendimeve kur janë kushtet dhe kriteret e parashikuar nga ligji. Të drejtat gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë ankuesi mund t'i mbrojë me ndihmën e një avokati privat.

3. Ankuesja Z.B. nga Korça, ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me të cilin është gjykuar e dënuar padrejtësisht djali i saj.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se djali i ankueses ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë, e cila nuk e ka shqyrtuar akoma. Për shkeljet dhe pretendimet e saj ndaj vendimeve gjyqësore ankuesja është sqaruar mbi rrugën ligjore të shqyrtimit dhe të prishjes së vendimit gjyqësore nga një gjykatë më e lartë, me ndihmën e një avokati privat.

#### **d. Ankesat ndaj Gjykatës së Lartë**

Dihet se Gjykata e Lartë nuk ka lidhje vartësie nga Ministria e Drejtësisë. Por ne i kemi radhitur ankesat në këtë kre, për shkak të problemeve që ngrenë shtetasit për këtë Gjykatë, që janë pothuaj të njëjlojta me ato që ngrejnë ata edhe për gjykatat e tjera më të ulta.

Në vitin 2009 kundër Gjykatës së Lartë kanë ardhur gjithsej 27 ankesa. Nga këto, në 4 raste ankesat kanë qënë kundër vendimeve

gjqësore të Gjykatës së Lartë dhe nga ana e jonë ato janë refuzuar si jashtë juridiksionit tonë.

Mbi bazën e informacionit të dhënë në median e shkruar dhe konkretisht artikullit të gazetës “Metropol” të datës 01.07.2009 “I liruar me vendim pesë muaj peng nga gjykata e akuza”, Avokati i Popullit ka marrë për shqyrtim rasti i të dënuarit P.D.nga Berati. Nga ana jonë është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë si edhe është administruar pranë sekretarisë gjyqësore një kopje e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga drejtoria e I.E.V.P. Kosovë e Lushnjes ku vuante dënimin shtetasi P.D është marrë shkresa së bashku me urdhërin e ekzekutimit të vendimit penal datë 08.07.2009. I dënuari P.D. është liruar nga burgu më datën 09.07.2009, pra pas pesë muajve të qëndrimit padrejtësisht në burg për faj të Gjykatës së Lartë.

Në ankesën e tij shtetasi R.M nga Shkodra ankohej ndaj Prokurorisë së Përgjithshme dhe Gjykatës së Lartë për mosnxjerrje të urdhërit të ekzekutimit për lirim nga I.E.V.P. Shënkoll -Lezhë të nipit të tij I.M, e si rrjedhojë ai ka qëndruar padrejtësisht në burg 7 ditë.

Për të dy rastet Avokati i Popullit i ka paraqitur rekomandime Kryetares së Gjykatës së Lartë dhe Prokurores së Përgjithshme për marrjen e masave me qëllim ekzekutimin e vendimeve penale ndaj personave që duhet të lirohen nga burgu, menjëherë pas shpalljes së vendimeve nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë.

1. Ankuesi R.H. nga Rrethi i Shkodrës ankohej ndaj vendimit nr.279, datë 04.06.2009 të Gjykatës së Lartë Tiranë me të cilin ishte gjykuar dhe dënuar në mungesë djali i tij I.H. me 16 vjet burgim.

Nga verifikimi ynë rezultoi se Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim.Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nga organi i prokurorisë dhe Gjykata e Lartë Tiranë duke gjykuar këtë çështje në themel në përfundum ka vendosur, prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dënimin e të gjykuarit me 16 vjet burgim.

Në lidhje me shkeljet proceduriale të kryera nga gjykata për gjykimin në mungesë të tij dhe mos respektimin e të drejtës së mbrojtjes në gjykim, ankuesi u sqarua se në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ai ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, dhe të kërkojë shfuqizimin këtij vendimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Për realizimin e të drejtave ligjore në përgatitjen e kërkesës për gjykim dhe mbrojtjen në Gjykatën Kushtetuese, ankuesi u sqarua se mund të kërkojë ndihmën e një avokati privat.

2. Ankuesi Xh.H. nga Tirana ankohej ndaj Gjykatës së Lartë për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje penale me të cilën ai

ishte gjykuar e dënuar padrejtësisht nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë me 12 vjet burgim. Nga ana jonë duke vlerësuar pretendimet e drejta të ankuesit për kohën e gjatë të hetimit dhe të gjykimit prej 3 vjetësh ju dërgua rekomandim Gjykatës së Lartë Tiranë duke arsyetuar shkaqet ligjore të përsheptimit të këtij gjykimi, rekomandim i cili përfundimisht u pranua nga Gjykata e Lartë.

3. Ankuesi Xh.H. nga Tirana është ankuar ndaj vendimeve nr.53 datë 23.11.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë dhe vendimit nr.23 datë 25.04.2008 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë me të cilët ai ishte deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283 të K.Penale me 12 vjet burgim. Ankuesi Xh.H. pretendonte se për të njëjtën vepër penale ai ishte gjykuar dhe dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një gjykatë e huaj në shtetin Maqedonas.

Gjykata e Lartë Tiranë me vendimin e saj me nr.194 datë 22.04.2009 kishte vendosur prishjen e dy vendimeve gjyqësore dhe pushimin e gjykimit të çështjes për të gjykuarin Xh.H. duke urdhëruar lirin e ankuesit menjëherë nga burgju.

Nga arsyetimi i vendimit gjyqësor rezultoi se ankesa e ankuesit Xh.H. ishte e drejtë dhe e bazuar në ligj, mbasi ai për të njëjtën vepër penale ishte dënuar një herë në vitin 2005 nga një gjykatë e huaj dhe ky vendim për të kishte marrë formë të prerë. Pra si përfundim gjykimi dhe dënimi i ankuesit Xh.H. u konsideruan të kundraligjshëm dhe si të tillë ato u prishën nga Gjykata e Lartë.

4. Ankuesi N.M nga Shkodra ankohej ndaj Gjykatës së Lartë për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore të një çështje civile.

Nga verifikimi ynë rezultoi se pretendimet e ankuesit u gjetën të drejta dhe të bazuara në ligj dhe Gjykatës së Lartë Tiranë ju dërgua një rekomandim për shpejtim të këtij gjykimi. Rekomandim ndodhet në shqyrtim pasi kjo çështje nuk është gjykuar akoma nga Gjykata e Lartë .

5. Ankuesi Gj.P, i dënuar në Burgun e Peqinit, është ankuar se është dënuar padrejtësisht nga gjykata me burgim të përjetshëm.

Ndaj këtij vendimi gjyqësor ai ka bërë kërkesë për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë Tiranë e cila nuk po e merr këtë kërkesë në shqyrtim.

Nga verifikimi ynë rezultoi se kërkesa e tij ndodhej e regjistruar për shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe pret radhën e gjykimit.

Nga ana tjetër ankuesi u sqarua se të drejtat e tij gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë mund t'i realizojë me ndihmën e një avokati privat të zgjedhur prej tij.

6. Ankuesi I.S. nga Tirana ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore nga Gjykata e Lartë të një çështje penale me të cilin është gjykuar e dënuar djali i tij B.S.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se kjo çështje është gjykuar dhe me vendimin datë 06.02.2009 të Gjykatës së Lartë është vendosur mospranimi i rekursit.

Nga ana jonë ankuesi u sqarua mbi rrugën ligjore të ankimit duke ju drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës duke argumentuar para saj se gjykatat nuk kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor.

7. Ankuesi E.Sh. nga Durrësi është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një kërkesë me objekt rishikim vendimi gjyqësor të formës së prerë. Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se kërkesa për rigjykim vendimi ndodhej e regjistruar në pritje për të kaluar në Dhomën e Këshillimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

Nga ana tjetër është bërë sqarimi se çështjet kanë një radhë për tu vënë në lëvizje, radhë e cila varet nga data e regjistrimit të dosjes në Gjykatën e Lartë.

Duke patur parasysh problemet që kanë dalë herë pas here për sigurinë e gjyqtarëve, kemi dërguar një rekomandim për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr.9110 datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”. Rekomandimi i është drejtuar Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe për dijeni Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Ministrave ndër të tjera pati parasysh edhe rekomandimin tonë dhe nxorri vendimin nr.480 datë 06.05.2009 “Për mbrojtjen e veçantë personale, të familjes dhe të pronës së gjyqtarëve dhe për sigurinë e jetës e të pronës së tyre”.

#### 4. Ankesat për Prokurorinë

Sipas Kushtetutës sonë Prokuroria nuk bën pjesë në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi studimi e kemi përfshirë pas saj.

Veprimtaria e punës së Avokatit të Popullit, në shqyrtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë ka konsistuar në zbatimin korrekt dhe objektiv të Kushtetutës, ligjit që normon punën tonë dhe ligjit procedural penal.

Në rastet e konstatimit të shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve në procesin penal, duke bashkëpunuar me Prokurorinë, kemi synuar që ato t'i shërbejnë qëllimit të mirë për përmirësimin e punës së Prokurorisë në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Për vitin 2009 në Institucionin tonë **290** shtetas të ndryshëm kanë paraqitur **169** ankese apo kërkesa, të cilat kanë patur për objekt

veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë. Mënyra e përfundimit të ankesave për vitin 2009 është: **46** ankesa janë zgjidhur në favor ose 27.5 përqind, **23** ankesa kanë qënë jashtë juridiksionit, **70** ankesa jashtë kompetence, dhe **24** ankesa kanë qënë të pabazuara. Për vitin 2010 kanë kaluar për shqyrtim 6 ankesa. Gjatë vitit 2009 janë shqyrtuar dhe 12 ankesa të mbartura nga viti 2008, të cilat kanë përfunduar në këtë mënyrë: 3 ankesa janë zgjidhur në favor, 6 ankesa jashtë kompetence dhe 3 jashtë juridiksionit.

Edhe për vitin 2009 ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë janë shqyrtuar me përparësi. Për ankesat që kanë qënë brënda kompetencës sonë, Avokati i Popullit ka bërë vlerësimet e rastit dhe ka urdhëruar kryerjen e procesit të hetimit administrativ nëpërmjet realizimit të veprimeve të nevojshme si marrja e deklarimeve të shtetasve të ndryshëm, kqyrja e dokumentave, kryerja e ekspertimeve mjeko-ligjore ose teknike me specialistë të fushave përkatëse, apo duke studjuar dosje hetimore për të cilat Prokuroria kishte vendosur, mosfillimin e procedimit penal, pushimin apo pezullimin e çështjes penale.

\*Për mjaft ankesa është shkuar në vëndbanimin e ankuesit ose kërkuesit, apo janë kryer veprimet në vënd, duke marrë dhe shpjegimet apo informacionin e nevojshëm në organin e Prokurorisë, ndaj të cilit shtetasi ka bërë ankimin. Në këto raste nga drejtuesit e Prokurorive dhe prokurorët që kanë patur çështjet në hetim është gjetur predispozicioni i nevojshëm. Vlen për t'u përmëndur fakti se gjatë vitit 2009 Avokati i Popullit ka kryer inspektime me grup ekspertësh në Institucionet e Paraburgimit si në Korçë, Kukës, Sarandë, Lezhë, Tropojë apo I.E.V.P Burrel, Peqin, Shën Koll të Lezhës etj, duke marrë një numër të konsiderueshëm ankesash nga shtetas të ndryshëm që ndodhen në këto institucione. Pra, edhe për vitin 2009 është bërë një vlerësim korrekt i ankesave dhe për rrjedhojë janë kryer hetime të gjithanëshme me ditë të tëra e me grup ekspertësh, dhe është ndjekur ecuria e tyre në vazhdimësi deri në përfundimin e çështjeve penale nga organi i Prokurorisë.

\*Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me precedencë dhe ankesat e shtetasve apo shoqatave që përfaqësojnë interesa të një grupi të caktuar personash të organizuar në sindikata, fondacione si nga "Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar" për fëmijët e ngujuar në Poliçan të Skraparit, Shoqata e të Burgosurve Politikë; Shoqata Kombëtare "9 janari 2004"; Peticion nga nxënës maturan të dhe mësues të shkollës së mesme të përgjithshme "Ali Demi" në Vlorë etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2009 ka marrë në shqyrtim dhe ankesën e shtetasit bullgar J.S, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për arsye se e kishte akuzuar padrejtësisht për veprën penale të "Falsifikimit të dokumentit" të

identifikimit, ndonëse sipas tij ajo ishte lëshuar në mënyrë korrekte nga Ministria e Brëndshme e Bullgarisë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se, shtetasi bullgar J.S. kishte kryer një vepër penale në Bullgari për të cilën ishte dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë 1 vit e 4 muaj burgim dhe për këtë, pas arrestimit të tij nga Interpool -Tirana është realizuar ekstradimi në Bullgari.

A. Gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2009, vihet re se objekti i tyre është i njëjtë me objektin e ankesave të paraqitura edhe gjatë vitit 2008. Në mënyrë të grupuar shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë:

### **1. Për zvarritje në hetimin e çështjeve penale**

Raste të tilla mund të përmëdim ankesën e shtetasve S.LL, F.K. dhe A.L nga Tirana; GJ.P. nga Lezha; T.SH nga Durrësi; V.Z nga Korça; Ç.H. nga Fieri etj.

\*Në Institucionin e Avokatit të Popullit një numër i konsiderueshëm ankuesish nga rrethe të ndryshme të vendit ngrenë shqetësimin për zvarritje në hetimin e çështjeve penale për krime të rënda si “Vjedhje të pasurisë me pasoja të rënda”, “Vrasje”, “Mashttrim” apo dhe vepra të tjera penale si “Falsifikim të dokumentave” etj. Kështu në ankesën e tij shtetasi Ç.H. nga Fieri ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor së atij rrethi për zvarritje në hetimin e çështjes penale që bënte fjalë për vjedhje të shumave të konsiderueshme në valutë të huaj dhe lekë shqiptare, djalit të tij të mitur J.H.

\*Në ankesën e tij shtetësja S.LL nga Tirana ka ngritur shqetësimin për zvarritje të pajustificuara në hetimin e proçedimit penal nr.3830 të vitit 2008 filluar më datën 18 nëntor pas kallëzimit të saj për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe pa marrë parasysh kërkesat me shkrim të përfaqësuesit ligjor të ankueses në respekt të nenit 110/1 të Kodit të Proçedurës Penale, që bën fjalë për “Memoriet dhe kërkesat e palëve”, organi i Prokurorisë më datën 05.10.2009 ka vendosur pushimin e hetimit të këtij proçedimi penal.

\*Në ankesën e tij shtetasi F.K. nga Tirana ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zvarritje në hetimin e proçedimit penal nr.171 të vitit 2007 filluar për veprat penale të “Falsifikimit dhe përdorimit të dokumentit të falsifikuar”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 186/1 e 25 të Kodit Penal dhe “Vjedhje me anë të mashttrimit”, parashikuar nga neni 143 e Kodit Penal. Sipas ankuesit F.K. zvarritja në hetim i ka sjellë për pasojë dëm pasuror biznesit të tij. Në këtë proçedim penal janë kryer tre ekspertime kontabël me qëllim përcaktimin nëse janë pasqyruar saktë në bilancet e shoqërisë për vitet 2002-2006 aktiviteti i shoqërisë “BBF” SHA, evidentimi i personave përgjegjës në rast konstatimi të shkeljeve etj. Pavarësisht kryerjes së një numri të



konsiderueshëm veprimesh hetimore si kryerje të ekspertimeve të ndryshme si kontabël etj, apo dhe veçimit të çështjes për veprën penale të “Shpërdorimit të kompetencave nga ana e antarit të Këshillit Mbikqyrjes të një shoqërie tregëtare”, parashikuar nga neni 164 e Kodit Penal deri në momentin e verifikimit nga ana e jonë datë 04.12.2009, kjo çështje penale ende nuk kishte përfunduar. Në zvarritjen e hetimit të këtij procedimi penal ka influencuar dhe ndjekja e çështjes nga disa prokurorë të ndryshëm.

\*Në ankesën e tij shtetasi P.M. nga Tirana ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, për arsye se ka zvarritur në mënyrë të pajustificuar hetimet e procedimit penal nr.111 të vitit 2009, filluar më datën 01.06.2009 për veprat penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”. Pavarësisht veprimeve të kryera sidomos për verifikimin e kërkesave të paraqitura nga ankuesi P.M, aktualisht procedimi penal i mësipërm ndodhet në fazën e hetimit paraprak dhe organi i Prokurorisë nuk ka marrë vendim për mënyrën e përfundimit të tij.

\*Në ankesën e tij shtetasi V.Z. nga Korça ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi e cila ka zvarritur hetimin e çështjes penale nr.1326 të vitit 2008 për veprën penale të “Vrasjes” së vëllait të tij F.Z, parashikuar nga neni 76 të Kodit Penal. Ndonëse në këtë procedim penal janë kryer veprime të konsiderueshme hetimore si dhe ekspertimi biologjik për gjakun e gjetur tek personi i dyshuar Z.X, organi i Prokurorisë më datën 10.06.2009 ka vendosur pezullimin e hetimit, bazuar në nenin 326 Pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, duke kaluar aktet e çështjes për veprime të mëtejshme pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë.

\*Gjatë shqyrtimit të ankesave janë ndeshur edhe raste kur hetimet janë zvarritur si rezultat i kthimit me vonesë të përgjigjeve të letërporosive nga autoritet e shteteve të tjera. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit M.K. nga Durrësi, i akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 e 25 të Kodit Penal. Edhe pse procedimi penal nr.147 është filluar në vitin 2002 dhe prokuroria e ka dërguar çështjen në gjyq në vitin 2003, pas rekursit të bërë në Gjykatën e Lartë kjo e fundit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për dënimin e shtetasit M.K dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, me trup tjetër gjykues. Nga verifikimi i kryer rezultoi se jo vetëm organi i Prokurorisë, por edhe gjykata megjithë kërkesat e herëpashershme drejtuar Ministrisë së Drejtësisë Tiranë në shkresat për ndihmë juridike, nuk ka bërë të mundur administrimin e përgjigjes së letërporosisë nga Italia. Kjo gjëndje ka vazhduar deri në datën 29.10.2009 kur Ministria e Drejtësisë shqiptare i rikujton Ministrisë së Drejtësisë Italiane

ekzekutimin e letër porosisë nr.102 datë 25.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, por ende nuk është kthyer përgjigje nga autoritetet e drejtësisë italiane. Ministri i Drejtësisë ka marrë masa për përshpjetimin e procedurave për ekzekutimin e letërporosisë nga autoritetet e drejtësisë italiane për zgjidhjen sa më shpejt të ankesës së shtetasit M.K.

\*-Me të njëjtin shqetësim është edhe ankesa e shtetasës R.V. nga Elbasani, e cila është ankuar për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.761 të vitit 2009 ndaj të kallëzuarit prej saj A.Ç akuzuar për veprën penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a/4/5 të Kodit Penal. Nga verifikimi i kryer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan rezultoi se arsyeja e zvarritjes së hetimit në këtë procedim penal ka qënë moskthimi i përgjigjes së letërporosive drejtuar autoriteteve të drejtësisë italiane.

Nga studimi dhe analiza e rasteve kur hetimet e procedimeve penale janë zvarritur në mënyrë të pajustificuar nga organi i Prokurorisë, konstatohet se zvarritjet e tejzgjatura në hetimin e çështjeve penale shpesh nuk kanë qënë justifikuese. Zvarritjet flasin sa për mosplanifikim në kryerjen e veprimeve hetimore të gjithanshme dhe në vazhdimësi, ashtu dhe për moskontroll të prokurorit që ndjek hetimin ndaj oficerëve të policisë gjyqësore. Shpesh, zvarritjet e hetimeve të procedimeve penale kanë patur si shkak transferimin e çështjeve penale nga një rreth tek tjetri duke shpallur moskompetencën gjatë hetimeve paraprake, kërkesë kjo e parashikuar nga neni 84 i Kodit të Procedurës Penale. Në raste të tjera, siç është ai i shtetasit A.H. nga Tirana, i cili ka kundërshtuar në gjykatë vendimin e pushimit të çështjes për “Falsifikim të dokumentave”, nuk është paraqitur në tre seanca gjyqësore prokurori, për arsye të transferimeve në detyrë apo rrethe tjetër.

\*Ankesat e shtetasve për zvarritje në hetimin e çështjeve penale kanë qënë dhe ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit H.T. nga Gjirokastra i cili ka ngritur shqetësimin për zvarritje në hetimin e procedimit penal që bën fjalë për veprën penale të “Dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, në ngarkim të djalit të tij R.T. dhe shtetasit P.G; Ankesa e shtetasit P.D. i cili ndodhej në Paraburgimin e I.E.V.P.313 Tiranë, akuzuar për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të Kodit Penal etj. Konstatojmë se më tepër duhet të vlerësohet momenti i regjistrimit të veprës penale në regjistrin penal që disponon organi i Prokurorisë, për të pasqyruar në të me vërtetësi dhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale, mbasi nga ky moment fillon afati i hetimit të çështjes penale, e cila parashikohet nga neni 287/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Nuk duhet të abuzohet në disa raste duke zgjatur hetimin e çështjes me justifikimin se vepra penale është pa autor, kur në kallëzimin e tyre

drejtuar Prokurorisë, shtetasit tregojnë dhe për autorin e veprës penale.

Konstatohet se nga ana e Prokurorisë në disa raste nuk tregohet kujdesi dhe interesimi i nevojshëm për marrjen e përgjigjeve të akteve të ekspertimeve të ndryshme si, mjeko-ligjore, kimike për lëndët narkotike, kriminalistike etj.

Avokati i Popullit duke ndjekur në vazhdimësi ankesat e shtetasve për zvarritje të theksuara në hetimin e çështjeve penale, ka konstatuar se kohëzgjatje e hetimeve sipas prokurorive në rrethe arrin deri në 5-6 muaj. Për këtë arsye është duke u përgatitur studimi për afatet e hetimit e paraburgimit, me qëllim përmirësimin e legjislacionit procedural penal.

## **2. Për moskryerje të hetimeve të gjithanëshme dhe objektive**

\*Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve L.L. nga Elbasani; R.L dhe A.C nga Tirana; L.D nga Vlora etj.

Më konkretisht ankesat e tyre kanë konsistuar në mosvënien para përgjegjësisë ligjore të autorit dhe bashkëpunorëve në kryerjen e krimit, në mosnjoftimin e akuzave për të gjitha veprat e kryera nga të pandehurit, në mosnxjerrjen e motiveve që kanë shtyrë autorët në kryerjen e veprës penale, në ndryshimin e kualifikimit të veprës nga një vepër më e rëndë në veprën më të lehtë në ngarkim të pandehurit, në moskryerjen e ekspertimeve të ndryshme mjeko-ligjore apo tekniko-grafike të nënshkrimit etj. Në raste të tjera nuk janë marrë deklaratimet e familjarëve të dëmtuar nga vepra penale, ndërsa kur palët kanë paraqitur kërkesa me shkrim, ato nuk janë vlerësuar dhe organi procedues nuk është shprehur për to, ose vendimi është marrë jashtë afatit 15 ditor që përcakton neni 110/2 i Kodit të Procedurës Penale. Për rrjedhojë moskryerja e hetimeve të gjithanëshme në disa raste, ka sjellë për pasojë dhe pezullimin e hetimit apo pushimin e çështjes penale.

\*Kështu në ankesën e tij shtetasi L.L. nga Elbasani ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore me qëllim zbulimin e autorit të vrasjes , mbytjes në lumë të djalit të tij H.L, ngjarje e ndodhur në datën 23 dhjetor të vitit 2008. Më konkretisht ankuesi ka kërkuar kryerjen e “ekzumimit të kufomës” sepse organi i Prokurorisë, më datën 02.04.2009 ka vendosur pushimin e çështjes duke arsyetuar ndërmjet të tjerave se në trupin e viktimës nuk kishte shënja dhune.

\*Në ankesën e tij shtetasi R.L. nga Tirana ngre shqetësimin dhe ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi sepse duke mos kryer hetime të gjithanëshme dhe objektive, ka pushuar padrejtësisht çështjen penale nr. 336 të vitit 2006 filluar mbi bazën e kallëzimit të tij. Pas kundërshtimit të vendimit të pushimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës së tij. Por nga ana e organit të Prokurorisë nuk janë kryer detyrat e lëna nga gjykata dhe sidomos kryerja e

ekspertimit teknik-grafik të shkrimit tek dokumenti i falsifikuar. Ankuesi R.L më datën 27.10.2009 i ka paraqitur prokurorit kërkesë me shkrim për të cilat nuk i është kthyer përgjigje. Në këto kushte është komunikuar me prokurorin e çështjes i cili kishte thirrur shtetasin R.L. për t'i marrë të gjitha kërkesat që ai pretendonte si dhe për të realizuar detyrat e lëna nga gjykata.

\*Shtetasi A.C nga Tirana ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për arsye se, ka marrë në përgjegjësi penale djalin e saj XH.C, për veprën penale të “Mosparaqitjes në repart ose vëndin e shërbimit”, sipas nenit 36/1 të Kodit Penal Ushtrarak. Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasi XH.C., paraqitet me turbullime të personalitetit dhe për rrjedhojë sipas ankueses është i paaftë për të kryer shërbimin ushtarak. Kështu, më datën 06.04.2009 djali i ankueses shtetasi XH.C. ka qënë i shtruar në spitalin ushtarak dhe mandej nga ana e mjekëve i është dhënë pushim. Ndërsa organi i Prokurorisë Vlorë më datën 29.04.2009 ka filluar procedimin penal nr.45 për “Dezertim”, parashikuar nga neni 33/1 të Kodit Penal Ushtrarak. Ka qënë detyrimi i organit të Prokurorisë jo vetëm për kualifikim të drejtë të veprës penale në fillimin e saj, por dhe kryerjen e hetimeve të gjithanshme lidhur me gjendjen mendore e mandej për të kryer ekspertimin psihiatriko-ligjor të shtetasit XH.C, veprim të cilin nuk e ka realizuar, por e ka dërguar çështjen në gjyq më datën 23.10.2009.

\*Shtetësja L.D. nga Vlora ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se në procedimin penal që lidhet me vrasjen e djalit të saj A.D. nxënës shkolle, duke mos kryer hetime të gjithanshem, nuk ka vënë para përgjegjësisë ligjore bashkëpunatorin në krim dhe nuk ka nxjerrë motivet e kryerjes së krimit.

\*Ndërsa shtetasi F.B. nga Saranda, polic i një firme private, ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi për mosvënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve të identifikuar të “Shkatërrimit të pronës me zjarr”, djegjes së makinës që ai kishte në përdorim. Pas komunikimit me drejtuesin e Prokurorisë u sqarua se ishte filluar procedimi penal për veprën penale të parashikuar nga neni 151 e Kodit Penal dhe ankuesit iu bë e qartë detyrimi që ai kishte për të dhënë deklarime para Prokurorisë për rrethanat e ngjarjes dhe autorët e veprës penale, meqënëse ai kishte dijeni për to.

### **3. Për shkelje proceduriale në kryerjen e veprimeve hetimore**

Këto shkelje kanë konsistuar në ndalimin apo arrestimin e paligjshëm të personave, mosnjohim të akuzës në ngarkim të tyre, mbajtje tej afateve të hetimeve paraprake apo dhe ndjekjen penale në një kohë që për të njëjtën akuzë, ka patur proces gjyqësor nga autoritetet e drejtësisë të shteteve të tjera.

\*I tillë është rasti i ankesës së shtetasit E.GJ nga Vlora, ndaj të cilit është filluar procedimi penal nr.390 i vitit 2008 për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit të rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 të Kodit Penal. Ankuesi E.GJ. në asnjë rast nuk është thirrur nga ana e prokurorit për t’u pyetur si person nën hetim. Nga ana e organit të Prokurorisë shtetasit nën hetim E.Gj nuk i është njoftuar akuza dhe pa iu caktuar mbrojtës ligjor çështja është dërguar për gjykim. Në dosjen hetimore ndodhet një vendim i marrë nga prokurori i çështjes për “njoftimin e akuzës dhe marrje si të pandehur” të ankuesit E.Gj, i cili jo vetëm që nuk është nënshkruar prej tij, por dhe nuk është mbështetur në asnjë dispozitë procedurale siç është neni 34 i Kodit të Procedurës Penale. Për këto shkelje procedurale etj, shtetasi E.GJ ka paraqitur kallëzim penal ndaj prokurorit përkatës në organin e Prokurorisë dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier është filluar procedimi penal nr.310 për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar përkatësisht nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal. Veç sa sipër në procedimin penal nr.390 në ngarkim të tij, shtetasi E.GJ. ka kërkuar deklarin e moskompetencës për arsye se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë punon si gjyqtare bashkëshortja e tij, por organi i Prokurorisë e ka refuzuar atë kërkesë.

\*Në ankesën e tij shtetasi SH.S. nga Hasi është ankuar ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për arrestim të padrejtë për akuzat e “Vjedhjes së pasurisë me armë”, “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake” dhe “Vjedhje të pasurisë”, parashikuar nga nenet 140, 278/2 dhe 134/2 të Kodit Penal në procedimin penal nr.3674 të vitit 2008. Pas kryerjes së hetimeve më datën 30.07.2009, Prokuroria ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit Sh.S. i cili ka qëndruar padrejtësisht në burg 3 muaj, në Institucionin e Paraburgimit 302 Tiranë.

#### **4. Për akuzë të padrejtë apo rëndim të akuzavë në ngarkim, në momentin e marrjes në përgjegjësi penale.**

Rastet që ankuesit i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit për akuzë të padrejtë të ngritur nga organi i Prokurorisë, kanë qënë kryesisht ato kur të pandehurit kanë marrë pafajësi nga Gjykata, apo kur Gjykata ka kthyer aktet e çështjes organit të Prokurorisë dhe më pas kjo e fundit, ka vendosur pushimin e hetimit të çështjes penale.

\*Në ankesën e tij shtetasi G.M. nga Elbasani ngre shqetësimin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës kishte akuzuar djalin e tij E.M për veprat penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Largim nga vëndi i qëndrimit”, parashikuar përkatësisht nga nenet 79/dh, 22 dhe 323/1 të Kodit Penal. Pas verifikimit të ankesës së tij, rezultoi se ankesa ishte e drejtë dhe se organi i Prokurorisë pasi ka marrë zgjatje të afatit të hetimit, ka ndryshuar akuzën në “Vrasje me dashje” e mbetur në

tentativë, parashikuar nga neni 76 e 22 dhe 323/1 të Kodit Penal. E përmëdim këtë rast për faktin se organi i Prokurorisë pavarësisht kryerjes së hetimeve komplekse në këtë procedim penal, nuk duhet t'i zgjaste ato për më tepër se 7 muaj, çka bie ndesh me nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana tjetër duke kryer hetime të gjithanshme do të arrinte në një përfundim për kualifikim të drejtë të veprës penale.

\*Shtetasi S.XH nga Tirana ngre shqetësimin dhe ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për arsye se në mënyrë të gabuar ka ndryshuar kualifikimin e veprës penale që lidhet me vrasjen e djalit të tij A.XH, nga "Vrasje me dashje", parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal në "Vrasje e kryer në gjëndje të tronditjes së fortë psihike", e "Mbajtje pa lejë të armëve luftarake" parashikuar nga nenet 82 dhe 278/2 të Kodit Penal. Pas dërgimit të çështjes në gjyq Gjykata ka vendosur deklarimin fajtor dhe dënimin me 3 vjet e 8 muaj burgim të autorit të veprës penale shtetasin V.M.

\*Gjatë shqyrtimit të disa ankesave është konstatuar se, organi i Prokurorisë ka vepruar në mënyrë të nxituar dhe të pabazuar në verifikimin e ngjarjes me të gjithë elementët që përbëjnë veprën penale apo duke mosvlerësuar të dhënat e paraqitura me qëllim për fillimin e hetimit të procedimit penal. I tillë është rasti i ankesës së shtetasës V.P nga Tirana e cila ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se ka filluar padrejtësisht procedimin penal për vëllanë e saj I.P, për veprat penale të "Marrëdhënie seksuale me dhunë me kërcënim me përdorimin e amrës", "Heqjes së paligjshme të lirisë", "Dëmtime të tjera me dashje", "Kanosje me armë zjarri", "Shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie" dhe "Shkaktim i vetvrasjes mbetur në tentativë", parashikuar përkatësisht nga nenet 104, 109/b/1, 110, 84, 90 dhe 99 e 22 të Kodit Penal. Pas arrestimit në flagrancë të shtetasit I.P nga policia gjyqësore e Komisariatit të Policisë për këto vepra penale, mbi këtë bazë nga ana e Prokurorisë është kërkuar masë sigurimi "Arrest në burg". Aktualisht procedimi penal ndodhet në fazën e hetimit paraprak për veprat penale të "Kanosjes" dhe "Shkaktimit të vetvrasjes mbetur në tentativë", parashikuar nga nenet 84 e 99 me 22 të Kodit Penal.

Pas studimit të ankesave është konstatuar se ato janë drejtuar në Institucionin tonë menjëherë pas marrjes së vendimit nga Prokuroria. Kështu nga ana e jonë ankuesit janë sqaruar për ndjekjen e rrugës ligjore, për të kundërshtuar vendimin në gjykatë, e drejtë kjo e përcaktuar në nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale.

**5. Për mosnjofitim apo njofitim me vonesë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit apo përfundimit të çështjes penale, si p.sh ankesat e shtetasve SH.M. nga Kuçova; F.H dhe S.H nga Tirana; L.M nga Elbasani etj.**

\*-Veçojmë ankesën e shtetasit S.H. nga Tirana i cili ka paraqitur kallëzim penal për “dëmtim të pasurisë” para oficerit të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Nr.1 Tiranë, qysh më datën 25.07.2009. Megjithë interesimin e tij edhe pse kishin kaluar tre muaj nga rregjistrimi i kallëzimit penal, nuk kishte asnjë dijeni lidhur me mënyrën e zgjidhjes së tij. Vetëm pasi ankuesi S.H. ka paraqitur kërkesë tek drejtuesit e Prokurorisë, nga ana e tyre është sqaruar se vendimin e mosfillimit të procedimit penal duhet ta merrte tek sekretaria e atij organi. Nga verifikimi i kryer rezultoi se vendimi i mosfillimit të procedimit penal ishte marrë më datën 27.10.2009.

\*Rast tjetër analog është edhe ankesa e shtetasit B.H. nga Tirana, i cili më datën 06.09.2009 kishte paraqitur kallëzim penal për veprën penale të “Vjedhjes të pasurisë”, por edhe pse kishin kaluar dy muaj ai nuk kishte dijeni për mënyrën e zgjidhjes së tij. Nga verifikimi i kryer në zyrën e rregjistrimit penal u konstatua se kallëzimi i shtetasit B.H ishte rregjistruar me numurin 5024, datë 06.09.2009 ndërsa vendimi i mosfillimit të procedimit penal mbante datën 10.10.2009.

\*Shtetasi SH.M dhe familjarët e tij nga Kuçova kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me veprime të paligjshme kryer nga punonjësit e policisë së Komisarariatit Kuçovë. Pasi është studjuar materiali kallëzues Drejtoria e Hetimit i ka dërguar ato për kompetencë hetimi pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ndërsa Prokuroria e atij rrethi ka filluar procedimin penal Nr.161 të vitit 2009, për veprën penale të “Torturës” parashikuar nga neni 86 e Kodit Penal, ankuesi SH.M nuk ka marrë dijeni lidhur me mënyrën e përfundimit të hetimit të atij procedimi penal.

\*Në ankesën e saj shtetësja F.H nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila, jo vetëm nuk ka vlerësuar materialet e kallëzimit të saj penal të datës 03.11.2009 për të vënë para përgjegjësisë penale shtetasin P.G, lidhur me dëmtimet e shkatkuara, por dhe nuk e ka vënë në dijeni për ecurinë e heitmeve apo mënyrën e përfundimit të tyre. Nga verifikimet e kryera rezultoi se organi i Prokurorisë duke patur parasysh faktin që edhe shtetasi P.G. paraqiti kallëzim penal, ka përpiluar vendimet për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor duke pritur përgjigjen e akteve të ekspertimit nga Instituti i Mjeksisë Ligjore për të konkluduar për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

-Për vitin 2009 janë marrë në shqyrtim dhe disa ankesa të shtetasve të cilët i janë drejtuar me kërkesë-ankesa Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në rastet kur nga Prokuroritë në rrethe, është vendosur mosfillimi i procedimit penal apo pushimi i hetimit të çështjes, por nga ajo Zyrë nuk është kthyer përgjigje, ose përgjigja është dërguar me vonesë. Raste të tilla janë ankesat e shtetasve V.S nga Tirana, R.V nga Elbasani etj.

\*Kështu në ankesën e tij shtetasi V.S. nga Tirana është ankuar ndaj Prokurorisë së Përgjithshme, për arsye se nuk i ka kthyer përgjigje ankesës së tij datë 22.07.2008, në të cilën ai ka denoncuar disa persona banues në Turqi të cilët kanë përvetësuar në mënyrë të paligjshme pasurinë e babait të tij të vdekur, J.S.S. Nga verifikimi i kryer në Zyrën e Protokollit dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme rezultoi se shtetasi V.S. i është kthyer përgjigje, por me tre muaj vonesë dhe konkretisht më datën 22.10.2009 sipas shkresës nr.1024/4.

\*Në ankesën e saj shtetësja R.V nga Elbasani ankohej ndaj Prokurorisë së Përgjithshme e cila nuk i kishte kthyer përgjigje ankesës së saj për pushim të padrejtë të çështjes penale për “Shfrytëzim prostitucioni” në ngarkim të shtetasis A.Ç. nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në ankesën e saj shtetësja A.Ç. ngrinte shqetësimin edhe për faktin se personi i akuzuar e kishte kanosur dhe për këtë organi i prokurorisë nuk i kishte marrë kallëzimin. Nga verifikimi i kryer në Prokurorinë e Përgjithshme rezultoi se ankesës së shtetases R.V të muajit korrik të vitit 2009 i është kthyer përgjigje pas dy muajve.

Konstatohet se nga ana e Prokurorëve të Drejtorive në Prokurorinë e Përgjithshme të cilët marrin ankesat e shtetasve, nuk tregohet kujdes i duhur për verifikimin e tyre dhe kthimin e përgjigjes sa më parë.

## **6. Për mosvënie në lëvizje apo mosvlerësim të kallëzimit të shtetasve.**

\*Raste të tilla janë ato të shtetases M.B. nga Tirana e cila ka paraqitur në Prokurorinë e atij rrethi kallëzimin për “Shpërdorim detyrë” në ngarkim të punonjësve të Z.R.P.P Tiranë; shtetasis A.GJ. nga Maqellara e Dibrës për mosmarrje të kallëzimit penal për vjedhje të mjetit që kishte në pronësi; shtetasi N.L nga Shkodra për mosvlerësim të kallëzimit penal lidhur me një pjesë toke e cila ishte rregjistruar padrejtësisht me dokumente të falsifikuara nga shtetasi M.GJ. etj. Në raste të tjera ankuesit kanë ngritur shqetësimin për faktin se organi i Prokurorisë në mënyrë të padrejtë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, apo pushimin e çështjes. E tillë është ankesa e shtetasis A.L. nga Tirana, ku pas kallëzimit penal për dëmtim të pasurisë tek hoteli që ka në pronësi nga shtetasi T.F, prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se dëmi i shkaktuar duhet të jetë mbi 30.000 lek; Ankesa e shtetasis S.K nga Shkodra për pushim të hetimit të çështjes penale filluar mbi bazën e kallëzimit të tij, ndaj oficerit të policisë gjyqësore Z.M etj.

\*Në praktikën e punës të organit të Prokurorisë janë konstatuar raste kur ndaj personave të shoqëruar apo që janë marrë në përgjegjësi penale, është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e policisë, dhe ky organ edhe pse ka marrë dijeni nuk është filluar çështja penale kryesisht.



Është detyra e Prokurorit që në zbatim të neneve 24 e 30 të Kodit të Proçedurës Penale, mbi konstatimet për dëmtime të dukshme të personave të shoqëruar nga policia të fillojë proçedimin penal. Nga ana e prokurorit duhet të kryhen veprimet e para hetimore të domosdoshme si, të marrë kallëzimin duke e vlerësuar atë dhe menjëherë të përpilojë vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor. I tillë është rasti i filluar me iniciativën e Avokatit të Popullit për ushtrim dhune nga oficerët e policisë gjyqësore në Komisaratin e Policisë Dibër ndaj ndaj shtetasit të mitur E.Ll. Kështu, pas informacionit të dhënë nga media e shkruar të datës 07.04.2009 në artikullin “Hidhet nga kati i tretë i Komisaratis adoleshenti”, është urdhëruar kryerja e një hetimi administrative për të zbardhur rrethanat dhe motivet e ndodhjes së kësaj ngjarje. Grupi i ekspertëve të Zyrës së Avokatit të Popullit pas hetimit të kryer ka arritur në përfundimin se thirrja në polici e të miturit E.Ll. dhe bashkëmoshatarëve të tij K.Sh dhe B.M si persona të shoqëruar, të dyshuar për vjedhje të disa materialeve tek një lokal në qytetin e Peshkopisë ishte e paligjshme dhe binte ndesh me nenin 27 Pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë si dhe nenet 111/6, 100, 101 dhe 106 të Ligjit Nr. 9749 datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Pyetja e të miturve nga oficerët e policisë gjyqësore të Komisaratis të Policisë jo vetëm që është bërë pa praninë e psikologut apo pjestarve të familjes, por edhe në orët e vona të natës. Nga ana tjetër prej shefit të parandalimit të krimeve dhe policimit në komunitet, shtetasit P.Zh. është përdorur dhunë fizike dhe psikologjike pasi shtetasi i mitur K.Sh. është qëlluar me pëllëmbë në fytyrë, ndërsa shtetasi E.Ll. është qëlluar me një send të fortë, shkop në shputat e të dy këmbëve pasi ishin hequr atletet. Në këto kushte Avokati i Popullit ka rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër fillimin e hetimit për veprën penale të “Torturës” në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore P.Zh. Hetimi i kësaj çështje është zvarritur tej mase.

\*Në ankesën e tij shtetasi A.K. nga Tirana sqaronte se më datën 14.11.2009 është shoqëruar nga dy persona që i janë prezantuar si inspektorë policie pa i treguar dokumentin e identitetit dhe mandej pasi e kanë sjellë në Komisaratin e Policisë Nr. 4 Tiranë, punonjësi i policisë E.D. e ka qëlluar me grushte në kokë e fytyrë duke i shkaktuar dhimbje koke dhe një ekimozë në kapakun e syrit të majtë dhe pas asnjë shkak pasi i ka marrë sendet personale dy aparate celulare, e ka futur në birucë. Avokati i Popullit ka ndërmarrë një hetim administrativ të pavarur duke përpiluar dhe vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor për dëmtimet e shkaktuara shtetasit A.K. dhe në përfundim duke gjeut se ankesa e tij ishte e drejtë, i ka rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimin e heitmit, për “Kryerje të veprimeve arbitrare” ndaj punonjësit të policisë E.D.

## **7. Për bllokime apo sekuestrime të sendeve prove materiale, për mosdhënie të tyre gjatë fazës së hetimit apo për dhënie të tyre me vonesa**

\*Vihet re se në disa Prokurori të Rretheve Gjyqësore, në praktikën e hetimit të çështjeve penale kur vendoset sekuestrimi i mjeteve në aksidentet automobilistike apo sendeve prova materiale të tjera, ka një tendencë që ato nuk u kthehen personave që ju takon gjatë fazës së hetimit, ose në raste të tjera ato kthehen me vonesë, ndonëse janë kryer veprimet e nevojshme si ekspertime autoteknike, akte ekspertimi për vlerësime etj.

Kjo kërkesë përcaktohet në mënyrë të qartë në Pikën 2 të nenit 190 të Kodit të Proçedurës Penale, **“Disponimi i provës materiale”** ku thuhet shprehimisht se: “Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të proçedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes”.

\*E tillë është ankesa e shtetasit Sh.S nga Komuna Gjinaj e Hasit i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për arsye se, nuk kishte kryer veprime të shpejta me qëllim marrjen e mjetit me targa greke të bllokuar si send provë materiale pas arrestimit të tij. Sipas ankuesit, mjeti ishte në pronësi të tij dhe ai e përdorte për punë. Në këto rrethana është komunikuar me prokurorin e çështjes i cili ka nxjerrë urdhërin për kthimin e sendit të sekuestruar. Ky veprim është realizuar pas ndërhyrjes sonë dhe daljes së ankuesit pas tre muajve nga paraburgimi, sepse çështja në ngarkim të tij u pushua.

\*Në ankesën e tij shtetasi I.I. nga Durrësi përfaqësues i të akuzuarve K.A. dhe F.M. ngre shqetësimin se nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk u janë kthyer mjetet “Audi Q-7” me targë VEJ-493 dhe “Bens Mercedes” i tipit ML270 me targë DR 8342-E. Nga verifikimi i kryer rezultoi se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka filluar proçedimin penal nr. 282 të vitit 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 302/1 i Kodit Penal dhe proçedimin penal nr. 90 për veprën penale të parashikuar nga neni 245 të Kodit Penal. Të akuzuarit kanë kundërshtuar në gjykatë vendimet e sekuestrimit të mjeteve dhe pas vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka pranuar kërkesën e tyre, Prokuroria ka vonuar nxjerrjen e urdhërit për kthimin e sendeve të sekuestruara. Nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit është insistuar kthimi i mjeteve të sekuestruara duke respektuar kërkesat e ligjit dhe përfundimisht ato janë kthyer, ndonëse me 3 muaj vonesë.

\*Në kërkesën e tij shtetasi K. K nga Tirana, kërkon ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim kthimin e dëshmisë së aftësisë së drejtimit të mjetit, pasi organi i Prokurorisë ia ka bllokuar atë, pas rregjistrimit të veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, datë 14.4.2009. Më datën 19.05.2009 është vendosur

mosfillimi i procedimit penal dhe pas ankesës së shtetasit K.K. në Institucionin e Avokatit të Popullit, më datën 28.05.2009 atij i është kthyer dokumenti, dëshmia e aftësisë së drejtimit të mjetit. Rast tjetër është ai i shtetasit S.X. nga Fieri, kur Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier pas arrestimit të tij ka sekuestruar dhe mjetin “Alfaromeo” që ankuesi kishte në pronësi. Pas verifikimit me drejtuesin e atij organi, rezultoi se më datën 21.07.2009 është urdhëruar bashkimi i sendit provë materiale me çështjen. Organi i Prokurorisë ka çmuar që mjeti të mos dorëzohet gjatë hetimeve paraprake dhe bazuar në nenin 190 të Kodit të Procedurës Penale e ka lënë atë në çmuarjen e gjykatës.

### **8. Mosmarrje të masave për kryerjen e ekspertimeve të ndryshme si mjeko-ligjor, neuropsikiatrik apo dhe riekspertimeve autoteknike.**

-Në ankesën e saj shtetësja E.D. nga Lezha është ankuar ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se nuk ka kryer ekspertimin psihiatriko-ligjor të bashkëshortit të saj E.D., duke e akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave” në bazë të nenit 186/1 të Kodit Penal. Mandej edhe pse ndaj tij nuk ka kërkuar masë sigurimi pasi ka përfunduar hetimet e ka dërguar çështjen në gjyq. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka deklaruar fajtor bashkëshortin e saj E.D. dhe ka vendosur pezullimin e vendimit me burgim me 6 muaj duke e vënë në provë për një periudhë kohore prej 18 muajsh.

\*Shtetasi A.P. nga Mborja e Korçës ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë për arsye se, në ngjarjen e ndodhur më datën 25.03.2009 ku është qëlluar me thikë nga shtetasi B.T. nga eksperti mjeko-ligjor është arritur në përfundim të gabuar duke e kategorizuar dëmtimin e tij të lehtë, në një kohë që ai ndodhej në spital për një kohë të gjatë dhe i dëmtuar rëndë. Ankuesi u sqarua lidhur me faktin që duhet të paraqeste me shkrim para Prokurorisë kërkesën e tij për kryerjen e një ekspertimi tjetër mjeko-ligjor me grup ekspertësh.

\*Rast i ngjashëm është edhe ankesa e shtetasit M.D. nga Tirana i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, për arsye se nuk ka mbajtur parasysh kërkesën e tij për kryerjen e një ekspertimi tjetër mjeko-ligjor për dëmtimet e shkaktuara motrës së tij F.B. ngjarje e ndodhur më datën 07.10.2008.

Konstatohet se, nga ana e Prokurorive në disa raste nuk tregohet kujdesi dhe interesimi i nevojshëm për marrjen e përgjigjeve të akteve të ekspertimeve të ndryshme, si mjeko-ligjore, kimike për lëndët narkotike, kriminalistike etj, duke qëndruar në pritmëri në një kohë që aktet janë përfunduar, por për arsye burokratike nuk u janë dorëzuar atyre. Shpesh, nga ana e Prokurorëve nuk merren pretendimet e të dëmtuarve nga vepra penale apo familjarëve të tyre, të paraqitura në formën e kërkesave me

shkrim, lidhur me konkluzionet e nxjerra nga ekspertët e fushave të ndryshme, apo kërkesa për rikryerje të ekspertimit me grup ekspertësh.

-Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe ndjekur me përparësi dhe rastet e ankesave të shtetasve që kanë pësuar dëmtime fizike apo të shëndetit mendor nga veprime ose mosveprime të punonjësve të policisë, apo mjekët kurues për kohën që ata kanë qënë të arrestuar. Në këto raste jo vetëm janë administruar dokumentat shkresore siç janë kartelat mjekësore etj, por dhe është përpiluar vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, i cili është dërguar Institutit të Mjekësisë Ligjore. Tek ekspertët e këtij Instituti kemi gjetur predispozicionin e nevojshëm për realizimin e aktit mjeko-ligjor dhe sjelljen e tij në Institucionin tonë brenda afateve të kërkuara. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit A.K nga Tirana etj. Në ankesën e tij shtetasi P.L. nga Pogradeci është ankuar për ushtrim dhune dhe kontroll banese të paligjshme nga punonjësit e policisë së Komisarariatit të Pogradecit. Nga verifikimet e kryera rezultoi se, pas kallëzimit penal të bashkëshortes së ankuesit shtetases B.L. është filluar procedimi penal ndaj tij për veprat penale të “Kundërshtim të punonjësve të policisë së rendit publik” dhe “Kanosje”. Pavarësisht se në përgjigjen e Komisarariatit të Policisë është sqaruar se ndaj ankuesit nuk është ushtruar dhunë, nga ana jonë ai është njohur me të drejtën e tij për të paraqitur kallëzim penal para organit të Prokurorisë.

\*Ndërsa në ankesën e tij në formën e “kallëzimit penal” shtetasi G.SH. është ankuar ndaj punonjësve të policisë së grupit të gatëshëm në Komisariatin Nr. 3 Tiranë, të cilët më datën 23.11.2009 kanë ushtruar dhunë fizike. Nga ana e jonë ankuesi është sqaruar që kallëzimin penal t’ja dërgojë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila siç rezultoi nga verifikimi i kryer e ka rregjistruar atë.

Vlen të theksohet fakti se, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, për rastet e ushtrimit të dhunës nga punonjësit e policisë së shtetit kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të dëmtuarve, duhet ta bëjnë konform Udhëzimit Nr. 22 datë 23.01.2003 të Shërbimit Qëndror të Ekspertimit mjeko-ligjor, dhe konkretisht ekspertimi bëhet nga mjeku-ligjor dhe një ekspert mjeko-ligjor i Institutit të Mjekësisë Ligjore në Tiranë.

Gjithashtu, organi i Prokurorisë në këto raste duhet të bashkëpunojë me ekspertin mjeko-ligjor në rrethet përkatëse me qëllim realizimin korrekt dhe objektiv, jo vetëm për ekzaminimin e të dëmtuarit, pasqyrimin e të dhenave në aktet shkresore, por dhe në dhënien e konkluzioneve të sakta për llojin e dëmtimeve të shkaktuara.

## **9. Ankesa për ngjarje të ndodhura para vitit 2000.**

\*Gjatë vitit 2009 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur disa ankesa shtetas nga rrethe të ndryshme të vëndit për moszbulimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të vrasjeve

të fëmijëve apo të afërmëve të tyre, ngjarje të ndodhura kryesisht gjatë viteve 1990-1999. Të tilla janë ankesat e shtetases M.B. nga Vlora e cila ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Vlorë për moszbulimin e autorit të vrasjes së djalit të saj A.B. ngjarje e ndodhur më datën 12.10.1998. Edhe pse nga ana e Prokurorisë janë rifilluar dy herë hetimet e çështjes së pezulluar, përsëri nuk është bërë e mundur gjetja dhe administrimi i provave për zbulimin e autorit të vrasjes së djalit të saj. Rast tjetër është ankesa e shtetases A.D. nga Shkodra e cila ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për vrasjen e djalit të saj K.K.D. në Balldre të Lezhës; Ankesa e shtetases F.SH. dhe familjarëve të saj nga Këlcyra e Përmetit për vrasjen e shtetasit H.H, ngjarje e ndodhur më datën 14 dhjetor të vitit 1999 etj.

\*Për vitin 2009 janë marrë në shqyrtim dhe një numër ankesash të shtetasve për vepra penale, sidomos për vrasje të ndodhura pas vitit 2000, por që nga ana e Prokurorisë është vendosur pezullimi i hetimit për moszbulim të autorit. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit H.S. nga Dibra i cili ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi për moszbulimin e autorit të vrasjes së motrës së tij Z.S; Ankesa e shtetasit K.V. nga Tirana i cili ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi për vrasjen e djalit të tij DH.V, ngjarje e ndodhur në një nga lokalet në afërsi të tregut tek posta qëndrore date 29.12.2006; Ankesa e shtetasit B.SH. nga Korça i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, për moszbulimin e autorëve të vjedhjes së shumës prej 3 milion lek në banesën e tij, ngjarje e ndodhur në datën 02.05.2009 etj.

Konstatohet se për këto çështje, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe që jo vetëm janë me rrezikshmëri të madhe shoqërore, por dhe që kanë tronditur komunitetin e më gjerë, ndonëse janë kryer veprimet e para hetimore të domosdoshme, nuk është predispozicioni i duhur për kryerjen e veprimeve të gjithanshme për zbulimin e autorit të veprës penale, si dhe mungon bashkëpunimi mes prokurorisë dhe policisë kriminale. Për rrjedhojë, shpesh hetimet pezullohen dhe materialet e çështjes i dërgohen policisë kriminale. Atje shpesh nuk ka asnjë impenjim për bashkëpunim për ndjekjen në vazhdimësi të çështjes dhe analizën e tyre të herëpashershme. Në këto kushte, ato mbeten pa veprime nga policia kriminale duke mbetur edhe kriminelët pa u ndëshkuar.

Nga ana jonë për një pjesë të mirë të këtyre rasteve është bërë verifikimi në vend, duke u marrë kontakt si me drejtues të Prokurorisë, ashtu dhe me ata të policisë kriminale. Në takimet e kryera kemi orientuar dhe insistuar në kryerjen e shpejtë të veprimeve dhe ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve të pezulluara.

- Duke patur parasysh faktin se, Policia Kriminale në bashkëpunim me Prokurorinë kanë rifilluar hetimin për disa ngjarje të rënda kriminale të ndodhura në vitin 1997 si ajo e “Qafë Gjashtës” Sarandë, “Cërrikut

etj”, ku janë vrarë efektiva të policisë, mbi shqetësimin e paraqitur nga familjarë dhe të afërm të viktimave të vrarë në atë periudhë, nga ana jonë do t’i paraqesim në vazhdimësi Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme, rekomandimet tona për ecurinë e mëtejshme të dosjeve të pezulluara me qëllim rifillimin e hetimeve.

### **10. Kërkesa për ndihmë juridike**

-Gjatë shqyrtimit të ankesave apo kërkesave të shtetasve për vitin 2009 konstatohen raste kur prej tyre kërkohet konsulencë juridike për mënyrën e veprimit të mëtejshëm për problemin që ata i shqetëson. Këto kërkesa janë paraqitur pranë Institucionit tonë, apo janë marrë gjatë inspektimeve të kryera në Institucione Paraburgimi apo Institucione të Ekezkutimit të Vendimeve Penale.

Në mënyrë të grupuar ankesë- kërkesat e shtetasve për konsulencë juridike paraqiten si më poshtë:

\*Të tilla janë rastet e kërkesave të shtetasit I.Q. nga Barbullinja e Lushnjës i cili kërkon ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për shkatërrim prone nga persona komshij me të. Kërkuesi u njoh me të drejtën e bërjes së kallzimit penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnje, e drejtë kjo që parashikohet në nenin 283 të Kodit të Proçedurës Penale. Gjithashtu kërkuesit iu dërguan dhe fotokopje të nenevetë Kodit që përcaktojnë rrugët dhe mënyrën e paraqitjes së kallzimit penal.

\*Në ankesën e saj shtetasi XH.J. nga Laçi i Kurbinit ngre shqetësimin se është rrahur dhe fyer nga shtetësja V.XH. Lidhur me dëmtimet e shkaktuara ai ishte vizituar tek mjeku-ligjor dhe kishte marrë aktin e ekspertimit me dëmtimet që hyjnë në kategorinë e “Rrahjes”. Ankuesja u sqarua nga ana jonë në mënyrë të hollësishme për rrugën ligjore që duhet të ndiqte si **“I dëmtuar akuzues”**, çka do të thotë se, ajo duhej të paraqiste kërkesë në gjykatë. Shtetases ju bë e qartë dhe mënyra e përpilimit të kërkesës sipas nenit 60 të Kodit të Proçedurës Penale e cila duhej të depozitohej më pas në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

\*Në ankesën e tij shtetasi Q.L. nga Tirana ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për mënyrën e zgjidhjes së shqetësimit të tij për babanë e tij me moshë 80 vjeç, i dënuar për krimin e vrasjes së bashkëshortes së tij. Ankuesi Q.L. jo vetëm u njoh në mënyrë të hollësishme me përmbajtjen e Ligjit “Për faljen” por dhe iu dërgua një kopje e formularit përgatitur për këtë qëllim duke e njohur me faktin se kush ka të drejtë të bëjë propozimin për falje, dokumentat e nevojshme që shoqërojnë propozimin dhe se kërkesa duhej t’i drejtohej Presidentit të Republikës.

\*Shtetasi F.A. nga Hotolishti i Librazhdit ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila nuk ka marrë masat e nevojshme me

qëllim nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit për lirimin e tij nga I.E.V.P.Peqin ku ishte duke vuajtur dënimin. Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasi F.A. ka qëndruar padrejtësisht në burg për një periudhë kohe prej 5 ditësh dhe arsyeja ka qënë se ato ditë ishin ditë pushimi. Ankuesi u sqarua nga ana e jonë për të drejtën e tij ligjore për të paraqitur në gjykatë kërkesë padi për shpërblimin e dëmit e kompesim për burgim të padrejtë.

\*Shtetasi S.V. nga Durrësi është ankuar ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se nuk ka zbatuar vendimin e Gjykatës për dërgimin e djalit të tij M.V. i dënuar me masë mjekësore “mjekim i detyruar” në Spitalin neuropsikiatrik të Elbasanit. Ankuesi u sqarua jo vetëm për faktin se spitali neuropsikiatrik i Elbasanit nuk është Institucion Psikiatrik për personat e dënuar nga gjykata si rasti i djalit të tij me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Aktualisht djali i ankuesit si dhe persona të tjerë të dënuar me masë mjekësore mjekim i detyruar ndodhen në Spitalin e Burgut, i cili është në sistemin e burgjeve. Ankuesi u sqarua për përpjekjet e Institucionit të Avokatit të Popullit për sistemin e këtyre personave në një Institucion Psikiatrik jashtë sistemit të burgjeve dhe përgatitjen e mjediseve për vendosjen e kësaj kategorie personash në I.E.V.P.Krujë. Në të njëjtën mënyrë është sqaruar dhe shtetasi T.K. nga Berati i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier për transferimin e djalit të tij A.K. dënuar me masë mjekësore “mjekim të detyruar”, nga spitali psikiatrik i Vlorës në Spitalin e Burgut Tiranë.

\*Ka dhe një grup ankesash ku shtetas të ndryshëm kërkojnë konsulencë juridike për rastet kur ata vetë apo pjestarë të familjeve të tyre janë akuzuar apo dënuar nga autoritetet e drejtësisë së shteteve të tilla si Italia, Greqia apo Maqedonia. Kështu, në ankesën e tij shtetasi A.ZH. nga Kalimashi i Kukësit kërkonte ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit, për faktin se ish pronari grek S.X. ku ai kishte punuar si emigrant në mënyrë të padrejtë kishte bërë padi penale pranë autoriteteve të drejtësisë greke. Në këtë rast shtetasi A.ZH. është sqaruar për faktin që sipas nenit 2 të Ligjit organik të Avokatit të Popullit, Avokati Popullit mbron të drejtat e shtetasve për veprime të parregullta të kryer nga administrata publike në Shqipëri. Për rrjedhojë ai duhet të sigurojë avokat mbrojtës privat i cili ndjek procedurat ligjore pranë autoriteteve të drejtësisë greke.

-Në këto raste shtetasit janë sqaruar nga ne sipas rastit, për të drejtën e parashikuar në nenin 283 të Kodit të Procedurës Penale për bërjen e kallëzimit penal tek oficeri i policisë gjyqësore apo prokurori, plotësimin e materialeve të kallëzimit sipas kërkesave të parashikuara në ligj, paraqitjen në prokurori të dokumenteve origjinale, të drejtën për rishikimin e vendimit penal që ka marrë formë të prerë dhe dërgimin e saj pranë Gjykatës së Lartë duke respektuar kërkesat e neneve 449-453 të

Kodit të Proçedurës Penale, duke dërguar dhe fotokopje të neneve respektive që bëjnë fjalë për këtë institut, dërgimin e formularit me dokumentet e nevojshme për faljen që bën Presidenti i Republikës etj, për dokumentet dhe proçedurat që duhet të ndjekin për rastet kur ankesa i drejtohet Gjykatës së Strasburgut etj.

### **11. Ankesa për kërkesat e prokurorëve për masat e sigurimit apo të dënimit.**

\*Në ankesën e tij shtetasi K.T. nga Ura Vajgurore Berat, ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi se, në proçedimin penal për veprën penale të “Kryerjes së funksionit pas dhënies fund të tij”, parashikuar nga neni 249 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit G.A. ish drejtor i Sh.a. në Ujësjellës-kanalizime, nuk ka kërkuar masë sigurimi.

-Ka edhe ankesa nga shtetasit për masa të ulta dënimi për autorët e veprave penale ku ata, ose pjestarë të familjes janë të dëmtuar, si p.sh. ankesa e shtetasit N.P.K nga Rrësheni i Mirditës i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për arsye se në hetimin e çështjes penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rugor” me pasojë vdekjen e bashkëshortes së tij, me autor shtetasin N.M, ngjarje e ndodhur më datën 02.01.2008 ka ndryshuar kualifikimin e veprës duke e akuzuar drejtuesin e mjetit për “Drejtim të mjetit pa dëshmie aftësie” dhe “Largim nga vendi i aksidentit”. Pas përfundimit të hetimit dhe dërgimit të çështjes në gjyq autori i veprave penale është dënuar me 4 muaj burgim me kusht për 2 vjet.

\*Në raste të tjera ankesat e shtetasve janë drejtuar ndaj organit të Prokurorisë e cila sipas tyre, ka kërkuar masë sigurimi “arrest në burg” pa mbajtur parasysh rrethana të tilla që lidhen me moshën, gjëndjen sociale-ekonomike e për rrjedhojë duhet të kërkonte masë sigurimi më të butë. I tillë është rasti i shtetasit N.D. nga Tirana kambist, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kërkesën për masë sigurimi “arrest në burg” në proçedimin penal nr.912 të vitit 2009 akuzuar për veprën penale të “Ushtrimit të palicencuar të veprimtarisë financiare” parashikuar nga neni 90 i Ligjit nr.9662 datë 19.12.2006 “Për Bankën e Shqipërisë”. Nga verifikimi i kryer në organin e Prokurorisë rezultoi se pas rivlerësimit të masës së sigurimit, ajo është zëvendësuar me masë sigurimi “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

Të tilla janë rasti i ankesës së shtetasit F.M. nga Durrësi, ku prokurori ka kërkuar masë sigurimi “arrest në burg” ndaj djalit të tij A.M. nxënës në vitin e dytë të shkollës së mesme, me moshë 16 vjeç, për veprën penale të “vjedhjes me armë”; Ankesa e shtetasit Xh.F ndaj Prokurorisë Sarandë për kërkesë për masë sigurimi “arrest në burg” ndaj djalit A.F me moshë 15 vjeç, akuzuar për veprën penale të “vjedhjes së pasurisë” kryer në bashkëpunim.



\*Ka edhe ankesa nga shtetasit për caktim mase sigurimi “arrest në burg” ndaj personave të tyre të afërm, por që vuajnë nga sëmundje mendore. Të tilla janë ankesa e shtetasës S.F. nga Durrësi ku Prokuroria e atij rrethi ka kërkuar masë sigurimi “arrest në burg” për veprën penale të “shkatërrimit të pasurisë me zjarr”, parashikuar nga neni 151 e Kodit Penal. Shtetasi B.H. nga Ballshi i cili ankohej ndaj Prokurorisë së rrethi gjyqësor Fier për kërkesë për masë sigurimi “arrest në burg” ndaj djalit të tij E.L. për veprën penale “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” në një kohë që ai ishte përdorues hashashi dhe invalid, etj.

\*Ka edhe ankesa të shtetasve drejtuar ndaj organit të Prokurorisë e cila sipas tyre ka kërkuar masë të ulët dënimi me burgim ndaj autorëve të veprave penale ndaj pjestarëve të familjeve të tyre si p.sh. ankesa e shtetasës V.P.M nga Zejmeni i Lezhës e cila ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi për kërkesë për deklarimin fajtor dhe dënimin me 20 vjet burgim ndaj autorit të vrasjes së vëllait të saj shtetasit A.M; Ankesa e shtetasit S.XH nga Tiranë, për kërkesë për masë dënimi të ulët me burgim ndaj autorit të vrasjes së djalit të tij A.XH; Ankesa e shtetasit D.Ç nga Kavaja ndaj kërkesës së prokurorit për deklarimin fajtor dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, masë e cila sipas tij është e lartë etj.

-Nga ana jonë ankuesit janë sqaruar për mosndërhyrjen e Avokatit të Popullit në pavarësinë e organeve të drejtësisë, kërkesë kjo e përcaktuar në nenin 145 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të drejtën që kanë për t’u ankimuar kundër vendimit të gjykatës duke iu drejtuar instancave përkatëse gjyqësore sipas procedurave të parashikuara në ligj. Pavarësisht nga sa më sipër, shqetësimi i tyre mbetet një problem që mendojmë se duhet rregulluar për të futur të drejtën e ankimit të viktimës ndaj vendimeve gjyqësore. Pra, të përmirësohet Kodi i Procedurës Penale në drejtim të dhënies së të drejtës që avokati i viktimës të ketë të drejtë të ankohet kundër vendimit të pafajsisë, apo masës së dënimit.

## **12. Ankesa për hetimet në çështjet e aksidenteve automobilistike**

-Për periudhën që analizohet ka patur dhe raste kur, shtetas të ndryshëm ankohen për “mbyllje” të çështjeve për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasoja të rënda për jetën apo shëndetin e shtetasve. Të tilla janë ankesat e shtetasve R.A. nga Bërzhitë e Tiranës, shtetësja Z.K. nga Shijaku i Durrësit dhe shtetasi F.B. nga Elbasani.

\*Kështu shtetasi R.A. nga Tirana, ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për kryerjen e hetimeve objektive në procedimin penal që bën fjalë për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”

me pasojë vdekjen e vëllait të tij A.A, ngjarje e ndodhur më datën 25.09.2009. Autori i veprës penale shtetasi E.L. i cili ka qënë drejtuesi i mjetit është lënë i lire, për faktin se në konkluzionet e aktit të ekspertimit autoteknik Nr.779 datë 26.09.2009 si shkak i ndodhjes së aksidentit është përcaktuar kapërcimi i rrugës pa kujdes nga ana e këmbësorit, viktimës A.A. Pas ankesës së paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit nga ana jonë është kërkuar Prokurorisë kryerja e një ekspertimi të ri autoteknik me grup ekspertësh, kërkesë e cila është marrë parasysh. Më datën 20.10.2009 nga ana e prokurorit të çështjes është përpiluar vendimi përkatës.

\*Shtetësja Z.K. nga Shijaku i Durrësit ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për arsye se kishte pushuar padrejtësisht procedimin penal për veprën penale të “Shkeljes së qarkullimit rrugor” me pasojë vdekjen e bashkëshortit të saj G.K, ngjarje e ndodhur më datën 17.07.2008. Ankueses iu sqarua rruga ligjore që duhet të ndiqte për të ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendimin e pushimit të marrë nga Prokuroria.

\*Shtetasi F.B. nga Shtërmeni i Elbasanit i cili është i aksidentuar nga vepra penale e “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, ngjarje e ndodhur qysh më datën 28.05.2007, për të cilën organi Prokurorisë më datën 08.06.2007 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ankuesi e ka ankimuar këtë vendim në gjykatë e cila ka pranuar kërkesën, duke lënë detyrat përkatëse organit të Prokurorisë e ndërmjet të tjerave kryerjen e ekspertimeve të reja autoteknike dhe mjeko-ligjore. Vendimi është ankimuar edhe nga personi i tretë që ka qënë drejtuesi i mjetit shtetasi O.T. dhe deri në momentin e verifikimit nga ana jonë vendimi i gjykatës nuk kishte marrë formë të prerë pasi gjykohej në Gjykatën e Apelit Durrës.

Nga studimi dhe analiza e bërë ankesave të paraqitura në Institucionin tonë arrijmë në përfundimin se, nga ana e Prokurorisë jo gjithmonë bëhet vlerësimi i duhur i këtyre çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe kërkojnë kryerje të shpejta të veprimeve të para hetimore të papërsëritshme, njohuri profesionale në fushën autoteknike dhe objektivitet. Njëanshmëria, dhënia e konkluzioneve të pasakta dhe të padrejta në aktet e ekspertimit mjeko-ligjor ose autoteknik, moskryerja e veprimeve të gjithanëshme, janë pasoja të vendimeve të pabazuara të ndërmarra nga policia gjyqësore e të miratuara nga Prokuroria. Nga ana tjetër, ato sjellin zvarritje në hetimin e çështjeve penale dhe pasoja të tjera që lidhen me probleme sociale, deri në acarimin e marrëdhënieve ndërmjet autorëve të veprës me familjarët e të dëmtuarëve apo viktimave të shaktuara nga vepra penale. Veç sa sipër, këto qëndrime ndikojnë negativisht në rritjen e numrit të aksidenteve në shkallë vëndi, i cili për vite me radhë është mjaft shqetësues.

### **13. Kërkesa për mbrojtje të dëshmitarëve**

- Për vitin 2009 shtetas të ndryshëm, të cilët kanë qënë dëshmitarë kryesorë në çështje të rëndësishme me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, kanë kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit pranë Prokurorisë së Përgjithshme me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e dëshmitarit. Të tilla janë rasti i përsëritur i ankesës së shtetasit SH.C, ku djali i tij A.C. ka qënë dëshmitar kryesor në procesin gjyqësor ndaj të quajturës “Banda e Lushnjes”. Sipas ankuesit edhe pse është ndryshuar vëndbanimi i tij dhe familjes, ai ka kërkuar largimin jashtë shtetit me qëllim sigurimin e jetës së tij dhe familjarëve; Shtetasi M.D. nga Berati person që ka patur dijeni për disa vrasje të kryera në rrethin e Beratit, të cilat i ka denoncuar dhe ka kërkuar ndërhyrjen e organeve kompetente me qëllim sigurimin e jetës së familjes mbasi kërcënohet nga persona që ende janë të lirë. Nga verifikimi i kryer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat rezultoi se ai ka rregjistruar kërkesën e tij, e cila përcaktohet në ligjin nr.9205, date 12.05.2004 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë” dhe pastaj e ka dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat me qëllim vlerësimin e situatës në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit. Nga ana e punonjësve të policisë është realizuar intervistimi i ankuesit M.D. lidhur me ngjarjet e ndodhura, por për atë moment nuk ka shprehur shqetësim që të përbëjnë rrezik apo kërcënim real për jetën e tij dhe të familjes.

**B.** Nga shqyrtimi i ankesave të ndryshme që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, Avokati i Popullit i ka paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm, apo drejtuesve të Prokurorive në rrethe 6 rekomandime, të cilat përgjithësisht janë mirëpritur dhe pranuar. Në mënyrë të grupuar rekomandimet tona drejtuar organit të Prokurorisë, paraqiten si më poshtë:

**1.** Rekomandimi drejtuar drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër e për dijeni Prokurores së Përgjithshme “Për fillimin e hetimit për veprat penale të Torturës” dhe “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 86 dhe 250 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit P.ZH, me detyrë shëf i Seksionit të Parandalimit të Krimeve dhe Policimit në Komunitet në Komisariatit të Policisë Dibër”. (Filluar me inisiativën e Avokatit të Popullit mbi bazën e informacionit të dhënë nga media e shkruar). Rekomandimi është pranuar dhe nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër është filluar procedimi penal për veprën penale të parashikuar nga neni 250 e Kodit Penal. Në përfundim të hetimit, organi i Prokurorisë ka vendosur pushimin e çështjes penale.

**2.** Rekomandimi drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për fillimin e hetimit ndaj punonjësit të policisë së Komisariatit nr.4 Tiranë, shtetasit E.D, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve

arbitrare”, parashikuar nga neni 250 e Kodit Penal”. (Ankesa e shtetasit A.K. nga Tirana). Rekomandimi është në shqyrtim.

**3.** Rekomandim drejtuar Prokurores së Përgjithshme “Për shfuqizimin e vendimit të pushimit të proçedimit penal nr.427 të viti 2008 dhe rifillimin e hetimit të pushuar ndaj oficerit të policisë gjyqësore A.H”. (Filluar me inisiativën e Avokatit të Popullit për veprën penale të “Torturës” ). Rekomandimi është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nuk është pranuar.

**4.** Rekomandimi drejtuar Prokurores së Përgjithshme dhe Kryetares së Gjykatës së Lartë “Për marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve penale ndaj personave që duhet të lirohen nga burgu, menjëherë pas shpalljes së vendimeve nga Gjykata e Lartë”. (Filluar me inisiativën e Avokatit të Popullit, mbi bazën e informacionit të dhënë nga media e shkruar). Rekomandimi është marrë në shqyrtim dhe është pranuar.

**5.** Rekomandimi drejtuar Prokurores së Përgjithshme dhe Kryetares së Gjykatës së Lartë “Për vlerësimin, trajimin dhe marrjen e masave të menjëhershme për arsyetimin dhe zbardhjen pa vonesë të vendimeve të gjykatës për pushimet e gjykimeve të çështjeve me persona të arrestuar , me qëllim ekzekutimin e tyre të menjëhershëm nga organi i Prokurorisë”. (Ankesa e shtetasit R.M. nga Shkodra për mbajtjen padrejtësisht për 7 ditë në burg, I.E.V.P.Shënkoll-Lezhë të nipit të tij I.M). Rekomandimi është shqyrtuar dhe është pranuar.

**6.** Rekomandimi drejtuar Prokurores së Përgjithshme dhe N/Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e hetimeve dhe gjykimeve objektive, të gjithanshme dhe profesionale për veprat penale të parashikuara nga nenet 297 dhe 298 të Kodit Penal, nëpërmjet zbatimit korrekt të Kushtetutës e ligjit penal nga Prokuroria dhe Gjykata”. (Filluar me inisiativën e Avokatit të Popullit, pas një inspektimi me grup ekspertësh të Zyrës në territorin që përfshihet në juridiksionin e Drejtorive të Policisë Kufitare në kufi me Greqinë, nga Devoilli në Sarandë). Rekomandimi është marrë në shqyrtim dhe nuk është kthyer përgjigje.

Vlen të theksohet fakti se për të gjitha rekomandimet e sipërpërmëndura drejtuar Prokurorive në rrethe të ndryshme gjyqësore të vëndit, nga ana jonë është vënë në dijeni Prokurori i Përgjithshëm, i cili pas shqyrtimit të tyre, jo në të gjitha rastet ka kthyer përgjigje brënda afatit ligjor në Institucionin e Avokatit të Popullit. Nga ana tjetër, në bazë të kompetencave të parashikuara në ligj, shpesh është urdhëruar dhe fillimi i hetimit.

Për vitin 2009, vlen për t’u theksuar fakti se nga ana e Prokurorive në rrethe, ka një vlerësim më të mirë dhe korrekt në rekomandimet e dërguara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Për rrjedhojë të gjitha rekomandimet tona janë marrë në shqyrtim dhe në përgjithësi janë

pranuar. Ka një mirëkuptim dhe bashkëpunim me drejtuesit e Prokurorive në Rrethet Gjyqësore në shkallë vëndi në dhënien e informacioneve, akteve të ndryshme dhe dosjeve penale për të cilat është vendosur pushimi apo pezullimi i hetimit. Këta prokurorë kanë parasysh ndryshimet e bëra me Ligjin Nr. 9398 datë 12.05.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin “Për Avokatin e Popullit”, ku janë qartësuar kompetencat tona edhe në marrëdhënie me Prokurorinë dhe sipas të cilave të gjitha kërkesat tona ndaj prokurorive kanë qënë dhe janë të bazuara në ligj. Thelbi është se ka predispozicion për bashkëpunim korrekt të Prokurorive me Institucionin e Avokatit të Popullit.

## 5. Ministria e Brendshme

Gjatë këtij viti ndaj Ministrisë Brendshme dhe organeve të pushtetit vendor kanë ardhur gjithsej 610 ankesa, kërkesa apo njoftime. Nga këto 173 kanë qënë ndaj institucionit të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, ndërsa 437 kanë qënë ndaj organeve të pushtetit vendor si Këshillave të Qarqeve, Prefekturave, Bashkive, Komunave dhe Zyrave të Gjëndjes Civile.

A. Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elementë të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korruptuar etj.

Në institucionin tonë për sektorin e Policisë gjatë vitit 2009 janë regjistruar gjithsej 173 ankesa, kërkesa, njoftime dhe raste inspektimi në organet e policisë. (Në këtë numër nuk përfshihet numri i ankesave të mbartura nga viti 2008). Kanë përfunduar 164 ankesa si vijon: 72 ose rreth 44 % janë zgjidhur në favor, 14 kanë qënë jashtë juridiksionit, 73 kanë qënë të padrejta, kurse 5 ankues kanë hequr dorë. Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2010, 9 ankesa.

Gjatë këtij viti për rastet që kemi vërtetuar shkelje të ligjit, janë bërë 2 rekomandime për fillimin e ndjekjes penale, nga të cilat 1 është pranuar dhe 1 është në shqyrtim. Gjithashtu janë bërë edhe 7 rekomandime për dhënien e masave disiplinore ndaj 19 punonjësve të Policisë, nga të cilat 5 janë pranuar, 1 është refuzuar dhe 1 është në shqyrtim. Mbi bazën e rekomandimeve tona janë dhënë masa disiplinore

ndaj 17 punonjësve të Policisë që kanë bërë shkelje të akteve ligjore ose nënligjore.

## **Ankesat e trajtuara ndahen sipas problemeve të mëposhtme:**

### **I. Ankesat për torturë dhe keqtrajtim të shtetasve**

Këto ankesa janë vlerësuar më tepër sepse kur ato kanë rezultuar të vërteta, kanë qënë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në institucionin tonë janë administruar 34 ankesa për torturë dhe keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit, të cilat janë përfunduar të gjitha. Pas përfundimit mënyra e zgjidhjes së tyre është: 8 ankesa janë vlerësuar të drejta, 16 të pa bazuara dhe 10 janë nxjerrë jashtë juridiksionit, sepse për të njëjtin problem ankuesit kishin bërë kallzim në organet e prokurorisë.

Theksojmë se këtë vit numri i ankesave për torturë dhe keqtrajtime është i njëjtë me numrin e ankesave të regjistruara në vitin e kaluar. Ky fakt është një tregues negativ i Policisë së Shtetit dhe për këtë arsye drejtuesit e saj duhet të reagojnë menjëherë për të ndryshuar këtë gjendje. Ata duhet të organizojnë më mirë punën edukuese dhe profesionale me efektivat e tyre, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni të papranueshëm për shtetin e së drejtës dhe shoqërinë demokratike që po ndërtojmë e konsolidojmë në vendin tonë.

Për rastet kur kemi vërtetuar pretendimet e ankuesve për torturë apo keqtrajtime nga punonjësit e Policisë kemi bërë rekomandime organeve përkatëse. Gjatë vitit 2009 kemi bërë 1 rekomandim organit të Prokurorisë në Dibër për fillimin e ndjekjes penale për veprën penale të “Torturës”, i cili është pranuar, por mbas disa muajsh “hetime” është pushuar. Ndërsa në një rast tjetër provuam ushtrimin e dhunës, por jo torturë, nga një punonjës policie ndaj një shtetasi, prandaj kemi bërë rekomandim organit të prokurorisë për fillimin e ndjekjes penale për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”. Ky rekomandim është bërë kohët e fundit dhe është në shqyrtim.

Si raste të ankesave për torturë dhe keqtrajtime të shtetasve të vërtetuara mund të përmëndim:

1. Rasti i ndjekur me iniciativë pas bërjes publike në media të ngjarjes së ndodhur në Komisariatit e Policisë Dibër, ku një adoleshent i quajtur E. Ll. u hodh nga kati i tretë i godinës gjatë kohës që ai po merrej në pyetje nga punonjësit e policisë.

Nga hetimi administrativ i kryer nga ekspertët tanë për të zbardhur rrethanat dhe motivet e ndodhjes së kësaj ngjarje, deklaramet e të dëmtuarit, të punonjësve të policisë, të dëshmitarëve dhe akti i ekspertimit mjeko-ligjor të të dëmtuarit, i bërë me kërkesën tonë nga Instituti i Mjekësisë -Ligjore Tiranë rezultoi se:

Shtetasi E. Ll. ishte i datëlindjes 22.03.1994, lindur e banues në qytetin e Peshkopisë, nxënës shkolle. Më datën 03.04.2009 rreth orës 20.00 shtetasi E. Ll. dhe bashkëmoshatarët e tij, K. Sh. dhe B. M. kanë qënë tek lokali “Shpella” në qytetin e Peshkopisë. Pronari i tij shtetasi Q. I. kishte pretendime se, ata ishin autorë të vjedhjes së atij lokali, ndodhur më datë 01.04.2009 ku ishin marrë disa sende si një video, një celular “Samsung” dhe disa DVD.

Shtetasi Q. I. ka njoftuar patrullën e përgjithshme të policisë, se shtetasit e lartpërmëndur janë autorë të vjedhjes së lokalit të tij. Patrulla e policisë ka bërë shoqërimin e tyre në Komisariatin e Policisë Dibër.

Shtetasit B. M., E. Ll. dhe K. Sh. janë dërguar në katin e tretë të Komisarariatit tek zyra e Shefit të Parandalimit të Krimeve dhe Policimit në Komunitet, Pavlin Zhivani, i cili i ka marrë në pyetje lidhur me autorësinë e vjedhjes së ndodhur më datën 01.04.2009 në lokalit “Shpella”.

Gjatë pyetjes shtetasi B. M. ka pranuar autorësinë e vjedhjes së sendeve të lokalit “Shpella” duke implikuar shtetasit E. Ll. dhe K. Sh. me pretendimin se vjedhja ishte kryer në bashkëpunim me ta.

Nga ana e Shefit të Parandalimit të Krimeve dhe Policimit në Komunitet, Pavlin Zhivani, i cili ka edhe atributet e oficerit të policisë gjyqësore, është insistuar tek shtetasit E. Ll. dhe K. Sh. që edhe ata të pranoin bashkëautorësinë e kësaj vjedhje. Ndaj tyre ishte përdorur dhunë fizike dhe psikologjike pasi shtetasi K. Sh. ishte qëlluar me pëllëmbë në pjesët e fytyrës, ndërsa shtetasi E. Ll. ishte qëlluar me një send të fortë shkop tip bejzbolli në shputat e të dy këmbëve pasi i ishin hequr atletet. Oficeri i policisë gjyqësore duke parë reagimin e dy të miturve E. Ll. dhe K. Sh. për mospranim të autorësisë së vjedhjes, ka përdorur presion psikologjik duke ju thënë se, pavarësisht se ata nuk e pranoin vjedhjen do të dënoheshin me burg nga 6 muaj deri në 5 vjet burgim. Ai ju lexonte nenin përkatës në Kodin Penal për masën që do të aplikohet ndaj tyre dhe ja u vendoste para fytyrës së tyre. Pavarësisht dhunës fizike dhe presionit psikologjik të ushtruar ndaj tyre, të miturit E. Ll. dhe K. Sh., e kishin sqaruar oficerin e policisë gjyqësore se ata nuk ishin autorë të kësaj ngjarje.

I ndodhur në këto kushte oficeri i policisë gjyqësore Pavlin Zhivani, rreth orës 01.30 të datës 04.04.2009 i ka lënë të lirë të tre personat, por duke ju thënë që do të paraqiteshin përsëri të nesërmen në ambjentet e Komisarariatit të Policisë.

Më datën 04.04.2009 rreth orës 20.00 janë shoqëruar në Komisarlatin e Policisë shtetasit E. Ll. me babanë A. Ll., K. Sh. dhe gjyshi i tij F. Sh. si dhe B. M. dhe babaj i tij F. M..

Përsëri personat e lartpërmëndur janë marrë në pyetje nga oficeri i policisë gjyqësore Pavlin Zhivani, i cili insistonte që shtetasit E. Ll. dhe K. Sh. të pranonin bashkëautorësinë e vjedhjes. Në disa momente ai ju ka kërkuar familjarëve të të miturve që të bisedonin më vehte dhe konkretisht shtetasi A. Ll. me djalin e tij E. Ll., ndërsa shtetasit F. Sh. me nipin e tij K. Sh. tek një sallon në katin e tretë të Komisarlatit të Policisë.

Megjithë insistimin e familjarëve, të miturit nuk e pranuan autorësinë e vjedhjes. Në momentin që shtetasi F. Sh. dhe K. Sh. ishin duke ju përgjigjur oficerit të policisë gjyqësore Pavlin Zhivani në zyrën e tij se nuk kishin lidhje me këtë ngjarje, i mituri E. Ll. në prani të babait të tij dhe të punonjësit të policisë Sinan Merdini ishte hedhur nga dritarja e katit të tretë të Komisarlatit të Policisë në pjesën e prapme të ndërtesës.

I dëmtuari E. Ll. është çuar menjëherë në spitalin civil të qytetit ku edhe ju dha ndihma e nevojshme mjekësore. Ndërsa më datën 06.04.2009 pacienti E. Ll. është dërguar në Spitalin Ushtarak Tiranë për ndërhyrje kirurgjikale të specializuar.

Nga ekspertët e Zyrës së Avokatit të Popullit u administruan në Komisarlatin e Policisë Dibër dokumenta shkresore si, libri i shoqërimit të shtetasve, libri i shërbimit të drejtimit operativ të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Dibër, informacioni i datës 03.04.2009 dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, komunikata e datës 04.04.2009, komunikata e datës 05.04.2009 dhe komunikata e datës 06.04.2009, si dhe në spitalin civil kartela klinike Nr. 15 datë 06.04.2009 për pacientin E. Ll..

Po ashtu, u administruan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër materialet kallëzuese të dërguara nga Komisarlati i Policisë Dibër për referimin e vepës penale.

Nga veprimet e kryera dhe studimi i dokumentave shkresore u konstatua se:

1. Shtetasit e larpërmëndur, megjithëse ishin shoqëruar dy herë në polici, nuk ishin regjistruar në librin e personave të shoqëruar në këtë komisarlat. Në datën 04.02.2009 në orën 23.30 në librin e shërbimit të drejtimit operativ të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Dibër ishte evidentuar ngjarja e hedhjes nga dritarja e shtetasit E. Ll..

2. Shoqërimi në polici i shtetasve të mitur E. Ll., B. M. dhe K. Sh. ishte bërë në kundërshtim e nenin 27 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet shprehimisht se: “Liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse në rastet e mëposhtme, gërma “c” “ kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj”.



3. Shoqërimi në polici i personave të lartpërmendur vinte në kundërshtim edhe me ligjin nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit, respektivisht me nenin 100, sipas të cilit punonjësi i policisë duhet të bëjë njoftim për paraqitje (me fletnjoftim apo verbalisht) për të marrë informacion për të identifikuar shkelsit e mundshëm të ligjit. Si dhe me nenet 11/6, 101 dhe 106 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, në të cilat parashikohet shoqërimi në polici për shkaqe administrative i personave dhe rastet e shoqërimit. Mirëpo rasti konkret nuk parashikohet në rastet e shoqërimit të personave në polici.

4. Nga punonjësit e policisë në momentin e shoqërimit dhe marrjes në pyetje në polici të shtetasve të mitur nuk ishte vënë në dijeni psikologu ose pjestarë të familjes së tyre. Po ashtu, pyetja e të miturve ishte bërë në orët e vona të natës duke u mbajtur në zyrat e Komisarariatit të Policisë nga ora 20.30 deri pas mesnatës së ditës tjetër. Këto mosveprime vinin në kundërshtim me kërkesat e K.Pr.Penale të parashikuara në nenet 35, 37, 48 dhe 296/1.

5. Kallëzimi i shtetasit Q. I. ishte marrë më vonë se shoqërimi dhe pyetja e të miturve E. Ll., B. M. dhe K. Sh., të cilët ishin marrë dhe pyetur para marrjes së kallëzimit.

6. Më datën 04.04.2009 shtetasit B. M. dhe K. Sh. janë pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Marrja në pyetje e shtetasit K. Sh. është kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Pavlin Zhivani pa praninë e avokatit mbrojtës. Ndërsa shtetasi i mitur B. M. është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore Admir Trupja në praninë e avokatit jo të zgjedhur prej tij, por të caktuar kryesisht nga policia gjyqësore. Ky veprim bie ndesh me nenin 296/1 të Kodit të Proçedurës Penale.

7. U provua plotësisht se ndaj të miturve E. Ll. dhe K. Sh. ishte përdorur dhunë fizike dhe psikologjike nga oficeri i policisë gjyqësore Pavlin Zhivani.

8. Gjithashtu nga hetimi u provua se punonjësi i policisë Pavlin Zhivani, i cili ka dhe atributet e oficerit të policisë gjyqësore, nuk kishte zbatuar me rigorozitet kërkesat e parashikuara në Kodin e Proçedurës Penale, që bën fjalë për veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, të parashikuara nga nenet 293 deri në 303 të tij. Në këto nene përcaktohet qartë detyrimi i oficerit të policisë gjyqësore që për çdo veprim të kryer duhet të njoftojë prokurorin.

Mirëpo në kundërshtim të plotë dhe të hapur me detyrimet e parashikuara në këto dispozita, nga oficeri i policisë gjyqësore Pavlin Zhivani jo vetëm që nuk ishte vënë në dijeni prokurori për marrjen e deklarimeve të personave të mësipërm në cilësinë e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetimet, por janë kryer dhe veprime të kundërligjshme duke ushtruar dhunë fizike e psikologjike. Dhuna fizike ka qënë më e

ashpër tek i mituri E. Ll. në trupin e të cilit, sidomos tek shputat e këmbëve ishte goditur me mjete të forta.

Veprimet e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Pavlin Zhivani, për marrjen në polici dhe pyetjen e shtetasve të mitur E. Ll. dhe K. Sh. pa mbajtur procesverbal, përbëjnë veprë penale, në rastin konkret atë të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 të Kodit Penal.

Vepra penale e mësipërme cënon funksionimin e rregullt dhe normal të veprimtarisë shtetërore dhe prek lirinë e shtetasve, pasi ata janë mbajtur në mjediset e Komisarariatit të Policisë Dibër duke mosrespektuar procedurat dhe garancitë ligjore.

Shoqërimi për disa ditë rresht në mjediset e Komisarariatit të Policisë dhe ushtrimi i dhunës fizike e psikologjike, duke i kërcënuar të miturit me futjen në burg, me qëllim marrjen prej tyre të informacioneve apo të dhënave mbi ngjarjen, përmban plotësisht elementët e veprës penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86, gërma “a” të K.Penal. Kjo veprë penale rrezikon seriozisht jetën dhe shëndetin e shtetasve. Ushtrimi i torturës ka qënë determinant në hedhjen e shtetasit E. Ll. nga kati i tretë i Komisarariatit të Policisë Dibër.

Edhe eksperti psikolog i Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës, i cili u thirr nga ana jonë për vlerësimin e këtij rasti, arriti në këtë konkluzion se ndaj shtetasit të mitur E. Ll. janë përdorur forma të ndryshme torture psikologjike dhe fizike nga punonjësit e policisë.

Pretendimet e policisë se, kjo hedhje është bërë me qëllim arratisjen e tij, rezultuan plotësisht të pavërteta. Kjo për arsye se i mituri E. Ll. ishte njohur edhe më parë me lartësinë e madhe (9 m) nga e cila do të hidhej, pasi e kishte vizituar këtë vend një ditë më parë. Njëkohsisht ai ishte i orientuar nga dritat e banesave ngjitur komisarariatit për rrezikshmërinë që paraqiste hedhja e tij nga ajo lartësi dhe megjithatë ai nuk hezitoi të tentonte vetflijimin në kushtet e një tronditje dhe presioni të fortë psikologjik.

Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor rezultoi se në trupin e shtetasit Edison Lleshi u konstatuan thyerje te kockave të parakrahut të majtë, e kofshës së këmbës së majtë dhe e kyçit të këmbës së djathtë.

Duke analizuar në tërësi provat e administruara rezultoi se, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore në Komisarariatit të Policisë Dibër, Pavlin Zhivani, janë kryer veprime me dashje në kundërshtim me ligjin, e për rrjedhojë janë konsumuar elementët e veprave penale të “Torturës” dhe të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar përkatësisht nga nenet 86 dhe 250 të Kodit Penal.

Për këto arsye dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21/ç, të ligjit nr. 8454

datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” dhe në vijim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9094 dt. 03.07.2003 “Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, i rekomandua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër fillimin e hetimit të procedimit penal për veprat penale të “Torturës” dhe të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 86 dhe 250 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Pavlin Zhivani, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Komisaratin e Policisë Dibër.

Rekomandimi u pranua dhe organi i prokurorisë filloi procedimin penal. Mirëpo çuditërisht dhe në kundërshtim të plotë e të hapur me ligjin dhe me provat, pas “hetimit” të bërë për disa muaj, ajo e pushoi këtë procedim penal. Do studjohet nga ne vendimi për të konkluduar nëse do ta ankimojmë tek Prokurori i Përgjithshëm.

Gjithashtu nga hetimi i këtij rasti konstatoam se, nga punonjësit e policisë të Komisaritatit të Policisë Dibër, ishin kryer edhe disa shkelje ligjore dhe administrative lidhur me të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të policisë për shoqërimin dhe pyetjen e shtetasve në polici, si dhe për regjistrimin e tyre në librin e personave të shoqëruar.

Për këto arsye i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që të analizohet me objektivitet kjo ngjarje dhe të fillohet procedimi disiplinor ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkeljet ligjore duke u dhënë masa disiplinore. Gjithashtu rekomandua që kjo ngjarje të përgjithësohet me të gjithë efektivat e Policisë së Shtetit, me qëllim që të mospërsëriten më raste të tilla në të ardhmen.

Rekomandimi u pranua dhe filloi procedimi disiplinor ndaj 7 punonjësve të policisë dhe konkretisht ndaj Drejtorit të Policisë së Qarkut Dibër zotit Ali Elezi etj. Në përfundim u ndëshkuan me masa disiplinore Shefi i Komisaritatit të Policisë Dibër, Alaudin Omuri, të cilit ju dha masa disiplinore “Shtyrje të afatit të gradimit për 6 muaj”; Shefi i Seksionit të Parandalimit të Krimin dhe Policimit në Komunitet në Komisaratin e Policisë Dibër, Pavlin Zhivani, ju dha masa disiplinore “pezullim pa pagese për 30 ditë”; Shefi i Rendit dhe Sigurisë së Objekteve në Komisaratin e Policisë Dibër, Xhezair Hoxha, ju dha masa disiplinore “Shtyrje të afatit të gradimit për 12 muaj”; Specialistit për Hetimin e Krimeve të Lehta në Komisaratin e Policisë Dibër, Admir Trupja, ju dha masa disiplinore “pezullim pa pagese për 30 ditë”; Ndihmës specialistit, Komandant Nëngrupi i Rendit dhe Sigurisë së Objekteve në Komisaratin e Policisë Dibër, Sinan Merdini, ju dha masa disiplinore “Shtyrje të afatit të gradimit për 12 muaj”; Ndihmës specialistit, Komandant Nëngrupi i Rendit dhe Sigurisë së Objekteve në Komisaratin e Policisë Dibër, Fatmir Ndreu, ju dha masa disiplinore “Shtyrje të afatit të gradimit për 12 muaj”.

2. Ankesa e shtetasit A. K., me banim në Tiranë, i cili pretendonte se në dt. 14.11.2009 rreth ores 22.00 ishte duke kaluar ne territorin e Spitalit “Nënë Tereza”, Tiranë, me qëllim për t’i rënë më shkurt për të shkuar në shtëpinë e tij. Aty e kanë ndaluar dy persona civil me një makinë “Volkswagen” me targa të huaja, të cilët i ishin prezantuar si inspektorë të policisë, por që sipas tij nuk i kishin demonstruar ndonjë dokument identifikimi të tyre. Ata e kishin pyetur atë, nëse kishte me vete dokument identifikimi. Ai ju kishte treguar patentën e re, të cilën e kishte me vete. Megjithëse ju ka treguar këtë dokument punonjësit e policisë e hipën atë në makinën e tyre dhe e dërguan në Komisarariat e Policisë Nr. 4 Tiranë, pa i thënë arsyen e këtij veprimi. Bashkë me ankuesin punonjësit e policisë kishin marrë edhe një person tjetër në të njëjtin vend, të cilin e kishin mbajtur në polici njëlloj në kohë me ankuesin. Kur e kanë çuar në polici ankuesin, në oborrin e komisarariatit, njëri prej tyre i quajtur Ervin Dalipaj e ka goditur atë me grushta në kokë e në fytyrë pa patur asnjë shkak të ligjshëm. Si pasojë e këtyre goditjeve atij i janë shkaktuar dhimbje në kokë dhe një ekimozë në kapakun e poshtëm të syrit të majtë. Më pas i kanë marrë sendet personale (dy telefonat e tij) dhe e kanë futur në birucë. Në këtë ambient atij nuk i kanë dhënë për të pirë e ngrënë. Rreth orës 12.00, të dt. 15.11.2009 i kanë dhënë telefonat dhe e kanë dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë ku i kanë marrë shenjat e duarve. Pastaj e kanë risjelle në Komisarariat e Policisë Nr. 4 dhe e kanë lënë të lirë. Gjatë qëndrimit në polici atij nuk i është komunikuar arsyeja e shoqërimit, nuk ishte pyetur nga ndonjë punonjës policie dhe nuk ishte mbajtur asnjë procesverbal ndaj tij. Ankuesi pretendonte se është mbajtur mbi 14 orë i shoqëruar dhe se familjarët e tij nuk u njoftuan për shoqërimin dhe mbajtjen e tij në polici. Rreth orës 14.00 ai ka shkuar në shtëpi dhe ju ka treguar prindërve të tij ngjarjen e ndodhur me policinë. Pas kësaj ai së bashku me babanë e tij, shtetasin Y. K. kanë shkuar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë ku janë takuar me Drejtorin z. Tonin Vocaj. Atij i treguan ngjarjen e ndodhur dhe shenjat e dhunës të cilat ishin të dukshme. Drejtori ju ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, sepse ai ishte i pafajshëm dhe se do të merrte masa administrative ndaj inspektorit Ervin Dalipaj dhe se do t’i informonte për këtë. Megjithë premtimin e tij për ndjekjen e problemit, ata nuk u informuan se çfarë u bë më pas.

Për hetimin e plotë të këtij rasti nga ana jonë u pyetën babai i ankuesit shtetasi Y. K., punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë, Ervin Dalipaj me detyre Shef i Seksionit të Vjedhjeve, Agron Shkëmbi e Jetnor Xhaferri me detyrë Specialist në Zyrën e Informacionit dhe Fetah Dyrmishi e Gëzim Hoxha me detyrë Ndhmësspecialist në Zyrën e Informacionit. U kqyr dhe u fotokopjua

libri i personave të shoqëruar në këtë komisariat, si dhe u mor vendimi për ekzaminimin mjeko-ligjor të ankuesit A. K..

Nga hetimi rezultoi se punonjësit e policisë Ervin Dalipaj me detyrë Shefi i Seksionit të Vjedhjeve dhe Xhevat Haxhia me detyrë agjent i policisë kriminale në këtë komisariat, rreth mesnatës së dt. 14.11.2009, duke qenë me shërbim në territorin e Spitalit “Nënë Tereza” Tiranë kanë parë dy shtetas që po kalonin aty pranë. Njeri prej tyre, i cili më pas është identifikuar si shtetasi A. K., pasi kishte ecur rreth 50 metra ka kthyer kokën prapa. Ervini ka dyshuar tek ky veprim i tij dhe ka vendosur që t’i verifikonte ata. Punonjësit e policisë i kanë bërë thirrje atyre, ju janë prezantuar dhe u kanë kërkuar dokumentat e identifikimit. Sipas Ervinit, shtetasi A. K. i ka dhënë kartën e identitetit, mirëpo, meqënëse i ka dhënë disa përgjigje që atij (Ervinit) i kanë krijuar dyshime, ka vendosur shoqërimin në polici të tij dhe të shtetasit tjetër M. V.. Ata janë regjistruar në librin e shoqërimit dhe nga kqyrja rezultoi të jetë regjistruar nga punonjësit e policisë së informacionit në orën 00.15 deri në ora 10.00 të dt. 15.11.2009. Shkaku i shoqërimit të tyre ishte për verifikim, sepse nga Ervini ishin dyshuar si vjedhës. Ata për pak minuta janë lënë tek stolat në oborr, ku ju është bërë kontrolli personal dhe pastaj i kanë futur në dhomën e shoqërimit të komisariatit. Punonjësi i Policisë Ervin Dalipaj i ka marrë dy telefonat celular shtetasit A. K., por nuk kishte bërë asnjë procesverbal për këtë veprim. Nga momenti që i shoqëruari ishte regjistruar në regjistër dhe deri në momentin që ishte lënë i lirë, me atë nuk kishte punuar asnjë punonjës policie dhe se familja e tij nuk ishte njoftuar për këtë veprim të policisë. Mosnjoftimin e familjes së tij, punonjësit e policisë e justifikuan me kërkesën e A. K. për të mos shqetësuar familjen. Paraditen e dt. 15.11.2009, shtetasi A. K. dhe i shoqëruari tjetër janë dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë ku ju janë marrë gjurmët e duarve.

Nga akt dëshmia mjeko-ligjore e shtetasit A. K. rezultoi se, në kapakun e poshtëm të syrit të majtë të tij konstatohet një ekimozë me ngjyrë mavi. Ky dëmtim ishte shkaktuar me mjete mbretëse. Koha e shkaktimit të dëmtimit ishte më shumë se dy ditë, duke mos përjashtuar edhe datën për të cilën pretendonte ankuesi. Ky dëmtim kategorizohet si rrahje.

Në përfundim të kryerjes së veprimeve hetimore nga ana jonë rezultoi se:

1. Shoqërimi në polici i shtetasit A. K. nga punonjësi i policisë Ervin Dalipaj ishte i kundërligjshëm. Justifikimet dhe pretendimet e tij se, e ka dyshuar atë si autorë vjedhjeje, ishin të pa mbështetura në prova dhe të pa bazuara në ligj. Në nenin 11, pika 6 e ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar përkufizimi i shoqërimit të personit në zyrat e policisë. Sipas kësaj dispozite, “Shoqërimi, në

kuptimin e këtij ligji, nënkupton rastin kur një person ka shkelur një rregull administrativ dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqërimit në zyrat e policisë me ose pa vullnetin e tij”.

Sikurse konstatohet qartë nga definicioni që jep kjo dispozitë, shoqërimi në zyrat e policisë i një personi, bëhet vetëm kur ai ka shkelur një rregull administrativ dhe nëse është i pa identifikuar. Pra që një person të shoqërohet në polici duhet që të ekzistojnë njëkohësisht të dy kushtet:

Së pari, shkelja e një rregulli administrativ nga një person, që do të thotë, kryerja prej tij e një kundërvajtje administrative për të cilën ai duhet të gjobitet apo të procedohet administrativisht.

Së dyti, shkelësi i rregullit administrativ d.m.th kundërvajtësi është i paidentifikueshëm në kohën dhe vendin e kryerjes së shkeljes, sepse nuk ka dokumente identifikimi me vete në atë moment që konstatohet shkelja nga punonjësi i policisë.

Është me shumë rëndësi që të theksojmë, se ligji në këtë dispozitë të rëndësishme të tij e ka kushtëzuar shoqërimin në polici të një personi, vetëm në rastet kur ai shkel një rregull administrativ dhe jo kur dyshohet apo shkel një rregull apo dispozitë penale. Mirëpo në rastin e shoqërimit të ankuesit nuk ndodhemi para kritereve ligjore të shoqërimit, sepse i shoqëruari nuk ka shkelur asnjë rregull administrativ dhe ndërkohë ai ka patur me vete dokumentin e identifikimit.

Ndërsa në nenin 101, pika 1, të ligjit janë parashikuar rastet e shoqërimit të personave në mjediset e policisë. Sipas kësaj dispozite, “Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në mjediset e policisë ose në organin urdhërdhënës në rastet e mëposhtëme:

a) për mbikqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;

b) kur personi është përhapës i një sëmundje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë”.

Pra duke ju referuar edhe kësaj dispozite ligjore, rezulton se shoqërimi i ankuesit në polici nuk është i mbështetur në ligj.

Në këtë rast, meqënëse punonjësi i policisë Ervin Dalipaj e “dyshoi”, ankuesin si autor vjedhjeje, megjithëse pa patur asnjë provë e fakt, ai në bazë të nenit 102 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, kishte të drejtën ligjore vetëm të kontrollit të identitetit të tij (si të përfshirë në veprimtari të jashtëligjshme), që në fakt këtë veprim e ka bërë në vend.

2. Pretendimet e ankuesit për keqtrajtimin fizik të tij nga Ervin Dalipaj, pavarësisht se nuk u pranuan prej Ervinit dhe punonjësve të policisë, u provuan nga deklaratimet e babait të ankuesit shtetasit Y. K. dhe akt dëshmia mjeko-ligjore.

3. Punonjësi i policisë Ervin Dalipaj, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në nenin 107, pikat 1 e 2 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” nuk

e kishte njoftuar ankuesin për arësyet e shoqërimit të tij dhe ndërkohë duke ia hequr telefonat celular nuk i ka dhënë mundësinë atij për të njoftuar të afërmit.

4. Veprimi i punonjësit të policisë Ervin Dalipaj, duke i hequr e bllokuar telefonat celular dhe mosmbajtur e dhënë procesverbal poseduesit të tyre, vjen në kundërshtim të hapur me përmbajtjen e nenit 108 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Pretendimet e ankuesit për mbajtjen e tij në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor nuk mundëm t’i provojmë.

Nga analiza ligjore e fakteve të mësipërme, si dhe ballafaqimi i tyre me dispozitat ligjore të citura më lartë arrijmë në konkluzionin se, punonjësi i policisë Ervin Dalipaj me veprimet e tij të kundërligjshme, duke prekur të drejtën kushtetuese themelore vetjake të çdo shtetasi për të lëvizur lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit, të garantuar nga neni 38/1 i Kushtetutës sonë, si dhe cënuar lirinë personale dhe të drejtat ligjore të garantuara nga ligji “Për Policinë e Shtetit” të shtetasit A. K., ka konsumuar elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Gjithashtu ne konstatojmë se gjatë kohës së trajtimit të këtij rasti, ndaj punonjësit të policisë Ervin Dalipaj, në institucionin tonë ishte bërë edhe një ankesë tjetër nga shtetasi Sh. M. për keqtrajtim fizik. Këtë ankese ia dërguam për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për arsye se për të njëjtën ngjarje punonjësi i policisë Ervin Dalipaj kishte bërë kallzim penal ndaj ankuesit për veprat penale të “Goditjes për shkak të detyrës” dhe të “Fyerjes për shkak të detyrës”.

Për rastin e ankesës së shtetasit A. K. i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësit të policisë Ervin Dalipaj, efektiv i Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Rekomandimi është bërë kohët e fundit dhe është në shqyrtim.

## **II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme apo të parregullta nga Policia**

Kanë qënë 65 ankesa për veprime arbitrare të punonjësve të Policisë, nga të cilat 4 për arrestime e ndalime të paligjshme; 9 për shoqërime të paligjshme në Polici; 20 për mosmarrje të kallzimeve, bllokim të automjeteve, armëve të gjahut e sende të tjera; 26 për mosndjekje të kallzimeve, të ankesave, të kërkesave të shtetasve dhe për moszbulim të autorëve të veprave penale; 4 për mosdhënie dokumentash të ndryshme; 2 për gjoha administrative të padrejta nga Policia Rrugore. Nga 65 ankesat e regjistruara në këtë rubrikë, 13 prej tyre janë konsideruar të drejta. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Rasti i ndjekur me iniciativë lidhur me ngjarjen e bërë publike në media për vetvarjen në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Durrës të shtetasit K. B. më dt. 12.11.2009. Nga ana jonë ky rast u hetua në vend nga një grup ekspertësh, të cilët kqyrën ambjentin ku ndodhi ngjarja, pyetën punonjësit e policisë që e kishin thirrur atë, punonjësit e policisë që kishin marrë kontakt dhe që kishin dijeni për ngjarjen, bashkëshorten dhe kunatin e tij, si dhe morën e administruan dokumenta të ndryshme që lidheshin me këtë ngjarje.

Nga hetimi i kësaj ngjarjeje rezultoi se, nga informacionet e policisë, shtetasi K. B. ishte autor i dyshuar i vjedhjes së një banese në qytetin e Durrësit, ndodhur në dt. 09.11.2009, ku ishin vjedhur disa sende (bizhuteri), disa prej të cilëve ishin shitur nga bashkëshortja e tij në një dyqan që tregton sende floriri. Nga Komisarati i Policisë Durrës ishte bërë referimi i veprës penale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe i ishte kërkuar prokurorit të çështjes thirrja e të dyshuarëve dhe kryerja e veprimeve hetimore proceduriale, ndërmjet të tjerave edhe paraqitja për njohje e bashkëshortes së K. B.. Me miratimin e prokurorit, shtetasit K. e Gj. B., në dt. 12.11.2009, rreth orës 16.00 janë thirrur verbalisht nga punonjësit e policisë Maringlen Muçaj, me detyrë specialist për hetimin e krimeve kundër pronës dhe Arben Luçi, me detyrë specialist i policisë së zonës, që të vinin në Komisaratin e Policisë. Meqënëse K.B. nuk ishte në banesë në kohën që shkuan punonjësit e policisë, këta i kanë thënë bashkëshortes së tij që të paraqiteshin të dy në polici në kohën që K. B. do të vinte në banesë. Rreth orës 18.30 të dt. 12.11.2009, shtetasit K. e Gj. B., së bashku edhe me vajzën e tyre 5 vjeçe janë paraqitur në Komisaratin e Policisë Durrës. Në polici ata janë pritur nga punonjësit e policisë Maringlen Muçaj dhe Arben Luçi. Pasi janë regjistruar në librin e takimeve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës dhe në librin e personave të shoqëruar në polici, ata janë marrë dhe janë futur në ambjentet e policisë nga punonjësi i policisë Maringlen Muçaj. Ky i fundit, shtetasin K. B. e ka lënë në koridorin e katit të parë të godinës së policisë, të ulur në karrike, ndërsa shtetasen Gj. B. dhe vajzën e saj të vogël i ka futur në zyrën e tij, e cila ndodhej aty pranë dhe në prezencën e specialistit të policisë kriminale Ledjon Hizmo e ka pyetur atë me cilësinë e personit që tregon rrethanat e hetimit. Në këtë kohë në polici ka ardhur edhe prokurori i çështjes Sokol Nishani, i cili është njohur me materialet e administruara nga policia. Meqënëse bashkëshortja e K. B. dha të dhëna dhe prova të rëndësishme materiale në ngarkim të K. B., punonjësi i policisë Maringlen Muçaj, ka dalë nga zyra dhe ia ka dhënë në dorëzim K. B. punonjësit të policisë të informacionit të Komisarariatit të Policisë Durrës Beqir Gjergji për ta shoqëruar e siguruar atë në ambjentet e shoqërimit, duke i thënë se ai do të ndalohej. Punonjësi i policisë Beqir Gjergji, pasi i ka bërë kontrollin personal, e ka shoqëruar K. B. në dhomat



e shoqërimit, të cilat ndodhen në katin e parë, prapa godinës së policisë. Atij i ka lënë vetëm cigare dhe e ka mbyllur atë në këtë ambjent të pajisur me derë hekuri, shul e dryn, pa ndriçim elektrik dhe në errësi të plotë (sqarojmë se që kur janë rikonstruktuar këto dhoma që para rreth dy vjetësh ato nuk kanë patur ndriçim elektrik). Këto dhoma janë pa stola apo karrike për të qëndruar ulur. Sipas punonjësve të policisë të informacionit dhe komandantit të tyre, meqënëse këto dhoma nuk janë me kushtet e përshtatshme, nga drejtuesit e organit është urdhëruar që në to të futen vetëm personat e shoqëruar të cilët dyshohen se janë autorë të veprave penale. Më pas në prezencën e prokurorit është bërë edhe paraqitja për njohje e shtetases Gj. B. nga blerëset e sendeve të vjedhura, të cilat ajo ua kishte shitur.

Gjatë kohës që shtetasi K. B. ka qëndruar në ambjentet e shoqërimit, punonjësi i policisë Beqir Gjergji e ka kontrolluar atë herë pas here kur kishte mundësi, dhe me kërkesën e tij i ka ndezur edhe cigare. Rreth orës 20.00 Beqir Gjergji duke qënë rreth 10 metra larg dhomave të shoqërimit, ka dëgjuar zhurmë, goditje të derës së dhomave të shoqërimit. Ai është afruar menjëherë atje dhe i ka thirrur K. B, por ai nuk është përgjigjur. Pastaj Beqiri ka hapur derën me vështirësi dhe ka konstatuar që K. B. ishte varur prapa derës me një rrobë, (benevrecke) të cilën e kishte lidhur në qafë dhe krahun tjetër të saj në hekurat sipër derës. Beqiri i ka ardhur në ndihmë menjëherë atij, duke e zgjidhur dhe nxjerrë jashtë në oborr dhe për këtë ka kërkuar edhe ndihmën e rojes që ishte aty pranë. Ata i kanë dhënë ndihmën e parë, duke i bërë frymëmarrje artificiale e veprime të tjera ndihmuese dhe dërguar menjëherë në spitalin e qytetit Durrës. Në spital shtetasi K. B. është dërguar i gjallë, por megjithëse i është ofruar ndihma mjekësore, ai ka vdekur.

Për këtë ngjarje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës është filluar çështja penale dhe përveç veprimeve të tjera procedurale është marrë edhe vendimi për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të shtetasis K.B.

Nga ana jonë u konstatua se kërkesat (pyetjet) në vendimin organit të prokurorisë për ekspertimin e të ndjerit ishin të pa plota. Për të arritur në një konkluzion objektiv në përfundim të hetimit që u bë nga institucioni ynë, i kërkuam Institutit të Mjekësisë Ligjore që të na informonte lidhur me shkakun e vdekjes së tij dhe faktin se, përse nuk jetoi i ndjeri, megjithëse ai u dërgua i gjallë në spital. Pra, kërkuam të kqyreshin edhe dokumentat për të na dhënë informacion nëse humbja e jetës së tij ishte pasojë e mosdhënies së ndihmës mjekësore në kohë, për shkak të mosdhënies së ndihmës së specializuar nga personeli mjekësor apo për shkaqe të tjera objektive.

Familjarët e të ndjerit kishin pretendime, se vetvarjen i ndjeri e kishte bërë për shkak të ushtrimit të dhunës fizike ndaj tij nga punonjësit

e policisë, por pretendimet e tyre nuk u provuan. Megjithatë lidhur me këto pretendime të familjarëve jemi në pritje të përfundimit të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Nga hetimi yne lidhur me këtë ngjarje të rëndë rezultoi, se disa nga shkaqet që sollën si pasojë vetvarjen në ambientet e policisë të shtetasit K. B. ishin:

I. Moszbatimi nga strukturat drejtuese të Komisarariatit të Policisë Durrës të Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 703, dt. 07.08.2008 “Për njohjen e raportit vlerësues paraprak të delegacionit të CTP-së dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”, si dhe të rekomandimeve të vazhdueshme të Avokatit të Popullit, lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit me standartet ligjore, si dhe për heqjen nga përdorimi dhe funksioni i atyre dhomave që nuk plotësojnë kriteret dhe kushtet domosdoshme.

Sipas pikës 2 të Letër-Porosisë, në dhomat e shoqërimit duhet të ishin vendosur stola, karrike apo pajisje të tjera për qëndrimin ulur të personave. Mbatja pastër, sigurimi i ajrimit e ndriçimit natyral në këto ambiente dhe krijimi i mundësive për të kryer nevoja personale në çdo kohë.

Ndërsa sipas pikës 4 të saj, kërkohet heqja nga përdorimi dhe funksioni i dhomave aktuale të shoqërimit të shtetasve që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e kërkuara duke krijuar ambiente të tjera me kushte komode për trajtim njerëzor e dinjitoz, pa dyer të blinduara e pa hekura, me dritare të përmasave normale që të lejoje hyrjen e dritës e të ajrimit të plotë natyral, me tavolina e karrike pune, të lyera e të pastra, sipas kriterëve që duhet të plotësojë një zyrë pritje.

Mirëpo në kundërshtim të hapur me urdhërimet e bëra në këtë Letër-Porosi, drejtuesit e policisë së këtij organi nuk kishin marrë asnjë masë në zbatim të saj. Dhomat e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Durrës ishin jashtë çdo standarti të kërkuar. Në këtë komisarariat nuk kishte tre dhoma shoqërimi sikurse parashikon ligji nr. 9749 , dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, por ka vetëm dy të tilla, një koridor dhe një WC, të cilat janë në një ambient të përbashkët dhe pa dyer ndarëse nga njëra tjetra. Derë nuk kishte as WC-ja dhe si pasojë e kësaj mangësie, kur kishte dy ose më shumë persona të futur aty, ata ishin të detyruar që të kryejnë nevojat personale në prezencë të njeri-tjetrit. Dhomat mbylleshin nga një derë e jashtme prej hekuri e cila ishte e pajisur me shul e dryn. Ato nuk kishin përmasat e duhura, nuk kishin ajrim, janë pa ndriçim natyral dhe akoma me keq janë edhe pa ndriçim elektrik (errësirë e plotë gjatë natës), ishin të pa pajisura me stola apo karrike për të qëndruar ulur të shoqëruarit.

Këto ambjente të papërshtatshme ishin konstatuar edhe më parë nga institucioni ynë gjatë inspektimeve të bëra, që para një vit e gjysëm e në vazhdim.

Për përmirësimin e kushteve të tyre kemi bërë disa rekomandime Drejtorisë dhe Komisarariatit të Policisë Durrës, por fatkeqësisht rekomandimet tona, megjithëse janë mirëpritur në parim, në fakt nuk kanë gjetur zbatim praktik sepse rezulton që nuk është bërë asgjë konkrete për përmirësimin e tyre.

Gjithashtu duhet të theksojmë se drejtuesit e këtij organi i kanë deklaruar ekipeve tona inspektuese, se i kanë hequr ato dhoma nga përdorimi dhe se të shoqëruarit i mbajnë në korridorin e godinës. Mirëpo, ngjarja e ndodhur dhe hetimi ynë provoi se, në fakt ato janë në përdorim dhe se drejtuesit e këtij organi nuk janë treguar të sinqertë me institucionin tonë.

II. Mosvlerësimi i duhur nga drejtuesit e këtij organi dhe nga punonjësit e policisë i rasteve të ndalimit dhe arrestimit të shtetasve.

Ne gjykojmë se, kur punonjësi i policisë, që është duke punuar me një person në organin e policisë, krijon bindje se ai është autor i një veprë penale dhe vendos që personi do të duhet të ndalohet apo do të arrestohet, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e tij, jo vetëm që ai të moslargohet, por edhe për sigurimin e jetës së tij. Që në këtë moment duhet organizuar puna për ruajtjen e tij permanente me punonjës policie deri sa të përpilohen procesverbalet përkatëse të ndalimit apo të arrestimit dhe dorëzimin e tij në dhomat e sigurisë, ku ka të dislokuar me shërbim punonjës policie në mënyrë të përhershme.

Kujtojmë se për shkak të neglizhencës së treguar nga punonjësit e policisë gjatë kryerjes së veprimeve hetimore proceduriale me autorë të veprave penale në ambjentet e policisë, janë larguar disa persona me rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Raste të tilla kanë ndodhur edhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës.

III. Paaftësia dhe papërgjegjshmëria e drejtuesve të Komisarariatit të Policisë Durrës, të cilët kanë përgatitur dhe miratuar plan-vendosjen e shërbimeve të policisë së rendit, si dhe detyrat e shumta dhe koha e gjatë e shërbimit të punonjësit të policisë që ka për detyrë mbikqyrjen e të shoqëruarëve.

Sipas “Plan-vendosjes së shërbimeve të policisë së rendit për periudhën 01.06.2009 deri 31.12.2009 të Komisarariatit të Policisë Durrës”, vendi i shërbimit Komandant N/Grupi; Përgjegjës Informacioni në Repartin e Policisë pranë Komisarariatit të Policisë, detyrë të cilën e kryente punonjësi i policisë Beqir Gjergji ditën që ndodhi ngjarja, kishte 20 detyra:

- Të mbajë kontakte të vazhdueshme me shërbimet me qëllim që të dijë në çdo kohë vendndodhjen e tyre.

- Të bëjë hyrje daljet e përkohshme të armatimit për shërbim sipas punonjësve të policisë kundrejt firmës.

- Në çdo ndrrësë shërbimi të japë listën e personave të shpallur në kërkim dhe atyre të anuluar si dhe të regjistrojë në regjistrin përkatës.

- Të ushtrojë kontrole të vazhdueshme për të siguruar gatishmërinë e rojeve që sigurojnë objektin e Drejtorisë së Policisë, ambjent ku ndodhet edhe Reparti i Policisë.

- Të ushtrojë kontrole të vazhdueshme në dhomat e shoqërimit në funksion të sigurimit të të shoqëruarëve.

- Të regjistrojë në librin përkatës të gjithë personat e shoqëruar dhe të njoftojë sallën operative për gjendjen e tyre, arësyet e shoqërimit dhe kush punoi me ta. Të verë në dijeni shefin e policisë kriminale, shefin e rendit në përfundim të kryerjes së procedurave nga specialistët përkatës.

- Të informojë komandën për gjendjen e dhomave të ndalimit, shqetësimet dhe problemet që lindin gjatë 24 orëve në ambjentet e ndalimit.

- Të moslejojë futjen në dhoma të ushqimeve për të ndaluarit që ndodhen aty pa u kontrolluar më parë imtësisht duke zbatuar kërkesat e rregullores 1075, dt. 15.09.1999 “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve”.

- Të mosnxjerrë të ndaluarit nga dhomat e ndalimit për veprime në rast se nuk merren masa të plota për sigurimin e tyre.

- Të sigurojë derën e jashtme të dhomave me kyç të cilin ta mbajë vetë në vend të sigurt në kasafortë.

- Të kontrollojë rojet e brendshme të dhomave para se të marrin shërbimin, tu heqë atyre telefonin celular, armën e brezit dhe ti sigurojë ato në kasafortë deri në përfundim të shërbimit.

- Përpilon raporte shërbimi për ngjarje që ndodhin gjatë shërbimit.

- Të mbajë në kontroll personat e shoqëruar, për të parandaluar çdo veprim që mund të rrezikojë jetën e tyre.

- Tu japë ndihmë të menjëhershme në rast se ka përkeqësime shëndeti duke i dërguar në spital me një grup të gatshëm. Por në çdo rast të vërë në dijeni komandën eprorë, sallën operative.

- Të moslejojë futjen në dhomat e shoqërimit të personave të tjerë përveç në rastet kur duhet të bëhet shoqërimi i tyre për siguri, apo për të dhënë ndihmë mjekësore.

- Të mospranojë në dhoma persona të dëmtuar, të rrahur apo të plagosur pa marrë më parë ndihmë mjekësore. Për çdo rast të përpilojë raport shërbimi.

- Të moslejojë personat e shoqëruar të keqtrajtohen në ambjentet e dhomave nga punonjës policie. Në rast ndodhje të njoftojë komandën eprorë.

- I raporton komandës problemet e konstatuara gjatë shërbimit dhe problemet që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës.

- Mban përgjegjësi për ruajtjen e automjeteve të bllokuara që ndodhen në ambjentet e drejtorisë deri në momentin e largimit të tyre në pikën e bllokimit e gjithë kjo procedurë kundrejt dokumentacionit përkatës.

- Të kërkojë zbatimin e urdhërit të Shefit të Komisarariatit për forcimin e regjimit të hyrjes dhe daljes dhe për forcimin e rregullit në Repartin e Policisë.

Gjithashtu sipas këtij plan-vendosje, shërbimi në këtë vend është i organizuar 24 orë nga ora 07.00 deri 07.00. Në fakt ditën e ngjarjes, më dt. 12.11.2009, punonjësi i policisë Beqir Gjergji dhe të nesërme në dt. 13.11.2009 edhe kolegu i tij Behar Llana, të cilët duhet të përmbushin të gjitha detyrat e përshkruara më lartë, duke përfshirë edhe mbajtjen nën kontroll të personave të shoqëruar, për të parandaluar çdo veprim që mund të rrezikojë jetën e tyre, ishin në shërbim për një kohë prej 24 orë pa ndërprerje.

Nga moria e detyrave që ka ky vend shërbimi, si dhe nga koha e gjatë e punës prej 24 orë pa ndërprerje që kryen punonjësi i policisë i disllokuar në këtë vend, arrihet në konkluzionin kategorik, se përpiluesi i plan-vendosjes së shërbimeve të policisë së rendit zoti Genc Peka, me detyrë Shef i Seksionit të Policisë së Rendit dhe miratuesi i tij zoti Gjelo Prendi, me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Durrës, e kanë bërë atë në mënyrë formale, të pa studjuar mirë dhe të pa mbështetur në baza e mundësi reale. Është e pamundur fizikisht dhe psikologjikisht që një punonjës policie t'i kryejë mirë të gjitha 20 detyrat e ngarkuara sipas këtij plani, edhe në qoftë se shërbimi do të ishte i organizuar vetëm për 8 orë pune dhe jo më për 24 orë sikurse është bërë në fakt.

IV. Mungesa e kontrollit nga strukturat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ndaj organeve vendore të policisë lidhur me zbatimin e detyrave, të përcaktuara në Ligj, në Letër-Porosi, Urdhëra, Udhëzime, Rekomandime e akte të tjera nënligjore, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë, objektivitetin dhe cilësinë e plan-vendosjeve të shërbimeve të policisë së rendit. Kujtojmë se Letër-Porosia e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 703, dt. 07.08.2008, e cila sikurse përshkruam më lartë, bën fjalë për heqjen nga përdorimi të dhomave të shoqërimit të papërshtatshme, sikurse janë ato të Komisarariatit të Policisë Durrës, si dhe për përmirësimin e kushteve të dhomave të shoqërimit ekzistuese, ishte nxjerrë para më shumë se një viti. Mirëpo nga hetimi i këtij rasti u provua se, Letër-Porosia nuk ka gjetur aspak zbatim nga drejtuesit e Policisë në Durrës. Gjithashtu duhet të theksojmë se zbatimi i detyrave të parashikuara prej saj nuk është kontrolluar nga strukturat e Drejtorisë së

Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilat kanë për detyrë që të kontrollojnë zbatimin e akteve të nxjerra nga ky organ qëndror.

Përveç sa më sipër, gjatë kqyrjes së dokumentacionit dhe ambjenteve që lidhen me këtë ngjarje u konstatua se:

1. Shtetasit K. e Gj. B. ishin regjistruar në dy libra, në atë të quajtur “Libër i takimeve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës” edhe në “Librin e shtetasve të shoqëruar në polici”. Në fakt u provua, përveç të tjerave dhe me deklaratimet e punonjësve të policisë, se ata nuk u shoqëruan në polici, por u thirrën për probleme “pune” dhe si të tillë nuk duheshin regjistruar në librin e personave të shoqëruar. Ky fakt është një tregues tjetër i mosnjohjes së ligjit “Për Policinë e Shtetit” nga drejtuesit vendor të policisë dhe efektivat e tyre lidhur me konceptin e shoqërimit të shtetasave në organet e policisë si dhe me rastet e kriteret ligjore të shoqërimit të parashikuara në ligjin “Për Policinë e Shtetit”.

2. Në këtë organ nuk kishte libër tip për takimet e shtetasve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, ku të ishin të pasqyruara të gjitha të dhënat e nevojshme, por si i tillë ishte “përshtatur”, apo “sajuar” një “Regjistër për automjetet dhe targat e vjedhura ose të humbura”, i cili nuk ka të dhënat e duhura për të pasqyruar takimet e shtetasve.

3. Në librin e takimeve të shtetasve në këtë organ, megjithëse quhet i tillë, ishin pasqyruar shënime për problematika të ndryshme dhe pa një rregullsi. Në të janë regjistruar persona të shoqëruar, shtetas që bëjnë kallzime të ndryshme, shtetas për takime private dhe persona të tjerë për të cilët nuk është pasqyruar asnjë arsye përse figurojnë të regjistruar në të.

4. Këto fakte tregojnë jo vetëm për mungesë përgjegjësie të drejtuesve të këtij organi të cilët kanë miratuar vendosjen e këtij libri, por në të njëjtën kohë edhe mungesë kontrolli prej tyre të punës së strukturave vartëse, lidhur me shënimet që ata bëjnë në libra, si dhe për pasqyrimin e të dhënave të tjera të nevojshme.

5. Në librin e shtetasve të shoqëruar nuk pasqyroheshin të gjitha kërkesat e ligjit “Për Policinë e Shtetit” lidhur me njoftimin e familjarëve, të të afërmëve apo të personit që i shoqëruari beson, ora e njoftimit të tyre, emri i të njoftuarit dhe numri i telefonit të tij.

6. Në dhomat e shoqërimit dhe në korridorin e godinës të këtij organi ku mbahen të shoqëruarit nuk kishte të afishuara postera për të drejtat e njeriut, për parandalimin e dhunës ndaj qytetarëve nga punonjësit e policisë, për të drejtat ligjore të personave të shoqëruar etj.

7. Në zyrën e informacionit të këtij komisariati nuk kishte libër për regjistrimin e personave të arrestuar dhe të ndaluar.

Për të përmirësuar shërbimin e policisë ndaj qytetarëve, për përmirësimin e kushteve të dhomave të shoqërimit, për mbajtjen nën kontroll të personave të shoqëruar në polici, për respektimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore dhe për të parandaluar ndodhjen e ngjarjeve

të padëshiruara në ambjentet e policisë, bazuar në pikën 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 21/c dhe në nenin 24/b, të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si më poshtë:

1. Analizimin e ngjarjes së vetvarjes së shtetasit K. B. në ambjentet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Durrës dhe nxjerrjen e përgjegjësiave administrative të drejtuesve të Komisarariatit të Policisë Durrës, Genc Peka, me detyrë Shef i Seksionit të Policisë së Rendit dhe Gjelosh Prendi, me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Durrës, të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre janë bërë shkaktarë të kësaj ngjarje të rëndë.

2. Rasti i vetvarjes së shtetasit K. B. dhe shkeljet e drejtuesve të Komisarariatit të Policisë Durrës të përgjithësohen në të gjitha organet e policisë vendore me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit policor dhe parandalimin e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen.

3. Rishikimin dhe përmirësimin e “Plan-vendosjes së shërbimeve të policisë së rendit” në Komisarariatit të Policisë Durrës dhe në të gjitha organet vendore të policisë në shkallë vendi, si dhe plotësimin e tyre me numrin e punonjësve të policisë të domosdoshëm për të kryer sa më mirë dhe me cilësi të lartë detyrat funksionale.

4. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të shtetasve në Komisarariatit të Policisë Durrës sipas kërkesave të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe në zbatim të Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 703, dt. 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femrat, meshkujt dhe të miturit, si dhe pa dyer apo zgara hekuri dhe pa shula e dryna.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin apo rikonstruksionin me parametra dhe standarte bashkëkohore të dhomave të shoqërimit të shtetasve në të gjitha Komisarariatet e Policisë në shkallë vendi, ku ato mungojnë.

6. Nga strukturat drejtuese të organeve vendore të policisë të punohet me të gjithë efektivat për njohjen e ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre. Ndërkohë nga strukturat drejtuese e kontrolluese vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm ndaj vartësve lidhur me shoqërimin e shtetasve në organet e policisë.

7. Në ambjentet e shoqërimit të shtetasve të vendosen postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar të parashikuara në dispozitat e ligjit “Për Policinë e Shtetit”, duke gjykuar se ato kanë vlerë informuese

për të shoqëruarit, por në të njëjtën kohë shërbejnë edhe si mjet kujtese për punonjësit e policisë për t'i zbatuar e respektuar këto të drejta.

8. Libri i personave të shoqëruar të riformatohet dhe të unifikohet me qëllim që të pasqyrohen në mënyrë të plotë kërkesat e ligjit, duke shtuar disa kolona të tjera që kanë të bejnë me:

- Njoftimin e familjarëve, të afërmëve apo personit që i shoqëruari beson, ora e njoftimit të tyre, emri i të njoftuarit dhe numri i telefonit të tij.

- Nënshkrimi i të shoqëruarit në libër pasi ai lihet i lirë. Vendosja e kësaj të dhëne do të parandalojë mundësinë e abuzimit të punonjësve të policisë me arësyen dhe kohën e shoqërimit të tyre.

- Kolona në të cilën regjistrohet arësya e shoqërimit, të ketë më shumë hapsirë me qëllim që të pasqyrohet më shumë informacion për arësyen e shoqërimit, sepse deri aktualisht ajo ka ngelur e përgjithshme si “verifikim” apo “konflikt”.

9. Të krijohet dhe unifikohet libri i takimeve të shtetasve me punonjësit e policisë në organet e policisë, duke pasqyruar të gjitha të dhënat e nevojshme, për gjeneralitetet e tyre, punonjësën e policisë që takon, qëllimin e takimit, orën e hyrjes dhe atë të daljes, si dhe të dhëna të tjera të cilat do t'i vlerësoni të domosdoshme.

10. Të rritet niveli kulturor e profesional dhe përgjegjësia e punonjësve të policisë që administrojnë librat dhe regjistrat e organit të policisë. Në librin e shoqërimit të shtetasve në polici të regjistrohen menjëherë sapo sillen në organ të gjithë dhe vetëm personat e shoqëruar nga punonjësit e policisë. Ndërsa në librin e takimeve të regjistrohen të gjithë dhe vetëm ata persona që vijnë vetë apo ata që janë thirrur nga policia në organ për probleme administrative, për probleme penale dhe për kryerje të veprimeve hetimore-proceduriale dhe të pasqyrohen me korrektesë të dhënat e sakta e të vërteta.

11. Në çdo organ vendor policie të vendoset sa më shpejtë një libër më vete për regjistrimin e personave të arrestuar apo të ndaluar nga punonjësit e policisë të atij organi. Ky libër duhet të vendoset përveç librit që qëndron në dhomat e sigurimit. Në këtë libër, i cili duhet të qëndrojë dhe të administrohet nga punonjësi i policisë së informacionit, të regjistrohen vetëm personat e arrestuar apo të ndaluar nga policia. Praktika e deritanishme e regjistrimit të personave të arrestuar dhe të ndaluar në librat e shoqërimit, sikurse kemi rekomanduar edhe më parë, duhet të ndryshohet menjëherë.

12. Nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të ushtrohet më shumë dhe më mirë kontroll në organet e policisë vendore lidhur me zbatimin e akteve normative ligjore e nënligjore për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të rekomandimeve të herë pas



hershme të Avokatit të Popullit të cilat janë vlerësuar e mirëpritur nga kjo drejtori.

Rekomandimi u pranua dhe filloi procedimi disiplinor për dhënien e masave administrative për punonjësit e policisë Isuf Vllasa, me detyrë Shef i Sektorit të Rendit dhe Sigurisë Publike në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, Baki Gjergji, me detyrë Shef i Sektorit Ekonomik, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, Genc Peka, me detyrë Shef i Seksionit të Rendit dhe Sigurisë Publike, në Komisariatin e Policisë Durrës dhe Beqir Gjergji, me detyrë oficer i patrullës së përgjithshme në Komisariatin e Policisë Durrës, i cili u pezullua menjëherë pas ngjarjes. Kjo ngjarje u përshkrua e përgjithësua nga Drejtoria e Përgjithshme në të gjitha organet e policisë dhe gjithë strukturave të policisë vendore ju është tërhequr vëmëndja për të punuar më shumë e më mirë lidhur me njohjen e zbatimin e akteve normative me qëllim respektimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese e ligjore të shtetasve nga organet e policisë.

2. Ankesa e shtetasit A. Sh. me banim në Elbasan, i cili pretendonte, se nga fundi i muajit korrit 2009 në Elbasan kishte ndodhur një vrasje. Një ditë pas ndodhjes së vrasjes nga Policia e Elbasanit është shoqëruar vëllai i tij, i quajtur Sh. Sh.. Sapo ankuesi ishte informuar për shoqërimin e vëllait të tij, është paraqitur në polici për t'u interesuar për atë dhe për t'i çuar ushqime. Ai pretendonte, se sapo është parë nga Drejtori i Policisë, është urdhëruar shoqërimi i tij duke u mbajtur 21 orë, ndërsa i vëllai është mbajtur 24 orë pa ju komunikuar asnjë lloj akuze apo shkaku ligjor për shoqërimin dhe izolimin e tyre në polici. Pasi vëllai i tij është liruar, është marrë përsëri pas dy orësh dhe është izoluar për 24 orë, dhe kjo metode pune ka vazhduar për 5 ditë rresht. Gjithashtu ai pretendonte, se kështu kishte ndodhur edhe me një shokun e vëllait të tij, të quajtur O. L..

Për të verifikuar pretendimet e ankuesit, i kërkuam Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan shpjegime rreth pretendimeve të ankuesit. Gjithashtu i kërkuam të na informonte për shkakun dhe bazën ligjore të shoqërimit dhe të mbajtjes së tyre në polici, a ishte bërë regjistrimi i tyre në librin e personave të shoqëruar në polici, si dhe fotokopje të fletëve të librit të shoqërimit të shtetasve të larpërmëndur.

Drejtorja e Policisë e Qarkut Elbasan na dërgoi përgjigje, nëpërmjet të cilës na informoi se, shkaku i shoqërimit të tyre në polici ka qënë vrasja e shtetasit R. R. ndodhur në dt. 22.07.2009 në Elbasan. Për t'u pyetur rreth ngjarjes ishin shoqëruar në polici dhe pyetur rreth 40 persona, ndërmjet të cilëve edhe shtetasit A. Sh., Sh. Sh. dhe O. L.. Së bashku me përgjigjen na dërgoi edhe fletët e librit të personave të shoqëruar në polici.

Nga dokumentat e dërguara rezultoi se, shtesai Sh. Sh. ishte shoqëruar në polici 3 herë respektivisht, në dt. 24.07.2009, nga ora 19.30

deri në ora 05.00 të dt. 25.07.2009; në dt. 27.07.2009, nga ora 17.50 deri në ora 03.40 të dt. 28.07.2009; në dt. 28.07.2009, nga ora 17.30 deri në ora 18.30, kur është ndaluar. Shtetasi A. Sh. ishte shoqëruar në 24.07.2009, nga ora 20.00 deri në ora 06.00 të dt. 25.07.2009. Ndërsa shtetasi O. L. ishte shoqëruar tre herë respektivisht, në dt. 24.07.2009, nga ora 20.00 deri në ora 06.00 të dt. 25.07.2009; në dt. 27.07.2009, nga ora 17.50 deri në ora 03.40 të dt. 28.07.2009; në dt. 28.07.2009, nga ora 17.30 deri në ora 23.30, kur është lënë i lirë.

Në përgjigjen e policisë nuk ishte pasqyruar baza ligjore e shoqërimit të personave të sipërpërmendur megjithëse ia kishim kërkuar atë.

Nga shqyrtimi i këtij rasti dhe konkretisht studimi i përgjigjes së policisë dhe i shënimeve në fletët e librit të personave të shoqëruar në polici, dhe pa marrë në konsideratë pretendimet e ankuesit për shoqërimin e tij dhe të personave të cituar më lartë disa herë dhe mbajtjen e tyre në gjendje shoqërimi për çdo rast më shumë se koha maksimale ligjore deri në dhjetë orë (sqarojmë se ankuesi pretendonte mbajtjen e tyre për çdo rast nga 21 deri 24 orë) rezultoi, se ata ishin shoqëruar e pyetur në polici si lidhje shoqërore dhe miqësore të ngushta të dy autorëve të krimit, A. Ll. dhe A. J., të cilët ishin arrestuar. Ndërsa shtetasi Sh. Sh. edhe si person i dyshuar për këtë vrasje. Ne arritëm në konkluzionin se veprimet e policisë, duke shoqëruar 40 persona ndërmjet të cilëve edhe të larpërmendurit, kanë cënuar të drejtat e tyre të ligjshme dhe janë kryer në kundërshtim të plotë dhe të hapur me dispozitat ligjore të mëposhtme:

1. Me përmbajtjen e nenit 312 të K.Pr.Penale, sipas të cilit, “thirrja e personave të cilët mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, duhet bërë me urdhër, i cili përmban gjeneralitetet e personit, ditën, orën, vendin e paraqitjes dhe paralajmërimin për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje pa patur pengëse të ligjshme”.

Ata ishin shoqëruar e pyetur në kuadrin e një hetimi penal që kishte filluar për zbulimin e autorëve të vrasjes së ndodhur dhe në këto rrethana duhej të zbatoheshin dispozitat e K.Pr.Penale. Mirëpo nuk rezultoi që në këtë rast nga punonjësit e policisë gjyqësore që kanë kryer veprimet e pyetjes me personat e mësipërm të jetë bërë ndonjë urdhër apo flet-thirrje për personat e shoqëruar. Po kështu nuk rezultoi që të jetë nxjerrë ndonjë urdhër për thirrjen dhe pyetjen e personave të cilët mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit as nga prokurori i çështjes apo nga oficerët e policisë gjyqësore të cilëve u është deleguar kryerja e veprimeve hetimore.

2. Me nenin 100 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, sipas të cilit “punonjësi i policisë duhet të bëjë njoftim për paraqitje (me fletnjoftim apo verbalisht) për të marrë informacion për të identifikuar shkelsit e mundshëm të ligjit”.

3. Me nenet 11/6, 101 dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, në të cilat parashikohet shoqërimi në polici për shkaqe administrative i personave dhe rastet e shoqërimit. Rasti konkret për t’u pyetur si lidhje shoqërore e miqësore të autorëve të veprës penale, apo si person i dyshuar nuk parashikohet në rastet e shoqërimit të personave në polici.

4. Shoqërimi dhe pyetja në polici i 40 shtetasve, dy prej të cilëve disa herë, përbën cënim të lirisë së tyre dhe dhunë psikologjike. Këto veprime të cilat vijnë në kundërshtim me parimet dhe rregullat e hetimit, janë ushtruar me qëllim për të dëshmuar apo pranuar rreth autorësisë së vrasjes së ndodhur. Këto veprime vijnë në kundërshtim të hapur me:

a) Nenin 25 të Kushtetutës tonë, i cili parashikon se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”.

b) Nenin 3 të Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, i cili parashikon se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimit ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.

5. Gjithashtu veprimet e punonjësve të policisë të kryera ndaj personave të shoqëruar vijnë në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me:

a) Nenin 1, pikën 2 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, i cili parashikon se: “Misioni i Policisë është të ruajë rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”.

b) Nenin 4, pikën 1, gërma “b” të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i cili parashikon si përgjegjësi të policisë, “të parandalojë, të zbulojë dhe hetojë, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedural, veprat penale dhe autorët e kryerjes së tyre”.

Është me rëndësi që të theksohet se, pavarësisht nga krimi i rëndë që kishte ndodhur, nuk mund të pranohet dhe të lejohet që punonjësit e policisë të përdorin mjete e metoda të kundërligjshme, duke shkelur të drejtat dhe liritë e shtetasve me qëllim për të zbuluar autorët e tij. Ne gjykojmë se, punonjësit e Policisë së Shtetit në veprimtarinë e përditshme për kryerjen e misionit të tyre ligjor duhet të synojnë jo vetëm realizimin e objektivit për tolerancë zero ndaj krimit, por në të njëjtën kohë duhet të zbatojnë edhe parimin universal të së drejtës, tolerancë zero ndaj shkeljes së të drejtave të njeriut.

Megjithëse veprimet e policisë përmbanin elementë të veprës penale, duke mbajtur parasysh edhe rrethanat konkrete kur janë kryer këto shkelje dhe me qëllim për të parandaluar shkelje të tilla në të ardhmen, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës tonë dhe në nenin 21, gërma “d” të ligjit “Per Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, i rekomanduar

Drejtorit të Policisë së Qarkut Elbasan që analizonte rastin e shoqërimit në polici të 40 shtetasve, ndërmjet të cilëve edhe të shtetasve A.Sh., Sh.Sh. e O.L. dhe të identifikonte personat që kanë kryer veprimet e kundërligjshme. Ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkeljet ligjore të jepte masa disiplinore, të cilat duhet t'i komunikonte në prezencë të efektivit me qëllim që të parandalohen shkelje të tilla në të ardhmen.

Rekomandimi u pranua dhe specialisti i krimeve kundër personit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Elbasan, Qemal Molla u ndëshkua me masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.

3. Rasti i ndjekur me iniciativë pas bërjes publike në disa media vizive dhe të shkruar, në datat 21 e 22.05.2009, ku u informua publiku për tubimin e të verbërve para Kryeministrit. Theksi i informimit u vu mbi një veprim të dhunshëm të bërë ndaj disa shtetëseve të verbëra dhe të moshura nga një shtetas, i cili më pas u identifikua me emrin P. B., biznesmen.

Nga shqyrtimi i ngjarjes së ndodhur gjatë tubimit të organizuar nga Shoqata e të Verbërve para godinës së Kryeministrit, shikimi i pamjeve filmike të dhëna nga disa TV në datat 21 e 22.05.2009 dhe artikujve të botuar në disa gazeta të përditshme në dt. 22.05.2009, rezultoi se shtetasi Pëllumb Borshi, ka dhunuar disa gra të verbëra të cilat ishin të moshuara. Këtë veprim ai e kreu në prezencën e jo më pak se 3 punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të 3 punonjësve të Gardës së Republikës, njëri prej të cilëve ishte me uniformë. Shqetësues në këtë ngjarje për ne, ishte fakti se asnjë nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës nuk ndërhyri jo vetëm për të parandaluar veprimin e dhunshëm të shtetasit Pëllumb Borshi, por edhe pas ndodhjes së saj ata qëndruan indiferentë dhe nuk reagojnë për kapjen e tij. Jo vetëm kaq, por nga pamjet filmike dhe fotot e botuara në disa gazeta dukej qartë që dhunusi pas kryerjes së veprës penale është mbështetur, duke u shoqëruar dhe “përgëzuar” nga një punonjës civil i Gardës së Republikës për veprimin e dhunshëm që bëri ndaj të verbërve.

Sikurse u bë e njohur nga media dhe përfaqësuesit e disa institucioneve shtetërore, shoqata e të verbërve kishte organizuar një tubim paqësor para godinës së Kryeministrit për të kërkuar realizimin e disa të drejtave të tyre ligjore humane.

E drejta e shtetasve për të ushtruar tubime është një e drejtë universale kushtetuese e bazuar në nenin 47, pika 1 të Kushtetutës sonë, në të cilën parashikohet se: “Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe pjesmarrja në to është e garantuar”.

Në nenin 59, pika 1, gërma “e” dhe “f” të Kushtetutës parashikohet se: “Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimet dhe invalidët”.

f) riaftësim shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Përveç sa më sipër, të verbërit gëzojnë një mbrojtje të veçantë ligjore nga shteti. Në nenin 3 të ligjit nr. 8098, dt. 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” përcaktohet se: “Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdesen për ta”.

Mirëpo ngjarja e ndodhur me të verbërit në dt. 21.05.2009 demostroi se punonjësit e organeve shtetërore të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës, në vend që të merrnin në mbrojtje të verbërit e dhunuar, përgëzuan agresorin e tyre. Ky qëndrim është jo vetëm i pamoralshëm, jo etik dhe ul imazhin e shtetit, por në të njëjtën kohë ai është edhe i kundërligjshëm dhe i dënueshëm.

Qëndrimi i mbajtur në këtë rast nga punonjësit e Gardës së Republikës të dislokuar me shërbim në godinën e Kryeministrit, të cilët jo vetëm që nuk ndërhyjnë ndaj aktit të autorit të veprës penale, por në kundërshtim me detyrat funksionale të parashikuara në ligjin nr. 8869, dt. 22.05.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, e shoqëruan dhe përgëzuan atë për aktin që bëri me të verbërit.

Fakti që kjo vepër u krye ndaj personave të verbër, të cilët nuk kanë mundësinë e identifikimit fizik të autorit të saj, i shton detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar menjëherë ndaj autorit të veprës penale.

Për këtë rast i rekomandua Komandantit të Gardës së Republikës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë dhe Shefit të Komisariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, që të identifikonin punonjësit e strukturave të tyre të pranishëm në vendin e ndodhjes së kësaj vepre penale, që jo vetëm nuk reagueshin ndaj veprimit të kundërligjshëm të autorit të saj, por e përgëzuan atë. Të analizonin sa më shpejt qëndrimin e kundërligjshëm të punonjësve të tyre dhe të jepnin masa disiplinore sipas ligjit. Gjithashtu rekomandua që ngjarja e ndodhur dhe masat disiplinore të përgjithësohen në të gjithë efektivat e tyre me qëllim që të parandalohen shkelje të tilla në të ardhmen.

Rekomandimi ynë u pranua nga Komanda e Gardës së Republikës, e cila menjëherë e analizoi me objektivitet ngjarjen e ndodhur dhe ndëshkoi me masa disiplinore disa punonjës të saj si, Kolin Gjoka, me detyrë Shef Shtabi njësia dytë në Gardën e Republikës, me gradë N/Kolonel, të cilit ju dha masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”;

Melsed Shazivari, me detyrë specialist ndërlidhje njësia e dytë në Gardën e Republikës, me gradë Kapiten, të cilit ju dha masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”; Gjini Marku, me detyrë trup shërbimi njësia e dytë në Gardën e Republikës, me gradë Rreshter, që ju dha masa disiplinore “Vërejtje”; Nik Gjini, me detyrë trup shërbimi njësia e dytë në Gardën e Republikës, me gradë Rreshter, të cilit ju dha masa disiplinore “Vërejtje” dhe Edmir Arifaj, me detyrë trup shërbimi njësia e dytë në Gardën e Republikës, me gradë Rreshter, që ju dha masa disiplinore “Lirim parakohe dhe përjashtim nga strukturat e Gardës së Republikës”.

Ndërsa padrejtësisht strukturat e Policisë së Shtetit u justifikuan se kjo ngjarje nuk kishte ndodhur në prani të punonjësve të policisë dhe u mjaftuan vetëm me tërheqje të vëmëndjes punonjësve të policisë që ishin me shërbim në këtë tubim.

4. Ankesa e shtetasit Kujtim Çashku, ortak i vetëm dhe administrator i subjektit juridik “Orafilm” shpk. Ankuesi pretendonte se, me vendimin nr. 12021, dt. 20.09.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ishte regjistruar si person juridik, me objekt zhvillimin e aktivitetit kulturor, kinematografik dhe edukimi universitar brenda e jashtë vendit.

Me VKM nr. 652, dt. 30.09.2004, ishte dhënë leja për të hapur shkollën e lartë jo publike “Marubi” për kinematografinë dhe televizionin, me seli qendrore në Rr. “A. Moisiu” nr. 78, tek ish Kinostudio.

Me VKM nr. 74, dt. 04.02.2005 i ishte dhënë në huapërdorje 200 m<sup>2</sup> në ambjentet e ish Kinostudios, në ish godinën e studios së zërit.

Me vendimin nr. 227, dt. 26.05.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ishte bërë akreditimi i të gjitha degëve të shkollës së hapur prej tij.

Në dt. 20.02.2009, atij i ishte dërguar një shkresë nga “Alba Film” sha, nëpërmjet të cilës ai urdhërohej që të lironte menjëherë sipërfaqen funksionale (lulishten) dhe të gjitha ambjentet e tjera përveç 200 m<sup>2</sup> të dhëna nga VKM nr. 74, dt. 04.02.2005. Sipas kësaj shkrese ky urdhër bazohej në VKM nr. 1445, dt. 29.10.2008.

Meqënëse subjekti juridik “Orafilm” shpk kishte bërë investime të konsiderueshme për 5 vjet rresht në këtë objekt dhe se gjatë këtij procesi të investimeve nuk ishte penguar, ka vënë në dijeni “Alba Film” dhe Qeverinë duke i kërkuar që të mos zbatohet ky urdhër, përderisa nuk kishte ndonjë vendim gjyqësor.

Më dt. 21.02.2009, ora 13.30, disa forca policie të shoqëruara nga 5 makina policie së bashku me Drejtorin e “Alba Film”, kanë shkuar në ambjentet që posedon ankuesi dhe kanë tentuar që ta rrethojnë atë me rrjetë teli, duke ndërprerë procesin akademik. Ankuesi pretendonte se gjatë këtyre veprimeve ai ishte dhunuar fizikisht nga punonjësit e policisë, duke u goditur me grushta në bark dhe me gju në organet

gjinitale. Si pasojë e goditjeve fizike dhe dhimbjeve të forta, ai ishte rrëzuar në tokë. Pas goditjeve ankuesi ishte vizituar në urgjencën e QSU “Nënë Tereza” Tiranë dhe i ishte dhënë mjekim. Gjithashtu sipas tij, ishin dhunuar fizikisht edhe studentët e shkollës të cilët i ishin bashkuar atij për të kundërshtuar paqësisht veprimet e Drejtorit të “Alba Film” sha dhe të punonjësve të policisë. Përveç sa më sipër, ankuesi na informoi se nga studentët e tij ishin filmuar veprimet e dhunshme të policisë. Së bashku me ankesën ai na dërgoi edhe disa dokumente dhe një kasetë filmike.

Nga Avokati i Popullit dhe disa ekspertë të institucionit morën takim me ankuesin Kujtim Çashku, Drejtorin e “Alba Film” sha z. Fatmir Musaj, Zv.Drejtorin e Policisë së Qarkut Tiranë z. Gjergji Jorgo, Shefin e Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë z. Ismet Shkreta dhe disa punonjës të tjerë policie që ishin në dijeni të këtij problemi.

Nga informacionet e marra prej punonjësve të policisë rezultoi se, veprimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë në këtë rast ishin kryer në bazë të disa kërkesave të Drejtorit të “Alba Film” sha drejtuar Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë dhe Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë. Në këto kërkesa kërkohej ndihma e policisë për ta mbështetur atë për lirim dhe dorëzimin e një sipërfaqe trualli që posedohej nga “Orafilm” shpk. Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, me shkresën nr. 1186/1 Prot., dt. 20.02.2009, i kishte kërkuar Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë që të marrë masat e nevojshme për të mbështetur Drejtorinë e “Alba Film” sha në dt. 21.02.2009. Në vijim Komisaritati i Policisë Nr. 4 Tiranë kishte nxjerrë Urdhër Shërbimin nr. 43/B, dt. 21.02.2009, ku urdhërohej dërgimi i disa punonjësve të policisë në ndihmë të Drejtorisë së “Alba Film” sha.

Nga studimi i VKM nr. 1445, dt. 29.10.2008, rezultoi se përmbajtja e tij kishte të meta serioze sepse:

Së pari, ai nuk përshkruante dhe nuk kishte bashkëlidhur genplanin e pronës që do t’i jepej me qira “TOP CHANNEL”. Ndërsa në fakt policisë i ishte dërguar një genplan bashkëlidhur VKM-së. Nga pyetja e Drejtorit të “Alba Film” sha, rezultoi se genplani ishte porositur prej Drejtorisë së “Alba Film” sha dhe se nuk ishte pjesë e VKM-së.

Së dyti, VKM-ja nuk përshkruante si subjekt detyrues “Orafilm” shpk, për të liruar e dorëzuar hapsirat të cilat ajo posedon.

Nisur nga sa më lart, Avokati i Popullit gjykoi se ky konflikt midis “Orafilm” shpk dhe “Alba Film” sha, ishte një mosmarrveshje juridiko-civile dhe si e tillë duhej zgjidhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga juristi i “Alba Film” sha u informuam se, në muajin tetor 2008 ky konflikt kishte nisur të gjykohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesë padinë e bërë nga “Alba Film” sha.

Në këto kushte për shkak se mosmarrveshja e mesipërme ishte bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, në bazë të nenit 36 të K.Pr.Civile, asnjë

organ tjetër i administratës publike nuk ka të drejtë që të marrë në shqyrtim atë dhe të ndërhyjë për zgjidhjen e tij.

Organet e policisë, para se të jepnin mbështetjen në terren subjektit juridik “Alba Film” sha, duhet të kishin studjuar me kujdes dokumentacionin e paraqitur prej këtij subjekti.

Ndërsa lidhur me pretendimet e ankuesit për ushtrim dhune fizike ndaj tij nga punonjësit e policisë, nga ana jonë ju rekomanduam Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë që të merrnin vendim për kryerjen e ekzaminimit mjeko-ligjor të ankuesit dhe personave të tjerë që kishin pretendime për ushtrim dhune fizike nga policia. Ndërsa ankuesit dhe të dëmtuarëve të tjerë ju sugjerua që të bënin kallëzim në organin e prokurorisë.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë pezullimin e të gjitha veprimeve administrative të organeve të Policisë së Shtetit në zbatim të kërkesave të “Alba Film” sha, në dëm të “Orafilm” shpk deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Rekomandimi nuk u pranua nga organet e policisë së shtetit.

### **III. Ankesat ndaj Ministrisë së Brendëshme dhe Policisë së Shtetit, për mos respektimin e të drejtave të punonjësve të tyre**

Në Institucionin tonë gjatë vitit 2009 janë bërë 13 ankesa nga punonjës Policie në detyrë dhe ish punonjës Policie në reformë, për largime të padrejta nga puna dhe për mosdhënie të pagës kalimtare apo pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

Ankesat e punonjësve të Policisë i kemi vlerësuar me prioritet dhe përkushtim. Gjykimi ynë është se, nëse nuk do të kujdesemi për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të punonjësve të Policisë, nuk mund të kemi të drejtë morale që të kërkojmë prej tyre respektimin e të drejtave të të tjerëve. Përmbushja e detyrimeve të shtetit në cilësinë e punëdhënësit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore do të sjellë pamëdyshje motivim dhe përkushtim të punonjësve të Policisë në kryerjen e misionit ligjor të Policisë të përcaktuar në nenin 1 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, atë ... të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Këtë gjykim dhe vlerësim për të respektuar të drejtat kushtetuese dhe ligjore të vetë punonjësve të Policisë, ja kemi bërë të ditur dhe theksuar herë pas here titullarëve të Ministrisë së Brendëshme dhe të Policisë së Shtetit, si nëpërmjet rekomandimeve për çështje të caktuara, ashtu edhe publikisht në media, në aktivitete të përbashkëta apo në



analiza vjetore të organeve të Policisë ku kemi qënë të ftuar. Si shëmbuj të rasteve të trajtimit të këtij problemi mund të përmëndim:

1. Ankesa e bërë në institucionin tonë nga Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe 21 qytetarë (punonjës të Policisë së Shtetit në detyrë dhe ish punonjës të Policisë së Shtetit të cilët trajtoheshin me pagesë kalimtare apo me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi). Këtë rast e kemi trajtuar hollësisht në rubrikën “Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese”.

#### **IV. Rekomandime në fushën legislative drejtuar Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.**

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave të ndryshme ne kemi konstatuar se shkelen të drejtat kushtetuese e ligjore të punonjësve të Policisë për shkak të mos nxjerrjes dhe miratimit të akteve normative nënligjore në bazë e për zbatim të ligjeve. Kështu p.sh. mund të përmëndim:

1. Ankesa e disa ish punonjësve të policisë të cilët ishin nxjerrë në lirim për shkak të reformës së bërë në Policinë e Shtetit. Pas nxjerrjes në lirim ata janë trajtuar me pagesë kalimtare deri më 30 Qershor 2009 në bazë të ligjit nr. 8661, dt. 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”. Pas muajit qershor ankuesve, por edhe dhjetra kolegëve të tyre, ju ishte ndërprerë pagesa kalimtare për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri, nr. 10142, dt. 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i cili e ka ulur kohën e trajtimit me pagesë kalimtare nga tre vjet, në dy vjet. Pas ndërprerjes së pagesës kalimtare, meqënëse ankuesit i plotësonin kriteret ligjore për të përfituar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kishin plotësuar e dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar këtë pension. Mirëpo, megjithëse dokumentacioni i tyre ishte dërguar në institucionet përkatëse, ata nuk ishin trajtuar me pagesë për disa muaj. Gjithashtu ankuesit na shkruanin se për shkak të mos pagesës ata janë vënë në vështirësi financiare. Dikush prej tyre kishte marrë kredi në bankë dhe nuk kishte të ardhura për të shlyer këstet e saj, ndërsa disa të tjerë nuk kishin asnjë burim tjetër të ardhurash në familje për të jetuar.

Për të bërë të mundur përfitimin e të drejtave të garantuara e ligj, ata i ishin drejtuar organeve eprore me kerkesa e ankesa por problemi nuk ju ishte zgjidhur.

Duke e vlerësuar si shqetësues këtë problem i kërkua shpjegime Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ai na ktheu pëgjigje për këtë shqetësim të ngritur nga ankuesit. Midis të tjerave ai na sqaroi se, kjo

kategori ish punonjës të policisë nuk ishte trajtuar akoma me pension të parakohshëm, sepse në bazë të paragrafit 2 dhe 3 të nenit 4, të ligjit nr. 10142, dt. 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, për të përfituar nga ky ligj duhet të përcaktohet paga referuese. Pagat referuese të njësuara dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese për të gjithë karrierën, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Mospagimin e kësaj kategorie personash, të cilët ishin të konsiderueshëm në numër, për një priudhë kohore për më shumë se tre muaj dhe për më tepër kur nuk dihej akoma se kur do të rifillonte pagimi i tyre, e konsideruam si një qëndrim të padrejtë të organeve të administratës publike dhe njëkohësisht si shkelje të të drejtave ekonomiko-financiare të punonjësve të policisë të nxjerrë në reformë, të parashikuara në ligj dhe konkretisht në nenet 7, gërma “d”, 13 dhe 14 të ligjit nr. 10142, dt. 15.05.2009. Nxjerrja e këtij akti nënligjor nga Këshilli i Ministrave ishte edhe një detyrim i parashikuar në nenin 30 të këtij ligji. Me qëllim që të mos krijoheshin pengesa në zbatimin e ligjit, VKM-ja duhet të ishte nxjerrë menjëherë pas hyrjes në fuqi të tij, më dt. 28.06.2009, por kjo nuk ishte bërë.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij problemi, i rekomanduam Ministrin të Brendshëm dhe Drejtorin të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përgatitjen e menjëhershme të projektit të VKM-së “Për pagat referuese të njësuara dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese për të gjithë karrierën” dhe dërgimin e tij për miratim në Këshillin e Ministrave, Këtë rekomandim ja dërguam për dijeni edhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Rekomandimi u pranua dhe nga Kryeministria dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, u informuam se me urdhër të Kryeministrit ishte ngritur grupi ndërinstitucional i punës për përgatitjen e projektvendimit.

2. Ankesa e disa banorëve të qytetit Orikum. Ankuesit, përveç të tjerave, pretendonin edhe për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë së FNSH-së Fier në datat 27 dhe 28 Tetor 2009, gjatë protestave që banorët e Orikumit kanë bërë në këtë qytet për të ndaluar fillimin e punimeve në tokat që ata i kishin marrë në përdorim. Nga ana jonë më dt. 28.10.2009 u dërgua në Orikum një ekip ekspertësh, të cilët morën takim me një grup banorësh protestues, me Kryetarin e Bashkisë së Orikumit, me drejtuesit e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë dhe drejtues të Policisë së Shtetit të cilët kishin shkuar në Vlorë për këtë problem.

Nga shqyrtimi i ankesave të banorëve, informacionit të dhënë nga Kryetari i Bashkisë Orikum dhe nga drejtuesit e policisë vendore e qëndrore, si dhe dokumentacioni i administruar nga ana jonë rezultoi se:

Banorët protestues ishin pajisur nga komisioni i ndarjes së tokës të NB-së Orikum me akte të marrjes së tokës në përdorim në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën”. Më pas toka që ata kanë patur në përdorim ishte shndërruar në truall dhe i ishte kthyer e kompensuar personave të tjerë. Pronarët e truallit kishin lidhur kontrata me shoqëritë ndërtuese për ndërtimin e pallateve. Nga KRRT-ja e Bashkisë Orikum ishin miratuar lejet e ndërtimit për dy objekte, pallate, në favor të shoqërive ndërtuese respektivisht “Enri” shpk me vendimin nr. 8/8, dt. 17.12.2008 dhe “Ervis-En” shpk, “Binaj” shpk, “Beis” shpk e “Annabell” shpk me vendimin nr. 8/4, dt. 17.12.2008.

Pa u futur në rregullsinë dhe vlefshmërinë e këtij procesi për titujt e pronësisë dhe lejet e ndërtimit, ne u ndalëm vetëm në aspektin e ndërhyrjes së Policisë së Shtetit në këtë rast, për ofrimin e shërbimit subjekteve private. Ndërsa pretendimi i ankuesve për përdorim dhune ndaj tyre nga punonjësit e policisë u bë objekt i një materiali tjetër.

Mbi bazën e lejeve të ndërtimit, subjektet ndërtuese kishin tentuar disa herë të fillonin punimet për ndërtimin e objekteve përkatëse por ishin penguar nga banorët. Të ndodhur në këto kushte shoqëritë ndërtuese gjatë muajit Tetor 2009, në datat 12 dhe 13 i kanë drejtuar kërkesë, bashkëlidhur edhe lejet e ndërtimit, organeve të policisë vendore Vlorë për ndihmë dhe ndërhyrje me forca policie. Meqënëse në organet e policisë vendore kishin bërë ankesa edhe përfaqësuesit e shoqatës së mbrojtjes së tokës bujqësore Orikum për mbivendosje të pronave në vendin ku ishin miratuar lejet e ndërtimit, nga Komisariati i Policisë Vlorë i ishte kërkuar një informacion Kryetarit të Bashkisë Orikum lidhur me konfliktin dhe për rregullsinë e dokumentacionit të shoqërive ndërtuese. Pasi nga bashkia është konfirmuar rregullsia e dokumentacionit të subjekteve ndërtuese, Shefi i Komisarariatit të Policisë Vlorë me shkresën nr. 179/9 Prot., dt. 24.10.2009, i ka kërkuar Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit z. Rasim Borishi mbështetje me shërbime policie të FNSH-së. Zv.Drejtori i Përgjithshëm i

Policisë së Shtetit z. Rasim Borishi me shkresën nr. 3891/1 Prot., dt. 27.10.2009, drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, ndërmjet të tjerave konfirmon marrjen në konsideratë të kërkesës për mbështetje me Forca të Ndërhyrjes së Shpejtë në momentin që Policia e Vlorës do të kryente mbështetjen e subjekteve ndërtuese për fillimin e punimeve.

Nga studimi i kërkesës së Komisarariatit të Policisë Vlorë dhe nga përgjigjia e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë konstatuam, se në këto shkresa nuk ishte pasqyruar baza ligjore e kryerjes së këtyre veprimeve mbështetëse me forca policie të Komisarariatit të Policisë Vlorë dhe të FNSH-së, të cilat varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Në ligjin nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, kreut të IV-të, i cili rregullon marrëdhëniet e Policisë së Shtetit me persona dhe organizma të tjerë, dhe konkretisht në nenin 48 përcaktohet se:

“1. Mbi bazën e kërkesës së personave juridikë e fizikë, publikë ose privatë, si dhe në varësi të mundësive që ka, Policia ofron shërbime policore shtesë kundrejt pagesës.

2. Llojët e shërbimeve dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Në rastin konkret edhe në takimin me drejtuesit e përmëndur më sipër, Shefin e Komisarariatit dhe Drejtorin e Policisë së Qarkut Vlorë, si dhe Zv.Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, rezultoi që ata nuk e njihnin dhe nuk ishin në gjendje të kuptonin dhe interpretonin saktë dispozitën përkatëse.

Sikurse rezulton nga përmbajtja e nenit 48 të ligjit, Policia e Shtetit e ka atributin ligjor të ofrimit të shërbimeve policore shtesë personave juridikë e fizikë, publikë ose privat kundrejt pagesës. Mirëpo megjithëse kishte kaluar një afat më shumë se dy vjet që ligji kishte hyrë në fuqi, nga pyetja e drejtuesve të policisë dhe shkresat e mësipërme rezultoi se nuk ishte miratuar akoma akti nënligjor, VKM-ja, e cila do të bëjë rregullimin ligjor lidhur me llojet e shërbimeve policore që ofron policia dhe tarifat e pagesës për këto shërbime. Pra kishte një vakum ligjor të pajustificuar për rregullimin e këtyre marrëdhënieve juridike. Në bazë të nenit 129 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri që të nxjerrin aktet normative në zbatim të këtij ligjit brenda një viti nga hyrja në fuqi e tij.

Ne konkluduar se, perderisa nuk ishte plotësuar baza ligjore dhe perderisa në rastin konkret nga personat juridikë privatë, subjektet ndërtuese, nuk ishte bërë ndonjë pagesë për shërbimin e policisë, sikurse përcaktohet në ligj, Policia e Shtetit nuk duhet të kishte ofruar këtë shërbim personave juridikë privatë, jo vetëm me punonjës të policisë të FNSH-së, por as edhe me punonjës të policisë vendore. Nëse nga ana e qytetarëve protestues do të kryheshin vepra penale ndaj subjekteve

ndërtuese, policia e ka për detyrë ligjore që të ndërhyjë dhe të kryejë veprimet e nevojshme proceduriale.

Pra në rastin konkret kishte shkelje nga Policia e Shtetit, sepse kishte dërguar forcat e policisë pa qënë përcaktuar më parë nga Qeveria, llojet dhe mënyrat e shërbimit policor që ofrohen prej saj, si dhe pagesat përkatëse. Për këto arsye ky veprim duhej analizuar dhe duheshin nxjerrë konkluzionet përkatëse.

Për zgjidhjen e problemeve të kësaj natyre në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës dhe në nenit 24 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” i rekomanduar Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përgatitjen e menjëhershme të projektit të VKM-së “Për rregullimin e marrëdhënieve të Policisë së Shtetit me personat juridikë e fizikë, publikë ose privatë, për llojet e shërbimeve policore shitesë që ofron policia dhe tarifatat e pagesës për këto shërbime”, si dhe dërgimin e tij për miratim në Këshillin e Ministrave, në bazë dhe për zbatim të neneve 48 dhe 129 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Këtë rekomandim ja dërguam për dijeni edhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Rekomandimi u mirëprit dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, u informuam se është ngritur grupi i punës me ekspertë nga të gjitha fushat e policisë dhe po punon për përgatitjen e draft-projektit të VKM-së.

3. Rasti i ndjekur me iniciativë pas bërjes publike nga disa media të shqetësimit të shtetasve lidhur me vlefshmërinë e përdorimit të letërnjoftimeve të reja.

Sipas mediave, disa institucione publike dhe jopublike në vend vazhdonin që t’u kërkonin qytetarëve me qëllim identifikimi çertifikata me fotografi edhe në rastet kur ata ishin të pajisur me letërnjoftimet e reja. Qëndrime të tilla nga institucione të ndryshme sillnin si pasojë detyrimin e qytetarëve, të cilët ishin pajisur me letërnjoftimet e reja, që t’u drejtoheshin përsëri zyrave të gjendjes civile, të harxhonin kohë duke mbajtur radhë dhe të bënin pagesa të panevojshme për marrjen e çertifikatave.

Mbi bazën e këtij njoftimi publik nga ana jonë u bënë verifikime në disa nga zyrat e gjendjes civile në Tiranë. Nga komunikimi me punonjësit e zyrave të gjendjes civile dhe me disa qytetarë të cilët gjendeshin në këto zyra për të marrë çertifikata me fotografi, rezultoi se shqetësimi i mesipërm i ngritur nga media qëndronte. Disa institucione publike dhe jopublike vazhdonin që t’u kërkonin qytetarëve që paraqiteshin pranë tyre për të kryer veprime të ndryshme, çertifikata me fotografi me qëllim identifikimin e tyre. Këta shtetas megjithëse ju kishin paraqitur këtyre institucioneve letërnjoftimet e reja, punonjësit e këtyre institucioneve nuk e kanë pranuar këtë dokument identifikimi për të kryer veprimet e

nevojshme me shtetasit. Disa nga institucionet që vazhdonin t'u kërkonin qytetarëve çertifikata me fotografi me qëllim identifikimi ishin: Ministria e Drejtësisë kur shtetasit shkonin për të marrë vërtetimin e gjendjes gjyqësore, Arkat e pagesave të PTT-së, kur shtetasit shkonin për të tërhequr pensionet, Drejtoritë e Shkollave të Mesme për nxënësit maturantë, kompanitë e telefonisë celulare, bankat dhe ambasadat e shteteve të huaja të akredituara në Republikën e Shqipërisë, etj. Pretendimi i këtyre institucioneve për të mosnjohur e pranuar letërnjoftimin e ri si dokument identifikimi ishte se, gjeneralitetet e pasqyruara në të nuk ishin të plota, sepse nuk kanë të pasqyruar atësinë dhe amësinë e mbajtësit të saj.

Ndërkohë nga verifikimet tona konstatuam me kënaqësi që kishte edhe organe të administratës publike që i njihnin dhe pranonin për efekt dokumentacioni letërnjoftimin e ri. Të tilla institucione ishin: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, e cila nëpërmjet një shkresë Nr. 2120 Prot., datë 03.04.2009 kishte njoftuar të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor në vend që të pranonin aplikime nga shtetasit e pajisur me letërnjoftimin e ri, duke e njohur këtë dokument identifikimi. Ky njoftim u drejtohej edhe autoshkollave për plotësimin e dosjes së kursantit.

Në nenin 2, pika 1 e ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002 "Për letërnjoftimin e shtetasve shqiptarë", i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: "Letërnjoftimi i personit është dokumenti bazë i përhershëm që shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë". Mirëpo në kundërshtim me këtë përcaktim ligjor, ky dokument nuk po njihej e pranohej akoma nga disa institucione. Ne konstatuam se qëndrime të tilla të disa institucioneve publike e private jo vetëm që nuk ishin në shërbim të qytetarëve, por i sorollasnin ata e ju sillnin shqetësime të panevojshme atyre. Në fakt këto qëndrime praktikisht bënë çvlerësimin e letërnjoftimit të ri. Ndërkohë këto qëndrime ndikonin negativisht edhe ndaj pjesës së popullatës që nuk ishin të pajisur me letërnjoftimin e ri, duke ju ulur interesin për aplikimin dhe marrjen e këtij dokumenti të rëndësishëm ligjor.

Për të ndryshuar sa më shpejtë këtë situatë të krijuar nga qëndrime të papërgjegjshme të nëpunësve të disa institucioneve publike dhe jopublike, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës tonë dhe në nenin 21, gërma "c" të ligjit "Per Avokatin e Popullit", i rekomanduam Kryeminitrit të Republikës së Shqipërisë, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, që të nxjirrej një akt nënligjor nga ana e Qeverisë nëpërmjet të cilit të njoftoheshin dhe detyroheshin të gjitha institucionet publike dhe jopublike për të njohur dhe pranuar nga shtetasit letërnjoftimin e ri si dokumentin bazë të identifikimit të tyre. Gjithashtu rekomanduam që të

njoftoheshin, për pajisjen e shtetasve shqiptarë me letërnjoftimin e ri, të gjitha ambasadat e shteteve të huaja dhe organizatat ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe të pranonin këtë dokument ligjor.

Rekomandimi u mirëprit dhe Këshilli i Ministrave brenda tre ditëve miratoi vendimin nr. 418 dt. 27.04.2009 “Për njohjen dhe përdorimin e letërnjoftimit si dokument identifikimi”.

4. Rasti i ndjekur me iniciativë pas bërjes publike nga disa media të shqetësimeve lidhur me procesin e pajisjes së shtetasve me letërnjoftime.

Ne gjykojmë se procesi i pajisjes së shtetasve shqiptarë me letërnjoftime është me rëndësi të veçantë kombëtare dhe një parakusht për procesin e lehtësimit dhe liberalizimit të vizave për shtetasit shqiptarë, si dhe për integrimin e vendit tonë në strukturat Evropiane. Gjithashtu Avokati i Popullit ka shprehur vlerësimin e tij pozitiv për angazhimin e Qeverisë shqiptare lidhur me pajisjen e shtetasve me letërnjoftime dhe pasaporta biometrike.

Duke e vlerësuar seriozisht këtë problem, një ekip i Zyrës së Avokatit të Popullit, i kryesuar nga vetë Avokati i Popullit, në datat 10 dhe 11 Mars 2009, bëri disa veprime hetimore administrative si, inspektimi i 9 Njësi Bashkiake në qytetin e Tiranës dhe konkretisht i njësi nr. 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9, 10 e 11, në zyrat ku bëhet aplikimi për pajisjen e shtetasve me letërnjoftime dhe marrja e tyre, pranë zyrave të gjendjes civile. Gjithashtu takuam disa drejtues të Njësi Bashkiake, u pyetën disa shtetas që u gjetën në vendet e aplikimit dhe marrjes së letërnjoftimeve, disa nëpunës të zyrave të gjendjes civile dhe punonjës (operatorë) të shoqërisë prodhuese të letërnjoftimeve “Aleat” etj. Më datën 11 Mars 2009 edhe Zv.Ministri i Brendshëm, z. Poni u bashkua me ne për disa verifikime të konstatimeve tona.

Në përfundim të këtyre veprimeve rezultoi se:

### **I. Lidhur me procesin e pajisjes së shtetasve me letërnjoftime u konstatuan disa probleme si më poshtë:**

1. Në disa Njësi Bashkiake, si 1, 2, 5 dhe 9 kishte radhë njerëzish, sikundër në disa të tjera, si në ato 3, 4, 10 e 11, nuk kishte radhë. Ne konkludim se, sipas gjendjes së konstatuar nga inspektimi i bërë, shërbimi i aplikimit nuk ishte i ngarkuar, pra punonte jo me kapacitet të plotë. Prandaj, nga të gjithë organet dhe palët e interesuara duhet të nxitej publiku që të aplikonte sa më parë dhe sa më shumë, me qëllim që të mos krijohej situatë piku, pra mbingarkesë afër datës 28 Qershor 2009 (data e zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme në vend).

2. Qytetarët ankoreshin se nuk ju caktohej një datë (afat) i saktë për t’u paraqitur që të merrnin letërnjoftimet e plotësuara. Afati 15 ditor, i shpalluar, nuk ishte respektuar. Në dy ditët e inspektimit ishin të gatshme për t’iu dhënë letërnjoftimet atyre qytetarëve që kishin aplikuar deri para

datës 5 Shkurt 2009. Pra, realisht afati i dorëzimit ka qënë mbi një muaj pas datës së aplikimit. Qytetarët u ankuan se ishin detyruar që të paraqiteshin disa herë pranë pikave të dorëzimit dhe asnjëherë nuk merrnin një datë të saktë. Po kështu edhe punonjësit e kompanisë që bënë shpërndarjen u ankuan për këtë mënyrë shpërndarje. Në disa njësi operatorët u ankuan se në disa raste, procesi vonohej sepse kishte ndërprerje të rrjetit kompjuterik.

3. Kishte shumë qytetarë që u ankuan se kishin shkuar disa herë për të marrë letërnjoftimet dhe se megjithëse kishin aplikuar në muajin janar 2009, ato nuk ishin prodhuar. Me qëllim që qytetarët të mos vinin disa herë dhe të mosqëndronin në radhë për të tërhequr letërnjoftimet, menduam që t'i kërkohej firmës prodhuese që pas prodhimit të letërnjoftimit, të bënte nëpërmjet operatorëve njoftimin në telefon të qytetarëve. Numrat e telefonave kompania i kishte në çdo fletë aplikimi. Këtij procesi do t'i shërbente edhe afishimi në Njesitë Bashkiake të listave me emrat e shtetasve të cilëve u ishin prodhur letërnjoftimet.

4. Disa qytetarë pensionist kishin ankesa për “çmimin e lartë” të letërnjoftimit. Ky problem u ngrit si shqetësim edhe nga drejtues të pushtetit vendor. Sipas tyre, qytetarët që nuk kishin të ardhura, apo ishin me asistencë sociale, ishin indiferent ndaj këtij procesi dhe nuk vinin për të aplikuar për t'u pajisur me letërnjoftime.

5. Disa shtetas që sipas VKM-së përfitonin rimbursim për çmimin e paguar të letërnjoftimit, nuk e kishin marrë shumën e rimbursuar, ndonëse ata kishin aplikuar dhe kishin marrë letërnjoftimet. Ata nuk ishin të informuar se si do t'i bëhej rimbursimi.

6. Në disa Njësi Bashkiake, ku kishte radhë, nuk shfrytëzoheshin të gjitha mjetet e aplikimit për pajisjen e shtetasve me letërnjoftime. Ky fenomen ndodhte për shkak se disa operatorë të punësuar fillimisht në procesin e aplikimit, ditët e fundit kishin kaluar tek procesi i shpërndarjes së letërnjoftimeve si p. sh. në njësitë nr. 1, 5 dhe 9.

7. Disa shtetas kishin ankesa se sorollateshin lidhur me gabimet e bëra në regjistrat e gjendjes civile. Në këto raste atyre ju kërkohej që të shkonin e merrnin çertifikata në zyrat e gjendjes civile ku kishin patur më parë vendbanimin. Kishte edhe nga ata që për shkak të natyrës së punës, kishin ndryshuar disa herë vendbanimin e tyre dhe nëse kishin gabime, ata duhet të shkonin në të gjitha rrethet ku kishin patur vendbanimin për të marrë çertifikata me gjeneralitete të rregullta.

8. Nuk ishte parashikuar ndonjë zgjidhje për të sëmurët, invalidët e ndryshëm dhe tepër të moshuarit, të cilët nuk mund të shkonin në vendet e aplikimit dhe sidomos në ato zyra aplikimi që ndodheshin në katet e dyta të ndërtesave.

9. Në disa raste procesi vonohej sepse kishte ndërprerje të funksionimit të pajisjeve të aplikimit.



10. Nuk ishte parashikuar ndonjë zgjidhje për pajisjen me letërnjoftime të personave të burgosur dhe të paraburgosur.

11. Shtetasit e lindur më datën 29 Shkurt, nuk mund të aplikojnë për pajisjen e tyre me letërnjoftime, sepse kur hapej faqja e regjistrit elektronik, datëlindja e tyre ju ndryshohej në mënyrë automatike duke u bërë më 1 Mars.

## **II. Në zyrat e gjendjes civile u konstatuan edhe problemet si më poshtë.**

1. Shqetësimi i ngritur edhe më parë nga Avokati i Popullit lidhur me mosçregjistrimin nga regjistrat e gjendjes civile të shtetasve të vdekur dhe atyre të cilëve ju ishte hequr shtetësia shqiptare ishte evident.

2. Nga disa nëpunës të gjendjes civile përfshi edhe juristë, nuk njihej e drejta ligjore e parashikuar në nenin 51/7 të ligjit nr. 8950, dt. 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, sipas të cilit, kur shërbimi i gjendjes civile ka të dhëna se persona të vdekur vazhdojnë të qëndrojnë të regjistruar në regjistrin themeltar, mund të ngrejë padi në gjykatë për të vërtetuar vdekjen.

3. Nga disa nëpunës të tjerë, megjithëse njihej kjo e drejtë ligjore, ajo nuk ushtrohej për motive nga më të ndryshmet.

4. Në regjistrin elektronik kishte pasaktësi të gjeneraliteteve të shtetasve, kishte dublime të fshehura emrash. Ky fenomen ndodhte në rastet kur vajzat martoheshin dhe merrnin mbiemrat e bashkëshortëve, kur kishte ndryshim emrash, korrigjim të gjeneraliteteve etj.

5. Programi kompjuterik kishte mangësi, sepse nuk ishin hedhur të gjithë emrat e fshatrave të vendit. Ndërsa në rastet kur nëpunësi i gjendjes civile bënte ndryshimin e vendlindjes së shtetasit, kur ajo ishte fshat, për shkak se ishte shënuar gabim, atëhere fshihej emri i rrethit të cilit i përkiste ai fshat. Këto mangësi krijojnë probleme për disa shtetas, të cilët ishin pajisur me dokumenta të lëshuara më parë në emër të tyre nga autoritetet tona shtetërore dhe në bazë të tyre edhe nga shtete të tjera (për emigrantët).

6. Në listat e zgjedhësve, ndonëse raste të rralla, mungonin emrat e disa qytetarëve votues.

7. Po kështu kishte edhe raste që disa zgjedhësve ju ishin ndryshuar qëndrat e votimit.

8. Nëpunësit e gjendjes civile ngritën shqetësimin se në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës nuk paguheshin për kohën e punës jashtë orarit zyrtar, e cila ishte e përditshme dhe për disa muaj.

## **III. Mungesa e transparencës nga Shoqëria “Sagem” dhe ajo prodhuese “Aleat”, e cila ka marrë përsipër pajisjen me letërnjoftime të shtetasve shqiptarë.**

Ky fenomen u konstatua nga komunikimi me disa operatorë të punësuar nga kjo shoqëri, të cilët na thanë se kishin porosi për të mos dhënë informacione lidhur me problemet e hasura, afatet e prodhimit etj.

Konkluzioni i mësipërm u konfirmua edhe nga qëndrimi i mbajtur nga përfaqësuesit e kësaj shoqërie në dt. 11.03.2009, kur dy përfaqësues të zyrës tonë shkuan në selinë e shoqërisë prodhuese për të marrë një informacion rreth këtij procesi dhe informacioni i kërkuar nuk na u dha. Sipas tyre, informacionin ja jepnin vetëm Ministrisë së Brendshme dhe se atje duhet ta merrnim edhe ne.

Për mbarëvajtjen e këtij procesi të rëndësishëm dhe për t'i krijuar më shumë mundësi dhe kushte lehtësuese qytetarëve për t'u pajisur me letërnjoftime, i rekomanduam Ministrit të Brendshëm si më poshtë:

1. Marrjen e menjëhershme të masave të nevojshme teknike dhe organizative për korrigjimin e mangësive të konstatuara dhe mbarëvajtjen e procesit të pajisjes me letërnjoftime të shtetasve shqiptarë, si dhe krijimin e më shumë mundësive dhe të kushteve lehtësuese për qytetarët.

2. T'i propozohet Qeverisë ulja e mëtejshme e çmimit të letërnjoftimit për pensionistët dhe shtetasit e tjerë të cilët nuk kishin të ardhura, si dhe rimbursimi sa më i shpejtë për ata që kanë aplikuar.

3. T'i kërkohej shoqërisë "Sagem" dhe nënkontraktorëve të saj që të njoftohen qytetarët për ditën që duhet të marrin dokumentin.

4. T'i kërkohej shoqërisë zbatimin e parimit të transparencës në marrëdhënie me publikun dhe me mediat.

5. Të na kthehet përgjigje për Rekomandimet tona të dërguara më parë, lidhur me çregjistrimin e të vdekurve dhe personave që ju ishte hequr shtetësia shqiptare.

Rekomandimet e mësipërme u mirëpritën dhe u morën në konsideratë. Në zbatim të tyre Këshilli i Ministrave nxorri disa vendime, siç mund të përmendim, V.K.M nr. 361, dt. 1.4.2009 "Për një shtesë në vendimin nr. 15, dt. 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtetasve në nevojë"; VKM nr. 366, dt. 15.4.2009 "Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtetasve në nevojë", si dhe VKM e datës 1.5.2009 "Për procedurat e pajisjes së shtetasve pa pasaportë, që nuk përfitojnë kompensim nga VKM nr. 366, dt. 15.4.2009 "Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtetasve në nevojë".

Me këto vendime Qeveria bëri kompensimin e çmimit të letërnjoftimit për disa shtresa shoqërore në masën e plotë, ndërsa për disa të tjera në masa të ndryshme.

Gjithashtu, nga verifikimet e bëra në disa zyra të gjendjes civile në Tiranë, rezultoi se u bënë edhe korrigjimet e mangësive në sistemin kompjuterik për regjistrimin e shtetasve dhe gabimeve të gjeneraliteteve në regjistrin kombëtar të shtetasve.

#### **IV. Inspektimi i ambjenteve të shoqërimit e të sigurisë si dhe mënyra e trajtimit të shtetasve të shoqëruar, ndaluar e arrestuar nga punonjësit e Policisë së Shtetit.**

Inspektimi i ambjenteve të shoqërimit e të sigurisë si dhe mënyra e trajtimit të shtetasve të shoqëruar, ndaluar e arrestuar nga punonjësit e Policisë së Shtetit ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë një infrastrukturë të pa përshtatshme për kryerjen e misionit të saj, si dhe elementë të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht e të pa trajnuar me konceptet e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit krahas veprimtarisë së tij në disa aspekte të tjera të kësaj fushe, ka kryer gjatë vitit 2009 në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, rreth 40 inspektime, ri-inspektime dhe kontrole tematike në të gjitha Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, Komisarariatet dhe Stacionet e Policisë, institucione këto që janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brëndshme.

Gjëndja e konstatuar nga këto inspektime si dhe mënyra e kryerjes së tyre do t'i trajtojmë në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Inspektimet janë kryer në orë të ndryshme, paradite gjatë orarit zyrtar, pasdite si dhe në orë të vona të natës. Gjatë inspektimeve janë konstatuar këto probleme:

Lidhur me shoqërimin e shtetasve dhe ambjentet ku mbahen këta persona u konstatua se;

Nga kqyrja e librit të shoqërimit të shtetasve si dhe ballafaqimin e tij me praktikën e punës së policisë, rezulton se shoqërimi i personave në organet e policisë bëhet jo gjithmonë sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ "a" dhe "b" dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit". Kështu konstatoam se, shoqërohen në polici persona jashtë kriterëve ligjore të përcaktuara në dispozitat e mësipërme në Komisariatin e Policisë Nr.4 dhe 5 në Tiranë, në Komisarariatet e Policisë Peshkopi, Vlorë, Shkodër dhe Sarandë. Por ndodh edhe që të trajtohen si të shoqëruar persona kur janë të dyshuar si autorë të veprave penale, siç ndodh në Komisariatin e Policisë Sarandë, Peshkopi, Vlorë dhe atë Nr.4 Tiranë. Edhe kur ata janë dëshmitarë të një ngjarje, raste këto për të cilat duhet aplikuar e drejta e "njoftimit për paraqitje në polici", e parashikuar në nenin 100 të ligjit "Për Policinë e Shtetit", bëhet shoqërimi i tyre në polici me detyrim.

Nga shqyrtimi rasteve të mësipërme dhe pyetja e punonjësve të policisë të cilët kishin urdhëruar shoqërimin e shtetasve në polici, rezultoi

se këto shkelje të ligjit ishin pasojë e mosnjohjes së konceptimit të ri dhe i kritereve ligjore të shoqërimit të përcaktura në ligjin e ri “Për Policinë e Shtetit”. Fatkeqësisht në radhët e policisë, duke përfshirë edhe drejtuesit e saj, vazhdon të ekzistojë konceptimi i shoqërimit të shtetasve në polici sipas ligjit të vjetër dhe të zbatohen kushtet dhe rastet e parashikuara prej tij, ndonëse ai është shfuqizuar që para më shumë se dy vjetësh.

Të shoqëruarëve në të gjitha organet e policisë ju bëhet kontrolli personal dhe ju hiqen e bllokohen sendet personale si telefona etj, veprim i cili nuk është në përputhje me ligjin. Në nenin 108 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar bllokimi i sendeve, si përjashtim vetëm në rastet kur sendet përbëjnë kërcënim të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike.

Gjithashtu konstatoam, se në rastet kur shtetasve të shoqëruar ju hiqen dhe bllokohen sendet personale, nga punonjësit e policisë nuk mbahet (hartohet) e nuk i jepet poseduesve procesvervali përkatës, siç parashikohet në nenin 108, paragrafi i dytë i ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Librat e shoqërimit të shtetasve në polici shpesh plotësohen pa shumë përgjegjësi. Në to nuk pasqyrohet saktë shkaku ligjor i shoqërimit. Kështu në Komisaratin e Policisë Nr. 4 Tiranë, ishte kapur një shtetas në kërkim, i dyshuar si autor i dy vjedhjeve dhe ai ishte ndaluar, mirëpo në librin e shoqërimit figuronte se ai ishte shoqëruar në polici për verifikim. Ka raste që shtetasit e shoqëruar nuk regjistrohen fare në librin e shoqërimit të shtetasve. P.sh në Komisaratin e Policisë Peshkopi edhe pse në raportin e shërbimit të punonjësve të policisë të datës 03.04.2009 thuhej se ishte bërë shoqërimi i shtetasve E.LI, B.M dhe K.S, në librin e personave të shoqëruar ata nuk figuronin të rregjistruar nga data 03.04.2009 deri më datën 05.04.2009. Vetëm më datën 04.02009, në orën 23.30, në librin e shërbimit të drejtimit operativ të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Dibër ishte evidentuar ngjarja e hedhjes nga dritarja e shtetasit E.LI.

Në të gjitha Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, Komisaritet e Stacionet e Policisë në vend nuk ka dhoma shoqërimi të shtetasve të ndara, për meshkujt, femrat dhe për të miturit, sipas konceptimit të bërë nga ligji i ri nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Vetëm në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier, në Komisaratin e Policisë Nr. 5 Tiranë dhe në Komisaratin e Policisë Kavajë dhomat e shoqërimit të shtetasve plotësojnë standartet e parashikuara në ligj. Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë ka 1 dhomë për femra dhe 1 për të mitur, por nuk ka për të rritur.

Dhomat e ashtuquajtura për të shoqëruar, në fakt si nga përmasat, ndriçimi ashtu edhe nga konceptimi dhe trajtimi i personave të shoqëruar, janë dhoma izolimi, sepse janë me dyer hekuri, të mbyllura me dryna dhe pa ndriçim. Në ndonjë komisarariat duhet të kalosh 3 porta hekuri për të

shkuar në dhomën e “shoqërimit”, si p.sh. në Vlorë. Por, të tilla dhoma shoqërimi, brënda dyerve të hekurta e të mbyllura, kemi konstatuar edhe në disa rrethe të tjera gjatë inspektimeve të kryera si p.sh. në Komisariatin e Policisë Pogradec, Përmet, Dibër, Sarandë, Berat e Librazhd.

Në shumicën e rasteve, “dhomat e shoqërimit” nuk janë të pajisura me stola apo karrike për t’u ulur të shoqëruarit dhe nuk janë të pastra e të lyera si dhe mungojnë tualetet.

### **Lidhur me të ndaluarit, të arrestuarit dhe ambjentet që mbahen këta persona:**

Në dhomat e sigurimit (izolimit) të organeve të mësipërme që janë inspektuar vazhdonin të qëndronin persona të paraburgosur ndaj të cilëve ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, si dhe persona të ndaluar për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim të formës së prerë, të dhënë në mungesë dhe nuk ishin dërguar në institucionet e paraburgimit dhe ato të burgimit në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për shkak të pengesave që krijonte vazhdimisht kjo e fundit. Koha e qëndrimit të tyre në ambjentet e policisë pas caktimit të masave të sigurimit varioje nga 1 deri 15 ditë. Kështu p.sh.:

- Në Komisariatin e Policisë Pogradec kishte 1 person ndaj të cilit nga gjykata ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” .
- Në Komisariatin e Policisë Nr. 4 Tiranë kishte 3 persona ndaj të cilëve nga gjykata ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”.
- Në Komisariatin e Policisë Vlorë kishte 4 persona ndaj të cilëve nga gjykata ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” dhe 1 person të ndaluar.

Vazhdon të ketë raste që të arrestuarve të mitur nuk ju sigurohet mbrojtja e detyrueshme me avokat, si dhe ndihma (asistenca) psikologjike, siç parashikohet në nenet 35 e 49 të K.Pr.Penale. Kështu p.sh. në Komisariatin e Policisë Peshkopi theksojmë faktin se, nga punonjësit e policisë në momentin e shoqërimit dhe marrjes në pyetje në polici të shtetasve të mitur E.LI, B.M dhe K.Sh nuk është vënë në dijeni psikologu ose pjestarët e familjeve të të miturve. Po ashtu pyetja e të miturve është bërë në orët e vona të natës si në datën 03.04.2009 ashtu dhe më datën 04.04.2009, duke u mbajtur në zyrat e Komisariatit të Policisë nga ora 20.30 deri pas mesnatës së ditës tjetër. Këto mosveprime vijnë në kundërshtim me kërkesat e K.Pr.Penale të parashikuara në nenet 35, 37, 48 dhe 296/1. Gjithashtu më datën 04.04.2009 shtetasit B.M dhe K.Sh janë pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Marrja në pyetje e këtyre dy shtetase është kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Pavlin Zhivani pa praninë e avokatit mbrojtës. Ndërsa shtetasi i mitur B.M është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore Admir Trupja në praninë e avokatit jo të zgjedhur prej tij, por të caktuar kryesisht nga

policia gjyqësore. Ky veprim bie ndesh me nenin 296/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Në shumicën e rasteve të arrestuarve dhe të ndaluarve, në procesverbalet e arrestimit dhe të ndalimit ju shënohet ora e përpilimit të këtyre dokumenteve dhe jo ora faktike si çasti kur atyre ju është privuar liria në fakt. Gjatë kryerjes së veprimeve verifikuese nga punonjësit e policisë, ata padrejtësisht trajtohen si të shoqëruar edhe në rastet e kapjes në flagrancë.

Në të gjitha organet që kemi inspektuar, dhomat e izolimit janë të papërshtashtme për banim dhe nuk plotësojnë standartet minimale të nevojshme për jetesë. Të gjitha janë të palyera, të mbipopulluara dhe pa dushe për t'u larë. Sikurse përmendëm edhe më sipër, ndodh që në këto dhoma të qëndrojnë persona të arrestuar për një kohë mbi 15 ditë pa u larë asnjëherë. Në disa organe ka edhe probleme të tjera shqetësuese, si në Komisariatit e Policisë Nr. 4 Tiranë dhe Lushnje ku dhomat e izolimit janë nëntokë, me shumë lagështi dhe pa ajrim. Ndërsa në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dy dhoma janë pa ajrim.

Nuk kemi konstatuar raste që të arrestuarit e mitur të mbahen së bashku me të arrestuarit madhorë.

Në disa komisariate, si në Komisariatit e Policisë Nr. 4, 6 Tiranë dhe në Vlorë, Fier, Shkodër, Pogradec, Përmet, Gjirokatër, Sarandë, Tropojë, Pukë dhe Kukës mungojnë posterat për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia.

Në të gjitha organet e policisë mungojnë formularë në gjuhë të huaj për të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar apo arrestuar kur këta janë shtetas të huaj.

Të ndaluarve dhe arrestuarve në polici, nuk ju bëhet detyrimisht kontroll mjekësor lidhur me sëmundjet që ata mund të kenë, aq më tepër kur bëhet fjalë për sëmundje ngjitëse, të cilat përbëjnë rrezik dhe mund t'i marrin edhe personat që janë në të njëjtën dhomë me të infektuarin. Ata vizitohen nga mjeku vetëm në rastet kur kanë shqetësime dhe e kërkojnë vetë atë. Normalisht mendojmë se ky kontroll duhet t'u bëhet brenda 24 orëve të para të ndalimit apo arrestimit.

Pas konstatimeve të bëra Avokati i Popullit ka paraqitur rekomandime, për çdo rast inspektimi ku janë konstatuar probleme, në të gjitha Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, Komisaritet dhe Stacionet e Policisë në varësi të tyre, duke kërkuar zgjidhje dhe përmirësim të problemeve si më poshtë:

Rikonstruksionin e ambienteve të dhomave të sigurisë dhe shoqërimit, si dhe ndarjen e tyre për persona të mitur dhe femra në të gjithë Komisaritet e Policisë në vend, sipas konceptimit të bërë në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit".

Respektimin me korrektesë të dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen ata fillimisht si të shoqëruar.

Transferimin nga ambjentet e policisë, në institucionet e paraburgimit dhe burgimit, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të të gjithë të paraburgosurve ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg” dhe e të ndaluarve për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit të tyre në mungesë me “burgim”.

Marrjen e masave që në librat e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të shtetasve të hapen rubrika për njoftimin e familjarve dhe avokatit mbrojtës.

Marrjen e masave urgjente që të ndaluarve dhe arrestuarve t’u bëhet detyrimisht kontrolli mjekësor lidhur me sëmundjet që mund të kenë, aq më tepër kur bëhet fjalë për sëmundje ngjitëse.

Vendosjen dhe ekspozimin e posterave për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia.

Sa më sipër, në muajin Nëntor 2009, përfaqësues të Avokatit të Popullit riinspektuan të gjitha Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, Komisarariatet e Stacionet e Policisë për të parë zbatimin e rekomandimit dhe u evidentua si më poshtë:

Edhe pse me inisiativën e disa prej drejtuesve të Komisariateve të Policisë, ishin bërë disa rregullime në ambjentet e shoqërimit, përsëri pika e parë e rekomandimit është e pa realizuar pasi nuk është bërë rikonstrukcioni i ambjenteve të dhomave të sigurisë dhe shoqërimit, si dhe ndarjen e tyre për persona të mitur, të rritur dhe femra sipas konceptimit të bërë në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

Avokati i Popullit vëren se megjithë interesimin e Ministrisë Brëndshme për këtë shërbim ka mangësi të cilat lidhen kryesisht me fondet që duhen lëvruar nga vetë ministria.

Nuk është realizuar pika e dytë e rekomandimit, për respektimin me korrektesë të dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve më qëllim mos trajtimin e tyre fillimisht si të shoqëruar pasi nga kqyrja e librit të personave të arrestuar e të ndaluar, u konstatua përsëri se të arrestuarit e të ndaluarit trajtohen fillimisht si të shoqëruar dhe mbas kohës së shoqërimit kryheshin veprimet proceduriale të arrestimit apo ndalimit të tyre. Gjatë kësaj kohe punonjësit e policisë kryenin veprime verifikuese dhe proceduriale ndaj tyre. Mbajtjen në këtë gjëndje punonjësit e policisë e justifikojnë me mendësinë se, “në qoftë se do t’i arrestojnë ata që në momentin e parë, atëherë nuk mund të kryejnë asnjë

veprim procedural për të provuar veprën e kryer”. Ky qëndrim dhe justifikim nuk ka mbështetje ligjore, përkundrazi bëhet në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale. Sipas neneve 30 dhe 294 të K.Pr.Penale, policia gjyqësore, atributet e të cilës i kanë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, edhe pas referimit të veprës penale në prokurori, ka të drejtë të kryejë me inisiativën e vet funksionet e saj ligjore si, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të veprës penale, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithshka që i shërben zbatimit të ligjit penal.

Sa më sipër, në këto organe, vazhdon përsëri mosrespektimi i dispozitave ligjore të K.Pr.Penale pasi në procesverbalet e arrestimit dhe të ndalimit të këtyre personave shënohej ora e përpilimit të procesverbaleve të arrestimit apo ndalimit dhe jo ora faktike, si çasti kur atyre ju është privuar liria në fakt. Duke i trajtuar në këtë mënyrë, atyre nuk ju llogaritet në kohën e paraburgimit dhe më pas edhe atë të vuajtjes së dënimit, koha gjatë së cilës bëhen verifikimet apo veprimet e ndryshme procedurale, kohë e cila mund të shkojë deri në 10 orë. Në bazë të neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Në ballafaqimin që u bë mes librit të personave të shoqëruar me librin e personave të ndaluar e arrestuar, si dhe nga komunikimi me vet punonjësit e policisë u konstatua se, nga punonjësit e policisë dhe drejtuesit e tyre nuk njihet dhe për rrjedhojë nuk zbatohet ligji i ri “Për Policinë e Shtetit” lidhur me konceptin ligjor të shoqërimit të personave në polici dhe rastet e shoqërimit. Rezulton që në shumë raste ishin shoqëruar në polici persona jashtë kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ “a” dhe “b” dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, pasi janë shoqëruar përsëri persona që kanë kryer apo dyshohen se kanë kryer vepra penale si, vrasje, vjedhje, kundërshtim të punonjësve të policisë, persona që janë në kërkim, për rrahje, persona për shkak të konflikteve midis tyre, për prishje rendi, për dhunë në familje, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor etj., megjithëse këto persona kanë qënë të identifikuar. Vlen për t’u theksuar se:

Rasti i shoqërimit për shkak të konfliktit nuk është i parashikuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Por meqënëse qëllimi i shoqërimit nga policia në këtë rast është i mirë, sepse parandalon ndodhjen e ndonjë krimi të mundshëm ndërmjet të konfliktuarve, atëherë e ritheksojmë që ky rast duhet të rregullohet në ligj.



Në rastet kur policisë i lind nevoja, për të marrë informacion për parandalimin e një rreziku, për të identifikuar persona që mund të kenë dijeni për rrezikun apo incidentin, dhe për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit, nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore për “njoftim për paraqitje në polici”, e parashikuar në nenin 100 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e policisë.

Në rastet kur policia ka informacione, se një person i caktuar mund të tregojë rrethana të dobishme për hetimin, nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore e parashikuar në nenin 312 i K.Pr.Penale, duke i thirrur ata me urdhër apo fletë thirrje dhe paralajmëruar për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje pa patur pengesë të ligjshme.

Në rastet e flagrancës, kur autori i veprës penale kapet gjatë kryerjes së veprës penale apo menjëherë pas kryerjes së saj, duhet të bëhet arrestimi i tij konform dispozitave të K.Pr.Penale dhe pa e mbajtur atë në gjëndje shoqërimi 10 orë.

Në rastet kur një person është në kërkim, për shkak se ndaj tij është nxjerrë një urdhër ekzekutimi i një vendimi penal, si dhe në rastet kur një person ka kryer më parë (është fjala kur nuk jemi në kushtet e flagrancës) apo dyshohet si autor i mundshëm i një vepre penale, ai duhet të ndalohej sipas dispozitave të K.Pr.Penale. Këto dy kategori personash (të arrestuar dhe të ndaluar) nuk duhen regjistruar në librin e shoqërimit sikurse ndodh shpesh herë, por në librin e personave të arrestuar dhe të ndaluar.

Ndërsa në rastet kur arsyeja e shoqërimit në organin e policisë është “për verifikim”, e cila ndeshet në pjesën më të madhe të rasteve të shoqërimeve, është e përgjithshme dhe ka nevojë që të specifikohet konkretisht se për çfarë verifikohet. Nga verifikimet e bëra në librat e shoqërimit dhe pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se, arsyeja e shoqërimit shënohet “për verifikim” edhe kur në fakt personi shoqërohet për raste të kryerjes së një vepre penale.

Në librat e shoqërimit nuk regjistrohet njoftimi i familjareve të të shoqëruarëve. Kujtojmë se, njoftimi i familjarëve të të shoqëruarit për shoqërimin e tij në polici dhe arsyet ligjore, përbën detyrim ligjor për punonjësit e policisë, i cili është parashikuar në nenin 107 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Megjithëse nga punonjësit e policisë u pretendua se bëhet njoftimi i familjarëve, mirëpo fakti që nuk pasqyrohet në libër ky veprim (emri dhe numri i telefonit të të njoftuarit), lë vend për dyshime. Por ka edhe raste të regjistrimit në libër të numrave telefonik fiktiv, sikur janë njoftuar të afërmit e të shoqëruarit. Këto raste i kemi konstatuar gjatë një sondazhi që bëmë në Komisariatet e Policisë Lezhë dhe Pukë. Në prezencë të Shefave të Komisariateve përkatëse u telefonuan nga ekspertët në numrat e telefonit të regjistruar nga policia. Mirëpo u

konstatua se disa numra telefoni ishin regjistruar në mënyrë fiktive, sepse ishin të pa disponueshëm dhe në disa të tjerë personat që komunikuan deklaruan se nuk ishin telefonuar e njoftuar nga policia për rastet për të cilat policia pretendonte se i kishte njoftuar.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se, të shoqëruarve në polici ju bëhej përsëri kontrolli personal pa përjashtim.

Lidhur me kontrollin e të shoqëruarëve sjellim në kujtesë se, në nenin 106, pika 3 e ligjit “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar e drejta e punonjësit të policisë, që mund të bëjë kontrollin dhe kqyrjen fizike me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të sëmurdje mendore, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmurdje ngjithëse. Pra vetëm në këtë rast mund të ushtrohet kontrolli fizik i personit të shoqëruar dhe jo në të gjitha rastet e shoqërimit. Ndërsa në nenin 108 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar bllokimi i sendeve, si përjashtim vetëm në rastet kur sendet përbëjnë kërcënim të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike.

Kontrolli i personave të shoqëruar përbën shkelje të hapur të të drejtës kushtetuese të paprekshmërisë personale të personit. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 37/3 të Kushtetutës tonë, ku thuhet se: “Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik”.

Njëkohësisht ky veprim vjen në kundërshtim edhe me dispozitat e K.Pr.Penale dhe konkretisht me nenet 202 e vijues, të cilat parashikojnë kontrollin e personit. Në nenin 202 të K.Pr.Penale parashikohet se:

“Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale, gjykata merr vendim për kontrollin personal....

Në rast flagrancë ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur dhe që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 299”.

Në ambjentet e shoqërimit ku në fakt mbahen shtetasit e shoqëruar nuk ka postera me të drejtat ligjore të të shoqëruarve.

Të arrestuarve dhe të ndaluarve në polici, megjithëse mbahen për pak ditë, përsëri nuk ju bëhet detyrimisht kontroll mjekësor lidhur me sëmurdjet që mund të kenë, aq më tepër kur bëhet fjalë për sëmurdje ngjithëse, të cilat përbëjnë rrezik për përhapje edhe tek personat që qëndrojnë në të njëjtën dhomë me të infektuarin. Ata vizitohen nga mjeku vetëm në rastet kur kanë shqetësime dhe e kërkojnë vetë atë. Normalisht ky kontroll duhet t’u bëhet brënda 24 orëve të para të ndalimit apo arrestimit.

Në disa Komisariate Policie si Fier, Elbasan dhe Lushnje në librat e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të shtetasve janë hapur rubrika për njoftimin e familjarve dhe avokatit mbrojtës.

Ekspozimi i posterave për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia është konstatuar ne Komisariatet e Policise Nr.1,2,3,4,5,6 Tiranë, Shijak, Kavajë, Ersekë, Peqin dhe Krujë.

Nga sa më lart, lind nevoja që edhe në të ardhmen Avokati i Popullit të vijojë të ndjekë me angazhim maksimal problemet e hasura në përfomancën e policisë, duke insistuar në përmbushjen e standarteve ligjore për respektim e të drejtave të njeriut.

#### **V. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga Policia.**

Në raportet e viteve të fundit, në mënyrë të përsëritur kemi bërë disa rekomandime, për të cilat gjykojmë se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga Policia. Megjithëse ato ja kemi dërguar Ministrisë së Brendëshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konstatojmë se edhe pas këmbënguljes tonë të vazhdueshme, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar. Kështu p.sh. mund të përmëndim:

1. Nuk janë marrë masat e nevojshme që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të drejtën që këta persona kanë për t'u ekzaminuar, nëse ata dëshirojnë, nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj të drejte gjithashtu duhet që:

- Të gjitha ekzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej Policisë të jenë larg dëgjimit të Policisë dhe vetëm nëse kundërshton mjeku. Për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të Policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo ekzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

2. Personave të privuar nga liria prej Policisë, nuk u dorëzohen formularë ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formularë duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qënë të informuar mbi të drejtat e tyre.

3. Nuk është nxjerrë udhëzimi (kodi i sjelljes) për marrjen në pyetje nga Policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seancave dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një

seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjëndje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluari gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shëmbull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

4. Nuk zbatohen të drejtat e mësipërme edhe për personat e mbajtur nga Policia për qëllime administrative. Nga inspektimi i bërë gjatë këtij viti në disa Komisariate të Policisë në shkallë vendi kemi konstatuar se në disa raste “shoqërimi në Polici” përdoret ndaj personave të dyshuar për një vepër penale. Pra shoqërimi përdoret jo për të sqaruar veprime administrative, por me qëllim hetimesh për vepra penale dhe mbas kohës së “shoqërimit” bëhen veprime procedurale të ndalimit ose arrestimit. Po kështu kemi konstatuar disa raste të kryerjes së veprimeve që çojnë në kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të dhëna të tilla mund të përmëndim ato që janë marrë nën efektin e dhunës fizike.

5. Nga verifikimi i disa ankesave ka rezultuar se koha e ndalimit ose arrestimit fillon pas asaj të shoqërimit, që në disa raste edhe ajo ka qënë tej afatit ligjor.

Pas disa rekomandimesh të bëra nga ana jonë, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nxorri Letër - Porosinë Nr. 1328, dt. 23.11.2009 “Për respektimin dhe garantimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese e ligjore të personave gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit”. Në pikën 2 të saj parashikohet që, personat e dyshuar si autorë të veprave penale dhe ata të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë të mos trajtohen e mbahen si të shoqëruar, por ndaj tyre të aplikohet menjëherë masa e arrestit në flagrancë apo e ndalimit.

6. Titullarët dhe kuadrot drejtues të Policisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në lidhje me librat e regjistrimit dhe të mbajtjes së personave në ambjentet e Policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit. Kemi konstatuar disa raste që shënimet në këto regjistra nuk përputhen me kohën e saktë të qëndrimit të tyre në Polici, ndërsa në raste të veçanta ata nuk regjistrohen.

7. Nuk ka ndryshuar koncepti për personat e shoqëruar në Polici, të cilët duhet të mbahen në dhoma shoqërimi dhe jo ndalimi, jo të prangosur ose në dhoma të mbyllura me dryn, siç veprohet në disa raste. Po kështu nuk ka ambjente për të shoqëruarit e mitur dhe femra. Dhomat duhet të

jenë me kushte të përshtatshme higjenosanitare dhe të pajisura me karrige e tavolina. Këto mangësi fatëkeqësisht janë të pranishme dhe shumë të dukshme edhe në pjesën më të madhe të Komisariateve të Policisë në Kryeqytet, ku pretendojmë dhe synojmë të kemi një Polici më të kulturuar dhe më të civilizuar.

8. Nuk janë ndryshuar e përmirësuar kushtet e mbajtjes së të ndaluarëve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambjentet e Policisë, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin, si dhe
- të ndahen gjithmonë të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmendje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Megjithëse në muajin qershor të vitit 2007 u bë kalimi i të gjitha dhomave të paraburgimit dhe i personelit të tyre nga varësia e Ministrisë së Brendëshme në atë të Ministrisë së Drejtësisë, kemi konstatuar se ka akoma raste që të paraburgosurit dhe në disa raste edhe të dënuarit mbahen në dhomat e sigurimit të Policisë. Dërgimi i të paraburgosurve në dhomat e paraburgimit që në momentin e vlerësimit të masës së sigurimit në organet gjyqësore, do të krijonte mundësinë për të vënë efektivisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në “Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 96, datë 09.03.2000.

Ministria e Brendëshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka insistuar vazhdimisht për realizimin e kësaj detyre, por Ministria e Drejtësisë dhe veçanërisht Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka sjellë pengesa.

Përveç zbatimit të rekomandimeve të mësipërme, nga organet e Policisë duhet të punohet më shumë për të zbatuar një nga detyrat kryesore institucionale të saj të përcaktuara në nenin 1 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, atë ... të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Për realizimin e kësaj detyrë është e domosdoshme që:

1. T'i jepet një përparësi më e madhe edukimit dhe formimit profesional në vazhdimësi të punonjësve të Policisë të të gjitha roleve dhe gradave. Në këto programe duhet të zërë një vënd të rëndësishëm edukimi i tyre me ndjenjën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Niveli kulturor e profesional, njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe aftësia komunikuese të jenë kriteret përcaktuese në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe përzgjedhjen në emërimet e ngritje në detyrë të punonjësve të policisë të të gjitha roleve.

2. Duhet që autoritetet politike dhe teknike të niveleve më të larta të dalin herë pas here, më shpesh dhe më fort, me mesazhe të qarta që

dënojnë rreptë rastet e torturës dhe të keqtrajtimit të shtetasve nga punonjës të veçantë të Policisë. Ky veprim duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e Policisë. Kjo në veçanti t'u theksohet punonjësve të Policisë të ngarkuar me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria. Është mjaft pozitive se këtë mesazh e ka dhënë Kryeministri Berisha në fjalën e tij të mbajtur në analizën vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2008. Mesazhi publik, i bërë nga Kryeministri, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, të të miturve dhe të paraburgosurve nga punonjësit e Policisë është shumë i rëndësishëm. Mirëpo do të ishte mirë që këtë mesazh t'a bënin herë pas here edhe drejtuesit e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit. Konstatojmë me shqetësim faktin se, në raportin e analizës vjetore të punës, Drejtori i Policisë së Qarkut Tiranë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, ku ne ishim të ftuar, nuk kishin pasqyruar dhe nuk thanë asnjë fjalë për respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Ata nuk përgjithësuan e nuk kritikuan asnjë rast të keqtrajtimit të shtetasve nga Policia, ndërkohë që raste të tilla gjatë vitit 2009, të konstatuara nga ana jonë, OJF-të e ndryshme të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbojtjen e të drejtave të njeriut dhe media, janë të konsiderueshme. Ky qëndrim nuk i shërben aspak parandalimit të shkeljeve të tilla nga punonjësit e Policisë në të ardhmen.

3. Në të gjitha ambjentet e Policisë të vendosen menjëherë posterat e përgatitura në bashkëpunim me institucionin tonë, të cilat bëjnë fjalë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunës nga punonjësit e Policisë. Ato do të shërbejnë jo vetëm për personat e shoqëruar apo të paraburgosur në Polici, por edhe si një kujtesë e vazhdueshme për punonjësit e Policisë dhe do t'i ndihmojë ata në zbatimin me rigorozitet të ligjit. Është konstatuar se edhe ato që janë vënë, janë hequr pa patur asnjë shkak.

4. Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, megjithëse ka qënë i mirë, duhet të rritet e përsoset më tej në të ardhmen. Këtij qëllimi do t'i shërbejë edhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me temë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

## **B. Ankesat per organet e pushtetit vendor (Komunat, Bashkitë, Prefekturat, Qarqet dhe gjëndja civile)**

Gjatë vitit 2009 kemi patur 437 ankesa për organet e mësipërme. Problematika e tyre është e larmishme dhe natyrisht jo e panjohur, pasi është prezantuar edhe në raportet e mëparshme.

### **1) Ankesat për komunat**

Nga 89 ankesa që kemi shqyrtuar për Komunat, 10 ankesa janë ende në shqyrtim. Janë përfunduar 79 ankesa, nga të cilat 15 janë zgjidhur në favor të ankuesve, jashtë juridiksionit dhe kompetencës kanë qenë 50 ankesa, ndërsa për 10 të tilla jemi në kushtet e pabazueshmërisë ose të braktisjes së procedimit administrativ me kërkesë nga vetë ankuesi. Objekti i ankesave të paraqitura gjatë këtij viti, ka qenë kryesisht lidhur me probleme të cilat kanë të bëjnë me çështje jetike të komunitetit, si zvarritje procedurash administrative, mungesë informimi, largime nga puna të pamotivuara, apo në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës.

Problemet ekzistuese të ankesave të evidentuara vit pas viti janë më të dukshme në këto nivele vendore, sepse dhe niveli profesional nuk është në standartet që kërkohen për pushtetin vendor. Gjithashtu dhe struktura e këtyre organeve dhe vetë fondet e kufizuara që ata kanë në dispozicion për zgjidhjen e çështjeve në terren, i bën edhe më të vështira zgjidhjet afat shkurtëra dhe afat gjata. Vazhdon të shfaqet vështirësi në marjen e iniciativave dhe vetëveprimet për mënyrat e krijimit të të ardhurave qoftë dhe modeste nga vetë komuna, me qëllim që këto t'i përdorin me pas në favor të komunitetit, duke shprehur kështu mungesë vizioni për vetqeverisje. Gjithashtu shpesh nga mos njohja e akteve ligjore dhe nënligjore, komunat jo vetëm që nuk shqyrtojnë dhe nuk zgjidhin probleme, por nuk u kthejnë as përgjigje ankuesve për sa kërkojnë. Sikurse e kemi konstatuar edhe në vitet e tjera, Kodi i Procedurave Administrative, në shumë raste nuk njihet. Por edhe kur njihet ose nuk zbatohet ose keqpërdoret për interesa të caktuara dhe shkaqe të pajustificuara.

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit paraqitën ankesë, banorë të Fshatit Hotolisht, duke parashtruar pretendimet e këtij komuniteti ndaj Komunës Hotolisht lidhur me ndërtimin e një rruge e cila kalon mjaft larg fshatit.

Konkretisht, shprehej pretendimi se rruga ekzistuese e ndërtuar në vitin 1975, e cila kalon rreth 1500 m afër fshatit mund të rikonstruktohej fare mirë duke plotësuar kështu edhe nevojat e banorëve për të komunikuar më lehtë me pjesë të tjera të zonës dhe gjithë vëndit. Sikundër shkruhej në ankesë Komuna kishte menduar të ndërtonte një rrugë të re, tashmë shumë larg dhe me kosto shumë më të madhe në krahasim me rehabilitimin e rrugës ekzistuese.

Lidhur me këtë ankesë kemi kërkuar shpjegime Kryetarit të Komunës Hotolisht lidhur me pretendimin e shprehur në ankesë. Në informacionin e dërguar nga komuna, na bëhej me dije se mbi bazën e fillimit të shqyrtimit administrativ nga Avokati i Popullit të kësaj ankesë, do të organizohej një takim me banorë të fshatit, me qëllim të gjetjes së mundësive për të zgjidhur këtë çështje, gjë që përmbushte dhe kërkesat e banorëve të shprehura në ankesën përkatëse.

2. Në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit përfaqësuesi i Komunitetit rom të Komunës Grabian, Lushnjë ankohej se diskriminohej nga titullarë të komunës sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të këtij komuniteti.

Përsa pretendohej në ankesë Avokatit i Popullit, kërkoj shpjegime shkresore nga Kryetari i Komunës Grabian, Lushnjë.

Në përgjigjen e Kryetarit të kësaj Komune na bëhej me dije se për shkak edhe të ndërhyrjes së Avokatit të Popullit këtej e tutje organizimi i këtyre aktiviteteve do të zhvillohej në ambiente të komunës, gjë që përmbushte edhe kërkesën e institucionit për mosdiskriminim të kësaj kategorie të popullatës e konkretisht në organizimin e aktiviteteve të komunitetit rom të Komunës Grabian.

3. Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, në cilësinë e përfaqësuesit të Komunitetit Mysliman shtetasi K.K., paraqiti një ankesë me anë të së cilës ngrinte pretendimin e tij ndaj Komunës Ndroq, lidhur me zvarritje administrative të konstatuara në përcjelljen e dokumentacionit zyrtar tek ZRKKP e Qarkut Tiranë, në kuadër të procedurave të njohjes dhe kthimit të pronave të këtij Komuniteti të ndodhura në fshatin Ndroq.

Konkretisht pretendohej se ishte kërkuar prej kohësh nga ZRKKP-së së qarkut Tiranë për tu shprehur lidhur me pronën e pretenduar nga ana e Komunitetit Mysliman.

Lidhur me këtë ankesë institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua me anë të disa shkresave zyrtare Kryetares së Komunës Ndroq, Drejtorit të ZRKKP-së të Qarkut Tiranë, si dhe duke vënë në dijeni edhe Prefektin e Qarkut Tiranë, për të kërkuar shpjegime lidhur me pretendimet e parashtruara, si dhe cilat ishin shkaqet ligjore për zvarritjet e konstatuara në përcjelljen e këtij dokumentacioni pranë institucioneve kompetente.

Në përgjigje të shkresës tonë, Drejtori i ZRKKP-së të Qarkut Tiranë na vuri në dijeni se kërkesa e paraqitur mbante numrin 737 datë 26.11.2008, si dhe ishte në proces pranë kësaj Zyre dhe se do të procedohej pas konfirmimit zyrtar nga të gjitha institucionet, të cilave u ishte drejtuar ZRKKP-ja.

Ndërkohë, në përgjigje të shkresës tonë, Kryetarja e Komunës Ndroq, na vuri në dispozicion informacionin e kërkuar lidhur me sipërfaqen e pretenduar nga ana e ankuesit, duke i bashkëngjitur edhe



planimetrinë e saj. Ky dokumentacion përmbushte dhe kërkesat e Avokatit të Popullit dhe zgjidhte në favor të ankuesit këtë çështje.

4. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi M.Sh paraqiti ankesë, në të cilën shprehte shqetësimin dhe pretendimin e tij ndaj komunës Bërxull, lidhur me mospërfshirjen në proces shpronësimi të pronës të cilën e dispononte me dokumentacion të rregullt ligjor.

Konkretisht, ankuesi deri në datë 24.09.2009 ishte lajmëruar nga komuna të prishte vullnetarisht murin rrethues të shtëpisë, për shkak të zgjerimit të rrugës ekzistuese nga firma e kontraktuar nga komuna.

Sa më sipër, u kërkuua ndërhyrja e Avokatit të Popullit, pranë organit përkatës të administratës publike me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të ankuesit mbi pronën.

Për të pasur efektivitet në hetimin administrativ të ndërmarrë nga ana jonë, eksperti i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës ka zhvilluar një bisedë telefonike me Kryetarin e Komunës Bërxull, përgjatë së cilës ka rezultuar se në mbledhjen më të afërt të Këshillit Komunal do të propozohet marrja e vendimit të shpronësimit, si dëmshpërblim për sipërfaqen e pronës që do të përdoret për interes publik.

Nga komunat si organe kompetente më afër komunitetit dhe problemeve të shumta të tyre, kërkohet një angazhim më i madh për zgjidhjen e problemeve të tilla jetësore, për të qenë më energjikë, si për sigurimin e ujit dhe dritave, të krijimit të kushteve të shkollimit të fëmijëve, të shëndetësisë dhe të shërbimeve të tjera, të infrastrukturës në përgjithësi, tregues të cilat do të ndikonin në rritjen e cilësisë së jetës së tyre.

Gjatë shqyrtimit të ankesave për Komunat, jo në pak raste është vërejtur se në këto struktura, aktet administrative apo shkallët e ankimit administrativ, nuk njihen ose ndërmerren veprime nga kryetarët e komunave që kapërcejnë kompetencat e tyre. Gjithashtu janë shfaqur dhe zvarritje e neglizhenca në trajtimin e problemeve, mos angazhim për zgjidhjen e fenomeneve, sidomos në zonat rurale. Kjo dhe për faktin se duke qenë të veshur me mandat zgjedhor, Kryetarët e Komunave e konsiderojnë veten të pacënueshëm edhe në rastet kur shkelin ligjin në mënyrë sistematike, me dashje apo për qëllime abuzive. Prandaj mendojmë se duhet bërë kujdes nga partitë politike në përzgjedhjen e individëve për këto poste.

## **2 Ankesat për bashkitë**

Gjatë vitit 2009 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë mbërritur 299 ankesa kundrejt Bashkive. Nga këto janë përfunduar 272 dhe janë ende në shqyrtim 27 ankesa. Nga totali i ankesave të përfunduara kanë rezultuar 58 ankesa në favor të ankuesve, 5 prej tyre jashtë juridiksionit, 164 ankesa jashtë kompetence dhe 33 ankesa të pa bazuara,

ndërsa 8 raste kanë rezultuar me heqje dorë. Nga këto 4 ankesa kanë përfunduar me përpilimin edhe të rekomandimeve me shkrim. Edhe këtë vit problematikat e prezantuara kanë qenë të shumta, dhe kanë patur në qendër të vëmendjes kryesisht dhënien e lejeve të ndërtimit, sanksionet e gjobvënies nga policia bashkiake për parkime të paligjshme të makinave, investimet për kanalizimin e ujrave të zeza, por dhe kërkesat për ndihma sociale, ato për papunësinë, etj..

Përqindje të konsiderueshme në numrin e ankesave të prezantuara gjatë vitit 2009, kanë pasur ankesat me objekt çështjen e strehimit si një problem madhor dhe jetik. Numri i familjeve të pastreha dhe kërkesat e tyre vijnë të rriten, duke sjellë zgjidhje të pa mjaftueshm e krahasimisht të këtyre kërkesave në drejtim të projekteve minimale të realizuara nga pushteti vendor. Megjithëse dhe nga informacioni që disponon zyra e Avokatit të Popullit kryesisht për Bashkinë e Tiranës, e cila ka hartuar një program 10 vjeçar për strehimin në qytetin e Tiranës, kjo është e pa mjaftueshme nëse nuk do të ketë mundësi reale financimi dhe strategji të harmonizuara me programet e qeverisë. Duke shpresuar se aktet e fundit ligjore dhe nënligjore që kanë dalë nga Qeveria për zgjidhjen e strehimit, do të zgjidhin hap pas hapi këtë problem kombëtar dhe madhor, besojmë se dhe kategoritë e tjera të pastreha do të përfitojnë nga këto politika sociale të shtetit. Megjithatë gjatë trajtimit të këtyre ankesave, kemi konstatuar se qytetaret vijnë te pretendojnë, që mungon transparenca në përzgjedhjen e kategorive apo në vendimarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese e radha e trajtimit të shtetasve, probleme të cilat janë prezantuar dhe në raportet e mëparshme.

Për këtë problem, zyra jonë rithekson mangësinë e informimit publik për ditën e mbledhjeve, apo dhe rendin e ditës të mbledhjeve të këshillave bashkiake, të cilat duhet të jenë publike dhe të njohura, me qëllim që personat e interesuar të jenë pjesë e kësaj procedure, për të cilët janë direkt të interesuar dhe për të cilat duhet të vihen në dijeni, qoftë dhe se kur praktikisht mund të zgjidhen shqetësimet e tyre.

Në vijim, po prezantojmë disa nga ankesat e trajtuara nga zyra jonë, si pasqyrim i punës konkrete të bërë në këtë drejtim.

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit paraqiti ankesë shtetasi R. T., në të cilën ankohej ndaj Bashkisë Kavajë, lidhur me mosmarrjen e masave për prishjen e një ndërtimi pa leje. Konkretisht, ankuesi shprehej se dy shtetas të tjerë po bënin ndërtimin e një shtese banese e cila ishte pa lejen përkatëse të Bashkisë. Ndërtimi i kësaj shtese kishte nxjerrë jashtë funksionimit banesën e këtij shtetasi, pasi nga gërmimet e thella ishin krijuar të çara në mure të cilat rrezikojnë shëmbjen e gjithë banesës.

Institucioni i Avokatit të Popullit, kërkoi nga Bashkia Kavaje që pasi të bënte verifikimin në vend të situatës ndërtimore, të na përcillte një informacion të hollësishëm mbi masat e ndërmarra për zgjidhjen e këtij problemi.

Nga ana e Bashkisë Kavajë, u vume në dijeni se pasi u bë verifikimi në vend i situatës u mbajt procesverbali më datë 05.01.2009 dhe më pas u mbajt akti i pezullimit të ndërtimit me Nr. 18, datë 19.01.2009. Gjithashtu në kete përgjigje, sqarohej se një ndërhyrje tjetër me prishjen e këtij ndërtimi do të çonte në shkarjen e dheut duke shkaktuar edhe prishjen e banesës së shtetasit R. T.

Për sa më sipër, zyra jonë argumentoi faktin e zbatimit të kompetencave ligjore të ndërmarra nga Bashkia Kavaje ndaj subjektit kundravajtës, me masën administrative të pezullimit të punimeve në objekt. Sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, shkelja e konstatuar në këtë rast nga ana e I.N.U.V pranë Bashkisë Kavajë, përbënte kundërvajtje administrative. Ndërkohë që akt-pezullimi nr.18 datë 19.01.2009, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 78 të Kodit të Proçedurave Administrative, përbënte dhe cilësohej si vendim i ndërmjetëm, i marrë nga ana e organit të I.N.U.V Kavajë. Në pikën 2 të nenit 78 të sipërcituar të Kodit të Proçedurave Administrative thuhej se: “Vendimi për marrjen e masave të ndërmjetme duhet të jetë i justifikuar dhe me afat të përcaktuar”.

Sipas përgjigjes se Bashkisë Kavaje, konstatoam se akt pezullimi, si vendim për marrjen e një mase të ndërmjetme në këtë çështje, gjente justifikimin në faktin se një ndërhyrje me prishjen e këtij ndërtimi, do të çonte në shkarjen e dheut duke shkaktuar edhe prishjen e banesës së shtetasit R.T. E gjithë kjo proçedurë e përshkruar dhe analizuar, tregonte për fillimin dhe vazhdimin e një proçedimi administrativ, i cili sikurse kishte patur gjatë zhvillimit të tij një vendim të ndërmjetëm, duhej patjetër që brenda afateve ligjore të përcaktuara, të kishte edhe një vendim përfundimtar.

Në trajtimin ligjor të kësaj çështje, duke analizuar për afatin përcaktues të vlefshmerisë, i`u referuam Ligjit Nr.7697 datë 7.04.1993 “Për kundërvajtjet administrative” i ndryshuar. Më konkretisht, në nenin 14 të këtij ligji, thuhej shprehimisht se: “Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 15 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 2 muaj pas kryerjes”.

Akti i pezullimit Nr. 18 i datës 19.01.2009, ishte masë parandaluese dhe kishte edhe cilësinë e një vendimi të ndërmjetëm. Marrja e një vendimi përfundimtar, duhej të bëhej brenda një afati 15 ditor.

Sipas dispozitave të Kodit të Proçedurave Administrative, rezultonte që në datën 06.02.2009, masa e pezullimit e vendosur me akt-

pezullimin Nr.18 datë 19.01.2009, kishte rënë automatikisht në cilësinë e vendimit të ndërmjetëm në këtë procedim administrativ.

Për sa më sipër, rezultonte se afati i përcaktuar nga ana e nenit 14 të Ligjit Nr.7697 datë 7.04.1993 "Për kundravajtjet administrative", i ndryshuar, nuk ishte respektuar në këtë rast, pasi edhe pas kalimit të tij, nuk ishte nxjerrë një vendim përfundimtar si akti administrativ përkatës i Bashkisë Kavaje.

Pra, në referencë të këtij ligji nga ana e këtij organi, duhej të ishin ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme proceduriale të një procedimi administrativ, për nxjerrjen e një vendimi përfundimtar të nevojshëm për këtë çështje, pasi edhe sipas referencave të ankuesit, personi kundravajtës jo vetëm që nuk i kishte pezullur punimet, por kishte vazhduar duke cënuar edhe më tej të drejtën e shtetasit R. T.

Për sa më sipër në kuadër të mirëfunksionimit të Bashkisë Kavaje, Avokati i Popullit nisur vetëm nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, qëllimi i mirë për përmirësimin e punës, si dhe për një zgjidhje sa më të drejtë dhe ligjore të kësaj ankese e çmoi me vend të bëjë një rekomandim, duke argumentuar marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e një vendimi përfundimtar për prishjen e këtij ndërtimi pa leje, apo marrjen e masave të tjera të nevojshme duke mos rrezikuar shëmbjen e banesës së shtetasit R. T

Nga ana e Bashkisë Kavajë na u ofrua përgjigja përkatëse, ku vihemi në dijeni se nëpërmjet vendimit Nr. 59 datë 16.04.2009, ishte vendosur prishja e ndërtimit pa leje brenda një afati sa më të shkurtër kohor.

2. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit paraqitën një ankesë, banorët e Rrugës "Meleq Gorishti", Selitë e Vogël, ku parashtronin shqetësimin dhe pretendimin e komunitetit të zonës, lidhur me mosndërrhyrjen e Policisë Bashkiake, për sa i përket zhurmave të shkaktuara nga ushtrimi i aktivitetit të një pabi të ndërtuar brenda ambjentëve të qendrës "Alternativa Profesionale", e sidomos gjatë natës.

Sikundër ata sqaronin në letrën drejtuar institucionit, rreth një vit më parë një pjesë e oborrit të vilës u kthye në PUB. Aktiviteti i këtij biznesi, me zhurmat e muzikës së lartë dhe zhurmat e klientëve pas përfundimit të mbrëmjeve, ishte kthyer në shqetësim serioz për banorët.

Gjithashtu ata parashtronin se në ambjentet e brendshme dhe të jashtme të godinës, dy ose tre herë në javë organizoheshin party, festoheshin ditëlindje me muzikë mjaft të lartë dhe të padurueshme shpesh herë deri në orët e para të mëngjesit. Problem mbetej edhe siguria fizike e banorëve për shkak të klientëve, që nën efektet e alkolit bëheshin pjesëmarrës të debateve të nxehta të cilat mund të precipitonin në ngjarje të rënda me karakter penal.

Në të tilla kushte, duke mos gjetur një zgjidhje ligjore me anë të telefonatave të përsëritura pranë Policisë Bashkiake, banoret kërkuan ndihmën e Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim ndërmjetësimin pranë Bashkisë Tiranë, për gjetjen e një zgjidhje të kësaj çështje.

Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm dhe sqarimit përfundimtar të kësaj çështje, i'u jemi drejtuar me një kërkesë për shpjegime Kryeinspektorit të Policisë Bashkiake pranë Bashkisë Tiranë, ku i kërkuam të na përcillej një informacion i hollësishëm, në lidhje me veprimet e ndërmarra për normalizimin e situatës së rëndë shkaktuar nga ushtrimi i aktivitetit të këtij lokali në këtë zonë.

Nga kontaktet e drejtëpërdrejta me titullarë të këtij organi, por edhe me përgjigjen zyrtare të Kryeinspektorit të Policisë Bashkiake, na u sqarua se mbi bazën e indiceve të përcjella zyrtarisht nga Avokati i Popullit, ishte bërë kontroll i vazhdueshëm paradite, mbasdite dhe në orët e vona të natës pranë pabit të ndërtuar brenda ambjenteve të qendrës “Alternativa Profesionale”, duke ndërhyrë për të mbajtur nën kontroll zhurmat e shkaktuara. Gjithashtu Kryeinspektori i Policisë Bashkiake, na informoi se subjekti do të mbahej nën kontroll të vazhdueshëm deri sa të mos konstatoheshin më probleme.

3. Ne ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, qytetarja S.Q. me banim në lagjen “Hajro Çakerri”, parashtronte pretendimin e saj lidhur me mostrajtimin me ambjente banimi nga Bashkia Vlore. Konkretisht, ajo shpjegonte se familja e saj perbehej prej 3 personash, të cilët banonin në një banesë të një ish pronari që ishte shumë e amortizuar dhe e pabanushme për të banuar njerez.

Ankuesja ishte e regjistruar në Bashkinë e Vlores si e pastrehe, por prej dhjetra vjetësh nuk trajtohej me banesë. Ajo pretendonte se ndarja e banesave nga Bashkia dhe Keshilli Bashkiak, ishte bërë në mënyrë të padrejte dhe të paligjshme.

Në këto kushte ankuesja i ishte i drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit për zgjidhjen e problemit të strehimit.

Në përgjigje të shkresës tone, Bashkia Vlore me datë 23.10.2009, na vuri në dijeni se meqenese familja e qytetares S.Q. jetonte në banesë që ishte prone e subjekteve të shpronësuara dhe kishte fituar statusin e të pastrehut të grupit të parë sipas VKM Nr.250 datë 16.4.1996, ishin duke u kryer procedurat për trajtimin me kredi pa interes nga Enti Kombëtar i Banesave.

4. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit paraqiti ankesë shtetasi F. D., i cili ankohej ndaj Bashkisë Tiranë, për mosshqyrtimin e kërkesës të kryer prej tij për pezullimin e procedurave në miratimin e lejes së ndërtimit të kërkuar nga një familje mbi pasurinë Nr. 9/766, Z.K. 8120 Tiranë.

Ankuesi shprehej se kërkesa në fjalë ishte bërë prej tij më datë 15.12.2008 dhe se Bashkia Tiranë, ende gjatë vitit 2009 nuk ishte shprehur lidhur me kërkimin e kryer prej tij.

Lidhur me ankesën e qytetarit, Institucioni jonë i kërkoj shpjegime Bashkisë Tiranë.

Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik pranë Bashkisë Tiranë, me datë 07.05.2009 na shpjegoi dhe na informoi se mbi pasurin e paluajtëshme për të cilën ankuesi kërkonte të informohej, ishte miratuar prej K.RR.T-së Tiranë Leja e Ndërtimit Nr.107 datë 07.06.2008.

Në përfundim bashkëlidhur sqarimeve, qytetarit i`u ofruam dhe shkresën e Drejtorisë së Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik pranë Bashkisë Tiranë, qe konfirmonte zgjidhjen e problemit te parashtruar.

5. Prane Zyrës së Avokatit të Popullit paraqiti një ankesë qytetari G. Ç., banues në Rr."Gjergj Legisi",Tiranë. Ai shprehej se ishte i pa punë, po ashtu dhe bashkëshortja e tij, e cila ishte mjaft e sëmurë. Po kështu ai sqaronte se ata mbanin dhe 4 femijet e të birit, i cili që nga viti 2006 ishte zhdukur. Ankuesi shprehej se e kishte shumë të nevojshme trajtimin me ndihmë ekonomike, pasi nuk kishte asnjëlloj burim të ardhurash për mbijetesë. Në Njësinë Bashkiake nr.11 Tiranë, i kishin deklaruar që duhej të shkonte e të kërkonte ndihmë tek Kryqi i Kuq. Meqënëse nuk kishte asnjëlloj burimi për mbijetesë dhe duke arsyetuar se i plotësonte kriteret për të përfituar ndihmë ekonomike, ai kërkoi ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për këtë problem.

Për gjetjen e një zgjidhje, por dhe mundësimin e rrugëve të tjera për ndihmë financiare në drejtim të këtij qytetari, zyra jonë kërkoi ndihmesën e Njesisë Bashkiake nr.11 Tiranë.

Në përgjigje të ndërhyrjes së zyrës së Avokatit të Popullit, nga Kryetari i Njësisë Bashkiake nr.11 Tiranë, u njoftuam se familja e ankuesit kishte hyrë në skemën e ndihmës ekonomike duke filluar nga muaji Mars 2009.

### **3. Ankesat për prefekturat**

Gjithsej kemi patur 16 ankesa për prefekturat për këtë vit. Nga këto 6 jane zgjidhur në favor të ankuesit, 7 ankesa rezultojnë të jenë të pa bazuara dhe jashtë juridiksionit, si dhe 3 janë në shqyrtim për vitin 2010.

Prefekti është hallkë ndërmjetëse midis pushtetit qëndror dhe vendor dhe për këtë arsye misioni i tij është të bashkërendojë punën dhe veprimtarinë me këto institucione. Në këtë këndvështrim nga ankesat e shqyrtuara janë konstatuar raste të zvarritjeve të procedurave administrative, mungesë transparence apo dhe shkelje të së drejtës së informimit, si dhe shkelje të procedurave administrative në rastet e largimeve nga detyra.

1. Veçojmë ankesën e shtetasit V.H., sa i përket kërkesës së tij për ndërhyrje të institucionit të Avokatit të Popullit pranë Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësive mbi tokën bujqësore, pranë Prefektit të Qarkut Korçë.

Në lidhje me këtë çështje ankuesit i është bërë me dije se duke e vlerësuar realisht shqetsimin konkret, kërkuam nga Prefektura Korçë, shpejtimin e procedurave për trajtimin e mosmarrëveshjeve për pronësinë e tokës bujqësore.

Në përgjigjen e Prefektit, një kopje e së ciles iu përcoll ankuesit, vihej në dukje gadishmëria e Komisionit për shqyrtimin e kërkesës, por gjithsesi pas dorëzimit nga ana e ankuesit të dokumentacionit të nevojshëm.

Për këtë qëllim ankuesi u orientua të kontaktonte me Kryetarin e Komisionit Vendor, Korçë, për plotësimin e dokumentacionin përkatës, për përfundimin e kësaj procedure.

2. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit paraqiti ankesë shtetasi A.T., Berat, në të cilën ankohej ndaj Prefekturës së Qarkut Berat për mosdhënie informacioni rreth një kërkesë të paraqitur nga ana e tij.

Konkretisht, pretendohet se në datë 30.03.2009, ankuesi kishte paraqitur një kërkesë pranë Prefekturës së Qarkut Berat për verifikimin të gjëndjes fizike të një sip. toke në pronësinë e tij, por pa marrë asnjë përgjigje zyrtare lidhur me kërkesën e paraqitur.

Me shkresën e Prefekturës së Qarkut Berat jemi vënë në dijeni se referuar pikës 6 të nenit 8 të Ligjit Nr. 9948 datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, si dhe ekzistencën gjëndje tokë bujqësore shtetërore në fshatin Duhanas edhe me bashkëpunimin e ankuesit do të bëhet i mundur plotësimi me tokë, gjë e cila përmbushte në thelb kërkesën e shtetasit A.T. si dhe mbyllet e shqyrtimit të ankesës në favor të ankuesit.

3. Në takimin zhvilluar në Qarkun e Dibrës midis Avokatit të Popullit dhe banorëve të prekur nga tërmeti i rënë në këtë zonë, u diskutua në lidhje me ankesat që këta shtetas kishin për vonesat e konstatuara në shpërndarjen e ndihmave të akorduara nga Qeveria Shqiptare.

Gjithashtu ankesat kishin të bënin edhe me formën e ndihmës së akorduar, pasi ajo konsistonte në ndihma ushqimore, si dhe çadra ku banorët do të strehoeshin gjatë periudhës së nevojshme për riparimin e shtëpive të dëmtuara.

Ankuesit në këtë rast kërkuan ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit duke parashtruar konkretisht edhe disa kërkesa specifike, të cilat vlerësohen nga ana e tyre si mundësi për zgjidhjen e kësaj çështje.

Duke e vlerësuar seriozisht dhe me përparësi këtë ankesë, Avokati i Popullit zhvilloi një takim me Prefektin e Qarkut Dibër, i cili në përgjigjen dërguar pranë institucionit informon me hollësi lidhur me verifikimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga tëmeti, si dhe për masat e marra nga Prefektura për ndarjen e ndihmave të akorduara.

Gjatë periudhës midis takimit të zhvilluar në prefekturë dhe kthimit të përgjigjes, Qeveria Shqiptare me vendim të Këshillit të Ministrave akordoi në vlerë monetare një fond të veçantë i cili do të shpërndahet sipas madhësisë së dëmit ndër banorët e prekur nga tëmeti.

Akordimi i këtij fondi do të mundësonte riparimin e shtëpive të dëmtuara duke përbushur në thelb edhe kërkesën për ndryshimin e llojit të ndihmës të paraqitur nga banorët pranë Avokatit të Popullit.

Për sa më sipër në kushtet kur kjo çështje u zgjidh në favor të ankuesve gjatë shqyrtimit të saj nga ana jonë, konsiderohet si një ankesë e zgjidhur pozitivisht edhe në sajë të ndërhyrjes direkte të Avokatit të Popullit.

Si perfundim mund të themi se Prefekturat në zbatim të Ligjit Nr.8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, duhet të rrisin rolin e tyre koordinues dhe kontrollues mbi administrimin dhe veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor në të gjitha hallkat e tij, si dhe kontrollin e bazueshmërisë ligjore të të gjitha akteve që nxjerrin këto organe, për t’u prerë rrugën veprimeve të kundraligjshme dhe abuzive që në fillim, me qëllim që situata të mos derivojë dhe të sjellë pasoja të pariparueshme sociale dhe ligjore për shtetasit.

#### **4. Ankesat për Sherbimin e Gjëndjes Civile**

Edhe gjatë këtij viti pranë Zyrës tonë janë trajtuar ankesa të cilat lidhen me shërbimin e Zyrave të Gjëndjes Civile. Kështu janë shqyrtuar 26 ankesa, nga të cilat 23 janë përfunduar dhe 3 janë ende në shqyrtim. Nga 23 ankesa të përfunduara, 8 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 13 kanë rezultuar të jenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës, ndërsa në dy prej tyre jemi në kushtet e braktisjes së procedimit administrativ nga vetë ankuesit.

Pjesën më të madhe të ankesave për Zyrat e Gjëndjes Civile e zënë ato për të cilat pretendohet mosveprim apo veprime me gabime materiale të bëra nga nëpunës të gjëndjes civile dhe për rrjedhojë mos plotësim të kërkesave të shtetasve për sa ata pretendojnë. Në ndonjë rast ankohen edhe për zvarritje të procedurave gjatë trajtimit të kërkesave apo për fallsifikim dokumentash.

Më poshtë po trajtojmë më gjatë disa raste të shkeljeve më të rënda të bëra nga nëpunësit e Zyrave të Gjëndjes Civile.

**1.** Një ndër çështjet e ndjekura me inisiativë nga Avokati i Popullit, i inicuar nga lajmet e publikuara nga disa media ishte shqetesimi tashmë i



vjetër, se në regjistrat e gjendjes civile figurojnë ende emrat e personave të vdekur, fakt i cili lë shteg për abuzime në votime.

Këtë problem e bënte më shqetësues fakti se nga intervistat në media me ndonjë prefekt qarku, ishte përdorur shprehja, “Zyrat e Gjendjes Civile nuk mund t’i ç’regjistrojnë ata me inisiativën e tyre dhe se e vetmja mënyrë ligjore për të bërë ç’regjistrimin e këtyre personave është rruga gjyqësore që duhet të ndjekin familjaret e tyre”.

Në fakt bëhej fjalë për një shqetësim që nga institucioni ynë është investuar që në vitin 2002. Pas rekomandimit të bërë nga institucioni ynë në vitin 2002, u bë e mundur që ligji i ri nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të lejojë që vetë shërbimi i gjendjes civile, për personat e vdekur në fakt, të vihet në lëvizje me inisiativë për çeregjistrimin e këtyre shtetasve nga regjistrat e gjendjes civile.

Sipas pikes 7, të nenit 51 të këtij ligji, tashmë në fuqi, shërbimi i gjendjes civile ka të drejtë që t’i drejtohet gjykatës me kërkesë padi për të vepruar. Konkretisht në këtë dispozitë thuhet se: “Shërbimi i gjendjes civile, kur ka të dhëna se persona të vdekur qëndrojnë të regjistruar në rregjistrin themeltar, mund të ngrejë padi në gjykatë për të vërtetuar vdekjen”.

Pra ekziston rruga ligjore. Vetem se zyrat e gjendjes civile duhet të urdhërohen që të ngrenë sa më shpejt padi në gjykatat përkatëse.

2. Nga institucioni ynë është konstatuar edhe një problem tjetër shqetësues lidhur me regjistrat e gjendjes civile. Ky problem ka të bëjë me faktin e mos ç’regjistrimit nga regjistrat e gjendjes civile të personave që kanë lënë shtetësinë shqiptare.

Ky fenomen ndodh për faktin se personat që lënë shtetësinë shqiptare nuk paraqiten në Zyrat e Gjendjes Civile dhe nuk kanë bërë pagesën e një takse prej 700 lekesh, e përcaktuar kjo në ligjin nr. 9975, datë 29.07.2008 “Për taksat kombëtare”, shtojca nr. 3, pika 5, ku parashikohet pagesa 700 leke për regjistrimin e lënies së shtetësisë. Institucioni i Avokatit të Popullit mendon se në këtë çështje ka një përplasje ligjore, pasi dekreti i Presidentit të Republikës në çdo rast, në nenin 2 përcakton se: “Ky dekret hyn në fuqi menjëherë”. Pra këta persona që nga momenti i nxjerrjes së dekretit nuk janë më shtetas shqiptar.

Ndërkohe që faktikisht nuk ju bëhet ç’regjistrimi i shtetësisë nga regjistri pa qenë prezent dhe pa paguar taksën prej 700 lekesh. Ligji “Për shtetësinë”, neni 23 detyron vetëm personin që fiton shtetësinë shqiptare, që të paraqitet para nëpunësit të gjendjes civile për të bërë betimin.

Ndërsa personat që e heqin shtetësinë nuk kanë pse të paraqiten pranë këtyre zyrave (duke marrë parasysh faktin se, pothuajse të gjithë këta nuk jetojnë në Shqipëri). Me sa jemi në dijeni nga praktika e punës së institucionit të Presidencës për këto raste, Ministrisë së Brendshme, i

janë dërguar rregullisht dekretet përkatëse, të cilat për çdo eventualitet gjenden në arkivin e kësaj ministrie.

Ka qenë dhe është detyrim i Ministrisë së Brendshme përcjellja e këtyre dekreteve pranë zyrave të gjendjes civile ku janë të regjistruar personat që ju është hequr shtetësia. Ne mendojmë se ky problem mund të zgjidhet duke u bazuar po në ligjin nr. 9975, datë 29.07.2008 “Për taksat kombëtare”, neni 9 “Përrjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare”, pika 3/b ku përcaktohet se: “Përrjashtohen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile” .

Në këto raste, punonjësit e gjendjes civile duhet thjesht të vënë shënim në këto regjistra, siç e përcakton shprehimisht edhe neni i lartpërmendur për përrjashtimin nga pagesa të taksave. Problemet që trajtoheshin në këtë rekomandim janë me shumë rëndësi për faktin se, mos ç’regjistrimi i këtyre personave nga regjistrat e gjendjes civile, krijon premisa për abuzime të mundshme në emër të tyre si “votues” dhe në këtë kontekst krijohet premisa për pretendime për një proces zgjedhor të padrejtë dhe të kontestuar si nga subjektet politike, ashtu dhe nga vetë votuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit i rekomandoi Drejtorit të përgjithshëm të gjendjes civile dhe prefektëve të të gjitha prefekturave:

a. Marrjen e masave të nevojshme që në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, të bëhet e mundur ç’regjistrimi nga regjistrat e gjendjes civile të personave të vdekur dhe personave që ju është hequr shtetësia shqiptare.

b. Marrjen e masave të nevojshme për pastrimin sa më shpejt të Regjistratit Kombëtar të Zgjedhësve nga personat e vdekur dhe nga personat që ju është hequr shtetësia shqiptare.

Në një përgjigje lidhur me rastin konkret Drejtori i Përgjithshëm z. Teliti shprehej se do të kryheshin të gjitha hapat proceduriale të nevojshme për plotësimin e kërkesave të parashtruara me ane të rekomandimit përkatës nga Avokati i Popullit.

Në lidhje me ankesat e tjera të paraqitura pranë institucionit, problematika që ndeshet shpesh është pamundësia për të regjistruar fëmijët, një problematikë për të cilën Avokati i Popullit nëpërmjet përgjigjeve zyrtare ka orientuar ankuesit për rrugën ligjore që duhet të ndiqet me qëllim zgjidhjen e kësaj çështje. Gjithashtu kur është konstatuar pamundësia finaciare e ankuesit për të zhvilluar procedurat e parashikuara, nëpërmjet bashkëpunimit me organizata jo qeveritare të cilat mundësojnë trajtimin e këtyre çështjeve falas.

## 5. Ankesa për Qarqet

Gjate vitit 2009 prane Avokatit të Popullit jane trajtuar 8 ankesa te cilat lidhen me veprimtarinë e Qarqeve. Keshtu 4 ankesa jane zgjidhur ne favor te ankuesve, ndërsa katër prej tyre kanë qenë në kushtet e pabazueshmërisë së pretendimeve të paraqitura apo jashtë juridiksionit dhe kompetences.

1. Pranë institucionit të Avokatit të Popullit paraqiti një ankesë shtetasi A.Ç. me banim në Pogradec, me anë të së cilës shprehej pretendimi ndaj zyrës së A.L.U.I.Z.N.I. qarku Korçë, në lidhje me mospërfitimin e pagës, për periudhën dy mujore, përgjatë së cilës ai kishte punuar në këtë institucion.

Institucioni i Avokatit të Popullit pasi shqyrtoi këtë ankesë, bazuar në nenin 17 gërma b të Ligjit Nr.8454 date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ktheu një përgjigje përfundimtare duke sqaruar për sa më poshtë:

Nga shqyrtimi i ankesës së paraqitur pranë Avokatit të Popullit, rezulton se nuk ishte bashkëngjitur asnjë dokument i cili të vërtetonte sadopak pretendimet e parashtruara, të cilat mund të verifikoheshin mbi bazën e atij dokumentacioni, siç mund të ishte kopje e dokumentit të lëshuar nga institucioni përkatës për emërim në detyrën përkatëse.

Gjithashtu me qëllim të marrjes së një informacioni më të hollësishëm në lidhje me këtë çështje, eksperti i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës, zhvilloi një hetim administrativ në organin e administratës publike ndaj të cilit ishte paraqitur ankesa, përgjatë të cilit rezultoi se pretendimet e paraqitura ishin të pabazuara.

Pra në kushtet kur nuk disponohej asnjë provë sado të tërthortë në mbështetje të pretendimeve të parashtruara, u gjykua si i pamundur shqyrtimin i mëtejshëm i kësaj ankese nga ana jonë.

Marredhëniet institucionale me Ministrinë e Brendshme kanë qënë korrekte. Ky fakt është një tregues pozitiv i mirëkuptimit që ky dikaster dhe organet e tij vartëse kanë ndaj rekomandimeve dhe kritikave tona për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë edhe ato të punonjësve të Policisë të cilat meritojnë më shumë vëmendje. Nëse nuk do të kujdesemi për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të punonjësve të Policisë, nuk mund të kemi të drejtë morale që t’u kërkojmë prej tyre respektimin e të drejtave të të tjerëve.

## 6. Ministria e Mbrojtjes

Për vitin 2009 ndaj strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes janë bërë 78 kërkesa e ankesa nga subjekte që janë ushtarakë apo ish ushtarakë si dhe të tjerë. Për këtë periudhë janë përfunduar 74 ankesa, si dhe 39 raste, të cilat kanë qënë ankesa të mbartura nga viti 2008 dhe që janë përfunduar. Janë në shqyrtim edhe 4 ankesa që kanë ardhur në muajin e fundit të vitit 2009.

Duke analizuar në tërësinë e tyre ankesat e ardhura në Institucionin tonë për vitin 2009, konstatohet se ato janë bërë kryesisht nga oficerë, nënoficerë, nga punonjës civile, ushtarë, si dhe ushtarakë të dalë në rezervë.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2009, rezulton se 26 ankesa ose 35 përqind e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Ky është një tregues i kënaqshëm që tregon efikasitetin e punës sonë si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa 6 ankesa kanë qënë jashtë kompetencës tonë, 31 raste kanë qënë ankesa të pabazuara, në 4 raste të tjera, ankesat kanë qënë jashtë juridiksionit. Në 4 raste janë filluar çështjet me inisiativë janë kryer inspektimet dhe në përfundim kanë përfunduar me rekomandim të pranuar. Në 2 raste kërkesat kanë qënë të pabazuara. Në një rast ankesa ka përfunduar me rekomandim të pranuar.

Gjatë vitit 2009 zyra e Avokatit të Popullit ka marrë takim me një numër të madh subjektsh ushtarakë, të cilët kanë prezantuar ankesat e tyre. Për ato raste që ata kanë gjykuar, ankesat janë me shkrim.

Në përgjithësi objekti i ankesave të prezantuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë kësaj kohe ka qënë si vijon:

1. Ankesa për mobilizim në shërbimin ushtarak në kundërshtim me ligjin.
2. Ankesa për pensionin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
3. Ankesa për mosdhënie e gradës sipas ligjit.
4. Ankesa lidhur me strehimin e ushtarakëve.
5. Ankesa për mënyrën e trajtimit me ushqim.
6. Ankesa për shërbimin shëndetsor.
7. Ankesa për kohën e punës dhe pushimit.
8. Ankesa për kompesimin e qirasë së banesave.
9. Ankesa kundër Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut.
10. Ankesa për trajtim financiar, jo sipas kushteve të vështira të punës.
11. Ankesa për kushtet e banimit dhe të jetesës.
12. Ankesa për trajtim me veshmbathje jo sipas normave ligjore të percaktuara.

Gjatë vitit 2009 u organizuan ditët e hapura në disa reparte ku kishte grumbullime të mëdha forcash mbi bazën e programit të punës të

hartuar në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, të datës 12 mars 2007 “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit”, ku parashikohej si objektiv, vazhdimi i organizimit të ditëve të hapura, për të pritur ankesat e ushtarakëve në repartet ushtarake. Organizimi i ditëve të hapura në repartet ushtarake gjatë këtij viti u bë i mundur edhe falë një bashkëpunimi të ngushtë me Komandat e reparteve ushtarake ku u organizuan ditët e hapura. Organizimi i ditëve të hapura vërtetoi se është mënyra më efikase, për të larguar ngurimin e kësaj kategorie individësh për të bërë ankesa apo kërkesa lidhur me probleme të ndryshme, që ata i shqetësojnë.

Gjatë organizimit të ditëve të hapura u takuam me rreth 2200 ushtarë, marinarë, oficerë dhe nënoficerë të Forcave të Armatosura. Gjatë takimeve të marra me këto kategori ushtarakësh, nga grupi i ekspertëve të zyrës sonë, ju bë i qartë qëllimi i ardhjes në këto reparte, si dhe ju shpjeguan detyrat dhe kompetencat e zyrës së Avokatit të Popullit. Nga ana tjetër atyre ju prezantuam edhe arritjet e zyrës sonë në takimet e organizuara më parë në këto reparte. Nga takimet individuale që patëm morëm rreth 44 ankesa dhe kërkesa, të cilat janë përfunduar, brenda vitit 2009.

Takimet u organizuan pa praninë e eprorëve të oficerëve, ushtarëve apo marinarëve që paraqitën ankesat. Një numër jo i vogël ankesash të paraqitura në ditët e hapura, në një kohë që problemet kishin një kohë të gjatë pa u zgjidhur, morën zgjidhje brenda një kohe të shkurtër.

Më konkretisht:

1. Shtetasi F.Sh nga Tirana ka prezantuar pranë nesh ankesën e tij, lidhur me djalin i tij E.Sh, i cili ishte thirrur në shërbimin e detyrueshëm ushtarak në kundërshtim me ligjin. Ai ishte thirrur në shërbimin e detyrueshëm ushtarak në një kohë që është duke vazhduar shkollën e mesme dhe për më tepër është i sëmurë dhe nga stomaku. Për këtë, zyra jonë pas pranimit të ankesës dhe verifikimeve të nevojshme i kërkoi shpjegime Brigadës së Stërvitjes Bunavi. Në përfundim u njoftuam se Qendra e Rekrutim Mobilizimit Tiranë për ushtar E.Sh. ka kërkuar të dalë urdhëri për ndërprerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

2. Për ankesat e ngritura nga disa ushtarakë për trajtim me strehim apo shtesë sipërfaqe banimi. Këto çështje janë parashikuar në ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004, ”Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe konkretisht në nenet 21, 38, dhe 39 si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes ky problem vazhdon të zgjidhet nëpërmjet: a) Rritjes së fondit të dhënies së kredive për strehim nga buxheti i shtetit, i cili deri tani ka qënë i kufizuar. Për vitin 2009 shuma e fondit të parashikuar është zvogëluar akoma më shumë. Kjo shumë është e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave të ushtarakëve në krahasim me numrin e shumtë të

kërkesave për strehim. Për këtë u sugjerua rritja e fondit të kredisë për strehim për ushtarakët e Forcave të Armatosura. Si dhe gjetja e formave të tjera duke bashkëpunuar me organet lokale të pushtetit për të bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të strehimit.

b) Strehimit të ushtarakëve në ambiente të cilat dalin të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura. Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme të Institucionit të Avokatit të Popullit, për përmirësimet që duhen bërë në këtë fushë më 30 Dhjetor 2008 është përsëritur rekomandimi për plotësimin e kërkesave të nenit 39 të Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, që bën fjalë për daljen e një Vendimi të Këshillit të Ministrave për të përcaktuar kriteret e përfitimit nga ushtarakët të së drejtës së parablerjes për objektet (bashkë me trojet funksionale), të dala të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura dhe që mbeten pronë e shtetit për nevoja për strehim. Dalja e një vendimi të tillë ishte parashikuar brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Por ndonëse ka kaluar një kohë e gjatë, rreth katër vjet që ligji ka hyrë në fuqi, një vendim i tillë ende nuk ka dalë. Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministria e Mbrojtjes është përgjigjur se pasi ka dërguar në Qeveri draftin e Vendimit të Këshillit të Ministrave i është refuzuar dalja e një vendimi të tillë me arsyetimin se me përfundimin e procesit të kthimit dhe kompesimit të pronave ligji do të hyj në fuqi, dhe se ata nuk do të bëjnë më propozime për plotësimin e ligjit.

c) Njëpërmjet kompesimit të qerave të banesave dhe të ushqimit të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.07.2004, i cili është në proces rishikimi. Kështu me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 28.01.2008 u rritën normat e ushqimit të efektivave ushtarakë të ushtrisë. Për një pjesë të ushtarakëve aktiv, Ministri i Mbrojtjes në pikën 8 të urdhërit të tij nr. 388, datë 13.03.2008 ka përcaktuar që një pjesë e efektivave këtë ushqim ta marrin duke ju kompesuar në vlerë leku.

Theksojmë se, pavarësisht vonesave për vitin 2009 në muajin Korrik 2009, nga ana e Ministrit të Mbrojtjes ka dalë urdhëri për dhënien e qirasë së banesave mbasi është përcaktuar çmimi mesatar i qirasë së banesave, i cili sipas gërmës “c” të pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524 datë 30.07.2004, përcaktohet çdo vit.

3. Për problemin e trajtimit me ushqim nga ana e Drejtorisë së Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm grupi punës përgatiti projekt vendim për përmirësimin e normave të ushqimit. Ky draft i kaloi për miratim Qeverisë. Në mbledhjen e datës 28.01.2008 Qeveria vendosi rritjen e normave të ushqimit. Me anën e këtij vendimi, i është lënë detyrë Ministrisë së Mbrojtjes të përcaktojë një sërë normash të tjera për ushtarakët në varësi të gradës dhe pozicionit që kanë. Ministrit të

Mbrojtjes i është lënë detyrë të nxjerrë udhëzim për të përcaktuar trajtimin me ushqim të gatuar pa pagesë për oficerët nënoficerët dhe ushtarët profesionistë, në rast të qëndrimit në repart mbi 8 orë për arsye gadishmërie, apo trajnime dhe stërvitje në terren, në lloje të ndryshme operacionesh brenda dhe jashtë vëndit. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 88 datë 28.01.2008 “Për Miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, u përcaktua rritja e normave të ushqimit të efektivave ushtarakë. Në zbatim të këtij vendimi kanë dalë edhe aktet nënligjore zbatuese siç është urdhëri nr. 388, datë 134.03.2008 i Ministrit të Mbrojtjes “Për trajtimin me ushqim të efektivave ushtarak të F.A të Republikës së Shqipërisë” si dhe urdhëri nr. 324, datë 27.03.2008 i Komandës së Forcës së Bashkuar, “Për trajtimin me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcës së Bashkuar”. Për vitin 2009 disa ushtarakë u ankuan se ju tatóhet vlëra në lekë e kompesimit të ushqimit. Mbas verifikimeve dhe konsultimit me udhëzimet e Ministrisë së Financave kjo ankesë u refuzua nga ana jonë si e padrejtë për shkak se sipas udhëzimit të Nr. 5 të Ministrisë së Financave edhe vlëra në lekë e ushqimit, konsiderohet si e ardhur e shtetasve e për rrjedhojë edhe ajo tatóhet.

4. Për problemin e normave të veshmbathjes nga Drejtoria e Logjistikës çdo vit rinovohet urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes për përmirësimin e normave të veshmbathjes. Në tabelat e reja për oficerët e trupës e të shtabeve janë përmirësuar normat e veshmbathjes, veçanërisht në drejtim të cilësisë së saj. Gjatë viti 2009 në disa raste u konstatua se nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes nuk respektohej e drejta e ushtarakëve për marrjen e normave të veshmbathjes. Për këtë nga ana jonë u kërkuan shpjegime në Drejtorinë e Personelit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në përfundim u quajtën të drejta kërkesat tona duke na u shpjeguar se shkak i këtyre shkeljeve ishin vonesat e shkaktuara nga shtyrja e tenderave. Prej tyre u muar angazhimi se shumë shpejt ky problem do të zgjidhet

5. Lidhur me ankesat për kohën e punës dhe pushimit, Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm, për të realizuar pushimet në ditët e shtuna ka bërë ndryshimin e programit stërvitor edhe për vitin 2009, duke kaluar nga katër cikle stërvitore në tre cikle stërvitore, me qëllim që të garantohet pushimi i ushtarakëve. Mbas çdo cikli stërvitor kryhen 15 ditë pushim. Në ato raste kur ankesat kanë patur të bëjnë me ushtarakët të cilët janë thirrur në punë kur e kërkon misioni i njëjësive ose situata operacionale, ato janë refuzuar nga ana jonë duke u mbështetur në pikën 2 të nenit 31 të Ligjit “Për Statusin e Ushtarakut në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit në këto raste ushtaraku nuk ka të drejtë përfitimi ose pagesë suplementare.

6. Ankesat e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën apo e kanë ndërprerë atë kohë më parë në kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura qysh nga viti 1992 e në vazhdim, zënë një vënd të konsiderueshëm. Këta persona ankohen se, jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegeve të tyre që kanë dalë në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qënë të barazvlefshëm në detyrë, por ata kundërshtojnë edhe inisiativën e Kryeministrit, për të ndryshuar ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh. Mbi bazën e kërkesës së Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në rezervë të Shqipërisë Avokati i Popullit studjoi projekt ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 ”Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ndodhej për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Me shkresën nr. 160, datë 07.07.2008 Avokati i Popullit mendimet e tij ia parashtrroi Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat si dhe Kryetarit të Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Por Kuvendi i Shqipërisë në muajin Maj miratoi ligjin nr.10142 datë 15.05 2009 “Për Sigurimet Shoqërore të Ushtarakëve”. Prandaj Avokati i Popullit e ka kundërshtuar atë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Çështja është në shqyrtim.

7. Ka edhe ankesa të tilla si ajo e shtetasit A.K, i cili është ankuar se jo vetëm është larguar padrejtësisht nga puna, por se i është mohuar edhe e drejta për të marrë me shkrim një vendim të largimit nga puna. Sipas tij është liruar padrejtësisht në moshën 38 vjeçare me 16 vjet punë , kur në bazë të gradës kapiten i takonte të lirohej nga shërbimi pas 18 vjetëve punë. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, shpjegon se emri i kapiten A.K nuk figuron në urdhërin nr. 1256, datë 03.09.2009 të rezervës, dalë nga Ministri i Mbrojtjes. Por ndërkohë kjo ministri nuk ka ndërmarrë asnjë masë për ta kthyer atë në vëndin e mëparshëm të punës.

8. Numri i përgjithshëm i ankesave të ardhura për vitin 2009, kundër Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorit të Atdheut ka qënë 8 ankesa ose rreth 10.8 % e numrit të ankesave të regjistruara për vitin 2009. Mënyra e përfundimit të tyre ka qënë: 5 ankesa janë zgjidhur në favor dhe 3 ankesa të pabazuara si të tilla i kemi refuzuar. Objekti i ankesave të paraqitura ka qënë për zvarritje të pajustificuara në shqyrtimin e dokumentave të paraqitura prej tyre për përfitimin e këtij statusi, për përfitimin e Statusit të Veteranit, për Statusin



e Dëshmorit, apo dhe për përfitime shtesë që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.190, datë 03.05.1995, për veteranët të cilët gjatë luftës kanë qënë në burgjet nazifashiste brënda apo jashtë vëndit.

Qysh në fillim konstatojmë se, Ministria e Mbrojtjes në vite ka bërë vlerësimin e veteranëve duke paraqitur projektet e nevojshme dhe Qeveria ka nxjerrë vendimet përkatëse “Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të LANÇ-it të popullit shqiptar” etj.

9. Gjatë viteve 2004, deri 2009 në zyrën tonë kanë prezantuar ankesat e tyre për zvarritje në shqyrtimin e kërkesave të tyre për dhënien e Statusit të Dëshmorit të Atdheut 41 persona. Në disa raste ata edhe i kanë përsëritur ankesat e tyre.

Nga viti në vit janë grumbulluar gjithsej 491 dosje me kërkesa për dhënien e statusit të Dëshmorit të Atdheut, të cilat prisnin mbledhjen e Komisionit përkatës për të shqyrtuar kërkesat, por ende edhe sot një pjesë e mirë e këtyre ankesave kanë ngelur pa u shqyrtuar nga Komisioni.

Gjatë verifikimit rezultoi se Komisioni i Qëndror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut ka shqyrtuar 72 dosje në mbledhjen e muajit shkurt të vitit 2009 dhe për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura nuk është mbledhur më gjatë vitit 2009. Nga ana jonë u kërkua përsëri që të përshejtohet puna për shqyrtimin e këtyre dosjeve në një kohë sa më të shkurtër, duke bërë mbledhje më të shpeshta të Komisionit. Me ndryshimet e bëra vendimit të Këshillit të Ministrave duke caktuar si Kryetar Komisioni Ministrin e Shtetit shpresojmë që ky problem të marrë zgjidhje përfundimtare gjatë vitit 2010.

10. Një prioritet i rëndësishëm i punës së Avokatit të Popullit që nga viti 2000 ka qënë zgjidhja e ankesave të ushtarakëve aktiv në lidhje me trajtimin e tyre financiar, për shkak të natyrës së vështirë të punës apo punës me orar të zgjatur etj. Në raportet e mëparshme Avokati i Popullit ka rekomanduar nevojën e trajtimit financiar më të mirë të ushtarakëve aktiv si dhe çeljen e fondeve për trajtimin financiar edhe të ushtarakëve të dalë në rezervë apo lirim. Me daljen e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 532 datë 27.04.2009 “ Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave” Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shpresojmë se kënaqen një pjesë e kërkesave të ushtarakëve për trajtim më të mirë financiar.

11. Një kategori ankesash karakteristike për vitin 2009 kanë qënë ato që lidhen me kushtet e banimit dhe të jetesës së ushtarakëve si ato të konstatuara gjatë inspektimeve në Komandën e Forcës së Bashkuar Durrës apo në Universitetin “Skënderbej”. Një pjesë e mirë e këtyre ankesave me ndërhyrjen tonë u zgjidhën aty për aty, kurse për një pjesë tjetër për të cilat kërkoheshin investime, Avokati i Popullit nëpërmjet

rekomandimeve ka kërkuar miratimin e fondeve të domosdoshme për përmirësimin e gjëndjes.

Verifikimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të ushtarakëve është organizuar edhe sipas një plan inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit, i cili parashikon vizita në disa reparte ushtarake nga ana e një ekipi ekspertësh të zyrës së Avokatit të Popullit. Këto vizita organizohen për të parë si respektohen të drejtat dhe liritë e ushtarakëve si dhe kushtet e ruajtjes dhe trajtimit të ushtarakëve të dënuar me ndalim disiplinor . Në ndryshim nga viti 2008, ku si objekt parësor i punës të Njësisë për Parandalimin e Torturës ishte inspektimi i ambjenteve i dhomave të ndalimit disiplinor, në vitin 2009 objekt i punës ka qenë edhe respektimi i të drejtave të ushtarakëve që rrjedhin nga ligji për statusin e ushtarakut, kushtet në të cilat punojnë ushtarakët si edhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të bëra në vitin 2008.

Repartet të cilat janë inspektuar nga ekspertët e zyrës së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009:

1. Akademi e Nënoficerave, Tiranë.
2. Akademi e Mbrojtjes, Tiranë.
3. Regjimenti i Helikopterave, Farkë, Tiranë.
4. Batalioni i Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë.
5. Universiteti Ushtarak Skënderbej, Tiranë.
6. Garnizoni Poshnje, Berat
7. Regjimenti Komando, Zall-Herr. Tiranë.
8. Qendra e Trajnimit të Gardës Mullet, Tiranë.
9. Brigada Detare, Kepi i Palit, Durrës.
10. Reparti Ushtarak Nr. 2001 Plepa, Durrës.
11. Brigada e Mbështetjes Rajonale, Rrapi i Treshit, Tiranë.
12. Brigada e Stërvitjes Bazë, Bunavi, Vlorë.
13. Spitali Qëndror Ushtarak, Tiranë.

Ushtarakët dhe studentët me të cilët është marrë takim janë mbledhur në salla të mëdha dhe ju është bërë e ditur qëllimi i ardhjes së grupit të ekspertëve duke i shpjeguar kompetencat e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe mundësitë që ka kjo zyrë për t'i zgjidhur konkretisht ankesat e tyre. Në këto takime përveç ankesave që janë marrë me shkrim, ekspertët i janë përgjigjur edhe pyetjeve të ndryshme që ushtarakët i kanë drejtuar për t'u njohur me ligjet dhe aktet nënligjore që lidhen me të drejtat e tyre. Ushtarakëve të tjerë që kanë paraqitur ankesa individuale vetëm me gojë, ju është lënë një kopje e formularit dhe janë orientuar për plotësimin e tij dhe adresimin për në zyrën tonë.

Në të gjitha takimet e zhvilluara deri tani, komanda nuk ka nxjerrë pengesa dhe na ka krijuar mundësitë për të marrë takim me shumicën e ushtarakëve që ndodheshin në akademi dhe në reparte. Nga 13 repartet

ushtarake të vizituara në 10 raste Avokati i Popullit ka reaguar nëpërmjet rekomandimeve dhe konkretisht:

### **I. Inspektim në Qendrën e Stërvitjes Bunavi në Vlorë**

Duke marrë shkas nga problemi i ngritur në median e shkruar për rekrutimin me forcë të të rinjve shqiptarë në shërbimin e detyrueshëm ushtarak, Institucioni i Avokatit të Popullit, organizoi më datë 30.01.2009, një inspektim në Brigadën e Stërvitjes Bazë në Bunavi të Vlorës.

Në përfundim të këtij inspektimi, nga analiza në tërësi e fakteve dhe e dokumentacionit të administruar, Avokati i Popullit, me qëllim që të parandaloheshin probleme gjatë rekrutimit në të ardhmen rekomandoi:

1. Të informohen menjëherë në rang kombëtar dhe lokal të gjithë shtetasit lidhur me kushtet, afatet, procedurat dhe sanksionet për rekrutimin e shtetasve shqipëtar.

2. Të përmirësohet puna për koordinimin e të dhënave të shtetasve mbi statusin e tyre arsimor dhe shëndetësor ndërmjet qendrave të rekrutim-mobilizimit, qarqeve, njësive të qeverisjes vendore dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Të vijojë me shpejtësi ekzaminimi i plotë mjekësor pranë Spitalit Ushtarak, Tiranë për të kryer më tej lirime të mundshme. Për të gjithë këta persona që do të vizitohen, të shtyhet afati i pagesës për t'u liruar nga shërbimi ushtarak në qoftë se janë të aftë.

4. Të përshpejtohen procedurat e lirimit të ushtarëve për arsye moshe, gjëndje familjare apo vazhdim të shkollës, pasi që nga dorëzimi i dokumentave nga ana e familjarëve të ushtarëve deri në lirimin e tyre nga Shtabi i Përgjithshëm kalon një periudhë jo më pak se dy javë.

5. Familjarët të cilët paraqiten pranë repartit duhet të priten, të informohen dhe t'u tregohet procedura e saktë që duhet të ndjekin për t'u plotësuar kërkesat e tyre për lirimin e të afërmëve.

6. Personat që dukshëm paraqesin probleme të karakterit shëndetësor duhet të përjashtohen menjëherë nga çdo stërvitje ushtarake deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, pas vizitave mjekësore kompetente.

Duke marrë shkas nga problematikat e gabuara të konstatuara gjatë rekrutimit forcërisht të të rinjve shqiptarë në shërbimin e detyrueshëm ushtarak, Institucioni i Avokatit të Popullit, organizoi më datën 27.04.2009, një tjetër inspektim në Brigadën e Stërvitjes Bazë në Bunavi të Vlorës.

Në këtë inspektim të dytë u vërejt se problemet e konstatuara në muajin Janar 2009, në pjesën më të madhe të tyre, vazhdonin të përsëriteshin. Avokati i Popullit i dërgoi Ministrin të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm një informacion të plotë për atë që u konstatua

dhe rekomandoi edhe një herë tjetër masat për përmirësimin e procesit të rekrutimit të shtetasve. Në muajin prill të vitit 2009 Ministrit të Mbrojtjes Z Gazmend Oketa dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm Gjeneral Maksim Malaj ju dërgua Informacioni mbi studimin e kryer për funksionimin e Komisioneve Mjekësore për rekrutimin e shtetasve në Shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

Në përgjigjen e Shtabit të Përgjithshëm, rekomandimet tona vlerësoheshin të drejta dhe për këtë ishte zhvilluar një analizë në Komandën e Qendrës së Personel-Rekrutimit, me pjesëmarrjen e të gjithë shefave të Qendrave të Rekrutim-Mobilizimit. Gjatë zhvillimit të kësaj analize ishin bërë prezent rastet e konstatuara në rekrutimin e shtetasve në kundërshtim me ligjin, shkaqet e mosfunksionimit të komisioneve mjeksore në Q.R.M, të mosverifikimit të gjëndjes arsimore të shtetasve që rekrutohen si dhe shkeljet ligjore në rekrutimin e shtetasve me pengesa ligjore.

## **II. Inspektim në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk.**

Avokati i Popullit kreu me iniciativën e tij në datën 19.05.2009 një inspektim në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë. Ky inspektim kishte si qëllim kontrollin e dhomave të ndalimit disiplinor, respektimin e të drejtave të ushtarakëve të dënuar dhe trajtimin e tyre.

Në përfundim të inspektimit u rekomandua:

1. Marrja e masave për të bërë të mundur njohjen më të mirë të rregullave mbi ndalimin disiplinor në repart, duke u bazuar në përmbajtjen e Rregullores "Për organizimin e komisionit disiplinor dhe procedurat për dhënien, ekzekutimin e administrimin e masave disiplinore për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", miratuar me urdhërin Nr. 398, datë 14.06.2004 të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Ushtarakët e ndaluar disiplinarisht, në raste të veçanta, të lejohen të flasin në telefon me familjarët, me qëllim që këta të fundit të mos paraqesin shqetësime për "mungesën" e komunikimit me ushtarakun e ndaluar.

3. Të merren masa për eliminimin e lagështirës në dhomat e ndalimit disiplinor.

4. Të programohen fonde për furnizimin e Batalionit të Policisë Ushtarake me dyshekë, batanije dhe çarçafë të rinj.

5. Të programohen fonde për të zgjidhur problemin e furnizimit me ujë të bollshëm të Batalionit të Policisë Ushtarake.

Komandanti i Batalionit të Policisë Ushtarake dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të F.A, në përgjigjen e tyre zyrtare, na informojnë se janë marrë masat për plotësimin e rekomandimeve të ngritura nga Avokati i Popullit.

### **III. Inspektim në Spitalin Qëndror Ushtarak në Tiranë**

Në vitin 2008, Avokati i Popullit, kishte rekomanduar për Spitalin Infektiv Tiranë si më poshtë vijon:

1. Hartimin e një rregulloreje të veçantë të këtij spitali në lidhje me procedurat e trajtimit të pacientëve në kushte karantine.

2. Marrjen e masave për krijimin e ambjenteve të veçanta në repartin infektiv për t'i paraprirë rasteve të epidemive që mund të sjellin futjen e tyre në karantinë, duke respektuar standartet.

3. Mbështetjen financiare të punonjësve të stafit mjeksor që punojnë në repartin infektiv (mjek dhe infermierë) dhe konkretisht shtesë për kushte pune të diferencuar nga kategoritë e tjera.

Në Nëntor te vitit 2009, pas një inspektimi të dytë në këtë institucion, i cili kishte si objekt pune verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të bëra në vitin 2008, u evidentua si më poshtë:

1. Është realizuar pjesërisht pika një e rekomandimit dhe konkretisht percaktimi i rregullave që duhet të ndjekë personeli mjeksor në raste karantine dhe plotesimi i standarteve që duhet të kenë këto ambjente. Kjo është përfshirë në rregulloren e brendshme të repartit infektiv.

2. Është realizuar pika dy e rekomandimit, duke u informuar se shërbimi infektiv në raste epidemish disponon gjashtë dhoma urgjencash madhore me aparaturat e duhura për trajtimin e të sëmurëve rëndë. Pra si përfundim ky spital i asistuar në rikonstruksionin e tij në vitin 2001 edhe nga zyra e NATO-PFP në Ministrinë e Mbrojtjes, ploteson standartet për karantinizimin e të sëmurëve me sëmundje ngjitëse.

3. Nuk është zgjidhur pika tre e rekomandimit për marrjen e një shtese financiare për kushte pune të diferencuar të stafit mjeksor. Kjo me arsytimin se vetë Spitali Qëndror Ushtarak nuk mund të bëjë diferencime pasi politikën e pagave e miraton Ministria e Mbrojtjes. Gjithashtu u informuam se mjekët e këtij reparti nuk marrin as shtesën e pagës për masterat dhe doktoraturat, sikurse e marrin të gjithë mjekët e sistemit shëndetësor në bazë të vendimit të Qeverisë dt.24.12.2008 “Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr. 306, datë 27.06.2002”, ku përcaktohen një sërë ndryshimesh nga të cilat mjekët e këtij spitali nuk kanë përfituar. Po kështu është vepruar edhe për rastet e tjera.

Në prioritetet e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit edhe për vitin 2009 do të jetë organizimi i Ditëve të Hapura dhe inspektimeve me grup ekspertësh në reparte të ndryshme, të Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, me qëllim tërheqjen e ankesave nga ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e Forcave tona të Armatosura si dhe bashkëpunimi më i ngushtë me Drejtoritë e ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e tjera ushtarake për zbatimin korrekt të ligjit dhe zgjidhjen e drejtë të ankesave

të ushtarakëve apo edhe të punonjësve civilë që punojnë në Forcat tona të Armatosura.

## 7. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Numri i ankesave, kërkesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë për vitin 2009 lidhur me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSH) si dhe të institucioneve në varësi të saj, Shërbimin Social Shtetëror, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Inspektoriatin Shtetëror të Punës si dhe strukturat e tyre në rrethe ka qenë **58**. Numri i ankesave dhe kërkesave, për vetë Ministrinë ka qenë **27**.

Janë përfunduar 19 ankesa, të cilat kanë rezultuar: 1 ankesë e pabazuar, 7 jashtë juridiksionit, 7 jashtë kompetence, 4 të zgjidhura në favor të ankuesve. Janë në proces shqyrtimi 8 ankesa. Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar 3 ankesa të mbartura nga viti 2008, të cilat kanë rezultuar: 1 ankesë e pabazuar, 1 me heqje dorë dhe 1 e zgjidhur në favor të ankuesit.

Qytetarë të ndryshëm janë ankuar për probleme të marrëdhënieve të punës, për moszbatim të Kodit të Punës për pagesat e punonjësve, për probleme në fushën e sigurimeve shoqërore, etj. Kështu p.sh. qytetarja Dh.M paraqiti kërkesë për mosdhënie të së drejtës nënës së saj për të përfutur pensionin e pleqërisë të babait të saj, i cili nuk jeton më.

Në objektin e kësaj kërkesë sqarohemi se babai i ankueses kishte punuar 10 vjet në minierat e Belgjikës dhe kishte përfutur pension pleqërie. Duke qënë se ka ndërruar jetë, sipas legjislacionit të shtetit Belg në fushën e sigurimeve shoqërore, pensionin që ai gezonte, ka të drejte ta vazhdojë ta gezojë bashkëshortja e tij, e cila është nena e ankueses dhe jeton në Shqipëri.

Sipas saj, Zyra Kombëtare e Pensioneve në Bruksel i bën me dije nënës së saj se nuk mund ta përfutojë pensionin e pleqërisë të të ndjerit, pasi nuk ka marrëveshje reciproke ndërmjet Shqipërisë dhe Belgjikës në fushën e sigurimeve shoqërore.

Pasi shqyrtuam me shumë kujdes të gjithë dokumentacionin e paraqitur pranë nesh, kërkuam informacion pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Në përgjigje të kërkesës sonë, u informuam se aktualisht nuk ka marrëveshje dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës.

Gjithashtu na u konfirmua fakti se MPCSSH-ja është shprehur e gatshme të bashkëpunojë në këtë drejtim dhe të fillojë negociatat për një marrëveshje dypalëshe me Mbretërinë e Belgjikës në fushën e sigurimeve shoqërore.

- Qytetarja E.P. paraqiti ankesë për largim të pamotivuar nga puna, si dhe mosrespektim të afateve ligjore paraprake të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga MPCSSH.

Ankuesja shprehet se është njoftuar zyrtarisht për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare pa përmendur shkaqet mbi të cilat është kryer largimi nga puna. Sipas saj, duke qënë se ka patur një eksperiencë punë prej 2 vjetësh si inspektore e punës pranë Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit të Punës në Tiranë, nuk janë zbatuar afatet ligjore të njoftimit paraprak për largimin nga puna, sikundër përcakton Kodi i Punës dhe Ligji “Për Statusin e Nëpunësit Civil”.

Në përgjigjen e ardhur nga ajo Ministri, sqarohej se motivacioni i largimit nga puna të ankuses ka qënë për “tregues të ulët të punës gjatë periudhes Janar-Maj 2009”.

Në keto kushte, Zyra jonë e informoi ankuesën se në nenin 153 të Kodit të Punës është përcaktuar se punëdhënësi dhe punëmarrësi, në çdo kohe mund të zgjidhin kontratën e punës për shkaqe të arsyeshme dhe si të tilla konsiderohen të gjitha ato rrethana që objektivisht nuk lejojnë që t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

- Avokati i Popullit në zbatim të përmbushjes së detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të personave që kanë nevojë për shërbime sociale, ka ndërmarre inspektime ne qendrat e përkujdesit shoqëror, ku ofrohen shërbime sociale.

Gjatë vitit 2009 janë kryer **22** Inspektime dhe konkretisht:

1. Inspektim në Shtëpinë e Fëmijes 0-3 vjeç në Tiranë
2. Inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë
3. Inspektim në Qendrën e Zhvillimit në Tiranë
4. Inspektim në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë
5. Inspektim në Qendrën e Zhvillimit “Unë jam si ju”
6. Inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve në Kavajë
7. Inspektim në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç në Shkodër
8. Inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër
9. Inspektim në Qendrën e Zhvillimit në Durrës
10. Inspektim në Qendrën e Zhvillimit në Lezhë
11. Inspektim në Qendrën e të Moshuarve në Kamëz.
12. Inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier
13. Inspektim në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç në Vlorë
14. Inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastër
15. Inspektim në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç në Sarandë
16. Inspektim në Qendrën e Zhvillimit në Vlorë
17. Inspektim në Qendrën e Zhvillimit 12-66 vjeç në Korçë

18. Inspektim në Shtëpinë e Foshnjës ‘‘Hens Kristian Andersen’’, në Shkodër.
19. Inspektim në Shtëpinë e Fëmijës në Durrës
20. Inspektim në Qendrën e Zhvillimit në Shkodër
21. Inspektim në Shtëpinë e Fëmijëve Parashkollorë në Shkodër
22. Inspektim në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç në Korçë

Në takimet që janë zhvilluar me drejtuesit dhe stafin e këtyre Qendrave të Përkujdesit Shoqëror, jemi informuar në lidhje me kapacitetin që duhet të mbajnë këto qendra, me numrin e personelit, kuotat ushqimore, rregulloret e jetës së brendshme dhe standartet që duhet të respektonin punonjësit e qendrave, me organizimin e ekskursioneve apo festave të ndryshme etj.

Megjithëse perkushtimi i stafit të këtyre qendrave ishte i lartë, disa qendra nuk plotesonin shumë nga standartet për ofrimin e shërbimeve sociale.

- **Qendra e Zhvillimit Lezhë**

Gjate inspektimit në këtë qendër konstatuam se:

1. Që prej 12 vjetësh kjo qendër ishte vendosur në katin e dytë të konviktit të shkollës së mesme profesionale. Përbëhej nga një korridor i gjatë dhe dhomat në të dy krahët e tij, ambjentet e të cilave ishin rregulluar dhe përshtatur nga vetë personeli, për t’i krijuar sadopak kushte të mira këtyre personave me aftësi të kufizuara. Ngjytja në katin e dytë krijonte shumë vështirësi për këta persona dhe rrjedhimisht pamundësinë e rehabilitimit të personave para-tetraplegjikë, të cilët janë me karroca. Pra kjo godine nuk ishte e përshtatshme për këtë kategori të sëmurësh.

2. Kjo qendër nuk kishte në dispozicion automjet për të transportuar të sëmurët nga shtëpia në qendër dhe anasjelltas. Mungesa e një automjeti krijonte mjaft vështirësi për familjarët e të sëmurëve, të cilët vinin nga komunat dhe fshatrat përreth. Sipas stafit të qendrës, numri i personave ishte shumë më i madh nga sa trajtohen në qendër, por duke mos patur mundësi transporti, këtyre personave nuk u ofrohen shërbimet e nevojshme për të cilat kanë nevojë, të cilat janë të përcaktuara në standartet e shërbimeve sociale.

3. Kjo qendër nuk ofronte shërbim mjekësor për personat përfitues as me mjek, as me fizioterapist. Ndihej e domosdoshme edhe nga stafi drejtues i Qendrës shtimi në organikë i një mjeku me kohë të pjesshme pune, ashtu dhe të një fizioterapisti.

4. Një problem ishte lagështira e tavanit, pasi në katin e tretë të godinës ndodheshin tubacionet e konviktit, të cilat ishin të amortizuara.

5. Ngrohja ishte e pazgjidhur dhe realizohej me sobë gazi, sepse sistemi qëndror me kaldaje nuk funksiononte.



6. Mensa ishte e papërshtatshme. Ishte një ambjent shumë i vogël, me shtatë tavolina të vendosura njëra pas tjetrës dhe pa karrige. Kishte stola pa mbeshtetje dhe në shumë raste personat që trajtoheshin në qendër ishin rrëzuar.

7. Nga stafi i kësaj qendre na u kërkua rritje e pagave, sepse puna me këtë kategori është shumë e lodhshme dhe e vështirë.

Sa më lart, në këtë qendër nuk plotësoheshin kriteret e standarteve të shërbimeve sociale, ku ofruesit e shërbimeve shoqërore duhet të vendosen pranë grupeve në nevojë që të zvogëlojnë vështirësitë në transport si dhe të jetë lehtësisht i arritshëm nga të gjithë kategoritë e personave në nevojë për të cilët ofrohet shërbimi. Gjithashtu mjedisi dhe pajisjet e shërbimeve duhet të jenë të përshtatshme me kapacitetin, llojin e shërbimit të ofruar, me nevojat dhe interesat e përfituesve. Konstruksioni dhe mjedisi fizik i qendrës së shërbimit duhet të jenë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.

Në këto kushte, ne proceduam me Rekomandim Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Drejtorit të Shërbimit Social Shtetëror për:

- Gjetjen e një zgjidhjeje për vendosjen e kësaj qendre në një godinë të përshtatshme për realizimin dhe efikasitetin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuar.

- Shtimin në organikë të një mjeku me kohë të pjeshme pune dhe të një fizioterapisti.

Në përgjigje të këtij Rekomandimi, Ministri i Punës, na informoi se me VKM nr.850 datë 15.12.2006 ‘‘Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave që janë në përgjegjësi administrimi të SHSSH’’, Qendra Ditore e Zhvillimit në Lezhë kishte kaluar në varësi të Bashkisë Lezhë së bashku me pronësinë e objektit ku zhvillohet ky shërbim.

Në këto kushte ne iu drejtua me Rekomandim Kryetarit të Bashkisë Lezhë, i cili e quajti të drejtë Rekomandimin tonë dhe shprehu angazhimin e tij se Bashkia Lezhë është e predispozuar të nxisë dhe të ndjekë në rrugë ligjore ecurinë e zgjidhjes së gjetjes së një trualli për të ndërtuar një qendër të re, duke i bërë kërkesë për fonde Qarkut Lezhë dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Të kësaj natyre si në Lezhë kanë qenë edhe mangësitë dhe problemet edhe në Shtëpitë e të Moshuarve në Gjirokastrë, Kavajë etj.

Lidhur me Rekomandimet e paraqitura nga ana jonë për 22 Inspektimet e kryera, për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të përfituesve në Institucionet e Përkujdesit Social, Shërbimi Social Shtetëror na informoi se do të merren masat si me poshtë:

- Për përmirësimin e kuotes ushqimore, shtesës në organikën e stafit dhe rikonstruksionit të ambjenteve të Institucioneve të Përkujdesit Social,

do të bëhen rekomandimet në mbledhjet e Këshillit Administrativ të Shërbimit Social Shtetëror, për të bërë ndryshimet e nevojshme si organ vendimarrës në zbatim të VKM nr.542 sate 27.07.2005 ‘‘Per miratimin e Statusit te Shërbimit Social Shtetëror’’.

- Do të përcaktohen detyrat përkatëse për çdo rekomandim ku institucionet përkatëse janë përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e tyre.
- Drejtoria e Inspektimit të Standarteve pranë Shërbimit Social Shtetëror, do të ndjekë me prioritet zbatimin e detyrave të lëna nga Rekomadimet e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit është i vendosur të trajtojë këto çështje dhe në të ardhmen, duke vijuar inspektime periodike. Në përmbushje të kësaj detyre jemi të hapur për bashkëpunim në interes të ndërsjelltë për përmbushjen e misionit tonë.

#### **a. Shërbimi Social Shtetëror**

Ankesa të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit drejtuar Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2009 rezultojnë 9. Nga këto janë përfunduar 8 ankesa, nga të cilat, 2 ankesa te pabazuara, 2 ankesa jashtë kompetence, 4 ankesa në favor të ankuesve. Eshte ne proces shqyrtimi 1 ankese. Gjithashtu është shqyrtuar dhe përfunduar 1 ankesë e mbartur nga viti 2008, e cila ka rezultuar jashtë kompetence.

Gjatë këtij viti ankesat kanë ardhur kryesisht nga të moshuar, të cilët janë azilantë, për kushte më të mira jetese apo të moshuar që janë ankuar për mospranim në Shtëpitë e të Moshuarve.

- I moshuari F.S, në emër të një grupi të moshuarish, ankohej për kushte jo të përshtatshme jetese në Shtëpinë e të Moshuarve në Kavaje.

Ai shprehej se kishin mbi 6 muaj që kërkonin të nderronin këtë shtëpi të moshuarish, pasi kishin probleme me ujin e pijshëm, sistemin e ngrohjes, ushqimit jo cilësor etj.

Pasi u njohëm me problemet e parashtruara në ankesë, i kthyem përgjigje ankuesit, se kerkesat e tyre ishin të drejta. Nga ana e Zyrës së Avokatit të Popullit ishte bërë Inspektimi në këtë qendër dhe u konstatua mosplotësim i standarteve që duhej të ofronte kjo qendër.

- Institucioni i Avokatit te Popullit, nisur nga kronika televizive e transmetuar më datë 20.10.2009 në Top-chanel për rastin e të sëmurit mendor Fatmir Rasho nga komuna Levan në Fier, i cili prej tre vitësh mbahej i mbyllur në një kasolle dhe i lidhur me zinxhirë, mori në shqyrtim me nismën e vet këtë çështje.

Më datë 21.10.2009, përfaqësues të institucionit tonë shkuan në komunën Levan për të kontaktuar me të sëmurin, dhe për të marrë një informacion për mënyrën se si ishte trajtuar nga familjarët dhe nga ana e organeve vendore ky rast, përfitimet që ai gëzonte aktualisht, gjendjen

ekonomike dhe sociale të familjes së tij. Konstatuam se i semuri ishte marrë nga autoritetet e shërbimit shëndetësor dhe ishte deëguar për ekzaminimin e tij pranë Spitalit Psikiatrik në Vlorë.

Gjatë kontaktimit me gjyshen dhe të afërm të tij, si dhe të personave të tjerë të këtij komuniteti, u informuam se Fatmir Rasho ishte i moshës 22 vjeç. Kishte lindur i sëmurë dhe që në fëmijëri ishte shtruar në spitalin distrofik, ku dhe ishte braktisur nga prindërit e tij. Për të ishin kujdesur gjyshërit e tij. Ky i semurë kishte frenkuentuar rregullisht gjatë gjithë këtyre viteve spitalin psikiatrik në Vlorë, por pasi i ishte dhënë ndihma mjekësore, ishte kthyer përsëri në shtëpi.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë, konstatuam se kjo familje, prej tre vetësh, jetonte në një gjendje tejet të mjeruar, vetëm në një dhomë, e cila ishte e pabanueshme. Të sëmurit i kishin ngritur një kasolle në oborr, ngjitur dhomës së tyre. Në atë kasolle të vogël, ai jetonte në kushte ç'njerëzore. Kjo justifikohet me faktin se ky person ishte i dhunshëm dhe shumë herë kishte qëlluar jo vetëm gjyshërit e tij, por edhe persona të tjerë. Prandaj nga ana e tyre ishte mbajtur me zinxhirë për tre vjet. Kjo familje jetonte vetëm me pagesën e aftësisë së kufizuar prej 8700 lekesh që përfitonte nipi i tij i sëmurë.

Nga relacioni zyrtar i bërë nga mjekët e Spitalit Psikiatrik të Vlorës për gjendjen mendore të shtetasit Fatmir Rasho, u informuam se pas ekzaminimit mendor, kishte rezultuar se: Pacienti Fatmir Rasho, i datëlindjes 12.02.1987, ishte me diagnozë **“Prapambetje mendore e rëndë”**.

Institucionalizimi në një spital Psikiatrik do të ndikonte negativisht në humbjen e mëtejshme të aftësive elementare që aktualisht ai i zotëronte. Kishte nevojë për trajtim psiko-social, programe të vecanta rehabilitimi, mbështetje dhe siguri të cilat ia ofrojnë vetëm institucionet përkatëse (qendra rezidenciale rehabilituese) për individë që janë me prapambetje mendore.

Në analizë të akteve ligjore dhe nënligjore, vërejmë se në bazë të VKM-së nr.209 datë 14.04.2006 **“Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit shoqëror”**, Kreu II, përcakton:

*“Mosha për t’u pranuar në institucionet rezidenciale, për personat me aftësi të kufizuara, është nga 0-25 vjeç”*.

Duke marrë shkas nga ky rast, nga përmbajtja e akteve ligjore, del se problemi është mungesa e trajtimit në qendrat e zhvillimit të përkujdesjes shoqërore për të sëmurët mendore që janë mbi moshën 25 vjeç. Kjo ka rezultuar edhe në inspektimet e bëra nga Institucioni ynë gjatë këtij viti në këto qendra, ku aktualisht strehohen të sëmurë mbi këtë moshë.

Për të sëmurin mendor Fatmir Rasho, i cili përveç kushteve ç'njerëzore të jetesës, plotesonte kriterin e moshes për t'u trajtuar nga qendrat e zhvillimit të përkujdesjes shoqërore si dhe për t'i ardhur në ndihmë të gjithë personave të tjerë të sëmurë mendore që janë mbi moshën e kërkuar nga ligji (25 vjec) dhe nuk mund të trajtohen në këto qendra, i Rekomanduam Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror, marrjen e masave për:

1. Sistemimin në Qendrën e Zhvillimit të Përkujdesit Shoqëror në Vlore të të sëmurit mendor Fatmir Ruzhdi Rasho.

2. Ngritjen e një qendre të posacme për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar (të sëmurë mendorë), që janë mbi moshën 25 vjeç.

Në përgjigje të Rekomandimit tonë, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror na informoi se Shërbimi Social Shtetëror, pasi mori në shqyrtim rastin e referuar, vendosi me urdhër pranimit, si rast emergjent për sistemimin e të sëmurit Fatmir Rasho në Qendrën e Zhvillimit Berat, deri në momentin e vendimit të Komisionit Qëndror për pranime në Institucione, në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin sipas VKM nr.209 datë 14.04.2006 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit shoqëror".

Ministritë përkatëse të fushës së zbatimit të detyrueshëm të politikave në fushën e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, duhet të vazhdojnë punën e nisur për përsosjen e këtyre politikave, të përmirësimit të legjislacionit dhe përshtatjes së tyre me standartet më të larta të vendeve të përparuara demokratike.

## **8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve**

Ankesa të paraqitura pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2009 për çështje apo problematika që lidhen me veprimtarinë e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe organet e saj në varësi, rezultojnë gjithsej 115.

Për vetë ministrinë janë trajtuar 31 ankesa, nga të cilat 4 ankesa janë ende në shqyrtim. Përsa i përket çështjeve të përfunduara, janë zgjidhur në favor 11 ankesa, jashtë juridiksionit dhe kompetencës kanë qenë 13 ankesa, ndërsa për 3 prej tyre jemi në kushtet e braktisjes së procedimit administrativ nga vetë ankuesit.

Ashtu si dhe vitet e mëparshme pjesa më e madhe e ankesave ndaj këtij organi lidhet me procedurën e shpronësimeve për interes publik dhe konkretisht ndaj vlerës së dëmshpërblimit të përfituar nga shtetasit, për

humbjen e pronës si pasojë e përdorimit për interes publik të saj. Në këto raste, ankuesit fillimisht janë sqaruar për të drejtat e tyre mbi këtë proces, e që burojnë nga:

- Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, ku në nenin 24 “Ankimimi i vendimit” parashikohet se pronarët e pasurive që zhvlerësohen nga shpronësimi dhe personave të tretë, të drejtat e të cilëve kompensohen për shkak të shpronësimit, vetëm lidhur me masën e shpërblimit të caktuar në vendimin perkates të shpronësimit, kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja e dëgjimit. Përfundimisht ankuesit janë orientuar t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në vendin ku ndodhet organi që ka përcaktuar çmimin e pronës.

Në të gjitha rastet kur kemi konstatuar se ka qenë i mundur shqyrtimi administrativ i çështjes, kemi ndërhyrë fillimisht për verifikimin e pretendimeve të ankuesit, e më pas nëse, konstatohet mosveprim apo veprim i jashtëligjshëm i organit ndaj të cilit ishte drejtuar ankesa, në ushtrim të kompetencave ligjore kemi ndërhyrë për zgjidhjen e çështjes në favor të ankuesit.

Në lidhje me çështjet e filluara me inisiativë vlen të përmendet rekomandimi i paraqitur pranë Drejtorisë së Rrugëve, në lidhje me mungesën e sinjalistikës rrugore, në disa akse rrugore të qarqeve Tiranë dhe Durrës, të inspektuara personalisht nga Avokati i Popullit.

1. Për shkak të aksidenteve të shumta automobilistike të ndodhura gjatë muajit Korrik në autostradën Tiranë-Durrës, si dhe nga paraqitja e një njoftimi, në lidhje me sigurinë e qarkullimit në këtë aks rrugor, nga një diplomat Francez, rezident në Shqipëri, Avokati i Popullit ndërmoi një inspektim në akset rrugore nacionale, përkatësisht: Tiranë-Rinas, Rinas-Fushë Krujë, Fushë Krujë-Kashar-Prezë -Vorë, Vorë Durrës e kthim, në datën 27.07.2009, nga ora 22.30’ deri në orën 24.00’.

Ky inspektim lidhej në mënyrë direkte me zbatimin e dispozitave të Ligjit 8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore, që ky kod i ngarkon organeve përkatëse të administratës publike.

Nga inspektimi i kryer rezultoi se pothuaj në të gjitha akset e inspektuara mungonte ndriçimi rrugor, si dhe në rastet kur ekzistonte infrastruktura për të realizuar një gjë e tillë, në pjesën më të madhe vihej re mosfunksionimi i llambave. Gjithashtu në një pjesë të këtyre akseve u konstatua mungesa e karrexhatave mbrojtëse në mes të rrugës, e në të gjitha mungonte vendosia e tyre në anë të saj.

Në të tilla kushte Avokati i Popullit apeloj për më shumë kujdes dhe profesionalizëm dhe njëkohësisht për më shumë përgjegjësi në ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të ngarkuara me ligj me qëllim që

të shmangen të gjitha ato mosveprime që sjellin pasoja shumë serioze për jetën e individëve.

Nëpërmjet këtij rekomandimi u tërhoq vëmendja për respektimin dhe zbatimin korrekt të dispozitave të Kodit Rrugor, që nga ana tjetër lidhen me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve, qofshin këta drejtues të mjeteve motorrike apo dhe kalimtarë të rastit, të cilët shpesh rezultojnë të jenë viktimat e aksidenteve rrugore.

Duke e konsideruar praktikën e lartpërmendur si fillimin e një procesi konstatues, por edhe rekomandues për përmirësimin e kushteve të lëvizjes në akset rrugore në vend, si dhe për përmirësimin e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve ju rekomandua marja e masave tekniko organizative për përmirësimin e gjëndjes së ndriçimit dhe sinjalistikës rrugore në akset e inspektuara nga ana jonë, bazuar në konstatimet e mësipërme. Gjithashtu u rekomandua fillimi i inspektimeve nga D.P.Rr. për evidentimin e mungesës së ndriçimit dhe të sinjalistikës rrugore në të gjitha akset për të cilat ky organ është enti përgjegjës, si dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjëndjes në të gjitha ato akse që do të evidentohen si problematike.

Në përgjigjen drejtuar institucionit, Drejtori i Përgjithshëm i D.P.Rr., shprehet se në lidhje me problematikën e trajtuar në këtë rekomandim, në bashkëpunim me Drejtorinë rajonale po ndërmerr të gjitha masat e nevojshme tekniko organizative për eliminimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër.

Kjo çështje do të vazhdojë të jetë në ndjekje të vazhdueshme me anë të inspektimeve të ndryshme jo vetëm në akset rrugore të inspektuara fillimisht, por dhe më gjërë.

2. Institucioni i Avokatit të Popullit mori në shqyrtim ankesën e qytetarit Th.G., i cili pretendonte për shkelje të së drejtës së riliçensimit të firmes ku ai është punësuar si drejtues teknik, për shkak të moshës së tij mbi 75 vjeç, nga ana e Komisionit të Posaçëm të Dhenies së Liçensave Profesionale, pranë M.P.P.T.T.

Në përgjigje të shpjegimeve të kërkuara nga ana jonë për këtë problem, Drejtorja e Liçensimit sqaronte se në zbatim të Vendimit nr. 2, datë 17.03.2008 të Komisionit të Posaçëm për dhënien e liçensave profesionale për shoqëritë ndërtimore në zbatim, individët me moshë mbi 75 vjeç nuk mund të regjistrohen në rolin e drejtuesit teknik në shoqëri ndërtimore në zbatim. Për rrjedhim aplikimi i shoqërisë "INTERALBAN" me drejtues teknik Th.G., është konsideruar jo në përputhje me kriterin e sipërpërmendur dhe nuk është trajtuar.

Për sa më sipër zyra e Avokatit të Popullit pas një studimi të kujdesshëm të argumentave të paraqitura nga të dyja palët, si dhe legjislacionit përkatës në këtë fushë, parashtroi rekomandimin përkatës

lidhur me mungesën e kompetencave të këtij organi të administratës publike, në referim të përmbajtjes së V.K.M. nr. 2, datë 17.03.2008.

Konkretisht, Vendimi i K.M. “Për kriteret, procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndër të tjera përcakton kriteret për Drejtuesin Teknik të shoqërive të ndërtimit, si dhe papajtueshmërite me detyren e këtij të fundit, e që në asnjë rast nuk përmendet kufizimi i moshës së drejtuesit teknik, për llogari të rilingësimit të shoqërise në zbatim.

Në këtë kuptim, Komisioni përkatës kishte vepruar në mungesë të kompetencave të tij, duke nxjerrë një vendim absolutisht të paligjshëm dhe si të tillë edhe të pavlefshëm, pasi rregullorja në fjale nuk i jep atij Komisioni asnjë kompetencë konkrete për të nxjerrë kriteret të posaçme për linçesimin e shoqërive në ndërtim, në referim të kufizimit të moshës së drejtuesit teknik.

Për sa më sipër u rekomandua revokimi i Vendimit nr. 2 datë 17.03.2008 të Komisionit të Posaçëm për dhënien e liçensave profesionale për shoqërite ndërtimore në zbatim, i marrë në tejkalim të kompetencave të percaktuara në rregulloren përkatëse për këtë qëllim.

Në përgjigjen drejtuar institucionit na bëhej me dije për marrjen në konsideratë të argumentave të paraqitura si dhe heqjen e kufizimit të liçencimit për efekt moshe të drejtuesit teknik për shoqëritë me aktivitet ndërtues. Pra ankuesi fitoi të drejtën që kërkonte.

\*Pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 9 ankesa në lidhje me veprimtarinë e Entit Kombëtar të Banesave, të cilat pas shqyrtimit të hollësishëm të pretendimeve të paraqitura dhe dokumentacionit bashkëngjitur, kanë rezultuar jashtë kompetencës apo juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Problematika e parashtruar ka të bëjë kryesisht me termat financiare të aplikueshme në marrëdhëniet midis Entit Kombëtar të Banesave dhe personave që përfitojnë banesë me kosto të ulët. Këto tarifa janë më të larta që prej hyrjes në fuqi të Udhëzimit nr. 19 datë 13.09.2007 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët”, i cili rrit çmimin e banesave për m<sup>2</sup> si dhe atë të shesheve funksionale të objekteve me rreth 2%.

Ndër rastet e tilla janë ankesa të paraqitura nga dy shtetas, respektivisht nga qyteti i Elbasanit dhe i Korçës, të trajtuar me banesë me kosto të ulët nga Enti Kombëtar i Banesave, degët përkatëse, për shkak të marrjes së lejes së shfrytëzimit nga zyrat e urbanistikës në bashkitë respektive pas vitit 2007, çmimi me të cilin do të vlerësoheshin këto banesa i referohej Udhëzimit të mësipërm për të cilin këta shtetas, paraqitën pretendimin se çmimi i banesave të tyre duhej të përlllogaritej në bazë të legjislacionit para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi.

Në përgjigje të kërkesës për shpjegime, Enti Kombëtar i Banesave sqaronte se çmimet e banesave dhe shesheve funksionale kishin ndryshuar sipas Udhëzimit nr.19, i detyrueshëm për t'u aplikuar në rastin konkret për shkak të marrjes së lejes së shfrytëzimit pas daljes së këtij Udhëzimi. Pra ankuesve ju dha përgjigje negative.

Në raste të tjera ankuesit kanë kërkuar shmangien e detyrimit financiar të përcaktuar përkundër trajtimit me banesë me kosto të ulët, gjë që në asnjë rast dhe për asnjë kategori të popullatës nuk parashikohet në ligj dhe akte të tjera nënligjore.

\*Në një vështrim të përgjithshëm të veprimtarisë së Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe strukturave në varësi të saj, vlen të përmendet progresi i arritur deri më tani në fushën e infrastrukturës rrugore, duke bërë rrugë të reja, si dhe rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese, të cilat do t'i shërbejnë qarkullimit më të madh të njerëzve dhe mallrave brenda vendit dhe kalimin tranzit të tyre. Nga ana tjetër, ashtu dhe siç jemi shprehur në rekomandimin e sipërcituar më shumë vëmendje i duhet kushtuar sinjalistikës rrugore, dhe mirëmbajtjes së tyre, me qëllim rritjen e sigurisë së qarkullimit rrugor, i cili mbetet një problem tepër shqetësues.

Gjithsesi vlen të përmendet si një shembull negativ mospërfundimi i punimeve për ndërtimin e aksit rrugor Plepa – Durrës – Kavajë. Në lidhje me këtë çështje Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar në vitin 2008 marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e problematikës së trafikut të mbingarkuar në këtë aks, i rënduar sidomos gjatë sezonit veror. Aktualisht vërehet se megjithëse punimet kanë një kohë të gjatë që kanë filluar, duke realizuar nga pikëpamja thelbësore kërkesat e parashtruara në rekomandimin tonë, ende vazhdohet të punohet çka shkakton çrregullime në lëvizjen e mjeteve në këtë aks shumë të rëndësishëm rrugor për vendin.

Një çështje tjetër e filluar me inisiativë dhe ndjekur prej disa kohësh tashmë nga institucioni lidhet me shërbimin hekurudhor. Në vitin 2006 Avokati i Popullit pasi inspektoi në të gjithë vendin dhe la detyra për përmirësimin e kushteve të këtij shërbimi. Por konstatohet se pothuajse nuk është bërë asgjë për rritjen cilësore të tij. Gjithashtu infrastruktura e këtij shërbimi vazhdon të përballet me vështirësi të shumta, pasi gjëndja e binarëve dhe shinave vazhdon të jetë e rënduar. Në fakt rrjeti hekurudhor, për nga cilësia e shërbimit që ofron ngelet një nga më të papërshtatshmit dhe si rrjedhojë më pak të preferuarit për udhëtime brenda vendit, duke shërbyer më së shumti në transportin e mallrave.

Duke mbajtur në vëmendje problematikat komplekse të këtij dikasteri në interes të qytetarëve, por edhe në interesin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të vendit, Avokati i Popullit do të vazhdojë edhe në të ardhmen të ndjekë me përgjegjësi këtë veprimtari për të dhënë



kontributin e tij në përmirësimin e shërbimeve publike që i ofrohen individit nga MPPTT dhe strukturat e saj vartëse.

#### **a. Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik Vendor dhe Kombëtar.**

Hyrja në fuqi e dispozitave ligjore që synojnë eliminimin e paligjshmërisë së ndërtimeve pa leje në të gjithë territorin e vendit, si një eksperiencë negative në kuadrin e zhvillimit të vendit, tashmë kanë zhvendosur fokusin në këto çështje, duke i parë ato jo vetëm si probleme sociale, urbanistike dhe të cilësisë së jetesës, por si probleme që tashmë janë shtruar për zgjidhje përfundimtare.

Organet apo institucionet të cilat me ligj janë ngarkuar për trajtimin e zgjidhjen e këtyre çështjeve, pas përfundimit të funksioneve konstatuese, tashmë janë përfshirë së bashku me individët kundravajtës në një proces funksional, atë të legalizimit të këtyre ndërtimeve pa leje.

Dy janë ligjet e miratuara nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, për zbatimin e të cilave rezulton të jenë dhe problematikat në lidhje me ndërtimet pa leje të paraqitura pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

Konkretisht, Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, i pasuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 438 datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, si dhe Ligji nr. 9780 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Miratimi nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe hyrja në fuqi e Ligjit nr.9482 datë 16.02.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, krijoi bazën e duhur për ndërmarrjen dhe realizimin e një procesi shumë kompleks dhe gjithëpërfshirës, që ka çuar në krijimin e institucioneve të reja specifike për mbarëvajtjen e tij. Por nga ana tjetër, ka shërbyer edhe si një shtysë për realizimin e kuadrit të decentralizimit të pushtetit vendor.

Edhe në Kushtetutën tonë, autonomisë vendore i kushtohet një vëmendje e veçantë në nenin 13 të saj, ku thuhet shprehimisht se:

“Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore”.

Ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, pa dyshim përbën një ndër hapat e parë serioz drejt realizimit të aftësisë efektive të bashkësive lokale për të rregulluar e drejtuar, brenda ligjit dhe nën përgjegjësinë e tyre një pjesë të mirë të çështjeve publike.

Në këtë kuadër vazhdon të mbetet problematik, raporti ndërmjet Inspektorateve Ndërtimore e Urbanistike të Bashkive, Komunave apo të Qarqeve (I.N.U.V.), me Inspektoriatin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (I.N.U.K.). Janë trajtuar mjaft raste kur vendime për prishje të marra nga

I.N.U. vendor nuk janë ekzekutuar brenda afateve të parashikuara në ligjin e sipërcituar, për të cilat është kërkuar ndërhyrja sipas kompetencave ligjore I.N.U.K., ndërkohë që ligji parashikon ndërhyrjen e kësaj të fundit vetëm kur nuk ushtrohen kompetencat ligjore nga I.N.U.V., në rastet kur objekti i paligjshëm është ndërtuar në parqe kombëtare, apo zonë turistike.

Pikërisht limitimi i kompetencave të I.N.U.K., në rastet e mosushtrimit të tyre nga I.N.U.V.-të, vetëm në zonat turistike ose me rëndësi kombëtare, ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm në trajtimin e ankesave konkrete, për shkak të mungesës së organit epror, në kuptimin klasik, pra me kompetenca të plota për ndërhyrje në gjithë territorin e vendit kur konstatohet mosveprim ose mosekzekutim i vendimeve për prishje nga I.N.U.V.

Në këtë kontekst vlen të përhëndetet nisma e qeverisë për krijimin e një projektligji për disa ndryshime në Ligjin 9780 dt. 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, sipas të cilave I.N.U.K. do të mundet të ndërhyjë për kontrollin dhe zbatimin e ligjshëmrisë në fushën e ndërtimit në gjithë territorin e vendit. Këto ndryshime padyshim do të shërbejnë për një përmirësim të mëtejshëm të situatës, e përkthyer në mundësi më shumë në personel dhe mjete për ndërhyrjen ndaj ndërtimeve pa leje.

\*Një problem tjetër shqetësues i vërejtur gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve të paraqitura pranë institucionit, vazhdon të jetë afati i parashikuar në nenin 13 të ligjit “Për inspektimin e ndërtimit” për ekzekutimin e vendimit për prishje. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se afati për zbatimin e vendimit të I.N.U.V.-ve apo Kombëtar është deri 60 ditë. Pra realisht ndërhyrja mund të realizohet që të nesërmen e marrjes së vendimit për prishje, duke mos i lënë kohën e nevojshme shtetasit, të ushtrojë të drejtën e tij të ankimimit në rrugë administrative apo gjyqësore. Gjithashtu kjo dispozitë shkel të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konvetën Europiane për të drejtat e njeriut.

\*Gjatë trajtimit të ankesave të paraqitura, problematik është fakti se I.N.U.V.-ja ushtron kompetencat e tij mbi bazën e dy standarteve të ndryshme, duke i dhënë të drejtë respektivisht zaptuesit të tokës apo edhe pronarit të saj të ligjshëm. Me dy standarte kuptojmë ndërhyrjet selektive të I.N.U.-ve në rastet ku ndërtimi është në proces legalizimi.

Në fakt Ligji për legalizimet nuk parashikon shprehimisht, mosndërhyrjen e I.N.U.V.-ve në rastet kur ndërtimi është në proces legalizimi, por kthimin e tij në gjëndjen e mëparshme, në rast se objekti legalizohet. Është pikërisht kjo dispozitë e cila lë vend për veprime abuzive, por të paatakueshme nga ana ligjore të I.N.U.V.-së, e cila në fund të fundit nuk ka detyrim dhe kompetencë të gjykojë nëse një objekt do të legalizohet ose jo.

Së dyti, referuar ligjit, subjekti i interesuar duhet të provojë se ndërtimi i kryer prej tij është ndërtuar para datës 03.04.2006. Por nga praktika e deritanishme por edhe nga vëzhgimet e bëra, në këtë drejtim është abuzuar pasi janë pranuar për hyrje në proces legalizimi, objekte të përfunduara pas kësaj date apo që do të ndërtohen në të ardhmen. Janë pranuar gjithashtu në proces legalizimi objekte të ndërtuara me konstruksion të përkohshëm, si p.sh. kioska, tenda dyqanesh etj., apo edhe objekte të cilat akoma nuk ekzistojnë.

\*Praktika e mosekzekutimit të vendimit për prishje që po ndiqet në rastet kur ndërtimi është deklaruar pranë degëve të A.L.U.I.Z.N.I.-it, konstatohet si një problem që nuk mund të lihet në heshtje dhe që ka të bëjë me mos harmonizimin e parashikimeve të Ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me legjislacionin tjetër në fuqi. Konkretisht mosekzekutimi i vendimit për prishje, bie në kundërshtim me parashikimet e bëra në gërmat “a” dhe “b”, të nenit 131 të Kodit të Proçedurave Administrative, në të cilat përcaktohen shprehimisht rastet kur pezullohet proçedura e ekzekutimit të një akti administrativ dhe që është në fuqi. Ky është një tjetër konstatim që evidenton një praktikë, e cila nuk duhet lënë thjesht në dëshirën e organeve specifike, sepse patjetër do të sillte veprime ose mosveprime abuzive në dëm të shtetasve, palë në këtë proçedim administrativ.

Gjithsesi, së fundi vërehet një përfundim masiv i shqyrtimit të proçedurave të legalizimit për subjektet që kanë paraqitur formularin e vetëdeklarimit për legalizim të objekteve pa leje, që domosdoshmërisht ndihmon në evidentimin sa më të shpejt dhe eventualisht fillimin dhe përfundimin e proçedurës administrative ndaj ndërtimeve pa leje.

Gjatë vitit 2009, për problematikën e ndërtimeve pa leje që lidhet me veprimtarinë e organit të Inspektoriateve Ndërtimore e Urbanistike, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, rezulton të jenë shqyrtuar 69 ankesa.

Nga ankesat e shqyrtuara deri në fund të vitit 2009, rezultojnë të përfunduara 52 ankesa dhe janë ende në shqyrtim 17 ankesa.

Përsa i përket ankesave të përfunduara, ka rezultuar se janë zgjidhur në favor 26 ankesa, jashtë juridiksionit dhe kompetencës kanë qenë 25 ankesa, ndërsa në një ankesë jemi në kushtet e braktisjes së proçedimit administrativ.

Ashtu si dhe vitin e kaluar trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje në vitin 2009, shfaq një veçori që lidhet me fazën tranzitore në të cilën kaloi organi i Policisë të Ndërtimit, me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për inspektimin e ndërtimit”.

Problematika e kësaj faze ka të bëjë me kalimin e praktikave dokumentare, nga Policia e Ndërtimit tek I.N.U.-të, fazë e cila ishte parashikuar specifikisht në Ligjin “Për inspektimin e Ndërtimit”, të

realizohet në një periudhë tre mujore. Por ka raste konkrete të trajtuara nga ana jonë kur shtetasi kërkonte ekzekutimin e vendimit për prishje të Policisë Ndërtimore, ndërkohë që kopja analoge e këtij vendimi nuk disponohet ende nga I.N.U.-ja e Bashkisë apo e Komunës, çka ka sjellë për pasojë edhe mosekzekutimin e atij vendimi, pra mos përmbushjen e një detyrimi nga ky Inspektoriat. Gjithsesi në të tilla raste, përveç ndërhyrjes institucionale nga ana jonë, ankuesit janë orientuar që të paraqesin një ankesë të re pranë INUV-së.

Në vijim po paraqesim çështjet të vlerësuara në mënyrë pozitive dhe njëkohësisht problematikat që kemi hasur gjatë vitit 2009 me këtë organ, e që lidhen me mosekzekutim apo zvarritje tej afateve të parashikuara ligjore të vendimeve për prishje, për objekte të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin që rregullon fushën e ndërtimit.

1. Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, paraqitën një ankesë banorë të pallatit T.I.D. në Rrugën “Marko Boçari”, Tiranë, të cilët ndër të tjera parashtronin pretendimin e tyre ndaj Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik(I.N.U.) pranë Bashkisë Tiranë. Ankesa lidhet me mosndërhyrjen e këtij organi përsa i përket ndërtimit të një pallati pranë objektit ku ankuesit banojnë, nga firma ndërtuese “SARA-EL”.

Konkretisht ankuesit shpreheshin se nga ndërtimi në vijim u konstatuan çarje të mureve të pallatit, rrëshkitje dhe, si dhe mbushje me ujë e katit nëntokë, që shërben si vendparkimi. Sipas tyre të gjitha këto dëmtime mund të sjellin shëmbjen e pallatit duke rrezikuar kështu jetën e tyre.

Me qëllim verifikimin e pretendimeve të ankuesve, si dhe për tu vënë në dijeni të veprimeve të ndërmarra, kemi kërkuar nga I.N.U.V. shpjegime. Edhe pse në rastin konkret nuk kishim marrë ende një përgjigje zyrtare, edhe pas verifikimit në vend të situatës së krijuar, ishte e qartë se dhënia e shpjegimeve zyrtare në këtë rast do të plotësonin aspektin formal të shqyrtimit të kësaj ankese, pasi ishte evidente mos marrja e asnjë veprimi nga I.N.U.V. Tiranë.

Në zbatim të dispozitave ligjore u rekomandua nga I.N.U.V. Tiranë të procedohet sipas njërës prej mënyrave të parashikuara në nenin 5 të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

Gjithashtu në rekomandim theksohet emergjenca për ndërhyrjen nga I.N.U.V. përderisa në rast shëmbjeje të pallatit pasojat do të ishin katastrofike. Pikërisht kjo është dhe arsyeja që Institucioni i Avokatit të Popullit përveç respektimit të akteve ligjore në këtë dokument rikujtoi dhe detyrimin moral që mbart organi i administratës publike për trajtimin e çështjeve të tilla në ushtrimin e detyrës kundrejt shtetasve.

Në përgjigjen drejtuar institucionit na bëhet me dije se pas verifikimit në vend të rekomandimit përkatës, u konstatuan shkelje të kondicioneve urbane nga firma ndërtuese, për të cilat zyrtarisht është

informuar Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit (D.P.K.Zh.U.T), për trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj çështje.

**2.** Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, banorët të dy pallateve të ndodhur pranë njëri tjetrit në Elbasan, paraqitën një ankesë ndaj Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik të Bashkisë Elbasan, për mosushtrim të kompetencave ligjore ndaj një ndërtimi të paligjshëm, i cili i cënonte rëndë në të drejtën e tyre për të gëzuar lirisht pronën.

Pretendimi i parashtruar bazohej në disa fotografi bashkëngjitur formularit të ankesës, nga ku dukej qartë se kishim të bënim me ndërtim jashtë çdo parametri urbanistik në lidhje me distancat e parashikuara në rregulloren e urbanistikës. Gjithashtu në ankesë theksohej fakti se banorët ishin ankuar disa herë pranë Bashkisë Elbasan, e cila nga ana e saj ka qëndruar indiferente ndaj ndërtimit të paligjshëm i cili ndodhet në qendër të qytetit.

Ne i kërkuam shpjegime nga I.N.U.V.-së Elbasan, sa i përket bazueshmërisë së pretendimeve të paraqitura, si dhe një informacion të hollësishëm lidhur me dokumentacionin ligjor që dispononte pronari i godinës, dhe objektit të sipërcituar.

Në një përgjigje zyrtare lidhur me problemin e parashtruar sa më sipër, na bëhej me dije se pas verifikimit nga inspektorë të I.N.U., rezultoi se firma ndërtuese po ndërtonte shtesë kati dhe zgjerim sipërfaqe ndërtimi pa leje. Në të tilla kushte u mbajt proces verbal për pezullimin e punimeve deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor nga ndërtuesi, si dhe u mor vendim për vendosje gjobe sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 5, të Ligjit 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

**3.** Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, banorë të pallateve 305 dhe 306, në Rr. “Jakov Xoxa”, Fier, paraqitën një ankesë në të cilën ndër të tjera parashtrohej shqetësimi dhe pretendimin ndaj Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik( I.N.U.) pranë Bashkisë Fier, sa i përket një objekti pranë pallatit ku banonin, në ndërtim e sipër, me leje të miratuar me vendim të K.Rr.T. të Bashkisë Fier.

Sikundër shkruhej në letrën drejtuar institucionit, nga ndërtimi në vijim janë konstatuar çarje të mureve të pallatit nr. 305, duke rrezikuar shëmbjen e tij dhe njëkohësisht jetën e banorëve. Gjithashtu parashtrohej vijimi i punimeve jashtë projektit të miratuar së bashku me lejen e ndërtimit, si dhe mosrespektim flagrant i distancave të parashikuara në rregulloren e urbanistikës.

Përkundër indiferencës totale në këtë rast të I.N.U.V. Fier, këta shtetas kërkuan ndërhyrjen e Avokatit të Popullit.

Me qëllim të zgjidhjes së çështjes së sipërcituar dhe mbrojtjen sa më efektive të interesave dhe të drejtave të shtetasve, Avokati i Popullit bëri kërkesë për shpjegime drejtuar I.N.U.V. Fier.

Në përgjigjen e Kryeinspektorit të I.N.U.V. Fier, na bëhej me dije se pas verifikimit sa i përket objektit në ndërtim nga subjekti ndërtues, u konstatuan shkelje në respektimin e kondicioneve dhe përmasave të sheshit të ndërtimit të miratuar, si dhe mosmarrje e masave përkatëse për ruajtjen e objekteve ekzistuese.

Shkeljet e pasqyruara në proces verbalin përkatës, u shoqëruan me një sërë aktesh administrative, si vendosje gjobe dhe pezullim punimesh.

Së fundmi Kryetari i Bashkisë lëshoi një urdhër për pezullim punimesh, në të cilin gjithashtu urdhërohej firma ndërtuese të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e dëmtimeve të krijuara në objektin ekzistues.

Për sa më sipër ankesa u mbyll në favor të ankuesve, edhe si pasojë e sensibilizimit të strukturave të pushtetit vendor për ndërhyrje të menjëhershme ndaj subjektit ndërtues.

Përfundimisht, në përgjithësi mund të thuhet se Inspektoratet Ndërtimore, kanë dhënë rezultate në disiplinimin e fushës së ndërtimit. Në fakt një ndër arsytet e transformimit të Policisë Ndërtimore në I.N.U në varësi të pushtetit lokal, ishte krijimi i një institucioni më të ndjeshëm dhe gjithmonë në korrent të veprimtarisë së paligjshme në fushën e ndërtimeve, më afër shtetasve për çdo problem që ato kishin në këtë fushë dhe në të gjithë territorin e vendit.

Gjithsesi për sa i përket rasteve të sipërcituara, të cilat janë zgjidhur në favor të ankuesve, por dhe atyre që kanë rezultuar jashtë kompetencave të institucionit, jo rrallë konstatohet inaktivitet apo përzgjedhje selektive në ekzekutimin e vendimeve, që përbën një tregues negativ në përmbushjen e detyrimeve që përcaktohen prej Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

Praktika të tilla duhet të shmangen dhe forca e ligjit duhet të ushtrohet njësoj mbi të gjithë, duke mos diskriminuar njeri për shkaqe nga më të ndryshmet.

Në këtë kuptim përmirësimet legjislative të sipërcituara si edhe konsolidimi i mëtejshëm i këtij organi do të sillte një mbrojtje më efektive të të drejtave të qytetarëve si edhe një zbatim më rigoroz të këtij Ligji nga organet e ngarkuara më këtë qëllim, duke shmangur në këtë mënyrë veprime apo mosveprime abuzive në dëm të tyre.

Gjithsesi Avokati i Popullit nuk do të ngurojë të ushtrojë kompetencat e tij edhe në të ardhmen duke u bërë protagonist aktiv në mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të thjeshtë apo të komuniteteve të gjerë të popullsisë nga ndërtime informale që i çenojnë ato në jetën e përditshme.

## **b) Ankesat për Ujësjellës Kanalizimet**

Gjatë vitit 2009, janë shqyrtuar 6 ankesa që kanë patur të bëjnë me Ndërmarrjet e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve. Nga këto 3 ankesa janë zgjidhur në favor, 2 është ende në shqyrtim, dhe 1 ankesë ka qenë jashtë juridiksionit të zyrë së Avokatit të Popullit.

Në vijim po trajtojmë ankesat e zgjidhura pozitivisht:

**1.** Një nga çështjet më problematike të konstatuara gjatë këtij viti, rezultoi të ishte vështirësia në furnizimin me ujë të pijshëm dhe mungesa totale në kanalizimet e ujrave të bardha dhe të zeza të komunitetit rom, që banon në brigjet e Lumit Bunë në Shkodër.

Konkretisht kjo zonë e banuar pothuaj ekskluzivisht nga komuniteti rom, prej vitesh vuante mungesën e ujit të pijshëm dhe mungesën totale të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe të bardha. Është e vetëkuptueshme që cilësia e jetës në këtë lagje ishte jashtë çdo norme. Ankesave të përsëritura të banorëve në Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Shkodër, u jepej përgjigje se s'kishin ç'tu bënin, ose kjo çështje do të shikohej më vonë.

Në fakt, ekspertë të Institucionit të Avokatit të Popullit, konstatuan nga afër gjëndjen e krijuar në këtë vendbanim, gjatë të cilit rezultoi mungesa totale e kanalizimeve.

Me pranimin e ankesës për shqyrtim, i jemi drejtuar me anë të një shkrese zyrtare, Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime (N.U.K.) pranë Bashkisë Shkodër, për të kërkuar shpjegime lidhur me pretendimin e parashtruar, si dhe në kushtet e konstatimit konkret nga ekspertë të Avokatit të Popullit u kërkuar gjithashtu një informacion i hollësishëm për masat e marra me qëllim përmirësimin e gjëndjes së krijuar.

Në përgjigje të shkresës tonë, titullari i ndërmarrjes na bënte me dije se për shkarkimin e ujrave të zeza të kësaj lagje nevojitej një sistem i veçantë kanalizimesh me shkarkim të veçantë në lumin Drin, për ndërtimin e të cilit duhet një investim financiar, aktualisht i papërbalueshëm nga kjo ndërmarrje. Gjithsesi, Ndërmarrja e U.K. sh.a. Shkodër, është në një nga fazat e projektimit për "Furnizimin me ujë dhe mbrojtjen mjedisore të Liqenit të Shkodrës", financuar nga donatorë të huaj, dhe në kuadrin e këtij projekti është përfshirë zgjidhja e zonave turistike Shirokë-Zogaj për problemin e rrjeteve ujësjellës-kanalizime.

Gjatë zbatimit të këtij projekti, edhe si pasojë e ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, nga ana e kësaj ndërmarrje do të sugjerohej që në një nga fazat e tij të zgjidhej dhe ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të zeza të kësaj lagjeje.

**2.** Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, është paraqitur ankesa e qytetarit E.P., me ane të së cilës ankohej për zvarritje nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, në drejtim të mosvënies së sahatit matës në banesën e tij.

Konkretisht, qytetari sqaronte se faturohej afrofe prej shumë vitesh, megjithëse gjithë familja e tij jetonte në Itali, dhe për arsye të mungesës se pjesëtarëve të familjes kishte kërkuar vendosjen e sahatit në banesë, me qëllim evitimin e faturimit afrofe.

Për sa më sipër, Zyra e Avokatit të Popullit i ka kërkuar shpjegime në mënyrë të përsëritur Ndërmarrjes së Ujësjiellës Kanalizimeve Tiranë, lidhur me problemin e parashtruar.

Në përgjigje të këtyre kërkesave, dhe pas kontaktimit në vend me nga ana jonë me punonjësit e Ndërmarrjes së Ujësjiellës Kanalizimeve Tiranë, zyra jonë u informua se problemi i ankuesit A.P. gjeti zgjidhje, dhe qytetarit iu vendos sahati matës në banesë.

### **c) Ankesa ndaj shoqërisë së telefonisë fikse, Alb-Telekom**

Ankesat e paraqitura pranë zyrës së Avokatit të Popullit ndaj kësaj shoqërie kanë qenë në total 9, nga të cilat 1 ankesë ka rezultuar e pabazuar, 6 jashtë juridiksionit dhe në mungesë të kompetencave të zyrës tone, dhe 1 ankesë zgjidhur në favor të ankuesit. Një ankesë është akoma nën trajtim përgjatë vitit 2010.

Konkretisht, qytetarë të ndryshëm gjatë vitit 2009 kanë prezantuar shqetësimin e tyre për largimet nga puna, pasi ankuesit kanë qenë punonjës të shoqërisë Alb-Telekom. Nga dokumentacioni bashkëngjitur këtyre ankesave, zyra jonë ka vërejtur se largimet nga puna janë arsyetuar në bazë të ristrukturimit të punonjësve të kompanisë Alb-Telekom, bazuar kjo në nenet 143,145 dhe 148 të Kodit të Punës.

Nisur nga fakti që marrëdhëniet e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, rregullohen me kontratën kolektive dhe individuale që nënshkruhet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, kontrate e cila mund të ishte me afat ose pa afat të përcaktuar si dhe nenit 153 të Kodit të Punës që përcaktonte se punëdhënësi dhe punëmarrësi, në çdo kohë mund të zgjidhnin kontratën e punës për shkaqe të arsyeshme dhe si të tilla konsideroheshin të gjitha ato rrethana që objektivisht nuk lejonin që t'i kërkohej atij që kishte zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës, zyra e Avokatit të Popullit konkludoi si më poshtë vijon:

Në rastet konkrete, por dhe të shumë të tjerëve në cilësinë e punëmarrësve në kontratën e punës, ndërhyrjet tona institucionale nuk kishin munguar. Por nuk kishte pasur hapësirë ligjore për të ndryshuar situatën me qëllim rikthimin në punë, iniciativë e cila megjithëse ishte ndërmarrë rast pas rasti, në shumë raste kishte sjellë humbjen e afateve ligjore për ankuesit, në ndjekjen e çështjes gjyqësisht. Në këto kushte gjykuam se meqënëse nga pikëpamja ligjore nuk mund të ndryshonim asgjë në rifitimin e të drejtave të ankuesve, do ishte në interesin e këtyre punonjësve të larguar, që për zgjidhjen e çështjes t'i drejtoheshin Gjykatës, sepse edhe sipas dispozitave të Kodit të Punës, Gjykata



vendoste përfundimisht nëse kishin ekzistuar shkaqe të arsyeshme për zgjidhjen e kontratës apo jo dhe nëse ndërprerja e marrëdhënieve të punës bëhej padrejtësisht nga ana e punëmarrësit, atëhere duhej të vendoste dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar nga këto veprime të padrejta dhe të pabazuara.

Në përgjigjet e dhëna, zyra e Avokatit të Popullit sqaroi gjithashtu qytetarët dhe mbi të drejtat legjitime që buronin nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës për arsye ristrukturimi, të cilat ishin ato të trajtimit nga punëdhënësi me një vit asistencë dhe shpërblimin për çdo vit vjetërsie në punë, që ishte 15 ditë te plota page për çdo vit pune.

## 9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës

Për vitin 2009 janë trajtuar gjithsej 16 ankesa për vetë Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Së bashku me numrin e çështjeve të ndjekura me organet në varësi të METE-s janë trajtuar gjithsej 74 ankesa, nga të cilat 16 prej tyre pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, 5 kanë qenë jashtë juridiksionit, 20 në mungesë të kompetencave, 16 janë zgjidhur në mënyrë pozitive, 4 ankesa janë arkivuar pasi ankuesit kanë hequr dorë. Nga 8 ankesa të trajtuara me rekomandim 7 prej tyre janë pranuar dhe janë zgjidhur pozitivisht, ndërkohë që 1 rekomandim i zyrës tonë nuk është pranuar, dhe 3 ankesa janë ende në shqyrtim.

Në vijim po paraqesim disa nga ankesat e zgjidhura pozitivisht, duke nxjerrë në pah edhe problematikat kryesore me të cilat është përballur puna e Avokatit të Popullit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe strukturat administrative në varësi të saj.

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit një ankesë në emër të banorëve të Komunës Qesarat, të cilët ankoheshin ndaj Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për mosmarrjen e masave për shpronësimin e këtyre banorëve nga dëmtimi i pronave të tyre si pasojë e kryerjes së punimeve për ndërtimin e Hidrocentralit të Kalivaçit.

Avokati i Popullit pasi mori në shqyrtim ankesën konkrete, iu drejtua Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, duke i kërkuar dhënien e sqarimeve për këtë problem, në drejtim të informimit në një kohë sa më të shpejtë të këtyre banorëve, por dhe marrjes së masave përkatëse për problemin e parashtruar nga ata.

Nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, u vumë në dijeni se në datë 11.06.2009, ishte lëshuar autorizimi përkatës për lidhjen e aktmarrëveshjes për shpronësimin e gjithë banorëve të Komunës Qesarat. Pas kësaj, do të përgatiteshin edhe listat përfundimtare me emrat e pronarëve të cilët prekeshin nga shpronësimi, ku ishin përcaktuar sipërfaqet kadastrale me çmimet përkatëse dhe vlerat e

kompesimit për çdo pronar. Gjithashtu, nëse do të kishte dëmtime në kulturat bujqësore do të jepeshin edhe vlerat për këto dëmtime, të cilat do të likujdoheshin nga konçensionari.

Pas informimit të bërë për këtë problem nga zyra jonë, ankuesve iu ofrua dhe një kopje e këtij konfirmimi zyrtar të dhënë nga Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, për zgjidhjen e problemit të pretenduar.

2. Një grup qytetarësh, në cilësinë e ish punonjësve të larguar nga puna si pasojë e riskstrukturimit, nga shoqëria “ARMO” sha, u paraqitën pranë zyrës së Avokatit të Popullit duke pretenduar me anë të një ankese, se VKM-ja nr. 261 datë 17.02.2008, (që ngarkonte Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe zbatimin e këtij vendimi), nuk kishte gjetur ende zbatim dhe në këto kushte të drejtat e tyre të cituara në të nuk ishin plotësuar.

Për këtë problem, Avokati i Popullit iu drejtua Ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, duke i kërkuar një informacion lidhur me situatën e krijuar. Për sa më sipër, me qëllim marrjen e një informacioni sa me të shpejtë të këtij problemi, përveç shkresës së mësipërme, eksperti i zyrës së Avokatit të Popullit mori komunikim direkt me Drejtoreshën e Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare. Në këtë takim, nga ana jonë u pyet rreth kontakteve që Ministria kishte pasur me perfaqësuesit e kompanisë “ARMO” të privatizuar tashmë, dhe nga ana e Drejtoreshës së METE-s u informuam se ishin bërë shume takime në nivel Ministri, si dhe ishin dërguar disa shkresa ku kërkohej zbatimi i VKM-së së mësipërme.

Drejtoresha, sqaroi në vijim se në VKM-në nr. 261 datë 17.02.2008, ishte parashikuar një fond prej 376 000 000 lekësh, i llogaritur për 606 punonjësit që dilnin të papunë si pasojë e ristrukturimit, por që në vijimësi ky fond kishte rezultuar jo i plotë pasi në të nuk ishte llogaritur dhe dhënia e shpërblimit të vjetërsisë në punë, por vetëm asistenca vjetore. Në këtë kuptim, punëtorët vijonin të përfitonin asistencë, por tashmë drejtuesi i shoqërisë “ARMO” pretendonte se nga fondi që qeveria kishte llogaritur për të trajtuar punonjësit ishte dhënë i gjithi në drejtim të asistencës, dhe për pasojë nuk kishte detyrimin të nxirrte fonde shtesë nga llogaria e shoqërisë dhe për shpërblimin për vjetërsi në punë.

Megjithatë, qëndrimi përfundimtar i METE-es në këtë takim ishte ai që punonjësit vetë duhet të hidhnin në gjyq shoqërine ARMO, dhe METE do t'i mbështeste në kërkesat e tyre.

Avokati i Popullit konkludoi se, orientimi për të zgjedhur rrugën e gjyqësorit përfundimisht për zgjidhjen e të drejtave të këtyre punonjësve, linte vend për diskutim, sepse kjo menyrë i shtonte zvarritjet administrative akoma dhe më shumë kundrejt këtyre qytetarëve, për të

arritur një të drejtë të njohur ligjërish si me Kodin e Punës, ashtu dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave. Kjo gjë, pasi nuk duhej harruar që procesi gjyqësor kishte një kosto financiare në një kohë kur këta persona jetonin me të ardhura minimale, të cilat për hir të së vërtetës po u mohoheshin çdo ditë. Duke pasur parasysh edhe kalvarin e gjatë që duhej të ndiqnin rrugëve të gjyqësorit dhe në vijim atij të permbarimit, krijonte përshtypjen e gabuar se ata nuk po përkraheshin nga Institucioni i METE-es si autoriteti i ngarkuar në zbatim të VKM-së nr. 261 datë 17.02.2008.

Në këtë kuptim, zyra jonë duke mos pasur informacion të plotë të detyrimeve dhe të drejtave kontraktore që kishin lindur midis palëve në bazë të privatizimit të shoqërisë “ARMO”, konstatoi paligjshmërinë e veprimeve të shoqërisë “ARMO”, por dhe mosargumentim të drejtë të qëndrimit të Institucionit të METE-es, me qëllim detyrimin e shoqërisë “ARMO” të paguante shpërblimin e vjetërsisë në punë për ankuesit.

Në vijim të argumentave të paraqitura më sipër, shtuam gjithashtu se nëse fondi i llogaritur (prej 376 000 000 Lekësh) në qëllim të trajtimit financiar me asistencë dhe shpërblim të vjetërsisë në punë, nuk mund të mbulonte të dy këto zëra për 606 puntorët e larguar nga puna, atëhere dikush duhet të mbante përgjegjësinë disiplinore për këtë parregullsi. Megjithëse me VKM-në Nr. 1523, datë 19.11.2008, ishte bërë ndryshimi i VKM-së nr. 261 datë 17.02.2008, që shoqëritë do të përballonin me likuiditetet e veta fondet e llogaritura për pagesën e punonjësve që dilnin si të papunë, dhe në këtë kuptim, çfarëdo pretendimi nga ana e shoqërisë “ARMO” nuk mund ngrinte justifikime dhe zvarritje të mëtejshme, pasi këto detyrime ishin marrë përsipër nga kjo kompani automatikisht me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit rekomandoi marrjen e masave konkrete nga METE, për zbatimin e VKM nr. 261 datë 17.02.2008, në drejtim të përfitimit të pagesës së vjetërsisë në punë të ish punonjësve të shoqërisë “ARMO” sha, pas largimit të tyre si pasojë e ristrukturimit.

Në shkresën Nr. 7923 Prot, datë 17.11.2009, nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës u vumë në dijeni se ky problem po ndiqej me prioritet, duke u ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për shlyerjen e gjithë detyrimit.

**a. Ankesat për Korporatën Elektroenergjitike (KESH) Sh.A. dhe shoqërinë OSSH sh.a.**

Gjatë vitit 2009 Avokati i Popullit ka trajtuar 55 ankesa kundër kompanise KESH sh.a. si dhe asaj OSSH sh.a. të privatizuar tashmë pjesërisht nga kompania Çeke, ÇEZ. Nga këto ankesa të trajtuara nga zyra jonë, 11 ankesa janë zgjidhur pozitivisht, 14 prej tyre kanë rezultuar të pabazuara, 2 kanë qenë jashtë juridiksionit, 16 ankesa kanë rezultuar në mungesë të kompetencave tona. Nga 7 ankesa të trajtuara me

rekomandim 6 janë pranuar, ndërkohë që 1 rekomandim nuk është pranuar, 3 ankesa janë arkivuar për shkak se ankuesit kanë hequr dore, dhe 2 ankesa janë ende në shqyrtim.

Në vijim do të prezantojmë disa nga çështjet të cilat kanë rezultuar pozitive, si dhe problematikën që ka hasur Avokati i Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave konkrete:

**1. Zyra e Avokatit të Popullit, trajtoi ankesën e paraqitur nga një grup punonjësish të larguar nga puna në cilësinë e inspektoreve të Shërbimit të Kontrollit të Energjisë Elektrike (SHKEE), pasi pretendonin se nuk ishin trajtuar financiarisht sipas Kodit të Punës, si dhe nuk ishin informuar në kohë për largimin e tyre nga puna.**

Për sa më sipër, në përgjigje të kërkesës për shpjegime të zyrës së Avokatit të Popullit, Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare na informoi se, Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike (SHKEE), në varësi të Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare krijuar menjëherë mbas shkrijës së Policisë Elektrike, financohej nga KESH sha me qëllim kontrollin e përdorimit të Energjisë Elektrike nga përdoruesit dhe administruesit e saj. Me ndryshimet e nevojshme ligjore dhe miratimin e Ligjit nr. 9997, datë 22.09.2008 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, u hoq e drejta e kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike nga strukturat shtetërore (SHKEE) e krijuar për këtë qëllim, duke i lënë hapësirat e nevojshme OSSH sha (tashmë operatorit privat CEZ) për ta administruar dhe kontrolluar vetë përdorimin e energjisë elektrike.

Në këto kushte Këshilli Mbikqyrës i KESH sha vendosi ristrukturimin e SHKEE dhe transformimin në një departament që do të arkëtojë detyrimet e prapambetura të ish klientëve të KESH sha deri më datë 31.12.2006, si dhe gjobat e dëmet e paarkëtuara të vendosura nga ish Policia Elektrike dhe SHKEE. Ky departament aktualisht përbehej nga një grup i vogël punonjësish që në vazhdimësi do të reduktoheshin. Si pasojë e këtij ristrukturimi do të zgjidhej kontrata e punës me rreth 20 punonjës, të cilët njoftimin e parë verbal e morën nga Drejtori i Përgjithshëm në datën 22.12.2008, në një takim të përbashkët.

Në zbatim të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, u përgatitën njoftimet për punonjësit që do të largoheshin nga puna dhe në afatet e duhura ligjore u bë ndërprerja e marrëdhënieve të tyre nga puna. Në kuadër të ndërprerjes së marrëdhënieve financiare u krye pagesa për efekt të afatit të njoftimit për një muaj pavarësisht kohës së qëndrimit të tyre në detyrë, për shkak të gjëndjes jo të mirë financiare të Koorporatës.

Nisur nga kjo pamundësi financiare e Koorporatës, por edhe në plotësim të vakumit ligjor në lidhje me mënyrën e trajtimit financiar të punonjësve që dalin të papunë nga ristrukturimi i KESH sha, Këshilli Mbikqyrës i KESH sha i kishte propozuar Ministrisë së Ekonomisë,

Tregtisë dhe Energjitikës që të paraqeste pranë Këshillit të Ministrave një projektvendim, i cili parashikonte trajtimin e këtyre punonjësve me pagën e një viti.

Për sa më sipër, duke analizuar argumentat e paraqitura nga ana shoqërisë KESH sha si dhe legjislacionit në fuqi për këtë problem, zyra jonë konkludoi se gjëndeshim përball zvarritjeve administrative të pajustificuara, dhe aspak ndonjë vakumi ligjor (sikundër shprehej kompania KESH sha) për zgjidhjen e kërkesave të këtyre punonjësve, të cilat gjenin zgjidhje të drejtëpërdrejtë po t'iu referoheshim dispozitave të Kodit të Punës dhe Ligjit “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht, në Kodin e Punës në bazë të nenit 145 pika 1 dhe 2 që përcaktonte se:

“(1) Punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Punëmarrësi e humb të drejtën e shpërblimit për vjetërsi, nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm, për shkaqe të arsyeshme.

(2) Shpërblimi për vjetërsi është të paktën sa paga e një 15 ditëshi, mbi çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës që ekziston në përfundim të marrëdhënieve të punës”.

Gjithashtu në këtë kuptim, Ligji Nr. 7703 datë 11.5.1994 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktonte në nenet 53-55 të tij rastet e përfitimit të pagës për këta punonjës deri në një vit, për shkak të humbjes së vendit të punës për arsye të cilat nuk vareshin nga i punësuari.

Konkretisht, neni 53 pika 1 që përcaktonte se:

“1. Personat e siguruar përfitojnë të ardhura papunësie, në rast se: kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj për çdo rast përfitimi”.

Pra për sa më sipër, na rezultonte se KESH sha, në rolin e punëdhënësit, përgjigjej krahas dëmshpërblimit të vjetërsisë në punë dhe për pagën në formë asistence deri në 12 muaj, si pasojë e detyrimeve që rridhnin nga kontrata e punës dhe Ligjit “Për Sigurimet Shoqërore” për këta punonjës, që kishin vjetërsi pune më tepër se 3 vjeçare pranë Policisë Elektrike, marrëdhëniet e punës të të cilëve ishin transferuar në vijim pranë SHKEE-së.

Për këtë fakt, Avokati i Popullit kontestoi pretendimin se KESH sh.a. kishte përmbushur detyrimin e saj duke paraqitur pranë METE propozimin për trajtimin me anë të një VKM-je rastin e punonjësve të larguar nga puna si pasojë e ristrukturimit, dhe në këto kushte rekomanduam marrjen e masave të menjëhershme dhe konkrete për këtë problem. Kjo gjë, pasi vete kompania KESH sh.a. pranonte se puna e kryer me përgjegjësi nga punonjësit e SHKEE-së, kishte sjellë fitime dhe

të ardhura në drejtim të kompanisë KESH sha, gjatë mbledhjes së gjobave dhe detyrimeve të parapambetura të abonentëve.

Për sa më sipër, Zyra jonë vijoi argumentimin e këtij rekomandimi duke theksuar se paligjshmëria e mostrajtit korrekt financiar të punonjësve që nga muaji Janar 2009, kur ishte bërë ndërprerja e marrëdhënieve të tyre të punës, ngarkonte me përgjegjësi të drejtëpërdrejtë si Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, ashtu dhe kompaninë KESH sh.a. Të dy këto institucione duke parashikuar prej kohësh procedurat e ristrukturimit apo shkrires së kësaj njësie (SHKKEE-se), nuk kishin marrë masa veprimi për t'ju përgjigjur kërkesave të ligjit, që buronin nga Kodi i Punës (për marrëdhëniet e punës punëdhënës-punëmarrës), si dhe ato në bazë të Ligjit “Për Sigurimet Shoqërore”.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a., na ofroi një informacion me anë të të cilit, konfirmonte zgjidhjen e kërkesave të punonjësve të larguar në bazë të Kodit të Punës, dhe pranimin e rekomandimeve të bëra nga Zyra e Avokatit të Popullit.

2. Nga ankesat e paraqitura pranë zyrës tonë për vitin 2009, në drejtim të OSSH-së është vënë re se qytetarët vijnë të paraqesin ankesa për abuzime gjatë punës së faturistëve të OSSH-së, lidhur kjo me ata abonentë të cilët disponojnë sahatë të rregullt matës në banesa. Ky fakt, megjithë disponibilitetin e OSSH-së për të ballafaquar sahatët me qytetarët, përsëri nuk ka rregulluar totalisht gjëndjen e krijuar, pasi këta qytetarë kanë vijuar të pretendojnë se faturimi i bërë nga kompania OSSH ka qenë tepër i lartë, duke krahasuar aparaturat modeste që dispononin qytetarët në banesat e tyre.

Ritheksojmë fenomenin që dëmton ndjeshëm abonentët në vend, dhe që mbetet ende premtim i pambajtur nga ana e kompanisë OSSH sha për instalimin e matësve dhe me këtë rast moseleminimi i faturimit afrofe. Kjo tregon edhe një herë mungesën e seriozitetit të kësaj kompanie për të përmbushur në kohë një detyrim ligjor, të cilin kishte premtuar që të zgjidhë deri në fund të vitit 2009. Ky fakt çon në atë që për sa kohë do vazhdojnë faturimet afrofe në arkëtimin e të ardhurave të OSSH sha, kjo kompani do të vijojë të mos jetë e besueshme për konsumatorin dhe do të kontestohet vazhdimisht.

Nisur nga faktet e konstatuara më sipër, me datë 11.11.2009 Avokati i Popullit personalisht, zhvilloi një takim me Kryetarin e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike Z. Bujar Nepravishta. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i mendimeve dhe marrja e sqarimeve të nevojshme për cilësinë e shërbimeve të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve dhe për propozimet e fundit të OSSH-së për rritjen e çmimit të energjisë.

Nga ana e Avokatit të Popullit, midis të tjerash u kërkuar që Enti Rregullator i Energjisë Elektrike në vendimmarrjen e tij të mbante në

konsideratë të drejtat dhe interesin më të lartë të konsumatorit shqiptar, duke vepruar me paanësi, integritet dhe objektivitet të lartë.

Në këtë kuadër nga ana e Avokatit të Popullit u përshëndet qëndrimi i mbajtur nga ERE me Vendimin Nr.77 dt.16.10.2009, në të cilin nuk ishte pranuar të miratohej “Raporti i Auditit të Humbjeve” të OSSH-së për vitin 2008. Ky vendim tregoi një përgjegjshmëri të lartë të ERE-s dhe njëkohësisht parandaloi ndikime të drejtpërdrejta negative në përlllogarizim e ardhshme të shpenzimeve për energjinë nga konsumatorët.

Avokati i Popullit dhe Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike shprehën në mënyrë të përbashkët shqetësimin për abuzimin dhe vjedhjen e energjisë elektrike nga një pjesë e qytetarëve, në bashkëpunim ngandonjëherë edhe me punonjës të OSSH-së, e cila po sillte në vijmësi humbje për këtë kompani, duke ndikuar edhe në kërkesën për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Ky fenomen u konstatua nga palët e pranishme se kishte rritur se tepërmi premisat për një padrejtësi shoqërore në raport me konsumatorët e rregullt. Ndaj të dy drejtuesit e institucioneve apeluan jo vetëm për pagimin e faturave të energjisë nga të gjithë qytetarët, por dhe për forcimin e veprimtarisë së organeve të zbatimit të ligjit dhe veçanërisht Prokurorisë në çuarjen para drejtësisë pa kompromis të personave përgjegjës.

Në përfundim të këtij takimi, Avokati i Popullit dhe Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike shprehën angazhimin për një bashkëpunim të ndërsjellë institucional në mbrojtje të të drejtave të konsumatorit dhe mbajtjen e kontakteve për të gjitha procedurat dhe seancat dëgjimore që do të zhvilloheshin veçanërisht për propozimet e reja të rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

Në këtë kuadër, përpjekjet e Avokatit të Popullit vijuan me pjesëmarrjen e tij personale dhe në seancën dëgjimore publike të datës 25 Nëntor 2009, që Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) zhvilloi, lidhur me kërkesat për rritjen e çmimit të energjisë Elektrike nga kompanitë respektive të prodhimit, transmentimit dhe shitjes së saj, sikundër ishin KESH sh.a. OST sh.a. dhe OSSH sh.a.

Në fjalën e mbajtur për këtë qëllim, Avokati i Popullit duke vlerësuar fillimisht organizimin e kësaj seance dëgjimore nga ana e ERE, përfitoi nga rasti për ta konsideruar këtë zhvillim si dëshminë me kuptimplotë të transparencës që tregonte institucioni i ERE-s ndaj konsumatorëve, institucioneve shtetërore dhe grupeve të interesit që mbronin të drejtat e konsumatorëve në vendin tonë.

Përpjekjet e Avokatit të Popullit në çdo seancë dëgjimore të organizuar nga ana e ERE ndër vite, kanë qenë konsistente në qëndrimin se rritjet e çmimit të energjisë elektrike të propozuara duhet të ishin të drejta, të arsyeshme, si dhe të rezultojnë produkt i një veprimtarie

efiçente të operatorit që menaxhonte këtë shërbim në favor të konsumatorëve.

Pyetjet e paraqitura nga Avokati i Popullit paraprakisht për këtë seancë dëgjimore ngriten shumë pikëpyetje dhe dyshime të mëdha jo vetëm mbi përmirësimin e shërbimit të OSSH pas transformimit të saj, por dhe në kërkesën e saj për rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Dilema më e madhe publike që u shtrua nga Avokati i Popullit në këtë debat dhe që kishte përfshirë edhe ERE-n si protagoniste kryesore në vendimmarrje ishte e qartë: A duhej rritur apo jo çmimi i energjisë elektrike?

Në përgjigje të kësaj pyetje, Avokati i Popullit theksoi domosdoshmërinë, fillimisht të analizimit me përgjegjësi se cilët ishin faktorët teknikë dhe keqmenaxhues që rëndonin pozitën ekonomike të OSSH-së dhe që e detyronin atë të propozonte çmime të reja të energjisë. A ishin vërtet këta, faktorë të natyrshëm të tregut, apo ishin pjesë e keqmenaxhimit dhe mospërshtatjes me një treg problematik, nga ai që kompania e huaj Çeke kishte njohur më parë?

Konstatimet e Avokatit të Popullit në këtë aspekt, ishin të orientuara në disa pika kryesore,

1. OSSH sh.a., ishte ende shumë larg realizimit të planeve afatshkurtra për eliminimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike. OSSH ende nuk kishte të identifikuar zërat e humbjes teknike të ndara nga ato jo-teknike, megjithëse një gjë e tillë i ishte kërkuar si detyrim nga ERE. Në këtë rast, Avokati i Popullit me të drejtë shtroi pyetjen, se çfarë përfaqësonte realisht propozimi i ri për rritjen e çmimit të energjisë? (thjesht mbulim humbjesh apo reflektim të drejtë të situatës së tregut).

2. OSSH sha me këtë rast ishte ende larg detyrimit të vënë nga ERE për pajisjen e të gjithë konsumatorëve me matësa deri në 31.12.2009. OSSH sha duhej të kuptonte fare mirë se vendosja e matësave ishte një nevojë akute e mbijetesës së saj finaciare, pasi nivelet e aforfeve të vendosura nga ERE i thellonin kësaj kompanie humbje nga viti në vit. Krahas kësaj, përpjekjet për të riorganizuar personelin, riformatuar sistemin e faturimit apo ndëshkuar nëpunësit abuzues nuk kishin dhënë ende shenjën e duhur në kthesën e humbjeve të rënduara të kompanisë.

3. Të vetëdijshëm për kapacitetet e hidrocentraleve tona, por dhe nga kushtet hidrike mjaft të favorshme për 2010, Avokati i Popullit vërejti një kontraditë shumë të madhe midis eksportimit aktual të energjisë tonë që po kryhej nga KESH dhe blerjes që OSSH-ja bënte nga operatorë të tjerë të huaj për llogari të furnizimit të sistemit. Diferenca e çmimeve në këto raste ishte shumë e madhe dhe sigurisht ajo kishte ndikim të drejtpërdrejt mbi konsumatorin tonë.



Krahas kësaj, edhe vetë çmimet ndërkombëtare nga viti në vit kishin ardhur duke e favorizuar tregun rajonal. P.sh. në vitin 2008 energjia shitej 79 Euro për 1 MWh, ndërsa për vitin 2009 e njëjta sasi shitej për 45 Euro.

Për të gjitha argumentat e sjella në vëmendje nga Avokati i Popullit në këtë seancë dëgjimore, konkludoi se:

1. Megjithë reformat strategjike dhe ndryshimet në menaxhimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë, sërish ky shërbim vuante nga të njëjtat simptoma problematike që kishin krijuar një ngërç të madh shoqëror dhe impakt negativ ekonomik.

Si rrjedhojë e kësaj gjëndje, konsumatorët e këtij shërbimi vijonin të ishin të ndarë në dy grupe. Në grupin e parë rradhiteshin ata konsumatorë të cilët iu duhet të vuanin korrektesën e tyre në pagimin e konsumit të energjisë, duke respektuar fatura shpesh herë të tejfryra, aforfe dhe fiktive. Ky grup konsumatorësh ishte ajo shtresë shoqërore që mbante sot të mbushur arkën e OSSH-së dhe me të cilën ky operator planifikonte strategjitë ekonomike për të ardhmen.

Ndërsa në grupin e dytë të konsumatorëve hynin të gjithë ata persona të cilët vijonin të shfrytëzonin të çarat e parikuperuara në menaxhimin e OSSH-së, duke përfituar energji të papaguar ose të pafaturuar në bashkëpunim kriminal me nëpunës të veçantë të këtij operatori, pa u ndëshkuar nga organet kompetente.

2. Për sa më sipër, Avokati i Popullit argumentoi faktin se duhej t'i apelohej organeve kompetente veçanërisht prokurorisë dhe gjykatës, që ndëshkimi i vjedhësve të energjisë të realizohej para se gjithash si një drejtësi shoqërore të munguar. Gjithashtu, duhej që OSSH-ë të merrte masa për vendosjen përfundimtare të matësave dhe të një menaxhimi efektiv dhe të besueshëm ndaj konsumatorëve.

Nga analiza e përgjithshme e situatës, Avokati i Popullit konkludoi në mbyllje se llogaritë që po beheshin nga OSSH për nevojën e rritjes aktuale të energjisë, se pari nuk ishin reale, së dyti, ato synonin të mbulonin më së shumti humbjet dhe, së treti, të justifikonin investimet e munguara për një menaxhim më të mirë të këtij shërbimi.

Për këtë arsye, qëndrimi zyrtar i Avokatit të Popullit ishte që çmimet e energjisë elektrike nuk duheshin rritur. Në këtë drejtim Avokati i Popullit theksoi se ERE duhej të ndikonte fuqishëm me të gjithë autoritetin ligjor të një organi të pavarur që OSSH të vihej në punë me efikasitet të plotë për të eliminuar sa më parë problemet e mëdha që mbarte menaxhimi i shërbimit të saj dhe mungesa e aseteve të domosdoshme teknike.

## 10. Ministria e Financave

Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve drejtuar Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009 nga shtetas dhe persona juridikë për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre nga administrata financiare, ku përfshihen Ministria e Financave, organet doganore, tatim-taksat, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe bankat është 166. Nga ky numër, 12 ankesa i janë adresuar Ministrisë së Financave si institucion, 6 ankesa Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve të Drejtorive Doganore në rrethe, 7 ankesa i janë adresuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Degëve të Tatim-Taksave në rrethe, 138 ankesa për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe 3 ankesa për Bankat e nivelit të dytë dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Krahas këtyre ankesave gjatë vitit 2009 janë përfunduar edhe 2 ankesa të mbartura nga viti 2008, të cilat kanë qenë të trajtuara me rekomandim dhe kanë rezultuar të zgjidhura pozitivisht.

Për vetë Ministrinë kemi pasur gjithsej 12 ankesa. Nga këto, 4 ankesa janë konsideruar në mungesë kompetence të Institucionit të Avokatit të Popullit, 4 ankesa janë zgjidhur në favor që në fazën e parë të ndërhyrjes dhe verifikimit, 1 ankesë është zgjidhur në favor pas paraqitjes së rekomandimit përkatës nga Avokati i Popullit, dhe 3 ankesa rezultojnë të jenë ende të hapura për trajtim.

Në lidhje me ankesat e drejtuara këtij institucioni, do të trajtojmë disa prej tyre, për të cilat është ndërhyrë me rekomandim nga ana e zyrës së Avokatit të Popullit.

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2009 u paraqitën disa ankesa qytetarësh, të cilët shprehnin shqetësimin për mospërrjashtimin nga taksa për përdorimin e aparateve televizive të radiotelevizionit publik shqiptar, pasi ishin veteranë të luftës.

Lidhur me këtë çështje, ata sqaronin se kjo “taksë” ishte përfshirë tashmë në mënyrë të detyrueshme në faturën e energjisë elektrike të OSSH-së, ndërkohë që deri vitin e kaluar konsiderohej si taksë e drejtëpërdrejtë dhe kjo kategori përjashtohej nga pagesa e saj.

Për sa më sipër, zyra jonë kërkoi shpjegime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të OSSH-së dhe verbalisht mori dijeni se “taksa” në fjalë, ligjërisht ngarkohej të paguhej nëpërmjet faturës së energjisë elektrike, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Financave me nr. 1, datë 8.1.2009. Megjithatë ky udhëzim, këtë detyrim e referonte si “Tarifë për përdorimin e aparaturave televizive”, dhe jo si taksë, sikundër pasqyrohej në faturat e OSSH-së. Lidhur me këtë të fundit, na u sqarua se gabimi konsistonte kompjuterik dhe si i tillë do korrigjohej.

Sa më sipër, pas hetimit të çështjes, na rezultoi se:

Së pari: Udhëzimi nr. 1, datë 8.1.2009 i Ministrit të Financave “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizivë” ishte nxjerrë në mbështetje të nenit 11 të Ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. Neni 2 i këtij Ligji përcaktonte përkufizimet apo termat e përdorur në kuptim të ligjit, siç ishte “taksapagues”, “taksë” dhe “Agjent i taksave”. Në vijim të tij, në nenin 3 renditeshin llojet e taksave kombëtare. Ndërkohë, në nenin 11 po në vijim të këtij ligji, jepej renditja e tarifave të shërbimit, që ndërmjet të tjerave ishte dhe ajo mbi përdorimin e aparateve televizivë. Gjithashtu në renditjen e këtyre tarifave të shërbimit, vihej re se ishin pasqyruar përgjithësisht si të tilla të gjitha ato çka më përpara përcaktoheshin si “taksa të drejtpërdrejta” me anë të Udhëzimit nr. 3, datë 18.01.2005 “Për sistemin e taksave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” të Ministrit të Financave, i cili përcaktonte se kush do të quhen taksa të drejtpërdrejta kombëtare, nga të cilat përjashtoheshin kategori të caktuara. Vetëm se tashmë, nuk bëhej fjalë për asnjë kategori që përjashtohej, dhe për më tepër nuk jepej ndonjë përkufizim se çfarë do kuptohej me “tarifë shërbimi”.

Së dyti: Në mungesë të përkufizimit të termit “tarifë shërbimi” brenda Ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, iu referuam Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon në nenin 17 të tij se:

“Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë përveç rasteve në të cilat ligji parashikon pagesën për shërbimin e ofruar nga administrata.

Administrata nuk kërkon pagesën e tarifave edhe në rastet kur kjo kërkohet me ligj, në rastet kur provohet pamundësia e kërkuesit për të paguar. Rastet e pamundësisë caktohen me akte nënligjore”.

Pra, parimi i mospagimit të shërbimit në administratën publike sipas Kodit të Procedurave Administrative nënkuptonte se kjo e fundit ishte në funksion të komunitetit dhe se qytetarët kontribuonin për mirëfunksionimin e saj nëpërmjet taksave. Për këto arsye, në përgjithësi, shërbimet e administratës publike duhet të jepeshin falas, duke mos përjashtuar mundësinë e aplikimit të tarifave për shërbimet e ndryshme të ofruara nga administrata. Por me qëllim të eliminimit të abuzimit me këto tarifa ishte vënë si kusht që tarifat duhej të ishin të parashikuara me ligj.

Por konstatoam se, për këto tarifa nuk kishte asnjë kategori që të përjashtohej nga pagesa. Pra, për kategoritë në nevojë nuk ishte parashikuar përjashtimi nga pagesa e “tarifës së shërbimit”, në përmbajtje të ligjit të ri Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. Ky ligj kishte parashikuar vetëm përjashtimin e disa kategorive në nevojë nga disa taksa kombëtare. Në të njëjtën kohë, konstatoam se janë ende në fuqi disa ligje si Ligji nr.7663, datë 20.01.1993, “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, Ligji nr.7874,

datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, Ligji nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, dhe Ligji Nr.8098 datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërve”, të cilët parashikonin përjashtimin nga pagesa e taksave të drejtëpërdrejta, për disa kategori. Por në legjislacionin në fuqi nuk parashikoheshin si të tilla, pasi ishin përfshirë në kategorinë e tarifave të shërbimit.

Për sa më sipër, zyra jonë vlerësoi se Ministria e Financave duhej që, sikundër kishte vepruar si organ pergjegjës në bazë të pikës 2 të nenit 11 të Ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, duke nxjerrë Udhëzimin Nr. 1 datë 8.1.2009, tashmë i lindte detyrimi dhe për rastet e përjashtimit të kategorive në nevojë. Kjo bazuar dhe në nenin 13 të Ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” ku parashikohej se:

“Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji”,

si dhe nenit 17, paragrafi i dytë i Kodit të Proçedurave Admistrative, i sipërcituar.

Pra, në bazë të argumentave të paraqitura në përmbajtje të këtij rekomandimi, në përfundim zyra jonë konkludoi për domosdoshmërinë e nxjerrjes së aktit nënligjor nga ana e Ministrisë së Financave, për përjashtimin e kategorive në nevojë të pagimit të tarifave të shërbimit, në zbatim të Ligjit Nr.9975 datë 20.07.2008 “Për taksat kombëtare”.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur, i ka kërkuar Ministrisë së Financave të na kthejë përgjigje për qëndrimin e saj lidhur me këtë rekomandim. Por nga ana e saj ende nuk kemi asnjë përgjigje. Në këto kushte, Avokati i Popullit e ka ende nën trajtim këtë çështje, pasi gjykon se për vetë problematikën delikate që përfaqëson objekti i saj, në mbrojtje të interesave të disa shtresave në nevojë sikundër janë invalidët, veteranët e luftës etj, duhet insistuar nga ana jonë për një zgjidhje konkrete të problemit të prezantuar, në drejtim të Ministrisë së Financave.

**2.** Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit ankesa e qytetarit N.Gj. i cili pretendonte për mos ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga ana e Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave, lidhur me njohjen e dëmshpërblimit pas largimit të tij nga puna në cilësinë e Përgjegjësit në Degën e Thesarit Peqin.

Konkretisht, dhe nga dokumentacioni bashkëngjitur kësaj ankese rezultonte se ankuesit, i ishte njohur me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, e drejta që ti paguhej nga Ministria e Financave paga e një viti, paga e tre muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe paga e 6.5 muajve si vjetërsi shërbimi në punë. Në vijim të këtyre sqarimeve, ankuesi parashtronte se Drejtorja e

Thesarit Peqin i ishte drejtuar, Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave, prej kohësh për çeljen e fondit me qëllim ekzekutimin e detyrimit në drejtim të qytetarit N.Gj., por nga ana e kësaj të fundit nuk ishte marrë ende asnjë masë.

Për sa më sipër u parashtrua, Zyra e Avokatit të Popullit iu drejtua me kërkesë për shpjegime Ministrisë së Financave, dhe në përgjigje të ndërhyrjes tonë, u informuam se Vendimi nr. 704 datë 13.03.2008 në favor të qytetarit N.Gj. me objekt “Dëmshpërblim për largim nga puna” u ekzekutua nga Ministria e Financave me urdhër pagesën nr. 3961 datë 15 Qershor 2009. Qytetarit iu ofrua dhe një kopje e dokumentacionit që konfirmonte zgjidhjen e problemit të tij.

#### **a) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Degëve në varësi të saj**

Për organin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe për degët e organeve tatimore në rrethe, kemi pasur gjithësej 7 ankesa. Nga këto 3 ankesa kanë rezultuar me mungesë kompetence, 1 është zgjidhur në favor të ankuesit që në fazën e parë të ndërhyrjes së Institucionit të Avokatit të Popullit, 1 ankesë është arkivuar pasi vetë ankuesi ka hequr dorë, dhe 2 ankesa janë ende në trajtim për vitin 2010.

Më hollësisht paraqitet një nga rastet e trajtuara me rekomandim si më poshtë vijon:

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit qytetari A.K. paraqiti një ankesë, me anë të së cilës pretendonte se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ishte bërë pengesë në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë me Nr. 133 datë 27.04.2009 të Gjykatës së Apelit Korçë, që urdhëronte Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për kthimin e tij në punë si inspektor në Sektorin e Kontrollit në Degën e Tatimeve Korçë, si dhe pagimin e pagës që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në zbatimin e këtij vendimi. Në përfundim, ankuesi mbështeste kërkesën e tij bazuar në urdhërin për ekzekutim me nr. 431, të datës 29.05.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë të rrethit Gjyqësor Korçë, me anë të së cilës Dega Përmbartimore i ishte drejtuar D.P.T. për ekzekutimin vullnetar të vendimeve gjyqësore.

Në këto kushte, kur pretendonte se nuk kishte asnjë informacion nga ana D.P.T.-së, qytetari A.K. kërkoi ndërhyrjen e Avokatit të Popullit.

Zyra e Avokatit të Popullit, iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me kërkesën për shpjegime lidhur me këto pretendime.

Në përgjigjen e ofruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sqarohej se, kjo e fundit kishte ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, dhe pas vendimit të Gjykatës së Lartë, do të ndiqte procedurat ligjore për ekzekutimin e vendimit.

Në përfundim të këtyre sqarimeve, zyra jonë konkludoi se veprimet dhe pretendimet e mësipërme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ishin krejtësisht në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, në të cilën Republika e Shqipërisë aderonte.

Qëndrimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve shkelte nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilin përcaktohej se; “Organet e Shtetit janë të detyruar të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”. Në këtë kontekst nënvizuar faktin se vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk duheshin konsideruar si çështje dëshire, dhe për më tepër nuk mund të interpretoheshin në mënyrë subjektive nga askush, por duheshin konceptuar si detyrime ligjore që duheshin respektuar me përpikmëri nga të gjithë drejtuesit e institucioneve shtetërore.

Avokati i Popullit nisur vetëm nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, çmoi me vend të bënte një rekomandim, për marrjen e masave për ekzekutimin sa më parë të Vendimit Gjyqësor Nr. 133 datë 27.04.2009 të Gjykatës së Apelit Korçë, për kthimin e ankuesit në punë si inspektor në Sektorin e Kontrollit në Degën e Tatimeve Korçë, si dhe pagën që nga momenti i ndërprerjes së marrdhënieve financiare, deri në zbatimin e këtij vendimi.

Aktualisht, për këtë problem nuk disponojmë ende ndonjë përgjigje nga organi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në këto kushte ankesa e qytetarit A.K. ndodhet në trajtim dhe gjatë vitit 2010.

#### **b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët në varësi të saj**

Për këtë organ së bashku me degët e rretheve kemi pasur gjithsej 6 ankesa. Nga këto ankesa, 2 kanë rezultuar në mungesë të kompetencës së Institucionit të Avokatit të Popullit, 1 ankesë është trajtuar me rekomandim dhe është pranuar duke u zgjidhur pozitivisht për ankuesin, ndërkohë që 3 ankesa janë ende në trajtim për vitin 2010.

Theksohet se ankesat në fushën doganore, kryesisht gjatë vitit 2009 kanë prezantuar si objekt të tyre paligjshmërinë e ndërprerjes së marrdhënieve të punës, apo dhe transferimin e paligjshëm të ankuesve, dhe kanë vijuar me pretendimet për aplikimin e mënyrave selektive gjatë zhdoganimit të mallrave nga ana e subjekteve të ndryshme dhe zbatimin jo të rregullt të procedurave të përcaktuara me ligj për këtë qëllim.

Më konkretisht, paraqitet një rast i përshkruar si më poshtë:

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u ri-paraqit për vitin 2009 ankesa e qytetarit, e prezantuar si objekt më parë dhe gjatë vitit 2008, nga administratori i shoqërisë ALB-AM sh.p.k. zoti V. K., i cili ankohej për veprime abuzive dhe selektive, të Degës së Doganës, Tiranë kundrejt zhdoganimit të kamionit me mall të këtij subjekti.

Nisur nga kërkesa për shpjegime që Zyra e Avokatit të Popullit i drejtoi Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave, Institucionit tonë nuk iu ofrua nga ana e strukturave përgjegjëse asnjë informacion. Në kushte kur subjektit ALB-AM sh.p.k., i ishte njoftuar Vendimi me Nr. 2315 Prot. i datës 17.06.2009 nga Dega e Doganës Tiranë, “Për rekuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara (sekuestro mallrash/objekte në pronësi/vlerash monetare etj)”, atëherë u gjendëm përpara detyrimit ligjor të parashtronim në vëmendje të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, si organ epror, argumentat në vijim:

Në përgjigje të rekomandimit të mëparshëm po për këtë ankues gjatë vitit 2008, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kishte dërguar informacionin se ndër të tjera, pasi kishte pranuar sugjerimet e Avokatit të Popullit, Drejtoria përkatëse kishte filluar procedurat hetimore... Lidhur me vijueshmërinë e tyre, do të njoftoheshim sa më shpejtë të ishte e mundur.

Duke marrë për të mirëqënë faktin e një kontrolli të mësipërm, zyra jonë konstatoi paligjshmëri të plotë të veprimeve për sekuestrim nga Dega Doganore Tiranë. Kjo gjë pasi në nenin 22, paragrafi 3 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohej se: “Kur juridiksioni territorial i një organi i transferohet një organi tjetër, procedimi duhet ti kalojë automatikisht këtij të fundit në bazë të një urdhëri zyrtar”.

Pra për sa më sipër u citua, kryerja nga ana e strukturave të Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave, të një kontrolli-hetimor për faturat e subjektit ALB-AM sh.p.k., kishte sjellë dhe transferimin e kompetencave që i takonin Degës Doganore Tiranë, në drejtim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Kështu organi i parë nuk mund të kishte kompetencë vendimmarrje për sekuestrim mallrash në drejtim të subjektit, deri në përfundim të procedurave të kontrollit nga ana e DPD-së dhe nxjerrjes së rezultateve konkrete.

Gjithashtu, në vijim nga zyra jonë u theksuan përcaktimet ligjore që ndodhen në Kodin e Procedurave Administrative për këtë gjë, në bazë dhe të nenit 23, paragrafi 1.

Për sa më sipër, gjykuam se hetimi i ndërmarrë nga ana e DPD-së, duhej të kishte pezulluar automatikisht veprimet administrative të organit vartës (të Degës Doganore Tiranë), pa përjashtuar këtu dhe që çështja ndodhej ende ne proces shqyrtimi nga Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë. I vetmi përjashtim që do të mundësonte lejimin e veprimeve të Degës Doganore Tiranë që të mos priste vendimin përfundimtar të DPD-së si organ epror, do të ishin kushtet e përcaktuara në vijim të nenit 23 në Kodin e Procedurave Administrative, të rasteve kur palët nuk ankoheshin brenda afatit të 30 ditëve. Por në kushtet kur palët e interesuara kishin paraqitur dhe protokolluar ankimim pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave, dhe për më tepër kur DPD-ja

kishte ndërmarrë procedurën administrative të hetimit për vlerat e faturave, gjëndeshim përpara veprimeve të paligjshme të organit vartës të Degës Doganore Tiranë.

Për të gjitha argumentat e parashtruara më sipër, zyra jonë gjykoi se ishte e nevojshme që Titullari i DPD-së, si organi epror i Degës Doganore Tiranë, të pezullonte veprimet e sekuestrimit të mallit kundrejt subjektit ALB-AM sh.p.k., që po kryheshin nga ana e Degës Doganore Tiranë, me qëllim përfundimin e rezultateve të hetimit nga Departamenti Hetimor-Drejtoria e Inteligjencës, Drejtoria e Informacionit dhe Njësisë së Kontrollave Aposteriori (që ishin përgjegjëse për verifikimin e plotë brenda dhe jashtë vendit), për vlerat e faturës së paraqitur si vlerë transaksioni.

Në përfundim, Zyra e Avokatit të Popullit kërkoi gjithashtu me insistim një kopje të procesverbalit të mbajtur nga Njësitë përgjegjëse për kontrollin e vlerave në faturën e paraqitur nga subjekti ankues.

Për këtë qëllim, zyra jonë rekomandoi pezullimin e Vendimit me Nr. 2315 Prot., të datës 17.06.2009 nga Dega e Doganës Tiranë, “Për rekuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara (sekuestro mallrash/objekte në pronësi/vlerash monetare etj), dhe zbardhjen në një kohë sa më të shpejtë të rezultateve të hetimit nga strukturat përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për vlerat e faturës së paraqitur si vlerë transaksioni nga subjekti ALB-AM sh.p.k..

Lidhur me këtë rast, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) na u ofruan dy përgjigje kontradiktore.

E para, e ofruar nga Departamenti Operativ dhe Hetimor, Drejtoria e Hetimit, me Nr. 7182/1 datë 24.07.2009, sqaronte se lidhur me rekomandimet e zyrës së Avokatit të Popullit, për zhdoganimin e ngarkesës së shoqërisë ALB-AM sh.p.k., kishte nisur hetimi nga Drejtoria në fjalë dhe kishin filluar verifikimet e nevojshme me palën doganore të shtetit Italian. Lidhur me këtë investigim, pala Shqiptare ishte në pritje të përgjigjes dhe dokumentacionit të nevojshëm nga Autoritetet Doganore Italiane, dhe se Zyra e Avokatit të Popullit do të njoftohej sa më shpejtë për verifikimet e kryera, pas përgjigjes që pritej nga shteti fqinj.

Ndërkohë që në përgjigjen e Drejtorisë Juridike të DPD-së, me Nr. 8397/3 Prot. të datës 03.08.2009, sqarohet se DPD-ja nuk mund të niste shqyrtimin ndaj Vendimit të Degës së Doganës Tiranë, pasi në mbështetje të Ligjit Nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, apeluesi duhej të paguante shumën e përgjithëshme të detyrimeve doganore, duke derdhur të pakten deri në 40% të vlerës së kësaj gjobe. Gjithashtu në këto sqarime thuhej se, në mbështetje të nenit 36 të Kodit të Procedurave Civile, asnjë institucion nuk kishte të drejtë të pranonte një mosmarrveshje civile, që ishte duke u gjykuar nga gjykata.



Duke u gjendur përpara një konflikti të tillë të organeve doganore dhe ankuesit, zyra jonë orientoi në vijim qytetarin V.K. ndjekjen deri në fund të këtij problemi me anë të rrugës gjyqësore, duke e mbështetur me dokumentacionin përkatës të rekomandimeve që zyra jonë kishte përgatitur në drejtim të DPD-së në dy vite.

### **c) Instituti i Sigurimeve Shoqërore**

Gjatë vitit 2009 pranë Institucionit tonë janë paraqitur 138 ankesa, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe strukturave në varësi të tij. Janë përfunduar 126 ankesa. Nga këto kanë rezultuar 30 ankesa të pabazuara, 13 jashtë juridiksioni, 31 jashtë kompetence, 2 heqje dorë, 46 të zgjidhura në favor të ankuesve dhe 4 Rekomandime të pranuar. Në proces shqyrtimi janë 12 ankesa. Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar 17 ankesa të mbartura nga viti 2008. Nga këto ankesa, 6 kanë rezultuar të pabazuara, 1 jashtë kompetence, 3 jashtë juridiksionit, 1 me heqje dorë dhe 6 të zgjidhura në favor të ankuesve.

Problematika që ngrihet në ankesat e qytetarëve është pothuajse e njëjtë si në vitet e tjera paraardhëse. Konkretisht qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, mosnjohjen e vjetërsisë në punë, mosdhënien e invaliditetit nga Komisionet përkatëse të Caktimit të Aftësisë për Punë, mospërfitimin e shtesave të pensionit të pleqërisë, zvarritje burokratike nga organet kompetente, për kohën e daljes në pension, mospërfitimin e pensionit familjar, mospërfitimin e pensionit si nënë me shumë fëmijë, sigurimin e detyrueshëm për personat e vetëpunësuar në bujqësi, për mospërfitim të kompensimit të energjisë elektrike, për ndërprerje të trajtimit të veçantë si minator, për moslllogarritje të saktë të masës së pensionit të parakohshëm, etj.

Përgjithësisht nga këto ankesa kemi evidentuar se shpesh herë ankuesit, kryesisht për mosnjohje të Ligjit, nuk kanë konsumuar shkallët e ankimit administrativ në Komisionet e Apelit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin Qëndror të Apelit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këto raste ndihma jonë juridike ka qenë e favorshme duke i dhënë mundësinë qytetarit të qartësohet për problemin e tij, pa i hyrë procedurave të zgjatura administrative. Këtë veprim ua kemi orientuar që ta kryejnë në një moment të dytë, në qoftëse nuk mbeten të kënaqur dhe më pas t'i drejtohen komisioneve përkatëse të Apelit.

Gjithashtu, nga ana e Institucionit tonë është bërë një punë jo e vogël për informimin e qytetarëve për zhvillimet e herë pas herëshme lidhur me përmirësimet në Ligjin nr.7703 datë 11.05.1993 ‘‘Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë’’ si dhe mbajtjen në kontakt të vazhdueshëm të tyre për fazat e rishikimit të këtij legjislacioni. Kjo sepse është konstatuar fakti se shumë qytetarë kur i drejtohen

Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, marrin përgjigje në mënyrë verbale dhe jo shkresore, duke mos u qartësuar për kërkesat e tyre.

Në bazë të të gjitha evidentimeve, statistikave dhe observimeve të nxjerra si dhe bazuar në rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit që ndikon dhe përçon vizionin e mirëqeverisjes, është arritur në konkluzionin se Qeveria Shqiptare së bashku me institucionet e tjera përkatëse, me gjithë arritjet e deritanishme, duhet të jetë më efektive në politikat që lidhen me fushën e sigurimeve shoqërore.

Ky konkluzion ka dalë pasi shumica e ankuesve problemin e masës së pensionit që ata përfitojnë, e shohin në këndvështrimin e një diskriminimi që u bëhet atyre nga shteti për punën që ata kanë bërë për vite me radhë. Ata kërkojnë të ketë edhe një bazë më të mirë për politikat që ndjek shteti në fushën e sigurimeve shoqërore. Megjithëse kohe pas kohe janë bërë përmirësime ligjore në këtë fushë, përsëri vihet re se ka kundërtënie, evazivitet, diferenca të masës së pensioneve të qytetarëve në kushte të njëjta pune etj. Por këto ndryshime dalin jashtë juridiksionit të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit.

Konkretisht, në këtë kuadër, duke marrë shkas nga ankesat e qytetarëve, po paraqesim problematikat e mëposhtme:

1. Ankesa në lidhje me mosnjohjen e derdhjes së kontributit si të vetpunësuar ne bujqësi të personave që ndërrojnë vendbanim.

Qytetari S.Xh, paraqiti ankesë në lidhje me mosnjohjen e derdhjes e kontributit si të vetpunësuar në bujqësi për periudhën 1997-2004 të tij dhe të bashkëshortes së tij.

Në objektin e kësaj ankese sqaroheshim se ankuesi së bashku me bashkëshorten e tij kishin punuar në komunën Vreshtas të Korçës. Në vitin 1997 kishin ndërruar vendbanim, duke ardhur me banim në Tiranë. Kishin derdhur kontribute si të vetpunësuar në bujqësi deri ne vitin 2004 pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Korçë. Pas këtij viti, inspektorët e sigurimeve shoqërore e kishin vënë në dijeni ankuesin se nuk mund te derdhnin më kontribut si të vetpunësuar në bujqësi, pasi duhej të banonin në të njëjtin rreth ku kishin tokën në pronësi.

Pasi kishin dorëzuar dokumentacionin për përfitimin e pensionit të pleqërisë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë, kishin marrë përgjigje se kontributet e derdhura për peridhën 1997-2004 nuk i njiheshin si vjetërsi në punë, sepse në vitin 1997 kishin ndryshuar vendbanimim e tyre.

Pas depozitimit të ankesës, ne kërkuam shpjegime pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në përgjigje të kërkesës sonë, ky Institucion, ndër te tjera, na informoi se:

“Në kushtet kur po viheshin re sigurime të të vetpunësuarve në bujqësi jashtë kushteve dhe që konkretisht nuk plotësonin kushtin e pasaportizimit në rrethin ku personi dispononte tokë, ISSH nxjerr

shkresën nr.1311/2 date 29.05.2000, ku në pikën 2 theksohet: “Për kategoritë e të ardhurave, personat të cilët kane patur tokë në pronësi, do te sigurohen për periudha të kaluara, deri në momentin e disponimit të tokës, në zonën ku kanë patur tokën”. Po kështu në shkresën nr.501 datë 09.04.2003 “Mbi zbatimin e skemës së sigurimit shoqëror për të vetpunësuarit në bujqësi”, ku në pikën 2 theksohet “Nuk sigurohen si të vetpunësuar në bujqësi të gjithë personat, që megjithëse plotësojnë kushtet e mësipërme, lejen e banimit (certifikatën) e kanë jashtë nënqarkut ku kanë tokën në pronësi”. Kjo mbasi është absurditet të mendohet që një person, duke qënë në një rreth tjetër, të mund të ushtrojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale në rrethin që ishte. Më pas ISSH përfshin këtë çështje dhe e trajton këtë problem ne vendimin e Këshillit të Ministrave nr.298 datë 14.05.2004 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402 datë 11.06.2001 “Për disa çështje në zbatim të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Pas analizës së përgjigjes së ardhur dhe akteve ligjore e nënligjore që kanë dalë lidhur me këtë çështje, konstatuam si më poshtë:

Sipas VKM-së nr.402 datë 11.06.2001 “Për disa çështje në zbatim të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar në pikën 5 të Kapitullit I “Sigurimi i detyrueshëm”, thuhet shprehimisht : “...*Quhen persona të mbrojtur të vetpunësuarit në bujqësi, kur janë të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç deri në 60 vjeç për meshkuj dhe 16 deri 55 vjeç për femrat dhe nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për periudhën e shtatzanisë e të paslindjes, për pensione dhe sigurim shëndetësor*”.

Kjo dispozite me VKM nr.298 date 14.05.2004 ndryshoi si më poshtë: “*Të vetpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç deri në moshën për pension sipas nenit 92 të ligjit nr.7703 datë 11.03.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, ku nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, kur banojnë në të njëjtin rreth ku kanë tokën në pronësi, të fituar nga ligji për tokën dhe zhvillojnë veprimtari bujqësore e blegtorale, sigurohen në mënyrë të detyrueshme për barrëlindje, për pensione dhe për sigurim shëndetësor*”.

Pra, VKM-ja nr.402 datë 11.06.2001 nuk e kishte parashikuar kushtin e njohjes së derdhjes së kontributeve të të vetpunësuarve në bujqësi, që personat të kene vendbanimin e tyre në të njëjtin rreth ku kanë tokën. Në këto kushte personat kishin vazhduar të derdhnin kontribute edhe pas ndryshimit të vendbanimit të tyre dhe nga ana e inspektorëve të drejtorive rajonale ne rrethe ishte mbajtur ky kontribut.

Pra, llogjikisht deri ne vitin 2004, kohë kur ka dale akti i ri, nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore duhej të merrej në konsideratë periudha për të cilën është paguar kontributi. Kjo, pasi nuk mund t'u mohohet e drejta këtyre personave për faktin se urdherat dhe shkresat që kanë dalë dhe që kanë kufizuar këtë të drejtë, konsiderohen në kundërshtim me vendimin perkatës të Këshillit të Ministrave. Veprimtaria administrative është një veprimtari që ka karakter nënligjor. Kjo nënkupton faktin se aktet e nxjerra prej saj duhet të jenë në përputhje me Ligjet dhe aktet nënligjore të cilat rregullojnë marrëdhëniet e caktuara administrative. Fakti që kjo çështje është rregulluar më pas, tregon që praktika e ndjekur nuk ka qënë konform parimit të ligjshmërisë. Pra, është një detyrim kushtetues ligjor njohja e kontributit si të vetpunësuar në bujqësi të të gjithë personave që realisht e kanë derdhur këtë kontribut.

Sa me sipër, i Rekomanduar Ministrit të Financave njohjen e periudhes së sigurimit të të vetpunësuarve në bujqësi deri ne vitin 2004 si dhe kthimin e shumës së derdhur të kontributeve si të vetpunësuar ne bujqësi pas vitit 2004 për personat që kanë ndërruar vendbanimin e tyre.

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave, miratoi Vendimin nr.1206 datë 11.12.2009 “Për një shtesë e ndryshim në VKM nr.1114 datë 30.07.2008, ku sipas pikes 6/1 njihen periudha sigurimi periudhat nga data 01.10.1993 deri më datë 01.05.2004 për të cilat të vetpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pavarësisht nga vendbanimi në kohën e kryerjes së pagesës. Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare nr.177 datë 21.12.2009.

2. Ankesa në lidhje me mospërfitimin e një kategorie pensionistësh nga VKM nr.787 date 26.11.2003 “Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve”.

Qytetari M.S, në emër të disa pensionistëve, paraqiti ankesë në lidhje me mospërfitimin nga VKM nr.787 datë 26.11.2003.

Me hyrjen në fuqi të VKM-së të sipërcituar dhe veçanërisht bazuar në përcaktimin e bërë në gjurmën “dh”, të pikës 3 të këtij vendimi, ku thuhet shprehimisht se:

*“Pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën nga 1.4.1996 deri në 31.12.1996, me masë pensioni në këtë periudhë nga 5421 lekë deri në 6500 lekë në muaj, dhe që pas datës 1.12.2003 kanë masë pensioni 10768 lekë në muaj, shtohen me shuma fikse nga 56 lekë deri në 679 leke në muaj”*, ankuesi shprehej se ka qënë ne pritje të shtimit të masës së pensionit të tij të pleqërisë. Por megjithë kërkesat e herëpashërëshme të tij, si pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë, ashtu edhe pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për të përfituar nga ky vendim, ai ka marrë përgjigje se llogaritja e masës së pensionit të tij të pleqërisë ishte bërë e saktë dhe në përputhje me

dispozitat ligjore në fuqi për sigurimet shoqërore. Rrjedhimisht, ai nuk kishte përfituar shtesë nga zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787 datë 26.11.2003 “Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve”.

Megjithëse sipas gjurmës “dh”, të pikës 3 të kësaj VKM-je është parashikuar shtesë në masën e pensionit të pleqerisë për kategorinë e pensionistëve, të cilëve e drejta e pensionit të pleqërisë iu ka lindur në periudhën 01.04.1996-31.04.1996, ai vetë edhe pse është pjesë e kësaj kategorie, nuk e kishte përfituar këtë shtesë.

Duke e konsideruar zbatimin e gjurmës “dh”, të pikës 3 të VKM-së nr.787 datë 21.11.2003, si diskriminim që u bëhet pensionistëve dhe si shkelje e të drejtave të tyre të ligjshme për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore në vend, ankuesi kërkoi ndërhyrjen e Avokatit të Popullit.

Për nevojat e shqyrtimit të metëjshëm të kësaj ankese nga ana jonë, kërkua shpjegime pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për pretendimin e ankuesit si dhe të na saktësohej masa ekzistuese e pensionit minimal dhe maksimal për periudhën 01.04.1996-31.12.1996.

Në përgjigjen e ISSH-së për këtë kërkesë tonën, theksohet se:

“Për sa i përket VKM-së nr.787 datë 26.11.2003 “Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensionit”, llogaritjet teknike janë bërë sipas tabelave përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi, në të cilat përcaktohen edhe nivelet e masave të pensioneve që fitojnë shtesë. **Personat që datën e lindjes së të drejtës për përfitim e kanë në harkun kohor 01.04.1996-21.12.1996, nuk përfituan shtesë sipas këtij vendimi, pasi masa e pensionit nuk përfshihet në pikën 3 “f” dhe tabelën C “ f ”, të VKM-së nr.787 datë 26.11.2003.**

Përsa i përket pensionit minimal e maksimal në periudhën 01.04.1996-31.12.1996, sipas VKM-së nr.229 datë 01.04.1996 “Pensioni i plote i pleqërisë dhe pensioni i plote i invaliditetit, i llogaritur sipas ligjit nr. 4171 datë 13.09.1966 dhe ligjit nr.7703 datë 11.05.1993, më datë fillimi 01.04.1996, nuk mund të caktohet më pak se 3250 lekë në muaj. Masa e pensionit maksimal mbetet 5420 lekë në muaj”.

Pra, sipas kësaj përgjigjeje, na konfirmohej fakti se kjo kategori pensionistësh ku bën pjesë edhe ankuesi, nuk kishin përfituar nga VKM-ja e sipërcituar, megjithëse ky akt normativ në dispozitën e tij ka parashikuar shtesë në masën e pensionit të plotë të pleqërisë.

Në analizë të kësaj përgjigjeje, por edhe të bazës ligjore në fuqi lidhur me këtë çështje, rezultoi se përcaktimi i bërë në gjurmën “dh”, të pikës 3 të VKM-së nr.787 datë 21.11.2003, si dhe tabela “C.f”, që i referohet kësaj pike, ishin jashtë objektit të rregullimit në tërësi të VKM-së të sipërcituar, për këto arsye:

1. Ky percaktim nuk i referohej masës së pensioneve të lidhura në periudhën 01.04.1996 deri në 31.12.1996.

2. Masa e pensioneve të pleqërisë, përkatësisht nga pensioni në masën më të vogël (5420 lekë) deri në pensionin në masën më të madhe (6500 lekë) në muaj, nuk kanë ekzistuar për periudhën 01.04.1996 deri në 31.12.1996, pasi ato ishin mbi masën e pensionit të plotë të pleqërisë që konfirmohej nga vetë ISSH-ja për këtë periudhë.

Sa me lart, gërma “dh”, e pikës 3 të VKM-së nr.787 datë 21.11.2003, si dhe tabela “C.f”, rezultuan se janë fiktive.

Në këto rrethana, megjithëse kishim nje akt nënligjor në fuqi, i cili parashikonte efekte financiare për kategori të caktuara pensionesh pleqërie, për kategorinë e pensioneve të cilat janë lidhur për periudhën 01.04.1996 deri në 31.12.1996, ky akt nënligjor nuk mund të zbatohet pasi referenca që ai bën për bazën e llogaritjes së shtesës për keto pensione (pensioni maksimal e ai minimal), ishte e gabuar.

Përfundimi real që ka ndodhur për trajtimin e përfitimit të shtesës për pensionet e pleqërisë të lidhura për periudhën nga 01.04.1996 deri në 31.12.1996, është në fakt cenim i të drejtës së ankuesit dhe jo vetëm të tij, por të të gjithë kategorisë së pensionistëve që ai përfaqëson, për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore në pleqëri.

Kjo e drejtë është e afirmuar shprehimisht në pikën 1, të nenit 52 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se:

“Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paafte për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”.

Për sa më sipër, ne i Rekomanduar Ministrit të Financave dhe Drejtoreshës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore që t’i propozojë Këshillit të Ministrave ndryshimi i gërmës “dh”, të pikës 3 të VKM-së nr.787 datë 21.11.2003, si dhe tabelës “C.f”, bashkangjitur këtij vendimi, me qëllim që efektet e shtesës në masën e pensioneve të plota të pleqërisë, të përfshijnë edhe ato pensione të cilat janë lidhur në periudhën nga 01.04.1996 deri në 31.12.1996 si dhe efektet financiare të pritshme pas ndryshimit të kesaj VKM-je të fillojnë nga data 01.12.2003.

Ministria e Financave na ka vënë në dijeni se ka kërkuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të paraqesin shpjegimet përkatëse për këtë çështje si dhe propozimet lidhur me Rekomandimin tonë.

**3. Ankesa në lidhje me ndërprerjen e pensionit të pleqërisë.**

Qytetari L.B, ankohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë për ndërprerjen e pensionit të tij të pleqërisë.

Ankuesi shprehej se kishte punuar me detyrë oficer prej 32 vitesh. Në vitin 2000 i ishte lidhur pensioni i pleqërisë, të cilin e kishte gëzuar deri në muajin Shtator të vitit 2008 dhe më pas ky pension i ishte ndërprerë. Kishte marrë përgjigje verbale se ndërprerja e pensionit ishte

bërë pasi po verifikohet dokumentacioni i ndodhur në dosjen e tij të pensionit.

Megjithëse kishim kaluar mbi 5 muaj, ankuesi nuk kishte marrë asnjë përgjigje konkrete nëse kishte mbaruar procedura e verifikimit të dokumentacionit të tij dhe se çfarë do të bëhej më tej, me qellim që ai të vazhdonte të gëzonte e pensionit të tij të pleqërisë.

Pas shqyrtimit të ankesës, kerkuam shpjegime pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë. Në përgjigje të kërkesës sonë, ajo drejtori na informoi se pas kontrollit të ushtruar mbi ligjshmërinë e caktimit të pensioneve të pleqërisë nga ana e Auditit të ISSH-së, kishte rezultuar se shtetasit në fjalë, sipas vjetërsisë së punës, i takonte pension pleqërie në vitin 2003, në kushtet e kategorisë së tretë të punës. Ishte bërë rishqyrtimi i pensionit nga i plotë në të pjesshëm, pasi ankuesi kishte 32 vjet e 2 muaj vjetërsi në punë dhe jo 33 vjet sa kërkohej në vitin 2003. Në këto kushte masa e pensionit ishte ulur dhe njëkohësisht për periudhën 17.10.2000 – 17.04.2003 ankuesi duhej të merrte një diferencë prej 49.208 lekësh, midis pensionit të parakohshëm dhe atij të pleqërisë që kishte përfituar deri në atë moment.

Por, megjithëse ishin bërë rilogaritjet përkatëse, ankuesi nuk kishte filluar të merrte pensionin e tij të pleqërisë.

Në keto kushte dhe me qëllim që personit të mos i zvarritej dhënia e pensionit të tij të pleqërisë, por të vazhdonte të gëzonte atë çka atij i takonte të përfitonte, ne i Rekomanduam Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë dhënien e pensionit të pleqërisë si dhe të shumës prej 49.208 lekësh.

Në përgjigje të këtij Rekomandimi, u vumë në dijeni se çështja e qytetarit L.H ishte zgjidhur dhe qytetari duhej të paraqitej pranë qendrave paguese për të tërhequr diferencën dhe pagesën mujore të pensionit.

Pra, pas nderhyrjes sonë u bë e mundur që qytetari të vazhdonte të gëzonte pensionin e tij të pleqërisë.

**4.** Qytetari Xh.M, paraqiti ankesë ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë për mosllogaritje të drejtë të masës së pensionit të invaliditetit.

Pas shqyrtimit të ankesës, proceduam me kërkesë për shpjegime pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë. Në përgjigje të kërkesës sonë, kjo drejtori na informoi se masa e pensionit të pleqërisë ishte llogaritur gabimisht për 4 vjet e 8 muaj. Pas rivefikimit të dokumentacionit për vjetërsinë e punës, rezultoi se periudha e sigurimit ishte 5 vjet e 8 muaj.

Në keto kushte, dosja kaloi për rishqyrtim në Sektorin e Përfitimeve dhe ankuesi përfitoi shtesën në masën e pensionit të invaliditetit.

5. Ankesa në lidhje me masën e pensioneve të pleqërisë për personat që kanë dalë në pension pleqërie gjatë vitit 2004, problematikë e cila është pasqyruar edhe në raportin vjetor të vitit 2008.

Pretendimi i të gjithë ankuesve që kishin fituar të drejtën e daljes në pension pleqërie gjatë vitit 1994, ishte se megjithëse nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave ishin bërë korrigjime të pensioneve për periudha të ndryshme kohore, masa e pensionit të tyre nuk ishte e njëjtë me personat që kishin dalë në pension pleqërie para vitit 1993.

Për këtë problem kërkuam shpjegime si pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ashtu dhe pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nëse do të ndërmerrej ndonjë studim për një tjetër fazë të ngushtimit të diferencave të këtyre pensioneve, duke qenë se zbutja e dallimeve në masën e pensioneve ishte kryer gradualisht në 5 etapa dhe aktualisht shumë pensionistë kërkonin që të mos kishte diferencime në masën e pensioneve për punë të të njëjtit nivel dhe profesion.

Nga ana e MPCSSH-së, na u konfirmua fakti se me zbatimin e pesë fazave të reformës së ngushtimit të diferencave të pensioneve ishte arritur të përafrohen pensionet e caktuara para vitit 1993 me ato pas këtij viti, me rreth 98% nga 58% që ishte para fillimit të reformës. Por ky proces nuk ka përfunduar.

Në fazën e tretë të ngushtimit të diferencave të pensioneve, zbatuar në vitin 2002, kanë përfituar dhe persona të kësaj kategorie. Por ende ka raste të veçanta mosperputhjes, të cilat kërkojnë një studim të plotë, për të realizuar një ndërhyrje me dispozitë, duke ndryshuar kushtet e daljes në pension të kësaj kategorie.

Në funksion të përmirësimeve të mundëshme që mund të rezultojnë pozitive, Zyra jonë është në vazhdimësi të proceseve të rishikimeve dhe analizave të legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore, proces i cili do të pasohet me rekomandimet përkatëse në këtë fushë.

Së fundi, duhet të theksojmë se bashkëpunimi ndërmjet Institucionit tonë me administratën qendrore dhe lokale të Sigurimeve Shoqërore ka qenë rezultativ, duke vërejtur një përgjegjshmëri në rritje të kësaj administrate.

#### **d) Bankat**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur gjatë vitit 2009 dhe 3 ankesa gjithsej, të cilat kanë pasur si objekt bankat që operojnë në Shqipëri.

Nga këto ankesa 2 kanë qenë në mungesë kompetence të Avokatit të Popullit, dhe 1 ka rezultuar e pabazuar.

Konkretisht, paraqitet një nga rastet e trajtuara nga zyra jonë për pretendimet e paraqitura nga një qytetare:



1. Ankuesja e moshuar me banim në qytetin e Kavajës, M.D. paraqiti një ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, me anë të së cilës pretendonte për disa veprime të padrejta nga ana e Raiffeisen Bank.

Konkretisht, ajo sqaronte se kishte shitur një sipërfaqe toke në vitin 1999-2000, të cilën dispononte si pronare, dhe shuma e paguar nga pala blerëse, i ishte derdhur në emër të saj pranë ish Bankës së Kursimeve, e privatizuar tashmë nga Raiffeisen Bank. Meqenëse, qytetarja ishte vonuar për të tërhequr këtë shumë, kur ishte paraqitur në vitin 2007 pranë sportelit të kësaj banke për të përfituar vlerën e 12milion lekëve nga shitja e kësaj prone, asaj i ishte thënë që shuma në fjalë i ishte transferuar Ministrisë së Financave pas procesit të privatizimit, si detyrime dhe kompensime ndaj shtetit.

Në përgjigjen që Ministria e Financave i kishte dhënë për këtë problem, mohonte se shuma e llogarisë së qytetares, i ishte transferuar ketij Institucioni, pasi ajo përbënte marrëdhënie midis palëve private dhe si e tillë nuk hynte në detyrimet që kishte tërhequr shteti nga llogaritë e ish-Bankës së Kursimeve, pas privatizimit të saj nga subjekti Raiffeisen Bank.

Për sa më sipër, Zyra e Avokatit të Popullit i kërkoi Departamentit të Mbikqyrjes Bankare, pranë Bankës Qëndrore Shqiptare, që të verifikonte këtë problem, në transfertat e llogarive të subjektit Raiffeisen Bank.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Banka Qëndrore Shqiptare, na ofroi një informacion, ku ndër të tjera sqaroi se Zonja D.M. nuk kishte pasur një llogari personale pranë ish-Bankës së Kursimeve, dhe shuma e derdhur nga pala blerëse, i ishte depozituar në një llogari tranzitore, në të cilën grumbulloheshin të gjitha pagesat e klientëve që nuk kishin një numër personal llogarie pranë Bankës. Në momentin e privatizimit, meqenëse shuma prej 12milion lekësh kishte mbetur pezull, ishte përfshirë në listën e detyrimeve që duheshin sistemuar me Qeverinë (Ministrinë e Financave). Kjo e fundit, kishte marrë një listë të detajuar të të gjitha detyrimeve dhe pretendimeve që kishte me ish-Bankën e Kursimeve, të firmosur nga Ministri i atëhershëm, që kishte pranuar kompesimin e tyre dhe sistemimin e diferencave me aksionerin e ri të Bankës. Në këtë drejtim, padrejtësia kundrejt zonjës D.M., ishte përgjegjësi që u takonte të dy palëve, si Bankës ashtu dhe Ministrisë së Financave, që kishin përfshirë padrejtësisht këtë shumë në llogaritë e Ministrisë së Financave, e cila kjo e fundit për shkak se e kishte pranuar duke kompesuar detyrimet e tjera.

Në këto kushte, Zyra e Avokati të Popullit orientoi ankuesen që për çështjen konkrete, ti drejtohej gjykatës së rrethit me padi civile, lidhur me veprimet e padrejta të kryera kundrejt saj nga subjekti Raiffeisen Bank, dhe nga Ministria e Financave së bashku. Në këtë drejtim, për arsye se

Zyra jonë nuk kishte kompetenca për ta përfaqësuar ankuesen në këtë çështje pranë organit të gjykatës, e orientoi atë gjithashtu që në rast se nuk dispononte të ardhura të mjaftueshme për të marrë një avokat privat, t'i drejtohej Shërbimit Ligjor Falas për ta ndihmuar me ndihmë ligjore, duke i ofruar dhe informacionin me adresën përkatëse të këtij shërbimi.

## 11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Gjatë vitit 2009 ka patur 77 ankesa apo kërkesa të ardhura ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve në vartësi të saj. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës sonë 26 ankesa. Në favor janë zgjidhur 14 ankesa apo kërkesa, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës 22 ankesa, të pabazuara 10 ankesa, ndërsa për 1 çështje rekomandimi është pranuar dhe për 2 çështje rekomandimet dërguar organeve përkatëse janë refuzuar. Për 3 ankesa subjektet kane hequr dorë nga trajtimi i tyre

Nga viti 2008 janë mbartur për shqyrtim 14 ankesa, nga të cilat 4 janë zgjidhur në favor, 2 jashtë juridiksionit dhe kompetencës, 1 e pabazuar, 1 rekomandim është refuzuar, 2 janë pranuar dhe për 4 ankesa subjektet kane hequr dorë nga trajtimi i tyre.

Një numër jo i vogël ankesash ka patur si objekt marrëdhëniet e punësimit në sektorin e arsimit, duke filluar që nga problemi i pagesës, shpërblimeve, trajtimeve të veçanta apo edhe i largimeve nga puna të mësuesve.

Në dy raportet e fundit që kemi paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë kemi ngritur një sërë problemesh që lidhen me mënyrën e rregullimit ligjor të marrëdhënieve të punës së personelit mësimdhënës në sistemin parauniversitar, ashtu dhe në drejtim të moszbatimit të drejtë të këtij kuadri ligjor nga ana e organeve përgjegjëse. Ne kemi rekomanduar :

- Domosdoshmërinë e rregullimit të posaçëm ligjor apo nënligjor të kushteve dhe kriterëve që duhet të përmbushë një person që të punësohet si mësues në arsimin parauniversitar.

- Parashikimi në mënyrë të qartë dhe pa ekuivokë i procedurës së aplikimit për vend pune, si dhe i mënyrës së zgjidhjes së konflikteve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës për personelin mësimdhënës në arsimin parauniversitar

- Ballafaqimin e mendimeve të grupeve të interesit, në procesin e hartimit të Dispozitave të reja Normative për arsimin parauniversitar, në mënyrë që të jenë jo vetëm në përputhje me ligjet, por dhe me kushtet e reja të cilat janë bërë prezent.

Për këto konstatime kemi patur reagim pozitiv konkret nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës vetëm kohët e fundit.

Nga ankesat e trajtuara përmendim:

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesë dy mësuese, të cilat japin mësim në shkolla në varësi të Drejtorisë Rajonale Qarkut Tiranë.

Në ankesën e tyre ato shpjeguan se në vitin shkollor 2008- 2009 paga e tyre ishte ulur në vlerën prej 6000 lekesh për shkak të kategorizimit të pagës së tyre pikërisht në grupin II “2”, sipas Udhëzimit të Ministrit të Arsimit Nr.30 datë 29.07.2008 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 06.05.1999 “Për pagat e punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”. Ky udhëzim bënte një kategorizim të ri të pagave në arsimin parauniversitar.

Gjatë shqyrtimit të fakteve të parashtruara dhe të akteve ligjore e nënligjore që kanë qënë në fuqi, rezultoi se të gjithë personat, të cilët kishin mbaruar arsimin e lartë në degën e mësuesisë trajtoheshin në të njëjtën mënyrë, pavarësisht nëse jepnin mësim sipas profilit apo jashtë tij. Ndërkohë që udhëzimi i fundit bënte një kategorizim të pagave, por duke lënë jashtë pikërisht kategorinë e personave të cilët kishin mbaruar arsimin e lartë në degën e mësuesisë por që nuk jepnin lëndë të profilit të tyre, duke i barazuar me personat që janë me arsim të mesëm.

Në përfundim Institucioni i Avokatit të Popullit konstatoi se me Udhëzimin Nr. 30. datë 29.07.2008 të Ministrit të Arsimit, u ishin shkelur të drejtat legjitime një sërë subjektësh, të cilët ishin diskriminuar duke u trajtuar në pagë në të njëjtën mënyrë si dhe personat me arsim të mesëm. Natyrisht duhet të ketë kategorizim në pagë për mësuesit, por ky kategorizim duhet të jete së pari, në përputhje me VKM V.K.M Nr. 194 datë 22.04.1999, “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” i ndryshuar, dhe së dyti, autoriteti, pra Ministri i Arsimit duhet të ketë të drejtë që të bëjë një kategorizim sipas profilit të shkollës së lartë dhe ngarkesës mësimore, pra të autorizohet shprehimisht nga V.K.M.-ja përkatëse.

Në përfundim ju rekomandua Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të plotësojë Udhëzimin Nr.30 datë 29.07.2008 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 06.05.1999 “Për pagat e punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, ku të përcaktohet përfshirja në një kategori të caktuar të personave të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë për mësuesi dhe që kanë një ngarkesë të plotë mësimore në lëndë jashtë profilit. Në të njëjtën kohë ju rekomandua marrja e masave për t’u dërguar për botim në Fletoren Zyrtare të Udhëzimit nr.8 datë 06.05.1999 “Për pagat e punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”.

2. Shtetësja I.M. depozitoi një ankim pranë Institucionit të Avokatit të, lidhur me vendimin e Rektorit të Universitetit të Tiranës për përzgjedhjen në vendin e punës si pedagoge në Departamentin e Laboratorëve të Fakultetit të Mjekësisë.

Ne analize te rastit konkret, pavarësisht se nuk u shprehem konkretisht për thelbin e kësaj ankese, për shkak se ankuesja i ishte drejtuar gjykatës, nga studimi në përgjithësi i akteve ligjore e nënligjore të cilat kishin rregulluar këtë proces, arritëm në konkluzionin se:

Çdo fakultet, kërkesë kjo e ligjit, duhet të hartonte përshkrimet e vendeve të punës vakante, me qëllim që të dilnin në pah kriteret e veçanta, pasi të përgjithshmet janë të përcaktuara në Ligj dhe do të parashikohen në Statut. Mosveprimi për të bërë përshkrimet e vendit të punës linte vend për subjektivizëm nga ana e vendimmarrjes së komisioneve të vlerësimit.

Nga studimi i projekt Statutit konstatoam se procedura që duhet të respektohej nga momenti i shpalljes së vendeve të lira dhe deri në momentin e përzgjedhjes që bënte Rektori, nuk ishte e detajuar në mënyrë të saktë. Konkretisht në nenin 64 të tij, parashikohej se: “Procedura e konkurimit përcaktohet me shpalljen e vendit vakant dhe për të zbatohen, për aq sa janë të mundura, dispozitat e ligjit për shërbimin civil dhe ato të Kodit të Punës”.

Një parashikim i tillë nuk specifikonte rastin se kur do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për statusin e nënpunësit civil” dhe kur Kodi i Punës, pasi këto dy ligje kane procedurë të ndryshme.

Në përfundim, duke vlerësuar aktet e përmendura, Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Rektorit që në Statutin e Universitetit të Tiranës apo në Rregulloren e tij të bëhej detyrimisht një parashikim i të gjithë momenteve proceduriale, nëpër të cilat duhet të kalojë vendimmarrja për rekrutimin e stafit akademik, bazuar në mënyrë specifike në ligjin konkret që do të zbatohet, si dhe Statuti të parashikojë kushtin e detyrueshëm të miratimit të një Metodike të vlerësimit nga ana e komisioneve të vlerësimit.

Në përgjigje të Rekomandimit tonë, nga ana e Rektoratit jemi informuar se sugjerimet tona janë marrë në konsideratë në ndryshimet që i janë bërë dispozitave të Statutit të Universitetit të Tiranës.

3. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë V.T. Në kuadër të Paketës Altertekst 2009, të shpallur dhe të aprovuar me Urdhrin nr.36 datë 24.02.1009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, shtëpia botuese Mediaprint ka paraqitur vlerësimin për tekstet e “Edukimit muzikor” për klasën e 7, 8 dhe 9-të hartuar prej tij si autor.

Lidhur me procedurën e vlerësimit të këtyre teksteve, ankuesi pretendoi dhe kërkoi rivlerësim të tyre nga ana e komisionit pasi një nga personat, të cilët kishin bërë vlerësimin e këtyre teksteve, kishte qënë autor teksti i “Edukimit Muzikor” si dhe kishte interesa me një prej shtëpive botuese, e cila ishte konkuresë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese arritëm në përfundimin se

në rastin konkret ishte shkelur pika 4 të Udhëzimeve të përgjithshëm për përdorimin e teksteve në shkollat e Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se:

“Personat, të cilët janë autorë tekstesh apo kanë interesa të lidhura me shtëpitë botuese pjesëmarrëse në sistemin konkurrues të tregut të teksteve shkollore, nuk lejohet të marrin pjesë në KSHT për vlerësimin e teksteve...”, pasi njëri prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit pavarësisht se nuk ka qënë autore e teksteve objekt shqyrtimi të komisionit ku bën pjesë, rezulton të ketë interesa me shtëpinë botuese “Morava”, pasi është kjo shtëpi botuese që ka botuar librin e tij dhe të një autori tjetër, Edukimi Muzikor 4.

Termi “interesa” i përdorur në këtë akt, përfshin natyrisht çfarëdolloj interesi të karakterit pasuror ose jo, direkt ose indirekt, në mënyrë që vendimmarrja të jetë e pacënueshme dhe objektive. Natyrisht në aktet përkatëse është e mirërregulluar çështja e konfidencialitetit të materialeve që do të vlerësohen nga vlerësuesit. Por kjo nuk e përjashton vlerësuesin që të deklarojë se nuk ka asnjë konflikt interesi në vendimmarrjen përkatëse. Akti konkret nuk kërkon deklaram për shtëpitë botuese që janë pjesëmarrëse, por për të gjitha ato “shtëpi botuese pjesëmarrëse në sistemin konkurrues të tregut të teksteve shkollore”. Anëtarja e komisionit ishte në dijeni të faktit se shtëpia botuese “Morava” bënte pjesë pikërisht në ato shtëpi botuese pjesëmarrëse në sistemin konkurrues. Është e padiskutueshme që në këtë rast mbi këtë fundit ka qendruar detyrimi për të deklaruar mungesën e konfliktit të interesit. Në përfundim në analizë të legjisilacioni përkatës konkluduar vendimi i Komisionit të Miratimit të teksteve shkollore, i cili ka miratuar tekstin Edukimi Muzikor 9, është një akt administrativ relativisht i pavlefshëm pasi ka ekzistuar konflikti i interesit dhe si pasojë vullneti i organit është i vesuar.

Sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut për një proces të drejtë dhe të paanshëm të vlerësimit të teksteve shkollore, bazuar në pikën 4.b të ”Udhëzime të përgjithshme për përdorimin e teksteve në shkollat e Republikës së Shqipërisë”, kërkoj fillimin e një procedimi administrativ dhe shfuqizimin si të pavlefshëm të aktit të miratimit të tekstit Edukimi Muzikor 9, nxjerrë nga Komisioni i Miratimit të Teksteve Shkollore si dhe vendosjen e sanksioneve të parashikuara pikën 4.b të ”Udhëzime të përgjithshme për përdorimin e teksteve në shkollat e Republikës së Shqipërisë” si në drejtim të vlerësuesit dhe të Shtëpisë Botuese.

Në përgjigje të rekomandimit të dërguar nga ana e Ministrisë së Arsimit jemi infomuar se ky organ ka filluar procedimin për marrjen e masës ndaj anëtarit të komisionit të vlerësimit.

4. Pranë Institucionit të Avokatit u depozitua ankesa e një grupi studentësh të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të cilët pretendonin se duhet të zhvillohin studimet në nivelin e dytë në mënyrë të detyrueshme pavarësisht mesatares që ata kishin në përfundim të ciklit të parë të studimeve në përfundim të të cilit merret Diplomë e Nivelit të dytë.

Pas analizës së akteve ligjore e nënligjore në fuqi konstatuam se:

1. Ligji për Arsimin e larte e përcaktonte teëqarte se është Statuti i institucionit të arsimit të lartë akti që duhet të parashikojë kriteret akademike për të vazhduar studimet në ciklin e dyte;
2. Statuti i UBT ja jep këtë kompetencë Rregullore së fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit;
3. Rregullorja e Fakultetit parashikon se duhet të vendosen kriteret në Rregulloret e studimeve universitare të Fakultetit.
4. Por pavarësisht se ekziston një rregullore studimesh e cila parashikon kriteret, kjo nuk ishte pjesë e Rregullores së fakultetit pasi nuk ishte miratuar nga Rektori siç e kërkon Statuti për rregulloren e fakultetit;
5. Statuti nuk parashikon se çfarë natyre ka rregullorja e studimeve dhe si duhet të miratohet ajo;

Si konkluzion Institucioni i Avokatit të Popullit konkludoi se në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit duhej të ishte parashikuar se, “Rregulloret e Studimeve duhet të miratohen nga Rektori pasi propozohen nga Këshilli i Fakultetit”. Rregulloret e studimeve duhet të jenë pjesë e rregullores së Fakultetit. Statuti e ka të parashikuar qartë se kriteret do të parashikohen në Rregulloren e Fakultetit. Por edhe sikur mos të ishin pjesë e saj në një moment të dytë ato duhet të miratohen nga Rektori.

Referuar teorisë së vlefshmërisë së aktit administrativ, që ai të jetë i vlefshëm, duhet të miratohet nga organi kompetent. Në rastin konkret duke qene se Statuti i UBT dhe Rregullorja e Fakultetit të Ekonomi Agrobiznesit nuk parashikojnëse cila do të jetë struktura që do të miratojë këto Rregullore, nisur dhe nga parashikimet e mësipërme, rezulton se, këto Rregullore duhet të miratohen sipas procedurës dhe në të njëjtën mënyrë që parashikon Statuti për Rregulloret e Fakulteteve. Në kushtet kur ky akt është miratuar vetëm nga Këshilli i Fakultetit dhe nuk është miratuar nga Rektori, ai nuk mund të konsiderohet si akt që ka fuqi juridike dhe si pasojë ai nuk mund të zbatohet. Ai është pa fuqi juridike, pasi që të konsiderohet akti i nxjerrë ai duhet të gjejë miratimin në rastin konkret të dy organeve, konkretisht të Këshillit të Fakultetit dhe të Rektorit të Universitetit. Pa kundërfirmimin e Rektorit ky akt nuk mund të konsiderohet me fuqi juridike. Këshilli i Fakultetit në këtë rast ka vetëm fuqi propozuese dhe jo vendimmarrëse. Bazuar sa më sipër ne e gjetëm të bazuar kërkesën e studentëve dhe rekomanduam zbatimin e

Statutit të Universitetit Bujqësor të Tiranës që për hyrjen në fuqi të Rregullores së studimeve të ciklit të dyte në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, të kërkohet miratimi i saj nga Rektori i Universitetit Bujqësor. Në përgjigje të këtij rekomandimi jemi informuar zyrtarisht vetëm nga ana e Ministrisë së Arsimit, e cila na ka vënë në dijeni se Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës nuk është miratuar ende nga Ministria e Arsimit. Për këtë arsye Institucioni ynë është duke e ndjekur në vijimësi këtë çështje.

5. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur dy ankesa konkretisht nga Z.A. Ç. dhe Z.Xh. B., të cilët janë punonjësit mësimor shkencor, në proces për të marre titullin shkencor Prof.Asoc. pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Objekt i këtij ankimi ishte Urdhri Nr.171, datë 30.12.2008 i nxjerrë nga ana e Rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, lidhur me kriteret që duhet të përmbushin punonjësit mësimor shkencor për të aplikuar për marrjen e titujve akademike.

Në analizë të pretendimeve të dhena nga ankuesit, si dhe të akteve ligjore e nënligjore të cilët parashikojnë dhe rregullojnë kriteret dhe procedurat që duhet të ndiqen për marrjen e titujve shkencorë, kemi arritur në konkluzionin se bazuar në V.K.M. Nr. 467 datë 18.07.2007 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik", kreu III, pika 3.2 ku parashikohet që ankuesit të përfitojnë titullin e kërkuesit duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786 datë 17.12.1998 "Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjike e kërkimore" i ndryshuar, por duhet të nënshtrohen procedurave të parashikuara në V.K.M. Nr. 467 datë 18.07.2007 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik".

Në rastin konkret Rektori i Universitetit Bujqësor ka nxjerrë Urdhrin Nr.171 datë 30.12.2008 i cili është një akt administrativ që ka natyrë procedurale dhe materiale. Është materiale pasi ai shton një kriter, atë të përvojës në mësimdhënie në listën e kriterëve që duhet të përmbushin aplikantët, të cilat e ritheksojmë janë të parashikuara në V.K.M. Nr. 786, datë 17.12.1998 "Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjike e kërkimore" të ndryshuar.

Në analizë të akteve që rregullojnë situatën ligjore konkrete kemi arritur në konkluzionin se Urdhri Nr.171 datë 30.12.2008 i nxjerrë nga Rektori është një akt absolutisht i pavlefshëm pasi :

a. Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës nuk ka kompetencën për të nxjerrë një akt të tillë. Kjo del nga analiza e dispozitave të Ligjit Nr.9741 datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e

Shqipërisë" dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave të cilet parashikojnë kriteret dhe procedurat për marrjen e titujve akademike.

b. V.K.M. nr. 897, datë 29.12.2004 "Për disa ndryshime në vendimin nr.786, datë 17.12.1998, të Keshillit të Ministrave, "Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjike e kërkimore", të ndryshuar, ka parashikuar se kriteret që duhet të përmbushen nga dy individët janë parashikuar në pikën 4.3.2. Pra nuk rezulton që në këtë rast të kërkohet një përvojë e caktuar në mësimdhënie. Në mënyrë të prerë mund të themi që me asnjë akt tjetër nuk mund të shtohen apo të pakësohen kriteret që duhet të përmbushë nje person për të marre një titull akademik.

Në këto kushte kemi çmuar se Rektori kishte detyrimin ligjor dhe duhet të konstatonte pavlefshmërinë absolute të aktit duke vënë në lëvizje në të njëjtën kohë procedurat deri në atë kohë të pezulluara për marrjen e titujve akademike.

Në përfundim i kemi Rekomanduar Rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të Urdhrit Nr 171 datë 30.12.2008 dhe vazhdimin e procedurave për marrjen e titujve akademike ne Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Nga ana e Rektorit ky rekomandim është refuzuar padrejtsisht, prandaj jemi ende duke e shqyrtuar këtë çështje në bazë të ligjit.

6. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u paraqit një ankesë lidhur me faktin se nga ana e Ministrisë së Arsimit shtetasit D.A. po i zvarriteshin procedurat administrative për ekuivalentimin e diplomës marrë në Universitetin e Piteshtit, Rumani.

Nga ana jonë, për këtë ankesë, është zhvilluar një korespondencë e gjatë si me Institucionet Shqiptare dhe në të njëjtën kohe kemi komunikuar zyrtarisht dhe me Ombudsmanin e Rumanisë për të ndërmjetësuar ardhjen e përgjigjes për Ministrinë tonë të Arsimit nga ana e Universitetit të Piteshtit.

Në përfundim me ndërhyrjen tonë dosja e ankuesit u depozitua pranë Komisionit të vlerësimit i cili bëri njohjen e diplomës për ankuesin.

## 12. Ministria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2009 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj ka patur gjithsej 34 ankesa e kërkesa. Janë zgjidhur në favor 11 ankesa dhe 1 kërkesë, 1 ka rezultuar e pabazuar, 13 kanë qënë jashtë juridiksionit dhe jashtë kompetence, 4 raste janë zgjidhur me rekomandim të pranuar dhe 1 rast me rekomandim të refuzuar. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës tonë 3 ankesa.

Nga viti 2008 kanë qënë të mbartura 5 raste, nga të cilat 1 ka rezultuar e pabazuar, 2 ankesë kanë qënë jashtë kompetence, 1 është



zgjidhur me rekomandim të pranuar dhe 1 ankesë rezulton me heqje dorë nga ankuesi.

Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri ka qënë kryesisht lidhur me vendimet për largimet nga detyra, transferime, zvarritje të procedurave administrative, kërkesa drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për t'u kuruar jashtë shtetit, trajtimi i të sëmurëve me probleme të shëndetit mendor etj.

Këtë vit, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ushtruar në mënyrë aktive kompetencën që i është dhënë nga ligji, për të kryer inspektime edhe në institucionet publikë shëndetësore, konkretisht në disa spitale infektive si dhe ka riinspektuar spitalet psikiatrike. Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këto inspektime janë kushtet dhe standartet që duhet të plotësojnë këto spitale në lidhje me nevojat e pacienteve të strehuar në to .

Nga ana jonë ju është paraqitur autoriteteve përkatëse një rekomandim i veçantë për këtë çështje. Nga pergjigjet e prezantuara pranë Zyrës së Avokatit të Popullit u vërejt dukshëm një angazhim i veçantë i Ministrisë së Shëndetësisë për të marrë masat e duhura në përmirësimin e situatës së konstatuar.

Megjithëse rekomandimi i paraqitur në vitin 2008 arriti të ngacmojë vëmendjen e organeve kompetente dhe u shoqërua me masa konkrete, Avokati i Popullit nisur nga eksperiencia e tij mbi problemet në këtë fushë, vendosi që të ushtrojë sërish një inspektim mbi të gjithë objektet spitalore që mbulojnë shërbimin e psikiatrisë dhe ate infektiv.

**A.** Në mënyrë të detajuar rezultatet e inspektimit të realizuara nga Njësia për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit, sipas kërkesave të Ligjit Nr.8092 dt.21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor”, i janë dërguar Ministrisë së Shëndetësisë, përfshirë edhe rekomandimet përkatëse:

### **I. Spitali Psikiatrik Elbasan**

Në vitin 2008 Avokati i Popullit rekomandoi për Spitalin Psikiatrik Elbasan si më poshtë vijon:

Shtimin e organikës me mjekë psikiatër në Spitalin Psikiatrik Elbasan për një trajtim sa më të plotë të pacientëve të shtruar .

Marrjen e masave për nxjerrjen nga ky spital të pacientëve që janë të sëmurë mendorë kronike, pasi qëndrimi i tyre në këto ambiente ishte thjesht për arsye strehimi dhe jo kurimi.

Miratimin e një kuote të re ushqimore, pasi në gjëndjen aktuale të çmimeve në treg ajo nuk plotësonte nevojat jetike të pacientëve.

Eliminimin e të gjitha mangësive të tjera që përmbante ai rekomandim.

Në tetor të vitit 2009 në përfundim të inspektimit të Avokatit të Popullit u evidentuan me anë të rekomandimit mangësitë dhe përmirësimet si më poshtë:

1. Nuk është realizuar pika e parë e rekomandimit dhe aktualisht është pakësuar numri i mjekëve nga 7 në 6 mjekë psikiatër, pasi njëri prej tyre është larguar në pozicionin e drejtorit të spitalit rajonal të Elbasanit. Gjithashtu gjëndja paraqitet shqetësuese edhe me personel kujdestar, ku drejtuesit na informuan se kanë bërë kërkesë për shtim të numrit të kujdestarëve për vitin 2010.

2. Nuk është realizuar pika e dytë e rekomandimit, për arsye të mungesës së strukturave përkatëse, në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të cilat duhet të jenë qendra të veçanta për strehimin e personave me prapambetje mendore, të cilët qëndrojnë prej shumë vitesh në keto spitale. Kjo gjë mbetet për t'u ndjekur dhe nga Ministria e Shëndetësisë duke bashkëpunuar me Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Nuk është realizuar pika e tretë e rekomandimit për shtimin e kuotës ushqimore për vitin 2009. U informuam se grupi i punës i ngritur nga Ministria e Shëndetësisë ka bërë studimin përkatës, por që aktualisht edhe pas një viti nuk është implementuar. Drejtuesja na pohoi se kjo rritje do reflektohej në buxhetin e vitit 2010.

4. Janë realizuar pjesërisht disa nga problematikat e tjera të ngritura si më poshtë:

**a.** Furnizimi me paisje hotelerike si krevate, komodina, dollape etj., është bërë i mundur në vitin 2009 dhe gjëndja është e kënaqëshme.

**b.** Situata është e keqe në lidhje me veshmbathjet e pacienteve pasi tenderi për to nuk është realizuar fare për vitin 2009. Situata është përballuar me ndihma të shoqatave të ndryshme apo të nxënësve të shkollave dhuruar për këta të sëmurë. Edhe paisjet e lavanderisë dhe guzhinës janë të amortizuara dhe institucioni ka bërë kërkesë për shtesë në buxhetin e vitit 2010.

**c.** Nuk është zgjidhur edhe mjekimi stomatologjik për këtë kategori pasi paisja dentare që bën të mundur këtë trajtim, nuk është blerë për mungesë fondi. Shërbimi vazhdon i njëjtë vetëm për heqje dhëmbësh dhe jo trajtim mjekësor.

**d.** Ka përmirësim të dukshëm në jetën sociale të këtyre pacienteve pasi shoqata italiane San Egidio organizon aktivitete të larmishme, si ekspozita pikturash, dërgimin e tyre në kinema dhe teatër, organizime festash fetare dhe ditëlindjesh të ndryshme. Gjithashtu është ngritur edhe ekipi i futbollit dhe ndjekje të aktiviteteve të ndryshme sportive.

## **II. Spitali Psikiatrik Vlorë**

Në vitin 2008 Avokati i Popullit rekomandoi për Spitalin Psikiatrik Vlorë si me poshte vijon:

1. Marrjen e masave emergjente për rikonstrukcion të Godinave të Spitalit Psikiatrik në Vlorë.

2. Furnizimin me pajisje hotelerie (veshmbathje, komodina, shtretër, pajisje kuzhine) me qëllim përmirësimin e shërbimit shëndetësor psikiatrik.

3. Shtimin e kuotës ushqimore për të perballuar çmimet e tregut në rritje.

4. Shtimin e numrit të mjekëve dhe personelit tjetër ndihmës për përmirësimin e trajtimit të këtyre të sëmurëve.

Në tetor të vitit 2009 në perfundim të inspektimit të Avokatit të Popullit u evidentuan me anë të rekomandimit, mangësitë dhe përmirësimet si më poshtë:

1. Është realizuar pjesërisht pika e parë e rekomandimit, dhe aktualisht është bërë rikonstrukcioni vetëm i një godine për 10 paciente gra, dhe janë në proces dy godina të tjera për 25 paciente. Është kërkuar fondi për vitin 2010 për ndërtimin e spitalit të ri me shtretër për mjekim akut. Godinat e tjera ekzistuese nuk janë rikonstruktuar, pasi nga projekti i miratuar disa prej tyre do të prishen sepse pasi janë tejet të amortizuara.

2. Është realizuar pika e dytë e rekomandimit, furnizimi me pajisje hotelerike si krevatë, dyshekë, komodina, batanije etj. Gjithashtu janë blerë pajisje të reja për guzhinën si sobë, aspirator, lavatriçe. Situata është e keqe në lidhje me artikullin veshmbathje spitalore, pasi tenderi për to nuk është realizuar për vitin 2009. Spitali është mbajtur me ndihma nga kisha ortodokse e Beratit dhe rezervat e tyre.

3. Nuk është realizuar pika e tretë e rekomandimit për shtimin e kuotës ushqimore për vitin 2009. Jemi informuar se grupi i punës i ngritur nga Ministria e Shëndetësisë ka bërë studimin përkatës, por që aktualisht edhe pas një viti nuk është implementuar. Drejtuesja na pohoi se kjo rritje do reflektohej në buxhetin e vitit 2010.

4. Nuk është realizuar pika e katërt e rekomandimit, që është shtimi i numrit të mjekëve dhe personelit tjetër ndihmës për përmirësimin e trajtimit të këtyre të sëmurëve. Institucioni ka bërë kërkesë për personel ndihmës dhe për 2 specializime për mjek psikiatër për vitin 2010.

## **III. Spitali Psikiatrik Shkodër**

Në vitin 2008 Avokati i Popullit rekomandoi për Spitalin Psikiatrik Shkodër si më poshte vijon:

1. Marrjen e masave emergjente për rikonstrukcionin total të godinës së Spitalit Psikiatrik në Shkodër, si dhe zëvendësimin e të gjitha

paisjeve hotelerike, me qëllim përmirësimin e shërbimit shëndetësor psikiatrik, për të ngritur standartet e tij.

Në tetor të vitit 2009 në përfundim të inspektimit të Avokatit të Popullit u evidentuan me anë të rekomandimit mangësitë dhe përmirësimet si me poshtë:

1.Është realizuar plotësisht rekomandimi pasi konstatoam se që prej dy muajsh ka nisur rikonstruksioni total i këtij spitali. Gjithashtu me një fond nga ministria është bërë e mundur pajisja me 90 shtretër, 50 dyshekë si dhe paisje të tjera hotelerike. Gjithashtu u informuam se spitali psikiatrik ka kaluar në varësinë e D.SH.P-së Shkodër. Tashmë duhet treguar kujdes që rikonstruksioni të bëhet sa më mirë.

#### **IV. Spitali Psikiatrik Tiranë**

Në vitin 2008 Avokati i Popullit rekomandoi për Spitalin Psikiatrik Tiranë si me poshte vijon:

1.Krijimin e një shërbimi më vete me personel kujdestar dhe edukator vetëm për fëmijë dhe adoleshentë duke i dhënë statusin e një klinike dhe shkëputjen e saj imediate nga godina e Psikiatrisë së të miturve.

2.Marrjen e masave urgjente për punësimin e punonjësve social dhe të një mësuesi pranë këtij reparti, pasi kjo kategori meriton një vëmendje specifike, e parë kjo edhe në këndvështrimin e përgjithshëm të këtij sistemi.

3.Përmirësimin e paisjeve hotelerikë si krevatë dhe komodina dhe zëvendësimin e xhamave të dritareve me xhama të pathyeshëm për sigurinë maksimale të pacientëve të strehuar

Në nëntor të vitit 2009 në përfundim të inspektimit të Avokatit të Popullit u evidentuan me anë të rekomandimit mangësitë dhe përmirësimet si më poshtë:

1.Është realizuar plotësisht pika e parë e rekomandimit, pra krijimin e një shërbimi më vete me personel kujdestar dhe edukator vetëm për fëmijë dhe adoleshentë, godine e cila pritet të inagurohet brënda disa ditëve.

2.Nuk është realizuar pika e dyte e rekomandimit, për punësimin e punonjësve social dhe të një mësuesi pranë këtij reparti. Theksojmë se në përgjigjen e dhënë nga ministria një vit me parë është premtuar zgjidhja e këtij problemi, por aktualisht rezulton e kundërta.

3.Është realizuar plotësisht pika e tretë e rekomandimit për përmirësimin e paisjeve hotelerikë si krevatë dhe komodina te reja, e zgjidhur kjo me përmirësimin e kushteve dhe transferimin në ambientet e reja të spitalit.

**B.** Njësia për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit, ka realizuar gjithashtu inspektime në Spitalin Infektiv të Tiranës.

## **Spitali Infektiv Tiranë**

Në vitin 2008 Avokati i Popullit rekomandoi për Spitalin Infektiv Tiranë si më poshtë vijon:

1. Hartimin e një rregulloreje të veçantë të këtij spitali në lidhje me procedurat e trajtimit të pacientëve në kushte karantine.

2. Marrjen e masave për krijimin e ambjenteve të veçanta në spitalin infektiv, për t'i paraprirë rasteve të epidemive që mund të sjellin futjen e tyre në karantinë, duke respektuar standartet.

3. Mbështetjen financiare të punonjësve të stafit mjeksor që punojnë në spitalin infektiv (mjek dhe infermier) dhe konkretisht dhënien e shtesës për kushte pune të diferencuar nga kategoritë e tjera edhe sipas ligjit 8689, dt.16.12.2000, "Për Parandalimin e Përhapjes së Infeksionit HIV/AIDS".

Në Nëntor të vitit 2009 në përfundim të inspektimit të Avokatit të Popullit u evidentuan me anë të rekomandimit mangësitë dhe përmirësimet si më poshte:

1. Nuk është realizuar pika një e rekomandimit dhe konkretisht hartimi i një rregulloreje të veçantë për pacientet në kushte karantine, kjo e justifikuar me faktin se ekziston një bazë ligjore e mjaftueshme siç është ligji për Epidemiologjinë, ligji i inspektoriatit sanitar shtetëror si dhe akte të tjera nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve bazë (referuar përgjigjes së Ministrisë së Shëndetësisë viti 2008). Ndërsa po rishikohej rregullorja e përgjithshme e spitalit e cila shumë shpejt do jetë një rregullore konform standarteve të kërkuara.

2. Është realizuar pjesërisht pika dy e rekomandimit, duke u informuar se është krijuar një ambient i veçantë për raste epidemish dhe konkretisht gjashtë dhoma të cilat janë të pamjaftueshme për përballimin e ndonjë pandemie siç është edhe gripi AH1N1.

3. Është zgjidhur pika tre e rekomandimit për marrjen e një shtese financiare të punonjësve të stafit mjeksor që punojnë në spitalin infektiv (mjek dhe infermier) dhe konkretisht dhënien e shtesës për kushte pune të diferencuar nga kategoritë e tjera edhe sipas ligjit 8689, dt.16.12.2000, "Për Parandalimin e Përhapjes së Infeksionit HIV/AIDS". Kjo në bazë të vendimit të Qeverisë nr. 1670 dt.24.12.2008, "Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr 306, datë 27.06.2002", ku përcaktohen një sërë ndryshimesh nga të cilat mjekët e këtij spitali kanë përfituar. Por nga shefi i shërbimit u informuam se në këtë vendim nuk janë përfshirë personeli i ulët (sanitare, shoferë, sekretare etj), persona këta njësoj të ekspozuar nga HIV/AIDS sikurse edhe mjekët dhe infermierët.

Në lidhje me ambjentet e duhura që duhet të ketë ky spital në raste emergjence epidemie masive nuk janë të mjaftueshme. Konkretisht spitali ka një kapacitet prej 80 shtretërisht (numër jo i vogël) por sipërfaqja e shtrirjes së tyre lë për të dëshiruar. Kjo me llogjikën se dhomat duhet të

jenë me më pak pacientë, pasi në të njëjtën dhomë bashkëjetojnë të sëmurë me diagnoza të ndryshme, gjë që e vështirëson kurimin e më pas shërimin e plotë të tyre. Kjo gjë mund dhe duhet të zgjidhet konkretisht duke transferuar dy reparte të tjera që ndodhen në të njëjtën godinë, konkretisht reparti reumatologjisë dhe alergologjisë. Kjo do të zgjeronte mjaftueshëm kapacitetin e spitalit infektiv duke krijuar ambiente të veçanta për karantinën apo ndonjë epidemi masive.

Problematika e trajtuar më lart në shumë aspekte paraqitet e njëjtë për spitalet e inspektuara. Kjo do të thotë se në tërësinë e tij shëndeti mendor po përballet me vështirësi të mëdha që në shumë raste i faturohen mungesës së fondeve të organeve shtetërore kompetente.

**1.** Funkzioni kryesor i Spitaleve Psikiatrike dhe i shërbimit mjekësor ndihmës është rehabilitimi dhe përmirësimi i gjendjes së të sëmurit mendor. Ky është edhe qëllimi që jepet si kusht parësor për zbatim në Ligjin “Për Shëndetin Mendor”. Nga të dhënat dhe gjëndja e konstatuar në të tre objektet e inspektuara, rezultoi se kushtet dhe trajtimi i të sëmurëve, jo vetëm që lë shumë për të dëshiruar dhe nuk premtan përmirësimin e shëndetit të tyre, por në shume raste ai ndikon në përkeqësimin e tij.

**2.** Kuotat ushqimore të të sëmurëve vijojnë të mbeten në nivele minimale dhe nuk janë rishikuar në perputhje me çmimet e reja të tregut ushqimor. Për këtë qëllim kjo çështje duhet analizuar dhe zgjidhur sa më shpejt për të përmirësuar ushqimin dhe llojshmerinë e tij në dobi të pacienteve.

**3.** Ministria e Shëndetësisë ende nuk ka realizuar objektivat me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për vënien në zbatim të detyrimeve ligjore për ngritjen e qëndrave të veçanta për pacientet të cilët strehohen në spitale psikiatrike, jo për t’u kuruar dhe rehabilituar, por se nuk kanë se ku të rrinë. Spitalet Psikiatrike në shumicën e tyre, shfrytëzohen si azile dhe ambiente hotelerike. Kjo, pasi familjarët apo kujdestarët nuk pranojnë të rimarrin në shtëpi personat tashmë të abandonuar. Gjithashtu numri i vendosur në qendrat komunitare mbetet në shifra të ulta në raport me nevojat e të sëmurëve.

**4.** Nga inspektimi rezultoi se personeli mjekësor ishte mjaft i rrezikuar nga pacientet pasi nuk ekzitonin mjete efikase mjeksore dhe teknike për çmobilizimin e tyre në rast krizash akute psikike. Gjithashtu, Ministria duhet të marrë parasysh sygjërimet tona për rritjen e personelit në këto institucione, gjë që do të ulte rrezikshmërinë evidente aktuale.

**5.** Një çështje tjetër, e cila kërkon një vemendje të veçantë, është paisja me veshje hotelerike që për vitin 2009 nuk është realizuar dhe spitalet e kanë përballuar me vështirësi situatën e krijuar. Për sa më sipër, i jemi drejtuar Ministrave të Shëndetësisë dhe atij të Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me rekomandime për marrjen e

masave ligjore, organizative dhe buxhetore për përmirësimin e shërbimit shëndetësor psikiatrik në shkallë vendi, duke e standartizuar atë me kushte te pranueshme dhe ligjore.

Ndërkohë Avokati i Popullit megjithëse ka paraqitur në Maj 2008 Raportin e Posaçëm të Shëndetit Mendor Nr. 2, nuk ka marrë ende një njoftim lidhur me shqyrtimin e tij në Kuvendin e Shqipërisë.

C. Gjatë vitit 2009 Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar një sërë ankesash nga individë të ndryshëm apo dhe me inisiativë, nga të cilat përmendim:

1. Ankesën e një grupi Drejtorësh të disa Qëndrave Shëndetësore Tiranë, lidhur me konkursin e shpallur “Mbi emërimet për pozicionet e tyre” nga Drejtori i Autoritetit të Shëndetit Rajonal Tiranë. Konkretisht në ankesë ata shprehen se janë bërë me dije për njoftimin e këtij konkursi në faqen zyrtare të internetit të Agjensisë së Prokurimeve Publike, në Buletinin e datës 29 Qershor 2008. Në këto kushte, duke pretenduar se ata nuk janë njoftuar kurrë dhe nuk kanë pasur asnjë informacion të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Autoritetit Shëndetit Rajonal (ASHR) më parë, por dhe në kontekst të asaj që kjo kompetencë e ndërmarrë nga ana e ASHR-së është e paligjshme, ankuesit kanë kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për anulimin e procedurave të përcaktuara në këtë njoftim për konkurs.

Lidhur me këtë fakt, një nga ekspertet e Zyrës së Avokatit të Popullit ka marrë kontakt telefonik direkt me drejtorin e ASHR-së. Nga ana e tij u konfirmua fakti i mungesës së vendimeve të marra nga Bordet e QSH-së për shkarkimin e Drejtorëve përkates, me justifikimin se kjo procedurë është shumë e gjatë dhe merr shumë kohë. Gjithashtu, nga drejtoria e kësaj qëndre na u konfirmua se janë konstatuar dosje të Drejtorëve të veçantë të QSH-rë, të cilat kanë pasur mungesa të dokumentacionit që kërkohen si kritere të përgjithshme për emërimin e personave në pozicionin e Drejtorit të Qendrave Shëndetësore dhe ky argument e ka bërë atë të shpallë një konkurs me qellim aplikimin e gjithë dokumentacionit nga fillimi të kandidateve për Drejtorë të Qëndrave Shëndetësore Tiranë.

Në këtë aspekt, duke parë se afatet e përcaktuara në njoftimin “Për pozicionet e Drejtorëve të Qendrave Shëndetësore të Tiranës”, përcaktojnë domosdoshmërinë e paraqitjes së dokumentave nga kandidatet pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore të ASHR-së së Tiranës, brenda datës 15.07.2009, Avokati i Popullit, ju drejtua me rekomandimin përkatës Ministrisë së Shëndetësisë, pasi shpallja e këtij konkursi në buletinin e datës 29.06.2009, thotë se bëhet në bazë të VKM Nr. 680 datë 2007 “Për disa ndryshime në VKM Nr. 857 datë 20.12.2006, të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor

parësor nga skema e detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetsor”, dhe Rregullores së Përgjithshme për Kontraktimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor parësor” – neni 25.

Institucioni yne duke studjuar me kujdes të veçantë të dy këto akte ligjore të përmendura më sipër në njoftimin për konkurs, argumentoi se në asnjë nga këto akte nuk përmendet kompetenca e Drejtorit të ASHR-së Tiranë për të shpallur një konkurs të tillë.

VKM Nr. 680 datë 2007 (neni 23), por dhe VKM Nr. 857 datë 20.12.2006 (pika 10), përcaktojnë shprehimisht se: “Drejtori i Qendres Shendetesore (QSH) emerohet dhe lirohet nga Bordi i Qëndres”.

Gjithashtu dhe neni 25 i Rregullores se Pergjithshme, thotë se: “Drejtori i QSH-së emerohet dhe lirohet nga Bordi i QSH-së në bazë të kriterëve për emërimin e Drejtorit të QSH-së të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë, së bashku me Statutin tip të Qëndrave Shëndetësore. ISKSH, ka të drejtë që kur konstaton keqmenaxhim të QSH, bazuar në prova të shkruara, t’i kërkojë Bordit të Qëndrës Shëndetësore shkarkimin e drejtorit”.

Nisur për sa më sipër Institucioni ynë e gjykoi se rishikimi i të gjitha dosjeve, për përmbajtjen e dokumentacionit të rregullt që i nevojitet çdo mjeku me qellim emërimin në pozicionin e Drejtorit në një Qendër Shëndetësore, nuk mund të përlligjë shpalljen e një konkursi të tillë, për vetë faktin se konkursi ka në përmbajtje një konkurim të gjerë për një pozicion vakant pune.

Per sa me siper, ne mbeshtetje te Nenit 63/3 te Kushtetutes se Shqipërisë si dhe Nenit 21/b te Ligjit 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse i rekomanduam Ministrin të Shëndetësisë marrjen e masave për anulimin e konkursit të shpallur nga Drejtori i Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë, në Buletinin e datës 29 Qershor 2009, të Agjencisë së Prokurimit Publik, për shkak të mungesës së kompetencave të organit të mësipërm, sipas ligjit ne fuqi “Për Qëndrat Shëndetësore”.

Në përgjigje të këtij rekomandimi si dhe nga kontakti që kemi mbajtur me ankuesit u vumë në dijeni se procedurat e konkursit në fjalë janë anuluar.

**2.** Ankesa e shtetasit A.Gj. në të cilën ankohej për moszbatimin nga Drejtoritë Spitalore në vend të Urdhrit nr.520 datë 5.12.2000, të Ministrin të Shendetesise sipas të cilit ngarkohen spitalet rajonale të përshtasin e pajisin nga një dhomë për shtrimin eventual të të semureve paraplegjike e tetraplegjike, si dhe të ngarkohej Spitali Universitar “Nënë Tereza” të përshtase e pajise dy dhoma për shtrim eventual të të semureve paraplegjike e tetraplegjike.

Në përgjigje të shkresës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me këtë problem që u parashtrua nga ankuesi, u informuam se për



pacientët me aftësi të kufizuara, janë marrë masat përkatëse pranë spitaleve rajonale dhe posaçërisht Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” për zbatimin e detyrimeve që dalin nga urdhëri i mësipërm.

### 13. Ministria e Puneve te Jashtme

Gjate vitit 2009 ka patur dhe jane shqyrtuar 14 ankesa dhe kerkesa per Ministrine e Puneve te Jashtme, Ambasadat dhe Konsullatat e Republikës së Shqipërisë.

Ka rezultuar se 2 ankesa kane qene jashte juridiksionit te Zyres se Avokatit te Popullit, 3 ankesa jane derguar per kompetence Drejtorise Konsullore te Ministrise se Puneve te Jashtme dhe Ambasadave, 2 ankesa jane zgjidhur ne favor te kerkuesit dhe 4 ankesa jane ende ne shqyrtim.

Disa prej ankesave, kane te bejne me pretendime te ndryshme te qytetareve shqiptare kunder perfaqesive diplomatike te vendeve te huaja te akredituara ne Shqiperi, prandaj ato cilesohen jashte juridiksionit tone. Ne perfundim te shqyrtimit te ankesave, duke patur parasysh specifikën e tyre, ankuesve u eshte dhene ndihmesa dhe konsulenca e nevojshme ligjore dhe ne raste te tjera praktikate i jane kaluar per kompetence Drejtorise Konsullore te Ministrise se Puneve te Jashtme.

Nder ankesat e marra ne shqyrtim nga Zyra e Avokatit te Popullit, permendim:

1- Ankesa e shtetasit C.P. nga qyteti i Kukesit, lidhur me hapjen e pikes kufitare te fshatit Borje, komuna e Shishtavecit e kerkuar kjo e fundit nga Kryepjegesia e fshatit. Nga angazhimi maksimal i Zyres se Avokatit te Popullit, bashkepunimit efektiv me Ministrine e Puneve te Jashtme si dhe strukturave te tjera te Shtetit Shqiptar dhe Republikës së Kosovës, kjo çështje është zgjidhur. Me këtë kontribut të dhënë, Avokati Popullit ka përmbushur detyrimin për të mundësuar realizimin e këtij projekti në kohë, i cili do të ketë një rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik të zonës.

2- Ankesa e paraqitur nga shtetasi K.A. nga Fieri, për kërcënimin që i bëhej djalit të tij, i cili ishte dënuar për vrasje dhe vuan dënimin me burg në Itali. Sipas korrespondencës së tij me të birin, atij (të birit) i kanosej jeta nga të burgosur të tjerë të cilet ishin paguar nga jashtë.

Mbas verifikimit dhe bashkërendimit të punës me Konsullatën e Përgjithshme të RSH në Milano të interesuarit ju dha konsulenca e duhur juridike dhe problemi i te birit u zgjidh, duke e sistemuar në një tjetër institucion të vuajtjes së dënimit.

3- Ankesa e nje grupi ish ambasadorësh te Republikës së Shqipërisë qe e kemi paraqitur ne raportin tone vjetor 2008 dhe ende nuk ka gjetur zgjidhje.

Objekti i saj eshte mosparashikimi ne buxhetin e Ministrise se Puneve te Jashtme te fondit te kontributeve të sigurimeve shoqërore për bashkëshortët/et e nëpunësve të përfaqësive diplomatike të vendit tone, ashtu siç dhe përcaktohet shprehimisht në nenin 46, paragrafi 1 të Ligjit nr.9095 datë 3.07.2003 "Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë": "Për personelin e Përfaqësive Diplommatike, koha e qëndrimit jashtë shtetit i njihet për efekt të vjetërsisë në punë dhe të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe bashkëshortit/es, i cili/e cila shoqëron nëpunësin në përfaqësinë diplomatike".

Rezulton se të pakten qe nga viti 2005 problemi qendron i pazgjidhur nga neglizhenca e strukturave qe merren me Buxhetin dhe Personelin ne Ministrine e Puneve te Jashtme.

Per kete qellim i kemi rekomanduar Ministrit te Puneve te Jashtme:

1. Marrjen e masave të shpejta për zgjidhjen e problemit të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortët/et, që shoqërojnë nëpunësin në përfaqësinë diplomatike.

2. Fillimin e ecurise disiplinore per shqyrtimin e punes se personave pergjegjes per kete çeshtje, me qellim marrjen e masave administrative per moskryerje te detyres se tyre.

Megjithese kemi kerkuar pergjigje lidhur me Rekomandimin ne fjale, nga ana e kesaj Ministrie nuk i eshte dhene zgjidhje problemit ne fjale.

\*

\* \*

Ne zbatim te funksioneve kushtetuese e ligjore, Institucioni i Avokatit te Popullit ne bashkepunim me IOM dhe Ministrine e Puneve te Jashtme gjate vitit 2009, dhe konkretisht ne kuadrin e projektit **“Mbështetje për zbatimin e Strategjisë Kombëtare shqiptare mbi Migracionin”**. Per kete qellim u zhvilluan vizita në Athinë dhe Milano, gjatë muajve shkurt dhe prill 2009. Vizitat kishin si synim vlerësimin e çështjeve më urgjente të cilat shqetësojnë emigrantët shqiptarë si dhe konsolidimin e bashkëpunimit midis zyrave të Avokatit të Popullit në Shqipëri, Greqi, Itali si dhe me perfaqesite tona diplomatike dhe konsullore, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë në këto vende.

Rendi i ditës për secilën vizitë u hartua në bashkërendim me Ambasaden tone ne Greqi-Athine, Konsullaten e Pergjithshme te RSH ne Milano, misionin e IOM në Athinë, Avokatin e Popullit te Greqise dhe Koordinatorin Kombëtar të zyrave të Avokatit të Popullit në Itali.

Këto vizita mundësuan vlerësimin e gjendjes së të drejtave të migrantëve në këto vende, si dhe perceptimin e tyre për shërbimet konsullore për emigrantët shqiptarë. Rezultoi se emigrantët shqiptarë në

Greqi i kanë mjaft të qarta mundësitë që ofron institucioni i Avokatit të Popullit aty në rast nevojë, pasi rreth 75-80% e kërkesave të tyre janë shqyrtuar pozitivisht. Ndërsa në Itali nuk ka shumë njohuri mbi funksionet e institucionit të Avokatit të Popullit ndaj dhe nevojitet më tepër punë për t'i informuar migrantët rreth kësaj mundësie, aq më tepër që Italia nuk ka një institucion ombudsmani Kombëtar.

Në përfundim të këtyre vizitave u evidentuan shqetësimet e tyre ndaj organeve të administratës publike shqiptare si dhe ato në drejtim të Shtetit Grek dhe Italian.

**Ndaj organeve të Administratës Publike në Shqipëri dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme (Ambasada jone në Athinë dhe Konsullata e Pergjithshme në Milano) u ngritën këto probleme:**

1. Ka procedura burokratike për të bërë legalizimin e dokumenteve në Shqipëri (Zyra e Gjendjes Civile - Prefekturë - Drejtoria Konsullore pranë Ministrisë së Jashtme). Kjo mënyrë kërkon shpenzim kohe dhe para më shumë.

2. Legalizimi i dokumenteve të lëshuara nga autoritetet shqiptare deri në muajin qershor 2007 bëhej edhe në Konsullatat tona në këto vende, por kjo e drejtë i është hequr atyre. Sipas emigrantëve, legalizimi në konsullatë i dokumentave krijon lehtësira, me pak shpenzime financiare dhe me pak kohë prej tyre.

3. Legalizimi i dokumenteve në konsullata, aktualisht bëhet vetëm me postë dhe nuk është parashikuar asnjë përjashtim edhe për rastet urgjente. Kjo mënyrë pune sjell shqetësime të emigrantëve për të bërë legalizime të dokumenteve kur ata kanë raste urgjente, si vdekje etj.

4. Ndaj autoriteteve shqiptare u ngritën pretendime se nuk kanë bashkëpunuar me autoritetet greke për njohjen e lejeve të drejtimit të automjeteve. Shumë prej tyre janë të pajisur me leje drejtimi në Shqipëri, por ato nuk u njihen nga autoritetet greke dhe për rrjedhojë detyrohen që bëjnë kurse e të pajisen me leje drejtimi nga autoritetet greke, duke paguar shuma të konsiderueshme parash.

5. Autoritetet shqiptare nuk kanë bashkëpunuar me autoritetet greke e italiane për njohjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore (viteve të punës) jashtë shtetit për efekt pensioni pleqërie.

6. U kërkua vendosja e një avokati pranë konsullatës tonë në Athinë për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve të mitur.

7. U kërkua mundësimi i aplikimit për letërnjoftime dhe për pasaportat e reja biometrike pranë Konsullatave tona.

8. Ndaj Ministrisë së Drejtësisë u ngrit shqetësimi për mospranimin e transferimit të të burgosurve shqiptarë nga këto vende në burgjet shqiptare.

9. Krijimi i mundësisë nga Konsullatat tona lidhur me lënien e takimeve dhe dhënien e sqarimeve për problemet që kanë emigrantët nëpërmjet telefonit.

10. U ngrit shqetësimi për mungesë informacioni lidhur me të drejtat ligjore të emigrantëve dhe për pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm në Greqi dhe në Itali.

11. Shoqatat e studentëve ngritën shqetësimin lidhur me njësimin e diplomave të tyre nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Shqipëri.

### **Ndaj autoriteteve greke e italiane u ngritën këto probleme:**

1. Ka vonesa dhe burokraci në pajisjen e emigrantëve me dokumenta (leje qëndrimi).

2. Brenda të njëjtës familje ka të palegalizuar, si gruaja apo fëmijët.

3. Ka raste që lejet e qëndrimit jepen me shumë vonesë dhe pasi u ka mbaruar afati i vlefshmërisë.

4. Ka dallime raciale në shkolla ndaj fëmijëve të emigrantëve.

5. Nuk bëhet lëvizja e lirë nga Greqia në Shqipëri e emigrantëve që janë në proces legalizimi, por kjo bëhet vetëm në rastet e festave.

6. Emigrantët në masë të konsiderueshme nuk sigurohen në punë dhe nuk iu derdhen kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

7. Të aksidentuarit në punë nuk trajtohen me pension invaliditeti.

8. Emigrantët në Greqi nuk përfitojnë pension pleqërie, nëse nuk realizojnë 3500 ditë pune.

9. Ka dallime kombësie ndaj emigrantëve shqiptarë për të ushtruar një biznes të ligjshëm. Atyre për shkak të kombësisë u kërkohet 60 000 Euro si garanci bankare, nëse duan që të hapin një biznes.

10. Nëse një emigrant shqiptar në Greqi arrestohet dhe akuzohet për një vepër penale, pa pritur që ai të shpallet fajtor nga gjykata, i ndërpritet procesi i pajisjes me dokumenta, ndonëse prezumohet i pafajshëm.

11. Ka probleme me zyrat e tatimeve, të cilat nuk u japin numrin personal.

12. Ka probleme me fëmijët e pashoqëruar.

13. Ka probleme punësimi, sidomos në këtë periudhë krize globale, si pasojë e saj, disa ishin larguar nga puna e të tjerë ndiheshin të pasigurt e të rrezikuar.

14. Ka burokraci në shkëmbimin e informacioneve për emigrantët nga autoritetet e të dy vendeve, i cili bëhet vetëm nëpërmjet Zyrrave të INTERPOLIT edhe për probleme elementare si verifikimi i ndryshimit të emrave apo të mbiemrave. Për këtë qëllim u hodh ideja që shkëmbimi i këtyre informacioneve të bëhet edhe nga zyrat e tjera të Ministrive të Brendshme.

15. U ngrit shqetësimi i tarifave të larta për rinovimin e lejeve të qëndrimit.

**Problemet me të burgosurit shqiptarë në burgjet greke:**

1. Të burgosurve në Greqi u mungon asistenca juridike edhe në rastet kur ajo kryhet është formale.

2. Nga gjykatat greke jepen dënime maksimale ndaj të burgosurve shqiptarë.

3. Në burgje ka mbi popullime.

4. Ndaj të burgosurve shqiptarë jepen dënime plotësuese nga gjykata, duke i dëbuar nga Greqia. Dhënia e këtyre dënimeve sillte pasoja sociale, sidomos për ata persona që kanë familjet në Greqi me dokumente të rregullta, duke i ndarë familjet.

5. Ka të burgosur që janë shumë të varfër, pa asnjë të ardhur dhe nuk kanë mundësinë e komunikimit me familjet e tyre në Shqipëri dhe për pasojë kanë humbur kontaktet me ato.

6. Mungesa e literaturës shqipe në burgjet greke e italiane.

7. Ndonëse të rralla, ka raste të përdorimit të dhunës, por autoritetet e drejtësisë janë të disponueshme për t'i hetuar e gjykuar këto raste.

Për këto ankesa problemet ju bënë të njohura Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Praktika e deritanishme tregon se shumica e ankesave të prezantuara pranë nesh kanë të bëjnë me pengesat që hasin shtetasit shqiptarë jashtë vendit por edhe në Shqipëri, nga autoritetet zyrtare të vendeve të tjera, si dhe perfaqësive të tyre diplomatike në Shqipëri, lidhur me legalizimin e dokumentave, dhenien e vizave për qëllime të ndryshme etj.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe perfaqësive të saj jashtë ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me Konventën e Vjenës për "Marredheniet Diplommatike", Ligjin "Për Sherbimin e Jashtëm" dhe akte të tjera. Megjithatë, në këndvështrimin tonë, mbështetur në detyrimin ligjor që ka Shteti Shqiptar në mbrojtje të interesave të Republikës së Shqipërisë dhe shtetasve ose personave juridike të saj, brenda kufijve të lejuar nga e drejta nderkombetare, Ministria e Punëve të Jashtme dhe perfaqësive të saj diplomatike e konsullore jashtë vendit, kanë mundësi dhe hapësira të bëjnë me shumë për t'i ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë.

Zyra e Avokatit të Popullit, nëpërmjet trajtimit të ankesave të prezantuara pranë saj, me rekomandimet dhe nderhyrjet përkatëse, ka synuar të ndikojë për një veprimtari ligjore dhe sa më efektive jo vetëm të strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri, por dhe të misioneve të saj diplomatike e konsullore që veprojnë jashtë.

## 14. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

### **A. Ankesa për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit**

Gjatë vitit 2009 ka patur 2 ankesa të veçanta për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit që kishin të bënin me zvarritje të procedurave të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor dhe vonesa në shqyrtimin e dokumentacionit të pajisjes me tokë bujqësore nga ana e Komisionit Qeveritar të Tokës. Kështu, mund të përmendim ankesën e shtetasit D.XH. i cili ankohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit Fier për mospërbushjen e detyrimit ligjor të pagimit të dëmshpërblimit për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës

Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në detyrimin ligjor filloi shqyrtimin e çështjes duke kërkuar shpjegime prej Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit Fier për arsyen e mospërbushjes së detyrimit ligjor ndaj ankuesit, dhe pas ndërhyrjes tonë dhe plotësimit të dokumentacionit shtesë ligjor nga ana e ankuesit, u bë i mundur shlyerja e detyrimit në favorin tij.

### **B. Ankesa për çështje të Ligjit “Për Tokën”**

Kryesisht problemet e konstatuara kanë të bëjnë me problemet e Komisioneve të Tokave të ngritura në nivel lokal dhe me zbatimin e Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar, përfshirë edhe kontestimet e ish pronarëve të tokave bujqësore për këtë Ligj. Janë gjithsej 28 ankesa të tilla nga të cilat 25 janë shqyrtuar dhe 3 kanë kaluar për shqyrtim të mëtejshëm në vitin 2010. Objekti i ankesave është mosdhënia e tokës fizikisht, pavarësisht se janë pajisur prej vitesh nga Komisionet e Tokave me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, për mosplotësim me tokë sipas frymëve, për mbivendosje të sipërfaqeve të tokave, konflikte kufinjsh tokash midis fshatrave dhe komunave, për mosplotësimin nga ana e komunave dhe bashkive të dokumentacionit përkatës dhe përcjelljen e tyre në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në rreth për regjistrimin fillestar, kundërshtimin e Ligjit dhe kërkesa për ndërhyrje legjislative për anullimin e tij në zona të veçanta të vendit, si në Bregdet. Një pjesë e mirë e ankesave janë të mbartura në vite për shkaqe nga më të ndryshmet, ku në mënyrë të veçante ka spikatur puna e dobët e ish komisioneve të tokave në tërë hierarkinë e tyre, si dhe mos funksionimi i tyre për arsye subjektive në intervale kohe të gjata në fshatra dhe njësi të ndryshme të pushtetit vendor.

Nga ankesat e shqyrtuara , 7 janë zgjidhur në favor të ankuesve duke dhënë kështu një kontribut në zgjidhjen e problemeve që ato kishin prej vitesh me organet e administratës publike të ngarkuara me ligj për kryerjen e funksioneve. Kështu mund të përmendim ankesën e shtetasit Xh. D. i cili shprehte pretendimin e tij ndaj Komunës Kashar për

mospërcjelljen e dokumentacionit tekniko-ligjor për konfirmim pranë Këshillit të Qarkut, dhe pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit u bë i mundur përcjellja e dokumentacionit tekniko-ligjor të personave të interesuar në drejtim të S.A.M.T. në Qark.

Ndërkohë që pjesa tjetër e ankesave kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave të institucionit të Avokatit të Popullit dhe ankuesit janë orientuar për rrugën ligjore që ato duhet të ndiqnin për përmbushjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Kjo për shkak të mos pasjes dijeni nga ankuesit të hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9948, dt. 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i cili jo vetëm i dha fund procesit të ndarjes dhe rindarjes së tokës bujqësore, si dhe krijimit të titujve të pronësisë mbi të, por edhe ngriti struktura të reja, Komisionin Qeveritar të Tokës dhe Komisionet Vendore pranë prefektit të çdo qarku, nën autoritetin dhe varësinë e drejtpërdrejtë nga ky i fundit. Ligji ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve Vendore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të evidentuara për kufijtë e tokës bujqësore ndërmjet fshatrave dhe rretheve brenda qarkut, midis individëve dhe ish komisioneve të tokave në fshat, konfliktet midis personave fizike dhe juridike, mosmarrëveshjet ndërmjet palëve kur është vendosur gjyqësisht zgjidhja e tyre në rrugë administrative, zëniet dhe pushtimet e tokës dhe për verifikimin e bazueshmërisë së titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore. Mbi këtë bazë të re legjislacioni, subjekteve ankues të këtyre natyrave ju është sugjeruar të aplikojnë me kërkesa individuale pranë komisioneve vendore. 12 ankesat e tjera, kanë qenë për juridiksionin gjyqësor.

Gjithsesi Avokati i Popullit ka konstatuar se ky ligj cënon parime kushtetuese si parimin e sigurisë juridike, si edhe dispozita të veçanta të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke parashtruar para Gjykatës Kushtetuese kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të Ligjit nr.9948, dt.07.07.2008, “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore.”, si dhe te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.1269, dt.17.09.2008 “Per perberjen, menyren e funksionimit dhe detyrat e pergjegjesite e strkturave shteterore te ngarkuara per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”, dhe tashmë jemi në pritje të vendimit të Gjykatës pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor nga ana e saj.

## 15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Përpjekjet e Avokatit të Popullit lidhur me problemet e mjedisit për vitin 2009 janë konsideruar nga Institucioni ynë si mjaft prioritare për vetë rëndësinë që ato paraqesin për cilësinë e jetës dhe shëndetit të shtetasve. Objektivi kryesor i punës tonë në këtë drejtim ka qenë përmbushja e standarteve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe zbatimi korrekt i legjislacionit në fushën e mjedisit. Këto përpjekje të Avokatit të Popullit janë bashkërenduar shpesh herë me iniciativat e organizatave jo-fitimprurëse që punojnë për çështjet mjedisore, prej të cilave kemi marrë periodikisht të dhëna për gjendjen dhe problematikat e mjedisit në vend.

Kështu, gjatë vitit 2009 janë trajtuar 5 ankesa për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave kryesisht për ndotjen e mjedisit. Nga këto, 2 ankesa kanë qenë jashtë kompetencave dhe juridiksionit, 1 ankesë është zgjidhur në favor të ankuesit dhe 2 ankesa janë ende në proces shqyrtimi. Nga viti 2008 janë mbartur gjithsej 4 ankesa nga të cilat, 1 ka qenë jashtë kompetencave, 1 është zgjidhur në favor të ankuesit, 1 me rekomandim të pranuar dhe 1 me rekomandim të refuzuar.

Në vijim po trajtojmë shkurtimisht çështjet e zgjidhura pozitivisht për këtë fushë:

1. Ankesa e qytetarit A. B., me banim në fshatin Qerek-Krujë, i cili ankohej për ndotje të mjedisit nga hedhja e mbeturinave urbane në territorin e fshatit nga një firmë e kontaktuar nga Bashkia Kamëz.

Ankuesi në emër të të gjithë banorëve të këtij komuniteti pretendonte se firma private e kontraktuar nga ana e Bashkisë Kamëz, duke depozituar mbeturina në afërsi të fshatit, kishte shkaktuar probleme serioze për shëndetin e banorëve dhe sidomos femijëve në fshat.

Zyra jonë, në analizë të fakteve të parashtruara nga të dy palët, argumentoi me rekomandim dërguar Inspektoriatit të Mjedisit, edhe Bashkisë Kamëz, se meqenëse vendi i depozitimit të mbeturinave ishte i miratuar me vendim të KRRT-se Bashkisë Kamëz, kjo nuk do të thoshte që mbetjet e hedhura nuk kishin pasoja negative mbi shëndetin dhe mjedisin e banorëve të zonës.

Nga ana tjetër nuk rezultonte të kishte ndonjë raport kontrolli lidhur me verifikimin e situatës në vend nga autoritetet përgjegjëse. Për sa më sipër rekomanduam ushtrimin e kontrolleve nga Inspektoriati i Mjedisit, organi që kishte liçensuar veprimtarinë, Inspektoriati Sanitar Shtetëror dhe Inspektoriati Bashkiak ndaj veprimtarisë së zotëruesve të mbetjeve urbane, lidhur me depozitimin e mbeturinave të Bashkisë



Kamëz, në Argjinaturën e lumit Tërkuzë, për shkak të rrezikimit të shëndetit të komunitetit në këtë vend nga ndotja e mjedisit.

Në përgjigje të rekomandimit tonë Inspektoriati Sanitar Shtetëror, i cili pranoi sugjerimet e mësipërme na informoi ndër te tjera se: Në bazë të kërkesës tonë, inspektorët e Inspektoriatit Sanitar Shtetëror së bashku me përfaqësuesit e Bashkisë Kamëz, kanë ushtruar kontroll në vend-depozitimimin e mbeturinave urbane pranë "Argjinaturës së lumit Tërkuzë", dhe eliminimin e të metave janë lënë për zbatim detyrat:

- Të evitohet hedhja e mbeturinave pranë rrjedhës së lumit;
  - Të fillojë sistemimi i fushë-grumbullimit të mbeturinave me rrugë, kanale etj;
  - Të bëhet grumbullimi me dhé, dhe përgje të mbeturinave;
- Të ndalohet djegia e mbeturinave dhe të vendosen tabela për ndalimin".

2. Ankesa e shtetasit M.O në të cilën ankohej ndaj një firme që zhvillon aktivitet privat, në nxjerrjen e gurëve pranë shtëpisë së tij. Konkretisht, në ankesë ai pretendonte se ushtrimi i këtij aktiviteti kaq pranë banesës së tij, ka shkaktuar ndotje të konsiderueshme të ambjentit si dhe kapaciteti i madh në nxjerrjen e sasive të gurëve mund të shkaktojë shëmbjen e shtëpive duke rrezikuar jetën e gjithë familjarëve të tij dhe të banorëve përreth kësaj zone.

Institucionit i Avokatit të Popullit pasi shqyrtoi këtë ankesë kërkoi një informacion pranë M.M.P.A.U lidhur me verifikimin në vend të këtij problemi si dhe masat që do të ndërmerreshin për zgjidhjen e kësaj ankese.

Në përgjigje të shkresës tonë nga specialistë të kësaj ministrie u vumë në dijeni se pas verifikimit të kryer, është kërkuar nga subjekti "Besiona" sh.p.k të ndryshojë pasaportën e shpim plasjes, e cila do të minimizonte valën goditëse të shkaktuar nga shpërthimet për nxjerrjen e gurit gëlqeror. Për sa i përket pluhurit që shkaktohet nga shpërthimi dhe aktiviteti i subjektit, pas detyrave të lëna nga Agjensia Rajonale e Mjedisit, firma ka instaluar përgjatë linjës së prodhimit, tubacione të ujit teknologjik me qëllim minimizimin e shkarkimeve të pluhurave të mjedisit.

Lidhur nga ankesat që paraqiten pranë Institucionit të Avokatit të Popullit një sfidë e rëndësishme në kuadër të çështjeve mjedisore ashtu sikundër është parashikuar edhe në Progres Raportin e Bashkimit Europian të vitit 2009 për Shqipërinë, do të bëhen përpjekje për forcimin e kapaciteteve administrative të të gjitha institucioneve të përfshira në hartimin e politikave mjedisore dhe për zbatimin e Strategjisë ndërsektoriale për Mjedisin dhe do të kërkohen më shumë kapacitete monitorimi dhe inspektimi në nivel rajonal në zbatim të legjislacionit, dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9774 dt.12.07.2007, "*Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis*".

Nga ana jonë do të vijohet të kihet një interesim i veçantë që ky ligj të gjejë zbatim në shumë problematika komunitare urbane, pasi ai përmban një volum të madh kompetencash që e bëjnë shumë efektive veprimtarinë mbrojtëse mjedisore.

Përveç këtyre objektivave, Avokati i Popullit do të ketë në qendër të vëmendjes edhe çështje të tjera që do t'i ndjekë me iniciativë atëherë kur ai do të vërejë se ka çënime flagrante nga ndotje të ndryshme në dëm të interesave të individëve.

## 16. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2009 kanë ardhur gjithsej 7 ankesa, të cilat janë të përfunduara. Rezulton se 5 kanë qenë jashtë kompetence dhe 2 janë zgjidhur në favor të ankuesve.

Problematika e ankesave që kanë patur të bëjnë me këtë Ministri ka qenë kryesisht shkelja e së drejtës së informimit, si dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve nëpër institucionet në varësi të këtij organi qëndror.

1. Nga ankesat përmendim një ankesë të ligjshme që paraqiti shtetasi A.Z, banues në Tiranë ndaj Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për mosdhënie informacioni ndaj një kërkesë që ai kishte paraqitur.

Konkretisht, ai pretendonte një informacion pas verifikimit të gjëndjes së shtëpisë së tij të përcaktuar si monument Kulture e Kategorisë së I-rë, por në gjëndje tepër të shkatërruar. Megjithë kërkesat e tij të përsëritura, nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, ende nuk ishte marrë asnjë masë për rregullimin e saj.

Avokati i Popullit pasi ju drejtua Drejtorisë së Trashëgimisë Kombëtare, u vu në dijeni nga kjo e fundit se brenda mundësive financiare të këtij viti buxhetor do të kryhen vetëm ndërhyrjet emergjente, si dhe nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës do të përfundojë hartimi i një projekti restaurimi për vitin 2010. Në këtë mënyrë ankuesi realizoi të drejtën e tij të informimit.

2. Në ankesën e shtetasit A.D, banues në Tiranë pretendohej se nga inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit pranë Ministrisë së Turizimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, i është kryer një kontroll gjatë muajit Janar 2008 dhe është gjobitur me shumën 100.000 lekë për shkelje të të drejtës autorit.

Ankuesi parashtroi se duhet të ishte njoftuar paraprakisht për kontrollin e kryer nga ZSHDA-ja, dhe në këtë kuptim e konsideronte të padrejtë masën e sanksionit që i ishte vënë veprimtarisë në dyqanin që dispononte. Ndaj kërkoi ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, pranë ZSHDA-

së lidhur me anulimin e gjobës, për arsye të mosinformimit paraprak të kontrollit të kryer.

Në përgjigjen që i kthyer ankuesit, e sqaruam se:

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.232, date 19.04.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”, nuk përcaktohet në ndonjë nen apo paragraf, detyrimi i kësaj Zyre për lajmërimet paraprake në rast kontrolli dhe evidentimi të të drejtave të shkelura të autorit.

Ajo që përcaktohet ligjërisht janë nenet 130-131 të Ligjit nr. 9380, date 28.04.2008 “Për të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, në bazë të të cilave: “Ndaj dënimit me gjobë për kundravajtje administrative, të parashikuar në këtë ligj, bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të gjobës...Ankimi shqyrtohet nga titullari i njësisë përkatëse të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, që ka vendosur masën ndëshkimore, në të kundërt kjo masë vlerësohet e pranuar....”.

Prandaj ankuesi u sqarua se zgjidhjen direkte të kundërshtimit të sanksionit të vënë nga kjo zyrë, do ta gjente vetëm nëpërmjet rrugës ligjore të përcaktuar, që ishte ajo e ankimit administrativ pranë këtij organi.

3. Në ankesën e shtetasës S.L pretendohet për veprime të padrejta të kryera nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve gjatë një konkursi të zhvilluar në këtë Institucion për një vend vakant në cilësinë e specialistit të protokollit në Zyrën e Arkivës.

Kjo pasi pretendohet që ankuesja nuk ishte thirrur për intervistën me gojë, pas provimit me shkrim. Emri i kandidatës fituese, për më tepër figuronte si pjesë e organikës në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Ministrisë, para dhe direkt pas konkursit të zhvilluar, pa pritur për afatet e ankimit, gjë që ka thelluar dyshimet e ankueses për veprime abuzive dhe të padrejta në zhvillimin e konkursit.

Zyra e Avokatit të Popullit kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm në MTKRS-e, verifikimin e rastit konkret, si dhe sqarimin nëse kandidatja fituese ka qenë pjesë përbërëse e organikës në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve përpara konkursit të zhvilluar.

Nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve jemi informuar se përsa i përket intervistës me gojë, ankuesja ishte njoftuar në rrugë telefonike, por nuk ishte paraqitur personalisht për dhënien e kësaj interviste. Ndërkohë që kandidatja fituese ka qenë pjesë përbërëse e kësaj Ministrie, si punonjëse e kontraktuar, deri në zhvillimin e një konkursi, pasi procedurat e këtij të fundit kërkonin një kohë të konsiderueshme.

Ajo ka marrë emërimin e saj, në bazë të Ligjit “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, sipas shkresës së ardhur nga DAP, pas 30 ditësh.

Pra nga ana e MTKRS-së është hedhur poshtë pretendimi i ankueses, pasi ajo nuk kishte konsumuar procedurën e plotë të konkurrimit në fjalë dhe rrugën e ankimimit.

## 17. Ankesa për Administratën e Shërbimeve Sekrete

Gjatë vitit 2009, në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur 3 ankesa kundër veprimeve apo mosveprimeve të Shërbimeve Sekrete, nga punonjës të këtyre shërbimeve për largime nga puna, mosdhënie shpërblimi apo për pengesa në marrje dokumenti.

Për shkak të natyrës së këtyre shërbimeve, ankesat dhe kërkesat janë parë me përparësi dhe kujdes të posaçëm, duke i verifikuar dhe kërkuar përgjigje nga administratat e shërbimeve sekrete. Si rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe verifikimit të tyre, ka rezultuar se dy nga këto ankesa kanë qënë të pabazuara, sepse largimet nga detyra janë bërë për shkak të reformimit, ndërsa shpërblimi nuk është dhënë për moskryerje të detyrave, kurse një ankesë është zgjidhur në favor.

Si bazë ligjore për largimin nga puna si punonjës i Shërbimit Informativ Shtetëror është përdorur pika “d” e nenit 45 të ligjit 9347 datë 17.3.2005 “Për Statusin e Punonjësit të Shërbimit Informativ Shtetëror”, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e shërbimeve sekrete.

Ndër ankesat e ardhura po përmëndim ankesën e shtetases F.K. nga Tirana, e cila pretendonte se ishte larguar nga detyra pa të drejtë nga Shërbimi Informativ Shtetëror, duke mos i dhënë asnjë motivacion sipas ligjit.

Pas verifikimit zyrtar u vërtetua, se ankuesja kishte bërë kërkesë vetë për t’u larguar dhe në kuadër të ristrukturimit organik të këtij shërbimi vëndi punës së saj ishte suprimuar dhe si rezultat ankesa e kësaj shtetase u konsiderua e pabazuar.

Po kështu mund të përmëndim ankesën e shtetasit S.M. nga Tirana, i cili pretendonte se e pengonte policia duke mos i dhënë licencën për polici private, për shkak të shoqërimit që i ishte bërë në polici shumë vite më parë, sepse kishte miqësi me një shtetase të huaj.

Pas verifikimeve zyrtare nga Shërbimi i Kontrollit të Brëndshëm u vërtetua, se ndaj ankuesit nuk kishte asnjë dokument shoqërimi apo precedent penal dhe si rezultat ankesa e këtij shtetasi u zgjidh në favor.

Mund të themi se bashkëpunimi institucional me Shërbimin Informativ Shtetëror dhe Shërbimin e Kontrollit të Brëndshëm ka qënë dhe vazhdon të mbetet korrekt, sepse administrata e tyre i dërgon gjithmonë shpjegimet e duhura zyrës tonë brënda afateve ligjore.

## 18. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të Drejtave të Fëmijëve

Duke e gjykuar si mjaft të rëndësishme punën për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, vijojmë t'i kushtojmë një nëndarje të veçantë në raportin e punës vjetore, megjithëse nuk funksionon më për mungesë fondesh buxhetore Nënseksioni përkatës.

Veprimtaria për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ka vijuar si me anë të trajtimit të ankesave individuale, ashtu dhe të hetimit me iniciativë të rasteve të bëra publike si dhe të shqyrtimit të legjislacionit dhe dhënies së rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime të nevojshme.

Gjatë këtij viti janë trajtuar 94 raste ankesash, kërkesash apo çeshtje të filluara me iniciativën tonë që kanë patur objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Disa prej ankesave, kërkesave apo dhe rasteve të shqyrtuara me iniciativë preknin të drejtat e një numri të konsiderueshëm fëmijësh.

Është punuar për një ambjent më përgjegjës mbi politikën si dhe për ndërhyrje të qëndrueshme të Qeverisë për të drejtat e fëmijëve.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse si dhe institucionet e tjera shtetërore, me synimin e nxitjes së promovimit e të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, edhe gjatë këtij viti kemi marrë pjesë në mjaft aktivitete, workshope dhe konferenca.

Disa nga veprimtaritë konkrete të zhvilluara po i përmbledhim si më poshtë:

1- Është raportuar si çdo vit pranë Sekretariatit Kombëtar Teknik për Fëmijët (SKTF) mbi masat e marra për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët.

Në vijimësi të angazhimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit, detyrat e Institucionit tonë kanë qenë të përcaktuara në Objektivin 1 të Planit të Veprimit të Strategjisë: "Ngritja e strukturave institucionale, sigurimi i burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve". Konkretisht u përgatit ashtu si çdo vit, informacioni mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit për periudhën Qershor 2008-Maj 2009 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në këtë informacion janë dhënë aktivitetet kryesore të ndërmarra nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, është përpjekur që të përmbushë detyrimet që dalin nga objektivi i caktuar dhe është munduar që të jetë gjithnjë i përfshirë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

2-Rëndësinë e krijimit të një Komisioneri të veçantë për të drejtat e Fëmijëve e kemi shprehur dhe në mendimet që i kemi dërguar Drejtorisë

së Monitorimit të Strategjive Ndërsektoriale prane Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në Prill 2009 lidhur me projektligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në Shqipëri.

3-Po kështu është përgatitur e dërguar në Sektorin e të Drejtave të Njeriut, Minoriteteve dhe Raportimeve pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme pjesa përkatëse e punës sonë për hartimin e Raportit të dytë periodik Kombëtar lidhur me zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të Drejtat e Fëmijës”.

4-Kemi plotësuar pjesën e pyetësorit dhe ia kemi dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke kontribuar për hartimin e Raportit Kombëtar lidhur me Protokollin fakultativ mbi të Drejtat e Fëmijëve “Për shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve”.

5-Me 19-20 Maj 2009, Avokati i Popullit dhe Komisioneri i Seksionit të Përgjithshëm morën pjesë në Konferencën Vjetore të Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore. Tema e kësaj Konference ishte “Fëmijët dhe Divorcet problematike-Aksesi i Fëmijëve në Drejtësinë Kombëtare, Ndërkombëtare dhe Evropiane”.

6-Me 20 Maj 2009, Avokati i Popullit nënshkroi Memorandumin e Bashkëpunimit të Rrjetit të Ombudsmanëve të Fëmijëve të Evropës Juglindore (CRONSEE). Ky aktivitet u organizua në Dubrovnik, Kroaci dhe synonte përcaktimin e parimeve të bashkëpunimit të ndërsjellë të këtyre institucioneve. CRONSEE është një rrjet i institucioneve të pavarura në mbështetje të të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar, rajonal e lokal dhe është krijuar në vitin 2006. Qëllimi i tij kryesor është bashkëpunimi dhe fuqizimi i punës së zyrave të ombudsmanëve për fëmijët të vendeve të Evropës Juglindore, si dhe promovimi dhe shkëmbimi i praktikave të tyre më të mira.

7-Me rastin e 20 vjetorit të miratimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijës”, me 10 Nëntor 2009 Avokati i Popullit ishte palë nënshkruese në Deklaratën e përbashkët të Rrjetit të Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve të Evropës Juglindore. Në këtë Deklaratë ndër të tjera theksohet se: “Investimet për fëmijët prodhojnë efekte afatgjata. Ato përbëjnë investim për të ardhmen, që do të thotë se ne kemi detyrimin për t’i kushtuar fëmijëve vëmendjen më të madhe, dashurinë, kujdesin dhe ndihmën efektive derisa të rriten. Ndaj, ne i bëjmë thirrje shteteve të Evropës Juglindore, në përputhje me Konventën e të Drejtave të Fëmijës, që të plotësojnë detyrimet që kanë marrë përsipër me ratifikimin e Konventës, dhe që të sigurojnë për të gjithë fëmijët:

-Kujdes dhe mbrojtje siç parashikohet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

-Përfitimin e standarteve më të larta të shëndetit dhe aksesin në shërbimet e kujdesit shëndetësor.

-E drejta për arsimim falas dhe të mundësueshëm për të gjithë fëmijët .

-Asistencë e veçantë për prindërit dhe kujdestarët ligjorë në ushtrimin e përgjegjësive të tyre për mirërritjen e fëmijëve, duke përfshirë në raste të nevojshme dhe masat për asistencë sociale.

Ne i bëjmë thirrje qeverive që të mos lejojnë që varfëria të shkaktojë përjashtimin shoqëror të fëmijëve, veçanërisht atyre më vulnerabël, si fëmijët e varfër, fëmijët me vështirësi në zhvillim, fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijët që i përkasin grupeve të minoriteteve.

Ne i ftojmë të gjitha institucionet, individët dhe grupet, që të bashkohen me ne në punën për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dhe gjithmonë të veprojnë dhe të marrin vendimet në interesin më të mirë të fëmijëve”.

8- Ndhmëskomisionerja e Avokatit të Popullit ka mbajtur Referatin “Situata e respektimit të të drejtave të fëmijëve, prezantuar nga Zyra e Avokatit të Popullit” në lancimin e librit “Eliminimi i Ndëshkimit Trupor. Një detyrim i të drejtave të njeriut për fëmijët e Evropës” organizuar në Maj 2009 nga Këshilli i Evropës dhe Qendra “Fëmijet Sot”.

9- Në Mars 2009 ndhmëskomisionerja e Avokatit të Popullit referoi temën “Avokati i Popullit si një mekanizëm në mbrojtje të fëmijëve në Shqipëri”, në workshopin “Rëndësia e bashkëpunimit ndërsektorial në mbrojtje të fëmijëve” e organizuar nga CRCA-Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.

10-Në kuadrin e sensibilizimit të opinionit publik për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Komisioneri i Sekionit të Përgjithshëm dhe ndhmëskomisioneri që mbulon çështjet e të drejtave të fëmijëve, kanë marrë pjesë në disa emisione televizive në mediat kombëtare.

### **Inspektimet**

Janë kryer inspektime në të gjitha Shtëpitë e Fëmijës në të gjithë Shqipërinë, si dhe Qendrat e Zhvillimit, lidhur me monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve. Ndaj për disa prej tyre janë dërguar rekomandimet përkatëse drejtuar Shërbimit Social Shtetëror dhe Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Po përmendim tre prej tyre:

*Së pari*, Inspektimi në Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Vlorë, ku trajtohen fëmijët jetimë socialë me vetëm një prind dhe fëmijët jetimë biologjikë të moshës foshnjore deri 6 vjeç. Gjatë inspektimit të Avokatit të Popullit u konstatuan problemet si vijon:

-Në të tërë godinën ishin bërë rikonstruksione të pjesshme gjatë periudhave të ndryshme, por në tërësinë e saj kjo ishte një godine e vjetër dhe e amortizuar. Rikonstruksioni total i saj nuk ishte bërë që prej 15 vjetësh dhe në pamje të jashtme ajo linte shumë për të dëshiruar. Bashkia

e qytetit kishte bërë ndërhyrje si ne tualete, hidroizolim tarrace dhe riparime të tjera të pjesshme, por godina në tërësi ishte shumë e amortizuar dhe me lagështirë në korridoret e katit të tretë.

-Kuota ushqimore ishte 240 lekë në ditë për çdo fëmijë. Kjo kuotë ishte e pamjaftueshme, duke pasur parasysh rritjen e përditshme të çmimeve në treg.

Avokati i Popullit rekomandoi për zbatim masat e mëposhtme:

Marrjen e masave për rikonstruksionin e tërë godinës ku strehohen fëmijë nga 0 deri në 6 vjeç duke evituar lagështirën.

Shtimin e kuotës ushqimore, kjo referuar rritjes së çmimeve të tregut, e domosdoshme kjo për sigurimin normal të ushqyerjes së këtyre fëmijëve.

*Së dyti*, Inspektimi në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” Tiranë, një institucion rezidencial i përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë të grupmoshës 6-15 vjeç. Gjatë inspektimit të Avokatit të Popullit u konstatuan këto mangësi:

-Problem shqetësues mbetej lagështira nëpër mure në të gjitha katet e godinës, por e theksuar më shumë në muret e katit përdhe, e cila shërbente prej vitesh si menci dhe ngjitur me të ishte guzhina. Në këtë institucion ishin bërë vetëm investime të pjesshme vit pas viti, por asnjëherë tërësore në të gjithë godinën.

-Një problem tjetër ishin edhe banjat në të tre katet, të cilat ishin me lagështirë të madhe dhe të amortizuara. Edhe dyert e kateve ishin problematike, të rrënuara, pa doreza dhe në shumë dhoma jo të rregullta.

-Mungesa në organikë e një mirëmbajtësi për godinën kishte sjellë mangësi të theksuara të nevojave për riparime të ndryshme, aq të nevojshme dhe të domosdoshme për rregullimin e defekteve të ndryshme dhe të shumëllojshme, gjë që aktualisht bëhej nga punonjësit amatorë në këtë profesion.

Avokati i Popullit nisur nga kjo situatë rekomandoi:

-Marrjen e masave për rikonstruksionin e plotë të godinës së Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë, për evitim të lagështirës së madhe e shtrirë kjo në të gjithë ambjentet e saj.

-Shtimin në organikë, të një mirëmbajtësi ose ndryshimin e saj brenda numrit ekzistues për t’u kujdesur për përmirësimin dhe mbajtjen në punë të pajisjeve të domosdoshme për Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” Tiranë.

*Së treti*, inspektimi në Qendrën e Zhvillimit Vlorë. Në këtë qendër trajtohen fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuar, të kategorizuar në forma të lehta, të rënda apo me sindromin “dawn”, të moshës 6-25 vjeç. Gjatë inspektimit vërejtëm se në tërësinë e tyre kushtet e ofruara për personat e strehuar ishin të kënaqshme, por u konstatuan dhe disa mangësi.



-Problem shqetësues mbetej lagështira e madhe në katin e parë pasi kjo godinë është ndërtuar që në vitet 1950 dhe asnjëherë nuk është bërë drenazhimi i këtij kati.

-Kuota ushqimore prej 207 lekësh në ditë ishte e pamjaftueshme, pasi këta lloj fëmijësh instiktin e të ngrënit e kanë më të madh se fëmijët e zakonshëm. Kjo edhe për shkak të rritjes së çmimeve në treg që nga koha e miratimit të kësaj kuote.

-U paraqit pretendimi i shtesës në organikë të mësuesve, pasi kjo kategori fëmijësh nuk përballohet vetëm me kujdestarët, të cilët shumicën e kohës e kalojnë duke i shërbyer atyre në larje, ushqyerje, ndërrim, veshmbathje, pasi shumica nuk i kryejnë vetë këto nevoja. Gjithashtu kjo qendër nuk kishte në organikë një mirëmbajtës dhe prandaj për riparimin e defekteve të ndryshme angazhoheshin vetë stafi i qendrës.

-Një problem tjetër social, që kërkon vëmendjen e të gjithë strukturave shtetërore, është edhe transferimi i këtyre fëmijëve kur kalojnë moshën e përcaktuar të qëndrimit në këtë qendër. Sipas drejtueses, shteti nuk disponon qendra të veçanta për këtë kategori kur ata kalojnë në moshë madhore, dhe si rezultat ata bashkëjetojnë në një ambjent me fëmijë të vegjël.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme në këto institucione duhet të jetë prioritet i veçantë, pasi kjo kategori duhet të trajtohet si pjesë e shoqërisë sonë me të drejta të barabarta, pavarësisht gjendjes së tyre të rëndë shëndetësore. Në rekomandimin që u prezantua për këtë Qendër pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Social Shtetëror u ngritën per zgjidhje çështjet si më poshtë:

-Shtimi në organikë i mësuesve për mbarëvajtjen e punës mësimore dhe edukative të tyre, si dhe të një mirëmbajtësi për këtë godinë.

-Gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë për drenazhimin e katit të poshtëm, me qëllim evitimin e lagështirës së madhe në mure.

-Marrjen parasysh të kërkesës për rritjen e normës ushqimore për këtë kategori fëmijësh, e nevojshme si rezultat i rritjes së çmimeve.

-Gjetjen e mundësive për krijimin e qendrave të reja, me qëllim transferimin e fëmijëve kur arrijnë moshën e tyre madhore. Kjo për të evituar qëndrimet e tyre të përbashkëta me fëmijë më të vegjël.

Në përfundim të këtyre inspektimeve për të gjitha konstatimet dhe rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit për vitin 2009, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka shprehur angazhimin për realizimin e tyre në vitin në vazhdim, pasi shumë prej këtyre rekomandimeve kanë të bëjnë me planifikime fondesh buxhetore, hartime strategjish dhe sigurisht, vullnet dhe bashkëpunim me strukturat e pushtetit vendor. Në përgjigjet e dërguara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Social

Shtetëror, për secilin nga rekomandimet theksohet se janë ngritur grupe pune, të cilat do të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për realizimin rast pas rasti të detyrave të lëna nga ana e Avokatit të Popullit me synimin e përmirësimit të shërbimeve sociale, në përputhje me standartet e çdo kategorie të strehuarish në këto institucione.

Po kështu në Inspektimet e kryera për këtë vit në shumë nga Komisaritet e Policisë, në Dhomat e Shoqërimit dhe të Sigurimit të Shtetasve kemi rekomanduar marrjen e masave urgjente për rikonstruksionin e ambjenteve të dhomave të shoqërimit, si dhe ndarjen e tyre për persona të mitur dhe femra në Komisariate, sipas konceptimit të bërë në Ligjin nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

### **Raste me iniciativë, me rekomandime për ndryshime ligjore**

1-Në Shkurt 2009 i kemi drejtuar Ministrit të Drejtësisë si dhe *Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta* Rekomandimin mbi marrjen e iniciativës për ndryshimin e nenit 352 të Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Kjo nisur nga studimi i legjislacionit dhe qëllimi i harmonizimit sa më të mirë të tij në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.

Pjesëmarrja e fëmijës në procesin e caktimit të kujdestarisë, gjën rregullimet përkatëse në Kodin e Procedurës Civile si dhe në Kodin e Familjes. Kjo e drejtë në Kodin e Familjes u njihet fëmijëve që kanë mbushur moshën 14 vjeç (neni 264, pika c) në një kohë që Kodi i Procedurës Civile cakton si moshë minimale për të kërkuar vendosjen e kujdestarisë moshën 16 vjeç.

Patjetër që kjo mospërputhje e moshës përbën një problem në zbatimin e legjislacionit në gjykatë, lidhur me dispozitën që duhet të merret parasysh në rastin e paraqitjes së kërkesave drejtpërdrejt nga të miturit.

Duke marrë në konsideratë faktin që Kodi i Familjes është miratuar më vonë në kohë, konkluduar që interesi më i lartë i fëmijes do të garantohej duke pasur të sanksionuar këtë të drejtë në moshën më të vogël të tij (pra 14 vjeç). Kjo jo vetëm nisur nga fryma e parimeve të Konventës së OKB “Per të Drejtat e Fëmijës”, por dhe nga parimi që ligji më i ri ka prioritet përkundrejt të vjetrit.

Prandaj për të shmangur interpretimet dhe zbatimin e gabuar në gjykatë të këtyre dy dispozitave dhe për harmonizimin e unifikimin e praktikës gjyqësore, është e nevojshme që në çështjet që kanë të bëjnë me vendosjen e kujdestarisë së të miturve me kërkesën e tyre në Gjykatë, ata të mund ta ushtrojnë këtë të drejtë kur të kenë mbushur moshën 14 vjeç. Ndaj rekomanduar:

-Që të ndërmerret inisiativa legislative për një ndryshim ne Ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe konkretisht:

-Të ndryshohet neni 352 i tij me këtë përmbajtje: *“I mituri qe ka mbushur moshën 14 vjeç mund të ushtrojë vetë të drejtën që t’i drejtohet gjykatës për vendosjen e kujdestarisë. Këtë të drejtë e ka edhe Avokati i Popullit”*.

-Në përgjigjen që kemi marrë nga Ministri i Drejtësisë theksohet se rekomandimi do të mbahet në konsideratë për t’u përfshirë në iniciativat ligjore të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2009. Ndërsa pjesa e dytë e rekomandimit ka marrë përgjigje negative.

-Po kështu nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta kemi marrë përgjigjen ku shprehet gadishmëria për të bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë, si institucion përgjegjës për ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore, për të vlerësuar këtë rekomandim dhe më tej të bashkëpunojë për hartimin e përmirësimeve ligjore.

2. Rekomandimi drejtuar Ministrin të Arsimit dhe Shkencës për marrjen e iniciativës për disa plotësime në Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe në Dispozitat Normative për Arsimin, për garantimin sa më të plotë të të drejtave të fëmijëve.

Pasi i përmblodhëm disa probleme të konstatuara në përmbajtjen e Ligjit nr. 7952, date 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar, si dhe të Dispozitave Normative në Arsim, në mënyrë të përmbledhur i rekomanduam Ministrin të Arsimit dhe Shkencës:

-Të hartohen përmirësimet e nevojshme në Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995 “Per sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar, dhe në Dispozitat Normative për Arsimin, në lidhje me parashikimin e klauzolave për pranimin dhe integrimin në shkollë të fëmijëve viktimat të shfrytëzimit, abuzimit, dhunës, si masë për riaftësimin e tyre fizik, psikologjik dhe shoqëror.

-Të merren masa për zbatimin e parashikimeve në Ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar, dhe Dispozitat Normative për Arsimin, në lidhje me garantimin në praktikë të veprimtarive kulturore, argëtuese e sportive për fëmijët.

-Të rriten parashikimet buxhetore të destinuara për arsim, me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe të kushteve nëpër shkolla.

-Të përmirësohen procedurat e shqyrtimit të ankesave brenda shkollës në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative, duke garantuar të drejtën e dëgjimit të fëmijëve gjatë shqyrtimit të një ankese/kërkese nga strukturat vendimmarrëse.

-Të nxitet marrja e mendimit të fëmijëve në institucionet shkollore, si individualisht ashtu edhe nëpërmjet qeverisë së nxënësve, nëpërmjet

masave proaktive të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoritë Arsimore dhe ato të Shkollave.

-Të mundësohet realizimi i vendosjes së kutive të ankesave nëpër shkolla si një masë dhe standart që është i nevojshëm në realizim të të drejtave të parashikuara në nenin 12 të Konventës së të Drejtave të Fëmijës.

-Të parashikohet në Dispozitat Normative si detyrim për të gjitha shkollat e arsimit publik parauniversitar ngritja e organizmit të Qeverisë së Nxënësve brenda shkollës.

-Të mos kushtëzohet rrethi i të drejtave që u garantohen nxënësve individualisht në shkolla me ekzistencën apo jo të Qeverive të Nxënësve.

3- Lidhur me Rekomandimin që i kemi drejtuar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për nxjerrjen e një Urdhri në mënyrë që Drejtoritë Arsimore të ndalojnë përdorimin e shkollave dhe pjesëmarrjen e nxënësve dhe të mësuesve të shkollave në mitingjet elektorale të partive politike gjatë orarit të mësimi, kemi marrë përgjigjen negative.

4- Rekomandimi drejtuar Ministrit të Drejtësisë për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, në favor të fëmijëve, edhe në kuadrin e Reformës në drejtësi, është pranuar pjesërisht.

Drejtësia penale për të miturit përbëhet nga një sërë organesh, efektshmëria e të cilave bën që të respektohen interesat e të miturit gjatë një procesi penal dhe gjatë zbatimit të vendimit të gjykatës. Në bazë të këtyre akteve të miturit përfitojnë masa favorizuese përsa i përket gjyqimit dhe zbatimit të vendimit penal, por mbetet problematik hartimi i një kuadri ligjor të posaçem penal për të miturit.

Edhe në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale nuk ka gjetur pasqyrim parimi i interesit më të lartë i të miturit si një koncept udhëheqës i trajtimit të subjektit të mitur nga ligji penal dhe si element i rëndësishëm i procedimit penal, i cili do t'i siguronte të miturit, qënien subjekt i mbrojtjes së posaçme, parashikuar si e tillë në Kushtetutë. I mituri, në legjislacionin material dhe procedural, trajtohet në të dy pozicionet, si subjekt i veprës penale dhe si i dëmtuar nga vepra penale.

Në mënyrë të përmbledhur lidhur me rekomandimin konkret për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, në përgjigjen që kemi marrë nga Ministria e Drejtësisë, ndër të tjera konkludohet se mungesa e një ligji të veçantë penal dhe procedural penal për të miturit, nuk çënon respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tij, të njohura nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Ndaj krijimi i një kuadri të veçantë ligjor për të miturit në konflikt me drejtësinë konsiderohet i panevojshëm, përsa kohë i mituri është subjekt i një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

Përsa i përket faktit se parashikimet e bëra në Kodin Penal nuk mbajnë parasysh që subjekt pasiv i veprës penale, mund të jetë i mituri dhe se vepra penale mund t'i ketë shkaktuar atij paaftësi të përkohshme për të shkuar në shkollë, konsiderohet se duke pasur parasysh faktin se i mituri nuk punon, dispozita në fjalë mund të rishikohet, me qëllim që si rrethanë cilësuese të parashikohet edhe rasti kur vepra penale ka sjellë si pasojë paaftësi të përkohshme për të shkuar në shkollë.

-Nga ana e Ministrit të Drejtësisë vlerësohen përpjekjet e Institucionit të Avokatit të Popullit për përmirësimin e legjislacionit në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave e lirive themelore të njeriut. Po kështu theksohet se “Gjatë vitit 2009 është parashikuar rishikimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale me qëllim përmirësimin e tyre. Për çështje që mbulohen nga Institucioni i Avokatit të Popullit, çdo projektligj për ndryshimin e kodeve të lartpërmendura, do të paraqitet për mendim”.

Gjatë vitit 2009, ashtu sikundër e thamë më sipër, Zyra e Avokatit të Popullit ka shqyrtuar gjithsej 94 raste ankesash kërkesash apo çështje të filluara me iniciativën tonë. Nga këto 24 kanë rezultuar jashtë juridiksionit apo kompetencës së Avokatit të Popullit, 13 ankesa kanë qenë të pabazuara, janë në shqyrtim 8 ankesa dhe 46 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve. Në numrin e ankesave të zgjidhura në favor përfshihen dhe çështjet e ndjekura me iniciativën tonë për të cilat janë hartuar rekomandimet përkatëse.

Numri më i madh i ankesave për fëmijët vijnë nga prindërit osë të afërmit e tyre.

Objekti i ankesave ka qenë për trajtimin e veçantë të fëmijëve, për përmirësimin e kushteve në shkolla, mosdhënien e ndihmës ekonomike nga Bashkia, mosregjistrimi i mjaft femijeve të komunitetit rom në gjendjen civile, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor të prindërve, përmirësimin e kushteve të strehimit, dhe moszbatimin e procedurave ligjore për rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin, etj.

Po paraqesim disa raste, të trajtuara e që kanë marrë zgjidhjen në favor të ankuesve:

1-Shërbimi Ligjor Falas (Tirana Legal Aid Society-T.L.A.S) kërkoi ndihmën e Zyrës sonë për legalizimin e çertifikatës së lindjes së fëmijës Xh Z, 6 vjeç (lindur në Athinë). Meqënëse, edhe gjyshi i fëmijës u paraqit personalisht pranë Zyrës sonë dhe na deklaroi se nuk ka asnjë lloj mundësie fizike e financiare për të kryer legalizimin e çertifikatës së të nipit në Greqi, dhe si pasojë ai ende nuk është regjistruar në Gjendjen civile, u kërkua ndërmjetësimi i Zyrës sonë për këtë problem. Kjo pasi prindërit e fëmijës nuk kishin mundësi të riktheheshin në Greqi e të

legalizonin çertifikatën e lindjes së fëmijës. Si pasojë e këtij mosregjistrimi, fëmija rrezikonte dhe fillimin e këtij viti shkollor.

Nisur nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, që duhet të jetë mbizotërues në të gjitha vendimmarrjet që kanë të bëjnë me fëmijët, ju drejtua Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Greqi. Konstatuam gatishmërinë dhe përkushtimin e këtij Ambasadori për të ndihmuar lidhur me këtë problem. Dhe rezultati ishte përgjigjja që akti i lindjes së fëmijës Xh.Z u përcoll i përfunduar me vulat përkatëse. Çështja mori zgjidhjen pozitive dhe si pasojë ky fëmijë u regjistrua në Gjendjen Civile.

2- Në ankesën e G.Ç, banues në Tiranë paraqitej gjendja mjaft e vështirë ekonomike familjare dhe mostrajtimi me ndihmë ekonomike nga shteti. Për më tepër ai në cilësinë e gjyshit, kujdesej dhe për mirërritjen e 4 fëmijëve të mitur të të birit, i cili që nga viti 2006 ishte larguar dhe nuk dihej se ku ndodhej.

Pasi ju drejtua për shpjegime Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr.11 Tiranë, kemi marrë përgjigjen pozitive. Pra familja e të birit të ankuesit tashmë ishte përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike.

3- Në ankesën e M.N, banuese në Korçë dhe pjesëtare e komunitetit Rom të këtij qyteti, na u paraqit shqetësimi i saj si nënë për shëndetin e të birit. Djali i saj, 9 vjeçar mbi bazën e rekomandimit të mjekëve, duhej të kurohej patjetër jashtë vendit, për arsye se rrezikonte humbjen e shikimit. Ndaj ajo kërkonte ndihmën e Zyrës sonë për t'u informuar lidhur me rrugëzgjidhjen e këtij problemi. Pasi e drejtua për kompetencë shqyrtimi rastin në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor pranë Ministrisë së Shëndetësisë, konstatuam përgjigjen mjaft të shpejtë nga ana e kësaj drejtorie, mbi bazën e së cilës u sqarua dhe ankuesja. Konkretisht ajo duhej të paraqiste pranë Ministrisë së Shëndetësisë disa dokumenta, si epikrizë nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" si dhe Vendimin e Komisionit Ndërspitalor të QSUT.

Si përfundim, mund të themi se Avokati i Popullit është i angazhuar seriozisht të japë një kontribut me rëndësi të veçantë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Kjo duke rritur si ndërgjegjësimin e individëve të komunitetit, ashtu dhe të administratës publike në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë reciproke në mbrojtjen e garantimin e të drejtave të fëmijëve.

## 19. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT)

### 1. Konsolidimi i rolit të MKPT-së

Institucioni i Avokatit të Popullit që në fillimet e aktivitetit të tij në vitin 2000 e ka drejtuar veprimtarinë e tij edhe në monitorimin e vendeve të privimit të lirisë. Në këtë aspekt të punës tonë, ambjentet ku liria e

personit është e kufizuar janë konsideruar gjithmonë si vende ku të drejtat e njeriut ndihen më shumë të kërcënuara. Shkelja e këtyre të drejtave ka gjasa të ndodh më shpesh prapa mureve, e fshehur dhe e izoluar, sesa në vende të hapura, të dukshme dhe të monitorueshme nga të gjithë.

Nisur nga një eksperiencë e gjatë në këtë fushë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka krijuar një model pune mjaft të mirë, duke patur rezultate pozitive në kontrollin e ambjenteve të privimit të lirisë, zbulimin e shkeljeve dhe paraqitjen e rekomandimeve për ndëshkimin e nëpunësve të përfshirë në ngjarje dhune dhe abuzimi.

Roli aktiv dhe eksperiencia jonë e mirë bënë të mundur që në fillim të vitit 2008, Avokatit të Popullit t'i caktohej nga Kuvendi i Shqipërisë me ligj të posaçëm funksioni i Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës (MKPT), në zbatim të Protokollit Opsional të Parandalimit të Torturës (OPCAT), të ratifikuar nga Shteti Shqiptar me Ligjin Nr.9094 dt.3.07.2003.

Në përmbushje të këtij funksioni, Avokati i Popullit krijoi një strukturë të veçantë pranë zyrës së tij të emërtuar Njësia për Parandalimin e Torturës. Tashmë kemi rreth 2 vjet që krahas kontrolleve që kemi organizuar për ankesa apo ngjarje të ndryshme në vendet e ambjentet e privimit të lirisë, aktiviteti ynë është përqendruar edhe në vizitat e shpeshta ose inspektimet periodike në të gjitha ambjentet ku mund të ushtrohet torturë, trajtim çnjerëzor dhe degradues për shkak të rrethanave të veçanta të kufizimit të lirisë.

Vetëm gjatë vitit 2009 Njësia për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit ka kryer rreth 150 inspektime, ri-inspektime, kontrolle me tematikë të veçantë dhe vizita në vendet e privimit të lirisë dhe institucioneve të tjera si: burgje, paraburgime, institucione të Policisë së Shtetit, Spitale Psikiatrike dhe Civile (me rregjim karantine), Qendra Sociale të Trajtimit të Personave të Trafikuar dhe atyre Azilkërkues, baza ushtarake etj.

Në dallim nga aktiviteti i Njesisë së Parandalimit të Torturës për vitin 2008 (50 inspektime dhe vizita), gjatë vitit 2009 veprimtaria monitoruese e kësaj njësie është trefishuar në numër, duke treguar për një rendiment të lartë pune dhe një prezencë të shtuar në terren pranë institucioneve përkatëse. Në rrjedhim të kësaj veprimtarie, Avokati i Popullit ka adresuar pranë Institucioneve respektive që administrojnë këto ambiente 123 rekomandime, informacione, propozime për masa disiplinore etj.

Ky aktivitet ka kombinuar në tërësinë e tij, jo vetëm detyrimet ligjore për të kryer inspektime të rregullta në vendet e privimit të lirisë, por dhe për të qenë prezent në ato ngjarje të ndodhura në këto ambiente, ku është dyshuar për torturë, trajtim çnjerëzor apo degradues.

Krahas numrit të mësipërm të inspektimeve, Njësia për Parandalimin e Torturës ka trajtuar gjatë vitit 2009 edhe 413 ankesa, të cilat janë marrë gjatë takimeve me individë të privuar nga liria, apo të dërguara pranë Zyrës së Avokatit të Popullit me anë të postës apo me njoftim telefonik.

Në vijim të ngritjes dhe konsolidimit të kësaj veprimtarie, Njësia për Parandalimin e Torturës ka forcuar kontaktet me Organizata Ndërkombëtare si OKB, Këshillin e Europës, OSBE etj, si dhe ka bashkëpunuar dendur me Organizata të tjera kombëtare jo fitimprurëse që operojnë në fushën e monitorimit të ambjenteve të privimit të lirisë.

## **2.Kryerja e veprimtarisë monitoruese**

Sipas pikës 1 të nenit 60 të Kushtetutës së Shqipërisë: *“Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”*.

Sipas referimeve në legjislacionin tonë, brenda termit administratë publike janë të përfshira edhe institucionet shtetërore që mbulojnë sistemin penitenciar (burgjet dhe paraburgimet), organet e Policisë së Shtetit dhe ambjentet ku mbahen persona të arrestuar, ndaluar apo shoqëruar, si dhe dhomat e izolimit disiplinor në Repartet e Ushtrisë Shqiptare.

Brenda këtyre ambjenteve, individit gëzon realisht statusin e personit të privuar nga liria, në dallim nga qendra të tjera shtetërore, ku strehimi apo privimi administrativ i disa të drejtave të individit bëhet për shkak përkujdesje shoqërore apo asistence mjekësore (azile, shtëpi fëmije, spitale psikiatrike, qendra personash të trafikuar ose azilkërkues etj).

Të dyja kategoritë e ambjenteve të mësipërme janë konsideruar dhe trajtuar gjatë vitit 2009 si objekt monitorimi të punës tonë.

Krahas dispozitave të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (i ndryshuar) që autorizojnë këtë institucion në kryerjen e inspektimeve të pavarura, Ligji Nr.8328 dt.2.04.1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, në shtesat që u bënë në Mars 2008, i njohu institucionit tonë një rol mjaft aktiv dhe integral në veprimtarinë penitenciare.



Në Nenin 74, pikat 1. 2. 3, Avokati i Popullit është parashikuar shprehimisht si subjekt i veçantë për mbikqyrjen e zbatimit dhe realizimit të ligjit për të dënuarit dhe paraburgosurit. Në nenet 74 pikat 1, 2, 3, Institucionit të Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së i janë dhënë disa kompetenca shtesë të huazuara nga përmbajtja origjinale e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës ( OPCAT ).

Konkretisht sipas përmbajtjes së këtyre dispozitave, Avokati i Popullit ka kompetenca për të vëzhguar rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues. Gjithashtu, atij i njihet e drejta që të paraqesë rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Në realizim të kësaj detyre, Avokatit të Popullit në këtë ligj i njihen edhe një sërë kompetencash të posaçme për të realizuar një akses të plotë në këto ambiente, duke marrë midis të tjerash çdo informacion në lidhje me numrin e individëve që u është hequr liria dhe vendodhjen e tyre, mënyrën e trajtimit të këtyre individëve, kushtet e tyre të ndalimit etj.

Gjatë vizitave në këto ambiente, Avokatit të Popullit i njihet e drejta të kryejë në çdo kohë intervista private me të dënuarit, pa patur praninë e personelit të burgut apo paraburgimit, si dhe të zgjedhë lirisht vendet që kërkon të vizitojë dhe individët që kërkon të takojë.

Gjithashtu është parashikuar se në rolin e MKPT-së, institucioni ynë mund të marrë në çdo kohë dhe pa pengesë informacione apo ankesa nga të dënuarit ose nga administrata e burgut dhe paraburgimit, të verifikojë në çdo kohë dokumenta, objekte, pajisje ose mjedise, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit penitenciar. Për realizimin e procesit të mbikqyrjes, MKPT i njihet e drejta nga ky ligj që të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse, qofshin këta mjek ligjor, psikolog, psikiatër etj.

Në përmbushjen e detyrave të mësipërme, Njësia për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009 ka inspektuar, riinspektuar dhe kryer vizita në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit në vend. Gjatë kësaj veprimtarie janë parashtruar një volum i madh rekomandimesh, lidhur respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve, veçanërisht të plotësimit të nevojave jetësore, edukative, shëndetësore dhe arsimore. Gjithashtu janë propozuar edhe një sërë masash të tjera për vendosjen e kamerave të sigurisë, kryerjen e investimeve të brendshme, plotësimin e stafit punonjës me qëllimin për të arritur standartet e kërkuara në këto qendra. Megjithëse veprimtaria e MKPT-së nuk ka kryesisht një karakter të tillë, nuk kanë qenë të pakta

rastet ku është kërkuar edhe ndëshkimi i punonjësve të përfshirë si përgjegjës në raste dhune dhe trajtimi degradues. Në vijim të propozimeve tona, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka reaguar pozitivisht, duke ndëshkuar me masa disiplinore gjatë vitit 2009, 15 punonjës të policisë së burgjeve. Ky është një tregues mjaft pozitiv, jo vetëm i punës tonë, por dhe i bashkëpunimit në nivele të kënaqshme që ekziston me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të parandaluar dhunën brenda sistemit penitenciar dhe për të ndëshkuar autorët përgjegjës.

Njëkohësisht, pranimi i propozimeve dhe eliminimi i problemeve të konstatuara në rekomandimet e Avokatit të Popullit ka realizuar në praktikë mjaft përmirësime të ndjeshme në kushtet e brendshme të burgjeve dhe paraburgimit, të cilat do të përshkruhen më gjerësisht në rubrikën përkatëse të këtij raporti.

Në vijim të qëllimit tonë për të vendosur kontakte të ngushta me të dënuarit dhe paraburgosurit për të evidentuar dhe zgjidhur problemet që ata kanë, ka vijuar të konsolidohet komunikimi nëpërmjet numrit pa pagesë që ofron zyra jonë në dispozicion të tyre, si dhe të vendosjes dhe vënies në funksionim të kutive të posaçme postare që hapen vetëm nga personeli i Avokatit të Popullit në çdo burg dhe paraburgim. Ky projekt ka rezultuar mjaft i suksesshëm, kjo falë dhe ndihmës dhe mbështetjes së madhe që është dhënë nga Misioni i OSBE-së Tiranë. Për vitin 2009 Njësia për Parandalimin e Torturës ka realizuar rreth 270 telefonata me të dënuar dhe paraburgosur, si dhe ka marrë nga kutitë postare në të gjitha qendrat e burgjeve dhe paraburgimit 154 ankesa apo kërkesa.

Prezenca jonë e shtuar gjatë vitit 2009 në këto ambiente ka rritur së tepërmi komunikimin dhe besimin e personave të privuar nga liria për të prezantuar problemet e tyre reale, apo për të denoncuar fenomene negative që rëndojnë mbi të drejtat e tyre.

Një veprimtari e dendur e Njesisë së Parandalimit të Torturës është kryer edhe në monitorimin e ambienteve që disponon Policia e Shtetit për shoqërimin apo ndalimin e individëve. Kjo Njësi ka realizuar jo vetëm inspektime të kushteve që ofrojnë këto ambiente, por dhe ka marrë pjesë në një seri hetimesh për ngjarje dhune të ndodhura brenda tyre, të cilat në mënyrë të detajuar janë përmendur në rubrikën përkatëse të këtij raporti. Rast për t'u përmendur nga kjo veprimtari është ajo e Komisarariatit të Policisë Qarkut Dibër, ku nga puna hetimore e Njesisë së Parandalimit të Torturës u arrit të ndëshkoheshin me masa disiplinore 7 punonjës të Policisë së Shtetit. Gjithsesi, aktiviteti ynë ka qenë më tepër i fokusuar në evidentimin e problemeve që shfaqin dhomat e izolimit policor. Për këtë qëllim janë ngritur në mënyrë të përsëritur rekomandime dhe në terren janë vënë re një sërë investimesh që po kryhen për përmirësimin e kushteve të këtyre ambienteve.

Krahas kësaj gjatë vitit 2009, Njësia për Parandalimin e Torturës ka kryer edhe një sondazh për trajtimin e individëve, veçanërisht atyre të mitur, gjatë ndalimit dhe hetimit të ngjarjeve nga Policia e Shtetit, ku nga të dhënat është konstatuar një performancë kryesisht negative e punës së policisë në këtë aspekt dhe veçanërisht në përdorimin e dhunës fizike dhe psiqike gjatë hetimit. Megjithëse ky sondazh nuk u pajtua me opinionin e policisë, ai është një indicie që do të orientojë edhe në të ardhmen objektivat e punës gjatë vizitave tematike të Njesisë për Parandalimin e Torturës.

Duke qenë të vendosur për të vijuar monitorimin e aktivitetit të Policisë së Shtetit edhe në të ardhmen, Avokati i Popullit miratoi gjatë vitit 2009 edhe Metodologjinë e Inspektimeve në Organet e Policisë së Shtetit, dokument i cili do të udhëheqë mbi baza profesionale dhe ligjore punën e Njesisë për Parandalimin e Torturës në këtë fushë.

Një tjetër fushë ku është krijuar akses i madh për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, edhe në rolin e tij të ri si MKPT, është aktiviteti i Forcave të Armatosura, veçanërisht në trajtimin e të drejtave të individëve. Në kuadër të reformave dhe shndërrimeve të mëdha që po pëson ushtria jonë si pjesë përbërëse e forcave të NATO-s, Avokati i Popullit synon që prezenca e tij brenda bazave ushtarake, veçanërisht në dhomat e izolimit disiplinor të jetë sa më e shpeshtë, efektive dhe të synojë të japë këshilla për trajtimin sipas standarteve të individëve.

Për këtë qëllim, me marrjen e funksionit si MKPT, Njësia e Parandalimit të Torturës ka organizuar inspektime të shpeshta në bazat ushtarake, ku është njohur nga afër me kushtet e dhomave të izolimit, trajtimit të ushtarëve, akteve nënligjore që normojnë masat disiplinore izoluese etj.

Krahas kësaj, promovimi i Institucionit të Avokatit të Popullit si MKPT për inspektimin e bazave ushtarake, ka nxitur një marrëdhënie mjaft të ngushtë me autoritetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA. Nga ana e tyre u janë dhënë detyra bazave ushtarake për respektimin e aksesit ligjor që gëzon Institucioni ynë dhe për krijimin e të gjitha lehtësirave për përmbushjen e monitorimeve tona.

Në praktikë janë vënë re se disponibiliteti i drejtuesve ushtarakë të bazave ka qenë i kënaqshëm. Ata kanë mundur spas ligjit edhe njohjen me informacione të rezervuara ushtarake, lidhur me numrin e ushtarëve të rekrutuar, trajtimin e tyre shëndetësor etj.

Produkt i aksesit tonë në këto baza kanë qenë prezantimi i rekomandimeve të veçanta të Avokatit të Popullit, të cilat kanë ngritur veçanërisht probleme mbi hartimin dhe miratimin e rregulloreve të reja për izolimin disiplinor, trajtimin me të drejta të barabarta të efektivit ushtarak sipas statusit ligjor që ata gëzojnë, realizimin e procedurave transparente në rastet e izolimit të tyre, përmirësimin e kushteve të

ambjenteve dhe procedura të tjera, veçanërisht gjatë rekrutimit të individëve. Për të gjitha këto problematika flitet më gjerësisht në rubrikën përkatëse të këtij raporti.

Ajo që është e rëndësishme në marrëdhënie me Forcat e Armatosura, është fakti se ato e kanë kuptuar drejt rolin monitorues të Avokatit të Popullit dhe bashkëpunimi ynë do të vijojë edhe në të ardhmen, veçanërisht në promovimin e standarteve të të drejtave të njeriut në bazat ushtarake.

Njësia për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit ka vijuar edhe këtë vit të inspektojë një gamë të gjerë institucionesh shëndetësore dhe të shërbimit social. Megjithëse, për këto inspekte flitet gjerësisht në rubrikat përkatëse, ndihet e nevojshme të nënvizohet rëndësia që duhet treguar për veprimtarinë normale të tyre në respekt të personave në nevojë.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit në përfundim të monitorimeve të kryera kanë ngritur një sërë çështjesh me mjaft interes për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të shtëpive të fëmijëve, azileve të të moshuarve, qendrave për trajtimin e individëve me probleme të zhvillimit, qendra të tjera sociale ditore, spitaleve psikiatrike, spitaleve infektive etj.

Në tërësinë e tyre problemet e ngritura kanë qenë kryesisht për mungesa në pajime, investime ambjentesh të amortizuara, rritje të normës ushqimore, trajtime financiare të personelit punonjës etj.

Nga ana e autoriteteve përgjegjëse për marrjen e këtyre masave është vënë re një reagim i shpejtë dhe tepër pozitiv për shumë çështje me karakter emergjent, gjithësesi mbeten ende për t'u ndjekur edhe në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të individëve që strehohen në këto institucione.

### **3. Promovimi i veprimtarisë së MKPT-së dhe bashkëpunimi me OJF-të**

Duke e konsideruar të rëndësishëm aspektin promovues të veprimtarisë së MKPT-së dhe zhvillimin e një dialogu produktiv për përmirësimin e të drejtave të njeriut për individët e privuar nga liria, Avokati i Popullit ka organizuar dhe bashkëorganizuar gjatë vitit 2009 një sërë takimesh, seminaresh dhe konferencash me tematikë mbi parandalimin e torturës.

Konkretisht, gjatë vitit 2009 Avokati i Popullit ka bashkëorganizuar me Qendrën Shqiptare të Rehabilitimit të Viktimave të Torturës dhe Institutin European të Tiranës 9 tryeza të rrumbullakta dhe 3 konferenca kombëtare për çështjet e parandalimit të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues, në burgje, paraburgime, polici etj. Në këto takime ka patur një rol mjaft të veçantë adresimi i problemeve madhore në këtë fushë dhe nxitja e dialogut me përfaqësues të ftuar kryesisht nga

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Spitaleve Psikiatrike dhe Spitalit të Burgut, si dhe me pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë të shoqërisë civile.

Për t'i hapur rrugë një bashkëpunimi serioz mbi baza reciprociteti gjatë muajit Qershor 2009 Avokati i Popullit nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Shqiptare të Rehabilitimit të Viktimave të Torturës, Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe Institutin European të Tiranës.

Këto marrëveshje u nënshkruan me qëllimin për të krijuar një front të përbashkët të ndihmës së ndërsjelltë, si dhe për të konsoliduar forcën monitoruese të MKPT-së për parandalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor dhe degradues në çdo institucion shtetëror. Ky bashkëpunim ka synimin kryesor të sigurojë një mbulim të plotë të veprimtarisë monitoruese, të shkëmbejë informacion për çdo ngjarje apo situatë negative, të kombinojë me burime njerëzore shumicën e inspektimeve në terren etj. Avokati i Popullit me anë të nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve arriti të sigurojë krahas të tjerash një ndihmë mjaft të nevojshme në punën e tij, veçanërisht për mbështetjen me ekspertë mjeko-ligjor, mjek-psikiatër, psikolog dhe punonjës-social, profile këto, të cilat i mungojnë aktualisht brenda personelit të tij.

Nga vëzhgimi i rezultateve të këtij bashkëpunimi vërehet lehtësisht se në rekomandimet kryesore të paraqitura nga Avokati i Popullit për ngjarje dhune apo inspektime tematike, ai është ndihmuar me ekspertizën e duhur të pavarur të ofruar nga OJF-të e mësipërme.

Raste për t'u përmendur janë mbështetja me ekspertë mjeko-ligjor të Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Viktimave të Torturës, ofruar veçanërisht për hetimin e ngjarjeve në Burgun e Lezhës, Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër, Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, nga ku kanë arritur të dalin rezultate mjaft pozitive pune.

Bashkëpunimi ka qenë mjaft i frytshëm edhe me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, ku në një rast ofrimi i ekspertëve psiko-social nga ana e tyre solli hartimin dhe dokumentimin me sukses të sondazhit për performancën e punës së policisë gjatë shoqërimeve dhe ndalimeve të kryer me të miturit e Paraburgimit 313 Tiranë. Gjithashtu me KSHH është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm për informacione lidhur me raste të pretenduara nga individë të ndryshëm për dhunë në burgje, organe të policisë etj.

Model i mirë për t'u përmendur është edhe bashkëpunimi i sukseshëm me Institutin European të Tiranës, me të cilin krahas inspektimeve të përbashkëta të kryera në të gjitha qendrat e paraburgimit, është marrë një ekspertizë e veçantë mjeko-ligjore, psikiatrike dhe psikologjike për hetime të ndryshme dhune, trajtimi çnjerëzor dhe

degradues, veçanërisht për Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, Komisaratin Nr.4 të Policisë Tiranë etj. Me anë të bashkëpunimit me këtë OJF është bërë e mundur propagandimi i të drejtave të paraburgosurve me anë të spoteve publicitare në gazeta, si dhe me vendosjen në të gjitha qendrat e paraburgimit në vend të disa posterave me përmbajtjen e të drejtave të të paraburgosurve.

Avokati i Popullit ka treguar një vëmendje të veçantë për të bashkëpunuar edhe me Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS) sa herë që gjatë inspektimeve të tij ka hasur në kërkesa të të dënuarve për ndihmë juridike të kualifikuar dhe pa pagesë.

Ndihma e organizatave të mësipërme ka qenë e pazëvendësueshme për punën e Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe një eksperiencë e tillë do të vazhdojë të konsolidohet edhe më tej, me anë të shtimit të planeve monitoruese të përbashkëta.

Së fundi nuk duhet lënë pa përmendur puna mjaft e mirë që është bërë për informimin publik të veprimtarisë së MKPT-së, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Avokatit të Popullit, organeve të shtypit etj. Në këtë rast, pasqyrimi i rezultateve të inspektimeve apo punës për zbardhjen e rasteve të dhunës në burgje, komisariate policie etj, ka qenë një avantazh i madh për ndërgjegjësimin e publikut në denoncimin e fenomeneve negative të keqtrajtimit apo abuzimit me detyrën të punonjësve shtetëror. Një rol të pazëvendësueshëm në këtë rast ka luajtur marrëdhënia mjaft e ngushtë me median e shkruar dhe atë vizive. Falë këtij bashkëpunimi, gjatë vitit 2009 është rritur në mënyrë të ndjeshme pasqyrimi i pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit në zgjidhjen e mjaft ngjarjeve apo problemeve që kanë shqetësuar qytetarët.

#### **4. Rekomandimet legjislative**

Një nga veprimtaritë funksionale të Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së ka qenë edhe paraqitja e rekomandimeve me karakter legjislativ, të cilat nëpërmjet propozimit për ndryshime dhe amendime të akteve ligjore dhe nënligjore, ka patur si synim të përmirësojë kuadrin ligjor në fuqi për parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues, si dhe respektimit të të drejtave të individëve.

Në Maj 2009, Avokati i Popullit u ftua nga Ministria e Drejtësisë të jepte propozimet përkatëse për Rregulloren e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, si një akt, zbatimi i të cilit ka një rëndësi prioritare për respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve.

Mendimet e parashtruara dhe roli aktiv i mbajtur në seminarët e zhvilluara në përgjithësi për ngritjen dhe konsolidimin e Shërbimit të Provës ishin një kontribut i veçantë që Avokati i Popullit dha në këtë drejtim.

Në Korrik 2009, Avokati i Popullit u parashtrori gjatë një takimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, një sërë propozimesh në kuadër të miratimit të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Këto propozime në shumicën e tyre gjetën konsensus dhe pasqyrim në aktin e miratuar.

Njëkohësisht, përfaqësues të Njesisë për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit janë caktuar si antarë të Konsorciumit për Reformën në Burgje dhe kanë dhënë mendime të dobishme lidhur me ndryshime të ardhshme në kuadrin ligjor dhe nënligjor për respektimin e standarteve mbi trajtimin e personave të dënuar.

### **5. Raportimet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar;**

MKPT-ja krahas të qënit një strukturë kombëtare për parandalimin e torturës është njëkohësisht edhe një funksion që mbart detyrime ndërkombëtare të mirëfillta, veçanërisht raportuese. Në këtë drejtim, që me krijimin e Njesisë për Parandalimin e Torturës janë vendosur lidhje me përfaqësues të Nënkomitetit Kundër Torturës së OKB-së, Komitetit kundër Torturës së OKB-së, si dhe me Komitetin për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Europës dhe me një sërë organizatash të tjera jo qeveritare të huaja që asistojnë në këtë fushë veprimtarinë tonë.

Gjithashtu, përfaqësues të Njesisë për Parandalimin e Torturës janë bërë pjestarë të grupeve të punës pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme Shqiptare, lidhur me përgatitjen e raporteve pranë Këshillit të Europës dhe Komitetit kundër Torturës (CAT) të OKB-së.

Ndërkohë, në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme po vijojnë komunikimet me Nënkomitetin kundër Torturës të OKB-së, lidhur me të dhënat dhe informacionet që ata kërkojnë në mënyrë periodike për punën e MKPT-së. Gjithashtu, pranë këtij Nënkomiteti të OKB-së është dërguar edhe raporti i punës për vitin 2008 të MKPT-së Shqiptare i marrë si pjesë nga Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2008.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe promovimit në aspektin ndërkombëtar të veprimtarisë së MKPT-së, përfaqësues të Njesisë për Parandalimin e Torturës kanë marrë pjesë në disa takime ndërkombëtare të zhvilluara nga OKB, Këshilli i Europës dhe OSBE, lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në burgje dhe në polici, si dhe me konsolidimin e rolit të MKPT në rajon dhe më gjerë. Në këto takime, nga ana e ekspertëve tanë janë dhënë mendime dhe është ofruar eksperiencia për një sërë praktikash inspektimi dhe mënyrën e veprimtarisë tonë në përgjithësi. Kjo është bërë e mundur edhe falë faktit se në Kontinentin Europian krijimi i MKPT-së është bërë nga 23 vende, midis tyre edhe Shqipëria. Ndërkohë që në rajonin e Ballkanit, Shqipëria figuron e vetme që ka vënë në funksionim prej gati dy vjetësh këtë strukturë. Ky fakt ka bërë të mundur që MKPT-ja jonë të futet në një program të avancuar trajnimi dhe asistence (Peer to Peer, konsolidimi i MKPT-ve) nga ana e

Këshillit të Europës dhe OKB-së, i cili do të fillojë të funksionojë që nga Janari i vitit 2010 dhe do të përfshijë një sërë aktivitetesh për fuqizimin e MKPT-së shqiptare në rolin e saj monitorues.

Së fundi është vënë re se në çdo takim ndërkombëtar, vendi ynë është vlerësuar, jo vetëm për gatishmërinë për të ratifikuar dhe ngritur në kohë MKPT-në sipas Protokollit Opsional të Parandalimit të Torturës (OPCAT, OKB), por dhe për seriozitetin me anë të së cilës, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar të përmbushë këtë detyrim ndërkombëtar.

### **Sfidat**

Veprimtaria e parandalimit të torturës, nëpërmjet inspektimeve periodike ka patur edhe sfidat dhe vështirësitë e saj. Konkretisht, problemet që kemi hasur gjatë përmbushjes së veprimtarisë tonë janë si vijon:

1) Puna e kryer nga ana jonë është përcjellë gjatë vitit 2009 sërish me mungesa logjistike dhe në burime njerëzore. Konkretisht në mjaft raste, kur është konstatuar dhunë gjatë inspektimeve, Avokati i Popullit ka ndjerë nevojën e dhënies së një mendimi të pavarur nga ekspertë të fushave të ndryshme (sociologjike, psikiatrike, psikologjike, mjekoligjore etj), të cilat janë mundësuar vetëm falë fondeve të OJF-ve, pasi shteti shqiptar nuk ka lëvruar financime shtesë apo krijimin e vendeve të reja të punës për mbulimin e kësaj veprimtarie nga ana jonë, përveç pagave të stafit ekzistues.

2) Gjithashtu, ashtu siç jemi shprehur edhe më lart, vijojnë të mbeten problem rritja e fondeve të veçanta për blerje pajisjesh pune, kancelarie, dieta, automjete etj. Duke mos patur mbështetje financiare logjistike nga ana e Qeverisë, Institucioni i Avokatit të Popullit u detyrua të vinte në funksion të kësaj strukture pajisje të huazuara nga seksionet e tjera të Avokatit të Popullit si psh, kompjutera, kancelari, pajisje zyre, automjete etj.

Nisur nga këto vështirësi, Avokati i Popullit në të gjitha takimet e zhvilluara me përfaqësues të shtetit shqiptar, partnerë të tjerë vendas dhe të huaj ka kërkuar që të ndihmohet me bazë materiale, pasi aktualisht e ka të vështirë të përmbushë në mënyrë të plotë dhe të kualifikuar detyrën e tij.

3) Avokati i Popullit shpesh herë ka vënë re se megjithë veprimtarinë e tij promovuese për MKPT-në, disa institucione nuk janë përshtatur dhe kanë krijuar pengesa të pajustificueshme në kryerjen e detyrës tonë. Kjo është vënë re, sidomos në pengesat për të hyrë në ambjentet e sigurisë së Komisariateve të Policisë në Tiranë, si dhe në disa burgje. Gjithashtu, në disa raste nuk janë lejuar që punonjës të zyrës tonë të marrin me vehte brenda këtyre ambjenteve pajisje fotografimi për të provuar me fakte dhunën.



Për të gjitha këto raste, Avokati i Popullit ka komunikuar me Ministrin e Brendshëm, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve etj. Pas këtyre komunikimeve është vënë re një angazhim dhe përgjegjshmëri më e madhe e këtyre strukturave, për të reaguar në mënyrë ligjore në përkrahje të punës tonë. Gjithsesi sërish në praktikë vihen re mangësi nga niveli ekzekutiv i punonjësve të këtyre strukturave.

### **Parashikimet për të ardhmen**

Avokati i Popullit për vitin 2010 është në procesin e miratimit të një programi të ri inspektimi, në të cilin numërohen rreth 150 inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë në të gjithë vendin, duke përfshirë këtu Komisariate Policie, Burgje, Qendra Paraburgimi, Spitale, Reparte Ushtarake etj.

Në këto inspektime, MKPT-ja është orientuar t'ju rikthehet edhe një herë objekteve të inspektuara më parë, për të parë dhe nxjerrë në pah ndryshimet e bëra sipas propozimeve të Avokatit të Popullit, por duke u fokusuar edhe në përmirësimin e disa aspekteve të veçanta.

Gjithashtu është menduar të vazhdojë të forcohet bashkëpunimi me OJF-të për të vijuar punën me grupe të përbashkëta inspektimi, të cilat do të kenë në përbërje të tyre specialistë nga të gjitha fushat që nevojiten, si psh: Psikolog, Mjek Ligjor, Mjek Psikiatër, Sociolog etj.

Një tjetër objektivi do të jetë përfshirja e personelit të MKPT-së, në një program ndërkombëtar asistence dhe trajtimi, e cila do të rrisë në mënyrë efikase dhe profesionale standartet dhe metodologjinë e punës tonë. Avokati i Popullit planifikon për vitin 2010 që të miratojë metodologjinë e inspektimit për ambjentet e burgjeve dhe paraburgimit, si dhe të spitaleve psikiatrike. Këto dokumenta do të kenë një rol kyç në rritjen e profesionalizmit gjatë monitorimeve.

Së fundi, së bashku me disa OJF, do të planifikojmë për të vijuar organizimin e seminareve dhe tavolinave të rrumbullakta me institucionet shtetërore me synimin për të vijuar dialogun dhe shkëmbimin e ideve në përmirësim të standardeve të trajtimit të individëve të privuar nga liria.

Ne shpresojmë se besimi që na është dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë për të përmbushur këtë veprimtari, ka një rol mjaft domethënës që motivon së tepërmi aftësitë tona për të realizuar detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

## **20. Veprimtaria në favor të ish të të përndjekurve politikë**

Gjatë vitit 2009 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesa Shoqatat e ish të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, në të cilat pretendojnë se; Ligji Nr. 9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” bie në

kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut si dhe me Rezolutën e Këshillit të Europës për Dënimin e Krimeve të Komunizmit, në të cilat përcaktohet e drejta e viktimave të regjimit komunist për rivendosjen e drejtësisë, rehabilitimin moral e politik, dëmshpërblimin ekonomik si dhe riintegrimin real në shoqëri. Gjithashtu ata pretendojnë se Ministria e Drejtësisë ka miratuar disa procedura tepër të ndërlikuara dhe të vështira për t'u plotësuar dokumentacioni që u kërkohet të dënuarve politikë për të përfituar dëmshpërblimin që ju takon sipas ligjit përkatës. Sipas tyre procedurat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë janë në kundërshtim jo vetëm me ligjet dhe VKM-të e miratuara për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, por ato janë edhe në kundërshtim të hapur me Ligjin Nr.9831 datë 12.11.2007.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur gjithësej 15 ankesa individuale nga ish të burgosur dhe të perndjekur politikë nga regjimi komunist, me të njëjtat kërkesa dhe pretendime, por edhe ankesa për policinë, gjykatën, përmbarimin etj.

Një problem shqetësues, i paraqitur në vazhdimësi nga ish të perndjekurit politikë është edhe ai i mospërfitimit të statusit të të perndjekurit politik. Ky problem prek rreth 1000 persona që presin të fitojnë statusin e ish të perndjekurit politik, dhe që nëpërmjet statusit, pretendojnë të përfitojnë të gjitha benefitet që mund të përfitohen prej zotërimit të tij. Kjo si pasojë e mosfunksionimit të Komisionit Shtetëror Trepalësh si organi kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Perndjekurit Politik. Ky komision ka funksionuar gjatë periudhës Nëntor 1993-Korrik 1997. Më pas edhe pse ka qenë detyrim ligjor ekzistenca e tij, ky funksionim është ndërprerë. Ndaj në kuadër të një prej detyrave të tij, asaj të mirëfunksionimit të Administratës Publike, Institucioni i Avokatit të Popullit që në mars 2005 i ka rekomanduar Zv.Kryeministrit të asaj kohe përshpejtimin e procedurave për ngritjen e Komisionit Trepalësh si organ kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Perndjekurit Politik dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 1 dhe 2 të Ligjit. Nr.9260, datë 15.07.2004 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të perndjekurve politikë nga sistemi komunist" i ndryshuar. Këtë rekomandim ia kemi dërguar dhe Qeverisë të drejtuar nga Kryeministri Z.Sali Berisha, por nuk kemi patur ndonjë përgjigje për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje.

Aktualisht nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë duke u shqyrtuar me përparësi dy ankesa të rëndësishme të paraqitura nga shoqatat e të persekutuarve politikë të Shqipërisë.

- Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur një ankesë-kërkesë Shoqatat e të Burgosurve Politikë të Shqipërisë, në vitin

2008 në të cilën pretendojnë se; institucionet shtetërore si, Sektori i Arkivit në Ministrinë e Brëndshme, Prokuroria e Përgjithshme si dhe institucione të tjera, nuk japin dokumentet, informacionet dhe të dhenat e nevojshme për të gjetur vend-varrosjen dhe kufomat e të pushkatuarve me gjyq e pa gjyq gjatë regjimit komunist, duke mos iu përgjigjur kërkesave të familjarëve dhe kërkesave që kanë bërë shoqatat e të burgosurve politikë të Shqipërisë. Një nga arësyet e mosdhënies së informacionit lidhur me këtë çështje nga institucionet që administrojnë dokumentacionin përkatës është edhe fakti i klasifikimit të këtyre dokumentacioneve si sekret sipas legjislacionit në fuqi. Në fakt Shoqatave u janë kërkuar të sjellin gjithë dokumentacionet përkatëse që kanë ato apo familjarët, por në fakt ato veç kërkesës, nuk kanë bashkëpunuar më tej.

Megjithëkëtë, institucioni i Avokati Popullit për zgjidhjen e kësaj çështje mjaft delikate ngriti një grup pune për mbledhjen e dokumentacionit, identifikimin e personave që kanë marrë pjesë në ekzekutimin e tyre si dhe marrjen takim me ta me qëllimin e vetëm gjetjen dhe identifikimin e eshtrave të të pushkatuarve gjatë regjimit komunist, duke i siguruar ata për ruajtjen e anonimatit.

Për këtë qëllim, një nga Komisionerët e Avokatit të Popullit ka vajtur në Shkodër dhe ka takuar një nga tre personat që janë gjallë dhe që ka marrë pjesë në ekzekutimin e të denuarve Tom Kol Ndoja dhe Sokol Zef Sokoli, të cilët janë ekzekutuar me pushkatim në Shkodër në orën 24.00 të dt.09.06.1984. Ata ishin denuar me vdekje me pushkatim si pjesëmarrës në revoltën e të burgosurve politikë të dt.22.05.1984 në burgun e Qafë-Barit në Rrethin e Pukës. Në takimin që Komisioneri i Avokatit të Popullit ka patur me shtetasin M. R. (njëri nga të ngarkuarit për pushkatimin e këtyre dy të denuarve), ka pohuar se ka marrë pjesë në pushkatimin e dy të denuarve në orën dhe datën e caktuar në periferi të qytetit të Shkodrës, brenda territorit të antenave të Radio Shkodrës, por ai është shprehur se nuk mbante mend vendin e saktë ku i kishin varrosur. Nga thënjet e këtij shtetasi, i cili ka punuar si punonjës i Policisë së Shtetit deri në vitin 2006, kemi mësuar se: territori i antenave të Radio Shkodrës në periferi të qytetit ka qënë për një kohë të gjatë vendi i caktuar për pushkatimin e të denuarve me vdekje dhe gjithnjë sipas tij atje ndodhen shumë kufoma. Kemi patur edhe rast tjetër, i cili sipas pretendimeve të vëllait të të pushkatuarit Xh.E.B., por edhe sipas procesverbalit të mbajtur në orën 24.10' të dt.09.09.1984, në vendin e caktuar Pylli i Sodës, që bën fjalë për ekzekutimin me pushkatim të shtetasit Xh.E.B., rezulton se ka qënë i pranishëm edhe ish Prokurori i Seksionit të IV, H.B. në Vlorë.

U thirr dhe u pyet zoti H.B., por ai sqaroi se sipas rregullave të asaj kohe edhe mund të ketë qënë i pranishëm, kishte dëshirë të ndihmonte në

rastin konkret familjarët, por vendin e saktë nuk e mbante mend. Veçse dinte se Pylli i Sodës në Vlorë ishte caktuar si vend ku kryheshin ekzekutimet e dënimeve me vdekje të gjykatës, por ai pyll tashmë ishte transformuar dhe bërë mjaft ndërtime.

Në këto kushte, me mjetet dhe personelin që aktualisht ka në dispozicion Institucioni i Avokati i Popullit e kishte dhe e ka të pamundur, i vetëm, zgjidhjen optimale të kësaj çështje sa delikate aq edhe njerëzore.

Ne mendojmë se është detyrim moral dhe ligjor për Qeverinë e Shqipërisë, që të respektojë dhe të realizojë në praktikë këtë të drejtë njerëzore të familjarëve të këtyre viktimave fatkeqe të komunizmit.

Jemi të bindur se ky proces do të lehtësojë sadopak dhimbjen shpirtërore të familjarëve të këtyre martirëve të fjalës së lirë.

Për sa më sipër, në fund të vitit 2009 kanë konkluduar për t'i paraqitur Qeverisë Shqiptare një projekt ligj që do të caktonte organet që do të merren me këtë detyrë kompetencat e tyre, mënyrën si do merren dokumentet nga arkivat, si do pyeten personat që kanë dijeni, garancia e privatësisë dhe jetës së tyre etj, me qëllim indentifikimin e vendeve të caktuara për ekzekutime të tilla, çvarrosjen e eshtrave të të pushkatuarve dhe meqënëse së afërmi bëhet e mundur edhe analiza e ADN-së në Shqipëri, të bëhet identifikimi i tyre dhe pastaj t'ju jepen familjarëve. Kuptohet se ky proces kërkon kohë dhe burime financiare të konsiderueshme.

- Në ankesën e dytë, ish të burgosurit dhe të persekutuarit politikë të regjimit komunist të Shqipërisë kundërshtojnë Ligjin Nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", si dhe aktet nënligjore dhe administrative të nxjerra për zbatimin e këtij ligji. Ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë të regjimit komunist të Shqipërisë pretendojnë se me këtë ligj janë përjashtuar padrejtësisht shumë persona nga dëmshpërblimi moralo-financiar.

Institucioni i Avokati i Popullit pas verifikimit të të gjitha pretendimeve të të burgosurve dhe të përndjekurve politikë të regjimit komunist, shyrimit të të gjithë paketës ligjore e nënligjore të nxjerra për ish të burgosurit dhe të përndjekurit politikë si dhe të Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", të akteve të tjera nënligjore e administrative të nxjerra për zbatimin e këtij ligji ka konstatuar se shumë të persekutuar politikë nga regjimi komunist janë përjashtuar padrejtësisht nga e drejta e dëmshpërblimit moralo-financiar. Prandaj Avokati i Popullit i është bashkuar nismës që ndërmorën një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9831 dt.12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve

politikë të regjimit komunist” dhe ka bërë rekomandimet e nevojshme për amendimet e domosdoshme të këtij ligji, si dhe përmirësimin e akteve nënligjore dhe administrative të nxjerra në zbatim të tij.

Megjithë amendimet që iu bënë Ligjit Nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” konstatojmë se akoma ka mangësi të cilat kanë sjell si pasojë përjashtimin padrejtësisht të disa ish të burgosurve dhe të përndjekurve politikë nga e drejta e dëmshpërblimit moralo-financiar.

Dëmshpërblimi i të burgosurve politikë nga rregjimi komunist përbëhet nga dy komponentë:

1. Dëmshpërblimi për punën e detyruar dhe të pa paguar sepse ata u dënuan me burgim dhe jo me punë të detyruar. Dihet tashmë se ish të burgosurit politikë të regjimit komunist i janë nështruar punës së detyruar dhe të papaguar në frontet më të vështira, ku një pjesë prej tyre edhe kanë humbur jetën. Dihen botërisht veprat e ndërtruara nga të dënuarit politikë të regjimit komunist shqiptar. Kështu që 200 000 lekët e marrë më parë nga të dënuarit që kanë vuajtur mbi 10 vjet burgim si dhe “letrat me vlerë”, shumica e të cilave të mbetura stoqe apo të vjedhura nga firma fantazmë si “Anglo-Adriatika”, “Fabiona” etj, janë dhe duhen llogaritur si dëmshpërblim për punën e papaguar, pasi ato janë dhënë duke marrë për bazë pagën e minatorit të asaj kohe.

- Të gjithë shtetasit shqiptarë shtëpitë shtetërore që kishin në përdorim i privatizuan me çmime simbolike. Përse ish të dënuarit politikë të regjimit komunist duhet t’i paguajnë ato më shtrenjtë se të tjerët? Ish i burgosuri politik ka lidhur një kontratë-shitblerje me Entin Kombëtar të Banesave dhe sipas kesaj kontrate Enti Kombëtar i Banesave çvishet nga pronësia mbi këtë apartament dhe pronar i këtij apartamenti behet bleresi (ish i burgosuri politik). Mënyrat e zgjidhjes së kësaj kontrate janë të parashikuara në Kodin Civil dhe nuk mund të zgjidhen nga askush tjetër pas afro 15 vjetësh. Sa për ilustrim. Në vitet 1994-1995 kur u ndanë falas këto apartamente për ish të burgosurit politikë, një apartament i tillë në treg në Tropojë apo në Delvinë kushtonte 150 000 lek, ndërsa sot ish të burgosurve ju mbahet vlera e plotë e apartamentit që i është falur. Kjo vlerë shkon në mbi 1 500 000 lek.

Gjithashtu, Avokati i Popullit prej vitesh ka rekomanduar edhe nxjerrjen e një ligji për kompensimin e pasurive të luajtshme të konfiskuara gjatë regjimit komunist. Nxjerrja e këtij ligji është një detyrim që rrjedh nga ligji në fuqi “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”. Duke qenë se një pjesë jo e vogël e ish pronarëve që ju janë konfiskuar pasuri të luajtshme janë njëkohësisht edhe të përndjekur politikë, nxjerrja e këtij ligji automatikisht është edhe në favor të të përndjekurve politikë.

2. Dëmshpërblimi për burgimin e padrejtë për të gjithë ata ish të dënuar politikë të regjimit komunist të cilët tashmë janë deklaruar të pafajshëm.

Megjithë amendimet e fundit që iu bënë Ligjit Nr.9831 datë 12.11.2007, të cilat për hir të të vërtetës duhen përshendetur sepse përmirësuan mjaft dispozita të cilat kishin sjellë si pasojë përjashtimin padrejtesisht të shumë burgosurve dhe të persekutuarve politikë nga e drejta e dëmshpërblimit moralo-financiar, akoma ka mangësi që mendojmë se duhen përmirësuar.

Duke patur parasysh nenin 2 paragrafi i dytë të Ligjit Nr.9831 datë 12.11.2007, në të cilin përcaktohet se dëmshpërblimi financiar, sipas këtij ligji, nuk përjashton marrjen e masave të tjera, të njëkohëshme ose të mëvonshme, ligjore apo administrative, në dobi të të persekutuarve e të burgosurve politikë të regjimit komunist, të cilat i shërbejnë rivendosjes së drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shtrese të masakruar apo krijimit të kushteve favorizuese për riintegrimin politiko-shoqëror të tyre, Avokati i Popullit mori në shqyrtim të gjitha pretendimet e ish të dënuarve politikë, ligjet si dhe aktet nënligjore e administrative të nxjerra nga institucionet shqiptare për dëmshpërblimin e tyre.

2.1. Zgjerimin e listës së veprave penale politike të përcaktuara në nenin 5 të ligjit në fuqi. Në Ministrinë e Drejtësisë ishin disa kërkesa nga ish të dënuarit për veprat penale që propozohen të shtohen dhe ky ndryshim mendojmë se është një hap pozitiv për këtë kategori ish të dënuarish politikë të regjimit komunist. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se të burgosurve politikë të regjimit komunist të cilët janë tashmë të deklaruar të pafajshëm, ju është zbritur një pjesë e konsiderueshme e dëmshpërblimit financiar që u takonte me pretendimin se përveç të tjerave janë denuar edhe si terrorist.

2.2. Sipas të dhënave të Institutit të të Përndjekurve Politikë rezulton se aktualisht nuk janë më shumë se 2000 ish të burgosur politikë të regjimit komunist që janë gjallë prandaj Avokati i Popullit i ka kërkuar qeverisë që të marrë masa të menjëhershme që të dëmshpërblehen menjëherë të gjithë ish të burgosurit politikë që janë gjallë. Ky rekomandim i Avokatit të Popullit, është pranuar dhe në dhjetor 2009 Qeveria ka nxjerrë Vendimin përkatës. Për këtë ish grevistët e urisë erdhën në zyrën tonë dhe na falenderuan, sepse Rekomandimi ynë u shërbeu si shkak për të ndërprerë grevën e urisë.

2.3. Avokati i Popullit rekomandon që të shtohen edhe të ekzekutuarit pa gjyq dhe t'u njihet e drejta e dëmshpërblimit financiar edhe familjarëve të kësaj kategorie. Pra një tjetër mangësi e ligjit aktual ishte edhe çështja e mostrajtimit dhe dëmshpërblimit të personave të arrestuar për motive politike dhe të vdekur në qelitë e sigurimit nga torturat çnjerëzore të kryera ndaj tyre nga hetuesit dhe prokurorët, si edhe të atyre

që kanë vdekur në burgjet ose kampet çfarosëse të punës së detyruar dhe të papaguar, nga uria, keqtrajtimi, sëmundjet, vetëvrasjet apo vrasjet që në fillim të vuajtjes së dënimit ose pa e plotësuar atë. Të vdekurit nga torturat në qelitë e hetuesisë dhe të sigurimit nuk arritën të dënoheshin dhe për pasojë rezultojnë të “padënuar”, pra të “vrrarë pa gjyq”. Si të tillë, familjarët e tyre nuk e gëzojnë të drejtën e dëmshpërblimit. Gjithashtu për të vdekurit në burgje, për arsyet që përmendëm, nuk është e drejtë që familjarët e tyre të dëmshpërblehen vetëm për tetë vite burgim, ndërkohë që familjarit të tyre i ka humbur jeta në rrethana të tmerrshme dhe një pjesë të tyre akoma nuk ju është gjetur varri. Ligji nuk bënte asnjë zgjidhje për këto raste.

2.4. T’u njihet e drejta e dëmshpërblimit moral e financiar edhe atyre personave që për shkak të përndjekjes politike nga strukturat kriminale të regjimit komunist, pësuan dëmtime të rënda të shëndetit mendor dhe u klasifikuan si të sëmurë psikikë. Ligji 9831 datë 12.11.2007, pa asnjë motivim dhe në kundërshtim me çdo normë humane dhe njerëzore, u ka mohuar këtyre personave të drejtën e dëmshpërblimit kësaj kategorie të përndjekurish politikë. Këta persona do të duhej të kishin përkujdesjen e veçantë e të drejtpërdrejtë të strukturave shtetërore. Kësaj kategorie të persekutuarish politikë Ligji Nr.7748 “Për Statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, në pikën a të nenit 3 me të drejtë i ka futur në një kategori me personat që kanë humbur jetën.

Ne mbështesim nismën që ka marrë Qeveria Shqiptare, në shkurt 2010 për ngritjen e Institutit të kujtesës kombëtare si dhe të Task-Forcës për gjetjen dhe identifikimin e vënd-varrosjes dhe të kufomave të mijëra shqiptarëve që janë ekzekutuar dhe akoma nuk ju është gjetur varri. Ne kemi qenë dhe jemi të gatshëm që të kontribuojmë në hartimin e një ligji të veçantë për këtë problem dhe për çështje të tjera që preokupojnë ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga regjimi komunist.

## 21. Zyra eksperimentale vendore në Shkodër

Nenseksioni i te Drejtave te Femijeve hapi Zyrën Rajonale te Avokatit te Popullit Shkoder si nje mekanizem të mbrotjes se te drejtave te femijeve ne Nentor te vitit 2006 ne baze te mareveshjes tripaleshe ndermjet Institucionit te Avokatit te Popullit, Save the Children Albania dhe SIDA. Qe nga kjo periudhe u arriten qe te rikonstruktohen dy ambjentet e Zyres Rajonale te Avokatit te Popullit duke i shnderruar ato ne ambjente te pershtatshme zyre dhe komode per mikpritjen si te qytetareve, ashtu dhe te femijeve ku sidomos keto te fundit te ndiheshin mire e komfort. Zyra Rajonale e Avokatit te Popullit arriti vizibilitetin e saj jo vetem tek qytetaret per sherbimet qe ofronte, por edhe tek femijet

dhe nxenes dhe stuktura lokale qe trajtojne ceshtjet e femijeve, duke i ndergjegjesuar ato per te drejtat e femijeve dhe rigorizitetit te zbatimit te te drejtave te femijeve.

Pas perfundimit te kontrates se aktoreve te mesipërm, në vitin 2008 Zyra Rajonale e Avokatit te Popullit ka vazhduar funksionimin e saj si zyrë eksperimentale ne saje te urdherit te Avokatit te Popullit dhe emerimit te Z. Alfred Koçobashi edhe si Perfaqesues i Zyres Rajonale te Avokatit te Popullit në Shkoder si dhe kontributit vullnetar te Avokates private Anilda Gurakuqi, duke vazhduar te ruaje imazhin e ngritur me perpara te kesaj zyre ne funksion te mbrojtjes se te drejtave te qytetareve ne pergjithesi dhe femijeve ne veçanti.

Avokati i Popullit duke vlerësuar mikpritjen dhe aktivitetin pozitiv të institucioneve vendore të Qarkut Shkodër, që ka rreth 4 vjet që këto kanë lejuar pa shpërblim mbajtjen e dy zyrave në dispozicion si dhe nevojën për të eksperimentuar në këtë drejtim, lejoi funksionimin e saj, si eksperiment duke caktuar Z. Koçobashi që një ditë pune në javë të jetë atje. Nënvizojmë se zoti Koçobashi është gjithashtu i emeruar ndihmeskomisioner ne Njesine Kombetare te Parandalimit te Tortures ne Shqiperi prane Institucionit te Avokatit te Popullit Tirane, mekanizem i cili u krijua ne Janar 2008.

Zyra Rajonale e Avokatit te Popullit është lejuar të gezojë statusin e Ombudsmanit te Femijeve ne Rajonin Shkoder. Ajo perfaqesohet me logon e veçante te Zyres tonë dhe eshte pjese e Rrjetit Rajonal te Ombudsmaneve dhe Ombudsmaneve te Europes Juglindore me statusin e observuesit.

Aktivitetet kryesore që ka kryer kjo zyrë në Shkoder, në koordinim me partnere te ndryshem janë fokusuar në:

- Promovimi i te drejtave te femijeve;
- Ndergjegjesim masiv me nxenes te shkollave publike si ne zona rurale dhe urbane rreth sherbimeve per te rinjte ne konfikt me ligjin;
- Bashkëpunime nderinstitucionale për zbatim te te drejtave te femijeve.



Ne kete fryme kjo zyrë në Shkoder ne rolin e mediatorit dhe koordinuesit, ka mbeshtetur dhe mbeshtet cdo nisme te ardhur si nga organizmat qeveritare, ashtu dhe organizata qe fokusohen ne ceshtjet e femijeve ne fushen e mbrojtjes se te drejtave familjare,civile e penale te femijeve dhe qe



premtojne per nje ndryshim pozitiv te situates se zbatimit te drejtave te femijeve ne Rajon.

Gjate gjithë funksionimit te zyres rajonale te Avokatit te Popullit, por edhe qe ne fillimin e konsolidimit te Nenseksionit te Drejtave te Femijeve prane saj i eshte kushtuar nje rendesi e veçante funksionimit te pritjes se ankesave te popullit ne çdo kohe, me kulture e profesionalizem.

Me ndihmën e Këshillit të Qarkut Shkoder nje rendesie e veçante ju kushtua krijimit te dy ambjenteve te zyrave, njeri ku qytetaret kane qene te mirepritur per te adresuar ankesa ndaj organeve te administrates publike por jo vetem dhe tjetra e arregtuar ne menyre miqesore ku femijet te ndihen mire dhe konfident per te bere ankesat e tyre ne rastet e shkeljes se drejtave te tyre.

E rendesishme eshte qe te theksohet se hapja dhe funksionimi i kesaj zyre eshte shume me vlere dhe i vjen ne ndihme te gjithë qytetareve te Qarkut Shkoder, duke i lehtesuar atyre udhëtimin gjer ne Tirane nëse kanë nevojë për Institucionin Qendror te Avokatit te Popullit.



Per t'i ardhur ne ndihme qytetarëve eshte instaluar prane zyres Rajonale edhe kutia postare ku qytetaret mund te drejtojnë ankesa.

Në këtë zyrë rajonale jane marre ankesat prej qytetareve ne baze te formularit tip qe plotesohet, por gjithashtu edhe priten qytetarët edhe kur ato kerkojne thjesht konsulence ligjore per problemet e tyre dhe keshillohen e orientohen drejt zgjidhjeve optimale.

Gjate vitit 2009 jane pritur 138 ankesa të qytetareve qe i drejtohen Avokatit te Popullit me pretendimet per shkeljen e drejtave te tyre nga institucionet publike. Nga këto 14 jane ankesa me objekt shkeljen e te drejtave te te miturve. Për konsulencia ligjore janë 58 kërkesa.

Gjate gjithë vitit 2009 ankesat nga qytetaret per shkelje te te drejtave te tyre jane me se shumti te fokusuara per: Probleme me Policine Ndertimore; Zyren e Strehimit Bashkia Shkoder; Zyrat e Ndhimes Ekonomike ne Rajone; Zyra e Gjendjes Civile; Mosekzekutim te vendimeve gjyqesore; Kesh-in; me Prokurorine; ne lidhje me Pagesat e Kempeve; konflikte ne Gjykate; ne lidhje me rivleresime te pensionit te pleqerise; konflikteve dhe dhunes se ushtruar nga Komisarariatet; ne lidhje me çeshtjet e divorcit ne Gjykate etj; probleme me pronat etj. Të gjitha këto ankesa janë pritur në Shkodër dhe janë trajtuar nga zyra në Tiranë.

Në përshtatje me këto ankesa janë edhe Institucionet a po organet e pushtetit lokal ndaj të cilave jane adresuar ankesat.

Gjate kesaj periudhe eshte karakteristike fakti se jane depozituar ankesa kolektive nga ana e qytetareve per probleme te tyre dhe se ndergjegjesimi publik per te bere ankesa kolektive dhe per t'i u drejtuar Zyres se Avokatit te Popullit ka ardhur ne rritje. E njejta gje edhe per ankesat me objekt shkeljen e te drejtave te femijeve.

Ankesat me objekt shkeljen e te drejtave te te femijeve jane kryesisht njëlloj me ato të trajtura në pjesën e këtij raporti ku flitet për fëmijët.

Por Zyra Rajonale eksperimentale e Avokatit te Popullit në Shkoder perveç rolit si monitorues ka qënë edhe si mediator i frymes e nismave qe vijne nga shoqeria civile për ndergjegjesimin qe behet ne nivelet e shkollave. Me anë të Qeverive te Nxenesve dhe pjesëmarrjen e stafit te shkollave. Ne te gjitha aktivitetet e ndermarra synohet qe vete femijet te edukohen dhe të mësojnë qe te adresojne vete ankesa ne rastet e shkeljes se te drejtave te tyre.

Pergjate gjithe vitit 2009 eshte mbajtur parasysh qe ne realizimin e këtij qellimi te vendosen maredhenie te drejta dhe bashkpunimi me te gjithë institucionet e nivelit lokal pergjegjese per zbatimin e te drejtave te femijeve, por gjithashtu edhe me shoqerine civile te fokusuar ne te njejten fushe.

Eshte vene re nje predispozite nga te gjithë aktoret e administrës publike dhe organet e drejtësisë qe te mbeshtetin Zyren Rajonale në Shkoder ne rolin e saj.

Gjate vitit 2009 jane zhvilluar disa aktivitete me nxenes te Qeverive te Nxenesve në disa shkolla në Qytetin e Shkodrës, si shkollat 9-vjeçare “Ismail Qemali”, “Ali Laçej”, “Ndoc Mazi”, “Mati Logoreci” etj.

Qellimi i ketyre takimeve ishte njohja e ketyre femijeve me insitucionet si Gjykata dhe Prokuroria,si procedohet ne ceshtjet civile,familjare dhe penale nga gjykatesi apo prokurori, Avokati mbrojtës apo psikologu, te drejtat dhe detyrimet e femijeve ne baze te Konventes se te Drejtave te Femijeve dhe njohja me Zyrën e Avokatit te Popullit ne



Shkoder si nje organ monitorues i te drejtave te femijeve dhe mundesine qe kishin vete femijet per te drejtuar ankesa me objekt shkeljen e te drejtat e femijeve.

Keto takime u zhvilluan edhe me perkrahjen e DAR Shkoder dhe organizmat e shoqerise civile qe japin kontributin e tyre ne fushen e te

drejtave te femijeve.



Gjithashtu më datën 23.11.2009 Zyra Rajonale në bashkëpunim me DAR dhe Bashkia Shkoder organizoi një aktivitet sensibilizues me nxenes përfaqësues të Qeverive të Nxenesve në javën e Përvjetorit të Konventës së Drejtave të Femijëve. Në takim ishin pjesëmarrës të qeverive të nxenesve të disa

shkollave publike 9 vjeçare.

Gjatë vitit 2009 janë organizuar dhe 2 tryeza të rrumbullaketa me pjesëmarrjen e institucioneve më të rëndësishme të nivelit lokal të cilat janë përgjegjëse për garantimin e të drejtave të femijëve për të diskutuar problematikën dhe për të dhënë sugjerime për një ndryshim të situatës së drejtave të femijëve.

Në këto takime morën pjesë aktivisht punonjës të policisë së shtetit, gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkoder, prokurore e Prokurorisë së Rrethit Shkoder, avokate, psikolog, punonjës social që trajtojnë çështjet e të femijëve etj. Gjatë këtyre tryezave u bë e mundur shkëmbimi i eksperiencave të këtyre pjesëmarrësve.



Gjithashtu për të monitoruar situatën e zbatimit të të drejtave të femijëve në Qarkun Shkoder zyra Rajonale ka bashkëpunuar ngushtë me Observatorin e të Drejtave të Femijëve, iniciative kjo e fundit ndërmjet Unicef dhe Aleancës së Femijëve si një mekanizëm shkencor për hedhjen e të dhënave sipas treguesve të Konventës së Drejtave të Femijëve. Cdo e dhënë e shkëmbyer ka shërbyer për të kuptuar situatën e zbatimit të të drejtave të femijëve dhe për të lobuar e advokuar që këto të drejta të zbatohen. Gjatë gjithë vitit 2009 në aktivitetet që ka ndërmarrë Zyra vendore janë ftuar jo vetëm mediat kryesore të qytetit të Shkodrës, por edhe ato që i përkasin qyteteve përreth.

Kjo ka qenë pozitive edhe në adresimin e ankesave të ndryshme gjatë reportazheve që ato kanë realizuar.

Duke patur parasysh përvojën e kësaj zyre eksperimentale, me kalimin e kohës do të studjohet mundësia që në bashkëpunim me Kuvendin dhe Qeverinë, në vartësi të mbështetjes financiare që mund të na jepet, ta forcojmë këtë zyrë duke e bërë të përhershme dhe gjithashtu të hapin edhe ndonjë zyrë tjetër, atje ku do të vlerësohet më e nevojshme.

## KREU IV

### 1. E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative

Në nenin 24 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit” parashikohet e drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative. Në këtë dispozitë përcaktohet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkakua që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

a. t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;

b. t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

c. të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla”.

Qysh nga fillimi i veprimtarisë në qershor të vitit 2000 deri në fund të vitit 2009, institucioni ynë e ka përdorur shpesh herë këtë të drejtë, kur ka konstatuar gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave apo njoftimeve se janë kushtet e mësipërme për të bërë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit. Është e qartë se nga ndryshimi i një ligji apo akti nënligjor me karakter normativ (jo individual, për një person të caktuar) rregullisht përfiton jo vetëm personi i caktuar që ankohet, por përfitojnë të gjithë personat që kanë të bëjnë me marrëdhëniet që rregullon ligji apo akti nënligjor i nxjerrë, ndryshuar, shfuqizuar apo përmirësuar me rekomandim të Avokatit të Popullit. Që këtë del rëndësia e madhe e përdorimit të këtij mjeti pune nga Avokati i Popullit.

Siç del nga Pasqyra nr.1, gjatë periudhës 2000-2009 janë bërë 69 rekomandime drejtuar organeve që kanë të drejtën ligjvënëse (deputetëve të Kuvendit, Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë) që të bëjnë ata propozime për ndryshime apo përmirësime të ligjeve. Për vitin 2009 janë bërë 12 rekomandime të tilla, nga te cilat, 8 jane pranuar, asnje nuk eshte refuzuar dhe 4 jane ne shqyrtim. Nga 69 rekomandime janë pranuar 53 që kanë rezultuar me 32 ndryshime apo përmirësime të ligjeve; 21 janë në fazën e projektit për miratim në Kuvend apo ne Qeveri; 9 janë refuzuar dhe 7 jane ne shqyrtim apo pa përgjigje zyrtare.

Në Pasqyrën nr.2 janë pasqyruar rekomandimet për ndryshime apo plotësime të akteve nënligjore normative që ka në kompetencë të nxjerrë Këshilli i Ministrave (Qeveria) për periudhën 2000-2009. Nga 48 rekomandime janë pranuar 45, që kanë rezultuar 32 me ndryshime, përmirësime apo nxjerrje të akteve nënligjore nga Qeveria; 13 janë në fazën e projektit; 1 është refuzuar dhe 2 janë pa përgjigje zyrtare. Për vitin 2009 janë bërë 9 rekomandime të tilla, nga te cilat, 7 janë pranuar, asnjë nuk është refuzuar dhe 2 janë në shqyrtim apo pa përgjigje zyrtare.

Kurse në Pasqyrën nr.3 janë pasqyruar rekomandimet për ndryshime apo plotësime të akteve nënligjore normative në kompetencë të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore. Nga 51 rekomandime janë pranuar 44, nga të cilët për 35 janë bërë ndryshimet apo përmirësimet; 9 janë në fazën e projektit; 3 janë refuzuar, kurse 4 janë pa përgjigje. Për vitin 2009 janë bërë 7 rekomandime të tilla, nga te cilat, 3 janë pranuar, 1 është refuzuar dhe 3 janë në shqyrtim apo pa përgjigje zyrtare.

Në përfundim, nga 168 rekomandime, propozime apo kërkesa me karakter legjislativ janë pranuar deri tani gjithsej 142 prej tyre, ose rreth 84,5 %. Mund të themi se rezultatet janë të kënaqshme, sepse nga 142 të pranuarat, për 99 prej këtyre rekomandimeve janë bërë ndryshimet apo përmirësimet e ligjeve apo akteve nënligjore. Kurse 43 rekomandimet e tjera janë në proces realizimi. Për lehtësi studimi, të gjithë rekomandimet e bëra dhe ndryshimet e realizuara gjatë vitit 2009 janë shënuar me gërma të zeza.

**Evidenca e rekomandimeve per plotësime apo ndryshime te ligjeve te Kuvendit te Shqipërisë  
Per periudhen 2000-2009**

<b>Nr</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Permbajtja e rekomandimit</b>	<b>Kujt i drejtohet</b>	<b>Data e dergimit</b>	<b>Përfundimi</b>
<b>1</b>	Ankesa e 70 ish ushtarakëve të larguar nga detyra.	Rekomandim: “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8087 datë 13.03.1996 <i>“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve në F.A. të Republikës së Shqipërisë e konkretisht nenin 19/1 për ndryshimin e termit “braktisje në detyrë”.</i>	Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes në Kuvend, i cili mori inisiativën legislative.	16.03.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 8948 datë 03.10.2002, i cili bëri ndryshimet në nenin 19/1, sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit.
<b>2</b>	Ankesa e shtetasit K.D.	Rekomandim: “Për iniciimin e nxjerrjes së një ligji për rregullimin e simboleve fetare në shkollat publike”	Kryeministrit. Ministrit të Arsimit dhe Shkencës	26.04.2001	Ministri i Arsimit ka pranuar që të nxjerrë një udhëzim për të rregulluar këtë problem, por deri tani nuk është nxjerrë.
<b>3</b>	Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit	Rekomandim: “Ndryshimi i Ligjit Nr.8435 datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me taksën për rregjistrimin vjetor të automjeteve dhe taksën për aks	Ministresë së Transporteve, Ministresë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.	20.07.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 8840 datë 11.11.2001 që rriti përqindjen e D.P.T. Rrugor si agjent tatimor në 20 përqind, duke ndryshuar nenin 4 të ligjit.
<b>4</b>	Ankesa të ish pronarëve	Rekomandim: “Propozohen ndryshime në Ligjin nr. 7665 datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, për shfuqizimin e neneve 7/ç dhe 13 të tij.	Komisionit të Ligjeve, ekonomisë e financave në Kuvend. Ministrit të Turizmit e Rre-	12.10.2001	Rekomandimi është pranuar. Shfuqizuar me nenin 30 të Ligjit Nr. 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin e

			gullim Territorit		kompesimin e pronës”.
5	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr. 8097 datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.	Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Komisionit parlamentar të çështjeve kushtetuese dhe ligjeve.	14.12.2001 Përsëritur në datën 06.03.2003	Rekomandimi është pranuar në parim, por nuk është miratuar në ndryshimet që i janë bërë ligjit.
6	Ankesa të shtetasit J.L.	Rekomandim: “ Për ndryshimin e nenit 6, pika 2 të Ligjit Nr. 8360 datë 10.06.1998 “Për kriteret dhe mënyrat e shpërndarjes të pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjërë”.	Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve e Çështjeve Sociale. Komisionit Parlamentar për Punën dhe Çështjet Sociale	14.12.2001	Pa përgjigje.
7	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “ Dërgohen propozime për marrjen e nismës ligjvënëse lidhur me përmirësimet e ndryshime të akteve ligjore e nënligjore për përfundimin e procesit të rivlerësimit e rishpërndarjes së pasurisë së ish kooperativave bujqësore si dhe, ndryshime në Ligjin Nr. 8435 datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”	Ministrit të Bujqësisë. Ministrit të Financave. Kryeministrit.	26.12.2001	Pa përgjigje.
8	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim: “Për rregullimin ligjor të punës jashtë orarit dhe shërbimit 24 orësh”.	Ministrit të Mbrojtjes	2001	Rekomandimi është pranuar dhe rregulluar me nenin 31 të Ligjit “Për statusin e ushtarakut” dhe mbi këtë bazë dhe

					me rregullore të Ministrisë së Mbrojtjes.
9	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për përgatitjen e Ligjit “Për zhdëmtimin e personave të dëmtuar”, në zbatim të nenit 44 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.	Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë	24.12.2001	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Doli Ligji Nr. 9381 datë 28.04.2005 “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”.
10	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për zbatimin e nenit 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare dhe miratimin e tyre në Kuvendin e Shqipërisë”.	Dërguar të gjithë Kryeministrave.	16.01.2002 Përsëritur në 09.12.2005	Rekomandimi është pranuar. Është lidhur marrëveshja me Komunitetin Katolik nëpërmjet Ligjit Nr. 8902 datë 23.05.2002. <b><i>Ne datën 24.10.2008 u nënshkruan marrëveshjet me Komunitetin Mysliman, Orthodhoks dhe ate Bektashian. Keto marrëveshje u ratifikuan nga ana e Kuvendit të Shqipërisë perkatesisht me ane te miratimit te Ligjeve nr.10056 dt.22.01.2009, nr.10057 dt.22.01.2009, nr.10058 dt.22.01.2009.</i></b>
11	Ankesa nga Shoqata e të	Rekomandim: “Për domosdoshmërinë e ndryshimit të Ligjit Nr. 8098 datë 28.03.1996	Zv/Kryeministrit dhe Ministrit të	02.04.2002	Rekomandimi është pranuar në parim. Eshte miratuar strategjia kombëtare për personat me aftësi të



	Verbërve	“Për statusin e të verbrit”.	Punëve e Çështjeve Sociale		kufizuara, me ane te VKM nr. 8 dt.7.01.2005 “Strategjia Kombetare per personat me aftesi te kufizuar”. Ne vazhdim ka dale VKM nr.1325 date 1.10.2008 “per nje ndryshim ne VKM nr.277 date 18.06.1997 “Per perfitimet nga statusi i te verberit”, i ndryshuar”.
12	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për bërjen e disa ndryshimeve në Ligjin Nr. 8388 datë 05.08.1998 “Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake”	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit.	16.04.2002	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Kuvendi zgjati afatin e veprimit të Ligjit, duke miratuar Ligjin Nr. 9018 datë 06.03.2003 “Për mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake”
13	Banorë të komuniteteve në Tiranë, Durrës dhe Librazhd	Rekomandim: “Për përgatitjen sa më shpejt të projekteve për plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga rrezatimet jo jonizuese të telefonisë celulare”.	Ministrit të Mjedisit. Ministrit të Shëndetësisë. Ministrit të Drejtësisë.	13.05.2002 Përsëritur në dt. 27.10.2004	Është kthyer përgjigje nga Ministritë. Po përgatitet nje draft i ri nga Instituti i Fizikes Berthamore, por akoma nuk eshte paraqitur në Qeveri.
14	Ankesa e shtetasit B.I.	Rekomandim: “Për një plotësim në Ligjin Nr. 7710 datë 18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, lidhur me parashikimin e procedurës së ankimit administrativ kundër	Zv/ Kryeministrit dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shan-	09.05.2002	Rekomandim është pranuar dhe zgjidhur me nenin 25 të Ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën

		vendimeve të seksioneve përkatëse të Bashkive apo Komunave”.	seve të Barabarta		dhe përkujdesin shoqëror”.
15	Ankesa e shtetasit Th.K	Rekomandim: “Për ndryshimin e e ligjit Nr. 7889 datë 14.02.1994 “ <i>Për statusin e invalidit</i> ” për përfitimin e një shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit, për të gjithë të aksidentuarit gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak”.	Zv.Kryeministrit Ministrit të Mbrojtjes	12.06.2002	Rekomandimi është pranuar dhe problemi është zgjidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
16	Konferenca Kombëtare Dhjetor 2001	Rekomandim: “ Mbi masat që duhen marrë për zbatimin e Rekomandimeve të Konferencës Kombëtare “ <i>Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës</i> ”, që të krijohet një organizëm shtetëror për të kontrolluar gjakmarrjen etj.	Kryeministrit, disa ministrave	10.09.2002	Rekomandimi u pranua. Doli Ligji Nr. 9389 datë 04.05.2005 “Për Këshillin Koordinativ për luftën kundër gjakmarrjes”
17	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për marrjen e masave për të realizuar ndryshimin e Ligjit Nr. 5840 datë 20.02.1979 “ <i>Për rregjistrimin e akteve të gjëndjes civile</i> ”, me qëllim çrregjistrimin e personave të vdekur nga listat e zgjedhësve”.	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit	11.09.2002	Rekomandimi u pranua. Neni 57/7 i Ligjit nr.8950 datë 10.10.2002 i lejon zyrat e gjendjes civile të zgjidhin problemin duke ju drejtuar vetë gjykatës.
18	Ankesa të ish pronarëve	Rekomandim: “Të përshpejtohet procesi legjislativ në bazë të nenit 181 të Kushtetutës për miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë problemet e pronësisë, mosdhënien e titullit “ <i>person i stimuluar në fushën e</i>	Kryetarit të Kuvendit. Komisioneve Parlamentare dhe Qeverisë.	19.09.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 9 datë 03.10.2002, e cila i kërkoi Qeverisë dhe organeve të qeverisjes vendore që deri në

		<i>turizmit</i> ”, ndalimin e tjetërsimit të pronës shtetërore të rregjistruar dhe bllokimin e privatizimit apo të dhënies me qera të objekteve shtetërore dhe trojeve të tyre”			hartimin e projektligjit të ri “Për kthimin e Kompesimin e pronave” të ndërpritet tjetërsimi dhe dhënia me qera e pronave shtetërore.
19	Ankesat e ish pronarëve	Rekomandim: “Për masat që duhen marrë në zbatim të neneve 41/1 dhe 181/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë”, me qëllim rregullimin e drejtë dhe përfundimtar të çështjes së pronave.	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit.	19.09.2002	Rekomandimi u pranua. Dolën ligjet Nr. datë 29.07.2004, Nr. 9388 datë 04.05.2006 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”.
20	Ankesat e ish pronarëve	Rekomandohet të merret në konsideratë Vendimi nr.26 datë 24.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese në projektligjin “Për kthimin dhe kompensimin e ish pronarëve”	Kryetarit të Kuvendit. Komisioneve parlamentare në Kuvend	28.10.2002	Rekomandimi u pranua. Neni 8/2 i ligjit nr.9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish pronarëve”
21	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: Për plotësimin e Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.	Komisionit të Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvend, i cili mori iniciativën legjislative.	25.11.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 9071 datë 22.05.2003 Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajnimin e të dënuarve me burgim”
22	Njoftimi i zotit Pjetër Arbnori	Rekomandim: “Për përmirësimin e nenit 4 të Ligjit Nr. 8292 datë 25.02.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”, sepse nuk lejohet hetimi i policëve që bëjnë pjesë në këto forca, kur akuzohen për vepra	Komisionit të Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvend, i cili mori iniciativën	26.11.2002 Përsëritur në 2006	Nuk u miratua projektligji në seancë parlamentare. Është ribërë propozimi, drejtuar Komisionit të Ligjeve dhe Sigurisë Kombëtare si dhe në projektligjin “Për Policinë e

		penale.	legjislative dhe e paraqiti në Kuvend.		Shtetit”. Me ligjin nr.9748 date 4.06.2007 “Per Policine e Shtetit”, neni 4 eshte lene ne fuqi.
<b>23</b>	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: “Për plotësimin e Ligjit Nr. 8609 datë 08.05.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë” për t’u mundësuar gjithë të dënuarve që të votojnë në zgjedhjet për pushtetin vendor.	Komisionit Bipartizan në Kuvend.	13.02.2003 Përsëritur në datën 20.10.2006	Kerkesa ju drejtua Gjykatës Kushtetuese me dt.23.02.2007, e cila me vendimin e saj nr.40 dt.16.11.2007 e rrezoi kete kerkesë.
<b>24</b>	Ankesa e shtetasit S.H.	Rekomandim: “Për zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore”, ku është propozuar “Ndryshimi i nenit 59 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.03.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.	Kryeministrit. Ministrit të Punës e Çështjeve Sociale. Komisionit Parlamentar të Punës e Çështjeve Sociale.	23.09.2003.	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 977 datë 21.04.2005 “Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, neni 18.
<b>25</b>	Ankesa nga shtetas dhe shoqata	Rekomandim: “ Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8087 datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror”.	Kryeministrit	19.11.2003	Rekomandimi është pranuar. Zgjidhur me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të F.A. të Republikës të Shqipërisë”. Neni 14 pika 6 e tij.

26	Një numer i madh të dënuarish që vuajnë dënimet në burgje.	Rekomandim: “ Propozohet ndryshimi në Ligjin nr. 7941 datë 31.01.1995 për hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 7895 datë 27.01.1995 “Për Kodin Penal në Republikën e Shqipërisë”.	Komisionit të të Drejtave të Njeriut në Kuvend. Një grup deputesh morën inisiativë legislative.	20.11.2003 Përsëritur në datën 08.03.2006	Ne seancen plenare te dates 14.06.2007, Parlamenti ka diskutuar ndryshimet e rekomanduara, te cilat nuk u miratuan.
27	Ankesa e ish gjeneralit Y. D.	Rekomandim: “Bërja e një statusi të veçantë për ushtarakët madhorë duke u nisur nga rasti i ish gjeneralit Y.D”.	Ministrit të Mbrojtjes	24.03.2004	U mor parasysh në ndryshimet e Ligjit Nr. 9171, datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA të R. Shqipërisë dhe konkretisht Pika 2 e nenit 22 ku thuhet: “Statusi i gjeneralëve pas daljes së tyre në rezervë/lirim rregullohet me VKM. Doli VKM Nr. 542 datë 12.08.2004 “Për statusin e ushtarakut me gradë madhore në FA pas daljes në lirim”.
28	Me inisiativë të Avokatit të Popullit	Rekomandohet plotesimi i legjislacionit që mungon dhe kontrolli i atij ekzistues, në lidhje me ndotjet elektromagnetike që rrezikojnë shëndetin e njerezve.	Ministrit të Mjedisit Ministrit të Shëndetësisë Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, etj.	28.10.2004	Rekomandimi u pranua. Eshtë miratuar dhe ka hyre në fuqi Ligji nr.9973 date 28.07.2008 “Për disa ndryshime të Ligjit nr.8025 date 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet”.

<b>29</b>	Ankesa të ndryshme	Rekomandim: “Për plotësimin e nenit 28 të Ligjit “ <i>Për Statusin e Ushtarakut</i> ”.	Ministrisë së Mbrojtjes	03.11.2004 Perseritur ne date 17.06.2008	Rekomandimi u pranua si i drejtë. Pas perseritjes se tij ne daten 17.06.2008, Ministria e Mbrojtjes ka konfirmuar se çeshtjet perkatese do te zgjidhen rast pas rasti me VKM.
<b>30</b>	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Propozime për përmirësimin e Kodit Zgjedhor”, me qëllim që numurimi i votave në çdo zonë elektorale të bëhet nga tre gjyqtarë.	Bashkëkryetarëve të Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore	22.11.2004	Rekomandimi nuk është pranuar.
<b>31</b>	Ankesa e shtetasit D.M.	Rekomandim: “Për plotësimin e nenit 40 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “ <i>Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë</i> ”, me qëllim përfitimn e pensionit familjar pas vdekës së bashkëshortit, nga bashkëshortja ose bashkëshorti student nën moshën 25 vjeç	Komisionit të Ligjeve në Kuvend. Institutit të Sigurimeve Shoqërore.	28.01.2005 16.03.2005	Rekomandimi nuk është pranuar.
<b>32</b>	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Rekomandim: “Propozim për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9209 datë 22.03.2004 “ <i>Për legalizimin e shtesave në ndërtim</i> ” për të thjeshtuar procedurat e legalizimeve dhe për të ulur masën e gjobave.	Kryeministrit. Komisionit parlamentar të Ligjeve, e Komisionit për Veprimtaritë Pro-	16.03.2005 Përsëritur më datën 16.09.2005	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr.9482 datë 16.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejë”, ku është

			dhuese, Tregëtisë e Mjedisit.		përfshirë edhe rekomandimi i Avokatit të Popullit.
33	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, plotësuar më ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000 “Për Avokatin e Popullit”.	Kryetari të Kuvendit. Mori iniciativë një grup deputetësh	01.04.2005	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 9398 datë 12.05.2005.
34	Shoqata Uniteti Kombëtar	Rekomandim: “Për zhbllokimin e situatës së krijuar nga mosfutja në përdorim e letrave me vlerë dhe bonove të privatizimit”	Kryeministrit. Ministrit të Financave. Ministrit të Ekonomisë dhe Energjetikës.	12.10.2005	Rekomandimi u pranua. Doli ligji Nr.9516 datë 18.04.2006
35	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Propozim për një ndryshim në Ligjin Nr.8436 datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për të caktuar afate për qëndrimin në detyrë të kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të gjykatave.	Kryetares së Kuvendit. Kryetari të Komisionit për çështjet ligjore Kryeministrit	08.11.2005	Rekomandimi është pranuar. Eshte perfshire në ligjin “Për disa ndryshime në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i cili është miratur më datën 18.02.2008.
36	Grup Shoqatash	Rekomandim: “Për ndërmarrjen e iniciativës ligjore për parashikimin ligjor të termit “Taksë e drejtpërdrejtë” në Ligjin nr. 8977 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” si dhe në Ligjin nr. 8982 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendor”, për cilësimin ligjor të llojeve të “taksave vendore të drejtpërdrejta” për efekt të përjashtimit të veteranëve të luftës, invalidëve dhe të të verbërve”.	Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm, Komisionit të Financës dhe Buxhetit në Kuvend.	23.11.2005	Rekomandimi u pranua në parim, por nuk është përfshirë deri tani në ligjet e miratuara.

37	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së nenit 86 të <i>Kodit Penal</i> , për veprën penale të “ <i>torturës</i> ”.	Ministrit të Drejtësisë.	16.12.2005	Rekomandimi u pranua. Me Ligjin nr.9686 dt.26.02.2007 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7895 dt.27.1.1995 “Kodi Penal”, i ndryshuar, u be ndryshimi i nenit 86 te Kodit Penal, sipas rekomandimit tone.
38	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për marrjen e iniciativës për rregullimin ligjor të ndërtimeve të objekteve fetare”.	Kryeministrit Ministrit të Punëve Publike etj.	28.12.2005	<i>Ne dispozitat e Ligjit nr.10119 date 23.04.2009 “Per planifikimin e territorit”,te miratuar nga Kuvendi i Shqiperise, nuk eshte parashikuar ky rregullim, por jane pasqyruar rekomandime tonat te meparshme, per dispozita te tjera te Ligjit “Per urbanistiken”.</i>
39	Ankesa nga Shoqata joqeveritare	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit Nr. 8950 datë 10.10.2002 “ <i>Për Gjëndjen Civile</i> ” ndryshuar më Ligjin Nr. 9029 datë 13.03.2003 dhe Ligjin nr. 9229 datë 29.04.2004” për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar.	Ministrit të Brendshëm. Kryeministrit.	12.07.2006	Rekomandimi u pranua. Me Ligjin nr.9929 dt.28.06.2008 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.8950 dt.10.10.2002 “Per gjendjen civile”, i ndryshuar, jane bere ndryshimet e kerkuara.
40	Me iniciativën	Rekomandim: Për projektligjin “ <i>Për pagat</i> ,	Kryetarit të Ko-	13.07.2006	Nuk u pranua nga Qeveria dhe Kuvendi.



	e Avokatit të Popullit	<i>Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj</i> ”.	misionit të Çështjeve Ligjore. Grupeve Parlamentare		Pas ankimimit ne Gjykatën Kushtetuese, me vendimin e saj nr.19 date 3.05.2007 është vendosur shfuqizimi i disa neneve të Ligjit nr.9584 date 17.07.2006 “Për pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” sipas kërkesës tonë.
41	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: Për plotësimin e Ligjit Nr. 9087 datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, për të rregulluar tre çështje: votimi i të burgosurve në zgjedhjet lokale, ndalimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatat elektorale dhe zgjedhja e zëvendës kryetarit të komunës apo bashkisë direkt nga populli, njëlloj si kryetarët.	Bashkëkryetarëve të Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore.	20.10.2006	Për të burgosurit shih pikën 23 të kësaj pasqyre. Për dy propozimet e tjera nuk ka përgjigje zyrtare.
42	Koalicioni për barazi gjinore	Rekomandim: “ Për parashikimin në Kodin Zgjedhor të kuotave jo më pak se 30% për pjesëmarrjen e grave në politikë”.	Bashkëkryetarëve të Komisionit për Reformën Zgjedhore.	25.10.2006 Perseritur ne 4.07.2008	Rekomandimi është pranuar. Është përfshirë në nenin 15 të Ligjit nr.9970 date 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
43	Ankesa e	Rekomandim për plotësimin në Ligjin	Ministrit të Finan-	8.01.2007	Rekomandimi u pranua në parim nga Ministria e Finan-

	shtetasit O.Xh.	nr.9588 date 25.07.2006 “Per rillogaritjen e pensioneve”, i cili do te mundesoje trajtimin e kategorise se pensionistëve te periudhes Tetor-Dhjetor 1993, qe eshte perjashtuar per trajtim nga ky ligj	ncave. Ministrit te Punes, Çesht-jeve Sociale e Shanseve te Barabarta		cave. Por pas nje ekspertize konkrete per rillogaritjen e mundshme per efekt te ndryshimit te ligjit, ka rezultuar se nuk do te kishte ndonjë efekt ne rritjen e pensionit per pensionistet që mund të përfitonin nga rekomandimi.
44	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandim për ndermarrjen e iniciatives per shfuqizimin e dispozitave te Kodit Penal Ushtarak qe permbajne denimin me vdekje në kohë ne gjendje lufte apo situatë te jashtezakonshme, ne zbatim te protokollit 13 te Konventes Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore.	Kryetares se Kuvendit. Kryeministrit. Ministrit te Drejtesise.	19.02.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Kuvendi miratoi Ligjin nr.9722 dt. 30.04.2007 me ane te te cilit shfuqizoi ne Kodin Penal Ushtarak te gjitha denimet me vdekje.
45	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandim per pergatitjen e ligjit per ngritjen e nje autoriteti mbikqyres te pavarur, pergjegjes per mbrojtjen e te dhenave personale ne Shqiperi.	Kryeministrit. Ministrit te Drejtesise.	03.04.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Kuvendi i Shqiperise ka miratuar dhe ka hyre ne fuqi Ligji nr.9887 date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale”, ku parashikohet ngritja e institucionit te Komisionerit per mbrojtjen e te dhenave personale.
46	Me ankese te disa shtetasve	Rekomandohet nisma ligjore per perfshirjen e rreth 400 familjeve te zones se Berdeneshit	Kryeministrit. Ministrit te	20.11.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Ministri i Brendshem ka

		Sarande brenda territorit administrative te nje njesie vendore	Brendshem.		urdheruar ngritjen e nje grupi pune per studimin e zones dhe dhenien e mendi-meve per zgjidhjen ligjore te problemit.
<b>2008</b>					
47	Me insiative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet rregullimi i posaçem ligjor apo apo nenligjor i kushteve dhe kriterëve që duhet të përmbushë një person që duhet të punësohet si mësues në arsimin parauniversitar; parashikimi në mënyrë të qartë dhe pa ekuivokë i procedurës së aplikimit për vend pune, si dhe i mënyrës së zgjidhjes së konflikteve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës për personelin mesimdhënës në arsimin parauniversitar	Ministrit të Arsimit dhe Shkencës	11.02.2008	Nuk ka përgjigje
48	Me insiative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet përsheptimi i punës për realizimin e ndryshimeve ligjore për thjeshtimin e sistemit dhe të procedurave në dhenien e rinovimit të lejeve të drejtimit të automjeteve, sipas sistemit “One stop service”.	Ministrit të Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Drejtorisë së Përgjithshme të Sherbimeve të Transportit Rrugor	5.05.2008	Rekomandimi është pranuar në parim. Nga ana e Ministrisë së Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Sherbimeve të Transportit Rrugor, po punohet për rishikimin e legjislacionit të fushës në teresi dhe të kesaj çështje në veçanti.

49	Ankesa e shtetasit A.P	Rekomandohen ndryshime ne Ligjin nr.9380 date 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”	Ministrin te Turizimit, Kultures, Rinise dhe Sporteve Zyres Shqiptare te te Drejtave te Autorit	12.05.2008	Rekomandimi u pranua ne parim. Nga ana e Zyres Shqiptare te te Drejtave te Autorit, eshte konfirmuar se ndryshimet e propozuara jane pjese e ndryshimeve qe do te propozohen se shpejti nga Ministri i Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve, per Ligjin “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”
50	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandohet hartimi e paraqitja per miratim e projekt-ligjit “Per kthimin e kompensimin e prones se luajtshme”.	Ministrin te Drejtesise Ministrin te Financave Komisionit per Çeshtjet Ligjore, Administraten Publike dhe te Drejtat e Njeriut	4.06.2008 Perseritur ne 18.12.2008	Ne shqyrtim
51	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandohet ndryshimi dhe permiresimi i Ligjit nr.9087 date 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, per ndalimin e pjesemarrjes se femijeve ne fushata elektorale.	Kuvendit te Shqiperise Komisionit Parlamentarte Reformes Zgjedhore Komisioni per Çeshtjet Ligjore,	4.07.2008	Nuk u miratua

			Administraten Publike dhe te Drejtat e Njeriut		
52	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandohet pergatitja e ligjit “Per hetuesin (investigatorin) privat”	Kryeministrit Ministrit te Drejtesise	9.07.2008	Rekomandimi u pranua ne parim. Ministria e Drejtesise po pergatit nje studim per mundesine e perfshirjes se ketij projektligji ne sistemin tone ligjor.
53	Ankesa e shtetasit B.Gj	Rekomandohet permiresimi i akteve ligjore dhe nenligjore te cilet parashikojne standartet qe duhet te plotesojne personat fizike a juridike qe te ushtrojne nje aktivitet privat ne fushen e shendetesise	Ministrit te Shendetesise	10.07.2008	Rekomandim i pranuar.
54	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandohet plotesimi i Ligjit nr.8668 date 23.11.2000 “Per pajisjen e shtetasve shqiptare me pasaporte per jashte shtetit”, ne perputhje me nenin 118 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise	Ministrit te Brendshem	19.09.2008	Rekomandimi u pranua ne parim. <i>Eshte pergatitur nje projekt-ligj i ri per pajisjen e shtetasve shqiptare me pasaporta gjate vitit 2009, i cili eshte ne procedure miratimi .</i>
55	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandohen disa shtesa dhe ndryshime ne Kodin e Procedures Penale dhe Kodin e Procedures Civile ne kuader te reformes ne drejtesi	Ministrit te Drejtesise	23.09.2008	Rekomandimi nuk eshte pranuar.

56	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandim per te bere te mundur realizimin e detyres se Avokatit te Popullit per ankesat kunder vendimeve gjyqesore se prere, duke bere plotesimet e duhura ne Kodin e Procedures Penale dhe Civile, bazuar ne rekomandimet e Keshillit te Europes	Ministrin te Drejtesise	2.10.2008	Nuk ka pergjigje.
57	Ankesa e nje OJF-je	Rekomandohet ndryshimi i pikes 8 te nenit 55 te Ligjit nr.8410 date 30.09.1998 "Per radion e televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise", per te zgjeruar lirine e shprehjes.	Kryeministrin	6.10.2008	Ne shqyrtim.
<b>2009</b>					
58	<i>Me iniciativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandim per ndermarrjen e iniciatives per ndryshimin e nenit 352 te Ligjit nr.8116 date 29.03.1996 "Kodi i Procedures Civile te Republikes se Shqiperise", i ndryshuar.</i>	<i>Ministrin te Drejtesise Ministrin te Punes, Çeshtjeve Sociale e Shanseve te Barabarta</i>	2.02.299	<i>Rekomandimi eshte pranuar pjeserisht nga ana e Ministrise se Drejtesise.</i>
59	<i>Me iniciativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandim per ndermarrjen e iniciatives per disa plotesime ne Ligjin nr.7952 date 21.06.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar" dhe ne Dispozitat Normative per Arsimin, per garantimin sa me te plote te drejtave te femijeve. Rekomandimi eshte perseritur ne daten 18.11.2009.</i>	<i>Ministrin te Arsimit dhe shkences</i>	2.02.2009  18.11.2009	<i>Rekomandimi eshte pranuar ne parim.Ministria e Arsimit dhe Shkences ka ndermarre rishikimin e kuadrit ligjor per Arsimin Parauniversitar dhe Dispozitat Normative per Arsimin, duke perfshire rekomandimet tona ne kete proces.</i>

60	<i>Me inisiativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohen disa shtesa dhe ndryshime ne Kodin Penal dhe ne Kodin e Procedures Penale ne favor te femijeve edhe ne kuader te reformes ne Drejtesi.</i>	<i>Ministrin te Drejtesise</i>	<i>2.02.2009</i>	<i>Rekomandimi eshte pranuar pjeserisht nga ana e Ministrise se Drejtesise</i>
61	<i>Ankesa nga shtetas te paraqitura kohe pas kohe</i>	<i>Rekomandohet marrja e masave per heqjen e takses se ç' regjistrimit ne regjistrat e gjendjes civile te shtetasve qe lene shtetesine shqiptare dhe per pastrimin e Regjistrat Kombetar te Zgjedhesve.</i>	<i>Ministrin te Brendshem Ministrin te Financave</i>	<i>3.02.2009</i>	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Kuvendi ka miratuar Ligjin nr.10145 date 28.09.2009, i cili heq kete takse.</i>
62	<i>Ankesa nga shoqata te Ish te Perndjekurve Politike</i>	<i>Rekomandohen disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.9831 date 12.11.2007 "Per demshperblimin e ish te denuarve politike te regjimit komunist".</i>	<i>Kryetarit te Komisionit Parlamentar per Çeshtjet Ligjore e Administraten Publike dhe te Drejtit e Njeriut</i>	<i>24.02.2009</i>	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Kuvendi ka miratuar Ligjin nr.10111 date 2.04.2009 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 9831 date 12.11.2007 "Per demshperblimin e ish te denuarve politike te regjimit komunist".</i>
63	<i>Kerkesa nga shtetas te denuar me heqje lirie</i>	<i>Rekomandohet hartimi i nje projekt-ligji te ri "Per faljen".</i>	<i>Kryeministrin te Republikes se Shqiperise dhe Ministrin te Drejtesise</i>	<i>7.04.2009</i>	<i>Rekomandimi u pranua ne parim. Ministria e Drejtesise do te hartojte kete projektligj dhe ka konfirmuar se do ta paraqese ate per miratim ne Keshillin e Ministrave ne vitin 2009.</i>
64	<i>Ankesa nga</i>	<i>Rekomandim qe ti propozohen Kuvendit te</i>	<i>Ministrin te</i>	<i>8.04.2009</i>	<i>Rekomandimi u pranua ne parim. Ministria e Drejtesise</i>

	<i>shtetas te denuar me heqje lirie</i>	<i>Shqiperise, disa shtesa dhe ndryshime ne nenet 147 e 417 te Kodit te Procedures Penale.</i>	<i>Drejtewise</i>		<i>do te hartoje projektligjin per shtesat dhe ndryshimet ne Kodin e Procedures Penale dhe u pergjigj se do ta paraqese ate per miratim ne Keshillin e Ministrave gjate vitit 2009.</i>
65	<i>Ankesa te personave fizike dhe juridike</i>	<i>Kerkese per shfuqizimin si antikushtetues te: Ligjit nr.9948 date 7.07.2008 “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”.</i>	<i>Gjykates Kushtetuese</i>	<i>23.06.2009</i>	<i>Kerkesa eshte ne shqyrtim ne Gjykatën Kushtetuese</i>
66	<i>Ankesa te personave fizike dhe juridike</i>	<i>Kerkese per shfuqizimin si antikushtetues te: Paragrafeve te dyte dhe te trete, te nenit 10, te Ligjit nr.7843, dt. 13. 07. 1994 “Per Regjistrimin e pasurive te paluajtshme”, me ndryshimet e bera.</i>	<i>Gjykates Kushtetuese</i>	<i>23.06.2009</i>	<i>Kerkesa eshte ne shqyrtim ne Gjykatën Kushtetuese</i>
67	<i>Ankesa te shtetasve dhe organizatave joqeveritare ne mbrojtje te te drejtave te njeriut</i>	<i>Kerkese per shfuqizimin si antikushtetues te: Neneve 3/3; 4/2; 12/1,2,3; 14/1; 22; 27 dhe 29/2 të ligjit nr. 10142, dt. 15.05.2009, si të papajtuëshëm me Kushtetutën, sepse çënojnë të drejtat ekonomiko-financiare të punonjësve të Policisë së Shtetit, të përfituara me aktet normative të mëparshme.</i>	<i>Gjykates Kushtetuese</i>	<i>15.07.2009</i>	<i>Kerkesa eshte ne shqyrtim ne Gjykatën Kushtetuese</i>
68	<i>Ankesa te personave fizike dhe juridike</i>	<i>Kerkese per shfuqizimin si antikushtetues te: Germes “ç”, te pikes 1, te nenit 16, dhe heqjen e fjales “kryesisht” nga paragrafi i dyte i nenit 18 te Ligjit nr.9235, dt.29.07.2004 “Per kthimin dhe</i>	<i>Gjykates Kushtetuese</i>	<i>11.09.2009</i>	<i>Kerkesa eshte ne shqyrtim ne Gjykatën Kushtetuese</i>



		<i>kompensimin e prones”, ndryshuar me nenin 1/ “ç” dhe me paragrafin e dyte te nenit 2 te Ligjit nr.9684, dt.06.02.2007 “Per ndryshime ne ligjin nr.9235, dt.29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e prones”</i>			
<b>69</b>	<i>Me inisiativen e Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet pergatitja e drafteve ligjore per realizimin e inisiatives legjislative nga Qeveria per parandalimin dhe monitorimin e rreziqeve qe vijnë nga emetimi ne ajer i gazit radioaktiv Radon</i>	<i>Ministrin te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave</i>	<i>24.12.2009</i>	<i>Rekomandimi eshte pranuar ne parim. Ka ardhur pergjigje nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, se po punohet per pergatitjen e projekt-ligjit perkates.</i>

**Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime në aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave per periudhen 2000-2009**

<b>Nr</b>	<b>Ankuesi</b>	<b>Permbajtja e rekomandimit</b>	<b>Kujt i drejtohet</b>	<b>Data e dergimit</b>	<b>Përfundimi</b>
<b>1</b>	Ankesa e shtetasit M.Sh. etj.	Rekomandim: “Propozohet shtyrja e afatit të veprimit të V.K.M. Nr. 585 datë 11.12.1997 “ <i>Për evidentimin e familjeve që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale</i> ”, si dhe plotësimi i listave të kreditorëve.	Kryeministrit	16.06.2000	Rekomandimi u pranua në parim. Por pa nxjerrë V.K.M. u plotësuan listat e kreditorëve në njësitë e qeverisjes vendore.
<b>2</b>	Shtetasti A.R. ish pronar trualli	Të shfuqizohet si antikushtetuese shkronja “c” e pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët strategjikë” si dhe pikës 4 të V.K.M. nr.438, datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare” për çmimin e truallit që i është kthyer ish pronarëve	Gjykatës Kushtetuese	15.11.2000	Kërkesa u pranua. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.26, datë 24.04.2001 vendosi: 1. Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1, shkronja ‘c’ të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët jostrategjikë”. 2. Pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438 datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare”.

3	Ankesa te shtetasve	Rekomandim: “Për pagesën nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit për taksën e rregjistrimit të pasurive të paluajtëshme që ju ka shitur personave fizikë ose personave privatë”.	Kryeministrit Ministrit të Financave Agjensisë Kombëtare të Privatizimit	11.05.2001	Rekomandimi u pranua. Doli VKM Nr. 386 datë 31.05.2001”Për pagesën e taksës së kalimit të pronësisë nga privatizimi i pronës shtetërore”.
4	Shoqatat e “Dëshmorëve të Atdheut”, dega Fier dhe Krujë	Rekomandim: “Për nxjerrjen e disa akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 8607 datë 27.04.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.	Kryeministrit	08.10.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli VKM Nr. 151 datë 25.04.2002 “Për statusin Dëshmor i Atdheut”.
5	Ankesa të shoqatave të ish pronarëve	Rekomandimi që të nxirren Vendimet e Qeverisë në përputhje me vendimin nr.26 datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese	Ministrit të Ekonomisë	24.10.2001	Rekomandimi u pranua. Me VKM nr.119 datë 27.02.2003 u riformulua gërma “c” e pikës 1 të VKM nr.119 datë 18.03.2000, sipas Vendimit nr.26, datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese
6	Ankesa e një numuri të madh të dënuarish që vuajnë deni- min në burgje	Rekomandim: “Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, për kriteret e shpërblimit të punës së të dënuarve.	Kryeministrit Ministrit të Drejtësisë	13.05.2002 Perseritur ne date 17.07.2008	<b>Rekomandimi u pranua.</b> <b>Doli VKM nr.303 date</b> <b>25.03.2009 “Per miratimin e</b> <b>rregullores se pergjithshme te</b> <b>burgjeve”.</b>
7	Ankesa e shtetasit A.M.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e pikës 1 të VKM nr.24.10.2001 dhe urdhërit të Ministrit të Arsimit “Për kuotat shtesë të Shkollave të Larta”, që krijonte diferencim për kandidatët për studentë në	Kryeministrit. Ministrit të Arsimit	04.07.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli VKM Nr. 362 datë 18.07.2002

		shkollat e larta			
8	Disa familjare te punonjesve te policise, te vrare ne krye te detyres	Rekomadim: “Per permiresimin e V.K.M. Nr. 552 date 27.11.1999 “ <i>Per trajtimin ekonomik e financiar te familjareve te punonjesve te policise te vrare e plagosur per shkak te detyres</i> ”.	Keshillit te Ministrave. Ministrit Rendit Publik	06.12.2002 Perseritur disa here dhe heren e fundit, date 12.12.2008	Rekomandimi është pranuar. Eshte bere projektvendimi dhe eshte derguar për miratim në Qeveri dy here. Eshte kthyer per t’u ripunuar per shkak te koston financiare.
9	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Kërkesë: Të shfuqizohet si antikushtetues Vendimi nr.441 datë 26.09.2002 i Këshillit të Ministrave “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve”	Gjykatës Kushtetuese	13.12.2002	Pranuar. Para shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, Qeveria nxori Vendimin nr.19 datë 10.01.2003 “Për disa ndryshime në vendimin nr.441 datë 26.09.2002
10	Ankesa e shtetasit Q.H.	Rekomandim: “Për të deklaruar (konstatuar) pavlefshmërinë absolute të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 226 datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”.	Kryeministrit	27.05.2003	Rekomandimi u pranua. Kryeministri me urdhërin Nr. 157 datë 12.11.2003 revokoi urdhërin Nr. 226 datë 20.08.2002.
11	Ankesa e shtetasit Q.H	Rekomandim: “ Për ndryshimin e VKM Nr. 64 datë 02.02.2001 “ <i>Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për caktimin e funksioneve organike që do të ushtrohen sipas tyre</i> ”.	Këshillit të Ministrave, Ministrit të Rendit Publik	29.05.2003	Rekomandimi nuk u pranua. Por pati efektet e tij pozitive. Eshtë bërë i mundur korigjimi i shumë rasteve të dhënies së gradave në mënyrë të padrejtë.
12	Ankesa e shtetasit S.H.	Rekomandim: “Për përmirësimin e udhëzimit Nr. 1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”. Zbatimi me akt nënligjor i parashikimeve të nenit 61 Pika 1 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R.Shqipërisë”, dhe	Kryeministrit etj.	23.09.2003	Rekomandimi është pranuar. Në zbatim të këtij rekomandimi doli VKM Nr. 357 datë 01.06.2004 e VKM Nr. 374 datë 31.05.2005 “Për përcaktimin e koefiçiente-ntëve të indeksimit të

		udhëzimit Nr. 1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”.			bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve”.
13	Ankesa e shtetasit Xh.K dhe i një numuri të madh të veteranëve nga i gjithë vëndi.	Rekomandim: “Për ndërmarjen e inisiativës për hartimin e projektvendimit për caktimin e një afati të ri për paraqitjen e dokumenteve para Komisionit Qëndror të <i>Statusit të Veteranit</i> , me qëllim njohjen e statusit të veteranit”.	Ministrit të Mbrojtjes	26.11.2003	Është pranuar dhe për këtë ka dalë VKM Nr.748 datë 11.11.2004, i cili zgjati afatin deri më 31.12.2006. Afati është zgjatur edhe për vitin 2007.
14	Ankesa e shtetasit G.D.	Rekomandim: “Mbi hartimin e një projektvendimi për trajtimin e detyrimeve ndaj shtetit, ndaj sigurimeve shoqërore dhe të tretëve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes së konçesionit të formës BOT për uzinën e ferrokromit Elbasan dhe për minierat e kromit Prrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit dhe Shoqërisë italiane Darfo SPA”.	Këshillit të Ministrave.	2003	Rekomandimi është pranuar. Janë bërë ndryshime në ligj që falin detyrimet e papaguara ndaj Sigurimeve Shoqërore
15	Ankesa e Infosoft System” Sh.a.	Rekomandim: “Për revokimin e paragrafit që parashikon formularin e “Autorizimit të Prodhuesit” në kapitullin e tretë të Udhëzimit të K.M. Nr. 1 datë 01.01.1996 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ” ndryshuar me VKM Nr.3 datë 10.07.2003 “Për disa ndryshime të VKM. Nr. 1 datë 01.01.1996 “Për Prokurimin Publik”.	Kryeministrit	13.12.2003	Rekomandimi është pranuar nga ana e Agjensisë së Prokurimit Publik. Ne dokumentet standarte për blerjen e mallrave, të miratuara në përputhje me Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, është hequr ky formular.
16	Ankesa e	Rekomandim: “Për përfshirjen në listën e subjekteve që përfitojnë pension suplementar të	Kryeministrit. Ministrit të	08.07.2004.	Rekomandimi u pranua. Shtesat përkatëse të kerkuara janë pas-

	shtetasit N.GJ.	nëpunësve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Avokatit të Popullit”.	Punës dhe Çështjeve Sociale.		qyruar ne VKM nr.467 date 23.06.2005 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.382 date 20.05.1996 “Per zbatimin e ligjit nr.8097 date 21.03.1996 “Per pensionet shteterore suplementare te personave, qe kryejne funksione kushtetuese dhe te punonjesve te shtetit”, te ndryshuar”.
17	Ankesa të punonjësve të policisë së burgjeve	Rekomandim: “Për përshpejtimin e procedurave për miratimin e VKM për trajtimin e të gjitha strukturave të Policisë së Burgjeve, sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 8321 datë 02.04.1998 “Për Policinë e Burgjeve”.	Ministrit të Drejtësisë	22.12.2004	Rekomandimi u pranua. Çështja është zgjidhur perfundimisht me hyrjen ne fuqi te Ligjit nr.10032 date 11.12.2008 “Per policine e burgjeve”.
18	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për marrjen e të gjitha masave në bashkëpunim dhe me institucionet e tjera qendrore, për dhënien e tokës bujqësore në pronësi në bazë të Ligjit Nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” subjekteve që ende nuk kishin marrë ose nuk janë plotësuar me tokë në pronësi”.	Ministrit të Bujqësisë. Kryeministrit	09.03.2005	Rekomandimi u pranua. Ka dalë VKM Nr.291 datë 06.05.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 230 datë 22.07.1991 “Për krijimin e Komisionit të Tokave” në fshatra të cilat shqyrtojnë mosmarrëveshjet dhe konfliktet brenda fshatit, që kanë lindur në vijimësi të procesit të ndarjes së tokës dhe që në kohën e shqyrtimit nuk kanë marrë zgjidhje ligjore”.
19	Ankesa e	Rekomandim: “Për përshpejtimin e procedurave	Kryeministrit.	24.03.2005	Rekomandimi nuk ka përgjigje.

	shtetasit B.K.	lidhur me funksionimin e Komisionit Shtetëror Trepalësh, si dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore për ish të përndjekurit politikë”.		Përsëritur në datën 02.11.2005	
20	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për rritjen e transparencës dhe zbatimin e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” duke përgatitur një Rregullore tip”.	Kryeministrit.	12.10.2005	Rekomandimi u pranua ne parim. Më konkretisht shih nr.38 tek Pasqyra nr.3
21	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për përgatitjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera të lidhura me të”.	Ministrit të Financave Ministrit Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve.	18.10.2005	Rekomandimi u pranua. Ne zbatim te Ligjit nr.9380 date 28.04.2005 “Per te drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”, ka dale VKM nr.232 date 19.04.2006 “Per krijimin dhe funksionimin e zyres shqiptare per te drejtat e autorit; VKM nr.343 date 6.06.2007 “Per miratimin e tarifave te sherbimit qe ofron zyra shqiptare per te drejtat e autorit”.
22	Ankesa e shtetasit A.K.	Rekomandim: “Për përgatitjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9267 datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigu-rimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.	Ministrit të Financave. Këshillit të Ministrave Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve.	18.11.2005	Rekomandimi u pranua. Ka dale Udhezimi i Ministrit te Financave, nr.24 date 15.11.2007 “Mbi trajtimin e demeve te mbuluara nga kontrata e sigurimit te detyrueshem te mbajtesve te mjeteve motorike”.

23	Ankesa të shumta	Rekomandim: “Për situatën e çmimeve të operatorëve të telefonisë së lëvizshme dhe propozimi për miratimin sa më parë të Metodologjisë së caktimit të tarifave nga ERT”.	Entit Rregullator të Telekomunikacionit	25.11.2005	Rekomandimi është pranuar. Aktualisht Metodologjia është miratuar nga Keshilli i Ministrave me VKM nr.855 date 18.06.2008 “Per miratimin e metodologjise te rregullimit te tarifave te organizmit me fuqi te ndjeshme ne treg AMC sh.a dhe tarifave te interkonjeksionit.
24	Ankesa e shtetasit P. S. etj.	Rekomandim: “Kërkohej përsheptimi i procedurave për ndryshimin e VKM Nr.146 datë 26.02.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”.	Ministrin të Arsimit. Finacave dhe Punëve Publike.	2005	Rekomandimi është pranuar. VKM nr.146 date 26.02.1998, është ndryshuar me hyrjen ne fuqi te VKM nr.166 date 7.02.2007.
25	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues të Gjakmarrjes”	Kryeministrin.	02.02.2006 Përsëritur 2007	Rekomandimi është pranuar, por deri tani nuk janë nxjerrë aktet nënligjore.
26	Ankesa të shtetasve dhe organizatave joqeveritare	Kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të 1. V.K.M. nr.43, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike”. 2. V.K.M. nr.44, datë 27.01.2006 “Për shmangien	Gjykatës Kushtetuese	09.02.2006	Kerkesa është pranuar. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.20 datë 11.07.2006 vendosi shfuqizimin



	të të drejtave të njeriut	e nepotizmit në administratën publike”. 3. V.K.M. nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin nr.205 datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”			e tre vendimeve të Qeverisë.
27	Ankesa nga shtetas të ndryshëm	Rekomandim për përgatitjen e projektvendimit të Qeverisë për zbatimin e neneve 8, 9, 10 dhe 11 të ligjit nr.8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”	Kryeministrit Ministrit të Brendshëm	03.03.2006	Rekomandimi është pranuar. <i>Me miratimin e Ligjit nr.10142 date 15.05.2009 “Per sigurimin shoqëror suplementar te ushtarakeve te Forcave te Armatosura, te punonjesve te Policise se Shtetit, te Gardes se Republikes, te Sherbimit Informativ te Shtetit, te Policise se Burgjeve, te Policise se Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin e te punonjesve te Sherbimit te Kontrollit te Brendshem ne Republiken e Shqiperise”, dhe daljen e VKM-ne ne zbatim te tij, problemi ka gjetur zgjidhje.</i>
28	Shoqata e Talasemikëve të Shqipërisë	Rekomandim: “ Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 8032 datë 16.01.1995 “Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollit të gjakute produkteve të tij dhe transplantimeve”.	Ministrit të Shëndetësisë	13.03.2006	Rekomandimi është pranuar, është miratuar strategjia për gjak të sigurtë.
		Rekomandim për hartimin dhe paraqitjen për			Rekomandimi është pranuar. Eshte miratuar nga Kuvendi dhe

29	Ankesa të shtetasve	miratim të projekt vendimit të Qeverisë, për vënien në zbatim të nenit 51 të ligjit nr.9135 datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorit”.	Ministrit të Ekonomisë	20.03.2006	ka hyre ne fuqi ligji nr.9683 dt.28.01.2008 “Per ushqimin”, pjese e te cilit eshte edhe mbi-kqyrja e tregut.
30	Ankesa nga shtetas të ndryshëm	Rekomandim: “Per aktet nenligjore te Ligjit Nr. 9232 date 13.05.2004 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane”.	Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve	29.03.2006	Rekomandimi u pranua. Ne zbatim te ligjit, ka dale VKM nr.258 date 28.04.2005 “Per kushtet, normat dhe standartet qe duhet te plotesojne banesat sociale me qera, te cilat blihen ne treg”. Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve ka nxjerre Udhezimin nr.2 date 4.04.2007 “Per miratimin e koston mesatare te banesave, nga Enti Kombetar i Banesave dhe te koeficientit “K” per vitin 2007”.
31	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9110, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Për Krime të Rënda”.	Kryeministrit. Ministrit të Drejtësisë	24.05.2006 Perseritur ne daten 03.03.2008	Rekomandimi u pranua. Ne date 18.04.2008, eshte kthyer pergjigje. Ministria e Drejtësisë ka përgatitur projekt vendimin per kete problem.
32	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim për plotësimin e kërkesave të nenit 39 të Ligjit nr.9210 datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” për kriteret e përfitimit nga ushtarakët të së drejtës së parablerjes për	Ministrit të Mbrojtjes	30.05.2006	Rekomandimi u perserit ne daten 30.12.2008, por nuk u pranua.

		objektet ushtarake të dala të lira.			
33	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për shfuqizimin e Pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 87, datë 15.02.2006 “Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetave me rimbursim”	Kryeministrit. Ministrit të Financave, Ministrit të Shëndetësisë	21.12.2006	Rekomandimi është pranuar pjesërisht, tarifa e recetes është hequr vetëm për një kategori të caktuar personash, me VKM nr.727 dt.30.10.2007.
34	Me iniciative të Avokatit të Popullit	Rekomandohet hartimi dhe paraqitja për miratim pranë Këshillit të Ministrave të projektvendimit mbi kriteret liçensuese të eksperteve të dëmeve, si detyrim që buron nga neni 89 i Ligjit nr.9267 dt.29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”	Kryeministrit. Kryetares së Agjencisë së Mbikqyrjes Financiare.	13.03.2007	Rekomandimi u pranua. Është nxjerre VKM nr.164 date 28.01.2008 “Për kriteret e procedurat e liçensimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime”, si dhe është miratuar Rregullorja e AMF-se nr.18 date 27.03.2008 “Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime”.
35	Me iniciative të Avokatit të Popullit	Rekomandohet marrja e masave të menjehershme për botimin në Fletoren Zyrtare të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.565 dt. 9.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”.	Kryeministrit. Ministrit të Financave. Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta	17.07.2007	Rekomandimi është pranuar. VKM nr.565 dt.9.08.2006 u botua në Fletoren Zyrtare Nr.Ekstra 25, faqe 3, Viti 2007.
			Ministrit të Puneve Publi-		Rekomandimi është pranuar në

36	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet plotesimi i kerkesave te nenit 401 te Kodit Detar te Republikes se Shqiperise, per hartimin dhe kalimin per miratim ne Keshillin e Ministrave te disa vendimeve te veçanta me karakter nderministerial.	ke, Transporte e Telekomunikacionit. Ministrit te Financave. Ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.	31.07.2007	parim. Nga ana e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave po hartohen drafte ne lidhje me ndotjen ne hapësirën detare.
<b>2008</b>					
37	Ankesa e shtetasit Xh.M	<p>Rekomandohet marrja e masave organizative dhe ligjore per zgjidhjen e problemit te mosderdhjes se kontributeve shoqerore te bashkeshortit/es te ushtarakeve qe kane perfituar pagesen e papunesise per periudhen 1993-2003</p> <p>Ne vijim, rekomandohet marrja e masave per identifikimin e numrit te pergjithshem te personave qe kane perfituar pagesen e papunesise, ne baze te Ligjit nr.7496 date 3.07.1991 “Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te</p>	<p>Kryeministrit Ministrit te Financave Ministrit te Brendshem Ministrit te Mbrojtjes</p> <p>Ministrit te Mbrojtjes Ministrit te Brendshem Drejtorit te</p>	<p>30.05.2008</p> <p>16.07.2008</p>	<p>Rekomandimi eshte pranuar.Ne pergjigje te ketij rekomandimi, Kryeministri ka kerkuar ndjekjen e kesaj çështje nga ana e ISSH-se.</p> <p>Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe SHISH, i kane bere listat e personave qe kane perfituar pagesen e papunesise dhe eshte percaktuar numri i pergjithshem i tyre. Keto te</p>

		Republikes se Shqiperise”, per periudhen 1993-2003.	SHISH		dhena i jane derguar Ministrise se Financave.
38	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet miratimi i VKM-se per kohen e punes dhe te pushimit te punonjesve te Policise te Shtetit, ne baze e per zbatim te nenit 87/6 te Ligjit nr.9749 date 4.06.2007 “Per Policine e Shtetit”.	Kryeministrit	16.09.2008	Rekomandimi u pranua. Ndonese nuk ka dale VKM-ja e kerkuar, problemi eshte zgjidhur me nenshkrimin e kontrates kolektive te punes, ndermjet Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit dhe Sindikates se Policise.
39	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet marrja e masave per te rregulluar ligjerisht trajtimin e veçante te te semureve qe vendosen ne kushte karantine si dhe pagesen e personelit qe punon ne Spitalin Infektiv	Ministres se Shendetesise Drejtores se QSUT-se	16.09.2008	Rekomandimi eshte pranuar. Ka dale vendimi i Keshillit te Ministrave i dates 24.12.2008 “Per disa ndryshime e shitesa ne VKM nr.306 date 27.06.2002 “Per miratimin e struktures dhe te nivelit te pagave te punonjesve me arsim te larte ne sistemin e Ministrise se Shendetesise dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, ne sistemin e Ministrise se Mbrojtjes”, i ndryshuar. Gjithashtu Drejtoria e QSUT-se ka ngritur nje grup pune per hartimin e nje rregulloreje per kushtet e trajtimit te pacienteve qe vendosen ne karantine ne Spitalin Infektiv.

**2009**

<b>40</b>	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandim per marrjen e menjehershme te masave te nevojshme teknike dhe organizative per korigjimin e mangesive te konstatuara dhe mbarevajtjen e procesit te pajisjes me leternjoftime te shtetasve shqiptare, krijimin e me shume mundesive dhe te kushteve lehtesuese per qytetaret dhe te transparences per procesin.</i>	<i>Ministrin te Brendshem</i>	<b>12.03.2009</b>	<i>Rekomandimi u pranua. Keshilli i Ministrave ka nxjerre disa vendime, per kete qellim e konkretisht V.K.M nr. 361, dt. 1.4.2009 “Per nje shtese ne vendimin nr. 15, dt. 14.1.2009 te Keshillit te Ministrave “Per kompensimin e pageses per pajisjen me leternjoftim te shtetasve ne nevoje”, VKM nr. 366, dt. 15.4.2009 “Per kompensimin e pageses per pajisjen me leternjoftim te shtetasve ne nevoje”, si dhe VKM e dates 1.5.2009 “Per procedurat e pajisjes se shtetasve pa pasaporte, qe nuk perfitojne kompensim nga VKM nr. 366, dt. 15.4.2009 “Per kompensimin e pageses per pajisjen me leternjoftim te shtetasve ne nevoje”.</i>
<b>41</b>	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet nxjerrja e nje akti nenligjor nepermjet te cilit te njoftohen dhe detyrohen te gjitha institucionet publike dhe jopublike per te njohur dhe pranuar leternjoftimin e ri si</i>	<i>Kryeministrin te Republikes se Shqiperise Ministrin te</i>	<b>24.04.2009</b>	<i>Rekomandimi u pranua. Keshilli i Ministrave nxorri VKM nr.418 date 27.04.2009 “Per njohjen</i>

		<i>dokument baze identifikimi te shtetasve.</i>	<i>Brendshem Ministrin te Puneve te Jashtme</i>		<i>dhe perdorimin e lernjoftimit si dokument identifikimi”.</i>
42	<i>Ankesa e shtetasit M.S</i>	<i>Rekomandohet ndryshimi i gemes “dh”, te pikes 3 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.787 date 26.11.2003 “Per zbatimin e fazes se katert ne masen e pensioneve” dhe tabelës C.f bashkengjitur ketij vendimi.</i>	<i>Ministrin te Financave Drejtores se ISSH-se</i>	22.05.2009	<i>Rekomandimi u pranua ne parim. Ministria e Financave i ka kerkuar ISSH-se paraqitjen e shpjegimeve, si dhe te propozimeve perkatese per kete qellim.</i>
43	<i>Ankesa e shtetasit S.Xh</i>	<i>Rekomandim ne lidhje me derdhjen e kontributit si te vetepunesuar ne bujqesi te personave qe kane nderruar vendbanim</i>	<i>Ministrin te Financave</i>	17.06.2009	<i>Rekomandimi u pranua. Keshilli i Ministrave nxorri VKM nr.1206 date 11.12.2009 “Per nje shtese e ndryshim ne Vendimin nr.1114 date 30.07.2008 te Keshillit te Ministrave “Per disa çeshtje ne zbatim te Ligjeve nr.7703 date 11.05.1993 “Per sigurimet shoqerore ne Republikën e Shqiperise” i ndryshuar.</i>
44	<i>Ankesa te personave fizike dhe juridike</i>	<i>Kerkese per shfuqizimin si antikushtetues te: VKM-se nr.1269 date 17.09.2008 “Per perberjen, menyren e funksionimit dhe detyrat e pergjegjesite e strukturave shteterore te ngarkuara per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token”.</i>	<i>Gjykates Kushtetuese</i>	23.06.2009	<i>Kerkesa eshte ne shqyrtim ne Gjykatën Kushtetuese</i>

45	Ankesa te personave fizike dhe juridike	<i>Kerkese per shfuqizimin si antikushtetues te: 1. Te Udhezimit te Keshillit te Ministrave nr.4, dt. 21. 11. 2007, “Per miratimin e procedures se fshirjes se regjistrimeve te kryera ne kundershtrim me ligjin dhe te atyre, qe krijojne mbivendosje, ne zyren e regjistrimit te pasurive te paluajtshme” 2. Te neneve 2 dhe 6, te Udhezimit te Keshillit te Ministraver nr.1, dt. 31. 01. 2007 “Per procedurat e regjistrimit ne zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme”</i>	Gjykates Kushtetuese	23.06.2009	<i>Kerkesa eshte ne shqyrtim ne Gjykatën Kushtetuese</i>
46	Ankese e shtetasit M.D	<i>Rekomandohet pergatitja dhe miratimi i VKM-se “Per pagat referuese te njesuara dhe rregullat e llogaritjes se pages mesatare referuese per gjithe karrieren”</i>	<i>Ministrin te Brendshem Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit</i>	9.10.2009	<i>Rekomandimi u pranua ne parim. Me urdher te Kryeministrit eshte ngritur nje grup nderinstitucional pune per pergatitjen e VKM-se perkates.</i>
47	Ankese e nje grupi banoresh te Orikumit	<i>Rekomandohet pergatitja dhe miratimi i VKM-se “Per rregullimin e marredhenieve te Policise se Shtetit me te tretet, per llojet e sherbimeve policore qe ofron policia dhe tarifate e pageses per keto sherbime”</i>	<i>Ministrin te Brendshem Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit</i>	30.10.2009	<i>Rekomandimi u pranua ne parim. Nga ana e Drejtorit te Pergjithshem te Policise eshte konfirmuar ngritja e nje grupi pune me eksperte qe po punon per pergatitjen e draft-projektit te VKM-se perkates.</i>
48	Ankese nga Shoqatat e	<i>Rekomandohet marrja e masave per dhenien e menjehershme te demshperblimit per te denuarit</i>	<i>Ministrin te Drejtesise</i>	23.12.2009	<i>Rekomandimi eshte pranuar. Ka dale VKM-ja nr.189 date 29.12.2009 “per percaktimin e kritereve e te procedurave te</i>



	<i>ish te Perndjekurve Politike</i>	<i>politike gjate regjimit komunist qe jane deklaruar te pafajshem dhe qe aktualisht jane gjalle, me pare se kategorite e tjera</i>	<i>Ministrit te Financave</i>		<i>bashkerendimit te informacionit, ndermjet Ministrise se Drejtesise dhe Institucioneve te tjera, pergjegjese per shqyrtimin e kerkesave per demshperblim te ish te denuarve politike te regjimit komunist, si dhe te llojit te pergjegjesise per çdo kerkesë”.</i>
--	-------------------------------------	---	-------------------------------	--	--

**Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime për aktet nënligjore të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore për periudhën 2000-2009**

Nr	Ankuesi	Permbajtja e rekomandimit	Kujt i drejtohet	Data e Dergimit	Përfundimi
1	Subjekte private të qytetit të Korçës	Rekomandim: “Për shfuqizimin e Pikës 4 të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 362 datë 18.08.2000 “Mbi zbatimin e detyrave për dhënie e lejës higjeno-sanitare”.	Ministrit të Shëndetësisë	27.09.2000	Rekomandimi u pranua.
2	Ankesat e një numri të konsiderueshëm qytetarësh.	Rekomandim: “ Për masat që duhen marrë për zbatimin e Ligjit Nr. 8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, me qëllim që çdo autoritet publik të nxjerrë rregullore.	Kryeministrit. Çdo ministri edhe institucioni qendror, çdo organi të pushtetit vendor	09.11.2000 Përsëritur datë 24.01.2002	Rekomandimi është pranuar pothuajse nga të gjitha ministratë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor.
3	Shtetasi R. R. në emër të 49 familjeve nga Tirana.	Rekomandim: “ Mbi problemin e 49 familjeve të shpronësuara nga Ujëmbledhësi i Bovillës me qëllim që projektvendimi i paraqitur të dërgohet sa më parë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave”.	Ministrit të Punëve Publike	27.09.2000	Kthyer përgjigje pozitive më datën 19.02.2001. Por megjithatë problemi nuk është zgjidhur me ndonjë akt nënligjor, por me vendime gjykate
4	Ankesa të studentëve pasuniversitarë	Rekomandim për rivendosjen e së drejtës së shkelur në lidhje me tarifat e rregjistrimit për specializim pasuniversitar	Ministrit të Arsimit	12.01.2001	Pranuar. Ministri i Arsimit u përgjigj se do të ndryshojë Udhëzimin përkatës

5	Ankesa të shtetasve	Rekomandim për ndryshimin në Udhëzimin nr.39 datë 31.03.1999 të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë	Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë	15.02.2001	Rekomandimi u pranua
6	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim: “Për një ndryshim në VKM Nr. 379 datë 26.06.1995 “Për privatizimin e objekteve që dalin të lira nga ristrukturimi”	Ministrit të Mbrojtjes	13.04.2001	Pranuar dhe kanë dalë VKM Nr. 524 datë 30.07.2004 dhe VKM Nr. 452 datë 09.07.2004 “Për marrje kredi me interes”.
7	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët, për mbajtjen e proces verbaleve të kallëzimit të personave të keqtrajtuar nga policia jashtë shtetit”.	Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Rendit Publik	03.07.2001	Rekomandimi u pranua. Doli Udhëzimi i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i Ministrit të Rendit Publik Nr. 2037 dhe 1210 datë 23.07.2001
8	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “ Për marrjen e masave dhe nxjerrjen e udhëzimeve që përcakton V.K.M. Nr. 335 datë 20.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”.	Ministrit të Drejtësisë. Ministrit të Financave	19.11.2001	Rekomandimi është pranuar nga Ministria e Financave, por nuk është vepruar nga Ministria e Drejtësisë
9	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “ Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8092 datë 03.02.1996 “Për shëndetin mendor”, për të nxjerrë rregulloren “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjekësore të mjekimit të detyruar”.	Ministrit të Shëndetësisë Ministrit të Drejtësisë	13.05.2002	Rekomandimi është pranuar. U krijua Instituti për kurimin e të dënuarve me trauma psikike e përdoruesve të drogës në Krujë.
		Rekomandim: “Për krijimin e kushteve për funksio-			Rekomandimi është pra-

<b>10</b>	Ankesa të të dënuarve	nimin e Komisionit Mbikqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të Ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1994 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.	Kryeministrit Ministrit të Drejtësisë,	11.11.2002	nuar. Është ngritur, por nuk funksionon në vazhdimësi Komisioni Mbikqyrës.
<b>11</b>	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për rritjen e objektivitetit të ekspertimeve mjeko-ligjore, në rastet e vdekjeve të shtetasve kur dyshohet se janë dhunuar nga punonjës policie apo nëpunës të shtetit”.	Instituti të Mjekësisë Ligjore.	16.01.2003	Rekomandimi u pranua. Doli Udhëzimi Nr. 22 datë 27.01.2003, i cili udhëzon kryerjen e ekspertimit me grup ekspertësh ku njëri duhet të jetë patjetër nga Instituti i Mjekësisë–Ligjore.
<b>12</b>	Ankesa e policit Q.H.	Rekomandim: “ Për përmirësimin e Urdhërit Nr. 1661 datë 08.04.2002 “Për komunikimin me media”.	Ministrit të Rendit Publik	28.05.2003	Rekomandimi u pranua në parim, por nuk u ndryshua
<b>13</b>	Pas një inspektimi në Spitalin psikiatrik Tiranë	Rekomandim për zbatimin e nenit 23 të ligjit nr.8092 datë 03.02.1996 “Për shëndetin mendor” në spitalin psikiatrik Tiranë për të nxjerrë një rregullore për komisionin që përligj masat e kufizimit fizik	Ministrit të Shëndetësisë	13.06.2003 Përsëritur 2007	Rekomandimi pa përgjigje
<b>14</b>	Ankesa të punonjësve të policisë	Rekomandim: “ Për ndryshimin e urdhërit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1484 datë 18.06.2001, pika 14 dhe urdhër shërbimit Nr. 1172 datë 04.04.2003 të Drejtorit të Policisë së Shtetit pika 8, duke zgjatur afatin e pranimin të ankesave të punonjësve të policisë për gradat deri më 31.12.2004”.	Ministrit të Rendit Publik	16.12.2003	Rekomandimi u pranua më datën 20.01.2004.
		Rekomandim: “ Të rishikohen për ulje tarifave e	Entit		Rekomandimi u pranua.

<b>15</b>	Ankesa të shtetasve.	shitjes së energjisë elektrike të miratura me vendimin e E.R.E Nr. 22 datë 30.12.2003”.	Rregullator të Energjisë	12.02.2004	U ulën pjesërisht tarifat e energjisë elektrike.
<b>16</b>	Ankesa e shtetasit A.T.	Rekomandim: “Për revokimin e Urdhërit Nr. 191 datë 22.04.2002 dhe për mospërfshirjen në përbërje të Komisionit Qëndror të Përmirësimit Racor (KQPR-së) të antarëve të subjekteve të tjera konkurruese”	Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit	12.10.2004	Rekomandimi u pranua. Revokuar me Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit Nr. 223 datë 12.05.2005
<b>17</b>	Me iniciativë të Avokatit të Popullit (Pas inspektimit në dhomat e paraburgimit Berat)	Rekomandim: “Për shfuqizimin e rregullores “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve” miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Nr. 1075/2 datë 15.09.1999 dhe urdhërimin për zbatimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Sistemit të Paraburgimit”, miratuar me urdhër të Ministrit të Dretjesisë Nr. 3750/2 datë 23.07.2003”	Ministrit të Drejtësisë dhe të Rendit Publik	29.03.2005	Rekomandimi u pranua. Kthyer përgjigje se është përgatitur drafti i rregullores ku janë marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet e Avokatit të Popullit
<b>18</b>	Ankesa e shtetasit B.V.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e një pjese të Urdhërit Nr. 110 datë 20.04.2004 të Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës “Mbi miratimin e strukturës së Policisë Elektrike”	Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës. Për dijeni Kryeministrit.	31.03.2005	Nuk është kthyer përgjigje zyrtare.
<b>19</b>	Ankesa e shtetasit L.D.	Rekomandim: “Për bërjen e ndryshimeve në rregulloren e Institutit të Policisë Shkencore, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 751 datë 16.01.2003, duke parashikuar që në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda në ambjentet e policisë ose jashtë saj, por që kanë si autorë të dyshuar punonjës policie, në kqyrjen e vëndit të	Ministrit të Rendit Publik	30.05.2005	Rekomandimi u pranua në parim. Ne datë 16.02.2006 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit sugjeron që t’i drejtohem

		ngjarjes dhe në kryerjen e veprimeve ekzaminuese të marrin pjesë dhe ekspertë privatë të specialiteve përkatëse”.			Prokurorit të Përgjithshëm.
<b>20</b>	Ankesa e shtetasit L.D. Pas vetvrasjes së shtetasit A. D. në Komisarriatin e Policisë Nr. 4 Tiranë.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168 datë 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisarriate, Reparte, Posta të Policisë dhe Zyra të tjera të tyre” si dhe për përgatitjen, miratimin dhe vënien në zbatim të Rregullores së re të shoqërimit të shtetasve në zyrat e policisë	Ministrit të Rendit Publik	28.06.2005	Rekomandimi u pranua. Me urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005, u bë shfuqizimi i urdhërit të mësipërm dhe u miratua Rregullorja e Policisë së Shtetit.
<b>21</b>	Ankesa e shtetasit A. B.	Rekomandim: “Kërkohet shfuqizimi i nenit 10 paragrafi i tretë i Rregullores së Fakultetit Histori Filologji të Universitetit të Tiranës”	Fakultetit Histori Filologji. Rektorit të Universitetit të Tiranës.	30.06.2005	Rekomandimi u pranua. Është shfuqizuar paragrafi i tretë i nenit 10 të Rregullores.
<b>22</b>	Ankesa e të dënuarve Z.F. dhe Gj.R. në Burgun e Burrelit.	Rekomandim: “Për rregullimin çështjes së uljes së dënimit për të dënuarit që punojnë në burgje dhe marrja e masave për korigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 3223 datë 08.10.2004, dërguar Prokurorive në rrethe”.  Rekomandohet revokimi i Urdhërit të ish Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3223 datë 08.10.2004.	Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm  Prokurores së Përgjithshme	22.09.2005  17.07.2008	Rekomandimi nuk u pranua nga Prokurori i Përgjithshëm. dhe Ministri i Drejtësisë.  Rekomandimi është pranuar në parim. Ministria e Drejtësisë ka përgatitur një projektligj për një ndryshim në

					Ligjin nr.8328 date 16.04.1998 “Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim”, qe do te mundesonte revokimin e Urdherit nr. 3223 datë 08.10.2004. Projekt ligji ndodhet per diskutim e miratim ne Keshillin e Ministrave
23	Me iniciativën e Avokatit të Popullit. Vetvrasja e shtetasit A.B. në Komisaratin e Policisë Nr. 3, Tiranë.	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e Kreut XII-të “ <i>shoqërimi i personave</i> ” të Rregullores së Shërbimeve të Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005, si dhe për hartimin e Metodikës së njoftimit të akuzës dhe marrjes në pyetje të personave që dyshohen si autorë të veprave penale, ose që kanë dijeni për rrethana të hetimit”.	Ministrit të Brëndshëm.	22.12.2005	Rekomandimi u pranua në parim pjesërisht, në pikat e propozuara me shpresën e datës 20.02.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Meqenese kjo rregullore ishte nxjerre ne baze e per zbatim te ligjit nr.8553 dt. 25.11.1999 “Per Policine e Shtetit”, i cili eshte shfuqizuar me ligjin nr.9749 dt.4.06.2007 “Per Policine e shtetit”, ne kuadrin e implemtimit te MSA po per-gatitet “Manuali i procedurave te punonjesve te

					Policise te Shtetit”.
24	Ankesa e shtetases L. G. etj.	Rekomandim: “Për dispozitat e reja normative që do të miratohen, për një mbrojtje sa më të mirë si të të drejtave të personelit që kujdeset për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të drejtave të vetë fëmijve”.	Ministrit të Arsimit.	17.01.2006	Rekomandimi u pranua në parim. Është në proces rishikimi i dispozitave normative.
25	Ankesa e shtetases E.S.	Rekomandim: “Per shpejtimin e punes per hartimin e marreveshjes shqiptaro–greke, per perfitimimin e sigurimeve shoqerore nga shtetasit e te dy vendeve”	Ministrit te Punes e Çeshtjeve Sociale Ministrit te Puneve te Jashtme Drejtorit te ISSH	15.02.2006	Rekomandimi i pranua ne parim. Ne muajin Nentor 2008, Ministri i Punës, Çeshtjeve Sociale dhe shanseve te Barabarta, ka kerkuar nga ana e Kryeministrit nxjerrjen e nje urdheri per ngritjen e nje grupi pune nderinstitucional, per pergatitjen e marreveshjeve dypaleshe jo vetem me shtetin Grek por edhe me shtete te tjera ku ndodhen emigrante shqiptare.
26	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandim: “Per pershpejtimin e proçedurave per nxjerrjen e akteve nenligjore ne zbatim te Ligjit Nr. 9381 date 28.04.2005 “Per kompesimin per burgim te padrejte”.	Ministrit te Financave Ministrit te Drejtesise	27.03.2006	Rekomandimi u pranua dhe eshte perpiluar udhezimi i perbashket.
					E.R.E. me vendimin



27	Ankesa të shtetasve dhe organizatave joqeveritare	Rekomandim për mospranimin e propozimit të KESH sha për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë	Entit Rregullator të Energjisë	03.04.2006	nr.27 datë 20.04.2006 nuk pranoi rritjen e çmimeve
28	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Per permiresimin e akteve nenligjore te perbashketa per kqyrjen e vendit te ngjarjes ne ambjentet e Komisariateve te Policise, paraburgimit dhe ne burgje”.	Ministrit te Brendshem Prokurorit te Pergjithshem	07.04.2006	Rekomandimi u pranua.
29	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “Per konstatimin si akt administrativ absolutisht te pavlefshem te Urdherit te Drejtorit te Pergjithshem te Burgjeve Nr. 1522 te vitit 2006 “Per organizimin dhe kryerjen e takimeve speciale”.	Ministrit te Drejtise Kryeministrit	20.04.2006	Rekomandimi u pranua pjesërisht.
30	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Per rishikimin e Udhezimit Nr. 6291 date 17.08.2005 “Per Evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve noteriale si dhe per organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”.	Ministrit te Drejtise Dhomes Kombetare te Noterise	12.05.2006	Rekomandimi u pranua pjesërisht
31	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: “Per krijimin e kushteve te nevojshme Per funksionimin e Komisionit te Sherbimit Alternativ”.	Ministrit te Punes e Çeshtjeve Sociale. Ministrit te Mbrojtjes	26.09.2006	Rekomandimi u pranua. Janë krijuar kushtet
32	Ankesa të Mjekëve	Rekomandim: “Per hartimin dhe nxjerrjen e rregullores Per funksionimin e Qendres Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane.	Ministrit te Shendetesise, Ministrit te	13.10.2006	Rekomandimi u pranua. Hartimi i rregullores eshte ne fazen perfudimtare, draft-teksti

			Arsimit		i rregullores i eshte shperndare per mendim drejtorive te QSUT "Nene Tereza".
33	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet permiresimi i sherbimeve dhe vendosja e tarifave te reja ndaj kompanive te sigurimit per mbulimin e transportit te mjeteve motorike ne rast aksidenti	Agjencise se Mbikqyrjes Financiare	21.03.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Eshte miratuar nje vendim i AMF-se per menyren e trajtimit te demeve nga aksidentet ku jane pasqyruar disa detyrime te reja qe duhet te respektojne kompanite private ne fushen e sigurimeve.
34	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet marrja e masave per te vendosur ne pozita te ligjshme veprimtarine e KESH sh.a, ne kuader te permiresimit te menyres se matjes se konsumit te energjise elektrike, sepse ka përfunduar afati i aplokimit të faturimit afrofe.	Entit Rregullator te Energjise. KESH sh.a	20.04.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Eshte nxjerre vendim per te shtyre afatin e vendosjes se mate-save. Ndersa per zbatimin e faturimit afrofe pa vendim te ERE, KESH sh.a i eshte vendosur gjobe.
35	Me iniciative te Avokatit te Popullit dhe ne bashkepunim me USAID dhe ISPL	Rekomandohet miratimi i rregullores tip "Per shqyrtimin e ankimeve administrative (RTAA)"	Gjithe organeve te Administrates Publike.	5.06.2007	Rekomandimi eshte pranuar dhe pjesa me e madhe e organeve te administrates publike, e

					ka miratuar kete draft te propozuar nga ne si rregullore te brendshme.
<b>36</b>	Me ankese te Dhomes se Tregtise se Bajram Currit.	Rekomandohet marrja e masave per lejimin e transportit te mallrave nepermjet doganes ne piken kufitare te Qafe Morines, Tropoje, si veprim qe nxit zhvillimin ekonomik dhe lehteson shkembimet tregtare te banoreve te zones.	Kryeminsitrit Ministrit te Financave	29.06.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Ne baze te VKM nr.19 dt.19.01.2007, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave emeroi punonjesit e sherbimit doganor ne Qafe Morine.
<b>37</b>	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet marrja e masave per shpalljen e menjehershme ne publik te grafikut te kufizimeve te energjise elektrike ndaj klienteve familjare dhe jofamiljare	ERE KESH sh.a	13.07.2007	Rekomandimi eshte pranuar. KESH sh.a ka kryer publikimin e te gjitha orareve te kufizimeve me ane te njoftimeve te vecanta.
<b>38</b>	Me iniciative te Avokatit te Popullit dhe ne bashkepunim me USAID dhe ISPL	Rekomandohet miratimi i rregullores tip "Per te drejten e informimit".	Gjithe organeve te Administrates Publike.	16.07.2007	Rekomandimi eshte pranuar dhe pjesa me e madhe e organeve te administrates publike, e ka miratuar kete draft te propozuar nga ne si rregullore te brendshme.
<b>39</b>	Ankesa e shtetasit H.P	Rekomandohet eliminimi i parregullsive te aktit administrativ, Rregullore "Per kriteret mjekesore per vleresimin e personave me aftesi te kufizuar",	Ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe	26.07.2007	Rekomandimi nuk eshte pranuar.

		miratuar me urdherin e perbashket te Ministrit te Shendetesise dhe Ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, nr.276 date 8.02.2007.	Shanseve te Barabarta Ministrit te Shendetesise		
40	Me ankese te nje shtetasi	Rekomandohet marrja e masave te menjehershme per rikthimin ne pozita ligjore te gjendjes se krijuar nga levizja e kuadrit ne sektorin e auditit	Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave te Shtetit	30.10.2007	Rekomandimi eshte pranuar. Drejtorise se Pergjithshme te Rezervave te Shtetit, ka nxjerre urdherin per rregullimin e organikes se stafit te auditit te brendshem.
<b>2008</b>					
41	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet hartimi i nje rregulloreje te veçante per emigrantet e paligjshem qe strehon Qendra Pritese e Viktimave te Trafikut, ne Linze, Tirane.	Ministrin te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta Drejtoreshes se Sherbimit Social Shteteror Drejtorit te Qendres Pritese, Linze	16.09.2008	Rekomandimi eshte pranuar ne parim. Nga ana e Ministrise se Drejtesise ka filluar puna per hartimin e kesaj rregulloreje.
42	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet revokimi i pjesshem i Urdherit te Ministrit te Rendit Publik nr.1980 date 4.06.2004	Ministrin te Brendshem	19.09.2008	Rekomandimi eshte pranuar. Kane dale akte

		“Per disa ndryshime ne Udhezimin e Ministrit te Rendit Publik nr.1672 date 22.01.2002 “Mbi procedurat per pajisjen e shtetasve shqiptare me pasaporte per jashte shtetit””.			te tjera ligjore, te cilat kane shfuqizuar urdhezimin e meparshem te Ministrit te Rendit Publik.
43	Ankesa e shtetasit A.V	Rekomandohet plotesimi i Rregullores per Zhvillimin e Matures Shtetore ne Republiken e Shqiperise Kerkohet zbatimi i Rekomandimit per plotesimin e Rregullores per Zhvillimin e Provimeve te Matures Shtetore ne Republiken e Shqiperise, 2009.	Ministrit te Arsimit dhe shkences	23.09.2008 13.02.2009	Rekomandimi nuk u pranua.
44	Me iniciative te Avokatit te Popullit	Rekomandohet ndryshimi i Urdherit nr.18 date 17.01.2008 “Per numrin e te punesuarve ne median e shkruar”, ne Udhezim “Per metodologjine e vleresimit te deklarimeve te subjekteve per numrin e te punesuarve ne median e shkruar”.	Ministrit te Financave	7.10.2008	Rekomandimi eshte pranuar ne parim.
<b>2009</b>					
45	Me iniciative te Avokatit te Popullit	<i>Rekomandohet permiresimi i projekt-rregullores “Mbi standartet dhe proceduren e mbikqyrjes se ekzekutimit te denimeve alternative, si dhe organizimin e funksionimin e sherbimit te proves”.</i>	<i>Ministrit te Drejtesise</i>	4.02.2009	<i>Rekomandimi u pranua. Ka dale VKM nr.302 date 25.03.2009 “Per miratimin e rregullores “Per organizimin e funksionimin e sherbimit te proves e per percaktimin e standardeve dhe procedurave per mbikqyrjen e ekzekutimit</i>

					<i>te denimeve alternative”, ku jane pasqyruar rekomandimet e bera.</i>
46	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet pershpejtimi i punes per nxjerrjen e akteve nenligjore ne zbatim te kerkesave te nenit 10, te Ligjit nr.9110 date 24.07.2004 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave per krimet e renda”.</i>	<i>Presidentit te Republikes se Shqiperise Ministrit te Drejtesise Zv/Kryetarit te KLD-se</i>	27.02.2009	<i>Rekomandimi u pranua. Keshilli i Ministrave ka nxjerre Vendimin nr.480 date 6.05.2009 “Per mbrojtjen e veçante personale, te familjes dhe te prones se gjyqtareve dhe per sigurimin e jetes dhe prones se tyre”.</i>
47	<i>Ankesa e dy mesueseve</i>	<i>Rekomandohet plotesimi i Udhezimit nr.30 date 29.07.2008 te Ministrit te Arsimit dhe Shkences “Per disa ndyshime ne Udhezimin nr.8 date 6.05.1999 “Per pagat e punonjesve mesimore ne arsimin parauniversitar”.</i>	<i>Ministrit te Arsimit dhe Shkences</i>	25.03.2009	<i>Rekomandimi u pranua. (mesueset kane marre shtese ne page, por neve nuk na eshte kthyer pergjigje formale)</i>
48	<i>Ankesa nga shtetas te ndryshem</i>	<i>Rekomandohet nxjerrja e aktit nenligjor per perjashtimin e kategorive ne nevoje te pagimit te tarifave te sherbimit ne zbatim te Ligjit nr.9975 date 20.07.2008 “Per taksat kombetare”.</i>	<i>Ministrit te Financave</i>	6.04.2009	<i>Ne shqyrtim</i>
49	<i>Me iniciative te Avokatit te Popullit</i>	<i>Rekomandohet nxjerrja e një urdhri që Drejtoritë Arsimore të ndalojnë përdorimin e shkollave dhe pjesëmarrjen e nxënësve dhe të mësuesve të shkollave ne mitingjet elektorale te partive politike te vendit gjate orarit te mësimit.</i>	<i>Ministrit te Arsimit dhe Shkences</i>	24.04.2009	<i>Rekomandimi nuk u pranua.</i>

<b>50</b>	<i>Ankesat e shtetasve A.Ç dhe Xh.B</i>	<i>Rekomandohet konstatimi si absolutisht i pavlefshem i Urdherit nr.171 date 30.12.2008 dhe vazhdimi i procedurave per marrjen e titujve akademike ne Universitetin Bujqesor te Tiranes.</i>	<i>Rektorit te Universitetit Bujqesor Tirane</i>	<i>28.07.2009</i>	<i>Ne shqyrtim</i>
<b>51</b>	<i>Ankese e nje grupi studentesh te Universitetit Bujqesor te Tiranes</i>	<i>Rekomandohet zbatimi i Statutit te Universitetit Bujqesor te Tiranes per hyrjen ne fuqi te Rregullores se studimeve te ciklit te dyte ne Fakultetin e Ekonomise dhe Agrobiznesit</i>	<i>Rektorit te Universitetit Bujqesor Tirane</i>	<i>13.11.2009</i>	<i>Ne shqyrtim</i>

## 2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit ("ex officio")

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005, Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjërë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.

Këto ndryshime kanë hyrë në fuqi me 1 Korrik 2005.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar totali i çështjeve të filluara me iniciativë gjatë vitit 2008 dhe 2009.

	<b>2008</b>	<b>2009</b>
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor	<b>50</b>	<b>91</b>
- Jashtë kompetence ose juriksionit	<b>4</b>	<b>2</b>
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim doli se ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë	<b>15</b>	<b>10</b>
- Në shqyrtim	<b>16</b>	<b>7</b>
<b>Totali</b>	<b>85</b>	<b>110</b>



## ANEKSE

Letra Falenderimi nga qytetarët dhe vlerësime të institucioneve.

### 1.

Ju shpreh falenderimet e miya për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në ndjekjen e çështjes sime kundër Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Ppavarësisht nga mos bashkëpunimi i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Avokati i Popullit krijoi te unë një besim akoma më të madh se ky Institucion lufton për të zgjidhur çështjet që i ngrihen në bazë të ligjeve në fuqi.

Meqenëse Ministria ju përgjigj negativisht rekomandimit të Avokatit të Popullit me një shkresë aspak dinjitoze dhe të pa argumentuar profesionalisht nga ana ligjore unë po ndjek rrugën e gjyqit sipas rekomandimit Tuaj.

Duke ju falenderuar edhe një herë shpreh konsideratën time të lartë për Institucionin e Avokatit të Popullit.

10.02.2009

Me respekt  
Simo Koço

### 2.

Quhem Ali Balliu nga Qereka e Krujës, para disa kohësh kam bërë një ankesë lidhur me djegjen e plehrave të Fshatit Qerekë.

Ndërhyrja e Institucionit tuaj që para një viti i cili ka qenë shumë i specializuar dhe ligjor. Ajo bëri që pas një viti shkresa juaj të zbatohet dhe të shkatërrohet ky vend i plehrave. Prandaj ju shpreh ju si Avokat i Popullit mirënjohjen time dhe të fshatit duke u uruar suksese të mëtejshme në punë.

26.02.2009

Me respekt  
Ali Balliu

### 3.

Unë, avokat Petrit Baku, me banim në qytetin e Laçit të rrethit të Kurbinit, kam qenë i pajisur me prokurë të posaçme për përfaqësimin në të gjitha shkallët e gjyqësorit të çështjes civile me palë paditëse dhe palë e paditur Ministria e Financave me objekt dëmshpërblim për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës.

Meqenëse vendimi i gjykatës kishte marrë formë të prerë dhe nuk po ekzekutohet nga Zyra Përmbarimit Tiranë, ju drejtova juve me kërkesën për

ndihmë.Me vullnetin tuaj për ti shkuar çështjes deri në fund, u bë i mundur ekzekutimi i vendimit nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë disa kohë më parë dhe për këtë ju përgëzoj sinqerisht.

Aktualisht jam njoftuar nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë për tu paraqitur, por meqenëse nuk ishte formuluar mirë prokura e posaçme, kam njoftuar klienten time e cila ka ardhur nga Greqia ku punon dhe me sa di unë është në fazën e ekzekutimit të plotë të vendimit.

Edhe njehre ju përgëzoj për punën që keni bërë për këtë çështje dhe unë si përfaqësues ligjor e konsideroj të mbyllur këtë çështje.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin

27.04.2009

Petrit Baku

#### 4.

Falenderojmë punonjësit Tuaj për seriozitetin që i dhanë ankesës sime, në lidhje me çështjen e pronës.

Pas kaq vitesh sorollatje të kota në zyra të ndryshme të shtetit, zyra juaj e përkushtuar për të qenë vërtet Avokat i Popullit, i dha zgjidhje çështjes time për kthimin dhe kompensimin e pronës në Hallias të Tiranës.

Uroj që zyrtarët dhe Komisionerët tuaj të jenë gjithmonë të gatshëm për të përfaqësuar popullin në të gjitha hallet dhe problemet.

17.07.2009

Me shumë respekt  
Behije Hivzi Hoxha

#### 5.

Ju falenderoj shumë dhe ju jam mirënjohës, për interesimin që keni treguar lidhur me largimin tim të padrejtë e të kundraligjshëm nga puna deri në kthimin në punë.E mora edhe përgjigjen tuaj lidhur me këtë problem.

Respektet më të mëdha për ju dhe Institucionin që ju përfaqësoni.

06.10.2009

Me shumë respekt dhe konsideratë  
Naim Kurti

#### 6.

E ndiej për obligim qytetar në emër të mirënjohjes njerëzore të falenderoj shpirtërisht e sinqerisht institucionin e Avokatit të Popullit për seriozitetin në vlerësimin e ankesave të qytetarëve dhe përkushtimin e profesionalizmin e treguar në zgjidhjen me objektivitet të problemeve të tyre.Avokati i Popullit është e vetmja portë, në të cilën ne qytetarët mund të trokasim për të gjetur problemet tona, pasi institucionet përkatëse shtetërore nuk merren me

shqetësimet e qytetarëve dhe zbatimin e ligjit, por me “xhepat” e tyre dhe tallen gjoja duke vënë numra telefoni për denoncim të cilat nuk hapen kurrë. Jam paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit në muajin korrik 2007 për shkak të pushimit në mënyrën më absurde nga puna si pedagog në UBT. Në një kohë të shpejt, pas një hetimi korrekt e juridik 2-3 mujor, me 8 nëntor 2007 institucioni i Avokatit të Popullit me shkresë A92-5 prot datë 08/11/2007 na kthen përgjigje në të cilën rekomandon Revokimin e vendimit nr15. dt 24.05.2007 të rektorit të UBT. Për shkak se ky rekomandim i Avokatit të Popullit nuk u përfill nga rektorët e UBT, Fatos HARIZAJ e Velesin PECULI, u detyrova ta bëj problemin tim gjyqësor. Pas një odiseje gjyqësore gati 2 vjeçare dhe sorollatje nga burokracia gjyqësore Gjykata e Apelit Tiranë me Vendimin nr.361 datë 24.03.2009 konfirmoi Rekomandimin e Avokatit të Popullit, duke shpallur vendimin nr.15 dt 24.05.2007 të rektorit të UBT absolutisht të pavlefshëm dhe kthimin tim në punën e mëparshme si pedagog matematike.

Në qoftë se do të zbatohet Rekomandimi i Avokatit të Popullit i datës 08/11/2007 as unë si qytetar nuk do të sorollatesha dhe as shteti nuk do të dëmtohej ekonomikisht për shkak të drejtuesve të papërgjegjeshmë e të korrumpuar, të cilët e trajtojnë Universitetin si pronë e tyre. E çuditshme është se ndaj këtyre shkelësve të ligjit Ministria e Arsmit ben sehir, megjithë se ne auditimet se saj në UBT pasqyron korrupsionin e tyre.

Jam i mendimit se në media Avokati i Popullit duhet të jetë aktiv për të denoncuar këto veprime skandaloze të drejtuesve të korrumpuar e të paafte, në mënyrë që të mos guxoj ndonjë politikan i babëzitur apo shërbëtor të pushtetit që të bëhen mburojë e tyre.

Edhe një herë ju falenderoj sinqerisht për punën e mirë që bëni dhe ju uroj suksese të mëtejshme në misionin tuaj fisnik

08.10.2009

Me respekt e konsideratë  
Prof.As.Dr Fatmir Gumeni

7.

Avokatit të Popullit, ju faleminderit për punën fisnike që po bëni ndaj meje. Nga shkresa që mora në Shtabin e Përgjithshëm ndodhej emri në bazë të urdhërit që kishte nxjerrë Ministri i Mbrojtjes.

Urdhëri ishte me nr.1256 dt 3.09.2009, por unë dyshoj që është bërë pasi është verifikuar nga Avokati i Popullit, se nuk ndodhej emri im në listën e nxjerrë nga Ministri i Mbrojtjes.

Dyshoj se veprime manipuluese janë bërë në Shtabin e Përgjithshëm ku njerëzit që punojnë atje për të mbajtur në punë shokët fusnin emrin tim në listë.

Po u dërgoj komplet listën me emra dhe kërkoj që ky problem të ndiqet deri në fund nga ana e Avokatit të Popullit deri tek Ministri i Mbrojtjes.

Pres përgjigje nga ana juaj

11.12.2009

Me respekt të thellë  
Astrit Reshat Kusha



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

**I jep**

**INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT**

**Urdhrin "Nënë Tereza"**

*"Për gadishmërinë, humanizmin dhe kurajon e treguar në përmbushjen e misionit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve në Republikën e Shqipërisë."*

Tiranë, më 07.12.2009  
Nr. dekretit 6355

**PRESIDENTI**

**BAMIR TOPI**



## MEDIA ELEKTRONIKE

Nr.	ORGANI	DATA	TITULLI	PASQYRIMI
1	Klan, Alsat, A1	08.01.2009	Kemi kërkuar evidentimin e vatrave me rrezik të shtuar	Pronocim, F. Nuni
2	ARD Tv Gjerman	09.01.2009	AP mbi problemin e shtetasve ujqurë, të strehuar në Shqipëri	Intervistë, E. Dobjani
3	Klan	11.01.2009	AP ka denoncuar 6 subjekte për shkelje në tregtimin e gazit	Njoftim
4	Vizion+	12.01.2009	AP dhe problematika me policinë	Emision, S. Haluci
5	TVSH	14.01.2009	AP mbi dhunën në familje	Emision, R.Poda
6	Ora News	15.01.2009	Largimet nga Administrata dhe trajtimi i tyre nga AP	Emision, R. Konomi
7	Top Channel	21.01.2009	AP dhe te denuarat per droge	Emision, E. Karamuç
8	Ora News	23.01.2009	AP dhe projekti i ri per burgjet	Interviste, E. Karamuç
9	Klan	26.01.2009	AP kritikon pushtetin vendor per lejimin e ndertimeve te paligjshme prane digave dhe dampave	Pronocim, F. Paskali
10	News 24	03.02.2009	AP, libri dhe problematika e tij ne Vila 24	Emision, E.Dobjani
11	TVSH, Klan, Top Channel	05.02.2009	AP pershendet fillimin e punes per Komisionerin e Mbrojtjes se te Dhenave Personale	Pronocim, E. Dobjani
12	TV Kosova-Opinion	07.02.2009	AP ne Shqiperi dhe modeli i tij per Kosoven	Interviste, E. Dobjani
13	Top News	08.02.2009	AP ben raport per shendetin mendor ne vend	Njoftim
14	News 24	09.02.2009	AP: "Jo denime me burg per nenat e te miturve"	Njoftim
15	News 24	09.02.2009	AP viziton ne spital gjyqtarin e plagosur	Njoftim
16	Koha Tv	10.02.2009	AP per nenat e burgosura me femije te vegjel dhe gjendja ne burgje	Emision, E. Karamuç
17	TVSH	16.02.2009	AP dhe te drejtat e femijeve ne Zig-Zag	Emision, A. Nepravishta
18	TV A1	20.02.2009	AP dhe problematika e tij per grate, femijet, dosjet etj	Emision, A. Lazebeu

19	Top News	21.02.2009	AP rekomandon ligjin per investigatorin privat	Interviste, A. Lazebeu
20	Top News	22.02.2009	AP: Grate dhe femijet duhet te kene qeli te veçanta	Njoftim
21	Koha Tv	23.02.2009	AP i kerkon Qeverise te zgjidhe problemin e qiramarrësve ne pronat e pronareve	Prononcim, E. Dobjani
22	News 24	24.02.2009	AP denon dhunen shtetore ndaj Akademise Marubi	Prononcim, E. Dobjani
23	Ora News	24.02.2009	AP mbi konfliktin mes policise dhe akademise Marubi	Interviste, E. Dobjani
24	Vizion+	24.02.2009	AP mbështet Kujtim Çashkun ne konfliktin me policine	Prononcim, E. Dobjani
25	Mediasat	26.02.2009	AP mbi Raportin e Departamentit te Shtetit per te Drejtat e Njeriut	Interviste, E. Dobjani
26	Mediasat	27.02.2009	AP komenton mbi çështjen e akademise Marubi	Interviste, E. Dobjani
27	Vizion+	03.03.2009	AP mbi gjetjet ne sistemin e paraburgimit	Prononcim, A. Lazebeu
28	UFO Tv	03.03.2009	AP dhe problematika ne sistemin penitenciar	Prononcim, E. Karamuçça
29	News 24	04.03.2009	AP ne greven e urise se te semureve para dhe tetraplegjike	Prononcim, E. Dobjani
30	Koha Tv	04.03.2009	AP mbështet grevistet para dhe tetraplegjike	Prononcim, E. Dobjani
31	TVSH, Klan, Top Channel, Ora News, News 24, Vizion+	09.03.2009	Konference Evropjane per Lirine e Informacionit dhe rolin e Ombudsmanit	Njoftim
32	Top Channel	10.03.2009	Bashkepunimi i AP-se dhe Ombudsmanit grek per te drejtat e shqiptareve ne Greqi	Prononcim, J. Kaminis, Omb. Grek
33	Klan	10.03.2009	Abuzimi seksual me femijet ne Shqiperi	Emisioni "Opinion", E. Dobjani
34	News 24	11.03.2009	AP dhe Zevendesministri i Brendshem inspektojne procesin e pajisjes me pasaporta ne disa njesi bashkiake	Njoftim

35	RTSH, Top Channel, Vizion+, Ora News, Koha Tv, Top News, News 24, Alsat etj.	12.03.2009	Probleme gjate mbikqyrjes se procesit te pajisjes se shtetasve me karta identiteti dhe pasaporta	Konferencë Shtypi, E. Dobjani, R. Bosch, Amb. i OSBE-se
36	News 24	12.03.2009	AP per problematiken e pajisjes se shtetasve me pasaporta dhe leternjoftime	Interviste, E. Dobjani
37	Vizion+	13.03.2009	AP mbi problemet e hasura gjate procesit te pergatitjes se pasaportave	Emisioni ZIP, E. Dobjani
38	Vizion+	15.03.2009	AP dhe situata e pasojave te shperthimit ne Gerdec	Prononcim, E. Dobjani
39	Ora News	20.03.2009	AP per çeshtjen e rikthimit dhe kompensimit te pronave	Prononcim, E. Dobjani
40	Klan	26.03.2009	AP ka paralajmeruar me kohe per rrezikun e digave dhe dambave	Prononcim, E. Dobjani
41	Ora News	03.04.2009	AP per gjendjen ne burgje	Prononcim, E. Karamuçë
42	TVSH, Top Channel, Klan, Vizion +, Koha Tv, Alsat etj.	07.04.2009	AP raporton para Komisionit te Ligjeve te Parlamentit per veprimtarine gjate vitit 2008	Njoftim
43	News 24, Ora News	07.04.2009	AP ngre ne Kuvend shqetesimet e qytetareve	Njoftim
44	UFO Tv	09.04.2009	AP dhe veprimtaria e tij	Interviste, E. Dobjani
45	TVSH	16.04.2009	Marredheniet me Publikun si teori dhe praktike	Emisioni Zig-Zag, A. Lazebeu
46	TVSH, Top Channel, Klan, Vizion +, Koha Tv, Alsat etj.	17.04.2009	AP dhe te drejtat e pacientit ne nje trueze te rrumbullaket	Njoftim
47	Klan	17.04.2009	Perse rekomanduar nje ligj te ri "Per Faljen"	Prononcim, A. Lazebeu
48	TVSH, Top Channel, News 24, Klan, Vizion +, Koha Tv, Alsat etj.	21.04.2009	AP dhe Drejtori i Pergjithshem i Policise per rastin dhunes ndaj 15-vjeçarit nga Peshkopia	Konferencë Shtypi, E. Dobjani, A. Prençi



49	Vizion+	27.04.2009	Qeveria te nxjerre akt nenligjor per funksionalizimin e kartave te identitetit ne sherbimet publike	Prononcim, E. Dobjani
50	Shijak Tv	28.04.2009	Femijet nuk duhet te jene pjese e fushatave elektorale	Prononcim, A. Lazebeu
51	News 24	29.04.2009	AP dhe e drejta e ushtarakeve per tu organizuar ne shoqata profesionale	Njoftim
52	News 24	14.05.2009	Mitmarrja ne burgje, fenomen i njohur per ne, por pa prova	Prononcim, E. Dobjani
53	News 24	22.05.2009	AP kerkon masa ndaj policeve qe nuk vepruan, kur u dhunuan te verberit	Njoftim
54	Top Channel	29.05.2009	Gardisti qe nuk veproi per te parandaluar dhunen ndaj te verberve largohet nga puna	Njoftim
55	Koha Tv	04.06.2009	Keqperdorimi i femijeve ne fushata elektorale	Emision, A. Lazebeu
56	News 24	16.06.2009	AP nis Ditet e Hapura per problemet e romeve	Njoftim
57	TVSH, Top Channel, Alsat, Ora News, Top News etj.	17.06.2009	AP nenshkruan marreveshje bashkepunimi me tre OJF ne kuadrin e mirefunksionimit si Mekanizem Kombetar per Parandalimin e Tortures	Njoftim
58	News 24	18.06.2009	Promovohet ne Itali nje liber per AP-ne ne Shqiperi	Njoftim
59	Ora News	01.07.2009	Dilemat e zgjedhjeve tek ora e debatit	Emision, A. Lazebeu
60	TVSH, Ora News	02.07.2009	AP i Kosoves viziton Tiranen	Njoftim
61	Ora News	02.07.2009	Dobjani dhe Kurteshi per zgjedhjet ne Shqiperi	Emision
62	Koha Tv	15.07.2009	AP dhe gjykatat per femijet	Emision, S. Nushi
63	TVSH	23.07.2009	AP per perdorimin e kartave te identitetit	Emision, E. Dobjani
64	Ora News	24.07.2009	AP ne realitetin e paszgjedhjeve	Interviste, A. Lazebeu
65	News 24	27.07.2009	AP inspekton kushtet e ndricimit ne segmentin Tirane-Vore-Rinas	Njoftim
66	News 24	18.09.2009	AP nenshkruan marreveshje bashkepunimi me Zyren e AP te Kosoves	Njoftim

67	RTK	18.09.2009	Dobjani dhe Kurteshi nenshkruajne marreveshje bashkepunimi ne Prishtine	Njoftim
68	Tv. Kombi, Tv. Apollonia	18.09.2009	AP ne dite te hapura ne Fier	Prononcim, A. Lazebeu
69	Ora News	23.09.2009	AP mbi ndotjen akustike nga baret e nates	Interviste, A. Lazebeu
70	Shijak Tv	23.09.2009	AP denoncon dhunen e inskenuar nga gardianet	Prononcim, E. Karamuç
71	News 24	23.09.2009	AP inspektion komunit e goditura nga termeti ne Diber	Njoftim
72	News 24	24.09.2009	AP ben thirrje per kujdes ne trajtimin e rasteve te te miturve ne burgje	Prononcim, A. Lazebeu
73	Zeri i Amerikes	27.09.2009	Reportazh mbi Zyren rajonale te AP-se ne Shkoder	Prononcim, A. Koçobashi
74	BBC	09.10.2009	Problemet e Avokatit te Popullit	Interviste, E. Dobjani
75	News 24	10.10.2009	AP ne ditën boterore te shendetit mendor	Interviste, E. Dobjani
76	Vizion+	20.10.2009	AP:"Hipotekat po marrin pushtetin e gjykatave"	Prononcim, A. Lazebeu
77	News 24	27.10.2009	AP per rastin e lidhjes se vajzave me zinxhire nga i ati	Interviste. E. Dobjani
78	Zeri i Amerikes	05.11.2009	AP denon dhunen ndaj gazetarit Mero Baze	Prononcim. E. Dobjani
79	News 24	05.11.2009	AP dhe pensionet e ushtarakeve	Emision. S. Nushi
80	Scam Tv	07.11.2009	AP, Dhoma e Avokatise dhe Avokati i Shtetit	Emision. E. Dobjani
81	Vizion+	08.11.2009	AP quan te paligjshme nderhyrjen e policise ne Orikum	Njoftim
82	TVSH, News 24, Vizion+, Top Channel etj.	12.11.2009	AP ne Gjykatën Kushtetuese per te drejtat e ushtarakeve	Njoftim
83	TVSH, News 24, Vizion+, Top Channel etj.	18.11.2009	AP ankohet per shkurtime e buxhetit	Njoftim
84	Ora News	19.11.2009	AP flet per paraburgimet, buxhetin dhe rikandidimin e tij per mandatin e trete	Interviste, E. Dobjani

85	Vizion+	26.11.2009	AP dhe çmimi i energjise elektrike	Emision, E. Karamuç
86	TVSH, News 24, Vizion+, Top Channel etj.	26.11.2009	AP debaton ne ERE per çmimin e energjise elektrike	Njoftim
87	Ora News	28.11.2009	Rekomandimi i AP-se per ligjin per faljen	Njoftim
88	News 24	08.12.2009	AP dhe vetevarja e te ndaluarit ne Durres	Emision, S. Nushi
89	TVSH, News 24, Vizion+, Top Channel etj.	10.12.2009	AP feston 10 Vjetorin e krijimit; Konferenca Nderkombetare ku AP dekorohet nga Presidenti i Republikes me Urdherin "Nene Tereza"	Njoftim
90	Koha Tv	10.12.2009	AP dhe sfidat e tij ne 10 vjet	Prononcim, E. Dobjani
91	News 24	10.12.2009	Te drejtat e njeriut me rastin e 61 vjetorit te Deklarates Universale te OKB-se	Emision, A. Lazebeu
92	Scan Tv	11.12.2009	Sa i respektojme te drejtat e njeriut	Emision, A. Lazebeu
93	Top Channel	11.12.2009	Ne ditën e te drejtave te njeriut	Emision, E. Dobjani
94	News 24	15.12.2009	AP dhe aksidentet rrugore	Emision, S. Nushi
95	TVSH	21.12.2009	AP dhe veprimtaria e tij ne 10 vjet	Interviste, E. Dobjani
96	TVSH	21.12.2009	Ku synon te arrije Institucioni i AP-se	Emision, A. Lazebeu
97	TVSH, Top Channel, Vizioin+, Alsat, News24, Ora News etj.	28.12.2009	AP dhe Instituti Evropjan i Tiranes paraqesin Raportin per Permiresimin e Situats ne sistemin e paraburgimit ne Shqiperi	Konferenca Shtypi, E. Dobjani-M.Onorato

## MEDIA E SHKRUAR

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	05.01.2009	Korrieri	Keshilla leximi, AP boton librin "Triptik Mediatik"	Njoftim
2	06.01.2009	Tirana Observer	AP e nis vitin 2009 me librin "Triptik Mediatik"	Njoftim
3	07.01.2009	Shqip	AP ka paralajmeruar: "Kemi edhe 25 Gerdece te tjere"	Artikull
4	08.01.2009	Panorama	AP:"Tirana ne rrezik nga "bombat" e gazit te lengshem"	Artikull
5	08.01.2009	Shekulli	AP:"Tirana rrezikon shperthimin nga karburantet"	Artikull
6	08.01.2009	Standard	AP:"Pikat e gazit, Gerdece ne mes te qyteteve"	Prononcim
7	08.01.2009	Koha Jone	AP denoncon rrezikun e Tiranes nga 50 stacione naftje dhe gazi	Artikull
8	08.01.2009	Shqip	"Bombat Gerdec", ja harta per Tiranen	Artikull
9	08.01.2009	Telegraf	AP"Ju tregoj si shkelen te drejtat e te burgosurve"	Prononcim
10	09.01.2009	Panorama	Kontroll ne Berat, 20 pika shitjeje gazi me rrezik	Njoftim
11	09.01.2009	Telegraf	Ushtaraket mbrohen nga Avokati i Popullit	Njoftim
12	10.01.2009	Gazeta Shqiptare	Çeshtja Kryeziu, nderhyn AP:"Puna e policise, e justifikueshme"	Prononcim, S. Haluci
13	11.01.2009	Shqip	AP:"Ja "bombat" e gazit ne Berat"	Prononcim
14	12.01.2009	Gazeta Shqiptare	AP:"Tregtimi i gazit, jashte standardeve"	Prononcim
15	14.01.2009	55	Te Avokati i Popullit trokit pa ndrojtje ...	Artikull
16	23.01.2009	Shqip	I arratisuri nga burgu kish bere ankese tek Avokati i Popullit	Artikull
17	25.01.2009	Albania	AP i kerkon Ministrit te Mbrojtjes ndermarrjen e nje nisme ligjore per strehimin e ushtarakeve	Artikull
18	27.01.2009	Albania	AP:"Duhet nje ligj per kthimin e pasurise se paluajtshme te sekuestruar"	Prononcim
19	28.01.2009	Metropol	AP:"Floriri i sekuestruar, Kryeministri te nderhyje per paraqitjen e projektligjit"	Prononcim
20	31.01.2009	Albania	AP kerkon kompensimin per floririn e sekuestruar nga komunizmi	Artikull

21	31.01.2009	Tirana Observer	Rekomandimi i AP-se dhe bombolat e plasura ne pikat problematike te gazit	Artikull
22	01.02.2009	Shqip	AP:"Rrezik depozitat e naftes ne Rinas dhe port"	Prononcim, A. Lazebeu
23	05.02.2009	Albania	AP i rekomandon qeverise projektligj per familjet e policeve te vrare edhe para 1999	Njoftim
24	08.02.2009	Shqip	AP harton raport per gjendjen e shendetit mendo rne Shqiperi	Artikull
25	08.02.2009	Ballkan	AP:"Mbrojtja e femijeve, te ndryshohet Kodi i Procedures Penale"	Prononcim
26	08.02.2009	Panorama	AP:"Kontrolloret e tregut te zhytur ne korrupsion"	Prononcim
27	08.02.2009	Republika	AP rekomandon ndryshime ne ligj per mbrojtjen e femijeve	Njoftim
28	08.02.2009	Sot	AP:"14-vjeçaret mund te gjykohen nga drejtesia si te rritur"	Prononcim
29	09.02.2009	Gazeta Shqiptare	AP rekomandon jo denime me burg per nenat me femije	Njoftim
30	10.02.2009	Zeri i Popullit	AP"Jo burgim per nanat me femije te mitur"	Njoftim
31	10.02.2009	Albania	AP:"Te ndermerren nisma ligjore per mbrojtjen e jetes se gjyqtareve"	Prononcim, E. Dobjani
32	10.02.2009	Korrieri	Dobjani shoqeroi ne spital gjyqtarin Nuni	Artikull
33	14.02.2009	Koha Jone	AP:"Kemi ankesa per zvarritje te gjykimit"	Prononcim, E. Dobjani
34	14.02.2009	Shekulli	AP i kerkon qeverise dergimin e te paafteve mendore ne nje spital te posaçem	Njoftim
35	15.02.2009	Sot	AP kerkon masa urgjente per te semuret psikike ne burgje	Artikull
36	15.02.2009	ATSH	AP bashkepunon fuqishem me strukturat nderkombetare per te drejtat e njeriut	Interviste, A. Lazebeu
37	17.02.2009	Panorama	AP vlereson se Paraburgimi i Korçes eshte ne kushte te renda	Njoftim
38	17.02.2009	Shekulli	Ne Korçe s'ka ambjente per femrat dhe te miturit	Njoftim
39	18.02.2009	Albania	AP rekomandon zgjidhje ligjore per qiramarrësit ne shtepite e ish-pronareve	Njoftim

40	20.02.2009	Shekulli	AP u pergjigjet te burgosurve shqiptare ne Patra te Greqise, permes letres se Ombudsmanit Grek	Njoftim
41	22.02.2009	Ballkan	AP: "Te rritur e te mitur ne nje qeli"	Njoftim
42	22.02.2009	Sot	AP: "Qelite ne Komisarriatin e Korçes, ne kushte skandaloze"	Prononcim
43	22.02.2009	Tirana Observer	AP: "Ende nuk jane çregjistruar nga regjistrat e Gjendjes Civile, 6345 persona"	Prononcim, E. Dobjani
44	22.02.2009	Shqip	AP: "Mos neglizhoni qiramarresit ne prona private"	Prononcim, E. Dobjani
45	24.02.2009	Shekulli	AP rekomandon qe femijet te mbahen larg mitingjeve elektorale	Prononcim, A. Lazebeu
46	25.02.2009	Sot	AP kerkon qe çeshtja Marubi te zgjidhet ne gjykate	Njoftim
47	25.02.2009	Ballkan	AP: "Mbeshtesim akademine Marubi"	Prononcim, E. Dobjani
48	25.02.2009	Gazeta Shqiptare	AP: "Incidenti me Kujtim Çashkun, ndal dhunes shtetore"	Prononcim, E. Dobjani
49	25.02.2009	Korrieri	AP konstaton dhune shtetore ne Akademine Marubi	Njoftim
50	25.02.2009	Zeri i Popullit	AP: "Dhuna te Marubi, e denueshme nga ligji"	Prononcim, E. Dobjani
51	27.02.2009	Ballkan	AP kerkon vendosjen e kamerave ne burg per shmangien e dhunes	Njoftim
52	27.02.2009	Koha Jone	AP: "Paraburgimi ne Pogradec, jashte standardeve"	Njoftim
53	28.02.2009	Gazeta Shqiptare	AP i rekomandon Ministrise se Brendshme pastrimin e regjistrat te shtetasve	Njoftim
54	28.02.2009	Korrieri	AP kerkon pastrimin e listave nga votuesit e vdekur dhe ata qe e kane lene shtetesine shqiptare	Njoftim
55	28.02.2009	Shekulli	AP kerkon pastrimin e listave te votuesve potenciale	Njoftim
56	04.03.2009	Shekulli	AP: "Mungesa e kamerave ne burg, krijon rrezik"	Njoftim
57	05.03.2009	Sot	Greva e paraplegjikeve, AP i kerkon Qeverise t'i jape zgjidhje	Artikull
58	05.03.2009	Zeri i Popullit	AP: "Paraplegjiket te dalin nga greva, jane te semure"	Prononcim, E. Dobjani

59	05.03.2009	Republika	Apeli i AP-se, paraplegjiket te dalin nga greva, jane te semure	Prononcim, E. Dobjani
60	05.03.2009	Albania	AP:"Qeveria te pranoje kerkesat e paraplegjikeve"	Njoftim
61	05.03.2009	Gazeta Shqiptare	AP:"Grevistev duhet t'u plotesohen kerkesat"	Prononcim, E. Dobjani
62	05.03.2009	Shqip	AP:"Plotesoni kerkesat e grevistev"	Prononcim, E. Dobjani
63	06.03.2009	Ballkan	AP:"Ja pse ka deshtuar vendosja e kasave elektronike tatimore".	Prononcim, E. Dobjani
64	10.03.2009	Koha Jone	Presidenti i Republikes dhe Ministri i Drejtesise shkembjne vleresime te kunderta ne konferencen e organizuar nga Avokati i Popullit	Njoftim
65	10.03.2009	Shekulli	AP organizon Konferencen Evropjane per te drejten e informimit	Njoftim
66	10.03.2009	Ballkan	Ne Konferencen e organizuar nga AP:"Ne trashegojme nje mentalitet komunist, ku gjithçka ishte e censuruar"	Njoftim
67	10.03.2009	Shqip	Kreu i shtetit merr pjese ne Konferencen e organizuar nga AP dhe Ombudsmani grek	Njoftim
68	10.03.2009	Korrieri	AP:"Duhet mbrojtur zyrtaret qe u kerkenohet vendi i punes nga shefat"	Prononcim, E. Dobjani
69	10.03.2009	Sot	AP fut ne "sherr" Presidentin me Ministrin e Drejtesise, per te drejten e informimit dhe pronat	Artikull
70	10.03.2009	Metropol	E drejta per informim, Presidenti dhe Ministri i Drejtesise replikojne ne tryezen e Avokatit te Popullit	Njoftim
71	12.03.2009	Shekulli	AP i ka rekomanduar MASH-it ndryshimin e Nenit 26 te Rregullores se Matures Shteterore	Artikull
72	13.03.2009	Shqip	AP:"Kartat e identitetit, mungon transparencja"	Konference Shtypi, Dobjani-Bosch
73	13.03.2009	Tema	AP-OSBE: Problematika e pajisjes me leternjoftime	Njoftim
74	13.03.2009	Sot	AP dhe OSBE kerkojne transparence ne procesin e pajisjes me leternjoftime	Njoftim
75	13.03.2009	Panorama	AP:"Te semuret dhe te burgosurit nuk kane ku te aplikojne"	Njoftim

76	13.03.2009	Telegraf	AP-OSBE: Nese nuk zgjidhen problemet me kartat, rrezikohen zgjedhjet	Njoftim
77	13.03.2009	Koha Jone	AP, kritika per listat, kartat, dublikimet dhe mungesen e transparences nga Sagem	Njoftim
78	13.03.2009	Albania	AP:"Procesi i kartave te identitetit ne faze kritike"	Njoftim
79	13.03.2009	Republika	AP-OSBE:Tarife me te ulet per te papunet dhe pensionistet	Njoftim
80	13.03.2009	Zeri i Popullit	AP per kartat e identitetit, procesi ne faze kritike	Njoftim
81	13.03.2009	Korrieri	Bosch dhe Dobjani:"Kartat po rrezikojne zgjedhjet"	Njoftim
82	13.03.2009	Korrieri	AP ne Raportin Vjetor:"Ne Gerdec u shkel e drejta e jetes"	Artikull
83	13.03.2009	Gazeta Shqiptare	OSBE dhe AP kritikojne procesin e pajisjes me leternjoftime	Njoftim
84	13.03.2009	Gazeta Shqiptare	AP dorezon Raportin Vjetor ne Kuvend per shkeljet e administrates	Artikull
85	13.03.2009	Gazeta Shqiptare	AP ne Raportin Vjetor 2008:"Prokuroria dhe Gjykata, 214 ankesa per abuzime ne drejtesi"	Artikull
86	13.03.2009	Gazeta Shqiptare	AP ne Raport:"Lume ankesash per ndertimet pa leje dhe shperblimin e ish te perndjekurve"	Artikull
87	13.03.2009	Shekulli	AP kritikon procesin e pajisjes me leternjoftime	Njoftim
88	13.03.2009	Shekulli	Neper faqet e Raportit Vjetor te AP-se per 2008	Artikull
89	13.03.2009	Metropol	Raporti i AP-se per 2008 nxjerr "zhveshur" te pathenat e mijera qytetareve shqiptare	Artikull
90	13.03.2009	Metropol	AP, gardiani i te drejtave te njeriut	Artikull
91	14.03.2009	"55"	AP:"Vleresojme procesin e shperndarjes se kartave, mbeshtesim edhe shtrengesat e shpallura nga Ministria e Brendshme"	Prononcim, E. Dobjani
92	14.03.2009	Gazeta Shqiptare	Raporti i Dobjanit, reference tek "GSH"	Njoftim
93	15.03.2009	Ballkan	Raporti i AP-se, 233 te keqtrajtaur	Njoftim
94	15.03.2009	Ballkan	AP:"Zvarritje ne njohjen e pronesise dhe regjistrimin e pasurise"	Njoftim



95	15.03.2009	Korrieri	Raporti i AP-se: "Zgjidhje urgjente per ish-ushtaraket"	Njoftim
96	15.03.2009	Korrieri	Raporti i AP-se:"240 shkelje te afateve hetimore nga Prokuroria"	Njoftim
97	15.03.2009	Panorama	AP:"Pse duhet mbyllur burgu i Burrelit"	Njoftim
98	18.03.2009	Tirana Observer	AP:"Te pergatitet ligji per kompensimin e pasurive te luajtshme, te sekustruara nga regjimi komunist"	Artikull
99	18.03.2009	Shekulli	AP inspekton burgjet si Mekanizem Kombetar per Parandalimin e Tortures	Njoftim
100	19.03.2009	Albania	AP kerkon shtyrjen e afatit per demshperblimin e ish-te perndjekurve	Artikull
101	22.03.2009	Ballkan	Rriten pagat per Hipotekat dhe Avokatin e Popullit	Njoftim
102	22.03.2009	Albania	AP:"Te mbyllet burgu fameqeq i Burrelit"	Artikull
103	23.03.2009	Metropol	AP:"Pakenaqesite per hipotekat kane te bejne me mosnjohjen e ligjit"	Artikull
104	23.03.2009	Metropol	AP rreshton pese problematikat ne ambientet e burgjeve	Artikull
105	23.03.2009	Telegraf	AP:"Demshperblimi i te perndjekurve, jo i plote"	Prononcim
106	23.03.2009	Telegraf	Amendimet e AP-se per kategorite e lena jashte demshperblimit	Artikull
107	24.03.2009	Koha Jone	Matura, refuzohet kerkesa e AP-se per regjistrimin ne provime edhe pa deftese origjinale	Artikull
108	25.03.2009	Gazeta Shqiptare	MASH refuzon AP-ne per ndryshimin e rregullores se Matures Shteterore	Artikull
109	26.03.2009	Shekulli	AP kerkon rritjen e masave te sigurise ne spitalet psikiatrike	Njoftim
110	28.03.2009	Gazeta Shqiptare	Gjyqtarja A. Llazari ne Shkoder kerkon angazhim me te madh te AP-se dhe Bashkise per mbrojtjen e te drejtave te femijeve	Artikull
111	28.03.2009	Shekulli	Prokuroria e Shkodres per akuzat e policise ndaj AP-se	Prononcim, A. Lazebeu
112	28.03.2009	Gazeta Shqiptare	AP i shkruan Ministrit te Drejtesise per pajisjen me karta identiteti te 5000 te burgosurve	Njoftim
113	29.03.2009	Sot	Rikthehet ne pune oficeri i Sarandes qe u ndoq penalisht pas rekomandimit te AP-se	Artikull

114	29.03.2009	Telegraf	AP rekomandon pajisjen me karta identiteti te te burgosurve	Artikull
115	31.03.2009	Gazeta Shqiptare	AP: "Kartat, Qeveria te qartesoje menyren e kompensimit"	Njoftim
116	31.03.2009	Telegraf	AP kerkon shpjegime per vonesen e kompensimit per kartat e identitetit	Njoftim
117	31.03.2009	Tirana Observer	Raporti i AP-se per rrezikun e digave	Artikull
118	01.04.2009	Tirana Observer	Alarmi i AP-se behet bindes: nis te shfaqet rreziku i shembjes se digave	Artikull
119	02.04.2009	Panorama	Kontrolli, AP kritika paraburgimit	Njoftim
120	02.04.2009	Tirana Observer	AP perpilon nje rekomandim per kompensimin e pasurive te luajtshme	Njoftim
121	02.04.2009	Tirana Observer	Incidenti AP-Polici, Prokuroria mbyll çeshtjen	Prononcim, A. Lazebeu
122	02.04.2009	Gazeta Shqiptare	Raporti i AP-se: "Femijet jetime flene ne ambjente me lageshtire"	Artikull
123	03.04.2009	Metropol	AP dergon inspektoret ne komisarjatin e Ersekës	Njoftim
124	04.04.2009	Ballkan	AP: Ne Komisarjatin e Ersekës, te shoqeruarit mbahen pa u shenuar orari	Njoftim
125	04.04.2009	Albania	AP: "Mjeket ne Psikiatri, te kercenuar nga pacientet"	Prononcim
126	06.04.2009	Koha Jone	AP kerkon ndryshimin e udhezimit qe diskriminon arsimtaret me shkolle te larte	Njoftim
127	06.04.2009	Gazeta Shqiptare	AP, leter Ministrit te Drejtesise per kartat e te denuarve	Njoftim
128	07.04.2009	Shekulli	AP per rritjen e normes ushqimore ne spitalet psikiatrike	Artikull
129	07.04.2009	Albania	AP kritikon faktin qe mesuesit me shkolle te larte paguhen si te jene me gjimnaz	Artikull
130	08.04.2009	Shekulli	AP kritikon Kryetaren e Kuvendit se nuk shperndan raportet	Njoftim
131	08.04.2009	Shqip	AP raporton: Raportet tona flene ne Kuvend	Njoftim
132	08.04.2009	Ballkan	Gjate 2008, ne zyrat e AP-se jane regjistruar 1312 ankesa per Ministrine e Drejtesise dhe te Brendshme	Njoftim
133	08.04.2009	Albania	AP raporton para Komisionit te Ligjeve per 2008	Njoftim

134	08.04.2009	Koha Jone	AP ka depozituar ne Kuvend tre raporte me shqetesime te qytetareve, te cilat prej kohesh flene aty	Artikull
135	08.04.2009	Korrieri	AP kerkon ndryshimin e ligjeve, per t'i dhene me shume te drejta per shqyrtim çeshtjesh	Njoftim
136	08.04.2009	Metropol	PD-PS te pakenaqura me Dobjanin ne Komisionin e Ligjeve	Njoftim
137	08.04.2009	Telegraf	AP raporton per punen e 2008-es	Njoftim
138	08.04.2009	Metropol	Monitorimi i AP-se ne spitalet psikiatrike	Artikull
139	08.04.2009	Panorama	AP: "Votat te numerohen me skaner"	Njoftim
140	08.04.2009	Sot	AP i shqetesuar per morine e ankesave te qytetareve prane institucionit te tij	Artikull
141	08.04.2009	Standard	Raporti i Dobjanit: Te mos perdoren femijet ne fushate	Njoftim
142	08.04.2009	Zeri i Popullit	AP ben thirrje qe femijet te mos perdoren ne fushate	Njoftim
143	08.04.2009	Albanian Daily News	Thuajse gjysma e ankesave prane Ombudsmanit jane jashte juridiksionit	Njoftim
144	10.04.2009	Ballkan	AP kritikon perseri komisarjatin e Sarandes	Njoftim
145	12.04.2009	Standard	Gjendja ne komisarjate, Dobjani rekomandime Nishanit	Artikull
146	13.04.2009	Metropol	AP rekomandon ndalimin e dhunes ne burgje	Njoftim
147	15.04.2009	Albania	Rrezohet kallezimi penal i Policise se Shkodres ndaj Dobjanit	Njoftim
148	16.04.2009	Standard	AP rekomandon ligj te ri per faljen e te denuarve	Njoftim
149	16.04.2009	Albania	AP: "Ndryshimet qe duhen bere ne ligjin per faljen"	Prononcim
150	16.04.2009	Ballkan	AP: "Te rishikohet ligji per faljen e te denuarve"	Prononcim
151	16.04.2009	Panorama	AP kerkon ndryshime ne ligj, menjehere pas dekretit te Presidentit te Republikes	Njoftim
152	16.04.2009	Standard	AP kerkon rindertimin e shtepise se femijes ne Tirane	Njoftim
153	17.04.2009	Zeri i Popullit	AP rekomandon ligj te ri "Per faljen" e te denuarve	Njoftim
154	18.04.2009	Shqip	AP konstaton probleme serjoze ne trajtimin e grave dhe femijeve	Njoftim

155	18.04.2009	Albania	AP kerkon perjashtimin nga taksat te veteraneve te luftes	Artikull
156	18.04.2009	Shqip	AP kerkon perfshirjen e te drejtave te pacientit ne nje dokument ligjor	Njoftim
157	18.04.2009	Gazeta Shqiptare	AP:"Spitalet tona nuk respektojne pacientet"	Prononcim
158	18.04.2009	Koha Jone	AP tregon rastet e pacienteve qe trokasin tek ai	Prononcim
159	18.04.2009	Shekulli	AP:"Te drejtat e pacienteve te mbrohen me ligj"	Prononcim
160	19.04.2009	Shekulli	AP:"Qendrat psikiatrike kane probleme komplekse"	Prononcim
161	22.04.2009	Shqip	AP dhe Drejtori i Pergjithshem i Policise denojne dhunen ndaj 15-vjeçarit ne Peshkopi	Konferencë Shtypi, E. Dobjani-A. Prençi
162	22.04.2009	Metropol	Dhuna ndaj te miturit, ndeshkohen policet pergjegjes	Njoftim
163	22.04.2009	Tema	Dhuna ndaj minorenit, ndeshkohen 7 police	Njoftim
164	22.04.2009	Standard	Keqtrajtimi, Dobjani e Prençi penalizojne 4 punonjes policie	Artikull
165	22.04.2009	Panorama	Dhuna ne Diber, fortune ne polici	Artikull
166	22.04.2009	Albania	AP denon dhunen ndaj 15-vjeçarit	Njoftim
167	22.04.2009	Ballkan	AP dhe Drejtori i Pergjithshem i Policise se Shtetit padisin pese punonjes policie	Njoftim
168	22.04.2009	Koha Jone	Dhuna, ndeshkohen 4 police	Njoftim
169	22.04.2009	Korrieri	AP:"Si u dhunua gjimnazisti ne komisarjat"	Prononcim
170	22.04.2009	Republika	Dobjani-Prençi:"Punonjesit e policise te zbatojne vetem ligjin"	Prononcim
171	22.04.2009	RD	Incidenti ne Diber, merren masa ndaj shtate efektivave te policise	Njoftim
172	22.04.2009	Shekulli	Keqtrajtohet 15-vjeçari, ndeshkohen 7 punonjes policie	Njoftim
173	24.04.2009	Sot	AP kerkon te merren masa per te semuret mendore ne burgje	Njoftim
174	24.04.2009	Panorama	AP kerkon masa per torturen ne policine e Peshkopise	Artikull
175	24.04.2009	Telegraf	AP kerkon qe te semuret mendore te çohen ne burgun e Krujes	Njoftim

176	24.04.2009	Ballkan	Inspektimi i AP-se, 70 te denuar, te semure psikike, ne gjendje kritike	Prononcim
177	25.04.2009	Albania	AP kerkon ndryshime ne Kodin Penal lidhur me pezullimin e ekzekutimit te vendimeve, kur eshte bere kerkesa per rivendosjen ne afat te se drejtes se ankimimit	Artikull
178	25.04.2009	Panorama	AP:"Institucionet dhe ambasadat nuk njohin ende kartat e identitetit"	Prononcim
179	25.04.2009	Shekulli	AP:"Pa mjek 70 te denuar te semure mendore"	Prononcim
180	25.04.2009	Sot	Leternjoftimet e reja, AP kerkon nxjerren e nje akti nenligjor	Njoftim
181	26.04.2009	Zeri i Popullit	AP"Instiucionet dhe ambasadat nuk njohin kartat e identitetit"	Njoftim
182	27.04.2009	Gazeta Shqiptare	AP""Psikiatria e Durresit nuk ploteson kushtet"	Prononcim
183	27.04.2009	Korrieri	Te burgosurit me semundje mendore, deshton sistemi	Artikull
184	27.04.2009	Panorama	AP:"Te denuarit ne mungese izolohen padrejtesisht"	Prononcim
185	28.04.2009	Gazeta Shqiptare	AP, Ermir Dobjani ne bulevardin VIP	Interviste, E. Dobjani
186	28.04.2009	Gazeta Shqiptare	AP kerkon ndalimin e femijeve ne fushata	Njoftim
187	28.04.2009	Ballkan	AP Kryeministrit:Femijet, jo ne fushata elektorale	Njoftim
188	28.04.2009	Koha Jone	AP erkon nxjerrjen e nje urdhri per ndalimin e femijeve ne aktivite elektorale	Njoftim
189	28.04.2009	Zeri i Popullit	AP Kryeministrit: Femijet, jo pjese e fushatave elektorale	Njoftim
190	29.04.2009	Telegraf	AP:"Stop femijeve ne fushate"	Prononcim
191	01.05.2009	Ballkan	AP konstaton shkelje ne komisariatet e Delvines dhe Himares	Njoftim
192	01.05.2009	Panorama	AP dhe Instituti per Demokraci dhe Ndermjetesim, takim per krijimin e sindikates se ushtarakeve ne detyre	Njoftim
193	02.05.2009	Gazeta Shqiptare	AP:Merrni masa, qelite te mjerueshme	Njoftim

194	02.05.2009	Gazeta Shqiptare	Rekomandimi i AP-se perpajisjen e te denuarve me leternjoftime	Njoftim
195	04.05.2009	Zeri i Popullit	Dobjani:"Shteti te zbardhe urgjentisht vrasjen e deputetit Xhindi"	Prononcim
196	04.05.2009	Shekulli	Dobjani:"Shteti te zbardhe shkaqet e ngjarjes"	Prononcim
197	04.05.2009	Korrieri	AP:"Te gjenden shkaqet dhe vrasesit e deputetit"	Prononcim
198	04.05.2009	Mesuesi	AP dhe permiresimi i mbrojtjes se te drejtave te femijeve ne Shkoder	Prononcim
199	15.05.2009	Ballkan	AP pranon abuzimet me lejet e te denuarve	Prononcim
200	15.05.2009	Zeri i Popullit	AP pranon ankesa te tjera nga burgu i Rrogozhines	Prononcim
201	15.05.2009	Republika	AP dhe Instituti Evropjan i Tiranes, projekt per permiresimin e sistemit te paraburgimit	Njoftim
202	15.05.2009	Sot	Mitmarrja ne burgje, fenomen i njohur per Avokatin e Popullit	Prononcim
203	18.05.2009	Metropol	AP:"Grave tek Burgu 313 u mungojne lavatriçet"	Artikull
204	22.-5.2009	Metropol	AP kontrollon komisarjatet, naten, por nuk gjen probleme shqetesuese	Artikull
205	23.05.2009	Shekulli	AP i pergjigjet lexuesve nga Rubiku per mosmbulimin me vale televizive	Prononcim
206	23.05.2009	Tema	AP kerkon ndeshkimin e punonjesve te gardes qe nuk vepruan ndaj dhunesit te te verberve	Njoftim
207	23.05.2009	Gazeta Shqiptare	Letra e Dobjanit: Ndeshkim gardisteve indiferente	Njoftim
208	23.05.2009	Zeri i Popullit	AP kerkon masa ndaj policeve qe bene sehir	Njoftim
209	23.05.2009	Ballkan	AP:"Te ndiqen gardistet qe lejuan shkeljen"	Njoftim
210	24.05.2009	Ballkan	AP:"Dhunimi i te verberve, i mazhi i ulet i shtetit"	Njoftim
211	24.05.2009	Albania	Inspektimi i AP-se, verehen mangesi ne paraburgimin e Tiranes	Njoftim
212	24.05.2009	Shqip	Rekomandimi i AP-se per dhomat e shoqerimit dhe kontrollin mjekesor te te paraburgosurve	Njoftim

213	24.05.2009	Tirana Observer	Letra e AP-se per dhunen e ushtruar nga biznesmeni	Njoftim
214	24.05.2009	Korrieri	Dhuna ndaj te verberve, AP kerkon ndeshkimin e gardisteve	Njoftim
215	24.05.2009	Panorama	AP mbi dhomat e izolimit ne kryeqytet	Njoftim
216	27.05.2009	Panorama	AP per problemet e ushtareve ne Bunavi	Artikull
217	28.05.2009	Panorama	AP zbuloi se ushtaret hyne ne repart pa asnje kontroll mjekesor	Artikull
218	28.05.2009	Gazeta Shqiptare	Ministri i Arsimit i kthen pergjigje AP-se per pjesemarrjen e femijeve ne mitingje: "Me mitingjet tona edukojme femijet."	Artikull
219	29.05.2009	Tirana Observer	Ombudsmani Parlamentar i Bullgarise viziton Tiranen	Njoftim
220	29.05.2009	Albania Daily News	Ombudsmani Bullgar takohet me personalitetet e larta shqiptare	Njoftim
221	30.05.2009	Klan	AP dhe Ministri i Arsimit, pikepamje te ndryshme per perfshirjen e femijeve ne fushaten elektorale	Njoftim
222	01.06.2009	Metropol	Garda i pergjigjet AP-se: Oficerin qe nuk veproi ndaj dhunimit te te verberve, e larguam nga puna	Artikull
223	07.06.2009	Ballkan	AP mbi mbrojtjen e te dhenave personale	Artikull
224	18.06.2009	Tirana Observer	AP: Ja si dhunohen femijet ne policine e Tiranës	Artikull
225	18.06.2009	Zeri i Popullit	AP heton dhunen ndaj te miturve ne paraburgim	Njoftim
226	18.06.2009	Ballkan	AP ben raport per dhunen ndaj te miturve ne policine e Tiranës	Njoftim
227	18.06.2009	Gazeta Shqiptare	AP jep alarmin per dhune ndaj te miturve ne ambientet e paraburgimit	Artikull
228	18.06.2009	Shekulli	AP dhe tre OJF nenshkruajne marreveshje per monitorimin dhe parandalimin e tortures	Njoftim
229	19.06.2009	Metropol	Reagon Policia ndaj AP-se: "Asnje i paraburgosur nuk eshte dhunuar"	Njoftim
230	19.06.2009	Agon	AP konstaton perseri dhune ndaj te miturve	Artikull
231	19.06.2009	Ballkan	Perplasja, Policia pergenjeshtron Avokatin e Popullit	Njoftim
232	19.06.2009	Shqip	Policia "sulmon" AP-ne: Askush nuk eshte dhunuar	Artikull

233	19.06.2009	Standard	Policia AP-se: Nuk ka dhune ndaj te miturve ne paraburgim	Njoftim
234	19.06.2009	Sot	Dhuna ne burgje, Policia e Tiranes i kunderpergjigjet Avokatit te Popullit	Njoftim
235	20.06.2009	Sot	AP, mjet i ri institucional per mbrojtjen e te drejtave te njeriut	Njoftim
236	21.06.2006	Ballkan	AP, Dobjani, nderohet ne Itali me çmimin e Fondacionit per Propozime te reja Kulturore	Njoftim
237	21.06.2009	La Gazzetta del Mezzogiorno	AP ne anen e qytetarit	Artikull
238	04.07.2009	Albania	AP i Kosoves takohet me Kryetaren e Gjykates se Larte	Njoftim
239	04.07.2009	Ballkan	Shpresa Beçaj pret AP-ne e Kosoves	Njoftim
240	04.07.2009	Shqip	AP i Kosoves takohet me Presidentin, Kryetarin e Gjykates Kushtetuese dhe Kryetaren e Gjykates se Larte	Njoftim
241	04.07.2009	Standard	AP i Kosoves takohet me personalitetet e larta shqiptare	Njoftim
242	04.07.2009	55	Shqiperi-Kosove, bashkepunim ne fushen e te drejtave te njeriut	Njoftim
243	04.07.2009	Republika	Bashkepunim ne fushen e te drejtave te njeriut mes Shqiperise dhe Kosoves	Njoftim
244	04.07.2009	Metropol	AP heton skandalin "Deliu", per qytetarin e harruar ne burg pa vendim gjyqate	Artikull
245	06.07.2009	Metropol	Sot gjykata informon AP-ne per qytetarin Deliu	Artikull
246	13.07.2009	Tirana Observer	AP informon Parlamentin per burgjet	Artikull
247	15.07.2009	Telegraf	AP çon ne Gjykate ligjin e ri per Policine e Shtetit	Njoftim
248	15.07.2009	Albania	AP zbulon rastin e mbajtjes per kater vjet ne burg pa vendim gjyqesor	Artikull
249	16.07.2009	Shqip	AP bashkohet me shqetesimin e policise dhe ushtrise per pensionet	Njoftim
250	16.07.2009	Gazeta Shqiptare	AP: "Burgu i Korçes ne gjendje skandaloze"	Njoftim
251	17.07.2009	Albania	AP çon ne Kushtetuese ligjin per verifikimin e titujve te pronesise	Artikull



252	17.07.2009	Telegraf	AP:"Raste flagrante te dhunes ne burgje, paraburgim dhe komisarjate policie"	Interviste, S. Haluci
253	17.07.2009	Metropol	Ankesat e radhes te AP-se, pas inspektiveve ne burgje	Njoftim
254	17.07.2009	Tirana Observer	AP leshon alarmin pas kontrollit ne burgun e Korçes	Njoftim
255	18.07.2009	Albania	AP ka kerkuar ndryshimin e neneve te dy ligjeve per pronat	Njoftim
256	20.07.2009	Panorama	AP:"A. Shuli 14 dite ne qeli, edhe pasi Gjykata e kishte liruar"	Prononcim, S. Haluci
257	23.07.2009	Albania	AP çon ne Kushtetuese ligjin per pensionet e ushtarakeve	Artikull
258	26.07.2009	Albania	Rekomandimet e Dobjanit per Burgun e Korçes	Artikull
259	27.07.2009	Shekulli	AP:"Te ndryshohen pensionet e ushtarakeve"	Artikull
260	28.07.2009	Albania	AP, Ministrit te Brendshem:"Merrni masa qe "Sagem" te garantoje shperndarjen normale te dokumenteve"	Njoftim
261	28.07.2009	Shekulli	Shoqata e Ushtarakeve ne Rezerve mbeshtet AP-ne ne kerkesen per Kushtetuesen	Njoftim
262	29.07.2009	Albania	AP:"Nishani te marre masa per procesin e pasaportave biometrike"	Njoftim
263	29.07.2009	Gazeta Shqiptare	AP nderhyn per keqtrajtimet ne burgun e Korçes	Njoftim
264	30.07.2009	Albania	AP:"Vini dore mbi ndriçimin dhe sinjalistiken rrugore"	Njoftim
265	30.07.2009	Gazeta Shqiptare	Rruget, harta e plote e burimit te aksidenteve	Njoftim
266	30.07.2009	Ballkan	AP:"Ne segmentin Tirane Durres nuk ka ndriçim"	Njoftim
267	31.07.2009	Tema	AP:"Shteti, pergjegjes per aksidentet rrugore"	Artikull
268	31.07.2009	Gazeta Shqiptare	AP kerkon reduktimin e ndotjes akustike ne Tirane	Artikull
269	31.07.2009	Tirana Observer	Dhuna ne burgun e Korçes, zyrtaret nen hetim	Njoftim
270	31.07.2009	Tirana Observer	AP referon diplomatin francez: Rruget i keni pa sinjalistike	Njoftim

271	31.07.2009	Ballkan	AP:"Ja ku mungon sinjalistika, shkak per aksidente"	Njoftim
272	31.07.2009	Ballkan	Francezi, banor i Bllokut ankohet per muziken e larte tek AP	Njoftim
273	31.07.2009	Tirana Observer	AP inspekton baret e nates ne ish-Bllok	Artikull
274	10.09.2009	Koha Jone	AP nderhyn per takimin e çiftit ne spitalin e burgut	Njoftim
275	22.09.2009	Shekulli	AP:"Zhurmat ne bllok jashte normave te lejuara"	Artikull
276	22.09.2009	Koha Jone	AP dergon ne Gjykatën Kushtetuese ligjin per verifikimin e titujve te pronesise	Artikull
277	22.09.2009	Albania	AP ankimon ne GJ.K ligjin per titujt e pronesise	Artikull
278	23.09.2009	Shekulli	AP ngre shqetesimin per ndotjen akustike ne lokalet e nates	Prononcim, A. Lazebeu
279	23.09.2009	Tirana Observer	AP inspekton dhunen ne burgun e Shen Kollit	Artikull
280	23.09.2009	Tema	AP kerkon ndeshkimin e gardianeve qe stimuluan dhunen	Artikull
281	23.09.2009	Standard	Vonesa ne zbardhjen e vendimeve, Dobjani kritikon Gjykatën e Larte	Artikull
182	23.09.2009	Standard	AP:Te permiresohet gjendja ne burgun e Rrogozhines	Prononcim
283	23.09.2009	Standard	Dhuna ne burg, AP rekomandon masa ndaj pergjegjesve	Njoftim
284	23.09.2009	Sot	AP veren rastet flagrante te dhunes ne burgun e Lezhes	Njoftim
285	23.09.2009	Republika	Dhune ne burgun e Lezhes, reagon AP	Njoftim
286	23.09.2009	Panorama	Dhuna ne burg, AP heton 5 policet	Njoftim
287	23.09.2009	Panorama	AP kritikon Gjykatën e Larte per moszbardhjen e vendimit ne kohe	Njoftim
288	23.09.2009	Panorama	AP padit Qeverine ne Kushtetuese: U shkelen 6 nene te Kushtetutes	Njoftim
289	23.09.2009	Albania	Kushtetuesja degjon ankesat e AP-se per Ligjin e verifikimit te titujve te pronesise	Njoftim
290	23.09.2009	Ballkan	Inspektoret e AP-se verifikojne sherrin ne burgun e Shenkollit	Njoftim
291	23.09.2009	Korrieri	AP padit ne GJ.K ligjin e Qeverise per titujt e pronesise	Njoftim

292	23.09.2009	Gazeta Shqiptare	AP publikon raportin pas inspektimit per dhunen ndaj te denuarve	Njoftim
293	23.09.2009	Gazeta Shqiptare	Gjykata Kushtetuese merr parasysh ankesen e AP-se	Njoftim
294	24.09.2009	Shekulli	AP i rekomandon Prokurorise hapjen e çeshtjes penale per dhunen ndaj te miturit ne Drenove	Artikull
295	06.10.2009	Shekulli	AP:"Te demshperblehen qytetaret qe demtohen nga zhurmat"	Interviste, A. Lazebeu
296	18.10.2009	Gazeta Shqiptare	AP:"Ne paraburgimin e Kukesit mungojne shtreterit"	Njoftim
297	19.10.2009	Koha Jone	Komisarjati i Beratit, kushte te mjerueshme	Njoftim
298	19.10.2009	Ballkan	AP kritikon kushtet ne komisarjatin e Beratit	Njoftim
299	19.10.2009	Korrieri	AP rekomandim policise per kushtet ne komisarjate	Njoftim
300	19.10.2009	Gazeta Shqiptare	Kontrolli i Dobjanit:"Ne komisarjate mungojne ambjentet per te mitur"	Njoftim
301	25.10.2009	Albania	AP:"Ligji per Gjykatat Administrtrive ka shume mangesi"	Prononcim, E. Dobjani
302	26.10.2009	Panorama	Avokati i Popullit dhe Gjykata Kushtetuese	Artikull
303	29.10.2009	Koha Jone	AP:"Te mendojme serjozisht per te semuret mendore".	Artikull
304	30.10.2009	Koha Jone	Skandali i paralajmeruar nga AP	Prononcim. A. Lazebeu
305	31.10.2009	Gazeta Shqiptare	AP:"Te merren masa per digen e liqenit artificial"	Njoftim
306	01.11.2009	Albania	AP:"Ligji i ri i le ish-ushtaraket pa asistence"	Njoftim
307	01.11.2009	Korrieri	Dobjani-Bashes:"Paguajini policet ne reforme"	Prononcim. E. Dobjani
308	02.11.2009	Metropol	Shoqatat e ushtarakeve, AP dhe shteti shqiptar perballe njeri tjetrit	Njoftim
309	02.11.2009	Koha Jone	Raporti i AP-se jep alarmin per te semuret mendore qe nuk trajtohen	Artikull
310	02.11.2009	Koha Jone	AP nuk eshte vetem per policine dhe burgjet	Interviste. A. Lazebeu
311	03.11.2009	Korrieri	AP dhe shoqatat e ushtarakeve ne Gjykatën Kushtetuese	Njoftim

312	03.11.2009	Albania	Ankesat e ushtarakeve ne Gjykatën Kushtetuese	Njoftim
313	03.11.2009	Koha Jone	AP kundërshton shtete nene te ligjit per ushtaraket	Artikull
314	06.11.2009	Albania	AP:"Qeveria po perdor policine e shtetit per interesa private"	Prononcim. E. Dobjani
315	06.11.2009	Shqip	AP rekomandon plotesimin e boshllekut ligjor per sherbimet shtese te policise	Njoftim
316	07.11.2009	Albania	400 banore kerkojne nderhyrjen e AP-se per rrezikun nga diga e liqenit	Artikull
317	07.11.2009	Tema	AP:"Nderhyrja e Policise se Shtetit ne Orikum, e paligjshme"	Artikull
318	07.11.2009	Korrieri	Dobjani:"Policia shkeli ligjin ne Orikum"	Artikull
319	07.11.2009	Sot	Dobjani verejtje Edi Rames: Mjafdt me gjobitjen e qytetareve	Artikull
320	08.11.2009	Sot	AP:"Bashkia te demshperbleje gjobat e padrejta"	Artikull
321	09.11.2009	Gazeta Shqiptare	AP"MPJ lë pa sigurime grate e diplomateve	Artikull
322	09.11.2009	Ballkan	AP i kerkon MPJ-se te paguaje sigurimet e grave te diplomateve	Njoftim
323	09.11.2009	Koha Jone	Ish ambasadoret ankohen te AP:"Na ngelën grate pa sigurime"	Artikull
324	09.11.2009	Shekulli	AP:"Qe nga 2005, familjeve te diplomateve nuk u jane paguar sigurimet"	Artikull
325	09.11.2009	Shqip	Dobjani, leter Metës: "Paguani sigurimet e grave te diplomatëve"	Artikull
326	11.11.2009	Panorama	Ankesa e familjareve, AP inspekton qeline e Dritan Dajtit	Njoftim
327	12.11.2009	Libertas	AP, presion ERE-s per çmimin e energjise	Artikull
328	12.11.2009	Ballkan	AP:-ERE-s: "Mos e rrisni çmimin e energjise"	Njoftim
329	12.11.2009	Sot	AP kerkon paanesi nga ERE ne shqyrtimin e kerkeses per rritje te çmimit te energjise	Njoftim
330	12.11.2009	Shekulli	AP:"ERE te mbroje konsumatorët"	Njoftim
331	12.11.2009	Republika	AP, kerkese ERE-s:"Veproni ne interes te konsumatorit"	Njoftim
332	12.11.2009	Metropol	Dobjani-Nepravishta: Qytetaret te paguaje faturat	Prononcim

333	12.11.2009	Zeri i Popullit	AP takohet me Kryetarin e ERE-se per çmimin e energjise	Njoftim
334	12.11.2009	Korrieri	Rritja e çmimit te energjise, Dobjani kerkese ERE-s	Artikull
335	13.11.2009	Koha Jone	AP ne ERE: Mbron konsumatoret	Artikull
336	19.11.2009	Panorama	AP shprehet per buxhetin e institucionit te tij	Artikull
337	29.11.2009	Albania	AP nxit Ministrine e Brendshme te beje gati projektin per pagesen kalimtare te policeve	Artikull
338	01.12.2009	Zeri i Popullit	AP kerkon ndryshime ne ligjin per amnistine	Njoftim
339	01.12.2009	Ballkan	AP rekomandon ndryshime ne ligjin per faljen e te denuarve	Njoftim
340	02.12.2009	Koha Jone	AP rekomandon ndryshime ne ligjin per faljen e te denuarve	Prononcim, A. Lazebeu
341	10.12.2009	Shekulli	AP si Mekanizem Kombetar per Parandalimin e Tortures	Njoftim
342	11.12.2009	Zeri i Popullit	AP, 10 vite pune kunder fenomeneve negative	Njoftim
343	11.12.2009	Panorama	AP ne ditën e te drejtave te njeriut	Njoftim
344	11.12.2009	Telegraf	10 vjetori i AP-se, marrin pjese ambasadoret dhe kreu i shtetit	Njoftim
345	11.12.2009	Metropol	Institucioni i AP-se dekorohet ne "ditelindjen" e tij	Njoftim
346	11.12.2009	Sot	Topi dekoron Institucionin e AP-se me Urdherin "Nene Tereza"	Njoftim
347	11.12.2009	Gazeta Shqiptare	Ambasadoret vleresojne rolin e institucionit te AP-se	Njoftim
348	11.12.2009	Albania	AP shenon 10-vjetorin e krijimit dhe 61 vjetorin e Deklarates Universale te te Drejtave te Njeriut	Njoftim
349	11.12.2009	Shqip	Dobjani, Burgajt: Merr masa per vetevrasjen ne Komisariatin e Durresit	Artikull
350	11.12.2009	Ballkan	Topi dekoron Dobjanin me Urdherin "Nene Tereza"	Njoftim
351	11.12.2009	Koha Jone	Dobjani: Pse i bejme oponence qeverise	Njoftim
352	11.12.2009	Korrieri	Respektimi i te drejtave, dekorohet Dobjani	Njoftim
353	11.12.2009	Shekulli	10 vitet e Avokatit te Popullit	Artikull, E. Dobjani

354	13.12.2009	Tema	Incident i rende, policia nuk lejon inspektimin e AP-se ne paraburgimin e Komisarariatit 4	Artikull
355	14.12.2009	Ballkan	AP-Mjekesise Ligjore: "Ekzaminoni te vetevretet ne burgje dhe paraburgim".	Njoftim
356	15.12.2009	Panorama	AP: "Te shqyrtohen akuzat e familjareve te vetevarurit"	Njoftim
357	21.12.2009	Shqip	Pas ngjarjes se Orikumit, Dobjani rekomandoi ligjin per sherbimet policore ndaj te treteve dhe tarifave perkatese.	Njoftim
358	26.12.2009	Shekulli	AP dhe shqiptaret ne burgun e Shkupit	Artikull
359	26.12.2009	Panorama	AP shqiptar dhe maqedonas per te burgosurit respektive	Artikull
360	26.12.2009	Gazeta Shqiptare	AP i kerkon Qeverise informacion per shqiptaret e burgosur ne Shkup	Njoftim
361	26.12.2009	Standard	AP shkrese Ministrise se Drejtesise per te burgosurit shqiptare ne Shkup	Njoftim
362	26.12.2009	Albania	AP: "Transferoni te burgosurit shqiptare nga Maqedonia"	Artikull
363	29.12.2009	Gazeta Shqiptare	AP dhe Instituti Evropjan i Tiranes (IET), projekt per permiresimin e sistemit te paraburgimit	Njoftim
364	29.12.2009	Albania	AP zbardh perdhunimine te miturit ne qeline e Korçes	Njoftim
365	29.12.2009	Standard	AP: "Kushtet ne burgje vazhdojne te jene jo te mira"	Prononcim, E. Dobjani
366	29.12.2009	Sot	AP: "Te semiret ne Spitalin e Burgut mbahen te lidhur me zinxhire"	Njoftim
367	29.12.2009	Shekulli	Raporti i IET dhe AP-se per gjendjen ne paraburgimin shqiptar	Njoftim
368	29.12.2009	Korrieri	Raporti i ITE-se dhe AP-se: "Te paraburgosurit detyrohen te flene dy veta ne nje krevat"	Njoftim
369	29.12.2009	Koha Jone	AP dhe IET: "Situata ne paraburgim, alarmante"	Konference Shtypi
370	30.12.2009	Metropol	AP i kerkon pergjigje Ministrit te Drejtesise per te denuarit shqiptare ne Maqedoni	Artikull

STATISTIKE PERMBLEDHESE E MBULIMIT MEDIATIK 2009

**MEDIA E SHKRUAR**

a)



<b>Artikuj</b>	<b>Njoftime</b>	<b>Intervista</b>	<b>Prononcime</b>	<b>Konferenca shtypi</b>	<b>Gjithsej</b>
104	195	5	63	3	370

**MEDIA ELEKTRONIKE**

b)


<b>Njoftime</b>	<b>Prononcime</b>	<b>Intervista</b>	<b>Emisione</b>	<b>Konferenca shtypi</b>	<b>Gjithsej</b>
26	26	16	27	3	98

**Ankesa me shkrim te trajtuara gjate vitit 2009**  
**Totali 2911**






**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2009, pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit**  
**Totali 2705**





**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda  
juridiksionit gjatë vitit 2009  
Totali 1559**




- Ankesa të padrejta
- Ankesa në favor
- Me rekomandim ose propozim te refuzuar
- Heqje dore

**Gjendja e ankesave të marra në shqyrtim gjatë vitit 2009**  
**Totali 3165**




**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë  
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2009  
Totali 1547**



- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.


**Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2009**  
**Totali 3734**



Ankesa të trajtuara gjatë vitit 2009 (2546 të vitit 2009 dhe 365 të mbartura nga viti 2008)


Ankesa të paraqitura në zyrën e pritjes së popullit, gjatë vitit 2009, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë

**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000 - 2009,  
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)  
Totali 32726**




**Ankesa te ardhura ne vite**

**Krahasimi i ankesave të zgjidhura ne favor për vitet 2000 - 2009,  
Totali 5476**




## Shperndarja e ankesave te regjistruara gjate vitit 2009 sipas institucioneve Totali 2546 raste





**MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2009**



**MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2009**

